

Pär Edlirén

M. M. Kuhn

Shpenguar prej Krishtit

-roman-

Përktheu nga origjinali anglisht:
M. M. Kuhn



Titulli:

Shpënguar prej Krishtit

Autori:

M. M. Kuhn

Titulli në origjinal:

“Redeemed by Christ”

Botoi në Kanada:

FriesenPress
Suite 300-852 Fort Street
Victoria, BC, Canada V8W 1H8
www.friesenpress.com

Përktheu në shqip:

M. M. Kuhn

Përgatiti për botim në shqip:

Pëllumb Zekthi

Redaktore:

Anita Paza

Design:

Erbilin Zekthi

Kopertina:

Belina Koxhaj

© Copyright 2014:

M. M. Kuhn

“dy Lindje

dy Perëndime”

Rr. Vëllezërit Manastirliu, Tiranë.

Mob.: ++355 69 58 97 373

PROLOG

Është një mëngjes i thëllimtë janari, po brenda, ende shtrirë në shtrat, falenderoj Perëndinë për këtë shtëpi të bukur e të ngrohtë që kam. Si zakonisht, im shoq kërcen nga krevati duke tërhequr çarçafët dhe jorganin pjesërisht në shesh, del nga dhoma dhe e lë derën hapur. Unë i tërheq mbulesat prapë mbi vete me shpresë që të fle sërish, por mund t'ia dëgjoj ende hapat që heq zvarrë mbi dërrasat e lëmuara të dyshemesë në drejtim të kuzhinës. Ai mbush çajnikun me ujë të filtruar nga frigoriferi dhe e vendos mbi djegësen më të madhe të sobës së çeliktë. Ndërsa uji zien, i afrohet derës së jashtme, ngre gazetën nga pragu i ngrirë dhe e vendos mbi tavolinën e rrumbullakët në kuzhinë. Pastaj bluan kafënë e tejppjekur me mullirin e zhurmshëm elektrik dhe e zbraz në termusin e kafesë, duke e tundur brenda termusit me tingëllimën më të bezdisshme, si prej çange. *U pa puna e gjumit tim! Ah, sikur të pushoja me sytë mbyllur edhe për disa minuta më tepër!*

Uji i zier fillon të fishkëllejë dhe im shoq kthehet sërish tek soba, ngre çajnikun dhe e derdh në termus. Ndërsa e lë kafënë të rrijë për disa minuta, ndez televizorin mbi vatrën përballë me volumin në maksimum. Shtyp pistonin e termusit deri në fund dhe derdh kafënë në filxhanin e madh bojë qielli. Ulur në karrige tek tavolina e kuzhinës përballë televizorit, lexon gazetën.

Në ndryshim nga unë, për tim shoq, mëngjesi është vakti më i parapëlqyer. E vetmja gjë e gjallë që ka nevojë për vëmendjen e tij kaq herët, janë dy macet tona lozonjare: Bardhoshja, e imtë, e shkathët, e bardhë me njolla kafe dhe të zeza, dhe Hirushja, e ngadaltë, e majme, bojë hiri. Unë qesh me vete kur e dëgjoj t'i thotë Bardhoshes të hiqet nga gazeta. Pastaj dëgjoj fëshfërimën e këmbëve të tij duke iu afruar dhomës së gjumit.

- Mund të jenë të interesuar të marrin vesh se si u takuam - thotë im shoq duke qëndruar më këmbë pranë anës sime të krevatit.

“Me sa duket, vate dhe pushimi i syve!” - them me vete, ndërsa përpiqem

me vështirësi të ndaj qepallat nga njëra-tjetra. Duhet të jetë diçka, për të cilën ia vlen të më zgjojë, përndryshe nuk do të guxonte. Në pesëmbëdhjetë vjet martesë, nuk ka më asgjë të paqartë mbi oraret tona të gjumit. Ai fle me pulat dhe zgjohet me këndesin; unë rri natën vonë dhe fle deri vonë.

Ai vendos një copë të grisur të gazetës së atij mëngjesi mbi krevat dhe kthehet në kuzhinë. Nuk mund ta përmbaj dot kuriozitetin. Ashtu e përgjumur, ngrihem ngadalë dhe kërkoi syzet mbi komodinën prej druri të errët te koka e krevatit. Ngre gazetën para meje dhe filloj të lexoj artikullin, për të cilin më ka zgjuar im shoq. Gazeta po kërkon histori “zemre” interesante për artikullin e posaçëm të Shën Valentinit, që është duke u afruar.

E pranoj. Idea që historia jonë mund të përzgjidhet nga gazeta është ngacmuese. Ndoshta im shoq ka të drejtë; ndoshta do të ishin të interesuar ta dëgjonin. Gjumi më del fare, ndërsa i kthehem sërish leximit të shpalljes. Sfida e vërtetë do të jetë ta përshkruaj me më pak se dyqind fjalë, sipas kërkesës së gazetës. Kam kaq shumë për të thënë. Nga do t’ia filloja, po të shkruaja diçka të tillë?

Ngrihem me vrull nga krevati dhe sjell artikullin e grisur tek im shoq, që vazhdon të lexojë gazetën te tavolina në kuzhinë duke ngacmuar Bardhoshen me një laps të vogël.

- Kështu na u miqësokeni ju të dy çdo mëngjes? – i them duke parë macen që përpiqet të nxjerrë me putrën e mprehtë lapsin e ngecur poshtë tabakasë rrotulluese në qendër të tavolinës, që është në të njëjtën lartësi me banakët e kuzhinës.

- Vjen ashtu, si pa dashur dhe ulet mbi gazetë duke më ledhatuar fytyrën me bisht, - thotë im shoq pa u bezdisur aspak nga ndërprerja që i bën Bardhoshja rrjedhës së tij të mëngjesit.

- Femër hesapi! Si gjithmonë kërkuese, - i them, ndërsa i ulem në prehër me krahun rreth qafës.

Mezi pres që im shoq të ikë në punë, me qëllim që të bëj një provë me historinë tonë. *Një llaf goje!* Ulem para kompjuterit dhe ia ngul sytë ekranit të bardhë për njëfarë kohe. Ai më shikon mbrapsht pa më thënë asgjë. Kam plot për të thënë, vetëm se duhet t’i rreshtoj mendimet me rregull.

Mbase më rreshtohen po të shikoj postën elektronike. E hap kutinë e lajmërimeve të ardhura dhe njoftimi i një fotografie, në të cilën jam emërtuar, më kap vëmendjen menjëherë. Vendos të ndjek fillin për tek faqja e adresës së vet. Omari, një nga shokët e mi më të ngushtë të viteve të shkollës së lartë, ka shpallur një fotografi bardhë e zi të disa prej të rinjve që morën pjesë në grevën treditëshe të urisë me shtatëqind e ca studentë në shkurt të njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e një. Ndërsa shikoj me dhembshuri fytyrat e tyre të hequra dhe flokët e gjata, më ringjallen kujtimet e një kohe dhe vendi të largët që më konfirmojnë thirrjen për t’i shkruar të gjitha.

KAPITULLI I

NË POGRADEC

Në pranverën e vitit njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e dy, mimozat e verdha ishin në lulëzim të plotë dhe po mbushnin rrugët dhe parqet e qytetit Studenti me aromën e tyre dehëse. Isha në vitin e katërt të inxhinierisë elektronike në Universitetin Politeknik të Tiranës. Një grup prej njëzet e ca studentësh nga klasa ime kishin vendosur të largoheshin nga shkolla për një fundjavë pas një sezoni provimesh të gjatë e të lodhshëm. Mezi po e prisja çlodhjen dhe kënaqësinë në praninë e shokëve të mi në qytetin e vogël lindor dhe piktoresk të Pogradecit, që shtrihet në brigjet jug-perëndimore të liqenit të Ohrit.

Tanimë, pas tre vjet e gjysmë në të njëjtën klasë e në të njëjtat mbrëmje, unë e shokët e mi ishim bërë një rrjetë e dendur miqsh të ngushtë. Disa prej tyre e kishin marrë shoqërinë një çikë më seriozisht dhe kishin filluar nga çiftosjet. E pse jo? Koha po fluturonte dhe vetëm një vit po na mbetej nga shkolla. Unë isha përpjekur ta përfytyroja veten pranë më të shumtëve të mundshëm, por asnjëri prej tyre nuk arrinte ta plotësonte figurën. Vetëm tik-taku i orës sime biologjike nuk më mjaftonte për t'u shtruar me “Z. Pothuajse”. E kisha përfytyruar shpesh të ishte misterioz, i panjohur, i largët. Edhe pse dashuria po ndodhte rreth e rrotull dhe zemra ime kishte kohë që ishte në pritje, kisha vendosur të prisja për të duhurin, në vend që të vendosja vetëm ngaqë po më kalonte mosha.

Po e prisja udhëtimin katër-orësh për në Pogradec me po aq kënaqësi sa mbrëmjen atje. Më kishte pëlqyer gjithmonë biseda me të njohur rishtaz gjatë udhëtimeve të përmuajshme me tren nga shkolla në shtëpi. Kjo hekurudhë kishte edhe disa tunele që përshkonin malet lindore.

Ky udhëtim do të ishte një shkëputje e këndshme nga ngjarjet turbulluese të së kaluarës së fundit në kryeqytet dhe një normalitet rinie pa kokëçarje.

Vetëm pak më shumë se një vit më parë bota politike shqiptare ishte tundur që nga themelet. Regjimi komunist dyzetegjashtë vjeçar njëpartiak u përmbys, kur një lëvizje e fuqishme studentore filloi në konviktet dhe rrugët e ngushta të qytetit Studenti. U derdh prej andej në rrugët kryesore të Tiranës vetëm për t'u shumëfishuar nga shpirtrat e meruar të burrave dhe grave pleq e të rinj, që ishin ngopur me shtypjen dhe kalbjen në vend. Qindra studentë u ngujuan në qendrën kulturore të qytetit Studenti për një grevë urie treditore derisa qeveria sunduese njëpartiake përmbushi kërkesat e tyre për heqjen e emrit të diktatorit të vdekur nga universiteti i tyre. U bashkuan në revolta edhe disa nga profesorët tanë të rinj dhe filmuan me guxim me kamerat e fakultetit. Ishte gjendja sa emocionuese, po aq edhe e nderë, megjithëse asgjë nuk mund ta ndalte atë “tren”.

Kur im atë ish komunist dëgjoi për lëvizjen studentore, i hipi trenit për në Tiranë dhe erdhi të më takonte. E dija sa në merak ishte gjithmonë për mua, kështuqë mendova se do të më merrte në shtëpi derisa të kalonte gjendja. Përkundrazi, për çudinë dhe kënaqësinë time të papritur, më nxiti të bashkohesha me shokët e mi në demonstratë. “Mos marsho në radhët e para, por edhe mbrapa fare mos rri,” - më këshilloi.

Rrëmuja që erdhi pas lëvizjes studentore ishte më e vështira, por edhe kjo ishte qetësuar disi tani. Qindra të rinj ikën nga vendi drejt vendeve evropiane duke u futur në ambasadat e tyre në Tiranë, ose duke kaluar kufirin tokësor juglindor me Greqinë, por shumë prej atyre që mbetën mbrapa nuk kishin asnjë lloj frike nga qeveria e shembur dhe pa autoritet.

Leo, një shok klase nga Pogradeci, na kishte rezervuar për atë natë, disa dhoma tek Kampi i Punëtorëve anës liqenit . Kampi i punëtorëve ishte një hotel i ndërtuar dhe drejtuar nga qeveria për pushimet dyjavore të punëtorëve, zakonisht gjatë muajve të nxehtë të verës. Duke qenë se ishte fillimi i pranverës, kampi ishte pothuajse bosh dhe rezervimi i vendeve bëhej me lehtësi.

Arritëm te kampi i punëtorëve pak pas orarit të drekës. Isha ulur në buzë të një karrigeje në sallën e hyrjes, e mbështetur mbrapa me këmbët e shtrira përpara, për t'i çmpirë nga rruga e gjatë me tren. Të lodhur e të uritur po prisnim me shpresë që Leo t'u hidhte sirrën grave të kuzhinës për ndonjë gjë për të ngrënë të mbetur nga dreka. Tani, një shok nga “elektriksi”, me të cilët kishim bërë gjithë leksionet në dy vitet e para, më ishte ulur pranë.

-Pesëdhjetë lekë atij që bën një vertikale tani, - tha me të folurën e tij edhe më të ngadalte se zakonisht nga rruga e lodhshme.

- Ç'e do që di ta bëj vetëm duke u mbështetur në mur, - ia prita unë dhe u ula drejt në karrige, pothuajse gati. *Këtë kush nuk e bën?! S'ma merr mendja ta hajë kaq kollaj.*

- Hajde se po të lë të përfitosh nga bujaria ime sot. Bëje pas murit, - u përgjigj Tani dhe nuk i besohej që u ngrita në këmbë para se të mbaronte fjalinë. U drejtua në karrige.

Të nxjerr gjysmën e rrugës unë, pa, s'më bëhet vonë se po bëj lolon akrobat. I mora paratë, i futa në xhepin e palicetave kadife bezhë dhe iu afrova njërit prej mureve bosh në sallën e hyrjes së hotelit.

Mos! Harrova që palicetat e mia kanë një vrimë te tegeli i shtratit. Ç'u bë, u bë! Nuk e çbëj dot më tani! Do të më duhet të ngre këmbën e parë pas të dytës më shpejt se ç'mund ta dallojë njeri shqepjen. Pastaj, gjithë idea e kësaj aventure është të shkëthem dhe të kënaqem një çikë. Më shumë se për liqenin apo qytetin e vogël piktoresk, këtu jemi për gjëra të çmendura si kjo vertikale dhe mbrëmja me shokët.

Përpjekja për të justifikuar budallallepsjen time, nuk pati ndonjë efekt në skuqjen e fytyrës sime më pas, por mjaft të mos shikoja rreth e rrotull se kush më pa dhe të ulesha prapë në karrige me mjekrën te gjoksi sa më shpejt që të mundesha.

Mezi po prisja për vallëzimin që kishim planifikuar për atë mbrëmje në hotel. Kisha sjellë edhe magnetofonin tim dhe një tufë kasetash me këngë rroku.

Të kërcyerit ishte një nga pasionet e mia të fëmijërisë. Isha mahnitur kur njëra nga shoqet e mia më tregoi disa pirueta që kishte mësuar duke u përgatitur për konkursin e pranimit në shkollën e vetme të baletit në vend. Shkolla ishte në kryeqytet, njëqindesë kilometra në veri të vendlindjes sime. Kush do më linte mua, çupën e vetme të babit, të jetoja në konvikt që në moshën dhjetë vjeçare, apo të më linte të bëhesha balerinë? Ato kërcëjnë me funde të shkurtra dhe kapen e ngrihen peshë nga meshkujt kërcimtarë me tuta të ngushta dhe gunga të mëdha përpara.

- Pse mos të bëhesh inxhinierë me rrogë të mirë dhe të këndosh e kërcesh për qejf kur të duash? – thoshte Xhimi, vëllai im i madh, kur mbështeste babin në përpjekje për të më pështirosur ndonjë karrierë në arte. – Pastaj, ti i ke edhe talentin, edhe dashurinë për matematikën e shkencat, - vazhdonte.

Pa pasur gjë në dorë, iu nënshtrova vullnetit të shumicës mashkullore në familje dhe u regjistrova në gjimnazin pesë minuta larg shtëpisë. Siç kishte parashikuar im vëlla, kalova shumë mirë në gjimnaz dhe dola me nota të mjaftueshme për të vazhduar universitetin.

Leo u tha të gjithëve që, më në fund, darka ishte përgatitur dhe ne të gjithë u drejtua për te mensa përbri sallës së hyrjes. Vura re një ushtar simpatik afër sportelit të pritjes, që nuk m'i shqiste sytë duke buzëqeshur. *Mos! Do të më ketë parë vertikalen.*

- Do bëkeni qejf sonte, ë? – tha. – Do vij dhe unë.

- E pse më thua mua? Sikur është mbrëmja ime që të ftoj njeri, - iu përgjigja me mospërfillje dhe vazhdova me shoqet e mia për te mensa para se t'i jepja mundësinë të fillonte bisedën.

Më në fund, na u shtrua darka e shumëpritur. *Sigurisht, fasulet qenkan gjella më e parapëlqyer edhe në këto anë. Me sa duket, nuk paskemi ardhur as për ushqimin e mirë.* Po aq të uritur sa ishim tani, edhe fasulet ishin të shijshme. Vështrova rreth e rrotull tavolinave dhe qesha nën zë duke parë gjithë këta njëzeteca vjeçarë të babëzitur me kokat mbi gjellë, derisa u kujtova që të njëjtën gjë po bëja edhe vetë. Kur e ndala vështrimin kullotës te tavolina përballë simes, vura re shpinën e panjohur të një të riu që po hante në të njëjtën tavolinë me Tanin dhe Timon. *Po ky, nga doli këtu? Si nuk e vura re gjithë atë rrugë me tren? Si përfundim, ky udhëtim mund të na dalë interesant!*

- Ej, Timo! Pse nuk na prezanton me këta shokët e rinj ti ne? – e pyeta me padurim.

Gjatë viteve të shkollës, Timo ishte bërë shoku im më i ngushtë. Ata që e njihnin që nga gjimnazi, flisnin me shumë respekt për inteligjencën e tij që në fillim të shkollës, gjë që më bënte të ndjehesha e ndrojtur dhe pa fjalë sa herë që kishim mësim së bashku. Frika se mos thosha ndonjë budallallëk në sy të tij zgjati vetëm derisa tërhoqi dhe lëshoi me tendosje rripat elastikë të fundit tim nga mbrapa. E dija që atëherë që disi ia kisha tërhequr vëmendjen dhe ai po përpiquej të tërhiqte timen, edhe pse me një sjellje prej fëmije. Ndrojtja ime u shndërrua në vetëbesim, kur ktheva kokën mbrapa ta kapja me presh në dorë. *Ua! Timo më quante të denjë edhe për debat!* Vetëm se ia shkrija gjithë argumentimin pasionant para se të fillonte “betejën” kur pajtoheshja me pikëpamjet e tij të superioritet mashkullor mbi atë femëror. Pastaj kalonte në përbuzjen ndaj këmbëve dhe duarve të mia të mëdha ose kofshave të gjata e të holla dhe çdo gjëje tjetër të fizikut tim që binte ndesh me tradicionalen. Djali kishte uri për kundërshtim, por u dorëzua në përpjekjet për të më acaruar, kur qesha edhe me komentet e tij për mënyrën se si isha krijuar.

Në fund të fundit, nuk ishte dhe aq ndryshe nga ç'më kishin trajtuar dy vëllezërit e mi në fëmijëri. Vetëm se, në ndryshim nga të Timos, komentet

e vëllezërve kishin për qëllim të parandalonin ndonjë tendencë timen për të më hyrë vetja në qejf gjatë viteve delikate të adoleshencës. Ata mendonin që sa më vonë ta merrja vesh dhe sa më pak besim të kisha tek paraqitja ime, aq më e mbrojtur do të isha nga djemtë që kishin vetëm një gjë në mendje.

Radari i intuitës sime prej femre tek-tuk kapte sinjale që Timo donte të thoshte më shumë, sidomos pas ndonjë mbrëmjeje vallëzimi të rastit, por ishte shumë kryeneç të parashikonte mundësinë e refuzimit tim. Kështu që mbetëm partnerë vallëzimi dhe shokë shumë të mirë. Luanim lojën e të marrit me mend hapin e njëri-tjetrit në kërcim e sipër. Ia thithja nga mendja hapat para se t'i hidhte dhe përshtasja të miat me to. I besoja logjikës së tij të ftohtë dhe e dija që mund të mbështetesh gjithmonë në gjykimin e tij të prerë e të vërtetë. Si natën që po zbrisnim nëpër shkallët e pallatit të Skendit pas mbrëmjes për ditëlindjen e tij.

Kisha pirë vetëm sa për të më dhënë guximin të ngrija dorën për të shtypur zilen e derës së njërit prej gjitonëve të Skendit në katin e dytë sa për gallatë. Timo e pa që zgjata dorën për te zilja dhe e dinte në moment se çfarë kisha ndër mend të bëja. Me shpejtësi, më rrethoi për mesi me krahun e tij të hekurt dhe më tërhoqi fort përmbri vetes e larg derës, vetëm një çast para se t'i bija ziles.

Ja edhe këtë radhë, krejtësisht i përmbajtur dhe në mbrojtje të shokut të tij të fëmijërisë. I riu ktheu kokën nga pozicioni i kërrusur mbi tasin me fasule; më hodhi një buzëqeshje mospërfillëse dhe një vështrim vëngër, si për thënë: “Qenke trime e madhe ti!” Timo i vuri dorën mbi kokë dhe ia ktheu prapë drejt tavolinës: “Teo, as sytë mos i hidh asaj. Të merr më qafë ajo,” - i tha dhe m'u kthye mua: “Ça do, më?”

- Asgjë, re. Vetëm një prezantim. Ke frikë se mos ta hamë? Kam fasulet tani.

- Hë për hë, - u përgjigj Timo. – Është një shok i vjetër nga mjekësia.

Obobo! Edhe i bukur, edhe doktor! Dhe i gjatë! Kjo ditë po bëhet më interesante pas çdo minute. Kur u ngrit duke dalë nga tavolina, arrita t'i hedh nja dy shikime “të rastësishme”. Sa më shumë që përgjoja, aq më “i disponueshëm” po bëhej në sytë e mi. Flokët gështenjë me onde mbi ballin e përkryer kurorëzonin sytë e buta ngjyrë kafe, hundën e drejtë dhe buzët e plota vishnje. Ua! Çdo gjë që nuk më pëlqente te vetja ime ishte vendosur në mënyrë të përkryer në fytyrën e tij.

Pas darke, të gjithë u ngjitën shkallëve për tek dhomat që na u caktuan. Dhomat ishin goxha të mëdha, me nga katër krevate tek, por renditja

nuk ndjehej dhe aq ndryshe nga ato që lamë mbrapa në qytetin Studenti. Ndryshimi më i madh ishte ndjenja e pabesueshme e të qenit në të njëjtën dhomë me djem dhe krevate. Gjëra të tilla nuk ndodhnin në qytetin Studenti. Vajzat dhe djemtë nuk flinin as në të njëjtën godinë atje. Nuk na lejohej as të hynim në godinat e njëri-tjetrit, jo më të ishim në të njëjtën dhomë me ta.

Skendi ishte i pari që u shtri përmbys dhe unë, papritur, i mbërtheva muskujt e qafës për një fërkim të shkurtër para se të ftillohesha që nuk po ndrysha tim vëlla dhe e tërhoqa dorën menjëherë.

- Më fal, më fal! Ia bëja tim vëllai sa herë që kthehej i lodhur nga puna.

- O Zot! – këlthiti ai me zërin e mbytur nga jastëku ku kishte fundosur fytyrën. – Kush të ka mësuar? Mos ndalo, të lutem! Nuk më vjen rëndë fare, - këmbënguli dhe më bindi se fliste sinqerisht. Në fund të fundit, edhe mua do të më pëlqente një ndryshe e fortë tani. Pashë rreth e rrotull që kishte plot të tjerë në dhomë dhe, para se të pranoja, ai tha: “Do të të paguaj” dhe nxori një tridhjetëshe.

- Edhe mua! – u hodh Nedi me një tridhjetëshe tjetër dhe u shtri në krevatin tjetër duke pritur radhën e vet. Fillova të qesh dhe pranova me mëdyshe: “Epo mirë, të dalë ku të dalë. E nxora gjithë biletën vajtje-ardhje unë!”

U përkula mbi shpinën e Skendit dhe e ndrysa për disa minuta duke qeshur me rënkimet e tij dhe romuzet e gjithë të tjerëve në dhomë.

- Oh, lum ai që do të të marrë për grua! – tha kur mbarova dhe vazhdova me Nedin, ndërkohë që shumica e shoqeve të mia po hynin e dilnin me vrull nga dhoma duke kërkuar një copë pasqyre të pazënë.

- Uu, lashë nam! Ato po bëhen të gjitha gati për mbrëmjen, kurse unë as që jam ndërruar akoma!

U hodha nga krevati dhe shkova te dhoma ime. Vesha getat najloni dhe një korse bojë qielli për të theksuar belin e hollë nën fustanin e shkurtër të zi prej pambuku të trikotuar me jakë varke që mbulonte eshtrat e gjoksit, por vinte në pah qafën e gjatë e të hollë. Nuk di se si, por zonjusha e fshehur diku brenda meje i doli përpara qenies çapajeve që isha kur vishja pantallona dhe kacavirresha nëpër pemë. Leva qepallat me një çikë laps kafë të errët dhe bojë këpucësh për qerpikët, që theksoi kontrastin ndërmjet syve të mi prej kafeje të pjekur lehtë dhe fytyrës sime të lëmuar e të zbehtë. Ndërsa theksova konturin dhe ngjyrën e buzës së sipërme më të hollë se ç’do ta doja, gjithçka mendoja ishte: “Sikur të kisha dikë, që do t’i lija mbresë sonte!”. Rregullova me kujdes kaçurrelat ngjyrë gruri rreth e rrotull ballit tim të lartë, ndërsa dëgjoja muzikën që kishte filluar në dhomën e mbrëmjes.

- Përsosur! Hajdeni goca, se po fillojnë pa ne ata! Jeni të bukura vetë! – pothuajse bërtita gjithë emocion dhe i udhëhoqa duke kërcyer për te dhoma tjetër. Ishte e mbushur plot me njerëz dhe tym. Gjeta një karrige bosh drejt mesit të dhomës dhe u ula në pritje.

Pak pasi kishte filluar vallëzimi, dëgjova një rrëmujë në korridor, mbrapa derës. Timo, Teo dhe disa nga shokët e tjerë dolën nga dhoma dhe mbyllën derën pas vetes. Dëgjova dhe ca debate të tjera me zë të lartë dhe fillova të ndjehesha paksa e shqetësuar si shumica e shokëve që po kërcenin ose ishin ulur afër derës, por pas disa minutash, gjullurdia ndaloi dhe djemtë u kthyen në dhomë. Kisha njëfarë ideje se çfarë po ndodhte, por duke u ndjerë disi e përgjegjshme, vendosa të mos ndihesha. Në të njëjtën kohë, nuk e fshihja dot që po më bëhej paksa qejfi.

- Ça po bëhet? – pyeta Timon në kthim për te karrigia e vet, me shpresë që as ai as njeri tjetër nuk e kishte dëgjuar shkëmbimin e shkurtër që pata me ushtarin në sallën e pritjes atë mbasdite.

- Asgjë për t'u shqetësuar, - ma ktheu Timo, ndërsa mori pozën e kërcimit me krahë hapur. – Nja dy ushtarë të dehur. Njëri prej tyre ngulte këmbë që ishin të ftuar në mbrëmjen tonë dhe, o do merrnin pjesë, o do ta qelbnin për të gjithë ne, - vazhdoi, ndërsa filluam të kërcenim me një këngë të shtruar.

- Iku? – pyeta ende e shqetësuar që ushtari mund të kthehej.

- Tani për tani.

- Që do të thotë se mund të kthehet prapë?

- Kur morëm vesh që ishte nga Tirana, ia mbushëm mendjen që të na vinte në një mbrëmje atje më vonë, kur të ktheheshim. Aq “rrogoz” sa dukej ai, kush e di çfarë i thotë mendja më vonë, - tha Timo.

- Obobo! Po sikur të kthehet më vonë sonte? Po sikur të na thyejë dyert kur të jemi në gjumë? – thashë e alarmuar.

- E çë pastaj? Se mos ka për të ardhur në dhomën time, - u përgjigj Timo me një buzëqeshje ironike, që i thellonte rrudhat në cepat e syve të vegjël rrethorë dhe i zbulonte dhëmbin e parë të njollosur.

- Si ore “E çë pastaj?”

- Nuk besoj se ka ndër mend të vrasë njeri. Atij vetëm se i ka vajtur një çikë mendja keq për ta njomur sonte. Jepi çfarë kërkon dhe do ta zërë gjumi, - u përgjigj Timo tashmë duke qeshur me shqetësimin tim.

- Sa i lig je!

I rashë me grusht në krah dhe u ula në një karrige duke bërë të zemëruarën për një çikë, por muzika vazhdonte ende dhe unë vura re që gjithkush po kërcente me dikë, përveç meje. As Teo nuk po kërcente. *Uuu, ide fantastike! Mbase vjen të më kërkojë të kërcëjmë bashkë.*

Prita nja dy minuta duke shpresuar që të vinte të më kërkonte për vallëzim. *Si mund të rrinte tjetri ulur me alamet muzike që po ikte kot? Nuk e di ky që vallëzimi është arsyeja për të cilën ekziston muzika? Pse nuk vjen të më kërkojë mua, ose edhe ndonjë tjetër, xhanëm? Jo, jo! Jo tjetër. Ky është i imi. Ka gjatësinë e përkryer për mua dhe nuk duket se ka ndonjë të dashur, përndryshe do ta kishte sjellë, siç bënë gjithë të tjerët që kishin. Po kur as kërcen, as flet, kot që vjen. Ndoshta po mban vendin që i takon si i ftuar ose, ndoshta është i turpshëm. Mirë, pra! Si ta kesh! Meqë nuk dashke, as unë nuk jam duke t'u lutur. S'ka as lezet që ta kërkoi unë, vajza, në vallëzim.*

Sa më gjatë që rrija ulur, aq më e fortë bëhej dëshira për të kërcyer me djalin e ri, misterioz, tangërlliks, të gjatë dhe simpatik që rrinte në qoshen e vet duke kthyer ndonjë gllënjë konjaku herë pas here, ndërsa shikonte vallëzimin me sytë gjysmë të hapura përmes tymit të cigares së vet.

Mirë, pra, dorëzohem! Fiton ai! Nuk duroj dot më. Nuk më bëhet vonë se ç'mendon për mua. Unë kam ardhur për të kërcyer dhe pikë! U ngrita si me sustë dhe eca drejt karriges së tij.

- Vura re që je beqari më i gjatë këtu, - i thashë duke u përpjekur të maskoja guximin tim të paturpshëm me një buzëqeshje, ndërsa i qëndrova më këmbë përpara me dorën e shtrirë drejt tij.

Teo ngriti sytë gjysmë të hapura me ngërdheshje si për të thënë: “Kishte të drejtë Timo për ty; ti të merr më qafë”, por u ngrit ngadalë dhe mori dorën time të djathtë me të majtën e tij, ndërsa vendosi krahun e tij të djathtë rreth belit tim.

Nuk e mora vesh ndonjëherë pse të kërcyerit veç e veç në rrok ishte lloji i ndaluar gjatë komunizmit, në vend që të ishte vallëzimi romantik i ngadaltë, ku dy persona krejtësisht të panjohur mbahen në krahët e njëri-tjetrit. Krahu im i majtë ishte i nderur mbi supin e tij dhe unë po merrja frymë praktikisht në gushën e tij. Po më mbante aq afër sa më dukej sikur do të më dëgjonte mendimet. E theu heshtjen i pari dhe më pyeti: “Me sa shikoj unë, ti nuk kërcen me djem më të shkurtër, apo jo?”

Po flet! Me një zë ledhatues, të butë e të thellë, po aq tërheqës sa qëndrimi i tij.

- Nuk shkon dhe aq mirë. E di nga përvoja, - iu përgjigja. – Një herë e një kohë, në shkollë të mesme na nxorën vullnetarë të shkonim në një fshat për të ndihmuar kooperativën për bimët që u shkatërruan nga breshëri. Të rinjtë vendas merrnin orkestrën e fshatit natë për natë që të kërcenin me ne përjashta në lëmë. Ishte si dasmë çdo natë. Si gjithmonë, sapo fillonte muzika,

çunat e fshatit lëshoheshin pothuajse me vrap drejt vajzave që donin, përveç meje. Njëri nga mbrëmjet, pasi ishin çiftosur të gjithë, vjen të më kërkojë për të kërcyer një djalë i shkurtër, i dobët, me flokë të djegura nga dielli dhe lëkurën si shollë. Në vend që të më mbante mua, më mbërtheu mëngën e bluzës te supi dhe e tërhoqi mbrapa pa pushim gjatë gjithë vallëzimit. Çdo dhjetë sekonda, më duhej ta sillja bluzën në vend, se po më mbyste. E dija që më mirë të rrija ulur sesa të kërcëja me të, po nuk mund ta ktheja mbrapsht. Kam parë shumë sherre prej reagimesh të tilla, - tregova duke e përdorur si sebeb për t'u tërhequr paksa më larg nga mbajtja e tij e fortë dhe për ta parë në sy duke u llafosur.

- Si ajo që pothuajse ndodhi sonte? – pyeti Teo duke më parë edhe ai në sy.

- Aq afër ishte, vërtet? – e pyeta duke kujtuar gjulluridinë e mëparshme jashtë dera. Nuk isha e sigurt nëse të parët sy më sy me Teon ishte më pak tunduese sesa fryma ime në qafën e tij.

- Jo, po njëri prej tyre ishte shumë i mërzhitur që nuk po i jepej mundësia të kërcente me ty, - tha Teo duke shpuar sytë e mi me të tjtë.

Mos! Tani djemtë e dinin që unë isha “cherchez la femme” për atë natë. Heshta me faj dhe turp përsëri, por u ndjeva e sigurt në krahët e Teos. Kjo do të thoshte se ai e kishte marrë vesh që po më mbronte mua, sapo doli nga dera për të përballuar ushtarin e dehur. Si për thjeshtë i ftuar që ishte dhe krejt i panjohur për mua, si shumë mirësi po tregonte që të vihej në mes dhe të rrezikonte zënie ose edhe më tepër. Apo jo?

Papritur, ma ndërpreu arsyetimin një gudulisje buzësh të buta në anë të gushës sime. Dërgoi “rrymë” nëpër gjithë shtyllën time kurrizore. *Mos më puthi gjë? Nuk ia bëka syri “tërr” për një që mezi ka folur deri tani. Po gjunjët, ç'm'i gjeti? Përveç emrit, nuk di asgjë për këtë njeri. Si është e mundur? Kështu fillon dashuria? Avash ti, ore, truri im romantik, që fluturon me presh në bythë! Ja, do ketë pirë një çikë si tepër konjak.*

Më vinte shumë zor të vija në dukje që e ndjeva dhe vazhduam të kërcenim deri në fund të këngës sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Pastaj, si rastësisht u ulëm në karriget pranë njëri-tjetrit. Vazhduam të bisedonim, ndërsa ushtari dhe shokët e tij i binin derës me grushta nga dy-tre herë dhe largoheshin me vrap me çizmet gjëmuese.

Erdhi koha të mbyllnim mbrëmjen dhe të riorganizonim fjetjen. Vajzat tani kishin shumë frikë të flinin vetëm nëpër dhoma, kështu që u kërkuan djemve të shpërndareshin nga një ose dy për çdo dhomë, një vendim që ata të gjithë, natyrisht, e mirëpritën me mirënjohje ndaj ushtarit.

- Në cilën dhomë je ti? – më pyeti Teo.

- Dy dhoma më poshtë në të djathtë, - iu përgjigja dhe pothuajse vura dorën mbi gjoks, si për të qetësuar rrahjet e zembrës. – Me Edin, - vazhdova duke treguar me kokë nga shoqja ime para se të fantazonte njeri ndonjë ide.

Edi, si Tani, studionte për inxhinieri elektrike. Ishim takuar që në fillim të vitit të parë, kur banonim në dhomat përballë njëra-tjetrës në katin e parë të godinës. Kishte fizik të brishtë dhe sy të mëdhenj kafë të errët me vetulla harkore në kontrast me lëkurën e fytyrës së saj të lëmuar si prej porcelani. Kishte flokë gështenjë të imta dhe me onde rrafsh me zverkun e hollë. Prindërit e saj kishin shtëpinë private dhe tokën që u ishte kthyer pas rënies së komunizmit në kodrat juglindore mbi vendlindjen time. Ishim lidhur ngushtë gjatë katër viteve, fillimisht duke qeshur me ekzagjerimet që i bënim dialektit tonë të përbashkët e, më vonë, duke rrëfyer dëshirat më të thella të zembrës, një nga një.

- Flori dhe unë do të flemë në dhomën tuaj sonte, - tha Teo.

Flori ishte një gjimnazist me shumë humor dhe vëllai i njërit prej shokëve të mi të klasës, që e kishte sjellë me vete për të parashijuar aventurat e ardhshme të jetës studentore.

- Shkolla lartë keka çef i madh! – tha Flori, humori i të cilit më çlironte sadopak, jo vetëm nga faji, por dhe ngarkesa emocionale që ndjeja për situatën që kisha shkaktuar. – Ne nuk na vejn me fjet’ me gocat n’xhimmaz.

- Tani e more vesh pse duhet t’i bësh detyrat gjithmonë dhe të marrësh nota të mira, - i tha Edi.

- Bash ç’ka m’ka than’ nana me babë, veçse e kan’ lan’ arsyen pa shpjegu. Kam me ba si me m’than tash e m’rapa, - iu përgjigj Flori.

- Shshshsh! – tha Teo me gishtin tregues para buzëve dhe hapi pak derën ngadalë. Nxori kokën të shikonte për ndonjë shenjë të ushtarëve në korridor, pastaj bëri shenjë me dorë që ta ndiqnim. Dolëm nga dhoma në heshtje dhe u futëm me shpejtësi në dhomën tonë.

Sa më shumë kohë që kaloja me Teon atë mbrëmje, aq më afër ndjehesha me të, sikur të ishte truproja ime personale, që kishte marrë përsipër mirëqenien time.

Unë e Edi fjetëm të dyja në një krevat në mes të dhomës, ndërsa Teo zuri krevatin më afër derës, nja një metër përmbri timit. Florin e zuri gjumi të parin në krevatin afër dritares në fund të dhomës. Unë u futa poshtë mbulesës dhe hoqa getat dhe fustanin sa më shpejt dhe fshehurazi që të mundesha para se të dilte Teo nga banja. Ai fiku dritat dhe u fut në krevatin e tij, përballë meje, me një dorë varur nga krevati, që mbante shishen e konjakut të mbetur në dysHEME.

Pas pak, mund të dëgjoja frymëmarrjen e rëndë e të përgjumur të shoqes sime, Edit. Kishte qenë një ditë e gjatë dhe e ngarkuar, por unë isha ende shumë e shqetësuar ose ndoshta shumë e ngacmuar për të më zënë gjumi. “Gjumi është humbje e një të tretës së jetës, gjithsesi!” – tha vajza që besonte se vetë bukuria e saj varej prej tij dhe humbi një provim një herë për shkak të gjumit të tepruar. *Opo, ç’a po bëhet, ëre?!*

As goditjet e herëpashershme në derë dhe as hapat e çizmeve në korridor, të rënda sa faji në ndërgjegje, nuk po e bënë më të lehtë të flija.

- Të zuri gjumi? – i pëshpërita Teos pas disa minutash duke uruar për të kundërtën.

- Jo, - pëshpëriti dhe ai.

- As mua nuk po më zëka gjumi, - vazhdova. – Ndjem shumë fajtoresh që shkaktova gjithë këtë rrokullimë për të gjithë.

- Ç’faj kishe ti?

- Duhet ta kisha qepur gojën.

- Kur? – pyeti Teo me çudi.

- Në sallën e pritjes, pak pasi kishim mbërritur. Nuk e di se si e mori vesh për mbrëmjen tonë, po kur ushtari shprehu qëllimin për të marrë pjesë, unë ngrita supet dhe i thashë se nuk më bëhej vonë nëse vinte apo jo. Ndoshta e lexoi moskokëçarjen time si ftesë.

- Vetëm për kaq?

- Po... dhe i buzëqesha, - shtova pastaj.

- O, po ti ashtu thuaj, - u përgjigj Teo dhe unë mund ta dalloja ironinë e tij edhe në errësirë.

- Të duket qesharake ty tani, por kështu e pësoj sa herë zbardh dhëmbët.

- Jam i sigurt që kjo nuk është hera e parë që një djalë bie përmbys për ty. Kur ndodhi?

- Ou, është histori e gjatë. Ta them ndonjë herë tjetër.

- Kemi gjithë natën! – nguli këmbë Teo.

- Nuk je i lodhur ti dhe, për më tepër, tapë? – e pyeta tinëzisht për të parë nëse e mbante mend puthjen.

- Jam, po ti ma trego derisa të mendosh që më ka zënë gjumi, - tha dhe piu një gllënjë nga shishja.

- Ndodhi para nja një viti, vetëm disa muaj pas shembjes së qeverisë së vjetër. Ti ndoshta e mban mend çfarë lëmshi u bë për disa muaj mbas rënies.

- E mbaj mend mirë, - pohoi Teo.

- Pra, na ishte një çun Tirane, Mitati, që shiste ora elektronike nëpër dritaret e katit të parë të konviktit të vajzave. Kur trokiti te dritarja ime, unë po mësoja për provimin e tretë. Vajta te dritarja, përgjova anash perdes dhe pashë Mitatin. M'u duk më i vogël në moshë, pa rrezik dhe po mbante në dorë disa orë. Hapa dritaren dhe e lashë të më tregonte orët. Pastaj filloi nga bisedat më pak profesionale duke pyetur, "Nga je? Për se studion?" e të tjera si këto. Unë vazhdova të përgjigjesha miqësisht, akoma duke menduar që është pa zarrar.

- Duhet patur kujdes me këta të urtët që duken të ëmbël. Janë si thëngjij të mbuluar; duken të ftohtë derisa i prek, - tha Teo, si për të më siguruar se po më dëgjonte ende.

- Pastaj nguli këmbë që të provoja një nga orët e tij, kështu që e provova, por kur fillova ta heq nga dora, ai këmbënguli që ta mbaja si dhuratë. Tashmë, po më bezdiste pak dhe po më hante kohën. Mendova që do të ishte më lehtë ta hiqja qafe duke mbajtur orën se sa të bëja debat me të. Nuk e dija unë që do të më kushtonte provimin prapëseprapë.

Për disa ditë me radhë, Mitati bënte çmos të më shfaqej 'rastësisht' sa herë shkoja në mensë për të ngrënë, ose në bibliotekë për të mësuar për provimin që po afrohej. Ai priste dashurinë time dhe u zhgënjye shumë që, në vend të saj, mori mospërfilljen. Fillova të shqetësohesha vërtet për situatën atë ditë që më qëllloi me shuplakë në fytyrë mu përpara bibliotekës, në mes të ditës. U ndjeva e pafuqishme për të bërë diçka. Qeveria ishte rrënojë dhe policia pothuajse nuk funksiononte. Qarkullonin shumë thashetheme mbi rrëmbimet e studenteve dhe shitjen e tyre jashtë shtetit për trafik seksual. Vendosa të mbyllesha në dhomë për disa ditë dhe iu luta Inës, shoqes së dhomës prej tre vjet e gjysmë, të ma sillte gjellën në dhomë. Ina, e ëmbël dhe e mirë si gjithmonë, pranoi dhe përpiquej ta gënjente sa herë e ndalonte Mitati në rrugë dhe e pyeste për mua. Por po bëhej e rrezikshme edhe për të, kështu që, si përfundim, vendosa të ikja në shtëpi dhe i lashë dy provimet e fundit derisa të ftohej Mitati. Po mendoja "larg syrit, larg zemrës".

- Pati efekt? – pyeti Teo ende i ingranuar në tregimin tim.

- Akoma zgjuar qenke ti? – e pyeta me çudi.

- Sigurisht! Jam në shoqëri të mirë!

- E shoh. Nuk paske të ngopur me konjak!

- Mhë, edhe të konjakut. Kam shumë etje, po konjaku po më bën edhe më të etur. Po pastaj, çfarë ndodhi me të?

- Nuk e di. Nuk e pashë më kurrë; as kur u ktheva për provimet në vjeshtë.

Do ketë ikur jashtë më vonë. Ina e pa një herë, kur po kthehej në shtëpi pas një provimi. Më tha që Mitati po punonte si faturino për një nga autobuzat e linjës së qytetit tonë.

- Paska qenë i betuar!

- Pikërisht! Kjo më bëri të mendoja se kisha bërë mirë që kisha ikur nga Tirana dhe shkolla për njëfarë kohe. Nuk e kishte lënë Inën as të paguante; i doli rruga qyl atë ditë për në shtëpi.

- Kjo duhet të të ngushëllonte ndopak që, të paktën, vuajtja jote nuk vajti e gjitha dëm.

- Po, po! Qeshim ne tani, po unë isha në rrezik të madh për ca kohë. Ajo që më ngushëlloi më tepër ishte fakti që u zu me dikë vetëm disa çaste më vonë atë ditë dhe Ina e pa me sytë e saj se si e rrahën “vëndçe”. Siç thotë ime më: “Perëndia i shikon të gjitha”. Ma mori hakën paq për shpullën që hëngra.

- Uoou, qenke e rrezikshme ti!

- Eee. Jam Lel’e babit me mbrojtje të posaçme.

- Nuk paske nevojë për mbrojtje dashnori, atëherë? – përgjoi Teo.

- Jo-o!

- Asnjëherë? – vazhdoi Teo ca më tej.

- Isha e dashuruar me dikë në atë kohë, ose ashtu mendoja, po ajo është histori më vete, - u përgjigja dhe nuk po më besohej që e thashë me zë të lartë. *Pse nuk e paskam fare problem t’i përgjigjem këtij robi për çdo gjë që më pyet?*

- Edhe ai ta bëri borxh dhe dikush e rrahu për vdekje, apo jo? – vazhdoi të përgjonte Teo.

- Jo. Ai bëri ç’ ishte e mundur të zhdukej vetë. Në fakt, ai më pëlqeu shumë. Kishte sytë më të bukur në botë; një e gjelbër e thellë rrethuar me qerpikë të trashë e të zinj. Ishte i gjatë dhe i hollë, po pak i kërrusur. E mbante flokun e zi me shkëlqim dhe të shkurtër, përveç balukeve. I kishte shumë të dendura, të drejta dhe të gjata. Më bënte për të qeshur kur i mblidhte me dorë dhe i hidhte anash çdo dy-tre minuta. Më tregonte batuta për të qeshur nga bëmat e Tom Sojerit dhe unë qeshja me kakarimë. Sigurisht, ti do ta kesh vënë re tani që i kam të qeshurat pa para. Im atë mendon se qesh më shumë se ç’duhet. Më duket se ka frikë mos më marrin për mendjelehtë dhe nuk do të gjej dot burrë.

- Nuk më duket se yt atë ka arsye për t’u shqetësuar.

- Uuu, po më skuqen veshët!

- Si u takuat? – pyeti Teo duke u kthyer menjëherë te tregimi im.

- Kisha lexuar “Për kë bien kambanat” gjatë verës para vitit të tretë dhe m’u duk sikur kisha rënë në dashuri para se ta takoja. Nuk e di nëse do të ndodhte dhe intuita ime e parandjeu apo më përgatiti libri shpirtërisht dhe unë e vura në jetë vetë.

Një mëngjes, pasi kisha filluar vitin e tretë, pashë në ëndërr një djalë me sy të kaltër që m’u shfaq dhe po qëndronte para meje e thjesht më shikonte. Sytë e kaltër ishin përrallorë. Nuk më duket se kam parë sy me ngjyrë të tillë në të vërtetë. Sytë e Inës janë të krahasueshëm në bukuri, vetëm se në ngjyrë më të thellë. Thonë që sytë e kaltër në ëndërr paralajmërojnë dashuri dhe, duke gjykuar nga sa afër m’u shfaqën, do të thoshte që do të më ndodhte shpejt. Po atë natë unë e Ina shkuam në një mbrëmje vallëzimi te Qendra Studentore. Atje, më pyeti një i njohur nëse isha e lirë të vallëzoja me një shokun e tij.

- Dale, dale. Nuk ishte ti që e kërkove për të vallëzuar atë radhë? – ngacmoi Teo.

- Hë de. Çfarë u kthye përmbys? – buzëqesha. *Qenka akoma zgjuar!* – Çuditërisht, jo atë natë, - vazhdova rrëfimin. – Në fakt, më kërkuan për të kërcyer më tepër se një dhe, në botën time, kjo konsiderohet radhë. Mund të zgjidhja. Ishte ndryshe sonte këtu me shokët e klasës. I njoh të gjithë; ose janë të zënë ose u vjen zor të kërcëjnë.

Nejse, ma tregoi ta shikoja para se të pranoja dhe e pashë të ulur në buzë të karriges së drunjtë me ca shalë të gjata të përkulura te gjunjët. M’u afrua në fillim të vallëzimit pasardhës dhe, kur i pashë sytë, m’u kujtua ëndrra që kisha parë atë mëngjes e më lëvizi zemra nga vendi. “Po më del ëndrra” mendova.

- Po ti the që sytë e tij ishin të gjelbërta të errëta, jo blu si ëndrra, - tha Teo në përpjekje për të rrëzuar teorinë time parashikuese.

- Kjo është pjesa për të cilën nuk jam shumë e sigurt; ishte paralajmërim apo një profeci e vetëpërmëshur?

- Po pastaj?

- Dolëm dhe nja dy herë bashkë te galeria e arteve dhe Piramida. Pastaj filluan demonstratat studentore dhe ai tha që nuk i dukej e drejtë të dilnim më. I dukej vetja egoist, i vogël. Edhe pse nuk doja ta pranoja, kishte të drejtë. Po merreshim me gjëra shumë më të mëdha. U gjendëm në mes të “revolucionit”. Pastaj u hap kufiri jugor dhe gjithë djemtë e rinj vendosën të shkonin të shikonin botën. Iku nga vendi për disa muaj gjatë kohës që po

fshihesh nga Mitati, shitësi rrodhe. Edhe ai u kthye për provimet në vjeshtë dhe u takuam rastësisht te rruga e trenit. Kisha gjashtë muaj që ëndërroja për momentin që do ta takoja, po kur erdhi, ai ishte moskokëçarës, i ftohtë, i largët. U mërzita dhe u zhgënjeva, por shpresova dhe për disa muaj se do të kthehej, derisa më treguan kushërinjtë vajzën tjetër, me të cilën po dilte gjatë gjithë asaj kohe.

- Të merr malli për të? – pyeti Teo.

- Mendoj për ato pak çaste që kaluam bashkë dhe sytë e tij të bukur, por ajo që më mundoi më tepër ishte që nuk e dija pse nuk u kthye më, - thashë akoma duke vrarë mendjen. – Do të kenë qenë duart e mia, - vazhdova me shaka. – Ishin më të mëdha se të tija. Kam dëgjuar që kjo i tremb djemtë.

- Vërtet?! Pa dale? – pyeti Teo dhe, pa humbur kohë, nxori dorën e hapur nga mbulesa duke pritur që ta krahasonte me timen.

Mos! Goja ime e madhe sapo më kishte vënë me shpatulla pas muri. Tani iu hap mundësia për të më prekur dorën në mes të natës. Nuk ishte shumë e vështirë të parashikoja se çfarë mund të ndodhte pasi të më merrte dorën. Pastaj nga do t'ia mbaja?

- Është shumë errësirë për të dalluar gjë tani. E krahasojmë në mëngjes.

- Duket me të prekur, - këmbënguli Teo.

- Kam ftohtë ta nxjerr dorën nga mbulesat. Ta tregoj në mëngjes.

- O, kurse për timen nuk ka gjale që po rri ngret në të ftohtë? – tha Teo duke manipuluar me fajin.

- Po atë po them edhe unë. Fute brenda, - iu përgjigja me frikë se po më mbaronin justifikimet. – Të çava veshët. Duhet të jetë shumë vonë. Do hamë dynjanë për gjumë nesër. I bie sot, - sugjerova akoma e shqetësuar nga situata e nderë ku ndodhesh. E dija që sa më tepër që flisja, aq më afër tij ndjehesha.

- Hiç fare! – ma priti. – Por do ta kishim më lehtë të rrinim zgjuar po të dilnim një xhiro përjashta. Është freskët, - vazhdoi edhe më i guximshëm.

Opo nuk u dorëzoka kollaj! Përpjekja ka meritë.

- Jo! Po sikur të jetë akoma duke u vërdallosur nëpër korridore ushtari dhe të na shikojë? – u fsheha pas frikës së ushtarit edhe pse tani frika më e madhe ishte të rrija vetëm me Teon. Ajo që më frikësonte më tepër ishte se sa shumë më pëlqente të bisedoja me të. *Ndoshta ndjen njësoj edhe ai për mua. Ndoshta nuk ishte dhe aq i dehur kur më puthi në gushë qëparë. Ose është aq i dehur sa ka vetëm një gjë në mendje për t'i plotësuar mbrëmjen.*

- Ohu! Ai ishte bërë xurxull që para se të fillonte mbrëmja. Nuk ia kemi

dëgjuar çizmet prej kohësh. Pastaj, unë e ai u bëmë miq kur të mbrojta herën e parë. Kam përshtypjen se mund t'ia prish mendjen prapë të të lërë të qetë, - nguli këmbë Teo.

- Falemnderit edhe një herë që më mbrojte! Si ka mundësi që je akoma këtu? – ndërrova temë.

- Këtu domethënë “jo jashtë shtetit”? – u përgjigj.

- Po.

- Provova nja dy muaj kurbeti në Greqi dhe u ktheva. Mendoj se duhet të mbaroj shkollën një herë. Është gjithmonë më mirë të kesh një diplomë edhe pse mund të mos njihet jashtë, - shpjegoi Teo.

Edhe i përgjegjshëm! E kapa veten duke numëruar përsëri. *Oh, ç'kam për ta paguar nesër!*

- Mirë e ke. Mua më duket kurbeti shumë i frikshëm. Kishe frikë të ishe vetëm në një vend të huaj, të cilit nuk i dije as gjuhën?

- Nuk isha vetëm. Babai shkoi i pari, po mirë e ke. Nuk është kollaj.

- Edhe vëllai im atje jeton.

- Vërtet? Ku?

- Në Agrinjo, - iu përgjigja unë.

- Babai im jeton në Patra, më pak se njëqind kilometra në jug të Agrinjos. Praktikisht fqinj, - shtoi i gëzuar që kishim diçka të përbashkët.

- Do të shkosh prapë?

- Do të përpiqem në verë, - u përgjigj Teo.

Sigurisht. Çfarë kujtova unë?

Si përfundim, Teos i mbaruan pyetjet dhe mua më mbaruan llafet. Pak para se të zbardhej ishte gjithmonë koha më e vështirë të rrije zgjuar edhe natën e vitit të ri. Tani ndjehesha e qetë për të fjetur nja dy orë, por m'u dukën vetëm si disa minuta, kur më zgjuan fësh-fëshet e shapkave të Edit nëpër dhomë. Pashë rreth e rrotull dhe u ngrita me shpejtësi nga krevati. U përpoqa të vishja paliçetat sa më shpejt që të mundja duke shpresuar që çunat po flinin ende dhe nuk më panë shalë jashtë. Do të shkonim nga liqeni më vonë para se të ktheheshim me tren në Tiranë. Të gjithë zbritën dhe u takuan në sallën e hyrjes së hotelit dhe po qeshnin me batutat e sajara për djem e vajza që kishin fjetur në të njëjtat dhoma.

Gjatë rrugës për te liqeni, pamë restorantin e bukur në mes shelgjesh që na kishte rezervuar Leo për drekë. Pa hezituat fare, disi e kthyem edhe këtë drekë në mbrëmje vallëzimi! Sapo dëgjova këngën ritmike të Elton Xhonit “Nuk dua të vazhdoj me ty ashtu”, u ngrita me vrull dhe fillova të kërcëj, që

tani ishte një mënyrë më vete për t'u dukur lozonjare. Papritur, u gjenda midis Timos e Teos që po kërcenin me mua. As që m'u desh t'i ftoja! Vazhdova të kërceja duke u kthyer nga njëri për katër nota: *"T'u dha mundësia për tre vjet e gjysmë dhe zgjodhe të mos e kapësh"*, pastaj nga tjetri për katër numërimet e tjera: *"E ke radhën ti tani. Kape, të lutem!"*.

Rrugës për te stacioni i trenit, Teo po më ndihmonte të mbartja çantën e rëndë. Nuk po flisnim dhe aq, sikur ta dinim secili që diçka na kishte ndodhur atë natë. Doja të dija nëse po ndjente dhe ai të njëjtin lëmsh që më ishte mbledhur mua në stomak.

Kur mbërriti treni në stacion, Teo çau midis turmave për t'u futur në vagon dhe arriti të na zinte një katërvendësh. Teo u ul përballë meje nga ana e dritares, ndërsa Edi u ul përmbri meje, përballë Florit. E kaluam shumicën e kohës duke luajtur me letra në tavolinën e vogël midis ndenjësive.

- Si fituesi i kësaj loje, mua më takon të puth të humburin! – deklaroi Flori në fund të lojës.

- Dale të vijë tuneli, - bëra sikur rashë dakord unë, e humbura e lojës.

Dritat e zbehta as që nuk u ndezën fare këtë radhë kur u fut treni në tunel. Ishte errësirë e plotë dhe heshtje në tren. Papritur, Teo ndezi çakmakun dhe filloi të pinte një cigare.

Sa i mprehtë! Xheloz që tani?

E kënaqur dhe e mahnitur nga reagimi i tij i shpejtë për të parë nëse unë e Flori u puthëm vërtetë, i hodha një shikim vjedhurazi fytyrës së tij të bukur, të ndriçuar nga "xixëllonja" e vobektë e cigares së tij.

Dy orë pas nisjes, po e ndjenim të dy plogështinë e një nate të gjatë pa gjumë dhe trenin e ngadaltë. Mbështeta kokën në dorën time kundrejt dritares me bërrylin mbi tavolinë, ndërsa Teo e mbështeti mënjane mbi krahët e tij të kryqëzuara në anën e tij të tavolinës, vetëm disa centimetra nga fytyra ime.

- Ah sikur të kisha një filxhan kafeje tani! – pëshpëriti Teo.

- E vura re që pive një filxhan të madh në mëngjes, - iu përgjigja, gjithashtu me zë të butë, sikur kishim frikë se do të zgjonim njeri rreth e rrotull nesh.

- Nuk kam të ngopur me kafe! – tha Teo duke më ngulur sytë dhe pyeti, - Ti e di se çfarë thonë për ata që pijnë shumë kafe, apo jo?

- Jo, po kam dëgjuar ç'thoshte im atë për burrat që i hanë shumë të ëmblat, - thashë dhe ndjeva që po skuqesha që iu përgjigja me të njëjtën ide.

- Çfarë thoshte? – pyeti Teo.

- Që i duan shumë gratë. Mos ka dhe miti yt i kafesë të njëjtin kuptim? – e pyeta.

- Pak a shumë, - tha ai duke buzëqeshur dhe unë i vura re hijen e vogël që gropëza e faqes së tij krijonte nën dritat e dobëta të vagonit, që tashmë mbetën të ndezura deri në fund të udhëtimit.

- E marr me mend.

- Po ty të pëlqen kafeja? – më pyeti Teo.

- Jo dhe aq; më shqetëson stomakun sa herë që e provoj.

- Nuk na rri mirë kështu! – tha ai.

- Po më pëlqejnë të kripurat, - iu përgjigja pa humbur kohë.

- Ka ndonjë domethënie?

- Ajo që të thashë për burrat me të ëmblat është, po ashtu, e vërtetë për gratë që pëlqejnë të kripurat, - thashë unë. – Oh, shiko! Duket Tirana. Pothuajse mbërritëm, - vazhdova, ndërsa treni po i afrohej ngadalë stacionit.

Tani që udhëtimit tonë po i afrohej fundi, po mendoja nëse do ta shihja Teon përsëri. Ne studionim në dy fakultete të ndryshme, disa kilometra larg njëri-tjetrit dhe studentët e mjekësisë flinin në konviktet pranë spitaleve të kryeqytetit, gjithashtu, disa kilometra larg qytetit Studenti.

- Do të më quaje shok? – pyeti Teo duke më parë drejt e në sy ende duke pëshpëritur.

- Sigurisht që të kam shok! – iu përgjigja. – Edhe sikur vetëm për faktin që rrezik se më shpëtove jetën nga ushtari. Unë u mahnita dhe ndoshta nuk do ta marr vesh kurrë si ia mbushët mendjen të na linte të qetë, - shtova me buzëqeshje duke shpresuar thellë në shpirt që kjo të ishte më tepër se shoqëri.

- Më pëlqen shumë! – shtoi ai duke mërmëritur nën frymë dhe duke shpresuar që e dëgjova qartë.

Unë buzëqesha me mirësjellje duke pretenduar që e kishte fjalën vetëm si shoqe, ndërsa i uruam njëri-tjetrit natën e mirë dhe u ndamë në rrugë të ndryshme. Nuk mund t'i ngrija mendjen vetes për një djalë, që mund të mos e shikoja më kurrë. Edhe pse isha e pacipë për ta kërkuar në vallëzim, nuk do të thoshte që do ta ndiqja nga mbrapa. Kishte qenë një udhëtim i mrekullueshëm dhe tani ishte koha për t'u kthyer në realitetin e mbushur me leksione të mërzitshme dhe provime nervshkatërruese.

KAPITULLI II

NË FILLIM

- Teo është shumë simpatik! – më ngacmoi Ina para se të flinim atë natë në dhomën e konviktit.

Kishim qenë me fat të siguronim një dhomë dyshe në katin e tretë të godinës pesëkatëshe këtë vit. Dhomat përballë ishin treshe, zakonisht të zëna nga studente më të vogla. Ishte një lavaman në të djathtë dhe, në të majtë, një dollap rrobash deri në tavan në hyrje të dhomës. Në cepin e djathtë të murit përballë ishte tavolina dhe, në të majtë, dritarja e mbuluar nga perde të gjata basme të bardhë me vija vertikale rozë. Në të djathtë të dritares, përballë krevatit tim, varej një fotografi e madhe e kokës së Martin Kempit, që Ina e kishte sjellë nga Italia një verë më parë, ku kishte disa kushërinj të humbur prej kohësh.

Gjatë dy-tre viteve të fundit të regjimit komunist, qeveria e kishte liruar paksa darën dhe disave u ishte lejuar të udhëtonin nëpër të afërmit e tyre jashtë atdheut. U ishte hapur rruga e kthimit edhe shumë prej të arratisurve gjatë viteve të komunizmit.

Mbrapa fotografisë, ishte një portret i Eros Ramazotit, këngëtarit më të dashur italian të Inës dhe arsyeja, për të cilën e kishte blerë, por unë i isha lutur ta varnim në anën e të bukurit Martin Kemp, edhe pse as që e kishim idenë se kush ishte.

Dy krevatët ishin në secilën anë të dhomës me kokat e varura në muret që ndanin dhomën me aneksin në hyrje. Librat i mbanim në një komodinë të gjatë e të ngushtë varur në mur mbi krevat.

- Eeeh, e di! – psherëtiva. – Dhe shumë i mprehtë! Më pëlqen shumë! U llafosëm gjithë natën mbrëmë, po kush e di më mban a s'më mban mend nesër e tutje. Çunat ishin të gjithë tapë mbrëmë.

- Po të mos ishte aq i dehur sa të ecte pa ndihmë për te krevati i vet, ka për të të mbajtur mend. Ke për ta parë! – më siguroi Ina me buzëqeshjen e saj të ndritshme.

Ina ishte vajzë me pak fjalë, nga e cila mund të prisja gjithmonë të vërtetën. U rritëm në të njëjtin qytet; vajtëm edhe në të njëjtën shkollë të mesme. Ishte shumë inteligjente dhe i kishte sytë një blu të thellë si thellësitë e Jonit. Qerpikët e shkurtër, të drejtë e të zinj dhe vetullat e zeza të shkurtra e larg njëra-tjetrës ia thellonin blunë e syve edhe më tepër. Flokët e zeza të drejta bënë kontrast me fytyrën e bardhë të rrumbullakët prej foshnjeje. Kishte hundë të vogël me pak quka dhe dhëmbë rruazë të bardhë të rrethuar nga buzë të tulta vishnje natyrale.

- Të lumtë goja! – ia ktheva dhe u futa në rroba për të fjetur.

Të nesërmen, e gjithë klasa ishte ulur te shkallët e mëdha përjashta nën diell gjatë pushimit midis seminareve. Gjithmonë më dukej vetja e privilegjuar të ndiqja shkollën në këtë godinë të veçantë të Universitetit. Ishte një arkitekturë e vjetër italiane e përbërë nga një kullë e lartë dhe dy krahë në secilën anë me harqe të larta si kurora mbi ballkonet e katit të sipërm e ndërtuar e tëra me blloqe të mëdha mermeri. Shkallët e bardha e të panumërta gjatë gjithë gjerësisë së ndërtesës më kujtonin një ujëvarë të shumëfishtë. Fotografitë e Universitetit ishin përdorur në të gjitha videot reklamuese të sistemit universitar për sa kohë që mbaja mend. Ja ku qendronte kundrejt sfondit të kodrave të gjelbëruara si simbol madhështor i ndriçimit të mendjes, arsimimit, pavarësisë personale, besimit profesional në vetvete dhe shtegut drejt një të ardhmeje më të mirë! Sa herë që mendoja për shkollën e lartë kur isha e vogël, e përfytyroja veten duke zbritur këtyre shkallëve të bardha e të gjera.

Vetëm se fotografitë nuk përçonin të ftohtin e lagësht që ndjenim në klasat e mëdha me tavane të larta dhe pa ngrohje për gjashtë-shtatë orë në ditë. Kjo ishte një ditë e bukur pranvere me diell dhe asnjë nga të ulurit në shkallë nuk kishte dëshirë të linte ngrohtësinë e diellit dhe shakatë për klasën e errët, të ftohtë dhe seminarin e mërziqshëm mbi përpunimin analog të figurës.

Përveç Pirros!

- Ore, do vini në klasë ju, apo jo? Po na pret presor Nikolla të gjithëve, - dha lajmërimin Pirro me të folurën e tij të ngadaltë dhe fjalët e mirëshqiptuara.

Pirro kishte një mendje të ndritur me ndikime të thella nga “Bitëllsat”, që binte në sy me pantallonat kaubojs të ngjitura pas kofshëve të holla e të gjata, me syze dielli rrethore si të huazuara nga Xhon Lenon dhe flokë të yndyrshëm të gjata deri te supet me favorite të ekzagjeruara.

Unë e Edi u ngritëm më këmbë dhe filluam të zbrisnim me përtesë nga shkallët e ngrohta ku ishim ulur. Siç filluam me këmbët hosh drejt klasës me të tjerët, e befasuar, i kapa krahun Edit dhe i bëra shenjë me kokë të shikonte përpara në distancë. Teo ishte ulur me ca shokë nga elektrikja përballë shkallëve, te bordura e shatërvanit të sheshit para shkollës.

- Shiko kush ka ardhur! – i mëmërita shoqes sime nëpër dhëmbë dhe ula sytë sapo e pashë të ngrihej në këmbë dhe të ecte drejt nesh. Më kërceu zemra nga vendi dhe u përpoqa ta fshihja duke e përshëndetur me dorë dhe një buzëqeshje.

- Ç’kemi? – mezi arrita të nxjerr nga goja kur më shtrëngoi dorën për t’u takuar edhe pse po më mbyste një lumë me pyetje.

Si nuk e pashë dot më parë? Pse është këtu? Ndoshta kishte ardhur gjithmonë për të parë shokët e vet, por nuk e kisha vënë re, se nuk e njihja atëherë. Apo mos ka ardhur për mua? Ah sikur të më kërkonte të rrija një çikë me të! Do ta bëja me dëshirë.

- Hë, më, - përshëndeti edhe Teo. – Nga dole ti? – pyeti.

- Unë te shkallët isha gjithë kohën, duke ngrohur ‘gjellën’ në diell, - i përgjigja dhe mbylla gojën me dorë. Nuk më besohej çfarë sapo kisha nxjerrë prej andej.

- Ça po ngrohje, më? – pyeti prapë.

- Asgjë. Asgjë. Është një shaka pa kripë. Më mirë që nuk e ditke, - i thashë akoma duke u skuqur nga turpi dhe të qeshurit.

- Jo, ma thuaj! – u përgjigj Teo duke buzëqeshur.

- Nuk më besohet që më shpëtoi! – thashë duke u pëpjekur nga zori të ndërroja temën dhe shtova, - Jemi duke vajtur në klasë tani, ndoshta një herë tjetër.

- Unë kam kohë këtu, po nuk të pashë atje, - u përgjigj ai dhe mua sepse po më dukej se edhe ai do të donte të më kishte parë para se të më duhej të shkoja në mësim.

- Ndoshta ngaqë nuk më ke parë ndonjëherë me fund më parë, pale me një të gjatë si ky, - iu përgjigja duke tundur vithet dhe fundin tim verëf nga një copë e trikotuar e derdhur që mbulonte gjysmat e çizmeve prej kamoshi të zi deri te gjuri. – Gëzohem që u takuam përsëri! Çne këtej nga anët tona? – e pyeta. – Ke ardhur për të takuar Timon?

- Ja, pata një orë pushim dhe dola një xhiro këtej nga shokët e mi. Kam dhe shokë të tjerë këtej përveç Timos, - u përgjigj Teo, si të ishte kapur i papërgatitur nga pyetjet.

- Edhe unë pushim e kam këtë orë dhe më duhet të dal nga tregu, - u hodh Edi me një ide aty për aty. *E dua shumë shoqen time të mprehtë!* – Mbase

mund të na shoqërosh për një pjesë të rrugës, meqë je duke u kthyer, - i sugjeroi Teos, ndërsa më kapi nga krahu, duke më tërhequr drejt bulevardit në drejtim të kundërt të shkollës. Aq sa fajtores ndjehesha që po lija mësimin, po aq edhe më vinte ta puthja shoqen time të dashur tani!

- Sigurisht! Me këtë rast mund të më thuash edhe atë shakanë me llafë t'pista që zure në gojë qëparë, - pranoi Teo dhe filloi të ecte mes nesh drejt sheshit të qendrës.

- O ç'na gjeti! – psherëtiva dhe fillova të tregoj barsaletën. – Na ishte një çift shumë i varfër. Një natë të ftohtë dimri, vjen burri nga puna dhe pyet gruan nëse kishte bërë ndonjë gjë për të ngrënë. I thotë gruaja: “Vetëm këtë kam për ty o burrë!” dhe i bie vetes me pëllëmbë, e ke parasysh se ku. “Epo u pa puna!” – thotë burri, -“Sa pa gjë fare...”. Kështu që “hëngrën darkën” dhe fjetën gjumë. Të nesërmen, ishte edhe më ftohtë. Kur erdhi burri nga puna, e gjeti gruan ulur në shesh me këmbët e hapura para oxhakut me zjarrin të ndezur në vatër. “Ç'bën, o grua?” – e pyeti. – “Po ngroh gjellën!” – iu përgjigj gruaja, - mbarova së thëni barsaletën duke u kënaqur me dy të tjerët, që tani po qeshnin me zë. – Meqë ti studion te mjekësia, mund të na ndihmosh të sqarojmë një thashethem që qarkullon këtej nga inxhinieria për klasat tuaja, - vazhdova me ca humor të vjetër që kisha dëgjuar nga shokët e klasës sime.

- Pa hë, një herë, - u përgjigj Teo, akoma duke mbajtur të qeshurën.

- Është e vërtetë që të gjitha bankat në klasat tuaja janë të gdhendura me fjalë pjesësh për televizora dhe kompjutera, si p.sh. diodë, tranzistor, kapacitor, etj., e ke parasysh, siç janë bankat tona të gdhendura me fjalë të pjesëve trupore? – e pyeta unë në përpjekje për të bërë një shaka tjetër për gjithë fjalët përshkruese të organeve gjinore që studentët e shkollës sime gdhendnin mbi banka.

- E bukur edhe kjo, - qeshi. – Jo, nuk është e vërtetë.

- Kam një shok fëmijërie që studion për mjekësi, - thashë unë, tanimë serioze.

- Si e ka emrin? – pyeti Teo.

- E quajnë Herkul. E kam komshi dhe e kisha në klasë në të mesmen. Ishte gjithmonë nxënës i shkëlqyer, - shpjegova.

- Sigurisht që e njoh Herkulin. Akoma ashtu është. Edhe një çikë fodull.

- Vërtet?! – u solla e habitur. – Megjithëse ka plot arsye të mburret; i zgjuar, simpatik dhe gjithmonë i sjellshëm, të paktën me mua.

- Ka kohë që e shoh me një shoqe klase.

- E di. Jemi takuar. Është e mrekullueshme!

- Po të kaloja nga gjashtë muaj me të njëjtën të dashur, edhe unë do ta mbaja, - tha Teo dhe më pa në sy.

- Aq e thjeshtë është vërtetë? – mendova me zë. Nuk e mendoja dashurinë aq thjeshtë sa ai. – Më duken kaq të panumërta arsyet që i mbajnë ose i ndajnë çiftet dhe, për më tepër, asgjë që bëj ose refuzoj të bëj nuk do të ndryshonte gjë, si përfundim, - vazhdova, sinqerisht e trazuar nga kjo temë.

- Bën ti? – pyeti Teo dhe gjithçka dëgjova ishte: “E ke bërë?”.

Nuk u bëka më troç se kaq! Pse do të bënte një pyetje të tillë, po të mos kishte qëllime të ardhshme ndaj meje? Nuk isha e sigurt nëse duhej të gëzohesha apo ofendohesha. Por po të më duhej të vendosja të ofendohesha, nuk duhej të kishte qenë dhe aq ofenduese.

- Jo, - i rashë pas avazit, pa sqaruar qëllimisht nëse i përgjigjesha pyetjes së të bërit apo të refuzuarit për të bërë dhe i buzëqesha Edit, që ndërhyri me shkathtësi para se kjo bisedë të shkonte më thellë se ç'donte të dëgjonte ajo.

- Ne kemi ndër mend të vemi në plazh me tren me një grup shokësh këtë të dielë që vjen. Po të duash, mund të vish dhe ti me ne, - ftoi Edi Teon, ndërsa po ndaheshim.

- Falemnderit! Me kënaqësi! – u përgjigj Teo duke u larguar.

Sapo u sigurova që Teo nuk mund të na dëgjonte më, u ktheva nga Edi dhe i thashë: “Pse më duket sikur e vetmja arsye që erdhi gjithë asaj rruge sot ishte që të merrte vesh nëse jam e virgjër?”.

- Po, pra. Drejt e në thela tjetri!

- S'ka faj. Në moshën tonë, kush do ta besonte që jemi, gjithsesi?

- Duhet marrë masat që të rregullohet kjo punë! – më shkeli syrin Edi dhe buzëqeshi.

- Posi! Po të ishte aq e lehtë, do të kishte ndodhur deri tani!

- Bëj shaka! Është i lezetshëm, i thotë gjërat troç dhe duket se ti i pëlqen shumë!

Më vonë, po atë mbasdite, isha mbështetur me krahët në parvazin e dritares duke shijuar shiun e butë pranveror dhe hodha sytë nga dritarja e Vilmës një kat më lart në të majtë për të parë nëse po bënte dhe ajo të njëjtën gjë. I pëlqente shumë shiu.

- E dija që shpirtit tënd poetik nuk do t'i shpëtonte kjo. Sa e paqtë! – i psherëtiva shoqes sime të klasës.

-E di, - u përgjigj Vilma. – Edhe unë atë po mendoja. Sa dua të dal, të rri nën të derisa të regjem, - vazhdoi ajo duke parë shiun me sytë e saj të zinj melankolik.

- Dalim bashkë! – thashë unë, mendjengritur nga ideja.

- Po vij poshtë, atëherë! – u përgjigj Vilma e infektuar nga ngazëllimi im ngjitës. Vrapuam të dyja nëpër shkallë dhe qendruam në shi te rrugica në të majtën e përparme të godinës.

- Kush e di si po na qeshin! – tha Vilma.

- Kuft i plasi? – ia prita. – Se mos kemi për ta marrë vesh.

Mbasi qendruam në shi për njëfarë kohe, shiu pushoi dhe ne vendosëm të dilnim një xhiro nëpër qytetin tonë të vogël. Papritur, u ndeshëm me Bertin dhe një shokun e vet.

Berti kishte mbaruar për elektronikë një vit më parë. Kishte qenë një nga studentët më të dukshëm gjatë demonstratave dhe tani ishte shumë i përfshirë me lëvizjen politike në vend. Gëzonte vëmendjen e shumë vajzave të reja, që i tërhiqte personaliteti i tij madhor e energjik, dhe ai ua kthente me bujari. Vilma e kishte takuar një vit më parë në një nga mbrëmjet e vallëzimit në konviktin e gocave, ndërsa ishte akoma student, dhe ishte mahnitur nga intelijenca e tij, pavarësisht nga reputacioni i tij prej qejfliu. Edhe pse variacioni i tyre platonik nuk zgjati shumë, Vilma mendonte akoma për të dhe dukej shumë e lumtur nga takimi i rastësishëm i asaj mbasditeje.

Berti dukej i kënaqur të na takonte dhe na prezantoi me shokun e vet. Ai filloi të fliste për hapjen e madhe të një diskoteke të re, e para në vend, dhe propozoi që të shkonim të katërt atë mbrëmje. Hodha sytë nga shoqja për reagimin e saj dhe i dhashë të kuptonte që isha gati ta shoqëroja, po të dëshironte, siç më kishte ndihmuar Edi po atë ditë. Vilma pranoi dhe ne iu bashkuam dy të tjerëve më vonë atë mbrëmje tek diskoteka e re në qendër.

Mu përpara hyrjes, unë vura re tufa kabllosh të zeza drejt hyrjes së disko-klubit dhe një kameraman me një kamera të madhe mbi supe. Kur u futëm në klub, dëgjuam që po filmohej një video për reklamën e disko-klubit të ri, por u ndjemë si në grackë dhe nuk dinim ç'të bënim. E shqetësuar se mos më shikonin prindërit në televizor duke kërcyer në një disko në vend që të mësoja në bibliotekë, u ula te tavolina me kokën të mbështetur e të mbuluar pjesërisht nga dora dhe vështrimin në drejtim të kundërt nga kamera. Si përfundim, shoku i Bertit më kërkoi të kërcëja me të dhe unë pranova me mëdyshje duke u përpjekur sa të mundja të kërcëja me shpinë nga kamera. Isha shumë në siklet për të shijuar kërcimin dhe nuk më bëhej vonë fare për të pirën. Pastaj, e vetmja hapësirë për të kërcyer ishte midis dy sërëve të tavolinave. E gjithë mbrëmja ishte një zhgënjim për mua, por kjo nuk ishte mbrëmja ime. Vilma nuk e kishte hequr dorë nga shpresa e ribashkimit me Bertin dhe kjo mbrëmje mund të përbënte një rast ideal dhe një shenjë të mirë për të.

Siç kisha frikë, reklama që ftonte njerëzit në disko-klubin e parë në vend po shfaqej në televizor për natë para lajmeve kombëtare dhe unë isha mu në mes të saj; herë duke kërcyer e herë të tjera ulur në tavolinë.

E diela erdhi shpejt. Do të ishte një ditë e bukur, e ngrohtë, me diell pranvere. Kur unë e Edi arritëm te stacioni i trenit, isha shumë e lumtur të shikoja që Teo kishte vendosur të vinte me ne, siç kishte premtuar. U takuam me të tjerët nga grupi dhe hipëm në tren për një udhëtim dyzetepesë minutësh për në plazhin e qytetit të Durrësit. Mund të shikoja që nga dritarja e trenit që deti po shfaqej i qetë dhe po aq i kaltër e i bukur sa e mbaja mend përmes pishave përgjatë bregut. Plazhi kishte gëzuar gjithmonë qoshen më të dashur në shpirtin tim. Tani nuk e dija nëse isha më e lumtur që isha në plazh apo që isha me Teon. Pjesa më e vështirë e ditës do të ishte heqja e fustanit sapo të mbërrinim në plazh. *Ndoshta po ta heq kur jam ulur në rërë, nuk ka për të vënë re njeri shalët e holla!* – mendova duke e bluar të gjithë ngjarjen në kokë. Do të më duhej ta bëja shpejt, siç vrapoja drejt detit për të kapërcyer kontaktin fillestar me ujin e ftohtë. Sa më shpejt ta bëja, aq më herët merrte fund.

Kisha veshur një fustan bojë qielli me rripa, që kishte vija diagonale shumëngjyrëshe gjatë gjithë gjatësisë së fustanit. I kisha marrë hua Inës një palë rroba banje trupore ngjyrë kafe me vija brisk të holla, po ashtu, shumëngjyrëshe diagonale. Kostumi im i banjës përbëhej nga breçka të vogla bojë qielli me vija të trasha të kuqe, blu të errët dhe të bardhë në të djathtën e përparme dhe sutjena trekëndëshe të vogla me rripa të hollë, që lidheshin në qafë e mbrapa shpine.

Herën e fundit që e kisha veshur atë kostum banje kishte qenë për të marrë pjesë në garat e notit me skuadrën e femrave të fakultetit tim te pishina prapa Universitetit. Vajzat ishin rreshtuar përbri djemve dhe po prisnin radhën për të notuar. Njëri nga djemtë zgjati dorën pas meje dhe tërhoqi me shpejtësi njërin nga rripat e fjongos. Djemtë e tjerë po prisnin të shikonin dhe të qeshnin me turpin tim, kur të lirohej e ashtuquajtura sutjenë e imja duke zbuluar gjinjtë e mi të vegjël. Përkundrazi, isha unë që u kënaqa me fytyrat e tyre të zhgënjyera kur nuk ndodhi asgjë e tillë; kisha lidhur një nyje të fortë para se t'i lidhja fjongo për së dyti. Jo se prisja ndonjë numër të tillë nga Teo, por furia e valëve e kishte zhvendosur trekëndëshin përgjatë rripit më parë. Pastaj, kostumi i Inës më mbulonte pjesërisht edhe gjoksin kockanjar dhe unë doja që të lija përshtypje sa më të mirë në takimin tim të parë me Teon.

Unë e Teo u futëm në ujë së bashku dhe dalëngadalë notuam sa më larg që mundëm.

- Ku e ke mësuar notin? – më pyeti Teo.

- Ma mësoi mami kur isha e vogël. Babi nuk futej kurrë më tutje se gjunjët. Gjithmonë thoshte: “Të merr brenda, pa të merr jetën”. Unë e mami ia hipnim autobusit të ngjeshur me njerëz për në Seman në ditët e nxehta të verës. Mami ngrihej që në gjashtë të mëngjesit; skuqte specat dhe vezët, priste dhe shalqinin për drekë, ndërsa unë flija. E merrnim në këmbë njëzet minuta deri te stacioni dhe prisnim edhe njëzet a tridhjetë minuta të tjera për autobusin tjetër. Vajtja në plazh zinte gjithë ditën, po telendisja rrugës nuk ishte asgjë para kënaqësisë që ndjeja kur lundroja në shpinë duke parë qiellin e kaltër. Rrija në ujë derisa më bëheshin buzët mavi dhe lëkura e gishtave rrudhej si stafidhe. Po ti, ku e ke mësuar? Në Osum?

- Edhe ne shkonim në plazh të Semanit kur isha i vogël, - kujtoi Teo. – Mbjaj mend që më bënte alergji myku i dyshekëve të vjetër të kabinës që merrnim me qera për dy javë dhe të gjithë kujtonin se isha ftohur. Kështu që më mbanin në krevet e më mbulonin me batanije të tjera më të mykura për të më mbajtur ngrohtë derisa të më kalonte “i ftohti”. Meqë ra fjala te Osumi, - vazhdoi Teo duke qeshur, - e di ti si është krijuar?

- Jo. Si? – e pyeta.

- Mali i Tomorit dhe mali Shpiragut ishin dy vëllezër të dashuruar pas Kalasë. Bënë një duel ku Tomori e çau Shpiragun me shpatë duke lënë gjithë rrëpirat që duken sot e kësaj dite, ndërsa Shpiragu e bëri Tomorin gropa-gropa me topuz. Kalaja nuk zgjidhte dot midis tyre dhe i vinte keq për duelin dhe plagët e vëllezërve. Ajo filloi të qante për plagët e dashnorëve dhe lotët e saj krijuan Osumin, lumin që tani i kalon te këmbët duke ndarë dy vëllezërit.

- Oh, sa legjendë e bukur, por e trishtuar! – thashë dhe vura re që Teo po dridhej. – Ke ftohtë?

- Jo! – m’u përgjigj duke buzëqeshur me buzët tashmë të mavijosura.

- Po pse dridhesh i tëri? – e pyeta përsëri.

- Nuk e kam nga të ftohtit, - vazhdoi të buzëqeshte duke më parë me ngulm, sikur të thoshte: “Ti e di pse dridhem!”

- Do të kthehem në breg? – e pyeta duke mos i vënë veshin nënkuptimit të tij për të dridhurat si rezultat i ndonjë mbingarkese seksuale.

- Si të duash! – u përgjigj.

- Jemi goxha larg dhe mua po më lodhen krahët. Pastaj, do të më pëlqente të luaja volejball me të tjerët në rërë, - sugjerova unë duke menduar ende se kishte ftohtë, por i vinte zor ta pranonte, kështu që filluam notin ngadalë drejt bregut.

Dielli po ulej në perëndim dhe ne na duhej të kapnim trenin e fundit për

në Tiranë. Kjo kishte qenë një ditë e mrekullueshme dhe unë uroja të mos mbaronte kurrë. Kur arriti treni në Tiranë, ishte errur dhe Teo vendosi të më shoqëronte për në konvikt. Kjo ishte pjesa e udhëtimit për të cilën kisha pritur gjithë ditën e ditës.

- Tani mund t'i krahasojmë duart? – më pyeti duke buzëqeshur.

- Tani po! – ia ktheva edhe unë me buzëqeshje.

Ma mori dorën dhe e mati ndaj së tijës për disa sekonda.

- U shyqyr! Imja është më e madhe! – psherëtiu i çliruar. – Nuk paskam asgjë për t'u shqetësuar.

- Jo dhe aq më shumë, ama, - ia ktheva unë.

- Paske vërtet duar të mëdha si për femër që je, - pranoi Teo. – Po s'besoj se do rritesh më.

Pastaj ndërthuri gishtat e tij përmes të mive dhe vuri krahun e tij poshtë timit tamam si çiftet e vërteta të dashuruara që adhuroja nga dritarja e dhomës sime. Fjalët sa vinin e po na pakësoheshin dhe ne po bëheshim më të heshtur duke ecur përmes parkut të errët pranë urës së Elbasanit. A thua se kishim frikë mos turbullonim tensionin delikat në rritje. Tani po i ndjeja trupin që i dridhej ngjitur me timin. I ndjeva krahun e ngrohtë nën brinjën time dhe tani e besoja që të dridhurat e tij nuk kishin aspak të bënin me të ftohtin. Më tërhoqi lehtë drejt një peme të madhe, pas së cilës u mbështet me shpinë. Mbështolli krahët e tij rreth belit tim dhe, këtë radhë, buzët e tij të purpurta pa dyshim u puthitën mbi të miat. Ndjeva gjunjët që po më dobësoheshin, vetëm se këtë radhë nuk mund t'ia jepja meritën alkoolit. Kofsha e tij bëri vend midis të mijave dhe unë ndjeva pantallonat e tij të ngurtësuar ndaj eshtrës sime të shtratit, ndërsa u puthëm me epsh për një kohë të gjatë, që doja të zgjaste përgjithmonë.

Sapo fillova të alarmohesha me paaftësinë time për t'i rezistuar dhe frikën se mos më shihnin duke u puthur me një burrë, Teo u tërhoq nga pema, më mori për dore dhe filloi të ecte prapë.

- Më duhet të të kthej në konvikt, përndryshe do të ngelem këtu gjithë natën!

- Mirë thua! – iu përgjigja e trishtuar që këtij momenti i erdhi fundi, por e çliruar që njëri prej nesh e kishte akoma mendjen në vend, ndërsa filluam të ecnim drejt qytetit “Studenti”.

- Në fakt, unë po mendoja që të mos vije më për mua, - i thashë e frikësuar që po futesha shumë thellë, por në të njëjtën kohë uroja të mos ma vinte veshin. Zemra dhe truri im po i ulërinin njëra-tjetrit.

- Po, po, si urdhëron! – m'u përgjigj duke qeshur, sikur ta dëgjonte betejën brenda shpirtit tim.

KAPITULLI III

NDËRMJET

Më vonë po atë javë, po kthehesha nga shkolla, kur pashë Bertin përballë meje duke shkuar në shkollë. Ai ndaloi dhe më dha dorën për t'u takuar.

- E di ti që më kanë emëruar të jap mësim në fakultet? – më pyeti.

- Vërtetë?! Mrekulli! Më vjen shumë mirë që nuk po merresh më me politikë. Ti e di që politika është kurvë e vjetër.

- Pjesa më interesante është që do t'i jap mësim klasës tënde deri në fund të këtij viti, - shtoi.

- Lum Vilma! – thashë me gëzim. – Se mos ka nevojë për ndihmë me notat ajo, xhanëm. I ke thënë? – e pyeta.

- Jo! Akoma, - u përgjigj.

- Mirë atëherë, urime edhe një herë! Duhet të kem kujdes si të të drejtohem tani, “presor”! – buzëqesha me shaka dhe e përshëndeta “Mirupafshim!”.

Disa ditë më vonë, të shtunën para pashkëve, po ngjitesha shkallëve për në mësim, kur Timo ktheu kokën mbrapa duke u ngjitur disa shkallë përpara meje dhe më tha: “Po të pret Teo para teatrit”.

“Erdhi prapël” – mendova dhe ndjeva zemrën që m'u drodh nga gëzimi. – Ne po shullëheshim në diell një orë të tërë. Tani që po futem në mësim e gjete të ma thuash ti mua? – iu përgjigja pothuajse e inatosur që e mbajti për vete një lajm kaq të rëndësishëm.

- Nuk thua falemnderit që të thashë dhe aq! – u përgjigj Timo pa bërë asnjë përpjekje për të fshehur xhelozinë e tij. U kthye përpara dhe vazhdoi t'u ngjitej shkallëve për në mësim.

Nuk e dalloja dot për kë ishte më tepër xheloz, për mua, një dashuri të mundshme që po e humbiste në duart e Teos, apo shoqërinë e veçantë të Teos që po e humbiste për shkak të një femre.

Edhe pse ndihesha fajtores që po lija mësimin për të takuar një djalë, u ktheva mbrapsht dhe i zbrita shkallët me vrap kundrejt gjithë të tjerëve që po ngjiteshin. Si mund të rrija në klasë duke e ditur që më priste një dashuri e mundshme? Më dilte im atë para syve duke më qortuar, po ta dinte. Gjithmonë më dukej vetja si vajza më e dashur e babit, megjithëse isha e vetmja që kishte, dhe nuk doja ta zhgënjeja kurrë. Babi kishte shpresa të mëdha për të ardhmen time. Vija buzën në gaz sa herë e kujtoja të më pyeste “Do të më blesh kostum kur të rritesh?”

Më duhej të vendosja aty për aty dhe dashuria fitoi. Fillova të vrapoja drejt teatrit, që ishte një njezet minuta të mira më këmbë. “Po ky pse do të priste kaq larg nga ku isha?” – po vrisja mendjen duke iu afruar teatrit e duke e kërkuar me sy. Ja ku ishte, ulur te shkallët e teatrit duke më parë nga larg me sy zhbirues.

“Çfarë e papritur e mrekullueshme!” – mendova siç e përshëndeta me një buzëqeshje. – Ke kohë që pret?

- Ç’kemi? – më pyeti. – Edhe pesë minuta të tjera do të të prisja, - shtoi duke u përpjekur të fshihte mërzi të tjerë dhe krenarinë e lënduar nga pritja e gjatë. “Me sa duket ka pritur më tepër se dhjetë minuta”, - mendova, ndërsa m’u kujtua një thënie e vjetër midis studentëve: “Një shok të pret pesë minuta, dashnori dhjetë dhe budallai pesëmbëdhjetë!”

- Timo më tha që po më prisje këtu menjëherë para se të futeshim në mësim. Erdha me vrap sapo e mora vesh. Pse po prisje kaq larg? – e pyeta.

- Doja të blija bileta për shfaqjen “Zbutja e kreneçes” që shfaqet sonte. Do të vemi bashkë? – më pyeti Teo.

Unë me ty do të shkoja edhe në fund të botës.

- Sigurisht! Kam dëgjuar fjalë të mira për të, - u përgjigja me dëshirë. Doja shumë ta shikoja me të vërtetë; kishte kohë që nuk kisha parë shfaqje në skenë.

Teo shkoi bleu biletat te sporteli dhe pastaj filluam të ecnim nën pemët e mëdha në trotuarin drejt bulevardit qendror. E kaluam dhe vazhduam te blloku.

Kjo kishte qenë lagjia ku banonin zyrtarët e lartë të partisë komuniste. Ata banonin në vila private, ndërsa shumica e popullit në vend jetonin në apartamente me nga një ose dy dhoma gjumi. Deri vetëm tre vjet më parë, ushtarë të armatosur të gardës kombëtare, që patrullonin në skajet e rrugëve, e ruanin të gjithë bllokun. Çdo qytetar i thjeshtë që afrohej, ndeshej të paktën me dyshim. Kur qeverisja një partiake i hapi udhë pluralizmit, këto rrugë u hapën për publikun dhe tani të gjithë mund të shijonin rrugët me shtëpitë e

mëdha (për standardet shqiptare të viteve nëntëdhjetë) dhe pemët madhore në të dyja anët. Vilat tashmë u ishin lëshuar organizatave ndërkombëtare bamirëse që vërshuan në vend paskëtaj.

Teo u kthye majtas, drejt parkut mbrapa Universitetit. Ecëm drejt shtigjeve të asfaltuara të parkut nën pishat dhe bredhat e dendur. Mora frymë thellë disa herë si për të thithur gjithë aromën e pishave, që gjithmonë më kujtonte plazhin.

- Provimet fillojnë së shpejti dhe mua do të më duhet të shkoj të studioj në shtëpi, - paralajmëroi Teo për ndarjen tonë të shkurtër në të ardhmen e afërt.

- Nuk mëson këtu ti? – e pyeta me shpresë për t’i ndërruar mendjen. – Unë këtu mësoj për vete!

- Dhomat tona as që kanë të krahasuar me të gocave. Pastaj, më duhet t’i hedh një sy shtëpisë. Të dy prindërit dhe motra e vogël jetojnë në Greqi tani dhe shtëpia është e kyçur dhe pa njeri.

- Mbjaj mend që përmende diçka të tillë më parë. Mirë janë me punë?

- Po. Babai është mekanik shumë i zoti. Rregullon dhe shet frigoriferë të vjetër.

- Edhe vëllai im është mekanik i mirë, po atje lyen shtëpi, - thashë unë. – Po ti, punove kur ishe në Patra herën e fundit?

- Punova. Punova në ndërtim.

- Ti?! Në ndërtim?! Me ato duar të buta doktori?! E pabesueshme! – qesha.

- Nuk thashë që isha ndonjë mjeshtër! Një herë, më tha “afendikoi” të ngrija një kovë shumë të rëndë me beton dhe ta sillja ku e donte, ca metra më tutje. I thashë që po të ngrija kovën, nuk do të bëja asgjë tjetër për atë ditë pune. I çova kovën dhe u ula për pjesën tjetër të ditës. Më presin prindërit të shkoj prapë këtë verë.

- Ou! Rrugë të mbarë! – thashë dhe ula sytë për të fshehur ndjenjat e mia të vërteta për ikjen e tij nga vendi. Kisha frikë se nuk do të kthehej më. E urreja Greqinë dhe gjithçka kishte të bënte me të.

Teo më kapi nga dora dhe më tërhoqi drejt një stoli mënjanë. U ulëm dhe ai e vuri kokën time mes dy pëllëmbëve të tij, ma ngriti lart dhe më puthi lehtë. Unë isha e qeshur nga natyra e nuk mund të rrija e vrenjtur për shumë gjatë, po puthja e tij më ndriti nurin menjëherë. Buzëqesha dhe e putha me duart e mia rreth shpinës së tij, pastaj mbështeta kokën në gjoksin e tij.

- Ke vendosur çfarë lloj doktori do të bëhesh? – e pyeta.

Ai u kërrus përpara, vuri veshin në anën e majtë të gjoksit tim duke më dëgjuar rrahjet e zemrës dhe tha: “Zemra më ka mahnitur gjithmonë. Më pëlqen tingulli që bëjnë rrahjet e saj dhe dua të mësoj gjithçka mundem për të. Megjithëse, motra do që të bëhem kirurg operacionesh plastike, sepse i është mbushur mendja që është veshllapushë dhe do që t’ia ngjis pas koke”.

- Bëhet? – e pyeta e çuditur.

- Si jo? Edhe shumë më tepër, - u përgjigj Teo.

- Lum ti që studion për mjekësi. Im atë donte shumë të bëhesha mjekë, po nuk kishte miq aq të fortë. Megjithëse, nuk mendoj se do t’ia kisha dalë mbanë. E kam të rëndë të shikoj plagë ose gjak, - thashë. – Po ti?

- Sa të futësh këmbët në shkollë, se pastaj mësohesh me ato gjëra. Shumica e mësimeve bëhen në spital. Ka plot nga ata që vjellin zorrët në fillim. Ti nuk do të kishe qenë e para. Një herë, pashë një aksident makine mu përpara godinës sime. Makina shtypi një burrë dhe ai ra pa ndjenja, po ishte akoma gjallë kur iu afrova. Më ndihmoi një shok ta ngrinin peshë dhe nxituum për te spitali përballë. Ishte përvojë e fuqishme. Edhe vetë u habita se si nuk ngurrova për të vepruar, - u përgjigj Teo.

- Po vete ora për teatrin, - thashë kur vura re orën e dorës.

- Mirë thua. Hajde çohemi të shikojmë shfaqjen, - miratoi dhe filluam të ecnim ngadalë drejt teatrit.

Më pëlqeu shumë “Zbutja e kryeneçes”. Më pëlqeu ngjarja, aktorët, kostumet, por më shumë nga të gjitha më pëlqeu që isha e ulur pranë Teos kapur për krahu. Sa më shumë afroheshim aq më tepër Teo doja. Të dy po ndiqnim me padurim turmën për të dalë nga teatri duke lënë mbrapa tingujt e këngës “Let the sunshine in”.

Përrjashta, mbrëmja ishte e ngrohtë dhe dritat e rrugës i jepnin ajrit një vezullim të kaltër përmes degëve të pemëve. Iu drejtuum bllokut pothuajse duke vrapuar. Sapo mbërritëm në fushë të hapur, filluam me puthje të zjarra duke u gjunjzuar me ngadalë mbi barin e freskët. Pastaj Teo u përkul përpara duke më shtrirë ngadalë me një dorë mbas shpinës sime dhe tjetrën mbi bar duke mbështetur peshën e të dyve. U gjenda shtrirë në bar me trupin e tij krejtësisht mbi timin për herë të parë. “Shumë përpara, shumë shpejt!” – filloi truri im me trumpetën e alarmit. Bëra shaka që duhej bërë diçka për virgjërinë para se të ishte shumë vonë, po kjo nuk ishte fare për të qeshur. Më dukej sikur po shikoja tim atë dhe vëllezërit rreth e rrotull duke ulëritur “ç’bën moj?!” Kur vinte puna për seks para martese, edhe mami ma kishte bërë më se të qartë që nuk hahet ëmbëlsira para buke nëse do një jetë të shëndetshme.

Për arsye që nuk mund t'i shpjegoja, i besoja Teos dhe e dija që nuk do të bënte ndonjë gjë që do të më vinte në pozitë të vështirë. Pas puthjes së gjatë, bari po ftohej nën vete. Siç e kisha menduar, u ngritëm të dy dhe filluam të ecnim në natën e qetë drejt konviktit.

- Do të të pres këtu në orën gjashtë si sot një javë, - tha Teo kur mbërritëm në rrëzë të kodrës në hyrjen jugore të qytetit Studenti.

- Mirë! – pranova, edhe pse e zhgënjyer që nuk do të vinte të më thërriste me emër poshtë dritares, siç bënin djemtë e tjerë me vajzat që donin. Megjithëse, vetëm fakti që i thërrisnin nuk do të thoshte se ishin të gjithë të dashuruar. Pastaj, unë kisha plot njerëz që e bënin këtë tashmë. Shoku im i vjetër, Omari si dhe kushërinjtë e mi më të mëdhenj më thërrisnin nga poshtë dritares pothuajse për natë.

Kur isha e vogël, ëm'e bijë u kishim vajtur kushërinjve për vizitë rrugës për te nëna dhe unë mbaja mend sa përshtypje më bëri që i madhi punonte me shtiza. Deri atëherë, mendoja se shtizat ishin vetëm për vajzat. Tani që banonim në të njëjtin qytet si studentë, vëllezërit ishin bërë këshilltarët dhe shokët e mi më të mirë. I kisha prezantuar edhe me shoqet e mia. Kushërinjtë sillnin shokët e tyre dhe kështu mblidheshim bashkë për pikniqe ose mbremje vallëzimi.

Omari përdorte fishkëllimën melodioze më të dalluar për të më thirrur nga poshtë dritares. Ai ishte shok i llojit që të thoshte hollësisht më intime të marrëdhënieve të tij me vajzën që po dilte për momentin dhe priste këshillën time më të sinqertë për reston. Të dyve na pëlqente të kërcenim dhe më bënte gjithmonë për të qeshur me shakatë “e pista” të çastit.

Siç po kthehesha te cepi i godinës, pashë Bertin duke u larguar te rruga përpara godinës përkrah një bjondeje të bukur e të gjatë me flokë të shkurtra. “Vate dhe shpresa e Vilmës!” – mendova e trishtuar për shoqen time që i kishte mbetur mendja në një aventurier të tillë.

Gjeta të voglin e kushërinjve duke u ulur te stolat me ca nga shokët tanë, kështu që u ula dhe unë me ta për pak kohë. I uruam njëri-tjetrit natën e mirë dhe vazhdova drejt dhomës sime, kur, papritur, u ndesha përballë Bertit.

- Mirëmbërëma! – më përshëndeti duke më shtrënguar dorën. – Po futesh brenda për sonte? – pyeti.

- Po. Po bëhet vonë. Ndenja ca me kushëririn tim dhe shokët e tij.

- E di. Të pashë qëparë, - tha me buzët vesh më vesh.

- Të pashë dhe unë, po nuk mendova se më vure re, - iu përgjigja e çuditur që më kishte parë nga aq larg.

- Je e pashme, - shtoi akoma duke qeshur, së cilës iu përgjigja,

- Për Vilmën ke ardhur? Do të ta thërras kur të ngjitem për në dhomë?

- Jo. Jo këtë radhë. Por do të doja të të ftoja ty në një mbrëmje për Pashkët me ca nga shokët e mi.

- Nuk e dija që ishe i krishterë, - iu përgjigja.

- Nuk jam! Jam thjesht i lumtur që, më në fund, të kem lirinë të festoj çfarëdo lloj feste fetare që më pëlqen. Te mbrëmja do të jemi deri në mesnatë, pastaj do të nderim qirinj dhe do të dalim rrugëve të Tiranës. Do të jetë shumë gallatë! – këmbënguli Berti.

- Jo, falemnderit! Nuk më duket me vend. As unë nuk jam e krishterë dhe nuk më duket se më takon ta festoj, - iu përgjigja dhe ika për në dhomë duke vrrarë mendjen pse Berti po më ftonte për në mbrëmje. Po më ndizeshin sirena të vogla paralajmëruese në kokë. *Sjellja e Bertit po duket si interesim i një natyre të dyshimtë.* Nuk do të rrija kurrë pranë një personi me reputacionin e tij në mes të natës. As do të shkoja në mbrëmje me dikë që e donte akoma thellësisht një prej shoqeve të mia më të ngushta. *Pastaj, a nuk e pranoi vetë që e pashë duke kthyer një vajzë tjetër në shtëpi as një orë më parë?* Nuk kanë pikë turpi ca e ca!

Aty nga ora dy e mëngjesit, na zgjoi papritur një gjullurdi e madhe poshtë dritares që dukej si serenatë këngësh e të bërtiturash nga disa të rinj. Unë e Ina u ngritëm nga krevatët dhe vrapuam te dritarja pa nderur dritën e dhomës. Pamë me kujdes poshtë përmes dy perdeve pa dalë në dritën e fortë të rrugës që ndriçonte në dhomë dhe njohëm Bertin e ca nga shokët e tij duke kënduar këngë dashurie poshtë dritares. Njëri nga djemtë po i binte kitares, ndërsa të tjerë valëvitnin qirinj dhe kaushë gazetash të nderura, duke bërtitur emrin tim dhe duke më thirrur të hapja dritaren ose të dilja poshtë të festoja Pashkën me ta.

- Çfarë do të bësh? – më pyeti Ina duke qeshur e duke parë me kujdes poshtë dritares nga errësira e dhomës.

- Asgjë! – iu përgjigja. – Do bëjmë sikur nuk ishim në dhomë sonte dhe nuk dëgjuam asgjë po na pyetën ndonjë herë ose po e mbajtën mend këtë natë. Jam e sigurt që janë të gjithë rrogoz. Vetëm shpresoj të mos e ketë dëgjuar Vilma gjithë këtë potere.

Nja gjysmë ore më vonë, djemtë u dorëzuan dhe ikën. Pastaj ne u shtrimë prapë e u përpoqëm të flinim për çka kishte mbetur nga ajo natë e ngarkuar. Sapo më kishin kënduar një serenatë, gjë që më përkëdhelte sedrën dhe do ta kisha shijuar shumë më tepër po të mos ishte bërë në kurriz të njëres prej shoqeve të mia më të dashura.

Të nesërmen, duke u kthyer nga mensa, u gjenda ballë për ballë me Tepelensin, një student i shkurtër po i ngjeshur që e ndiqte Bertin nga mbrapa si këlysh roje.

- Ku ishe mbrëmë? – pyeti. – Ne të bëmë gjithatë serenatë poshtë dritares dhe të thirrëm gjithë natën.

- Kush ne? – e pyeta duke u përpjekur të mbaja të qeshurën dhe të mos tregoja asnjë shenjë dijenie të zhurmës që më zgjoi mua dhe shumë të tjera në godinë një natë më parë.

- Ishte Berti, unë dhe ca nga shokët tanë, - shtoi.

- Oh, ju paska vajtur dëm kot! – gënjeva. – E kalova natën te një shoqe nga ana tjetër e godinës. Nuk dëgjova gjë. Mirupafshim! – ia bëra me dorë dhe vazhdova rrugën.

Isha më tepër e shqetësuar për reagimin dhe ndjenjat e Vilmës ndaj gjithë kësaj ngjarjeje. U ndjeva keq që po ndodhte, por nuk mund të sillja në mendje asnjë rast që t'i kisha lënë Bertit të kuptonte në ndonjë mënyrë se isha e interesuar për të.

- Hajde shfaqje, hajde! – tha Vilma sapo u pamë pas serenatës.

- Më vjen shumë keq që t'u desh ta dëgjoje, - iu përgjigja. – Nuk besoj se i kam dhënë ndonjë shpresë apo arsye të sillet ashtu.

- Nuk ke pse. Është tërheqje e natyrshme. Ju të dy keni shumë gjëra të përbashkëta dhe ndoshta do të bënit një çift të puqur. Ti duhet të dalësh me të! – sugjeroi Vilma.

- Si në “unë e bëj për vete, ai bie në dashuri dhe pastaj unë e lë kur t'i dhemb më shumë”? – u përpoqa të kuptoja, pa qenë e sigurt nëse shoqja ime po rrekej për hakmarrjen, po vinte në provë besnikërinë time prej shoqeje apo vërtet mendonte se shkonim bashkë.

- Nuk e kisha fjalën aty! – tha Vilma me të qeshur, e gudulisur nga plani im i shpejtë për hakmarrje. – Aq sa tunduese më duket si ide, nuk besoj se do ta çoje deri në fund. E vetmja mënyrë se si mund t'u dhembë njerëzve si ai është nëse të humbasin vetëm pasi të të kenë pasur të tërën! – u përgjigj Vilma.

- Eeee, jo! Për atë, pikës i ke rënë. Pa ofenduar shijen tënde në meshkuj, as më pëlqen e as i zë besë. Pastaj, jam e zënë! – shtova duke i shkelur syrin dhe u kujtova që sapo kisha shpallur dashurinë time të re për herë të parë.

- Pa dale, dale, prit, prit! Çfarë the, moj? Ke rënë në dashuri?! – pyeti Vilma me gëzim. – Ndonjë që njoh unë? – vazhdoi kurioze. – Uu, prit se do ta gjej vetë. Mos është shoku i Timos nga mjekësorja që takuam te kampi në Pogradeç? – shtoi Vilma.

- Ëhë! – ia pohova me buzëqeshje.

- E dija. Nuk reshtja së menduari atë natë se sa shkonit si çift, - vazhdoi Vilma po aq e ngazëllyer.

- Ou? Një puqje tjetër për mua, kështu? - e ngacmova.

Tani tre prej shoqeve të mia e dinin të fshehtën e shpirtit tim.

- Ohu, ti do të ishe puqje e mirë për çdo burrë! Jam shumë e lumtur për ty! Shkonit shumë bashkë atë natë që ju pashë duke kërcyer! – u shpreh Vilma.

Të shtunën tjetër, veshja fustanin më të bukur që kisha. Kunata më kishte dërguar një dy-tre metra copë si prej lëkure gjarpri, që ma qepi komshia në një fustan shumë elegant e të gjatë deri te pulpa. Më rrinte pas trupit deri te gjunjët, ku një fund verëf i zi i hapur më një anë deri poshtë gjunjëve krijonte përshtypjen e një sirene. Siç po zbrisja me kujdes tatëpjetët trotuarit me këpucët e bardha me taka, dëgjova dikë që më thirri në emër nga mbrapa dhe u ktheva të shihja. Ishte Tepelensi i Bertit.

“Mos! Jo tani! Nuk ka për të dalë mirë! Opo ku më gjen, xhanëm?” – thashë me vete e bezdisur, por e çliruar që Teo kishte vendosur të priste në rrëzë të kodrës, ku nuk mund të shihej me mua.

- Hajde njëra sonte! – tha Tepelensi duke m’u afruar.

- Po dal, - ia prita thatë e prerë.

- Berti do të të takojë sonte, - tha. – Ca nga shokët tanë janë ulur bashkë te klubi dhe ai do të donte që të vije dhe ti, - vazhdoi.

- Më bëhet qejfi, - iu përgjigja, - por, siç e shikon, kisha bërë plane të tjera, - i thashë duke përmbajtur veten. Nuk e kisha idenë se ç’ishte në gjendje të bënte dhe nuk kisha pikë dëshirë ta merrja vesh. Nuk mund të bëja gjë në një fustan të ngushtë dhe taka të larta.

U ktheva mbrapsht me shpejtësi dhe vazhdova të ec sa më shpejt që të mundja para se Tepelensi të ndërronte mendje. Nuk kisha më asnjë dyshim për qëllimet e Bertit ndaj meje. Po bëhej gjithnjë e më këmbëngulës dhe paksa kërcënues.

Siç kishte premtuar, Teo ishte në fund të tatëpjetës duke më buzëqeshur dhe i kënaqur që më shihte.

- Njatjeta! – më përshëndeti, siç filluam të ecnim përkrah njëri-tjetrit. – Ke dëgjuar për pastiçerinë e re turke që është hapur kohët e fundit? – pyeti.

- Po! Kam dëgjuar që bëjnë ëmbëlsirat më të mira! – iu përgjigja.

- Dua të të çoj atje sonte. Të vemi t’i provojmë, - tha dhe filluam të ecnim drejt ëmbëltores.

- Nuk të pyeta nëse ma njeh një kushëri që kam te mjekësia Mondin. Është moshë jonë. Jemi rritur bashkë derisa u shpërngulën me shtëpi në veri. Gjyshi i tij është xhaxhai i babit tim dhe ishte i martuar me tezen e mamit, - shpjegova.

- Sigurisht që e njoh Mondin! Bëjmë “qe-palla” sa herë shihemi. Uuuu! Do t’i them që po dal me kushërirën e tij dhe do ta ngacmoj për ty! – vezulloi Teo me gëzim nga idea.

- Më mirë t’i kisha vënë gojës një çorape! Mos i thuaj gjë, të lutem! – iu përgjigja e kënaqur që Teo donte të dilte hapur me marrëdhënien tonë të re, por e tmerruar me idenë që kushëriri im t’u thoshte atyre të shtëpisë së vet dhe ata të mive që po dilja me një çun, me të cilin nuk isha e fejuar. E imagjinoja tim atë ose tim vëlla duke thënë “Nëse do i biri i botës të takohet me ty, le t’i vijmë prindërit e të trokasin në derë”. Nga ana tjetër, kjo do të thoshte fejesë me dikë që mezi e njihja dhe as kjo nuk mund të shtyhej as me vaj as me uthull. Edhe im atë, që ishte martuar me mblesëri këtu e dyzetetre vjet të shkuara, e njihnte time më para se të martoheshin më gjatë se kaq. Nuk do të ishte më keq të fejojeshin gabimisht dhe më vonë të ndaheshin, sesa të dilja fshehurazi për njëfarë kohe derisa të siguroheshin? Nga ana tjetër, takimet e lirshme mund të rezultonin në rënien në dashuri të thellë e dhembje shumë më të forta po të qëllonte me personin e gabuar. Isha në luftë me veten edhe një herë.

- Kalova nga Filua sot, - tha Teo për vizitën e tij tek fakulteti Filologjik.

- Ç’është çoi atje? – e pyeta kureshtare.

- U takova me ish-en. Studion për histori. Ishim në një klasë në shkollë të mesme. I thashë që kam gjetur dikë, - u përgjigj me një buzëqeshje sikur të donte t’i thoshte gjithë botës për mua.

- Nuk e dija që ke pasur të dashur, - iu përgjigja e kënaqur që i kishte thënë dikujt për ne po paksa e bezdisur që po i mburrej ish-es.

- Rrokulliseshim nëpër misra, kur na çonte shkolla për të ndihmuar kooperativën me të korrat. Bënte dhe shkolla jote nga këto, apo jo? – më pyeti Teo.

- Po. I mbaj mend mirë ato ditë. Mbaj mend një orë rrugë në këmbë për te fushat ose lëmi dhe një orë e gjysmë mbrapsht, pas një dite të lodhshme me të çjerrat e misrave. Megjithëse, këtë rrokullisjen në lëpushka nuk e mbaj mend, - e ngacmova duke trokitur gishtin tregues mbi buzën time të sipërme. Programi i shkollës tënde më duket shumë më interesant se i times.

- Ishte me veprimtaritë jashtëshkollore! – vazhdoi Teo me lojë fjalësh.

- Më pëlqenin ditët e misrave; ishte qejf të mos bënim shkollë, të hanim, këndonim dhe afroheshim me shokët e klasës, po kur na përvëlonte dielli në kokë dhe na gërryenin zorrët në kthim, nuk ndihej më njeri.

- Si? Nuk je rrokullisur me asnjë në misër në shkollë të mesme?

Ja ky! Prapë duke gërmuar për dashnorët e së kaluarës sime!

- Isha si shkop, derisa mbusha katërmbëdhjetë vjeçe, nuk kisha veshur as sutjena në plazh, - iu përgjigja dhe fillova të mendoja: “Djemve u pëlqejnë cicat në çdo moshë! Po ti, pse je me mua sonte?!”. Pastaj vazhdoja: “Se si më duket që kishe një të dashur që aq i vogël! Shumica e vajzave që ishin të dashuruara në shkollë të mesme ishin ato që nuk kishin plane për të vazhduar shkollën e lartë. Po të mos vazhdonin, më mirë të martoheshin sapo të mbaronin shkollën e mesme, përndryshe do të mbeteshin “pleh n’katuat”, kur thoshte im atë”, - kujtova me të qeshur. – Nuk mbaj mend asnjë nga djemtë e klasës me ndonjë të dashur, ndoshta ngaqë të gjithë kishin mendje për shkollë të lartë. Pse nuk je më me të? – mora radhën për të përgjuar.

- Ziheshim shumë për gjëra koti. Mua më duket se zënkat e helmojnë dashurinë pikë-pikë! – u përgjigj Teo.

Pasta turke ishte aq e shijshme sa më kishin thënë. Isha edhe më e kënaqur që Teo pagoi për të dy. Kisha dëgjuar Timon të aludonte se shumica e vajzave dalin për të ngrënë qyl sikur t’ua kishin djemve me hile. Sapo të fillonte të dilte me një vajzë, djali do t’i humbiste shokët dhe do t’i zëvendësonte me të. Ndoshta Teo më donte vërtet, po nuk kishte rëndësi, sepse unë nuk mund ta vazhdoja këtë marrëdhënie dhe për shumë kohë. Edhe pse e kisha kyçur përkohësisht llogjikën në një nga dhomat më të errëta të mendjes, vazhdoje të trokiste gjithnjë e më fortë duke bërtitur: “Kjo marrëdhënie është rrugë pa krye!”. Teo ishte për Greqi dhe shumë i ri për të planifikuar ndonjë fejesë në të ardhmen e afërt, ndërsa ora ime po trokiste. Ndjenjat i përgjigjeshin “Ja edhe këtë radhë dhe pastaj nuk dal më”.

Koha kishte fluturuar përgjatë mbrëmjes sonë të këndshme duke ngrënë dhe folur së bashku. Shkuam te një nga stolat tanë të preferuar në parkun mbrapa Universitetit dhe u ulëm për pak kohë.

- Të thashë gjë unë ty sa mahnitëse dukesh sonte? – më pyeti Teo pothuajse duke pëshpëritur dhe duke u afruar drejt buzëve të mia.

- As edhe një herë të vetme, - iu përgjigja duke ngritur kokën për të mbaruar fjalinë. – Dhe të mendosh që veshja fustanin më *mudhern* që kam. E di ti sa e vështirë është të ecësh tatëpjetë me taka të larta sa këto?

- S’e kam idenë, - tha duke qeshur dhe duke më puthur në gushë. E gudulisur nga fryma e tij në gushën time, ula kokën poshtë për ta fshehur

dhe përfundova me buzët e mia mbi të tijat. Ai më mori kokën me të dyja duart e tij dhe më puthi lehtë e ëmbël. Edhe një nate tjetër dehëse po i afrohej fundi dhe unë i mbloja një nga një në shpirt si gurë të çmuar të rrallë, pa ditur nëse do të gjeja ndonjë tjetër ndonjëherë.

- Mirupafshim javën tjetër! – tha Teo, ndërsa u ngritëm nga stoli vonë atë mbrëmje maji.

- Mirë! – iu përgjigja. – Pastaj hamë! – dhe fillova të qesh.

- Hë? – pyeti pa kuptuar.

- Hiç asgjë. Një nga ato barsaletat e shkurtra.

- Ma thuaj, të lutem! – nguli këmbë.

- Jo! Akoma jo! Ndoshta herën tjetër.

- O ma thuaj tani, o do të të gudulis derisa të ma thuash! – më kërcënoi dhe filloi të më guduliste nën brinjë. Unë fillova të përdridhesha duke qeshur dhe duke i mbajtur duart ndërsa përpiqesha të mbushesha me frymë. Pastaj u dorëzova.

- Mirë, de, mirë, pastaj hamë. Një burrë kishte ftuar një grua për darkë në shtëpinë e tij dhe e pyeti: “Hamë një herë pastaj e bëjmë, apo...?” – “Mirë, pastaj hamë!” – e ndërpreu ajo në përgjigje.

U kënaqa duke e parë që qeshte si fëmijë.

- Më është bërë zakoni i keq tani. Sa herë që më duhet të përgjigjem “mirë” në shenjë miratimi të një kërkese apo pyetjeje, më rrëshqet nga goja “pastaj hamë” menjëherë, - shpjegova duke qeshur.

- Erdhëm. Natën e mirë! – i uruam njëri-tjetrit dhe unë fillova të vrapoja, po u kujtova shpejt që nuk mund ta bëja me këto taka dhe iu ngjita shkallëve të godinës me hap.

KAPITULLI IV

LOZ E QESH DERISA....

Iu ngjita shkallëve të konviktit sa më shpejt që të mundja dhe hyra me vrull në dhomë e lumtur dhe në ëndrra. Pas pak, hyri Ina që dukej e zbehtë dhe e tronditur. Ajo kyçi derën sapo e mbylli pas vetes.

- Çfarë ke? – pyeta shoqen e dhomës.

- Nuk e ke idenë sa me fat je që nuk ishe këtu sonte. Erdhi Tepelensi në dhomë para nja një ore i dehur tapë dhe i armatosur me thikë. Më pyeti se ku ishe dhe, kur i thashë që kishe dalë, u ul në krevatin tënd dhe vendosi të priste derisa të ktheheshe. Më detyroi edhe mua të ulesha në krevatin tim dhe më kërcënoi me thikë po të guxoja të dilja nga dhoma. Tha që Berti po pinte dhe po qante për ty dhe ai vendosi të bënte diçka për ta qetësuar. Kishte ardhur të të çonte tek Berti, - tha Ina.

- Pata një parandjenjë që kishte mendje të keqe kur e pashë qëparë mbasdite.

- Të pa të dilje të veshur kështu? – pyeti Ina.

- Më pa. Më tha për Bertin dhe më ftoi të veja ta takoja te klubi i bilardos, po unë i thashë që po shkoja gjëkund tjetër. Më vjen shumë keq, Ina. Më vjen shumë keq! Ç'paske hequr! Si i shpëtove?! – pyeta e mahnitur me trimërinë dhe kurajon e shoqes sime.

- Ai u ul në krevatin tënd dhe u rehatua për njëfarë kohe.

- M'u përballë teje?! Çfarë bëre ti?

- Ballë për ballë meje. Ça do bëja? Ulur edhe unë në krevatin tim, e trembur. Pastaj fillova të shtrydhja mendjen se si të shpëtoja.

- Po pastaj?

- Ai hoqi këpucët e çorapet që i qelbnin erë dhe pastaj u ngrit nga krevati

drejt lavamanit. Mendova se po shkonte të lante këmbët, por filloi t'i hidhte ujë syve një herë. Aty iu lëshova derës me vrap nga mbrapa tij. Sapo dola nga dhoma, fillova të bërtisja nëpër korridore dhe shkova lart te Vilma. Atëherë do të ketë dalë nga dhoma, - u përgjigj Ina. – Duhet t'i biesh mbrapa kësaj. Jepi fund. Mos e lër të zgjatet kështu! – vazhdoi.

- E di. La nam. Tepelensi do t'i ketë thënë Bertit menjëherë mbasi më pa duke dalë. Do flas me Bertin nesër, - i premtova dhe fillova të zhvishesha gati për gjumë. Nuk më dilte nga mendja se si Teo më kishte shpëtuar edhe një herë nga një “ushtar” tjetër i zellshëm, “ushtari” i Bertit.

Të nesërmen, pas mësimit, shkova në mensë për të marrë drekën. Tek po prisja në radhë, pashë Bertin duke ngrënë vetëm në një tavolinë. Mora gjellën me vete dhe, pa m'u dridhur qerpiku, i vajta me hap të vendosur atje ku ishte ulur. As vetë nuk e dija se si nuk kisha fare frikë prej tij edhe pas gjithë ndodhive të një nate më parë. E dija që vetë ai nuk do të më bënte gjë.

- Çfarë të kam bërë unë ty që meriton terrorizimin e shoqes së dhomës? – e pyeta me vetulla të mbledhura duke u ulur në karrigen përballë tij.

- Më vjen keq që bëri ashtu, po ç'faj kam unë se kam shokë besnikë. I erdhi keq për mua dhe e mori vetë situatën në dorë për të ndihmuar një shok në nevojë, - u përgjigj Berti me qetësi dhe vazhdoi të gjerbte fasulet.

- Çfarë kërkon prej meje? Çfarë duhet të bëj unë që të më lësh të qetë? – e pyeta e shqetësuar nga kërcënimi i tij, me të cilin sikur nënkuptonte që ai nuk kishte gjë në dorë për të ndaluar gatishmërinë e shokëve të tij të zellshëm për ta “ndihmuar” përsëri.

- Po hëngre një darkë me mua, nuk kam për të të ngacmuar më kurrë! – premtoi Berti dhe i shndritën sytë.

- Vetëm kaq? – ia ktheva pa u besuar veshëve.

- Vetëm aq! – u përgjigj. – Dua thjesht të të qeras me një darkë. Di një restorant fantastik poshtë në Tiranë. Bëjnë biftekët më të mirë. Një darkë me mua dhe unë do të ta mbush mendjen që ti dhe unë i përkasim njëri-tjetrit, - vazhdoi.

-Mirë, pra, një darkë! – rashë dakord duke u ngërdheshur me mendjemadhësinë e tij.

- Takohemi para liceut sonte në orën gjashtë? – pyeti Berti.

- Shihena në orën gjashtë, atëherë!

U ngrita, mora sapllakun e drekës dhe u ktheva në dhomë.

Berti po më priste tamam atje ku e kishim lënë vetëm tre orë më parë.

- Unë e di që të pëlqej! – tha prapë me atë besimin në vetvete që më bezdiste edhe më tepër sesa lëkura e tij e vrazhdë. Provokonte kryeneçen brenda meje dhe frymën e kundërshtimit në çdo bisedë.

- Nga e nxore këtë përfundim? – e pyeta duke i kuptuar përpjekjet e tij të dëshpëruara për të më bindur mua, por mbi të gjitha vetveten, që më pëlqente, veçse shkaktonte të kundërtën.

- Ti ke veshur pantallona për të më kënaqur mua, sepse të kam thënë më parë që të shkojnë pantallonat më shumë se fundet, - tha buzagaz duke bërë ç'është e mundur ta trajtonte këtë si një takim të zakonshëm të dashuruarish.

- Unë kam veshur pantallona se rrallë vesh funde, - iu përgjigja në përpjekje për t'i prerë çdo fije shprese që mund të kishte pasur për një marrëdhënie me mua. “Dhe për të asgjësuar ndonjë ide tënden çakalloze të papritur!” – vazhdova me vete.

Ecëm më këmbë disa minuta rrugës për te restoranti. Fillimisht, u vura pak në siklet kur Berti shtyu një portë të vjetër prej druri në mes të një muri tulle të lartë, që ndante një shtëpi përdhese tradicionale Tiranase nga rruga.

- Erdhëm? – e pyeta. – Kjo është taverna jote e famshme?!

Para se të ndiqja Bertin brenda, u përkula pak përpara me kokën midis kanatave të portës për të parë brenda. Kisha dëgjuar për tavernën, po nuk e dija që ishte një shtëpi e kthyer në restorant. I gjithë oborri përpara shtëpisë ishte i shtruar me çimento dhe tavolinat e mbuluara me mbulesa të bardha ishin shpërndarë gjithandej. Muret prej tulle që kisha parë nga jashtë e rrethonin oborrin nga të gjitha anët. Hardhitë e ngritura mbi muret e larta krijonin një ambient shumë romantik dhe intim për disa çifte të tjera. U ndjeva pak më e qetë kur pashë që nuk ishim të vetmit njerëz që do të hanin aty dhe zbrita tre shkallët nga porta për në oborr. Berti porositi verë dhe biftekun karakteristik, që ishte vërtet më i miri që kisha ngrënë ndonjëherë.

- U ngope? – më pyeti Berti, kur vuri re pjatën time të fshirë.

- Po! Falemnderit. Ishte shumë i mirë! Më pëlqeu edhe vera! – iu përgjigja.

- Do një tjetër? – më pyeti me shpresë për të zgjatur kohën që po kalonim bashkë.

Bertit nuk i bëhej vonë që kjo darkë do t'i kushtonte sa gjashtë muajt e ushqimit të mensës. Ishte me rrogë profesori në Universitet. U mendova për një sekondë të shpejtë dhe thashë: “E pse jo? Me gjithë qejf?”. Në fund të fundit, unë e kisha bërë të qartë që kisha ardhur në takimin e sotëm vetëm për të ngrënë dhe ai do të paguante për të gjitha. Berti, nga ana tjetër, po përpiquej të bënte xhentilin dhe të linte përshtypjen më të mirë.

- Pse nuk të pëlqej unë ty? – pyeti që përtej tavolinës.

Ishte hera e parë që e shihja aq të dorëzuar. Për pak sa më erdhi keq për të, por vura frenat dhe vazhdova.

- Sepse dua dikë tjetër. Atë natë që erdhi Tepelensi të më merrte për tek ty, unë isha duke dalë me të, - iu përgjigja prerë.

- Nuk të besoj. Po të kishe ndonjë tjetër, unë ose shokët e mi do të të kishim parë me të, - tha Berti.

- Më pëlqen ta mbaj sekret nga lloji yt. Po edhe sikur të isha e disponueshme, nuk do të shkoja kurrë me ty. Ti ke nam të keq dhe nuk do të të zija besë me asgjë, pale diçka aq të shtrenjtë sa dashurinë time, - iu përgjigja. – Pastaj, ti mund të zësh kë të duash. Pse je kaq i fiksuar në mua, një herë? – vazhdova me kureshtje.

- Me sa duket, jo këdo. Të pashë një natë duke kërcyer me Xanin, arixhiun çalaman, para godinës tënde. Ti ishe ulur me nja dy çuna të tjerë. Xani filloi të tregonte ca shqelma karateje me “Billi Xhiin” në sfond dhe ti fillove t’i afroheshe duke kërcyer me vithet më joshëse që kam parë ndonjëherë, duke e eksituar komplet të shkretin. E mban mend? – më pyeti Berti me dritë në sy.

- Uuuuu! Si nuk e mbaj mend? Nuk u besonte syve. Ça qejfi ishte! Edhe çmenduri, apo jo? Ai tërheq këmbën zvarrë për të ecur, por i lëviz vithet si askush që kam parë. Unë thjesht po përpiqesha ta imitoja me lëvizjet e të mijave. Unë isha ulur dhe po dëgjoja me kushërinjtë muzikën nga manjetofooni që kishte nxjerrë njëra nga gocat. Njëri nga kushërinjtë më sfidoi të kërceja me Xanin dhe unë aq desha sapo dëgjova “Billi Xhiin”. Po ty nuk të mbaj mend aty afër. Sigurisht, unë po vdisja prej ndrojes nga ç’po bëja dhe, si struci, nuk guxoja të shikoja se kush po më shihte, po e bëra gjithsesi. Po qe për të kërcyer, dy fara kam në kokë unë! – thashë duke qeshur.

- Atëherë jam goditur unë nga ty dhe mënyra se si lëviz. Spontaniteti yt, aftësia jote për të shkrehur vargonjtë e së rëndomtës apo të gjykimit të të tjerëve është ajo që mendoj se kemi të përbashkët, - tha Berti.

- Eee, mirë e ke ti, po ja që unë nuk ndjej të njëjtën gjë për ty. Kot s’ia thonë dyshe myzeqare! – iu përgjigja duke dërrmuar pasionin e tij.

Unë e kisha fshirë edhe pjatën e dytë dhe filluam të ngriheshim.

- Uou! Më duket se piva një çikë si shumë verë, - thashë me mendjen vërdallë, kur u ngrita në këmbë për të ecur. Berti vuri menjëherë krahun e tij të djathtë nën të majtin tim për të më mbajtur, ndërsa filluam të dilnim nga restoranti.

- Mund të ec vetë tani që u ngrita, - thashë duke hequr krahun tim me kujdes nga dora e tij. – Ne bëmë marrëveshje. Unë e mbajta fjalën dhe u

kënaqa, në fakt. Tani pres që edhe ti të mbash premtimin që bëre për të më lënë të qetë, - i thashë siç po i afrohemishim godinës sime.

- Si mund të të bind unë ty që kam qëllime të sinqerta ndaj teje? – ngulmoi Berti. Lutja e tij tingëllonte edhe më e dëshpëruar me çdo hap që hidhnim drejt konviktit.

- Edhe po të isha e lirë, sa herë mendoj për ty, më vjen në mendje fabula e bariut që bërtiti “Ujku!”. Herën e tretë që thirri për ndihmë, kur ujku i ra vërtet në bagëti, nuk ia vuri veshin njeri. Ti mund të kesh rënë vërtetë në dashuri këtë radhë, po nuk të beson njeri. Më mirë syri se nami! – i thashë duke i qendruar times.

- Ti thuaj vetëm fjalën dhe unë të vij në shtëpi që nesër. Imagjinoje! Nesër si në këtë vakt unë e ti të fejuar! – u lut Berti edhe një herë dhe nuk i besohej që mbrëmjes si edhe mundësisë së tij për të më bindur për dashurinë e tij i kishte ardhur fundi.

- Natën e mirë, Berti! Shihemi në klasë! – e përshëndeta duke iu ngjitur shkallëve për te godina ime. I ktheva shpinën duke buzëqeshur për një tjetër herë të parë; propozimi im i parë për fejesë. Më erdhi mirë, edhe pse jo nga djali i duhur.

Më vonë gjatë javës, dëgjova një zë të ndrojtur që më thërriste emrin nën dritare. Më kërcëu zemra nga vendi dhe unë e ndoqa për te dritarja të shikoja fytyrën e dashur që i përkiste atij zëri të njohur, që më mungonte aq shumë që prej së dielës së kaluar. Teo kishte ardhur prapë dhe tani po më jepte shenjë nga poshtë të shkoja ta takoja. Futa këmbët në këpucët e sheshta lejla dhe fillova të dilja nga dhoma me vrap. Kapërceva nga dy a tre shkallë njëherësh dhe ndalova për një çast para pasqyrës së gjatë mbi murin e djathtë midis dy kateve. “Çdo gjë në rregull!” – mendova duke parë blu-xhinset e ngushta dhe bluzen deve bojëqielli mbi to.

Papritur, dallova një mur tulle që mbulonte gjysmën e dritares midis dy kateve, të cilin nuk e mbaja mend të kishte qenë atje më parë. Dy godinat e konviktit ishin të lidhura nga hyrja dhe salla e përbashkët njëkatëshe e televizorit, ku vajzat e të dy godinave sillnin batanijet dhe uleshin në stolat e drunjte për të parë televizor në mbrëmje. Në të dalë, ndalova dhe pyeta rojen e godinës për murin e ri.

- E kanë ngritur kohët e fundit! – shpjegoi roja. – Se kush u fut vjedhurazi në godinë javën që shkoi dhe mendohet se është ngjitur prej andej.

Kafshova buzën e sipërme për të mbajtur të qeshurën derisa dola nga godina duke e ditur tamam se kush ishte faktori dhe pse. Tani platforma e

pushimit midis dy kateve ishte më e errët për shkakun tim dhe vajzat do ta kishin më të vështirë të shiheshin në pasqyrën e gjatë para se të dilnin.

- Mirëmbërma! – e përshëndeta Teon me buzë në gaz kur u takuam te vendi ynë i zakonshëm në rrëzë të kodrës në të dalë të qytetit Studenti.

- He, më, zëmrë! – m'u përgjigj edhe ai buzagaz. – Si ke qenë?

- Mirë, - u përgjigja. – Po ti? – ia ktheva, ndërsa mendova: “Uuuuuuu! Mos më thirri gjë zemër? Apo ashtu i përshëndet gjithë shokët e vet?”. E kisha dëgjuar të njëjtën përshëndetje nga Timua më parë, kur i drejtohej shokëve të tjerë nga qyteti i tij. Ndoshta prandaj guxoi të më quante ashtu. Sido që të ishte, mund të fshihej pas së njëjtës arsye. Përdesh u gëzova kot!

- Mirë! – u përgjigj. – Po na afrohen provimet shpejt! – shtoi siç po kalonim rrugën e Elbasanit për në pyllin matanë.

Isha në mëdyshe të madhe për t'i treguar Teos ngjarjet e mia të javës së kaluar. Doja të hapësia e t'ia thosha të gjitha, por kisha frikë se rrezikonte jetën po të merrej me turmën e Bertit për hatrin tim. Vendosa të prisja edhe pak. Në fund të fundit, Berti më kishte premtuar se do të më linte rehat kështu e tutje dhe unë vendosa ta besoja. Nga ana tjetër, i kisha thënë Teos të mos kthehej më dhe nuk isha e sigurt sa më gjatë do të vazhdoja me të.

U ulëm në një nga stolat nën tendën rrethore dhe më hodhi atë vështrimin e tij ngulitës që më ngrinte buzëqeshjen në vend dhe më bënte zemrën të rrihte si e marrë prej mendimit që do të më puthte në çast. Më puthi me ngadalë në buzë dhe më vuri duart në mes, këtë radhë nën bluzën.

- U, hallall! – shpërtheu me çudi, i kënaqur që nuk kisha veshur asgjë poshtë bluzës. Shpërtheva dhe unë në të qeshura përsëri dhe vendosa të shijoj momentet e shtrenjta së bashku për sa kohë që e kisha.

- Shshshsh! Do të trembësh çiftet e tjera nëpër pyll! – tha dhe më zuri buzët me të tizat për t'i mbyllur. Rrëshqiti duart nën kofshat e mia dhe më ngriti peshë mbi prehërin e tij tashmë të rrethuar nga këmbët e mia. Ngriti fundin e përparmë të bluzës së kuqe të pambuktë mbi kokë dhe mbas qafe pa e hequr nga krahët. Lëkura e tij e lëmuar dhe e ngrohtë që i mbulonte muskujt e barkut, preku timen kur iu përgjigja duke ngritur edhe unë bluzën time pjesërisht. Ia vura kokën mes duarve duke i përkëdhelur flokët gështenjë dhe duke i puthur gjithë fytyrën nga balli tek vetullat e drejta, sytë kafe, gropëzën në faqen e majtë e deri tek buzët e tij të ëmbla.

- Thonë që po ta puthësh të dashurin në sy, ndahesh! – citova një nga bestytnitë e shumta që kisha dëgjuar që e vogël.

- Atëherë..., - u përgjigj Teo duke zhvendosur kokën sa nga një anë në tjetrën sa herë që i veja për sytë.

“Ja dhe një shenjë tjetër që nuk do të më lërë!” – mendova duke kërkuar me dëshpërim sigurinë në dashurinë time të re.

- Nuk mund të rri shumë gjatë sonte. Më duhet të provoj mos shkoj në shtëpi që sonte për sezon. Do të përpiqem të vij të të takoj pas provimit të parë javës tjetër, - tha Teo pas nja dy orësh së bashku.

Kur mbërritëm pranë konviktit, tingujt e zërit ëngjëllor të Uitnit po mbushnin natën e errët e të ngrohtë pranverore me “Gjithë burri që më duhet”. Njëra nga vajzat e godinës kishte ndezur manjetofonin në parvazin e dritares në një nga katet e sipërme dhe kënga dëgjohej e qartë dhe e plotë tridhjetë metra më tutje, para mensës. Ishte një nga këngët e mia më të dashura ato ditë. Ndalova dhe i bëra me shenjë Teos ta dëgjonte.

- Të përhëndes! – i thashë dhe fillova të këndoja pas refrenit “*Ai më mbush, ai më jep dashuri, më shumë dashuri seç kam parë ndonjëherë...*” – A nuk është fenomenale? – shtova dhe u zhgënjeva paksa që ai nuk ishte dhe aq i ngazëllyer sa unë.

- Është zezake! – ma priti Teo.

- E çë pastaj? Sikur do ta marrësh për grua ti. Apo dhe ta shikosh, xhanëm!

- Nuk dëgjoj muzikë zezakësh! – shtoi duke qeshur.

- Çfarë dëgjon ti?

- Metalika! – u përgjigj Teo.

- Ou! E mirë. Unë mendoj që ajo është e mrekullueshme! – i thashë. – Zëri, teksti, muzika... Më pëlqejnë nja dy nga këngët e metaliksave, megjithëse nuk e kam idenë se për çfarë bëhet fjalë! – shtova.

- Do përpiqem të gjej tekstet dhe t’i sjell ndonjëherë, - u përgjigj Teo.

- Mirë, pastaj hamë! – thashë duke qeshur e duke dashur aq shumë ta puthja edhe një herë para se të vrapoja shkallëve.

Vendosa të kaloja nga shoqja ime, Edi, para se të shkoja në dhomë për të mësuar për provimin e ardhshëm. E kisha zemrën kaq të mbushur me emocion, sa më dukej sikur do të pëlçiste po të mos ndaja ca me Edin. Ishte e dashur sa një nënë, vetëm se më e lehtë për t’iu hapur dhe aspak gjykuese. Ndjeja plot faj vetë e nuk kisha nevojë për doza shtesë nga një shoqe.

Edi ishte në dhomë me dy studente të vitit të parë, Tina e Selvia nga Vlora, një qytet i bukur bregdetar përgjatë Detit Jon, në jug të vendlindjes sime. Tina ishte e zgjuara, gojëmprehta, çapkënia dhe më e shprehura nga të dyja. Selvia, nga ana tjetër, ishte shumë e ndrojtur dhe e rezervuar në një ambient të panjohur, por me shumë humor pasi të të njihje.

- Ç't'i gjeti pantallonat, moj? – më pyeti Selvia, ndërsa qeshte dhe vinte gishtin te një grisje e vogël poshtë xhepit të pasmë të pantallonave të mia.

- Ohu dhe ti! Vinin pak si të tripsura vetë! E di unë ku të vete mendja ty, po nuk ka ndonjë gjë për t'u hargalisur këtu! – iu përgjigja duke u ulur me vrap te krevati i Edit, e skuqur nga turpi.

- Me sa duket, çdo gjë duket në rregull këtej nga lagjja jote! – u hodh Edi.

- Ëhë! – iu përgjigja me buzët vesh më vesh, që më ndriçonin gjithë fytyrën e lumtur dhe pa një pa dy, fillova t'i lodhja veshët Edit se sa mrekullueshëm ia kisha kaluar atë natë. – Sa i mrekullueshëm është dhe sa e lumtur ndjehem kur jam më të! – vazhdova.

- Kur do të vijë prapë? – pyeti ajo.

- Pas provimit të parë, shpresoj! – iu përgjigja. – Meqë ra fjala te provimet, vajti ora të vete të filloj. Natën e mirë! – përshëndeta shoqen dhe zbrita për në dhomën time.

Dhjetë ditë më vonë, Teo më thirri në emër nga poshtë dritares përsëri. Vesha shpejt e shpejt fustanin e shkurtër të zi të trikotuar, hodha mbi të një bluze krepë rozë me pulla përpara dhe zbrita shkallët me vrap për ta takuar.

- U hallaaaaall! – u shpreh Teo duke parë fustanin tim të shkurtër dhe unë buzëqesha e kënaqur që vuri re përpjekjen time për ta bërë të veçantë takimin tonë pas ndarjes më të gjatë.

- Si dole? – e pyeta për provimin, ndërsa filluam të ecnim drejt parkut të pyllëzuar rreth liqenit.

- Mora dhjetë! – u përgjigj Teo duke buzëqeshur. – Ti më sjell mbarësi! – vazhdoi duke u përpjekur ta ndante me mua meritën e suksesit të tij.

- Urime! – u gëzova për të dhe më erdhi mirë që kisha sado pak pjesë në suksesin e tij.

- Po ti? – më pyeti.

- Jo aq mirë sa ty! – iu përgjigja. – Nuk përqendrohem dot! Nuk më lënë ëndrrat me sy hapur që shikoj për ty!

Më mbështollí prej beli me krahun e tij të majtë dhe më ngriti peshë kundrejt vitheve të tij që të shmugia pellgun përpara nesh.

- Oh, s'ka gjë, se e kapërcej kollaj me këtë hap të madh që kam! – thashë nga frika se mos isha shumë e rëndë për krahët e tij, por shumë e lumtur që kishte dëshirën dhe forcën e mjaftueshme për të më ngritur peshë. – E bëj shpesh në korridoret e konviktit. Ka mundësi që i luaj mendsh gjithë vajzat e katit kur edhe këndoj me sa kam në kokë. Më pëlqen shumë si jehon zëri si me mikrofón. Më kujtohet shtëpia.

Shtëpia ku jam rritur kishte gjashtë shkallë gjysmë-rrethore, që zbrisnin nga ballkoni katror para derës së jashtme. Kur isha e vogël, shkalla e sipërme ishte skena ime mbrëmjeve, kur gjithë fqinjët në tre pallatet rreth e rrotull shtëpisë ishin brenda duke parë televizor. Këndoja këngën e sopranos më të dashur për mua, Tefta Tashko Koço “Kur më vjen burri nga stani”, ndërsa mami lante enët te pusi pranë gardhit. Pusi ishte mbushur me dhé, por çezma ishte përjashta afër pusit.

- Pse ishte çezma përjashta? – pyeti Teo.

- Nuk jetonim në pallat. Banonim në një shtëpi private me oborr me kumbulla dhe mollë, vetëm se nuk ishte pronë e tim eti. Im atë ishte më i madhi nga nëntë fëmijët. E ëma i vdiq tre muaj pas lindjes së tij dhe i ati u martua përsëri. Para Luftës së Dytë Botërore, gjyshi dhe vëllezërit e tij kishin prona shtëpish dhe hektarë tokash anembanë si dhe plot bagëti, lopë e kuaj. Kur babi mbaroi ushtrinë, vendosi të rrinte në ushtri si llogaritar dhe u bë anëtar partie. Nuk u kthye në tokat e familjes dhe ushtria i dha shtëpi kudo që e caktonin derisa u stabilizua në Fier, në shtëpinë ku u rrita.

I zoti i shtëpisë ishte mësues matematike i martuar me një mësuese letërsie dhe kishin tri vajza. Ai trashëgoi dy shtëpi private, secila me tokë rreth e rrotull. Shteti vendosi që kishte shumë shtëpi për një familje dhe ia sekuestroi më të madhen, një shtëpi dykatëshe, ku strehoi një familje tjetër me qera simbolike, kurse shtëpinë tjetër e detyroi ta ndante me ne. I mori edhe shumicën e tokës dhe ndërtoi tre pallate në të, ku strehoi tridhjetenëntë familje. Ne banonim në dy dhomat e pasme, po nuk kishim banjo brenda dhe mami e shndërroi pjesë të korridorit në një kuzhinë të vogël. Pronari mbajti dy dhomat e tjera të gjumit, të vetmen kuzhinë dhe banjo dhe sallonin e hyrjes, që e përdorte si dhomë pritjeje. Babi dhe mami im ndërtuan një hale mbi kanalën e ujërave të zeza në fundin lindor të bahçes dhe një rrugicë çimentoje nga shkallët rrethore deri atje.

Pak pas lufte, edhe gjyshi im e humbi të gjithë tokën e tij, kur shteti vendosi ta konfiskonte nga çdo pronar toke në fshat. Babi e bindi ta jepte vullnetarisht, përndryshe do të rrezikonte degdisjen e gjithë familjes në internim. Gjyshi pranoi me dhimbje dhe gjithë familja shpëtoi nga titulli “kulak”.

- Gjithë ato vite në ushtri dhe nuk i dhanë asnjëherë një shtëpi tjetër? – pyeti Teo.

- I ofruan disa, po ai gjithmonë gjente diçka që nuk i pëlqente nga apartamenti dhe nuk pranonte. “Jo kjo është e nxehtë nga taraca, kjo është në kat të parë, një tjetër shumë afër uzinave”. Unë mendoj që atij i pëlqente shumë bahçja. Doli në pension nga ushtria duke qenë akoma në të dyzetat

e vonëta dhe e kalonte më të shumtën e kohës me rritjen e perimeve dhe të pulave.

- Ku i mbante? – pyeti Teo me habi që i fshehëm mu në mes të qytetit.

- Filloi me pulat këtej nga vitet e fundit, kur po dukej se morsa komuniste po lirohej disi. Natën flinin në bincën poshtë njëres prej dhomave të gjumit. Më dërgon mami ndonjë zog të pjekur herë pas here.

- Lum ti! – tha Teo.

- Po boll me historitë e familjes sime.

- Më pëlqejnë historitë e tua! – u përgjigj ai. – Po të mos kishte dhënë tokën gjyshi yt, do të ishte bërë kulak, familja jote do të kishte një njollë në biografi dhe ti nuk do të kishe arritur në shkollë të lartë.

- E vërtetë! – u përgjigjja unë. – Njihja një djalë shumë të zgjuar me nota të shkëlqyera te shkolla ime që as që mund të bënte kërkesë për shkollë të lartë vetëm prej “biografisë së keqe”.

- Kisha dhe unë ca nga ata në shkollën time. Po tani do të jenë pranuar në shkollë. Jemi me fat që kemi lindur në këtë kohë. Të gjeta nja dy nga ato tekstet që të premtova, - shtoi Teo.

Nxori një copë letre nga xhepi i djathtë i pantallonave dhe filloi të këndonte disa nga vargjet me zërin e tij të thellë, por të ndrojtur. Unë buzëqesha me atë çka tingëllonte më tepër si recitim, por nuk mund të dalloja nëse ishte ngaqë stononte apo ngaqë nuk e kisha dëgjuar ndonjë herë këtë këngë. Edhe pse e kisha zakon ta qëlloja me grusht në krahë Dianën, shoqen time të fëmijërisë, sa herë që stononte, të kënduarit e Teos nuk më bezdiste fare. Në sytë e mi ishte po aq i dashur sa më parë.

I ishim afruar një zone të pyllëzuar thellë në park dhe Teo zgjodhi një vend të përshtatshëm për t’u ulur në tokë të rrethuar nga pemët. Ishte një mbrëmje qershori me zagushi dhe re.

- Duket sikur do të bjerë shi! – thashë sapo ndjeva nja dy pika shiu në fytyrë. – Ndoshta është shenjë nga lart që nuk duhet të jemi këtu! – vazhdova, por Teo m’u afrua duke më parë thellë në sy dhe filloi të më puthte. Mbështolli trupin tim të brishtë me krahë dhe u përkul lehtë përpara mbi mua.

Obobo! Po tani nga t’ia mbaj? Më mbaruan tregimet dhe as ai nuk po flet dhe aq! Fillova të dridhesha e tëra nga brenda. Ku më çonte mushka me fustan të shkurtër? Mund ta puth përgjithmonë, po jam e tmerruar nga ç’ka ndër mend për sonte. Po më shket situata nga dora me shpejtësi, po si ta kundërshtoj tani?

- Mos ki frikë! Do të jem shumë i kujdesshëm! – pëshpëriti Teo, duke

ndjerë trupin tim në dridhje, që konfirmoi atë që kisha marrë me mend. Ai vazhdoi të më puthte lehtë në gushë, pastaj me ngadalë filloi të më përkëdhelte nëpër trup me dorën e djathtë, ndërsa më mbante tek shpatullat me të majtën. Sa më poshtë ulej dora e tij, aq më e tmerruar isha për atë që tashmë dukej e pashmangshme. Fillova të harkoja shpinën duke përkulur gjunjët për të shtytur trupin lart me këmbët kundrejt tokës dhe duke pëshpëritur më kot: “Jo, jo, jo tani!”.

Pa u vënë veshin lutjeve të mia të fikura dhe të mundura, Teo rrëshqiti gishtin e mesëm nën të mbathurat e mia prej dantelle dhe i tërhoqi përgjatë kofshës. Pastaj e rrëshqiti prapë lart, ngadalë përmes kofshëve të mia. I kapa dorën e djathtë, e vura mbi kofshë dhe pëshpërita: “Më shpon! Me cepat e thonjve...”.

Teo me shpejtësi zbërtheu rripin dhe uli pantallonat e tij për të kaluar në opsionin mishtor, siç i kisha lënë të kuptonte. Vazhdova të përpëlitesha për t’i shpëtuar mbërthimit të tij, tashmë me të dyja duart nën shpatullat e mia me gishtat të përkulura mbi supet, duke më tërhequr në drejtim të kundërt. Teo dha një ngjeshje të fundit brenda meje dhe unë dëgjova një kërcitje.

Mori fund! Nuk ishte aq e dhimbshme sa kisha kujtuar, vetëm se tani nuk dija ku të fshihesha. Po mendohesha nëse e dëgjoi dhe ai kërcitjen i shtrirë mbi mua. *Mos më duhet të qaj tani?* Kisha dëgjuar tregime vajzash që qanin kur humbisnin virgjërinë, por asnjë lot nuk po gjendej gjëkund në sytë e mi. *Koka bën, koka pëson!* E çliruar që kishte marrë fund, veshat të mbathurat si një arsye për të mos u parë në sy me Teon, që tani ishte ulur pranë meje. *Ja ku vjen dhe turpi!* Vura kokën midis gjunjëve të mi dhe nuk mund ta shikoja.

- Ej, ç’ke tani? – pyeti Teo duke më fërkuar në shpatulla, si për të parandaluar për mua një moment që po dukej në prag të qarjes.

- Kam dashur gjithmonë të isha një nuse e virgjër! – pëshpërita e zhgënjyer që nuk qe e thënë.

- Je sonte! – u përgjigj Teo me krahun ende mbi supet e mia. Më ndihmoi të ngrihesha dhe ecëm qetësisht me krahë të kryqëzuar mbas njërit-tjetrit.

Çfarë do të thotë me “je sonte”? *Mos po thotë që jam nusja e tij sonte?* Sigurisht që më pëlqeu ky premtim i nënkuptuar, por fjala kyçe ishte “i nënkuptuar”. E dija që nuk mund t’i vija shumë peshë.

Shiu kishte pushuar dhe unë isha e qetë për atë natë të shënuar. Nuk kishte kuptim të pendohesha apo të shqetësohesha për të. Ç’u bë u bë! Tani vetëm sikur të fikja zërin e mamasë që më përsëritej në kokë: “Sapo mashkulli

‘pushton’ një ‘kështjellë’, hidhet te tjetra!’”. Megjithëse Teo nuk më kishte dhënë kurrë përshtypjen e ndonjë tipi që bridhte gardh më gardh, mendja dinte të mos priste që kjo marrëdhënie të zgjaste për shumë kohë, por zemra ime nuk mund të mos ndjehej më afër tij dhe gjithë shpresë për momentin.

Pas një jave, dëgjova emrin tim të thirrur në mënyrën më të dashur nga poshtë dritares dhe mendova: “Erdhi prapë!”. Vrapova për te dritarja e hapur, pashë poshtë nga i dashuri im i gjatë e i bukur dhe valëvita dorën për të më parë që aty isha. Vesha këpucët e sheshta me shpejtësi dhe dola nga dera me vrap.

- Nuk e dija që ishe nga ata studentët me të gjitha dhjeta! – thashë e habitur që Teo kishte marrë edhe një dhjetë tjetër në provimin e dytë.

- Asfare! – këmbënguli buzagaz. – Të thashë unë që ti më sjell fat! – u përgjigj, ndërsa filluam të ecnim përmes parkut tonë të dashur me krahun e tij mbi supet e mia dhe duke folur për provimin e suksesshëm të asaj dite.

- Duhet të vemi të gjejmë pemën tonë! – propozoi duke buzëqeshur.

- Cilën pemë? – pyeta me habi.

- Atë që më erdhi në ndihmë javën që shkoi.

- Si të ndihmoi?

- Ti ngele duke më shkarë si ngjalë. Vetëm e mbajtura nga njëra anë nuk do ta kishtë bërë “punën”. Përdora pemën për të mbështetur këmbën për “goditjen” përfundimtare, - shpjegoi Teo duke qeshur.

- Epo qenka pema jote, atëherë, - ia ktheva unë.

Iu drejtuam të njëjtës zonë të pyllit, ku kishim qenë një javë më parë.

- Akoma nuk më ke thënë si ia mbushe mendjen ushtarit të mos futej në mbrëmjen tonë atë natë në Pogradec, - e pyeta Teon, tek ecnim përkrah njëri-tjetrit.

- Jam shumë bindës nganjëherë, për arsyet e duhura. Kisha një arsye shumë të fortë në atë dhomë të mbrëmjes, që nuk doja ta ndaja me të atë natë. Pastaj, më duket se i pëlqeva edhe atij. Ngeli duke më quajtur “ëmbëlsirë” dhe tha se do të na linte të qetë vetëm prej meje. Pastaj tha që donte të ta bënte vetëm një herë, - vazhdoi Teo duke qeshur me sytë e mi të mahnitur.

Nuk po u besoja veshëve. Nuk e kisha kuptuar kurrë sa afër përdhunimit kisha qenë atë natë.

- E çfarë i the ti? – e pyeta.

- Ça ti thoshnjam unë? – u përgjigj me beratshen e tij të ekzagjeruar. – Merresh dot me të dehurin?

- Nuk.

- Kështu që i premtova: “Ç’ke ti! Do ta bëjmë bashkë sapo të kthehemi në Tiranë”. Unë e mbajta fjalën për vete. Kishnjam ça të bënjam unë?

- S’kishnje, - ia ktheva duke e imituar në dialekt.

- Dhe ajo është pema që mund të falenderoj për një mision të përfunduar, - tha Teo duke kaluar pranë pemës famëkeqe.

Gjetëm një strehë dhe ecëm midis stolave rrethorë dhe tavolinës në qendër. Teo u mbështet me të ndenjurat pas tavolinës dhe këmbët pak të hapura dhe më tërhoqi lehtë nga dora. Trupi im e ndoqi duke u ngjitur pas trupit të tij. Më shtrëngoi për mes me krahët e tij ndërsa buzët na u puthitën përsëri në muzgun e qetë të pyllit dhe aromën e mrekullueshme të bredhave rreth nesh. Mbështolla krahët e mi të gjatë rreth qafës së tij dhe e putha, ndërsa e gjithë qenia ime, përveç gojës, rënkonte: “Oh, sa të dua!”. Teo uli krahët e tij rreth vitheve të mia dhe filloi të më mblidhte fundin me gishta derisa arritën nën të. Kur i vajtën gishtat në anë të të mbathurave të mia, gjetën lidhëset e lidhura fjongo. Tërhoqi lidhësen në njërin anë dhe nuk i besohej që e zgjidhi.

- U hallaaall! – shpërtheu i lumtur dhe unë fillova të qesh duke prishur kështu puthjen e përkryer.

- Janë rrobat e banjës, - shpjegova.

Teo ndaloi së puthuri, më tërhoqi nga dora dhe ne zbritëm shpejt nga streha. Kaluam përtej shtegut të asfaltuar dhe vazhduam drejt një rrëpire të fshehur nga shtegu prej qeparisave përgjatë tij. Teo theu disa degë të vogla nga qeparisi aty pranë dhe i shtroi shesh në tokë. Filluam të putheshim përsëri edhe më me epsh duke u shtrirë mbi degët. I mbështetur mbi një bërryl, vazhdoi të zgjidhte lidhësen tjetër të kostumit tim të banjës me dorën tjetër dhe trupat tanë të dridhur u shkrinë në një. E nxori në kohë dhe e derdhi në tokë, ndërmjet kofshëve të mia. Të dyve na kishte mbetur edhe një vit tjetër shkollë dhe asnjëri prej nesh nuk ishte i interesuar në krijim bebesh.

- Desha të të thosha që do të shkoj në shtëpi të mësoj për provimin tjetër. E kam sezonin më të gjatë për këtë. Mund të jetë një kohë e gjatë derisa të shihemi përsëri, - thashë unë duke lidhur lidhëset e kostumit të banjës. U ngritëm dhe filluam të ktheheshim përmes mbrëmjes së bukur, të errët e të gjelbërt.

- Të kam thënë unë ty që kam një hallë në qytetin tënd? – më pyeti Teo i gudulisur nga ideja për të kaluar ndonjëherë nga shtëpia ime. – Nuk banon

dhe aq larg nga lagjja jote. Sa qejf do ishte të vija të të gjeja, po të mos shkoja në Greqi këtë verë, - vazhdoi Teo.

- Në asnjë mënyrë! Nuk mund të takohemi në qytetin tim! – ia prita e tmerruar nga ideja që mund të ma merrte vesh familja dhe e mahnitur nga guximi i tij në të njëjtën kohë. – Një bythë vend është. Do të dalë dikush që më njeh kudo që të fshihemi. Mirë që po shkon në Greqi këtë verë; merr me vete edhe idetë e tua të marra! – vazhdova.

- Po kjo e marra tjetër – po sikur të vish ti në Berat? Atje nuk të njeh askush nga ata që nuk e dinë tashmë, - propozoi Teo me sytë hapur tek një ide kaq e marrë, siç e pohoi edhe vetë. – Ti vetë the se ke disa ditë më tepër para provimit tjetër dhe unë ndjem i sigurt për timin. Po të të takoj para provimit, as që kam merak për notën time. Provimi tjetër na bie në të njëjtën ditë. Mund të vish një ditë para dhe pastaj udhëtojmë bashkë të nesërmen herët në mëngjes.

- Po sikur të të shikojnë njërëzia me mua në qytetin tënd? – pyeta në përpjekje të kotë për të ndryshuar planin.

- Nuk më bëhet vonë. Pastaj, nuk do jemi në publik dhe aq gjatë. Mos harro, kam gjithë shtëpinë në dispozicion. Të pres te stacioni i autobuzave nga ora njëmbëdhjetë deri në mesditë një ditë para provimit tjetër. Mirë?

- Mirë! Kam shumë qejf të shikoj shtëpinë dhe qytetin tënd. Nuk njoh njeri dhe askush nuk më njeh atje, kështu që nëse nuk të bëhet ty vonë që të shikojnë, nuk më bëhet vonë as mua! – thashë e ngazëllyer me zemrën që më kërcente brenda gjoksit dhe e putha në faqe para se të ndaheshim për një javë.

KAPITULLI V

NË BERAT

Për katër ditët e ardhshme, u përpoqa me sa munda të përqendrohesha tek mësimet për provimin e ardhshëm. Nuk ishte ndonjë lëndë veçanërisht e vështirë, por më duhej të isha gati në një ditë më pak seç kisha planifikuar fillimisht. Herët në mëngjesin e ditës para provimit, futa librin dhe shënimet në çantë dhe kapa një autobus të hershëm për në qytetin muze të Beratit. Kisha dëgjuar kaq shumë për Beratin me një qytetërim “më të vjetër se Krishti”, siç e përshkruante Timo shpesh. Edhe Diana, shoqja e ngushtë e fëmijërisë, më tregonte me orë të tëra për pushimet e mrekullueshme që kalonte me kushërinjtë e saj në verë.

Që kur fillova nga dashuria me Teon, më ngatërronte zemra ritmin sa herë më kalonte pranë një targë BR. Më ndrinte nuri sa herë dëgjoja emrin e atij qyteti. Tani ishte mundësia ime ta shikoja vendin nga afër me sytë e mi. Ndoshta do të kisha mundësi të shikoja Tomorin dhe Shpiragun e famshëm, dy malet vëllezër në secilën anë të lumit Osum, që luftuan dhe plagosën njëri-tjetrin për dashurinë e Kalasë.

U përpoqa të lexoj gjatë gjithë rrugës për atje, po ngecja duke lexuar të njëjtën faqe disa herë nga fillimi, e paaftë për t'u përqendruar për më tepër se dy-tre fjalitë e para. Pastaj më bridhte mendja ose te momentet e ëmblla të shkuara ose te gjërat që përfytyroja se do të bënim kur të mbërrija atje.

Autobusi hyri në qytet pak para orës njëmbëdhjetë, siç kishte parashikuar Teo. E pashë nga dritarja duke pritur në trotuar dhe ia bëra me dorë. Autobusi u ndal dhe unë zbrita ta takoja.

- Erdhe! – tha me buzëqeshje dhe gropëzën në faqe duke u përpjekur ta përmbante kënaqësinë që më shikonte përsëri edhe pse tashmë në një ambient të ndryshëm nga ku ishim takuar më parë, një ambient shumë më

fanatik dhe të ngjeshur, jo dhe aq të ndryshëm nga ai në të cilin isha rritur vetë dhe njihja mirë që nga fëmijëria. Ishte një ambient ku puna e dikujt ishin punët e gjithkujt. Duke ecur drejt shtëpisë së Teos, ndjeva shikimet ngulmuese të shumices së kalimtarëve, pavarësisht nëse Teo i njihte apo jo. E gjeta veten duke ecur një gjysmë hapi mbas tij si për t'u fshehur prej të gjithëve.

- Pse na shikojnë të gjithë? Mos bie në sy nga veshja? – pyeta Teon pothuajse duke mërmëritur nën zë.

Kisha veshur një këmishë të madhe burrash ngjyrë rozë me jakë, me mëngë të gjata të mbledhura nga një shirit i mbërthyer me pullë në mëngë, që mbulonte lirshëm getat e trikotuara, të zeza me kallamishte të çrregullta e shumëngjyrëshe.

- Më duket sikur të gjithë e dinë ku po shkojmë dhe çfarë do të bëjmë! – vazhdova.

- Nuk kanë me se merren tjetër. Mos e vrit mendjen. Do t'u dalim sysh së shpejti dhe ata do t'ia ngulin çiftit tjetër që do të kalojë, - u përpoq të më qetësonte Teo ndërsa po i afrohem shtëpisë së tij.

U futëm te hyrja e pallatit, ku dy fëmijë ishin ulur te shkallët dhe po na shikonin me kureshtje ndërsa iu ngjitëm shkallëve përmes këmbëve të tyre.

- Këta nuk kanë për të harruar. Po sikur t'u thonë prindërve të tu kur të kthehen? – pëshpërita.

- Do ta vras mendjen atëherë, - m'u përgjigj, duke më mahnitur me qetësinë e tij.

- Në ç'kat e ke shtëpinë?

- Në të pestin.

- Mirë pra, mbetsh meshëndet, - i thashë dhe ia shkela me vrap nëpër shkallë për në katin e pestë me sa më pak zhurmë.

- Ho, ho, gjete me kë të bësh garë! Unë jam rritur nëpër këto shkallë, - tha Teo duke qeshur dhe filloi të vraponte menjëherë mbas meje, ma kaloi në sheshin e katit dhe vazhdoi për të hapur derën. Unë vrapova brenda dhe, kur Teo mbylli derën pas vetes, u çlirova që nuk u ndeshëm me ndonjë fqinj tjetër.

Me siguri që isha krejt e skuqur mbas të nxehtit të qershorit të pasqyruar nga kalldrëmi, shikimet gjykuese rrugës dhe vrapit në ngjitje të pesë kateve.

- Më në fund, vetëm! – tha, siç u mbështet pas derës së mbyllur, më mori për dore dhe më tërhoqi pas vetes. Më mbështolli me krahë brinjët e fshehura poshtë këmishës së gjerë dhe më puthi në buzë me ngadalë. E putha dhe unë

dhe m'u duk po aq e ëmbël dhe e kripur sa herën e parë, të mbështetur pas asaj peme në parkun e errët.

- Mirëserdhe në shtëpinë time! – tha dhe më mbajti për dore, ndërsa më tërhoqi pas vetes. – Ja të ta tregoj! Ky po duket që është korridor, - tha Teo duke hapur dorën e tij të majtë për të treguar një korridor goxha të madh me pllaka të errëta bojë hiri. – Ajo dera në të majtë është banja, tjetra më lart është dhomë gjumi, që tani shërben si depo për frigoriferët e vjetër që im atë i sjell nga Greqia, i rregullon dhe i shet prapë. Më lart akoma është dhoma e gjumit të prindërve, dhoma e pritjes dhe e fundit në të djathtë është kuzhina me aneksin.

- Shumë mirë; dhe një nga modelet e rralla kaq të mëdha. Babi yt duhet të ketë pasur ca miq të fuqishëm. Megjithëse këtë e dimë tani që kur të çoi për mjekësi, - thashë dhe bëra shenjë për nga banja. – Të ngelet qejfi të përdor këtë derën këtu për një minutë? Jam me ato.

- U të lumtë, moj! – tha Teo i zhgënjyer. – Edhe erdhe gjithsesi!

- Erdha për të të parë me sy! – thashë gjithashtu e zhgënjyer që thjesht të më shikonte nuk mjaftonte edhe për të. Kisha shumë frikë të mendoja aty për aty se ç'nënkuptonte kjo dhe nxitova te banja për të shmangur ndonjë debat ose fshehur ndonjë lot të papritur. Qaja aq lehtësisht sa edhe qeshja. Kur dola, shkova te kuzhina e freskuar dhe duke u ndjerë më mirë. U ula në njërin nga divanet dhe vura re mbulesën e bardhë prej dantelle. Teo ishte në aneks duke nxjerrë një qese patatesh nga bufeja.

- Do të më ndihmosh për darkën?

- Patjetër! – iu përgjigja. – Do të qëroj patatet? Më jep një thikë.

Nuk më besohej që ishim vetëm së bashku dhe po bënim diçka të ndryshme nga të puthurit. Të lozurit me “*shpira*” po më krijonte ndjesi paqeje.

- Po, por do ta bësh me këtë, - tha duke më treguar një qëruese patatesh.

- Çfarë është kjo? – e pyeta duke parë veglën dhe vështrova Teon duke përdorur një tjetër si ajo.

- Është qëruese për patate, mollë, karrota, sallatorë, çdo gjë që ka nevojë të qërohet.

- Për së mbari! Nga Greqia është?

- Po. Sa herë vjen babi, na sjell gjëra të tilla.

- Vegla kuzhine, ujë të rrjedhshëm... duket se babi yt bën shumë për të ndihmuar mamin. E dashka shumë! - thashë duke qëruar patatet.

- Posi jo! – u përgjigj Teo.

- E ke vënë re? – e pyeta.

- Po, sigurisht.

- Me dashuri apo me mblesëri janë martuar? – e pyeta.

- Janë njohur në shkollë të mesme teknike dhe janë dashuruar atje. Po të tutë? – pyeti Teo.

- Prindërit e tu janë shumë më të rinj në moshë se sa të mitë. Kur ishin të rinj prindërit e mi, nuk kishte as shkollë përtej tetëvjeçares as të rënë në dashuri për vajzat. Por ishte hekurudha dhe gjyshi kishte frikë mos e detyronin komunistët ta çonte të bijën vullnetare që katërmbëdhjetë vjeçe. Kështu që sapo gjyshi (nga babi) dërgoi lajmësin për të kërkuar dorën e mamit për babin, babai i mamit i tha “Në vend!” pa pikë hezitimi. Im atë, nga ana tjetër, ishte ushtar në atë kohë dhe as që e kishte idenë që po e fejonin. Kur erdhi në shtëpi për disa ditë leje, në moshën njëzetë e një vjeç, i thanë për fejesën, i bënë një dasëm të mirë dhe e sollën time më në shtëpi. Pastaj u kthye të mbaronte shërbimin ushtarak dhe e la në shtëpi me të atin, njerken dhe tetë fëmijët e tjerë.

- Ohooo! Hajde surprizë, hajde! U bënë ndonjëherë pishman? – pyeti Teo.

- Im atë u inatos në fillim që, praktikisht, e martuan pa dijeninë apo miratimin e tij, por i pëlqente mami, kështu që u nënshtua. Mami, nga ana tjetër, ndjehej me fat që, të paktën, e kishte njohur që në fëmijëri burrin me të cilin do të kalonte gjithë jetën. Tezja e mamit ishte e martuar me xhaxhanë e babin. Nganjëherë, kur ishte e vogël dhe shkonte te tezja për vizitë, mami lozte me babin. Më ka thënë që i vinte keq për të, se vinte paksa i zbehtë dhe po rritej nga njerka, që kishte tetë gojë të tjera për të ushqyer. Xhaxhai i tij ishte gjyshi i Mondit. E mban mend që ta përmenda një herë më parë?

- Po, po, e mbaj mend, - tha Teo dhe vazhdoi, - I keq ishte komunizmi, por, të paktën, ca gjëra i ndryshoi për më mirë. Megjithëse im atë më ka këshilluar të mos martohem me dikë që dua, sepse e konsideron barrë.

- Si do të ishte më pak barrë po të mos jesh i dashuruar me gruan tënde? Në mos e lënç fare, duhet të kujdesesh për të pavarësisht nëse e do apo jo. Është detyrim moral, apo jo? – e kundërshtova.

- Po, por më duket se e ka fjalën për barrë shpirtërore më tepër se sa financiare, - ma ktheu Teo. – Të ngelet qejfi të shkoj në dyqan shpejt e shpejt? Po i mbarove së qëruari patatet para se të kthehem, prijti të holla si për të skuqur. Kthehem shpejt, - tha Teo dhe u përkul të më puthte në faqe.

- S’ka problem! Shko! – iu përgjigja buzagaz dhe vazhdova të qëroja dhe të prisja të gjitha patatet që kishte racionuar për të gatuar e pastaj i lava në

një tenxhere me ujë. Teo u kthye pas disa minutash dhe solli disa shishe birra dhe një pulë. E vëzhgova me admirim teksa kriposte me lehtësi pulën dhe patatet që pastaj i vendosi në një tavë alumini. Pastaj hodhi copa gjalpi mbi patatet nëpër tavë dhe e futi në furrë.

- Mjeshtë fare! – buzëqesha. – Sa i shpejtë që je! Me sa duket t’u desh të mësoje me shpejtësi, kur të lanë vetëm!

- Pata ndihmëse të mirë sot. Është tavë e thjeshtë. Unë po them shqyr që kemi drita. Duhet të bëhet për një orë e gjysmë. Nuk kam mbaruar së lexuari gjithçka që më duhet për provimin nesër, - shtoi.

- As unë! – iu përgjigja.

- Kështu që po mendoja të lexojmë pak derisa të piqet pula, pastaj hamë.

- Mirë, pastaj hamë! – e ndërpreva duke qeshur.

- E, mirë. Tallu ti tani! – tha edhe ai duke qeshur. – Ti mëso te dhoma e gjumit, unë te kuzhina.

- Mirë! – pranova dhe shkova për te dhoma e gjumit me shënimet e mia. U ula në krevatin e prindërve të tij dhe u përpoqa të lexoja për provimin, por nuk më besohej dot akoma që isha në shtëpinë e tij. Kaluan disa minuta dhe Teo hyri në dhomë duke mbajtur diçka në dorën e majtë.

- Sa shpejt lexoke ti! – i buzëqesha duke menduar që edhe ai po haste të njëjtin problem me përqendrimin në libra.

- Desha të të tregoja këto, - tha dhe vuri në krevat pranë meje disa fotografi të vjetra bardhë e zi të tizat nga kur ishte bebe.

- Ooh, sa bebe e bukur paske qenë! Ooh, sa të bukura, sa i lezetshëm! Sa beb bullafiq! – thashë me gëzim.

- Edhe mami im ka ca fotografi të miat kur isha bebe, çuditërisht, duke qenë që jam e fundit në familje. Ti ishe edhe i pari edhe mashkull. Ata gjithmonë marrin më të mirat.

- Po, por ti ishe e vetmja gocë dhe e vogla e familjes, - kundërshtoi Teo.

- Kjo ndoshta shpjegon pse ekzistojnë dhe ato pak fotografi që kam, po nuk jam vetëm në asnjërën prej tyre. Në njëërën jam me tim vëlla, të dytin, dhe në tjetrën jam ulur midis mamit dhe vëllait të saj të vogël.

Teo dëgjoi një fishkëllimë nga jashtë dhe doli në ballkonin e kuzhinës. E ndoqa deri tek kuzhina dhe e dëgjova të fliste me dikë poshtë ballkonit.

- Është Tani me nja dy shokë. E di që je këtu dhe po më ngacmon, - tha Teo. Unë refuzova të nxirrja kokën jashtë dhe të shihesha nga kush e di se kush. – Do që të dalim poshtë për një xhiro nëpër qytet me ta. Do të dalim?

- Dhe të na shikojnë komshinjtë e tu? Në asnjë mënyrë! Kush u tha që jam

këtu? –pyeta unë ende duke u fshehur mbrapa derës së ballkonit dhe duke dëgjuar çdo gjë që thoshin. – Po provimet? Pastaj, kemi pulën në furrë.

- Seriozisht e ke ti? E gjithë bota e di që je këtu. Doli dhe në lajme! – ngacmoi Teo dhe u kthye nga shokët e vet poshtë. – Kemi pulën në furrë.

- Obobo! Kaq shpejt të shtroi? Të bëri për shtëpi! Keni gjithë ditën mbyllur brenda si ndonjë çift pleqsh! – dëgjova zërin e Tanit nga poshtë ballkonit dhe mbajta të qeshurën.

- Shshshsh! “Boll bërtite” - thuaji! Do ta dëgjojnë fqinjët dhe do t’u thonë të tuve kur të kthehen, - i pëshpërita Teos akoma e tmerruar nga brenda kuzhinës.

- Vazhdoni juve. Dilni edhe për ne. Ne po rrimë këtë radhë, - u tha Teo shokëve të tij poshtë dhe u fut brenda.

- Koha për studim tani! Uuu, iku ora! – thashë dhe u futa në dhomën e gjumit, tashmë e shqetësuar për provimin e së nesërme.

- Sa të shikoj pulën dhe do të vete të mësoj ca edhe unë para se të hamë, - tha Teo dhe iu drejtua furrës.

Të dy lexuam pa ndërprerje për njëfarë kohe në dy dhoma të ndryshme, pastaj dëgjova derën e furrës të hapej e mbyllej në kuzhinë. “Do të jetë bërë pula”, - mendova. E mbylla fletoren e shënimeve dhe e hodha mënjanë mbi krevat. Shkova te kuzhina dhe fillova ta ndihmoja me dëshirë në shtrimin e tavolinës. Teo mbushi gotat me birrë dhe ne u ulëm për të ngrënë së bashku për herë të dytë, veçse këtë radhë në shtëpinë e tij. Teo ngriti gotën dhe tha “Gëzuar!”, së cilës iu përgjigja në të njëjtën mënyrë.

- Duken shumë të shijshme të gjitha. Akoma nuk më besohet që mund të gatuash një darkë të tërë vetë! – thashë sinqerisht e impresionuar nga talenti dhe përpjekja e Teos.

- M’u desh të mësoja shpejt. Kishnjam ç’a të bënjam unë? – u përgjigj Teo.

- Shumica e burrave nuk bëjnë nga këto gjëra andej nga anët tona. Përveç tim eti mbasi doli në pension. Mami punonte akoma me turne, kështu që i duhej babit të bënte darkë disa prej javëve. Një herë vendosi të na bënte fasule me tenxheren e re me presion që sa kishte blerë. Të gjithë po thoshin sa të mrekullueshme dhe të shpejta ishin për të zier fasulet. Ishte e llojit me kapakun që futej brenda dhe nën hapjen eliptike. Kur bie presioni, kapaku bie brenda dhe pastaj mund ta rrotullosh me nëntëdhjetë gradë për ta nxjerrë, - shpjegova unë.

- E di. Ashtu e kemi dhe ne këtu, - tha Teo.

- Atëherë ti e di që të gjitha udhëzimet ishin në gjermanisht dhe anglisht dhe asnjëri prej nesh as nuk fliste e as nuk kuptonte ndonjërin prej gjuhëve. I zieu për nja gjysmë ore, siç i kishin thënë, e hoqi tenxheren nga zjarri dhe e vuri në çimenton e korridorit. Unë po i rrija mbrapa dhe po shikoja siç përpiqej të hapte kapakun. U përpoq më kot ta kthente majtas, pastaj djathtas, por kapaku nuk jepej për qamet as andej as këtej. E dija që po i soste durimi me shpejtësi. Im atë kishte qenë në ushtri për tridhjetë vjet. Kur më thërriste, o i veja brenda sekondash, o e merrte vesh gjithë lagjja që po më thërriste dhe nuk po i përgjigjesha. Kështu që tashmë i ishin ngritur nervat duke mallkuar dhe i bërtitur tenxheres. Si përfundim, i ra kapakut me grusht dhe një shatërvan me fasule shpërtheu deri në tavan. Shyqyr që asnjëri prej nesh nuk u vra dhe kapaku u hap, - thashë duke mbajtur të qeshurën deri në fund të tregimit për t'u bashkuar me Teon, që e parashikoi gjithë kohës përfundimin dhe po qeshte me zë.

Hëngrëm dhe pimë një darkë të qetë e të këndshme së bashku, pastruam tavolinën dhe enët dhe vumë gjithçka nëpër vende në bufe. Kur Teo solli dy komplete çarçafësh dhe i vuri mbi secilin divan në kuzhinë, unë e mora vesh që nuk kishim për të fjetur bashkë në krevatin dopjo të prindërve të tij, siç kisha supozuar gjithë mbasditen. Edhe pse paksa e zhgënjyer, më bëri përshtypje vendosmëria e tij për të nderuar caqet e prindërve.

- Kush i ka punuar këto mbulesat e divanëve me bizë? – e pyeta duke hequr dhe palosur mbulesat e bardha nga shtroja dhe koka e divanit.

- Mami, - tha Teo, ndërsa paloste mbulesën e divanit tjetër.

- Uaa, gjithë ajo punë! Mami jot di bizë?! – thashë me një respekt të ri për nënën e tij.

- Po, është korçare. E di ti, ato kanë traditë të lashtë në punë dore! – shtoi Teo pa e kuptuar sa krenar ishte për nënën e vet.

- Unë di të punoj me shtiza, por nuk më ka rënë rasti të mësoj bizën. Ndoshta ndonjë ditë, - thashë pothuajse inferiore dhe e mangët në krahasim me nënën e tij, por u kujtova menjëherë. – Edhe mami im na bën gjithë bluzat e dimrit me shtiza. Ajo më ka mësuar! – shtova po aq krenare për nënën time të palodhur e duarartë.

Tërhoqa divanin nga muri për të nxjerrë pjesën e futur nën të, ndërsa Teo bëri të njëjtën gjë me tjetrin.

- Na duhet të ngrihemi shumë herët në mëngjes që të kapim provimin në kohë! – tha ai duke fikur dritat dhe u shtri në njërin prej divanëve. U shtriva dhe unë në divanin tjetër dhe u përpoqa të flija.

- Të zuri gjumi? – e pyeta pas pak.

- Jo, akoma, - u përgjigj Teo.

- As mua. Të vij një çikë te krevati yt? – e pyeta përsëri.

- Mirë, po vetëm një çikë! Këta divanët janë shumë të ngushtë për dy veta dhe ne na duhet të flemë mirë para provimit! – tha Teo i matur e i përgjegjshëm.

U ngrita gjithë gëzim, u futa në krevatin e tij dhe iu ngjita ngadalë pas trupit. Futa krahun tim të djathtë poshtë zverkut të tij dhe shtriva të majtin mbi të për një përqaqim të gjatë, të cilin kisha pritur ta bëja gjithë ditën. Teo më mbështolli për beli me krahët e tij, më shtrëngoi fort ndaj vetes dhe soditëm në sytë e njëri-tjetrit për disa çaste. Pastaj u afrua dhe më puthi me buzët e ëmbla. Të dy e dinim që ishte vetëm çështje sekondash para se të rrokullisej mbi mua dhe të bënim dashuri të zjarrtë.

U ngrita dhe shkova në banjë për të shpëlarë vazhdat e gjakut ndërmjet kofshëve. Teo erdhi pas meje dhe më hapi dushin. E bëmë me radhë duke u larë e duke u dridhur e duke u puthur nën ujin e ftohtë. Teo mbylli dushin dhe gjeti një peshqir të madh e të thatë, por uji i ftohtë nuk bëri asgjë për të shuar pasionin. U ndamë vetëm sa për t'u mbështjellë në secilën anë të peshqirit të thatë. U vara në qafën e tij me një krah dhe vendosa këmbët e mia mbi të tijat, ndërsa mbaja cepin e peshqirit me dorën tjetër. Teo mbajti cepin tjetër të peshqirit me një dorë, mbështolli krahun tjetër mbas mesit tim dhe filloi të ecte në errësirë drejt kuzhinës, paksa i përkulur dhe duke më puthur pa ndërprerje. Harruam fare tavolinën në mes të dhomës dhe u gjendëm të ngjeshur kundrejt saj. Teo hoqi peshqirin prej rreth nesh dhe e hapi mbi tavolinë. Më ngriti peshë prej vitheve dhe më uli në buzë të tavolinës, mbështolli kofshët e mia rreth vitheve të tij dhe filloi përsëri nga e para.

- Ne që do të zgjoheshim herët! – pëshpëriti Teo buzagaz në dhomën e errët siç më ndihmoi të zbrisja nga tavolina. I vezullonin sytë nga drita e zbehtë që vinte nga jashtë përmes perdeve të bardha të tejdukshme. Vesha të mbathurat dhe një pecetë të re në banjo dhe u ktheva përsëri për t'u ledhatuar mbas tij në divan.

- Jo, jo, jo! Unë, ti dhe gjumi përzihen aq sa përzihet uji me vajin. Do na lësh pa gjumë gjithë natën po s'u fute në krevatin tënd tani! – tha i vendosur.

- Do sillem mirë! – premtova më kot duke e ditur që nuk varej vetëm prej meje.

- Ee, po nuk sillem unë me ty aq afër meje. Më duket se e provuam këtë me orë të tëra! – këmbënguli ai.

U shtriva në divanin tim kokë më kokë me të, shtriva krahun për t'i

përkëdhelur flokët dhe i thashë: “Natën e mirë, atëherë!”. Teo takoi dorën time me të tijën, ndërthuri gishtat e tij me të mijtë dhe ra në gjumë mbas një natë të lodhshme.

Të nesërmen herët në mëngjes, Teo më trokiti lehtë në sup për të më zgjuar. Palosëm çarçafët dhe jastëkët mënjane, u hodhëm ujë syve dhe u larguam nga apartamenti ende të lodhur e të përgjumur. Kapëm autobusin me disa njerëz në të dhe u ulëm pranë njëri-tjetrit. Mbështeta kokën mbi supin e tij dhe fjeta për më të shumtën e rrugës. Kur arritëm në kryeqytet, u puthëm në faqe dhe i uruam njëri-tjetrit mbarësi për provimin.

- Do rrish këtu të studiosh për provimin tjetër? – pyeti Teo para se të shkonte për në provim.

- Po. Nuk më del koha ta harxhoj me udhëtim.

- Mirë atëherë, po vij të të takoj mbas provimit tjetër! – premtoi Teo.

Eca më këmbë për një gjysmë ore tjetër për te shkolla ime përmes bulevardit kryesor dhe mendova gjerë e gjatë për udhëtimin tim në Berat. Shpresoja që zbrazëtia që po ndjeja më vinte nga pagjumësia. Për herë të parë, nuk mund të shkundja boshllëkun dhe pasigurinë që kisha për thellësinë e ndjenjave të Teos ndaj meje.

Kaluan disa ditë dhe Teo e mbajti fjalën. Më thirri nga poshtë dritares nën pemën e ullirit dhe unë vrapova poshtë sa më shpejt që të mundja. Ecëm drejt pyllit tonë të dashur matanë rrugës, përballë qytetit Studenti, ku gjetëm një bregore për t’u ulur mbi barin e freskët nën pemë.

- Harrova të të pyes; si dole në dy provimet e fundit? – e pyeta.

- Të dyja dhjeta! – m’u përgjigj duke u ngërdheshur sikur të ndjeje ngushtë.

- Të lumtë mendja e fuqishme! – e urova dhe ula kokën me frikë se mos më bënte të njëjtën pyetje.

- Po ti? – më pyeti ai.

- E mora. Më duket se ti më thith gjithë mbarësinë.

- Më fal! – ma priti ai duke qeshur dhe u afrua për një puthje. – Dale mbase ta kthej mbrapsht!

- Mmm! U bë! – thashë unë. – Vetëm kaq më duhej!

- O, po prit, se ka më andej nga doli kjo! – tha Teo dhe më mbuloi me të puthura dhe gudulisje derisa u shtriva në tokë ndërsa ai u mbështet me bërriyl përbri meje. Teo ndaloi papritur dhe ktheu kokën mbrapa me vrull.

- Çfarë është? – e pyeta e trembur nga reagimi i tij.

- M’u duk se dëgjova diçka! – pëshpëriti dhe u ngrit ndenjmur për një çast.

U ngrit me shpejtësi dhe vrapoi tatëpjetë faqes së bregores me një hakërrimë. Pastaj pashë një burrë tjetër vetëm disa hapa hapa më tej, që u ngrit e vrapoi sapo pa se po e ndiqte Teo.

- O Zot! Ishte tmerrësisht afër. Çfarë po bënte? – pyeta akoma e pezmatuar nga frika.

- Po përgjonte dhe ndoshta priste ta bënim. Mos ki frikë! Këta lloj të sëmurësh janë pa zarar, veçse po aq të bezdisshëm! – tha Teo.

- E di. Vijnë gjithmonë te dritaret e katit të parë te konviktet e gocave. Të pështirë gjithsesi. Unë e Ina përdornim kapëse rrobash për të kapur dy perdet së bashku natën, - thashë e qetësuar dhe me mbresa nga trimëria e të dashurit tim.

- Sa trim që je! Si nuk ke frikë?

- Frika është pengesë. Nuk të hyn në punë për asgjë, - tha Teo.

- Dakord jam unë, po nuk e ndaloj dot. Po sikur të kthehet? – pyeta kur Teo filloi të më puthte në gushë dhe të më ledhatonte gjinjtë.

- Ohu, vë bast që ka shkuar të bezdisë ndonjë çift tjetër që nuk e ka idenë, - tha Teo dhe vazhdoi me puthjet e tij. I hodha krahët rreth qafës duke i përkëdhelur flokët mbrapa kokës dhe gjithë frika m'u zhduk.

- Nuk jam i sigurt që u tërhoqa në kohë, - tha Teo më pas. – Do të doja ta dija nëse nuk të vijnë ato para se të takohemi. Nuk ka nevojë të bësh gjë po të erdhën, por më dërgo një lajmthirrje nëse nuk të vijnë, - tha ai siç filluam të ecnim drejt konviktit tim.

- Po sikur të jetë në shtëpi yt atë për një nga ato vajtje-ardhjet dhe i bie lajmthirrja në dorë? Mbase është më mirë t'ia dërgoj thirrjen Timos dhe ai ta sjellë ty, - sugjerova duke u përpjekur të fshihja një shqetësim shumë më të madh tani.

- Mirë! – pranoi Teo.

I uruam njëri-tjetrit “natën e mirë” tek vendi i zakonshëm i ndarjes sonë pranë konviktit tim dhe Teo u kthye për tek konvikti i tij në anën tjetër të qytetit.

Unë u çlirova nga kthimi në kohë i menstruacioneve disa ditë më vonë, por m'u duk e mrekullueshme ideja për t'i dëgjuar zërin në telefon, gjithsesi. Shkova te posta dhe i dërgova Timos një lajmthirrje për të nesërmen, siç e kisha diskutuar me Teon për ta bërë në rast të kundërt.

- E luajte mendsh. Nuk ka fjetur gjithë natën para thirrjes, - më tha Timo në provimin pasardhës.

- E marr me mend, - iu përgjigja duke qeshur. – Po ma fali. Desha sa t'i dëgjoja një çikë zërin e ëmbël, - vazhdova buzagaz.

KAPITULLI VI

NË GREQI

Më në fund, sezoni i provimeve mbaroi. Isha e kënaqur që kalova në të gjitha dhe u hodha në vitin e fundit të studimeve. Madje mora edhe nota të mira në dy lëndët që dhashë provim me profesor Bertin, i cili e mbajti fjalën se nuk do të më ngacmonte më pas darkës me të, ku hëngra si e babëzitur. Nga ana tjetër, fundi i shkollës do të thoshte që nuk do ta shihja të dashurin tim për dy muaj të tërë. E dija se çfarë duhej të bëja që të më kalonte koha më shpejt, do të udhëtoja. Gjithmonë i kisha kaluar pushimet verore me kushërinjtë nëpër qytete e fshatra të ndryshme. Fillova duke shkuar në shtëpinë e Vilmës për një javë. Pastaj udhëtuam të dyja me autobus për në shtëpinë time për të kaluar një javë tjetër së bashku.

Ditën e dytë pas kthimit nga qyteti i Vilmës në Jug, unë e Vilma kishim dalë për xhiron e mbrëmjes në bulevardin kryesor të qytetit tim. Rrugët ishin mbushur me të rinj të kthyer nga shkolla, të veshur me rrobat më të mira, duke shëtitur dhe “gjujt” gjimnazistet. Kjo ishte, sipas traditës, një paradë mode e përnatshme dymujore për të dyja gjinitë. Gjyshet dhe gjyshërit të ulur nëpër ballkonet e pallateve katër a pesëkatëshe në të dyja anët e bulevardit, pinin kafënë e mbasdites duke soditur “paradën e modës”.

- E dije ti që halla e Nedit banon këtu në Fier? – pyeti Vilma.

- Jo, nuk e dija. E çë pastaj? – pyeta unë, kureshtare nëse Vilma po përpiquej të më thoshte diçka.

- Ja që po i vjen për pushime. E kemi lënë për t’u takuar sonte. Hap sytë kur të llafosemi! – u përgjigj Vilma dhe buzëqeshi me fytyrën time të çuditur.

- Hallaaall!!! – bërtita e elektrizuar nga dashuria e re e shoqes sime. – Ju pashë që uleshit bashkë duke çuquritur si dy zogj në atë bankën e parë, po nuk desha të fantazoja apo të fusja turinjtë. Mrekulli! – vazhdova sinqerisht

shumë e lumtur që shoqja ime e kishte kaluar mahnitjen e saj platonike me Bertin. Nedi ishte një djalë i mrekullueshëm, që shoqëronte çdo histori që tregonte me lloj-lloj efektshëm qesharake. E respektova aq më tepër për skadimin e Bertit nga zemra e brishtë e Vilmës.

- Ja ku është! – tha Vilma duke e përmbajtur emocionin e saj si zonjushë e vërtetë.

- E shoh! Zor të të shpëtojë me hapat që hedh anash dhe flokët përpjetë si gjemba iriçi!

- Mirëmbërëma, moj çupka! – na përshëndeti Nedi.

- Ç'bën në qytetin tim ti, ore? – e ngacmova ndërsa filluam xhiron së bashku lart e poshtë bulevardit.

- Kam ardhur te halla, moj! – tha Nedi me të qeshur.

- Uaa! Nga na dolën gjithë këta njerëz me halla papritur? – thashë duke dëshiruar që njëri prej tyre në veçanti t'i vinte për vizitë hallës së vet.

Ecëm të tre bashkë deri në mbrëmje vonë, pastaj Nedi na përcolli për në shtëpi dhe e lamë të takoheshim të nesërmen.

Kur unë e Vilma u kthyem në shtëpi, më njoftoi mami për një telefonatë nga vëllai im në Greqi, te i vetmi fqinj që njihnim me telefon në shtëpi.

- Yt vëlla do të të presë në kufi nesër! – tha mami me ndjenja të trazuara. Ishte disi e gëzuar për udhëtimin tim të papritur jashtë vendit, por edhe e shqetësuar në rast se im vëlla nuk mund të dilte për të më pritur.

- Si do ta kaloj kufirin pa vizë?! – pyeta duke u përpjekur të fshihja ngazëllimin nga ime më. *O Zot! Unë në Greqi; atje ku do të jetë Teo dhe, ku i dihet, edhe mbase shihemi këtë verë!*

- Është duke ardhur me një komshi i cili njej një oficer te pika e kufirit që mund të të japë leje kalimi për vizë turistike, - u përgjigj mami. – Fillo të bëhesh gati. Autobusi nisat shumë herët në mëngjes, - vazhdoi.

- Prit, po Vilma? – u kujtova papritur. – Kjo do të thotë që pushimet e Vilmës do të ngelen përgjysmë.

- Mos u shqetëso për mua. S'ka gjë. Jam e lumtur për ty! – u përgjigj Vilma.

- Më vjen shumë keq të ta ndërpres vizitën kaq shkurt! Ne nuk kemi marrë veten akoma nga rruga e gjatë për këtu. Të paktën është rrugës së kthimit tënd dhe mund të udhëtojmë bashkë prapë, - thashë pastaj u kujtova, - Obobo! Po Nedi që po të pret nesër mbrëma? – pëshpërita duke i kthyer kurrizin sime mëje.

- Do më kërkojë sa do më kërkojë pastaj do dorëzohet! – u përgjigj Vilma.

Herët në mëngjesin e asaj të diele, unë Vilma dhe ime më u nisëm për

udhëtimin njëqindcakilometërsh drejt qytetit të Vilmës dhe tetëmbëdhjetë të tjera drejt kufirit me Greqinë.

- Po të na vejë mbarë, duhet të arrijmë në kufi brenda orës dhjetë, - tha mami. – Mua zakonisht më vete rruga mbarë, - shtoi ajo.

- Është e vërtetë, - pohova unë. – Para autobusëve privatë, po të dilte im atë për ndonjë makinë të rastit në kthim nga fshati, do t'i duhej të rrinte me orë të tëra te çezma në anë të rrugës. Sapo dilte ime më, e kapte brenda minutash.

Pa kaluar ende as një të tretën e udhëtimit përmes rrugëve të ngushta malore të Shqipërisë së jugut, dëgjuam një shpërthim buçues jashtë dritares së autobusit.

- Hajde! Të gjithë zbrisni nga autobusi! – thirri shoferi pasi ndaloi në anë të rrugës. – Na plasi njëra nga gomat dhe duhet ta ndërrojmë! – vazhdoi ai.

- Mos! – psherëtinë shumica, ndërsa filluan të zbrisnin.

Nuk kisha se si ta njoftoja tim vëlla për vonesën. Kisha vetëm numrin e telefonit të shtëpisë së fqinjët që më kishte rregulluar vizën nëpërmjet miqve të tij, por edhe ai duhej të ishte rrugës tani. Kishin edhe ata rreth katër orë për të udhëtuar për te kufiri verior.

Nja gjysmë ore më vonë, u vu goma e re dhe të gjithë mezi po prisnin të dilnin nga dielli tashmë përvëlues i korrikut dhe të hipnin prapë në autobus. Sapo autobusi filloi në rrugë përsëri, dëgjova një shpërthim tjetër. Nuk kisha më dyshim që kjo ishte një shenjë e keqe. Goma kishte plasur prapë dhe kjo do të thoshte një vonesë shumë më e gjatë, pritje më e gjatë nën diellin e nxehtë dhe pritje më e gjatë për tim vëlla në anën tjetër të kufirit, pa ndonjë mënyrë për të ditur nëse po vija. S'kishim ç'të bënim tani veçse të prisnim të kalonte ndonjë autobus tjetër pranë dhe të na huazonte gomën rezervë. Pas nja dy orësh të tjera pritjeje anës rrugës, goma u rregullua për herë të dytë dhe ne vazhduam mbetjen e rrugës pa ndonjë ngjarje tjetër interesante.

Disa orë më vonë, u shfaq në faqen përtej rrugës qyteti i gurtë i Vilmës. Qindra kulla me çati të gurta, ballkone të drunjta dhe mure guri të bardha njëra mbi tjetrën në kodrat përgjatë luginës së Drinos.

E përqafova Vilmën me një “Mirupafshim!”, siç zbriti nga autobusi dhe vazhdova udhëtimin drejt kufirit me nënën time. Kur arritëm në kufi, kërkua përmes portës, por im vëlla nuk dukej asgjëkund. Nuk prisja të ishte atje katër orë pas takimit tonë. I dhashë numrin e telefonit një të riu që kishte vizë për të kaluar kufirin. Ai premtoi që do ta merrte në telefon fqinjin e tim vëllai sapo të mbërrinte në një telefon kinkalerie në qytetin më të afërt dhe do t'i thoshte që po e prisja te porta.

Dy orë të tjera kaluan pranë portës greke të ngjeshur me njerëz, kur dëgjova emrin tim të thirrej nga ana tjetër. Nuk m'u besohej veshëve, por rojet greke po më thërrisnin të kaloja përmes, ndërsa hapën portën për mua. Nxitova përmes portës dhe bëra disa hapa para se të ftillohesha që ime më nuk mund të vinte me mua për këtë pjesë të udhëtimit. Ktheva kokën për t'ia bërë me dorë, me ndjenja të trazuara frike që isha vetëm në dhé të huaj e që po ndahesha nga nëna kaq papritur, pa të puthurat dhe përqafimet e zakonshme.

Kisha kaluar në një tokë të huaj për herë të parë dhe e gjitha ndodhi me një shpejtësi kaq marramendëse. Mbi një vit e ca më parë, tim vëllai i ishte dashur të ecte me javë mes maleve të ftohta me dëborë për kalimin e tij të parë, ashtu siç kishin bërë mijëra të rinj, që u arratisën nja dy muaj pas shembjes së komunizmit. Ai la mbrapa gruan dhe birin e vet të porsalindur duke banuar me prindërit e mi, derisa të krijonte një shtëpi të re për ta në Greqi. Tashmë, ishte stabilizuar me familjen e tij dhe, me sa dukej, kishte krijuar miq të mirë mes fqinjëve. Im vëlla ishte shumë i zoti dhe punëtor. Vëllai i madh i kishte vajtur po atë vit dhe tani do t'u bashkohesha edhe unë.

Pasi më dha një dokument udhëtimi të përkohshëm, njëri nga oficerët e kufirit grek më çoi te autobusi dhe udhëzoi shoferin të më zbriste në qytetin e tim vëllai. Pastaj mori në telefon fqinjin e vëllait për ta njoftuar për orën e përafërt të mbërritjes sime.

Rreth gjashtë orë pasi lamë kufirin, autobusi ndaloi në anë të rrugës në qytetin e ri të Lonit, Agrinio. Ndërsa fillova të ecja drejt daljes së pasme të autobusit, vura re tim vëlla duke pritur në anë të rrugës dhe mora frymë lirisht. U gëzova shumë që pashë vëllaçkon. Kishim më se një vit pa u parë.

- Shyqyr që erdhe më në fund! Na bëre merak! – tha Loni ndërsa mori përqafë motrën e vogël. – Ne pritëm te kufiri gjithë paraditen, pastaj menduam se ndoshta nuk të kishin lajmëruar që do të të prisnim. Ç'u bëre? – pyeti ai.

- E mora vesh mbrëmë vonë dhe u nisëm sot që në mëngjes. Po autobusit nuk i plasi një gomë, po dy. Mos e pyet çfarë dite ishte. Pse më thirre të vija? – pyeta unë ende e çuditur nga e gjithë ideja e ardhjes sime në Greqi. Deri atëherë, nuk më kishte ndodhur të mendoja që vëllezërve të mi u bëhej vonë për mua. *E paska një të mirë mërgimi!* Po filloja të ndërroja mendim për Greqinë.

Isha nëntë dhe njëmbëdhjetë vjet më e vogël nga vëllezërit. Shpesh mendoja mos kisha lindur pa dashje. Mami kishte ndenjtur në shtëpi të rriste djemtë, por ishte kthyer në punë tek rafineria e naftës në qytet para se të binte shtatëzënë me mua. Kjo do të thoshte futjen time në çerdhe, ndërsa ajo

punonte me tre turne javore.

Xhimi, i madhi, iku nga shtëpia që në moshën katërmbëdhjetë vjeçare për të ndjekur shkollën e muzikës në qytetin bregdetar të Durrësit, rreth shtatëdhjetë kilometra në veri të Fierit, vendlindjes sonë. Instrumenti i tij parësor ishte flauti, po mësoi t'i binte edhe pikolos.

Mbaja mend shumë pak ndërveprime me të nga fëmijëria e hershme. Çdo herë që më kujtonte se si më kishte larë purthën nga mbulesat e krevatit të mamasë, unë i kujtoja se si më mashtronte t'i hidhja sytë gjetkë për të më marrë veshnikun e rrushit nga pjata.

Loni, nga ana tjetër, ishte më i lidhur pas shtëpisë; ndoshta ngaqë kishte lindur në shtëpi. Filloi të punonte që mbas tetë-vjeçares dhe babi e regjistroi në një shkollë mekanikë nate. Kisha shumë më tepër kujtime me të voglin. Si ndeshjet e ping-pongut në tavolinën e zgjatshme me kanata. Luanim derisa vinte babi në shtëpi dhe na bërtiste për gozhdët që kishte ngulur im vëlla në anët e tavolinës për të mbajtur rrjetën në mes.

Pasi doli në pension si financier ushtarak, babi vazhdoi të punonte mbrëmjeve për kompensim rroge. Një herë, më lanë vëllezërit në kopsht pas orarit të mbylljes dhe një nga pastrueset, një grua memece, më solli në shtëpi, ku gjetëm një kyç të madh në derën e jashtme.

Televizori ishte çudi e re dhe vëllezërve të mi, si të rinj që ishin, natyrisht u vinte më për mbarë të shikonin televizor bardhë e zi te komshinjtë, sesa të bezdiseshin me kujdesin e motrës së tyre të vogël. Mbaja mend edhe se si Loni më vinte në gjumë herët, mbyllte derën e dhomës së gjumit ngadalë duke përgjuar nga mbrapa derës në mbyllje dhe më linte në shtëpi vetëm, për të shkuar e parë televizor gjëkund në lagje. Vetëm pak fqinjë i kishin fillimisht. Edhe pse kushtonte sa gjashtë muaj rrogë e një intelektual, duhej të prisje një periudhë të gjatë për të përfutur një televizor. Qeveria ua shpërndante televizorët ndërmarrjeve, në vend që t'i shiste nëpër dyqane. Pastaj shefi i kuadrit bënte mbledhjen e kolektivit, ku sugjeronte me të madhe dhe të gjithë votonin për personin që duhej t'i jepej autorizimi për të blerë televizorin atë radhë.

- Një ditë po i mburreshim për ty Odisesë, që është një gjiton grek i pasur me miq, dhe ai ofroi të të bënte dokumentat për të të sjellë këtu sa për verë, derisa të rifillojë shkolla. Menduam se do të të pëlqente këtu! – u përgjigj Loni për çudinë time, ndërsa i hipëm një taksie drejt shtëpisë.

Vëllezërit kishin marrë me qera një shtëpi të vogël që kishte dy dhoma dhe një korridor në hyrje, pjesë e së cilës shërbente si aneks. Banja ishte përjashta

drejt fundit të oborrit para shtëpisë. Me përjashtim të banjës alla frënga, ujit të rrjedhshëm në aneks dhe rrugicës së shtruar me çimento ndërmjet shtëpisë dhe oborrit, kjo nuk dukej dhe aq ndryshe nga shtëpia në të cilën isha rritur.

Kur mbërritëm tek shtëpia, disa nga fqinjët ishin ulur në karrige plastike të bardha rreth një tavoline plastike përjashta, në pjesën e shtruar të oborrit, duke ngrënë suflaqe e duke pirë birrë, ndërsa prisnin për mbërritjen time. U ndjeva shumë ngushtë nga vëmendja e të gjithëve, por edhe e prekur nga mikpritja e tyre. Dukeshin të gjithë të sjellshëm e të kënaqur që më takonin. Filluan edhe nga lloj-lloj romuzesh që nuk mund t'i kuptoja. Xhimi më përqafoi dhe të gjithë bënë vend për karrigen time që të ulesha për të ngrënë me ta. Suflaqet ishin copa të vogla të shijshme mish derri, të shkuara në shishqebap e të pjekura në skarë me lëng limoni të shtrydhur mbi to. Nganjëherë, vendasit i fushnin në një petë të trashë me patate të skuqura, domate, një çikë mustardë, kripë, qepë e tarator.

Pas darke, Xhimi ofroi të më çonte të kërcenim në një restorant buzuqi në lagje.

- Kaq vonë?! Unë sapo erdha! – pyeta tim vëlla e çuditur që ai, antiqejf, do të shkonte në një vend qejfi me mua.

- E, hajde, është e dielë. Kanë muzikë popullore sonte, megjithëse mund të jetë një çikë vonë për të.

Restoranti ishte pesë minuta më këmbë nga shtëpia e vëllait.

- Pse i kanë të gjitha shtëpitë të bardha? – pyeta vëllanë rrugës për te restoranti, ndërsa admiroja shtëpitë shumëkatëshe me ballkone të mbështjella rreth e rrotull nga të dyja anët e rrugëve të shtruara e të pastra.

- Sepse shtëpitë këtu bëhen me skelet betoni dhe mure tulle ose blloqesh që mund të nxehen shumë në verë. Zakonisht, ndërtojnë nga një kat për çupë, po t'i kenë. Burrat futen në shtëpitë e grave kur martohen, - shpjegoi Xhimi.

- Si kollovarë? Çudi! Domethënë prindërit jetojnë me çupat në vend të djemve?! – vazhdova kureshtare.

- Në të njëjtën ndërtesë; prindërit kanë kat më vete. Ajo e madhja atje është shtëpia e Odisesë, fqinjit që na ndihmoi të të kalonim në kufi. Ai ka vetëm dy djem afërsisht mosha jote. Kati përdhes është dyqan karamelësh, ku ai tani është duke prodhuar vanilje. Po na paguan përditë që ta ndihmojmë për ta prodhuar. Më fton shpesh për darkë, kur dalin nëpër restorantet këtu rrotull. Nganjëherë edhe vete. Ka ca vende vërtet shumë të bukura për të ngrënë këtej. Mbase shkojmë në ndonjë sa të jesh ti këtu, - shpjegoi Xhimi.

Tani që mund të dëgjoja muzikën duke iu afruar restorantit, harrova fare sa ditë të lodhshme kisha kaluar. Xhimi e njihte pronarin, i cili më uroi mirëseardhjen në restorantin e tij dhe na shoqëroi për te tavolina jonë.

- Thotë që je vajzë shumë e bukur dhe që ai ka një djalë shumë të pashëm! – përktheu im vëlla për pronarin e restorantit. Buzëqesha me ndrojtë nga komenti dhe e falënderova për komplimentin.

- Ore, drejt e në thela njerëzia këtej! – i thashë tim vëllai pasi pronari shkoi për të na sjellë *Amstel*-et që porositëm.

- Ka rob provincialë gjithandej me sa duket. Ne u shikojmë rrugët e shtruara, shtëpitë e bukura dhe dyqanet e mbushura dhe druhemi, por njerëz radhë janë edhe këta, si ne, veçse më me fat që qeveria e tyre mbajti nga amerikanët në vend të rusëve pas Luftës së Dytë Botërore, - vazhdoi Xhimi.

Vëllai i madh gjithmonë gjente kënaqësi në leximet historike për vende e popuj të ndryshëm nëpër botë dhe shikonte me kënaqësi seritë e NOVA-s sa herë i jepej mundësia. Pasi mbaroi shkollën e mesme, Xhimi nuk arriti të fitonte njërin prej dy vendeve të hapura për në Institutin e Lartë të Arteve, kur konkuroi kundrejt pesëmbëdhjetë flautistëve të tjerë në vend me qëllim që të vazhdonte arsimimin e lartë. Shkoi ushtar për dy vjet, si çdo tetëmbëdhjetë vjeçar tjetër që nuk u pranua në shkollë të lartë, dhe u bë mësues muzike kur u kthye nga ushtria. Si përfundim, ndërsa punonte si mësues me kohë të plotë, u regjistrua në Institutin e Lartë të Shkodrës, ku studioi histori dhe gjeografi botërore me korrespondencë.

Siç e kishte parashikuar im vëlla, orkestra iku pak pasi mbërritëm tek restoranti, por ne pimë birrën, kërcyem për një këngë dhe vendosëm të ktheheshim në shtëpi.

- Duhet të jesh e këputur! Hajde të të tregoj se ku do të flesh, - tha Maria, kunata ime. – Gjeta një fustan nate mes rrobave që më kanë dhuruar fqinjët dhe mendova që do të të shkonte shumë, - vazhdoi ajo duke më treguar fustanin e natës mbi njërin nga divanët e shtruar për mua. E ngrita dhe i vështrova me kujdes qendrisjen e bukur me fije ari para gjoksit të hapur të fustanit të gjatë prej nape të verdhë me rrudha.

Maria më kishte dërguar thasë me rroba një vit më parë. Më mahniste dhe më kënaqte kunata që ma njihte shijen dhe masën aq mirë. Kur u martua vëllai i vogël, unë isha në shkollë të lartë dhe nuk kaluam kohë të mjaftueshme bashkë për t'u njohur mirë me njëra-tjetrën.

- Do të të tregoj plot të tjera nesër kur të ngrihesh.

Unë miratova me kokë dhe u futa qetësisht në krevatin tim të ri. Nuk

kisha udhëtuar kurrë aq gjatë më parë dhe mezi po prisja të pushoja ca.

Në dy-tre ditët pasardhëse, u takova me fqinjë të tjerë dashamirës dhe mësova rrugën për te dyqanet e lagjes. Po bëhej gjithnjë e më e vështirë për mua të ruaja shpirtin e kundërshtimit ndaj mësimin të gjuhës e kulturës. Dhimitra më thoshte shembuj të fjalëve shumë të gjata greke, por ato tingëllonin aq bukur dhe të lehta për t'u shqiptuar. Dhimitra, që ishte vetëm nja dy vjet më e vogël, jetonte diagonalisht nga im vëlla dhe e fliste anglishten shumë mirë. Fliste shtruar dhe ishte e ndrojtur, por shumë e dashur dhe ne u miqësuaam shpejt. Të dy vëllezërit e mi mendonin që Dhimitra ishte vajzë e mirë. Ajo madje më mori një herë me vete me një shoqen e saj te një lokal natën vonë.

- Nuk është një çikë si vonë për të dalë tani? Vetëm ne të treja po shkojmë? Pa mashkull për të na shoqëruar?! – pyeta pa u besuar syve që edhe vëllezërit e mi ishin dakord që motra e tyre të dilte në dhjetë të natës.

- Nuk na gjen gjë! Nuk na nget njeri! – më qetësoi Dhimitra duke buzëqeshur. Dhe ashtu doli vërtet. Agrinio ishte qytet i qetë, por të bredhurit nëpër lokale nuk ishte ndonjë territor i njohur qejfi për mua. Më mjaftonte edhe vetmia me ëndrrat për dashurinë time të re.

Përpiqesha të merrja me mend nëse Teo ishte hedhur në këtë anë të “gardhit”, por kisha shumë frikë të merrja në telefon për ta marrë vesh; frikë se mos më duhej të flisja dhe t'i shpjegohesha ndonjërit prej prindërve të tij, në rast se më dilyn në telefon. Por dëshira ime për të folur me të ishte më e fortë se frika. Mora gjithë reston që më linte familja të mbaja sa herë më dërgonin në dyqan dhe iu drejtova kioskës së kryqëzimit. Boll të ngrija telefonin, t'i bija numrit të fqinjit të prindërve të tij, që ma kishte dhënë herën e fundit që u takuam dhe do t'i dëgjjoja zërin. Sa më shumë i afrohesha telefonit aq më shumë emocion kisha. Po më dobësoheshin gjunjët dhe po më përzihej stomaku.

- A mund të bëj një telefonatë, të lutem? – pyeta shitësin nga dritarja e vogël përpara kioskës. Shitësi më afroi telefonin nga brenda dhe unë fillova t'i bija numrit. Siç më kishte thënë Teo, fqinja u përgjigj dhe unë i kërkova të flisja me të duke përdorur ato pak fjalë greke që kisha mësuar deri atëherë.

- Prit, - u përgjigj fqinja dhe disa minuta më vonë dëgjova një zë të butë gruaje që m'u përgjigj në shqip “Alo?”. E dija që po flisja me mamën e Teos,

siç kisha patur frikë.

- Mirëdita! Jam një shoqe e Teos. Kam ardhur te vëllai në Greqi dhe thashë të shikoja mos ka kaluar edhe Teo, - arrita të nxirrja me zë të dridhur.

E ëma u përgjigj: “Jo. Teo u përpoq dy herë, po nuk arriti të kalonte dot këtë verë”.

- Oh, më vjen keq! Mirë, atëherë, ditën e mirë! – ia ktheva duke u dridhur nga tmerri dhe e mbylla menjëherë.

Ika e çliruar që biseda e parë me “mamanë” nuk kishte qenë dhe aq e vështirë sa e kisha menduar, por e zhgënjyer që Teo nuk kishte mundur dot të kalonte kufirin.

Qëkur erdha në Greqi, çdo natë para se të flija, imagjinoja lloj-lloj mënyrash pa krye për t’u takuar me të në qytetin e prindërve të tij ose të vëllezërve të mi pa dijeninë e tyre. Çdo situatë dukej shumë më e realizueshme natën. Pastaj vinte mëngjesi dhe drita e diellit shkrinte si akullin të gjitha planet e mia të një nate më parë.

“Prandaj plasën dy gomat rrugës për këtu!” – mendova me vete duke qeshur me mënyrën se si ishin ngatërruar rrethanat për të më dhënë një lajm që nuk i kushtova vëmendje. *Nuk duhej të vija, sepse nuk po vinte as ai!*

Të mërkurën tjetër, Maria më mori me vete për te tregu i fshatarëve në fund të rrugës së tyre. Shtyva nipin dy vjeçar, Kristo, në një karrocë, ndërsa Maria tërhiqte karrocën e zbrastë të perimeve tatëpjetë për te tregu. Tregu i zhurmshëm kishte bllokuar nja dy blloqe të rrugës që kryqëzonte Ikoniun. Kamionët e vegjël ishin parkuar përbri njëri-tjetrit me rimorkiot plot me prodhime të kthyera drejt qendrës së rrugës.

- Përse bërtasin? – pyeta Marien për ca nga fshatarët e zhurmshëm.

- Po reklamojnë mallin. Ai që nuk po të ndan sytë, do të na shesë sardele të freskëta. Duhet blerë ca tani që të kam ty për t’i qeruar. Hajde të të tregoj si të bësh pazar.

Rrija pas kumatës duke admiruar mjeshtërinë e saj në pazarin me fermerët. Fliste shumë shpejt për të kuptuar gjë. Maria kishte jetuar atje vetëm pak më shumë se një vit, por mua më habiste sa greke tingëllonte kur fliste.

Shkuam nga fermeri në fermer duke parë e duke blerë bostanët, pjeprat, patëllxhanet, sallatat, specat, domatet dhe pjeshkët më të mira. Pashë disa bluza pambuku të bardha - ca me vija bojë qielli, ca me të kuqe - dhe mendova që do t’i shkonin Teos. Bleva një prej secilit lloj dhe disa sapunë Palmolive - sapuni me aromën më të këndshme. Ngarkuam çdo gjë që na duhej për të ushqyer familjen për një javë dhe e shtymë karrocën e rëndë të perimeve dhe të nipçes përpjetë kodrës drejt shtëpisë.

- Sa qejf ishte tregu! Çudi që shesin edhe rroba! Këtu i bleve rrobat që më dërgove mua vjet? – e pyeta.

- Disa, por shumica ishin të dhëna nga komshinjtë. U dërgova ca edhe motrave të mia, - u përgjigj Maria.

- Falemnderit! – ia ktheva. – Nuk e ke idenë sa të lumtur më bënë. Kur erdhi pakua, unë kisha pasur një dhembje të mprehtë në gjoks për nja dy ditë. Mami më kishte hedhur kupa atë mëngjes me shpresë që do të thithnin lagështirën që mund të ishte mbledhur në mushkëri dhe të shëronin dhimbjen që therte sa herë merrja frymë thellë. Duhej të rrija në krevat dhe të djersija mbas kupave, por, kur arritën rrobat, u çmenda nga gëzimi. Nuk kisha parë kaq shumë rroba gjithë jetën time. U ngrita dhe fillova t'i provoja. U lumturova edhe më tepër që çdo gjë më bënte si dorashkë. Dhimbja më iku dhe nuk u kthye më kurrë. Nga e dije masën time?! – e pyeta e mahnitur.

- Mbaja mend si dukeshe. Sa i shikoja rrobat një nga një, e dija cilat do të të pëlqenin dhe të bënin, - u përgjigj Maria. – Unë të dua, moj qëne, edhe pse ti s'më sheh dot me sy! – vazhdoi duke më ngacmuar.

- Kush të tha që nuk të shoh dot me sy?! – iu përgjigja në mbrojtje. – Shumë-shumë mund të kem menduar që im vëlla ishte shumë më king nga ty, - vazhdova me ngacmim, - por se mos na pyeti ne ai. Babit nuk i erdhi mirë. Pastaj, ai ishte mësuar t'i merrte të gjitha paratë që fitonte yt shoq para se të martohej. Kur erdhe ti dhe Loni na nxori kuotë për ushqimet, babi ta vuri fajin ty. Sigurisht, sa herë vija në shtëpi nga shkolla për një të dielë, unë e dëgjoja të vërtetën vetëm nga njëri vesh dhe, me sa duket, zemërimi dhe fajësimi i tyre m'u ngjit edhe mua. Ti rrije shumicën e kohës e mbyllur në dhomën tënde ose ikje te të tutë. Pastaj ike për Greqi dhe nuk na u dha mundësia kurrë të llafoseshim dhe aq e jo më të afroheshim, - vazhdova me justifikimin.

- Unë shkoja te prindërit, sepse fillova të bëhesha pishman që mora tët vëlla. Më pritët me këmbët e para dhe nuk më deshët e kjo më mërziste shumë! – u përgjigj Maria.

- Prandaj edhe turinjtë e varur? – qesha duke e ngacmuar për mjekrrën e saj të hequr dhe Maria bëri sikur do të më lëshohej me karrocën plot me ushqime. Unë shmanga karrocën e nipçes në reagim dhe u kujtova që ajo nuk mund të më kapte dot as me duar bosh.

- Seriozisht e ke? E vetmja mënyrë që ti të më kapësh mua me vrap është po të kem kryqëzuar shalët në vend që të mos pshurrem. Ti të mek me “kungujt” që të tunden sa nga një anë në tjetrën kur vrapon.

- Se po ushqej farën e tët vëllai, racën tënde, - ma priti Maria duke sforcuar buzët e saj të holla për të mbajtur seriozitetin.

- I ka mbushur dy vjeç ky?

- Pothuajse, - u përgjigj Maria.

- Kujtoja se bebet e ndërpresin gjirin rreth një vjeç.

- Sa më gjatë, aq më të shëndetshëm dhe të fortë bëhen. Do të të shikojmë ty kur të pjellësh ata të tutë. Katër djem do bësh!

- Nga e nxore këtë, moj?

- Nuk të imagjinoj dot fare me çupa ty!

- Më pëlqejnë djemtë, po katër? Në ditët e sotme? – iu përgjigja e gudulisur nga ideja.

Më vonë, po atë ditë, erdhi Kumbara për një vizitë të shkurtër. Ishte një e ve ortodokse shumë besimtare, që kishte ndihmuar vëllanë dhe familjen e tij që nga fillimi. Ajo u bë kumbara e Brunos dhe organizoi pagëzimin e tij te kisha ortodokse e lagjes, ku i ndërruan emrin në Kristo.

- Kumbara thotë që je vajzë e bukur! – përktheu Maria. U skuqa dhe e falenderova Kumbarën në greqisht.

- Pse të mos jetë? Ka qenë e privilegjuar; nuk është përvëlur në diell duke punuar arat siç i duhej të bënin shumicës së moshatareve të saj në fshat. Është Lel'e babit! Detyra e saj e vetme është të mësojë, të bëjë detyrat dhe të marrë nota të shkëlqyera. Po këtu nuk ka as mamin as babin tani. E kam vënë në punë. Do na bëjë kafetë, - vazhdoi Maria duke i shkelur syrin Kumbarës dhe duke përsëritur çdo fjali në shqip për mua.

- Unë bëja kafe të mira në shtëpi, - iu përgjigja duke ia pranuar sfidën. – Uuuuu! *Shkëncë* më vete bërja e kafesë! Me kaq gjë do të më trembësh ti mua? Unë jam rritur me punë të rënda. Lyeja shtëpinë, laja çarçafët, ktheja tokën çdo pranverë para se të mbillej bahçja, që as yt shoq as yt kunat nuk i zinin me dorë. Edhe drutë e dimrit i çaja me sëpatë, - vazhdova ndërsa shkova drejt aneksit për të filluar kafetë.

E dija që kunata ime bënte shaka, megjithëse çdo gjë që tha për veprimtarinë time ditore ishte e vërtetë.

- Bëka vërtet kafe të mirë! – tha Kumbara e çuditur siç gjerbi gllënjkenë e parë.

- Falemnderit! Po mësoj nga mjeshtërja! – u përgjigja duke nënkuptuar Marien.

- Edhe e zgjuar! – tha Kumbara duke qeshur me “furçën” time të shpejtë.

Tunda filxhanin tim pothuajse të zbrazët që të përhapja llumin nëpër gjithë sipërfaqen e brendshme dhe e ktheva përmbys mbi pjatën e vet për të kulluar për disa minuta.

Ky ishte një zakon i vjetër i grave në vendin tim për të lexuar të ardhmen e tyre. Ato besonin se disa njerëz kishin dhuratën e leximit të simboleve dhe formave në sipërfaqen e përlyer brenda filxhanit të kafesë dhe prej tij parashikonin të ardhmen e personit që kishte pirë nga ai filxhan. Kthimi i filxhanit dhe “leximi” i së ardhmes ishte pothuajse e vetmja arsye që pija kafe. Më shqetësonte stomakun sa herë që e pija, por mendoja që ishte një çmim i volitshëm për të parë në të ardhmen time dhe të tashmen larg meje.

Dimensioni shpirtëror më ka tërhequr që e vogël. Mami më merrte me vete kur shkonte tek e ëma në fshat. Sapo mbërrija tek shtëpia e dajës dhe takohesha me gjitonet, më fillonin dhimbje therëse në kokë. Nëna gjithmonë thoshte se më “hanin me sy” ata që më shikonin dhe fillonte të më yshte. Më pëlqente kur Nëna pëshpëriste lutje të mistershme nën zë dhe më frynte lehtë në fytyrë. Ndjeja dashurinë dhe përkujdesjen e saj; në ato çaste, unë isha qendra e vëmendjes, sikur gjithçka ishte për mua. Gjithmonë përpiqesha t’i kushtoja vëmendje nga afër fjalëve që t’i mësoja për vete, por nuk mund t’i kuptoja plotësisht.

Gjatë lutjeve të saj, fillonte t’i hapej goja shpesh pa u mbushur dot me frymë thellësisht. I mbusheshin sytë me lot dhe kjo i tregonte intensitetin e vuajtjes sime. Pasi Nëna i kishte përsëritur lutjet disa herë, më në fund, mbushej me frymë thellë siç i hapej goja dhe atëherë e dinte që lutja e saj ishte dëgjuar dhe shërimi im i plotë.

Nëna kishte sekrete shërimi edhe për “këputje mishi”. Fillonte duke lyer dhe fërkuar parakrahun tim me vaj ulliri. Pasi fërkonte parakrahun për njëfarë kohe, Nëna maste krahun tim të majtë me përxxhik. E fillonte matjen nga maja e gishtit tim të mesit, shkonte deri te supi dhe prapë poshtë. Sa herë që krahu dilte mangët tëposhtë, unë qeshja me teorinë e Nënës mbi raportin e drejtpërdrejtë ndërmjet ndryshimit në matjen e krahut dhe tkurrjes së muskujve të shpinës. Pastaj Nëna e shkundte krahun dy-tri herë dhe më thoshte të lëvizja nga vendi.

Pothuajse mezi prisja të më dhimbte koka. Ishte si një lloj konfirmimi i bukurisë sime; sikur të kisha bukuri të mjaftueshme që të soditesha nga fëmijët e lagjes. Nuk kisha kurrë merak për dhimbjen e kokës, sepse e dija që yshtjet e Nënës gjithmonë bënin efekt dhe dhimbja gjithmonë shërohej në

çastin që lutej Nëna.

- Shikon filxhan Kumbara? – pyeta kunatën.

- Absolutisht jo! – u përgjigj Maria, papritur shumë serioze. – Është shumë besimtare dhe të parët e “fatit” në një filxhan kafeje bosh shihet vëngër nga kisha. Kumbara e do Kriston si djalë e vet dhe ka qenë shumë e mirë me ne. Nuk dua ta zhgënjëj! – vazhdoi ajo.

Papritur u kujtova se si im atë gjithmonë tallej me gratë që shikonin filxhanin dhe më erdhi zor. E vura pjatën me filxhanin mbi tavolinë dhe nuk fola derisa kunata theu heshtjen e nderë në dhomë.

- Po letrat? – pyeta Marien mbasi iku Kumbara. – Nganjëherë u shikoja letrat shoqeve të shkollës. Nuk e dija kurrë çfarë broçkullisja, por disi kishte kuptim të përkryer për to dhe dukej se u kënaqte ndërgjegjen. Edhe hapja e letrave është keq?

- Po, - u përgjigj Maria, - por të them unë se cilës komshie nuk do t’i vinte keq fare. Jo të gjitha besojnë tek Perëndia njësoj. Ka nga ato që nuk e kanë për gjë ndonjë shikim të fatit aty-këtu, për sa kohë që nuk i shikon “papasi”. Pastaj ka të tjerë që vetëm shkojnë në kishë për Krishtlindje dhe Pashkë.

- Prifti është “papasi”? Ai me një rrobe të gjatë e të zezë? – e pyeta.

- Po, - u përgjigj Maria.

KAPITULLI VII

NË ÇAKRAN

Kishin kaluar pothuajse dy muaj që kur kisha ardhur për vizitë te vëllezërit e mi në Greqi. Unë e Xhimi po bëheshim gati për kthimin në shtëpi. Vëllai kishte blerë një komplet plastik të bardhë tavoline me katër karrige, një televizor me ngjyra dhe një frigorifer për të sjellë me vete, midis të tjerash. I kishin shijuar shumë mbrëmjet e verës greke përjashta në oborrin para shtëpisë dhe donte ta vazhdonte traditën e re kur të kthehej në shtëpi. Donte të kënaqte edhe mamin me një frigorifer të sajën që të mos luste më fqinjët për të ruajtur racionin javor të mishit të familjes gjatë muajve të nxehtë të verës. Problemi ishte i zgjidhur gjatë muajve të dimrit. Dhoma e gjumit ishte aq e ftohtë sa unë nuk përmbaja dot të dridhurat sapo shkelja në të dhe çarçafët e krevatit dukeshin të lagësht kur i prekja. Një herë, mami e ruajti mishin mbi dollapin e lartë të rrobave derisa ia zbuloi vendin e fshehtë macja dhe ia përplau shumicën.

Unë kisha blerë një çantë shpine me një xhep lejla përpara, që do të më hynte në punë gjatë vitit të fundit si studente. I paketova rrobat e reja dhe dhuratat në valixhen e re ngjyrë gri që kisha blerë, së bashku me paratë që kisha fituar duke qendisur si dhe reston që më kishin dhënë vëllezërit dhe kunata gjatë dy muajve të fundit.

Kisha kaluar një verë shumë të këndshme, por isha gati të kthehesha. Gjithmonë e kisha pritur me gëzim fillimin e një viti të ri shkollor dhe takimin me shokët e vjetër, por këtë radhë po më gufonte zemra nga gëzimi dhe dashuria në pritje të takimit me të dashurin tim përsëri. Nuk prisja dot sa të fillonte shkolla, ndërsa pyesja veten nëse i dashuri im po mendonte apo priste për mua. Qeshja me vete kur imagjinoja fytyrën e tij të befasuar sapo t'i thosha që kisha qenë në Greqi (në vend të tij) për dy muaj të tërë vere.

Më në fund erdhi dita e nisjes. Odisea, gjitoni që rregulloi hyrjen time në Greqi, u ndodh edhe një herë në dispozicion të tim vëllai. U tregua i

gatshëm për të na transportuar mua dhe Xhimin deri në kufi me çdo gjë që po sillnim.

Kishim filluar të ngarkonim furgonin e Odisesë me sendet tona të thjeshta herët në mëngjes, kur Odisea më dha një pako të vogël sa grushti duke thënë: “Na këtu! Ty mund të të hyjë në punë më shumë”.

E hapa dhuratën e vogël dhe gjeta një radio xhepi AM/FM të rrumbullakët, të zezë me kufje, që punonte me bateri.

- Sa radio e lezetshme! Falemnderit! – thashë buzagaz.

- Oh, hiç asgjë! – u përgjigj ai duke valëvitur dorën poshtë. – Një kinkalери e vogël që mendova se do të të pëlqente si studente që je.

Po ndjehesha fajtores që e kisha paragjykuar Odisenë që nga momenti i parë që ishim takuar. Mund ta dalloja llojin e tij nga një kilometër larg, por edhe vëllezërit ma kishin përforcuar opinionin, kur më paralajmëruan të tregohesha e zgjuar e të mos gjendesha kurrë vetëm me të. Megjithëse ndaj meje, Odisea kishte qenë gjithmonë i sjellshëm dhe zemërmirë.

Odisea ishte një nga burrat më të pasur të lagjes. Ishte aty nga fundi i të pesëdhjetave, kishte trup të bëshëm e të shkurtër me bark të madh, shpatulla të gjera dhe kurriz të drejtë me vithe pothuajse të padukshme. Kishte rrathë të errët e të fryrë rreth syve të mëdhenj, që dukeshin sikur do t’i dilnin vendit. Sa herë që mbyllte qepallat në qendër të syrit, nuk e di pse më vinin ndër mend sytë e gjarpërinjve.

Sa herë mendoja gjarpërinjtë, dridhesha e tëra nga historitë e vjetra të vëllezërve për Nënë tonë trime, që i ndiqte këmba këmbës. Më thanë një herë që një gjarpër iu hodh nga një pemë, iu mbështoll përreth trupit të imët dhe filloi ta rrihte Nënë me bisht. Ajo e mbërtheu për fyti dhe filloi ta shtrydhte me gjithë fuqinë në duart e saj si darë. Gjithë ato vite mjelje lopësh, dhensh e dhish, mbledhje ullinjsh dhe lërim arash nuk i vajtën dëm. Që nga ajo ditë, Nëna e ndiqte, e kapte dhe e vriste çdo gjarpër që i dilte në shteg.

Edhe pse nuk i kuptoja të gjitha komentet që u bënte Odisea vëllezërve të mi për gocat e bukura që kalonin para dyqanit të tij të vogël, e kuptoja nga gjestet që ishin të një natyre seksuale, por gjithmonë mendoja që nuk ishin asgjë më tepër se fjalë boshe. Më kujtonte nja dy shokë klase, që ngacmonin shumë me fjalë, por që nuk çonin deri në fund asnjë nga “premtimet” e tyre.

Hipëm të tre në furgon dhe u nisëm drejt veri-perëndimit, drejt shtëpisë.

- Duket se mbaka bateri të vogla. Ato mund të jenë të vështira për t’u gjetur në Tiranë, - tha im vëlla, ndërsa luante me radion time të re.

- Dukesh e lumtur. Je e lumtur që po kthehesh? – më pyeti Odisea duke ngarë makinën për të na kthyer.

- Po, jam! – u përgjigja me dëshirë.

- Nuk të pëlqeu Greqia?! – pyeti Odisea disi i çuditur nga gëzimi im për t’u kthyer. – Shumica e shqiptarëve që njoh unë nuk duan të kthehen, - vazhdoi ai.

- Shumica e shqiptarëve që njeh ti erdhën në Greqi nga e keqja. Falë teje, unë erdha për pushime verore dhe madje goxha të mira. Më pëlqeu Greqia; vendi, gjuha, muzika dhe njerëzit, mbi të gjitha! Do t’i kujtoj gjithmonë me kënaqësi netët që na qerese mua dhe vëllanë nëpër restorante të shtrenjta dhe piktoreske. Ishte kënaqësi që erdha për vizitë, por është koha për t’u kthyer tek jeta ime e këndshme, - iu përgjigja duke u përpyetur të fshihja ngazëllimin e kthimit prej tim vëllai.

- Të pëlqeu muzika greke? – pyeti Odisea.

- Më ka pëlqyer gjithmonë! E di ti që kjo nuk ishte hera e parë që dëgjova këngë greke? Me gjithë izolimin nga kultura e jashtme që duroi vendi ynë gjatë komunizmit, për çudinë e shumë njerëzve, qeveria i kishte lejuar disa këngëtarë grekë të jepnin shfaqje herë pas here në teatrin e vogël të qytetit tim. Mbjaj mend që u shiteshin krejtësisht biletat e koncerteve. Izolimi dhe, sidomos, kufizimi i arteve dhe muzikës për të shprehur vetëm dashurinë për “partinë” kishte shkaktuar një boshllëk të vërtetë kulturor në vend dhe njerëzit ishin shumë të etur për muzikë të ndjerë e të mirëfilltë. Mësova përmendsh një dy vargje nga “Dhimitrula”. Është qejf tani që kuptoj domethënien e vargjeve, - thashë unë dhe fillova të këndoj ato që mbaja mend nga kënga e vjetër.

Xhimi i buzëqeshi Odisesë sikur t’i thoshte “Të thashë që ka talent!” dhe më shoqëroi në këngë. Odisea buzëqeshi në miratim, ndërsa kthente kokën herë pas here nga ne të lumturit, që po ktheheshim në shtëpi.

- Do më marrë malli për ju, çiliminj! Edhe mos u bëni firar; më merrni ndonjëherë në telefon dhe, me shpresë, mbase vini papë! – tha Odisea.

- Po sigurisht që do të të marrim në telefon. Qysh do flasim me vëllanë ne? – ia priti Xhimi duke qeshur.

Katër orët për në kufirin shqiptar kaluan shpejt dhe tashmë mund të dalloja postbllokun për në Shqipëri. Odisea ndaloi sa më pranë postbllokut që i lejohej dhe na ndihmoi të shkarkonim ngarkesën.

- Falemnderit shumë për gjithçka që ke bërë për mua edhe kthim të mbarë! – e përshëndeti Xhimi Odisenë ndërsa ky i fundit hipi në furgon.

- Asgjë. Jemi miq. Rrugë të mbarë edhe juve! – u përgjigj Odisea, siç mbylli derën e shoferit, dhe u nis.

Xhimi filloi të mbartte ç'të mundte nga ngarkesa për te postblloku shqiptar, ndërsa unë ndenja mbrapa duke ruajtur mbetjen e pargut derisa u kthye për to. Duke parë përtej në anën shqiptare të kufirit, vura re ndryshimin e menjëhershëm nga rruga e shtruar me asfalt të zi e Greqisë në të pluhurosurën dhe të shkatërruarën e anës shqiptare dhe u ligështova. Nuk më ishte dashur shumë kohë në Greqi për ta harruar. M'u mbushën sytë me lot nga dhembshuria për vendin tim të dashur e të rrënuar nga vitet e gjata të vjedhjes komuniste të maskuar nën parrullat e mëdha të krenarisë kombëtare prej të qenit i vetmi vend komunist në botë. *Çfarë mashtrimi!* Të paktën nuk humba kohë duke lexuar ndonjë nga autobiografitë e diktatorit si një nga kushërirat e mia të vogla. Mbajta mend sa turp më kishte ardhur një verë, kur i kisha vajtur për vizitë dhe xhaxhai ishte mburrur me të bijën, kushërirën time të vogël, që i kishte lexuar të gjitha veprat e “udhëheqësit”, duke përfshirë edhe autobiografinë e tij. *Ina duket gjeniale tani, që i përdorte të gjitha veprat e tij për letër higjenike, pasi i bënte shuk për t'i zhubrosur një nga një.*

Xhimi gjeti kushëririn tonë, Luanin, duke na pritur me furgonin e tij, siç kishte premtuar. Ndihej tim vëlla të ngarkonte gjithçka kishte sjellë. Luani kishte të njëjtët sy të vegjël e të qeshur dhe hundën e tërhequr përpara që i mbaja mend nga fëmijëria, vetëm pak më i shkurtër dhe i bëshëm nga ç'mbaja mend. Isha zgjatur unë me kalimin e viteve dhe tani e kisha të vështirë të mësohesha me të parët nga lart njerëzit që dikur i shikoja nga poshtë.

- Mirëserdhët! Si je? – më përqafoi Luani para se të niseshim për në shtëpi.

- Mirë, falemnderit! Falemnderit që erdhe të na presësh! – u përgjigja unë.

- Si ishte Greqia? – pyeti Luani i qeshur.

- E bukur! – iu përgjigja. – U kënaqa!

- Ishte Agrinio shumë larg prej këtu? – pyeti Xhimin.

- Ishte ca, po nuk e ndjen, se janë rrugët shumë më të mira dhe makinat shumë më të shpejta.

- Eh, rrugët tona janë ashtu siç i ke lënë! – u përgjigj Luani.

Mami dhe babi u lumturuan kur na takuan disa orë më vonë. Udhëtimi ishte i lodhshëm dhe unë isha e lumtur që isha në shtëpi. Shkarkuam frigoriferin dhe televizorin e ri. Vëllait iu deshën disa minuta për të futur gjithçka në prizë dhe, disa orë më vonë, shijuam dhallë të ftohtë për herë të parë në historinë e familjes. Morën fund ditët e lutjes ndaj fqinjëve për të na mbajtur mishin në ngrirje.

- Po shkoj për vizitë te Flora. Do të vish me mua? – më pyeti mami, ndërsa po bëhej gati të dilte nga shtëpia për xhiron e mbasdites.

- Sigurisht, - iu përgjigja, - nuk ta kam parë kushërirën me mua! – dhe e shoqërova mamin nëpër rrugicat e lagjes.

- Kur ishe e vogël ma fusje ti krahun; tani që ti je më e gjatë se unë, janë ndërruar rolet. Po rritesh me ditë, të keqen nëna, lastar’e nënës! – tha mami dhe unë e dija mirë se ku do të dilte ky muhabet.

- Po, ma. Po rritem. Gjëra që ndodhin me të gjallët, - ia ktheva duke u përpjekur të vonoja sondazhin e pyetjeve të paevitueshme.

- Hë, pe ndonjë djalë të bukur andej nga Greqia?

E nxori kokën!

- Jo, o ma. Nuk më pëlqeu asnjë dhe asnjë nuk ra përmbys për mua.

- Po në shkollë? Asnjë në shkollë nuk e ka vënë re që je si drita?

- Jo, o ma. I duan si hëna. Ata që më vënë re, nuk më pëlqejnë mua dhe atyre që më pëlqejnë, nuk u pëlqej. I ka jeta këto. Pastaj, mua sikur nuk më lejohej të merresha me djem deri në fund të shkollës, - ia ktheva në përpjekje për t’ua hedhur fajin të dyve, nënë e babë.

- Po mirë, tani je në vit të fundit. Shikoji dhe një herë ata që mendon se nuk të pëlqejnë, - nguli këmbë mami me të mirë.

- Ty ndoshta do të të vinte mirë të dëgjoje që njëri ishte gati të më vinte në shtëpi që të nesërmen për të më kërkuar dorën tek im atë, po nuk më pëlqen! – thashë duke e ditur që po e torturoja time më nga shpresat dhe ëndrrat e saj për çupën e vetme.

- Po pse nuk të pëlqen? – pyeti mami.

- Nuk ka “pse”-ra në pëlqimin e njerëzve, o ma. Thjesht, nuk ngjit. Është me të dhënë, nuk është me të thënë!

- Me se merret ai? – vazhdoi mami në të vetën.

- Ishte pedagogu im vjet, por u zgjodh deputet në parlamentin e ri dhe tani është politikan profesionist. Do të ta tregoj në televizor ndonjë herë kur të shikojmë parlamentin e mbledhur, - e ngacmova dhe ca më tej.

- Mos po i mban turinjtë si shumë përpjetë? Nuk do ngelesh e re dhe e bukur përgjithmonë, të keqen nëna! Ikin vitet, ikën dhe bukuria.

- Ee, o ma, mos e vrit mendjen! Bëj shaka unë. Nuk më pëlqeu ngaqë më pëlqen dikush tjetër.

- Vërtet? – i shndritën sytë dhe iu fashit rrudha vertikale ndërmjet vetullave.

- Po ai, me se merret?

- Ai është student për mjekësi, si Herkuli.

- Uu, shumë mirë! Ky nuk është ai, të cilit nuk i pëlqen, apo jo?

- I pëlqej ca. Po se sa, nuk e di akoma.

- Nuk është një çikë i vogël? Është gjithmonë më mirë që burri të jetë ca vjet më i madh se gruaja, - tha mami e pasigurt nëse ishte e gëzuar apo e shqetësuar për mua.

- Më i madh është; një muaj e gjysmë të tërë. Nuk mjafton? – pyeta duke mos përfillur edhe një tjetër nga rregullat e saj për çiftosjen e të rinjve.

Pak ditë pasi u ktheva nga Greqia, na erdhi për vizitë Refati, një mik i vjetër i babit. Dikur, babi kishte ndërhyrë për ta regjistruar në kursin e shoferave dhe ai nuk e harroi kurrë nderin. U bë shofer kamioni dhe i shpëtoi punës së rëndë që do t'i ishte nënshtruar në fshat po të ishte bërë punëtor kooperative, karriera më e zakonshme për burrat që kishin lindur në fshat gjatë komunizmit. Refati kishte dy çupa, afërsisht moshë ime, me të cilat kisha luajtur gjatë pushimeve verore në të kaluarën.

- Si është Lavdia? – pyeta për më të madhen.

- Mirë, falemnderit! Të bën të fala. Është martuar dhe ka një djalë tani.

- Si ikin vitet! Më duket sikur ishte dje që mblidhja bar për lopën nëpër fusha. Më mbante gjithmonë afër dhe ishte shumë e dashur me mua. Mbaj mend si erdhi me vrap e u fut midis meje dhe patave, kur m'u turr e tërë tufa me qafat e shtrira përpara për sulm. Po Vezirja? – e pyeta për të voglën.

- Edhe ajo është martuar, - u përgjigj Refati, a thua se martesë ishte gjithçka kishte rëndësi për vajzat e tij. E dija ç'të prisja paskëtaj nga goja e tij... – Kur do ta hamë dasmën tënde? – pyeti duke parë nga im atë.

- Nuk martohem dot pa pajë. Unë nuk kam kohë ta përgatis, se më duhet të mbaroj shkollën një herë. Kam edhe një vit për të bërë. As im atë as ime më nuk duket se po e vënë *ujët* në zjarr për këtë. Sa të vihen të gjitha këto punë në vijë, unë do të jem plakur, kështu që nuk më duket se do të martohem ndonjëherë! – vazhdova shakanë duke ua lënë fajin prindërve.

- Mirë thotë ajo! – u hodh mami me zë fajtor. – Ne nuk kemi hequr as një kokërr leku mënjanë për dasmën e saj. Kshu e tutje, gjithë pensionin tim për ty do ta heq! – vazhdoi duke u kthyer nga unë.

- Bëj shaka, ma! – iu përgjigja buzagaz. – Nuk kam nevojë për pajë; po më jep *dhiplomën*.

- Diplomën po e merr ti, se je e mënçur vetë.

- Po mirë, po edhe ato zoçkat e pjekura që më dërgon gjithë kohën kanë meritë, ama; “mendj’e shëndoshë në trup të shëndoshë!” i thonë një llafi.

Kisha nënën më të mirë në botë. “Ti je më e bukura në botë!” më tha një herë, kur isha në shkollë fillore. “Jo, o ma, - ia prita unë, - është një çupë te shkolla ime një vit para meje që është më e bukur se unë. I ka flokët dyllë të verdha dhe të thurura gërshet të trashë”. “Mirë, po në klasën tënde ti je më e mira”, - e vendosi mami çështjen, por unë e dija që e thoshte sepse çdo nënë ashtu i thoshte bijës së vetme nga dashuria.

Mami gjithmonë kishte besim tek unë, gjithmonë në shërbim të gjithkujt, përveç vetes, gjithmonë e dashur dhe mikpritëse ndaj gjithkujt që trokiste në derë. Nuk e dëgjova kurrë time më të ngrinte zërin apo të nevríkosej me fëmijët e saj. Gjithmonë më mbështeste dhe brohoriste çdo veprimtari që doja të ndërmerrija.

Kur donte të më regjistronte për basketboll mësuesja e basketbollit, meqë isha një nga gocat më të gjata në klasë dhe më e gjatë se shumica e djemve në klasë të katërt, mami ishte e vetmja që miratoi, po babi dhe vëllezërit vendosën në kundërshtim.

Xhimi nuk kishte mendim të mirë për basketbollistët profesioniste, që udhëtonin në gjithë vendin dhe, me raste, edhe nëpër Europë. Mendonte se nuk do të ishte zgjedhje e mirë karriere, po të doja të martohesha ndonjëherë. Pastaj, mund të zgjatesha shumë dhe kjo përfundimisht do të zvogëlonte pellgun e mundësive për një burrë të ardhshëm. Xhimi gjithmonë ia gjente anën babit, sidomos kur vinte fjala për të ardhmen e motrës së vogël. - Është shkollë fillore! Nuk po thotë njeri të bëhet profesioniste, - kishte ngulur mami këmbë më kot, e mërziur nga mendjet e tyre mashkullore të mbrapshta.

- Meqë ra fjala te zoçkat, - i tha babi mamit, - pse nuk na bën një shpejt e shpejt për drekë?

- Nuk mund të rri gjatë, - u përgjigj Refati, duke e ditur që babi e kishte taksur zogun për të. – Kam qenë shumë i zënë që kur filloi privatizimi. Bleva kamionin nga qeveria dhe tani punoj për vete.

- U, urime! – u gëzua babi. – Je me fat që të zuri kjo kohë një çikë më të ri. Mua e plakës do të na duhet t’ia dalim me pensionin e qeverisë. Po të paktën

po na jep tokë për të ndërtuar shtëpi. Pas gjithë këtyre viteve së jetuari në shtëpinë e tjetrit, dashtë Perëndia, do të kemi tonën më në fund! – vazhdoi.

- Urime edhe juve! Ky qenka lajm i mrekullueshëm! Edhe djemtë po marrin tokë? – pyeti Refati për vëllezërit e mi.

- Po. Unë e Xhimi po e marrim bashkë dhe Loni më vete mbrapa tonës. Kemi vajtur ta shikojmë vendin. Është andej nga fushat në veri të qytetit, ku ajri është shumë më i pastër. Është edhe më larg se këtu nga rafineria e naftës. Vetëm se është një bunker i vjetër në pjesën tonë që do të na duhet të paguajmë për ta hequr.

- Nuk do ta mbash kotec për pulat? – pyeti Refati me shaka.

- Në fakt, kam dëgjuar që përpiqen t’i marrin dhe ripërdorin hekurin, po kjo mund të vejë shumë shtrenjtë, - u përgjigj babi.

- Epo mirë atëherë, po bëhet vonë dhe më duhet të iki tani, - tha Refati siç u ngrit të ikte.

- Mos kalon gjë nga Cakrani ti për të vajtur në Varibop? – e pyeta Refatin.

Pata një ide të papritur për t’i bërë një vizitë Edi për dy javët e fundit që kishin mbetur derisa të fillonte viti i ri shkollor. Iu ktheva prindërve të mi: “Po sikur të shkoja me Refatin te Edi për disa ditë derisa të fillojë shkolla? Si thoni?”.

- Për mua, shko, - tha mami, - po mos ta ketë problem Refati.

- Epo mirë, po si do të kthehesh? – shtoi babi me dy mendje.

- Sigurisht! – pranoi Refati. – Ka plot furgona dhe autobusa në atë linjë tani.

- Ju-huuu! Do të bëhem gati shpejt e shpejt! – kërceva me gëzim dhe paketova me shpejtësi disa nga teshat e mia.

- Kush është Edi? – pyeti Refati prindërit e mi.

- Një shoqe e saj nga Cakrani; kanë qenë në shkollë bashkë për katër vjet. E ka t’atin agronom dhe mamanë mësuese. Ti mund t’i njohësh, - u përgjigj im atë.

- Gjyshi nga e ëma ka qenë doktor me emër në fshatin tim, - shtoi mami.

- Gati jam unë, – thashë duke qendruar më këmbë në kuzhinë me çantën e re të ngjeshur me disa nga rrobat e mia.

- Mirë, ikim atëherë! – tha Refati, siç doli nga shtëpia pas meje.

Mami dhe babi na përcollën. – Rrofsh që na erdhe! Na dil prapë! – i thanë.

U ula në vendin e parë në kamion dhe i përshëndeta prindërit me dorë duke u ndjerë paksa fajtores që po largohesha kaq shpejt mbas kthimit nga

Greqia. Më kishte pëlqyer gjithmonë udhëtimi. Mami më merrte me vete sa herë shkonte të shihte nënën e vet të paralizuar gjatë pushimeve verore, po tani isha në moshë për të udhëtuar vetë.

- Ja dhe Azotiku që helmoi dynjanë, - thashë për uzinën e prodhimit të plehërave kimike.

Kamioni lëvizte ngadalë rrugës dredharake të shtruar me zhavor, që kalonte përmes kodrave mbi të, ndërsa unë ndiqja me sy gjithë kompleksin industrial poshtë në fushë që punësonte shumicën e popullsisë së qytetit, përfshirë nënën time dhe vëllanë e vogël. Mami kishte ruajtur portat e të treja uzinave nga “armiqtë e klasës punëtore” me një “kallashnikov” për pesëmbëdhjetë vjet, ndërsa djali i saj i vogli pastronte oxhaqet e çentralit termo-elektrik. TEC-i, siç ia thoshim, ndodhej midis Azotikut dhe rafinerisë së naftës që prodhonte mazutin që digjte TEC-i për të prodhuar energji elektrike.

- Nënës dhe vëllait tim të shkretë u duhej të thithnin helmet aty çdo ditë dhe pastaj të vinin në shtëpinë me dollapët bosh! – psherëtiva dhe vazhdova, - Vetëm nga një litër qumështi në ditë dhe nga një pako njëqindgramëshe gjalpi në muaj për kurorë. Mbjaj mend që ngrihej babi në tre të natës dhe bridhte lart e poshtë sa nga radha e bulmetit, te radha e mishit për dhjetë vjetët e fundit. Shyqyr dhe aq, se kishte dalë në pension!

- Mbledhja e bagëtive na rrënoi të gjithëve! – ra dakord Refati. – Shumica e fshatarëve e kishin më mirë t’i thernin bagëtitë e t’i hanin derisa t’u mbaronte mishi se sa t’ia jepnin qeverisë për hiç gjë. Vulëhumburi mendoi se nuk ishte aq komunist sa duhej duke na marrë vetëm tokën, po iu desh të na rripte nga çdo gjë që kishim. Sa më të vegjël bëheshin njërëzit, aq më i madh duhej grushti i tij shtypës mbi ta. Prandaj u desh të racionohej çdo gjë për njërëzinë e qytetit, përveç preshit dhe spinaqit, - tha Refati me ironi.

- Se si nuk mbaronin kurrë gjethet! Propaganda gjeti plot gjëra të mrekullueshme për vlerat ushqyese të ‘barit’! – buzëqesha e lumtur që ato ditë kishin marrë fund. – Desha të të pyesja për njerin nga vëllezërit e tu të vegjël, Hekuranin. Si është? – e pyeta.

- Mirë është, por po plakët dhe ai si gjithë ne të tjerët, - u përgjigj Refati duke buzëqeshur dhe duke shkuar gishtërinjtë e tij të shkurtër e të ashpër mbi ballin e zmadhuar nga rënia e flokëve.

- Është ai që më bleu sandalet e kuqe kur erdha një herë me pushime. Kurse e shoqja më qepi një fustan të bukur basme. Këto gjëra lënë mbresa të thella në mendjen e një fëmije!

- Patjetër. Të kishim mysafire me kimet; e bij'e vetme e mikut të kimetshëm. Pastaj, mikpritja me ç'të kemi dhe ç'të mundim është zakon këtyre anëve. Ne të gjithë përpiqeshim t'i bënim pushimet e tua sa më të kënaqshme, - u përgjigj Refati.

- Kam dhe një kujtim të keq nga ato ditë.

- Vërtet? – pyeti Refati i befasuar dhe i përgjegjshëm.

- Po, por nuk ishte fare faji yt. Unë po luaja kukamshefthi me Veziren dhe ca kalamaj të tjerë të lagjes. Isha duke vrapuar në një fushë të hapur, kur papritur erdha në buzë të një pusi të vjetër nja një metër në diametër, pak më i ulët në nivel nga toka rreth e rrotull, që e bëri të pamundur ta shikoja nga larg. Pusi nuk kishte mur përreth, siç kanë shumica e tyre. Mbaj mend që ndalova menjëherë mu në buzë të pusit. M'u duk sikur m'u fundos zemra nga ideja që mund të kisha rënë brenda në atë gropë të errët e të frikshme me ujë në fund pa e ditur askush se ç'më kishte ndodhur.

- Shyqyr Zotit që nuk re! As që e marr dot me mend se si do t'i kisha dalë përpara tyt eti po të të kishte ndodhur diçka e tillë! – u përgjigj Refati me psherëtimë sikur sapo të kishte ndodhur dhe shtoi, - Kishin të drejtë ata që nuk të lëshonin nga sytë për çdo moment, edhe pse donin të kënaqeshë në verë. Ti gjithmonë ke qenë – dhe e shoh që je akoma – Lel'e babit.

- Mami i kishte shumë frikë puset. Kishte dëgjuar histori të dhimbshme fëmijësh që binin brenda dhe mbyteshin. Xhaxhai im kishte një në oborr, pranë një shege pjellore, frutat e së cilës më pëlqenin shumë. Po ai pus kishte një mur guri rreth e rrotull deri te brezi dhe një kapak mbi të. Kur u zgjata sa të arrija çikrikun e drunjtë sipër pusit, më lejohej të nxirrja ujë nën mbikqyrjen e kushërirës sime dy-tre vjet më të madhe. Ajo më linte vetëm të lëshoja kovën, të tërhiqja litarin disa herë që të kthehej kova mënjanë dhe pastaj e merrte vetë në dorë duke buzëqeshur. “Provoje prapë herë tjetër, kur nuk jam me nxitim.” Po ajo gjithmonë rrugu-fugu ishte. Si përfundim, kushërirra më mësoi si ta hidhja kovën e llamarinës përmbys në gropën e thellë, pa goditur murin anësor e pa shkatërruar kovën.

- Të paktën ata e kishin pusin në oborr. Shumicës akoma i duhet ta ngrenë ujin në krah nga larg, - u përgjigj Refati.

- E di. Te daja që jeton majë një kodre nuk kanë pus. Nëna jonë duhej ta ngrinte ujin mbi supe për nja një kilometër e gjysmë të mirë përpjetë nga burimi në rrëzë të kodrës. Vajza e madhe e dajës nganjëherë vinte një bucelë në kokë dhe dy shtëmba plot me ujë në secilën dorë, kurse mua më jepte vetëm një litroshe për të mbartur. Me mahniste drejtpeshimi, me të cilin

zotëronte bucelën në kokë. Mbështillte një bluzë të vjetër rreth dorës për të bërë kurorën e sheshtë që vinte në kokë dhe pastaj bucelën mbi të.

Pas një ore me makinë në rrugën e përdredhur përmes kodrave të pyllëzuara me ullinj në jug të vendlindjes, falënderova Refatin për udhëtimin e bukur dhe zbrita nga ZIS-i i vjetër në fshatin e Edit. Pyeta ca rrugës për të ma treguar dhe ia gjeta shtëpinë duke befasuar atë dhe familjen e saj me vizitën time.

- U?! Po ti nga dole këtu?! Me çka erdhe? – pyeti Edi me notat e sipërme të zërit të saj zakonisht të ngjirur, lumturisht e befasuar që shoqja e saj i kishte gjetur shtëpinë. – Sa mirë bërë që erdhe!

- Kam dhe unë spiunët e mi, - thashë duke qeshur dhe e gëzuar që shoqja më priti kaq krahë-hapur. – Një mik i babit, që jeton një çikë më tutje nga fshati juaj, na ndodhi për vizitë sot me kamionin e tij. Kishte qenë shofer kamioni për kooperativën dhe tani po e privatizon. Kur pashë kamionin para shtëpisë, mendova: “Çfarë qejfi do të ishte t’i veja papritur!”. Edhe kështu përfundova këtu. Vetëm se do të më duhet të gjej ndonjë kamion a furgon në kthim.

- Të lumtë! – u përgjigj Edi duke më përqaftuar prapë.

- Të thashë gjë që sapo u ktheva nga Greqia?

- Jooo! Si ka mudësi? – pyeti Edi edhe më e habitur.

- Njëri nga fqinjët grek të tim vëllai mori në telefon një polic që njihte te kufiri dhe ata më dhanë një vizë të përkohshme për të më lënë të kaloja. Ndenja dy muaj, deri para disa ditësh.

- Nuk më besohet që vajte në Greqi!! Pe njeri andej? – pyeti Edi duke më shkelur syrin.

- Jo. Nuk erdhi. Më tha e ëma që nuk u hodh dot këtë radhë. Kjo ishte një arsye tjetër që vendosa të vija këtu; nuk po më shtyhej fare në shtëpi dhe më sosi durimi për ta parë, - iu përgjigja disi e zhgënjyer, po më ndriu fytyra aty për aty kur i thashë: “E imagjinon dot fytyrën e tij kur t’i them që isha në Greqi?”.

- Do të ishte më gallatë ta kishe parë kur i tha e ëma që e kishe marrë në telefon dhe pyete për të. Uaa! Ke folur me t’ëmën! Si t’u duk? Ishte e mirë?

- E mirë dukej. Kisha tmerr ta telefonoja, por as më bërtiti, as më pyeti shumë. Megjithëse nuk i dhashë shumë rast. Ia mbylla para se të më pyeste për ndonjë gjë që nuk isha gati t’i thosha të vërtetën.

- Eh, mos të të vijë keq që nuk e pe gjithë verën. Kur të shiheni, do të shpërthejnë fishekzjarret. Hajde t’i hipësh kalit tani. I ke hipur ndonjëherë

më parë? – pyeti Edi.

- Jo! Vërtet?! – më shndritën sytë nga gëzimi dhe ankthi në të njëjtën kohë.

- Sigurisht!

- Xhaxhallarët e mi vetëm gomerë kishin. Kushërira, që ishte vetëm tre vjet më e madhe se unë, e ngarkonte me çarçafët e rrobat e palara të të gjithë familjes dhe e çonte përposhtë në krua. Unë haja manaferra dhe i bëja shoqëri, ndërsa ajo fillonte zjarrin për të ngrohur ujin në kazanin e madh prej llamarine dhe lante gjithë rrobat. Pastaj shpëlante gjithë rrobat me ngjyra dhe i nderte mbi ferrat për t'u tharë në diellin e nxehtë, ndërsa gjithë të bardhat zienin.

- Hajde vemi të shikojmë mbase përdorim kalin e kushëririt tim, - tha Edi dhe të dyja zbritëm tatëpjetë te toka e familjes, kaluam përroin e vogël mbi një urë me dërrasa përmes shumë pemëve dhe hëngrëm gjithë fiqtë që na nxinte barku duke u llafosur për gjithçka kishim bërë atë verë.

Vazhduam për te kushëriri i Edit dhe e pyetëm nëse mund të na e jepte kalin hua për pak. Kushëriri i solli kalin dhe të dy më ndihmuan mua, qytetaren, të hipja në kalë. U ula mbi të për një çikë dhe prita që të lëvizte.

- Si e bëj të lëvizë? – pyeta, ndërsa të gjithë rreth e rrotull qeshnin me përpjekjet e mia për ta lëvizur kalin duke i dhënë trupit tim përpara ose duke thënë “ysh”, që kisha dëgjuar kushërinjtë e mi ta përdornin për të urdhëruar gomarin. – Boll qeshët dhe me thoni çfarë të them ose të bëj!

- Duhet të përsëritësh “ysh” disa herë para se të të përgjigjet, se nuk të njeh, - tha kushëriri i Edit duke u përpjekur të mbante të qeshurën.

Bëra si më tha derisa ai nuk e mbajti dot më dhe shpërtheu në të qeshura. Pastaj e kuptova se po argëtohej me mua dhe e turpëruar pyeta prapë: “Hë tani, çfarë të bëj?”

- Shqelmoje lehtë me thëmbat e këmbëve! – u përgjigj Edi pasi mori veten nga të qeshurit. Provova marifetin që më sugjeroi shoqja dhe kali filloi të lëvizte dalëngadalë përpara.

- Mos! – fillova të frikësohesha. – Po sikur të fillojë shpejt ose të vrapojë? Pastaj si e ndaloj? – pyeta Edin duke bërëtitur dhe menduar se sa budallaqe isha treguar të hipja në kalë pa mësuar disa komanda të thjeshta. Edi, që po qeshte akoma, më tha të tërhiqja frerët me kujdes ose ta fërkoja me pëllëmbë në anë të qafës. U ndjeva pak më mirë tani që dita si ta ndaloja dhe vazhdova edhe për disa hapa.

- Është shumë lart dhe frikë këtu sipër, sidomos kur merr tatëpjetë, - thashë akoma me frikë. – Ja, tani mund të them që kam ngarë edhe kalin, - vazhdova

pas pak dhe përdora komandën e ndalimit. Kali ndaloi dhe unë zbrita me kujdes, e lehtësuar që tashmë kisha vënë këmbët të sigurta në tokë.

- Falemnderit që më le të të abuzoja kalin. Ishte shumë kënaqësi! – i thashë kushëririt të Edit, siç i dhashë frerët e kalit.

- Kënaqësia ishte e gjitha e imja! – u përgjigj ai dhe mori kalin në shtëpi.

- Ç’kemi Xhuli? Si je sot? – përshëndeti Edi komshien e saj.

- Mirë, falemnderit; ditë e bukur sot, po shumë vapë. Çdo gjë që ndera vetëm dhjetë minuta më parë është tharë kockë tani, - u përgjigj duke mbledhur rrobat e fëmijëve të saj të vegjël nga teli për të bërë vend për ngarkesën tjetër. – Shoqja jote është kjo? – pyeti për mua.

- Po, - u përgjigj Edi. – Ka ardhur për ca ditë para se të fillojë shkolla.

- Mirëdita! – e përshëndeta me dorë nusen e bukur brenda gardhit. – Nga dialekti nuk duket fare si nga këto anë, - i thashë Edit paksa kureshtare.

- Sepse nuk është. I ke rënë në të; është nga Tirana, - pohoi Edi.

- Ç’bën këtu atëherë? Pse do ta linte e bije botës kryeqytetin për të jetuar këtu? – pyeta me çudi.

- Për dashuri, o derman, për dashuri! – u përgjigj Edi me dialekt të ekzagjeruar. – Ra në dashuri me djalin e lagjes sonë këtu. Ishte student i shkëlqyer dhe i premtuan fillimisht ta mbanin pedagog në universitetin nga u diplomua vetë, por me sa duket notat e shkëlqyera dhe bukuria nuk i mjaftuan dekanit aq sa i mjaftuan Xhulit. Kështu që ajo erdhi këtu pas burrit mbasi mbaruan shkollën.

- Me sa duket nuk kishte çfarë të bënte, atëherë, - thashë dhe e gjeta veten duke u menduar se çfarë do të kisha bërë në kushte të ngjashme. Më pëlqente fshati për një vizitë, po të jetuarit atje ishte një mendim i frikshëm që nuk do të doja as ta shkoja nëpër mend. – Nuk di ç’do të bëja po të më duhej të zgjidhja. Edhe për bursën them “shyqyr” që ma zgjodhi qeveria.

- Atëherë nuk do të të vinte keq të martoheshe me mblesëri si jot ëmë me tët atë, apo jo? – u përgjigj Edi me buzëqeshje në pritje të reagimit tim të fortë.

- Në asnjë mënyrë! – u hodha sikur të më kishte pickuar blea. – Pastaj, nuk është se më janë bërë rresht te dera duke më kërkuar për nuse, gjithsesi. Ime më e im atë nuk do të guxonin të zgjidhnin për mua. Nuk do ta mbanin dot përgjegjësinë, po të mos shkonte mirë, - u përgjigj pothuajse e gëzuar që nuk kishte mblesë për mua. – Po ti, do ta kishe sakrifikuar dashurinë për një jetë më të mirë? – pyeta Edin.

- Nuk e di. Çfarë e bën jetën më të mirë, në fund të fundit? Prioritete të ndryshme për njerëz të ndryshëm. Cave u mjafton dashuria, ca të tjerëve, jo. Është ndonjëri i lumtur me çfarë u bie për hise në jetë? – ma priti Edi dhe shtoi, - Xhuli e dinte që në fillim se nga ishte ai. Mund të kishte ndaluar para se të hynte shumë thellë.

- A mundej, pa? Për këtë nuk më është mbushur mendja akoma; qoftë me mblesëri apo me vetëvendosje, kemi vërtet gjë në dorë se me kë martohemi? Apo është disi e paravendosur nga rastësia apo nga planifikimi hyjnor? – mendova me zë.

Mami i Edit erdhi përjashta te ballkoni ku po llafoseshim dhe tha: “Darka është pothuajse gati, çupani. Hajde na bëni sallatën”.

- Zogjtë vijnë erë e shijshme! – thashë duke u ngritur për të ndihmuar.

- Bëra dhe përsheshin për ta shoqëruar! – shtoi mami i Edit.

- Prandaj po më vjen era kulaç mua? Po më duket si vit’i ri që tani, - ia ktheva. – Edhe mami im e bën vetë kulaçin për përsheshin. Fut edhe një monedhë në brumë dhe thotë që do t’i sjellë mbarësi gjithë vitin atij që e gjen në copën e vet, por më duket se qëllimi i vërtetë është që të na bëjë ne kalamajve ta ndihmojmë për përsheshin. E fut edhe ti monedhën në brumë si ime më? – pyeta mamin e Edit.

- Ëhë. Është traditë. Megjithëse më pëlqen arsyesimi yt për fillimet e traditës, nuk mendoj se ndonjë monedhë në lekun e sotëm mjafton të bindë fëmijët për të ndihmuar! – tha ajo buzagaz.

- E vërtetë, por tradita mund të jetë aq e hershme sa që monedhat aktuale mund të kishin qenë flori ose argjend, - debatova unë.

- Arsyetim me vend! – tha mami i Edit. – Një herë e një kohë, paraja ishte prej vërteti. Duket se çdo gjë është bërë gati për darkë. Hajde uluni të gjithë të hamë.

- Mirëserdhe në shtëpinë tonë, të të rrojnë prindërit dhe ju vaftë shkolla mbarë të dyjave! – uroi babi i Edit duke ngritur një dopjo rakië të bërë vetë.

- Falemnderit! – iu përgjigja si mysafire nderi që isha. – Rrofshi e qofshi me shëndet të dy për Edin dhe vëllezërit e saj! Siç thotë ime më: “U rritsh me nënë e me babë!”, kur uron një të porsalindur. Ajo mendon se ky është urimi më i mirë për një të porsalindur.

- Mirë thotë mamaja! – miratoi mamaja e Edit. – Mirë se na erdhe! Ne gëzohemi që Edi ka një shoqe të mirë si ty! – uroi ajo dhe të gjithë filluan të hanin darkën e mrekullueshme.

- Sa raki e mirë! Edhe im atë e zien vetë. Kur ishte ende në ushtri, e blinte rrushin, po kur doli në pension, filloi ta rriste rrushin vetë në atë pak oborr që

kemi para shtëpisë. Po ndonjëherë dallohej shija e helmeve, me të cilat kishte spërkatur hardhinë për ta ruajtur, dhe ato e prishnin rakinë, - kujtova.

- Rrushi është shumë delikat, - tha babi i Edit.

- Jam e sigurt që ti di shumë më tepër nga këto gjëra se sa im atë. Edi flet pa pushim se sa agronom i zoti dhe i talentuar je. Im atë, edhe pse u rrit me bujqësinë e bagëtinë, e la fshatin që në të ri dhe zbuloi që i pëlqente financa më tepër.

- Yt atë ishte njeri me mend që e la jetën e bujqësisë. Të paktën, unë ia arrita të hiqja fëmijët që këtej. Tani e kanë vetë në dorë të ecin mirë me shkollë dhe të gjejnë punë në industri, larg prej këtej, - vazhdoi babai i Edit.

Ndenja me Edin dhe familjen e saj edhe nja dy ditë të tjera, duke ngrënë fiq e manaferra në ato ditë të nxehta gushti në pritje të vitit të ri shkollor.

- Qenke ngritur herët sot! – tha Edi, kur më pa duke paketuar mëngjesin e fundit.

- Erdhi koha për mua të kthehem në shtëpi, e dashur. Duhet të bëhemi gati për shkollë. U kënaqa shumë. Falemnderit!

- E di. Do të shihemi së shpejti. Hajde të të përcjell te rruga që të sigurohem që gjete makinë, - tha Edi duke u bërë gati për të më shoqëruar.

- Ja ku po vjen një kamion. Mbase ndalon, - thashë duke bërë me kokë nga kamioni në ardhje me karrocerinë mbrapa plot me njerëz.

- Patjetër që do të ndalojë. Këtu ndalojnë të gjithë për të hedhur ca e për të marrë ca të tjerë, - shpjegoi Edi. – Mirupafshim dhe rrugë të mbarë! – më përshëndeti, siç u puthëm në faqe.

Pagova shoferin e kamionit dhe hipa mbrapa. U ula mënjane në stolin e drunjtë anash spondit me një shalë të mbledhur në stol dhe këmbën tjetër në shesh. Kryqëzova krahët mbi spondin dhe mbështeta mjekrën te dora, duke shijuar pamjen gjithë rrugës deri në shtëpi, ndërsa ëndërroja për fytyrën e dashur të Teos. Po përpiqesha t'i kujtoja veçoritë e fytyrës një nga një duke ledhatuar me gishtat e mi të gjatë përmes flokëve të tij gështenjë dhe duke i tërhequr mbrapsht për t'i zbuluar ballin. Pastaj i vura duart prapë mbi vetullat e tij kafe të errët duke ia larguar paksa nga njëra-tjetra, që e bëri të buzëqeshte menjëherë. I putha sytë, që më kishin munguar aq shumë gjithë verën, dhe zhvendosa buzët e mia poshtë në faqen e tij të majtë dhe më poshtë në gushë. Ma ktheu edhe ai të puthurën në të majtën e gushës sime

dhe vazhdoi në kërkim të buzëve të mia. E ndihmova t'i gjente dhe mbylla sytë për të humbur veten në krahët e tij të forta që më mbanin shtrënguar.

Zhurma e papritur e udhëtarëve, që i ranë kabinës së kamionit për të ndaluar, më zgjoi befasi nga ëndrra. Kamioni ndaloi në qytetin tim dhe unë u ktheva përpara në buzë të stolit për t'u ngritur. Papritur, siç u ngrita nga stoli, ndjeva pantallonat e ngecura në një kokë gozhdë të dalë nga vendi dhe dëgjova një zhurmë grisjeje nga mbrapa paliçetave të mia kadife bezhë. E tmerruar nga ideja që më ishin grisur dhe më kishte dalë mollaqja në shesh, e preka me dorë madhësinë e grisjes. U sigurova që ishte grisur me kënd të drejtë nga katër a pesë centimetra në çdo anë. U hodha nga kamioni dhe eca për një tridhjetë metra drejt një banje publike që dija, ndërsa përpiqesha sa të mundja të mbuloja vendin me çantën e shpinës. Edhe pse turpi i të ecurit në publik me pantallona të shqyera ishte i madh, frika e të futurit në banjë publike pa dikë tjetër për roje ishte edhe më e madhe. Peshova edhe një herë dy rrugëzgjdhjet dhe vendosa për më të rrezikshmen. Banja ishte nën tokë në të djathtë të trotuarit. Zbrita shkallëve për në banjën pa njeri dhe kërkova për një me derë. Asnjëra nuk kishte, kështu që u futa në njërën më larg nga shkallët e hyrjes dhe u përpoqa të hiqja pantallonat e grisura sa më shpejt që të mundja.

Siç kisha patur frikë, ngrita sytë dhe pashë një djalë të gjatë përpara banjës sime duke më vështruar. Shtanga për dy sekonda nga frika dhe m'u duk sikur më pushoi zemra. Djali më pa në fytyrë pastaj poshtë në të mbathurat e mia prej dantelle të zezë dhe shalët e zhveshura me pantallonat rreth kyçeve të këmbëve pastaj prapë në sy dhe tha: "Dua të flas me ty".

U ndjeva paksa e çliruar që foli edhe aq dhe mendova se ishte më i ri në moshë, gjë që s'e di pse më dha guximin ta shikoja drejt e në sy e t'i thosha: "Të vjen keq të presësh përjashta sa të vishem një herë?"

Ai pranoi me dy mendje, u kthye mbrapsht dhe zvarriti këmbët drejt shkallëve dhe përjashta. Mora frymë thellë, falenderova Perëndinë, që më kishte shpëtuar edhe një herë nga budallallepsja ime, dhe veshi një palë pantallona bluxhinse. Dola nga banja në trotuar dhe vazhdova rrugën në kalim pa ia vënë veshin të riut që po priste.

- Ndalo! – tha ai i inatosur që s'e përfilla. – E mban mend çfarë premtove atje poshtë?

- Nuk të vjen turp nga vetja? Mos pret ndonjë çmim për atë lloj sjelljeje? – thashë e vendosur tani që isha jashtë rrezikut dhe vazhdova të ec përpara.

- Ça të bëj unë ty tani. S'ke faj ti! Fajin e kam unë që të lashë të livadhisje! – tha dhe vazhdoi të ecte përbri meje.

- Çfarë pret prej meje? – e pyeta.

- Nga je? – pyeti me intonacion të ndryshuar, sikur të fillonte nga e para.

- Nga këtu, - iu përgjigja.

- Po më gënjen prapë.

- Nga e kuptove?

- Po të ishe nga këtu, do të të kisha parë më parë, - u përgjigj.

“Apo s’ të pëlqeka vetja, re!” – mendova dhe u përpoqa t’i mbaja përgjigjet e mia sa më të shkurtra e të prera. – S’para dal.

- Nuk është e mundur! – nguli këmbë.

- Boll me pyetje dhe më lër të qetë, atëherë!

Tundi kokën dhe tha: “Mirë, mirë, do të të gjej prapë herë tjetër”.

Fillova të vrapoj për në shtëpi dhe nuk më dilte nga mendja se nga çfarë ngushtice sapo kisha shpëtuar.

E pashë prapë të nesërmen, kur kisha dalë nga tregu me babin. Më nguli sytë dhe unë qesha me vete ngaqë më erdhi mirë që më pa me babin si vërtetim që isha vërtet nga ky qytet. *Ja që nuk i njihke të gjitha gocat e qytetit!*

KAPITULLI VIII

SËRISH NË SHKOLLË

Dita e shumëpritur e fundit të gushtit ishte pothuajse në prag. Një natë më parë, paketova valixhen e re që solla nga Greqia me çdo gjë që më duhej për një muaj. Paketimi për këtë stinë të vitit ishte gjithmonë me spec. Shtatori ishte përgjithësisht i nxehtë edhe për plazh, por mbrëmjet ishin të freskëta. Mirë që kisha blerë valixhen më të madhe që më mbante xhepi dhe e mbusha pothuajse me çdo gjë timen, përveç teshave të dimrit. Kisha shumë më tepër tешa këtë vit! Kisha ëndërruar për këtë gjatë gjithë fëmijërisë sime; provoja teshat e dimrit çdo verë dhe të verës herët në pranverë. Isha e para nga vajzat e lagjes që vishja fustan basme me çorape të bardha deri te gjuri, edhe pse bënte ende freskët dhe rrezikoja të më zinte gripi i pranverës së hershme.

Kthimi në Tiranë kishte qenë një udhëtim që mezi e prisja çdonjërin prej katër viteve të shkuara e aq më tepër këtë radhë. Ishte viti i fundit në kryeqytet dhe shpresoja që atje po më priste një person i shtrenjtë për mua. Ndërsa paketova bluzat dhe sapunët që i kisha sjellë nga Greqia po pyesja veten nëse i mungoja aq sa më kishte munguar ai gjithë verën. Mosdija më bënte merak në të njëjtën kohë. A do të vinte prapë të më kërkonte vallë? E kisha nxitur gjithmonë të më linte. “Më mirë herët se sa vonë!” – mendoja, edhe pse shpresoja të mos ma vinte veshin dhe të kthehej.

Sapo mbarova së paketuari, dëgjova mamin të më thërriste nga oborri. Dola përjashta për t’iu përgjigjur dhe pashë shoqet e mia, Inën dhe Ritën, të pispillosura për xhiron e mbrëmjes. – I bëre gati? – më pyetën. – Ne vendosëm të dilnim një xhiro dhe kemi ardhur të të marrim edhe ty me vete.

- Sapo mbarova! – thashë e gatshme për të dalë për një pushim të vogël dhe ajër të freskët. – Një minutë sa të ndërrohem, - shtova dhe, me një kërcim në korridor, arrita te dera e dhomës së majtë për t’u ndërruar.

Vesha pantallonat bluxhinse të ngushta me shtrat të shkurtër, një bluzë pambuku të bardhë me vija spicë të holla të kuqe dhe me jakë të ngrirë, që

e futa në pantallona si dhe një palë këpucë të kuqe doku të sheshta që sapo kisha sjellë nga Greqia.

- Me autobus apo me tren do të ikësh nesër? – pyeti Ina.

- Po them të iki me autobus. Po ti? – e pyeta.

- Me autobus. Them të kap një herët në mëngjes, - tha Ina. – Dëgjova që ka shumë lëvizje më vonë.

- Ikim bashkë, atëherë. Në orën gjashtë ikën i pari? – e pyeta.

- Po. Po Herkuli do vijë? Mbase na zë ndonjë vend! – pyeti Ina për fqinjin tim dhe shokun e gjimnazit.

- Nuk e di. Do ta pyes po e pashë sonte. Vjen shpesh tek ne dhe e ka zakon të përshëndesë time më, sidomos që kur humbi t'ëmën. Ajo e do shumë dhe ai e di! – thashë me buzëqeshje.

- Ajo ndoshta shpreson ndonjë gjë për ju të dy! – tha Rita buzagaz dhe shkeli syrin.

- Më duket se mami e mori vesh që nuk kishte shanse për të ndodhur, kur i solli të dashurën e vet për t'i prezantuar. Unë as që isha aty atë ditë. Mami nuk më ka thënë kurrë ndonjë gjë drejtpërdrejt, por mendoj se do të kishte dashur me gjithë qejf të kishim qenë më tepër se vetëm shokë të mirë. E vura re që ishte pak xheloze për të dashurën edhe pse i pëlqeu shumë. Dukej si xheloz e llojit “Pse të mos ishte ime bijë?”. Prindërve të mi nuk do t'ua nxinte goja kurrë fjalët “Shko, dil me të!” për këdo që të ishte fjala. Është rregull i pashkruar i llojit “mbaro shkollën një herë pastaj fejuhu!”, a thua se unë i kam gjërat me sustë këtej.

- Eh! Njësoj është dhe me të mitë! – miratoi Rita.

- Do vajtur do fjetur herët sonte, nëse duam vërtet ta kapim atë autobusin e gjashtës nesër!

Siç e kisha parashikuar, kur arrita në shtëpi, Herkuli ishte në oborr duke folur me prindërit e mi.

- Nga bredh ti natën kaq vonë? – më pyeti duke u hequr si vëlla i madh, të cilit ia ktheva buzagaz: “Sa për vëllezër të mëdhenj, më dalin ata që kam për t'u dhënë llogari, po nuk do të më vinte keq të kisha dhe një të vogël, që ta urdhëroja dhe ta quaja ‘më mirë m... se i vogël!’, siç më kanë thirrur mua gjithë jetën. Erdhën Ina me Ritën të më merrnin për një xhiro të freskët. Dole edhe ti ndopak?”

- Dola. Takova ca nga klasa, - u përgjigj Herkuli duke iu referuar shokëve tanë të shkollës së mesme.

- Unë e Ina po themi të ikim me autobuz nesër në mëngjes. Po ti?

- Po. Si shumë të tjerë. Treni është bërë pleh tani dhe do gjithë ditën. Po

vij të të thërras në mëngjes dhe ikim bashkë për te autobusi.

- Mirë atëherë, - iu përgjigja, - siç e menduam. Unë e Ina po shpresonim mbase na ecte nesër dhe na zije një vend për t'u ulur të tre.

- T'shikojmë. Mund të ketë shumë njerëz. Sa më shpejt të ikim, aq më shumë shans do të kemi. Po iki dhe unë të fle tani. Natën e mirë!

- Natën e mirë! – u përgjigja dhe iu ngjita shkallëve me vrap. U futa në krevat dhe hodha çarçafin mbi kokë për të fshehur ngëzëllimin për ditën e madhe që kisha pritur gjithë verën.

Të nesërmen në mëngjes, unë e Herkuli shkuam për te autobusi dhe pamë Inën mes një turme të madhe, që po priste ashtu siç e kishim marrë me mend një natë më parë.

- Mirëmëngjes! – përshëndeti Ina.

- Uaaa! Nuk më besohet që gjithë ky milet u zgjua kaq herët vetëm për të vajtur në shkollë! – shpreha me habi të shtirur duke i buzëqeshur Inës. – Me sa duket nuk qenkam vetëm unë që mezi po prisja një vit tjetër të bukur “studimesh”! – pothuajse i pëshpërita shoqes së dhomës nga frika se më dëgjonte Herkuli.

Sapo mbërriti autobusi dhe hapi derën, Herkuli u shty brenda dhe na zuri vend të treve. Me kohë, edhe unë e Ina u futëm në autobusin e ngjeshur. Nuk kishte vend as për të ndenjtur më këmbë midis sediljeve. Edhe pse bileta e autobusit ishte dhjetëfishi i asaj të trenit, shumica e kishin më mirë të rrinin më këmbë gjithë rrugës për Tiranë se sa të udhëtonin me tren. Autobusi lëvizte shumë më shpejt dhe kishte ajër të freskuar. Dhuna dhe rrëmuja pas rënies së qeverisë së vjetër kishte shqyer të përbrendshmet e trenit dhe kishte thyer shumicën e dritareve.

Tri orë më vonë, unë e Ina i uruam shëndet shokut tonë dhe filluam të tërhiqnim valixhet në rrotat e vogla nga stacioni i autobusave në Tiranë të Re deri në konvikt, ku morëm çelësat e dhomës së re, çarçafët dhe batanijet. U futëm në dhomë në katin e tretë, në të njëjtën anë si një vit më parë dhe filluam të rregullonim krevatët. Hapa batanijen e hirtë prej leshi mbi dyshekun e vjetër të pluhurosur e çarçafin e bardhë mbi të dhe i palosa me kujdes midis dyshekut dhe sustës së hekurt. Pastaj hapa çarçafin tjetër dhe batanijen rozë të pambuktë të varur në anët e krevatit. Palosa rreth dyzet centimetrat e sipërm të çarçafit mbi batanijen, pastaj futa jastëkun në këllëf dhe vendosa të shtrihesha në krevat për disa minuta. Udhëtimi ishte i gjatë e i lodhshëm dhe krevati po më ftonte.

“Arrh!” – u hakërrova me vete sapo u shtriva. Kisha harruar fare që duhej të përshtatja gjatësinë e njëres prej këmbëve të krevatit. Krevati lëkundej sa

herë ulesha, lëvizja ose kthehesha në anë duke bërë një trokitje të bezdisshme metali mbi beton, që do të luante mendsh jo vetëm mua dhe shoqen e dhomës, por edhe vajzat poshtë po të mos i bëja “marifetin”. Mora një copë letër, e palosa në formë pyke dhe e vura poshtë njëërës prej tubove prej hekuri që shërbente si këmbë krevati nga ana e murit.

Fillova të nxirrja teshat e mia nga valixhja për t’i varur në dollapin e gjatë pranë hyrjes, kur dëgjova një trokitje dhe hapa derën.

- Si jeni goca? – pyeti Vilma me të hyrë në dhomë, gjithë kënaqësi që po shiheshim sërish.

- Mrekulli! Po ti? Mirë ia kalove me pushimet? – e pyeta duke e përqaftuar.

- Po, po ti? Mirë ia kalove në Greqi? – pyeti Vilma.

- Ishte qejf, po jo dhe aq sa t’ia vلente të prishja pushimet e tua tek unë! – u përgjigja duke u ndjerë ende fajtores për të. – Udhëtove gjëkundi tjetër? – e pyeta.

- Jo, po pata mysafirë! – tha ajo dhe më shkeli syrin.

- Erdhi deri në Gjirokastër?! I çmenduri!! – u shpreha me çudi duke u ndjerë edhe më fajtores që e kisha lënë shokun e klasës duke pritur për të dashurën e tij të re dhe duke vrarë mendjen për zhdukjen e saj.

- Po. Ia filluam prapë mu atje ku e lamë në Fier! – u përgjigj Vilma pothuajse me pëshpërimë.

- Ju lumtë! Sa mirë që doli mbarë, - thashë dhe vazhdova, - Në të njëjtën dhomë e me të njëjtat shoqe që ishe vjet do të jesh edhe sivjet?

- Edhe për këtë erdha! – u përgjigj Vilma. – Po shpresoja mbase rregulloheshim me ju të dyja dhe Edin këtë vit. Shoqet e dhomës sime të vjetshme janë rregulluar me shoqërinë që zunë vjet. Po sikur unë e Ina të rrimë bashkë dhe ti me Edin bashkë?

- Për mua s’ka problem, po të jetë Ina dakord. Do t’i them edhe Edit. Nuk besoj të ketë ndonjë kundërshtim as ajo, - u përgjigja dhe pashë nga Ina për miratim.

- Edhe unë dakord jam, në rast se unë rri në këtë dhomë, - tha Ina duke buzëqeshur disi me ndroje për kushtin e saj.

- Mirë atëherë, po shkoj të shoh mos ka ardhur Edi dhe ta pyes para se të marrë prapë edhe ajo shoqet e vjetshme, - thashë unë dhe dola nga dera drejt kujdestares së godinës, ku vajzat po merrnin shtrojat.

- Edi! – thirra nga larg duke vënë në provë akustikën e korridorit, për të cilën më kishte marrë malli gjithë verën. Edi ktheu kokën që nga radha dhe ma bëri me dorë, shoqes së vet çakalloze, që e donte si motër.

- E gjen dot kush ka nevojë për dhomë tjetër këtë vit? – e pyeta pasi u

përqafluam dhe u puthëm në faqe dy-tri herë.

-Ti? – ma ktheu Edi pothuajse e ngacmuar nga zbulimi i saj.

- Vilma kërkoi të rrijë në dhomë me Inën dhe unë premtova që do të të pyesja ty për të ndenjtur bashkë. Si thua? – pyeta plotësisht e bindur për miratimin e shoqes sime.

- Vërtet?! Shkëlqyeshëm, sidomos në qoftë se nuk e ke problem të ngjitesh një kat më sipër çdo ditë! – tha Edi.

- Unë hidhem nga kati i katërt dhe qëndroj në këmbë për ty, kur thotë im atë! – thashë me shaka dhe shtova, - I bëj lart e poshtë me një frymë. Pse kot i kam gjithë këto shalë lejleku? – thashë e gëzuar nga marrëveshja e re. I doja që të treja shoqet e mia dhe isha e kënaqur që rregullimi i tyre më vinte mbarë edhe mua.

Edi mori gjithë shtrojat e saj dhe çelësat nga kujdestarja dhe u ngjitëm lart.

- Po shkoj edhe unë të marr çarçafët dhe rrobat e mia që t'i sjell lart, - thashë dhe u ktheva në korridorin e katit të tretë drejt dhomës sime.

M'u deshën disa rrugë për të lëvizur gjithë sendet e mia dhe për t'u rivendosur në dhomën e re në katin e katërt.

- Do parë pamja e re nga dritarja jote, - thashë dhe shkova përmes dhomës për tek dritarja. – Ulliri duket më i bukur dhe më afër prej këtej lart, - thashë për ullirin e madh nën dritare. – Vë bast që Teo do të dukej më i shkurtër po të vinte, - vazhdova duke hapur si me marifet bisedën për të dashurin tim.

- Sigurisht që do të vijë. Ku do të mbytet tjetër? – tha Edi duke më dhënë pikërisht përgjigjen që doja të dëgjoja.

- Po ku është, atëherë? – pyeta. – Po ta kishte marrë malli për mua, a nuk do të kishte ardhur deri tani?

- Mbase do edhe ai të marrë dhomën një herë! Këto do të dëgjoj unë nga ty gjithë vitin? – pyeti Edi.

- Më fal që po qahem! Nuk t'i thashë të gjitha që ndodhën këtë verë, - mërmërita si e zënë në faj që nuk i kisha thënë shoqes asgjë nga udhëtimi im në vendlindjen e Teos.

- Çfarë? – pyeti Edi me kërshtëri dhe u ul gati për rrëfimin tim.

- I vajta te shtëpia një ditë para njërit prej provimeve dhe e kalova gjithë natën me të në shtëpinë e tij.

- Uuuuuu, ti ke luajtur mendsh! Po pastaj? – pyeti Edi.

- Në fillim u duk i kënaqur që më pa, pastaj një çikë më pak kur i thashë që isha me ato.

- E çë pastaj? Nuk ka të thotë asgjë! Seksi është i rëndësishëm për burrat! Çdo mashkull do të ishte zhgënjyer, pavarësisht nëse të donte apo jo. Ndoshta mendoi se nuk do t'i dilte gjë. E kishte gabim? – buzëqeshi Edi dhe më shkeli syrin.

- Ëhë, - ia ktheva buzëqeshjen, - gjithë natën!

- Epo çfarë nuk po kuptoj unë, atëherë? – pyeti Edi.

- Ti asgjë, unë po! Unë jam ajo që nuk po kuptoj diçka. Pse më vjen turp sa herë e bëjmë? Pse më dukej sikur i gjithë qyteti po më shikonte me gjykim? Nuk e ndjej akoma nevojën për ta bërë, po nuk mund ta ndaloj, sidomos tani që nuk kam asgjë për të ruajtur, nga frika se mos i lëndoj ndjenjat ose krenarinë ose e humbas fare. Unë do të isha e lumtur thjesht duke qenë me të. Ndoshta po bëhem qaramane, por u ndjeva një çikë e thyer kur më la të kuptoja që më mirë mos të kisha vajtur në atë gjendje. M'u duk sikur e vetmja arsye që më ftoi atje apo që ishim bashkë ishte për seks. E di që ti ndoshta mendon që nuk i hyra kësaj marrëdhënieje shumë seriozisht, por ja që tani nuk mund të mos pres dashuri.

- Burrat nuk funksionojnë ashtu. Nuk mund ta çosh te kroi dhe mos ta lësh të pijë! Sidoqoftë, mendoj që po e analizon për vdekje. Zhgënjimi i tij që të kishte atje, por nuk të kishte “plotësisht” nuk do të thotë që nuk të do. Madje do të thotë që i duhej të ushtronte shumë përmbajtje dhe kontroll, - u përpoq Edi për të më siguruar që gjithçka do të dilte për mirë.

- Jam një çikë e lodhur nga të paditurit se çfarë ndjen ai për mua. Është shumë i vështirë për t'u lexuar. Është fjalëpak dhe i mbyllur si guaskë! – u ankova.

- Unë kujtova se kjo të tërhiqte tek ai që në fillim. Pa llafe, vetëm veprim dhe llogjikë e ftohtë, - më kujtoi Edi mahnitjen time pas misteriozes.

- U, po! – buzëqesha. – E kisha harruar fare këtë. E gjeta si breshka te nallbani. Apo jo? Mhhh! Si do ta marr vesh? – u qava përsëri.

- Boll me të qarat tani! Bëje kur të kesh arsye, se hë për hë nuk ke! Unë do të vë rrobat nëpër vende tani, ndërsa ti rri e prite në dritare.

- Më fal! E bëra prapë! Të premtoj që nuk qahem më! – thashë dhe u kujtova që Ina ma kishte tërhequr vëmendjen për këtë disa herë.

- Njoh një vajzë nga shkolla ime e mesme që e mori vesh sa e donte i dashuri i saj sapo i dha lajmin e fejesës me një burrë tjetër që ia bëri familja. Ndonjëherë, duhet ta humbasësh diçka para se t'i dish vlerën! – tha Edi duke filluar të shpaketonte mbi krevatin e saj.

- Uooo! Po ai çfarë bëri? – e pyeta e tërhequr nga tregimi.

- Iu lut me lot në sy që mos ta linte dhe i propozoi për martesë vetë! – vazhdoi Edi.

- Po ajo, ç'e bëri atë tjetrin?

- I tha të vërtetën dhe e prishi fejesën. Pastaj u martua me dellin e pavendosur që donte dhe vajtën të jetonin në Gjermani bashkë.

- E di ti që ky shpaketimi duket si ide e mirë tani? Koha kalon më shpejt kur je e zënë! – thashë dhe u largova nga dritarja. Nuk më dilte nga mendja përfytyrimi i një djali të ri me lot në sy duke iu lutur vashës që të ishte e tija përgjithmonë dhe përqesha: “Hëh, nuk e imagjinoj dot fare! Nuk ndodh gjallë në botë që Teo të qajë për mua!” – thashë duke uruar për të kundërtën.

Filluam të dyja të shpaketonim dhe të shikonim veshjet e reja të njëra-tjetrës, pastaj me kujdes rreshtuam këpucët dhe gjithçka kishim sjellë. Nxorrëm ushqimet që kishim prurë nga shtëpia dhe i vendosëm të gjitha mbi tavolinë.

- S’ka si dita e parë nga shtëpia, ë? Po më shpohet hunda nga gjithë këto ushqime; mezi po pres të ha! – thashë me padurim.

- E di! Sa keq që na duhet t’i hamë njëherësh se përndryshe prishen! – tha Edi. – Çfarë të paktoi mamaja? – pyeti ajo.

- Unë e di që ti mendon se meqë jetoj në qytet nuk mund të sjell ndonjë gjë për të qenë, po ja që kemi edhe ne pula e vezë. Këto domatet e stërmëdha janë nga bahç’e tim eti, për të cilën kujdeset sikur e ka djalë të vetëm. Ky është racioni i gjalpfit të familjes për gjithë shtatorin dhe mami ma dha mua të gjithë! – thashë duke treguar pakon njëqindgramëshe të gjalpfit. – Po ty, çfarë të dha me vete?

- Unë mora një zog dhe ca vezë të ziera si ty, ca ullinj, vaj ulliri dhe një kulaç. Çdo gjë përveç zogut duhet të na zgjasë për një dy ditë, - u përgjigj Edi duke nxjerrë pulën e skuqur nga çanta.

U ulëm te tavolina në cepin e djathtë të dhomës pranë dritares dhe sa kishim filluar të hanim së bashku, kur dëgjova fishkëllimën tipike të Omarit nga larg. Ishte akoma njëqindpesëdhjetë metra të mira larg dritares sonë, po nuk gjendej tjetër si fishkëllima e tij dhe unë e njoha në çast. U përkula te dritarja e hapur dhe pashë nga lart flokët e tij bjond, të prera si rreth e rrotull një tasi, duke iu afruar dritares sime të vjetër. Përtypa pulën në gojë, u ngrita në këmbë dhe u mbështeta mbi parvazin e dritares.

- Më gjete duke ngrënë. Të dashka vjehrra! – i bërtita nga dritarja.

- Të gjej gruan unë një herë, pa vjehrra...! – ma priti ai nga poshtë.

- Ke kohë plot. Po qysh t’ia bëj unë?! – buzëqesha nga kati i katërt.

- A nuk jam më i madh se ty unë? – u përgjigj Omari.

- Uuu, për një ditë bën ti? – ia ktheva. – Kur vjen puna te biologjia, e jotja është orë hapësire, ndërsa e imja tokësore. Njëzet e dy vjet në orën tënde janë shumë më pak se sa i njëjti numër në timen.

- Ee, po tani jam unë ai që po i këputet qafa me sytë përpjetë nga hapësira! – ma priti Omari duke qeshur.

- Ndoshta teoria e orës sime ka vend vetëm për sa kohë që je në shkollë.

Tani që e mbarove, ti dhe ora jote jeni kthyer në tokë. Imja, nga ana tjetër, nuk e ka lënë tokën fare dhe kam edhe një vit për të mbaruar.

- Edhe ti do ta kishe mbaruar, po të mos e kishe zgjedhur kaq të vështirë e të gjatë! – u përgjigj Omari.

- Më pëlqen e vështirë dhe e gjatë, megjithëse më zgjodhi, nuk e zgjodha!

- Unë sapo erdha nga mensa, - tha Omari.

- Ku po ha këtë muaj? – e pyeta.

- Te njëshi. Është më e vogël dhe ushqimin e ka më të mirë. Po ti?

- Nuk i kemi blerë latat akoma. Ndoshta e bëjmë nesër, - iu përgjigja.

- Do të vish poshtë të rrimë pak? – pyeti Omari.

Ktheva kokën nga shoqja e dhomës dhe e pyeta: “Do të dalim poshtë për ca gallata me Omarin?”

- Pse jo? Mirë do na bënte një pushim i vogël nga gjithë pastrimet dhe shpaketimi, - miratoi Edi.

- Këtu ke qenë gjithë verës? – e pyeta Omarin kur u ulëm me të te stolat e cepit jashtë godinës sonë.

- Po. Kam punuar me përkthime aty-këtu me amerikanët. Paguajnë shumë mirë.

- Lum ti! Mbarove edhe me tensionin e provimeve dhe gjithë shkollën tani! – thashë me zili. – Megjithëse, gjynah të qahem që kam sebeb për të ndenjur edhe nëntë muaj të tjerë aty ku janë shoqëria, qejfi dhe mbrëmjet.

- Të dukem sikur tensionohem për ndonjë gjë unë ty? – ma ktheu Omari duke qeshur.

- E, xhanëm! – thashë me ngërdheshje. – Pastaj një djalë kaq i zgjuar sa ti, nuk e ka për gjë fare të mësojë anglishten, - shtova.

- Kollaj për juve se e filluat të vegjël! – ndërhyri Edi. – Në shkollën time mësohej vetëm rusisht dhe unë e urreja me gjithë shpirt! – shtoi.

- Nuk kam takuar akoma ndonjë që i pëlqen të mësojë rusisht. Edhe Inës rusisht iu desh të mësonte të shkolla ku pothuajse më transferuan edhe mua në klasë të pestë. Sapo dëgjoi im atë që shkolla ime po jepte anglisht atë vit, e ndaloi transferimin menjëherë. I jam shumë mirënjohëse për këtë! Më duket se Ina do ta fillojë anglishten vetë këtë vit. Dëgjoj që po ngrihen plot kurse private gjithandej nëpër qytet. Unë mendoj se ia vlen edhe koha edhe shpenzimet, qoftë edhe sikur ta bësh thjesht për të kuptuar vargjet e Uitni Hjustonit! – thashë si në ëndërr.

- Edhe unë e kam menduar. Më duket si një detyrë e pamundur mbi gjithë ato që kemi për të studiuar vitin e fundit. Ndoshta pasi të diplomohem, - tha Edi dhe u ngrit nga stoli. – Jam ngritur që në pikë të mëngjesit sot; po më

mbyllen sytë, - vazhdoi.

- Edhe unë, - thashë e u ngrita. – Natën e mirë, Omar! Shihemi vërdallë! – thashë dhe ndoqa shoqen time lart për në dhomë duke u përpjekur të fshihja zhgënjimin tim që Teo nuk kishte ardhur ende të më takonte.

Por sapo hymë në dhomë, më luajti zemra nga vendi kur mendova se dëgjova atë zë të butë nga poshtë dritares duke më thirrur emrin.

- Dëgjove gjë ti? – pëshpërita e shtangur në vend duke pritur për një thirrje të dytë nga jashtë.

- Dëgjova. Luaj vendit! – u përgjigj Edi dhe më shtyu përpara drejt dritares.

Bëra dhe një hap tjetër dhe përfundova e mbështetur tek parvazi. Pashë poshtë dhe m'u gufos zemra me gëzim tek shihja Teon duke parë lart drejt dritares sime të vjetër. Shtriva krahun e gjatë dhe valëvita dorën e majtë.

- Shyqyr që e kam dhomën e re nga e njëjta anë e godinës! – thashë me zë të mekur nga frika mos tërhiqja vëmendjen e fqinjëve kureshtarë.

- Hej paske lëvizur! – u përgjigj Teo ndërsa drejtoi shikimin nga dhoma ime e re dhe më bëri shenjë me dorë të zbrisja poshtë.

- Ai është! Erdhi! – thashë me zë të dridhur siç u ktheva me shpinë nga dritarja duke kërkuar gjithandej.

- Mjaft u vërdallose si pordha nëpër brekë dhe ik! – tha Edi po aq e gëzuar. – Të thashë që do të vinte! – shtoi me ngrohtësi sikur t'i kishte ndodhur asaj vetë.

- Po kërkoj dhuratat që i solla nga Greqia! – thashë dhe u kujtova që ishin akoma në valixhe brenda dollapit e nxitova t'i merrja.

- Çfarë i ke sjell, moj? Sapun e ke atë? – pyeti Edi kur pa çdo gjë që vura mbi krevat.

- Po! Merri erë! Nuk ka aromë të mrekullueshme? Dua të më kujtojë sa herë të lajë sytë! – shtova.

- Jo, jo. Mos i jep sapun! – tha Edi me alarm.

- Pse?! – pyeta papritur, e palëvizur në mes të dhomës.

- Nuk e di se ç'thonë për këtë? Të tretet dashuria si sapuni në ujë! – shpjegoi Edi duke cituar një tjetër nga bestytnitë.

- Mo na rrokani kokën, tani! Edhe këtë nuk e kisha dëgjuar ndonjë herë! – iu ktheva duke qeshur dhe fillova të fus gjithçka në çantë. – Atëherë, do t'i them mos ta lagë. Ika! – i thashë dhe dola nga dera.

- Bëfsh qejf! – u përgjigj Edi nga brenda.

KAPITULLI IX

FIKUR ...

~~Mirëmbërma!~~ përshëndeta pothuajse me përshpërimë, kur u takuam nën ullirin poshtë dritares sime atë natë të ngrohtë shtatori.

- Mirëmbërma! – u përgjigj Teo po aq qetësisht dhe iu shfaq gropëza në faqe bashkë me buzëqeshjen e dashur.

- Uaa! Flokët! Sa të janë zgjatur! – thashë me habi për pamjen e re të Teos.

- Të pëlqejnë? – pyeti Teo siç filluam të ecnim tatëpjetë, në shtegun tonë të zakonshëm për te parku matanë rrugës kombëtare.

- Më pëlqejnë. Tani dukesh si këngëtar rroku. Sa të drejtë, sa të shkëlqyeshëm dhe sa erë e mirë mbajnë! I ke dhe më të gjata se të miat tani.

- Aroma duhet të jetë nga shampoja që më solli babi nga Greqia, ku, meqë ra fjala, nuk arrita dot të shkoja këtë radhë. Po ti ku u fshehe gjithë verën?

- Ti nuk ia dole dot, kurse unë po! Gixili, gixili, unë vajta në Greqi! – këndova fjalinë e fundit.

- E, de, e, e mora vesh që vajte. Më tha ime më.

- Çfarë të tha? Të ngacmoi? – e pyeta tmerrësisht kureshtare për ndonjë mbresë nga telefonata ime e parë me mamanë e tij.

- Jo. Tha vetëm që më kishte marrë në telefon një vajzë dhe unë i thashë që je një shoqe. Po ku vajte pasi u ktheve nga Greqia? Të erdha vërdallë shtëpisë duke të kërkuar, po ti nuk ishe.

- Vërtet?! – pyeta pa përmbajtur dot gëzimin. – Kisha një javë të tërë derisa të na fillonte shkolla, kështu që ia mbajta nga Edi për ca ditë. Sa ndenje te halla në Fier?

- Ndenja disa ditë. Halla po vriste mendjen çne gjithë kjo dashuri e papritur nga nipi. Më duket se e kuptoi që kisha diçka, sidomos kur i vajta për herë të dytë.

- I vajte dy herë? – qesha nën vete.

- Po. Një herë në fillim, para se ta dija që më kishe lënë e më pas kur mendova se ishe kthyer, - tha Teo pothuajse duke varur turinjtë, siç u ulëm në bar anës rrugicës së fshehur mirë nga gjelbërimi i halorëve.

- Oooo! Të mori malli ty?! Të solla diçka të vogël që të të sjell humorin në vend, - i thashë duke nxjerrë gjithçka i kisha sjellë nga Greqia.

- I more të gjitha këto për mua? Me çfarë parash? – pyeti me çudi duke shpalosur bluzat.

- Për ty! Kunata dhe vëllezërit më linin të mbaja reston sa herë që më dërgonin në dyqan për ushqime. Bleva këtë çantën për vete dhe një nga komshinjtë, ai që më rregulloi vizën për të kaluar, më dha këtë radion e lezetshme, vetëm se i mbaruan bateritë. Është kot tani, meqë nuk e kam idenë se ku mund të gjej bateri të tilla, - thashë.

- Pa dale? – pyeti Teo ndërsa hapi kapakun e folesë së baterive dhe shtoi, - Kam parë bateri të tilla. Do shikoj mbase të gjej ca.

- U, rrofsh! Të pëlqejnë bluzat? Më pëlqen si të shkon e kuqja, por mendova mos të pëlqente bluja më tepër, kështu që t'i mora të dyja, - i thashë duke ia matur përpara kraharorit nga supi në sup.

- Po pra, kujton se do t'ia hedhësh me kaq? Me dy bluza do të më gënjesh për zhgënjimin e një vere të tërë? – pëshpëriti Teo duke më shpuar sytë me shikimin e tij dhe u afrua përpara për buzët e mia.

Ma mbështolli trupin me krahët e tij të fortë dhe ma shtrëngoi fort pas të tijit.

- Të kam sjell edhe një sapun, - thashë dhe rrudha sytë para se të na puqeshin buzët, megjithëse, në të vërtetë ajo që doja t'i thosha ishte “Edhe mua më mori malli për ty!”.

Teo shpërtheu në të qeshura dhe u shtri me shpinë pas barit, duke më tërhequr mbi kraharorin e tij. I ndjeva karaharorin që hidhej nga e qeshura dhe mora frymë thellë sikur ta thithja këtë çast brenda meje dhe ta mbaja aty përgjithmonë. Ma mori kokën me duar, më vështroi drejt e në sytë e qeshur dhe më afroi për puthjen që kisha ëndërruar për më se dy muaj. U kthye anash që të mbështetej në bërryl dhe të më mbante kokën me një dorë, ndërsa ledhatonte me tjetrën gjirin tim të vogël, belin e më poshtë në anë të vitheve. Rrëshqiti gishtat poshtë në kofshë dhe ngriti anën e fundit.

- Ngadalë! – i pëshpërita duke i kapur dorën në lëvizje, në përpjekje të lehtë për të ngadalësuar gjërat, në mos për t'i ndalur fare, dhe Teo u përgjigj me bindje.

- Kur ike për në Greqi? – më pyeti Teo më pas.

- Të dielën pas provimit të fundit. Shkova te Vilma për disa ditë pastaj e solla te shtëpia ime menjëherë para se të më telefononte im vëlla që t'i shkoja për vizitë. Kështu që Vilmës së shkretë iu desh të kthehej që të nesërmen.

- Hëh! Unë kam qenë atje të shtunën para dhe të hënën pas së njëjtës të dielë. Vendosa të kthehesha në shtëpi të shtunën në darkë vonë dhe u ktheva për të tentuar të hënën në mëngjes. Nuk mendova se do t'ia dilja të dielën.

- E pabesueshme! Ishim kaq afër dhe kaq larg. E imagjinon dot të më shikoje nga mbrapa kangjellave të gjata të portës? Rrezik nuk do të guxoja fare të të flisja. Kam qenë me mamin gjithë ditën.

- Unë do të të kisha folur. Nuk u flet shokëve ti kur je me mamin? – pyeti Teo, ulur mbas meje me gjunjë të përkulur në secilën anë të brinjëve të mia dhe krahët e tij rreth belit tim.

- U flas, u flas! E xhanëm, mund të isha sjellë sikur ishim thjesht shokë, por do të isha skuqur dhe ime më nuk do ta kishte problem fare të merrte me mend lloj-lloj skenarësh. Ajo më pyet për çdo shok, me të cilin më shikon të shoqërohem. Më duket se të dy prindërit e mi po i kap ankthi që akoma nuk kam gjë në vijë, - thashë me frikë që kjo bisedë do të më çonte ku nuk isha gati të shkoja ende.

- Po ty? – pyeti Teo.

- Mendoj se pajtohem me ta. Nuk është se po rinohem dhe besoj se është koha që të bëj diçka për këtë, - iu përgjigja e befasuar që i kisha thënë të gjitha këto me zë.

- Çfarë, për shembull? – pyeti Teo duke e konsideruar edhe këtë si një nga tentativat e mia të kota për ta shtyrë larg vetes.

- Për shembull, të fejohej, - i thashë, e çliruar që nuk e kisha përballë në atë çast.

- Me kë, më? – pëshpëriti Teo me mjekrën e mbështetur mbi supin tim të majtë.

- Njoh një që është i gatshëm. Boll t'i them fjalën, - iu përgjigja me frikë se mos Teo ia thithte emrin me telepati që nga mendja ime.

- Si e ka emrin? – vazhdoi të luante me mua, siç e parashikova.

- Nuk ta them! – iu përgjigja disi e bezdisur që Teo ende vazhdonte ta merrte planin tim me të qeshur. – Pse do t'ia dish emrin?

- Mbase e njoh. Thjesht për t'u siguruar që të shkon për shtat.

- Megjithëse shqetësimi yt është shumë prekës, mendoj se është më mirë për të dy ne që të mos e dish! – iu përgjigja paksa me ironi.

- Nuk jam akoma gati ta hedh këtë hap! – tha Teo pas një heshtjeje të gjatë e të sikletshme duke e kuptuar se e kisha seriozisht këtë radhë.

- E di! E kam ditur që në fillim dhe nuk kam pritur kurrë ndonjë gjë të ndryshme prej teje. Por ka ardhur koha që ta përdor trurin edhe unë dhe e kam shumë të vështirë ta bëj këtë për sa kohë që vazhdoj të takohem me ty, - thashë duke shtrënguar nofullat për të përtypur lotët dhe e çliruar që ende isha me kurriz prej tij.

Teo mbeti i heshtur edhe për pak kohë dhe pastaj pëshpëriti: “Të dua!”.

Isha djegur nga dëshira për t’i dëgjuar ato dy fjalë për një kohë të gjatë dhe tani që i dëgjova, nuk po u besoja veshëve. *Ah sikur t’i përsëriste edhe një herë!* Nuk mund të thosha asgjë që do ta bënte atë çast më të ëmbël. U ktheva përballë tij me këmbët e mia rreth vitheve të tij dhe e përqafova fort dhe gjatë në natën e qetë e të ngrohtë.

- Po bëhet vonë. Më mbyllet dera në njëmbëdhjetë, - thashë duke u shkëputur nga kraharori i tij. Pastaj u ngritëm të dy për t’u kthyer. Kur mbërritëm te konvikti im, Teo më uroi natën e mirë dhe vazhdoi në kalim të godinës sime.

- Do të flesh me çunat këtu sonte? – e pyeta kur e kuptova që nuk po kthehej te konviktet e mjekësisë.

- Po! Tani fle këtu në qytet Studenti! – tha dhe ngriti dorën para gjoksit. U ndjeva edhe më keq për gjithë gjërat që i kisha thënë atë mbrëmje.

- Si vajti? – dëgjova zërin e Edit në errësirë prej krevatit të saj sapo hyra në majë të gishtave.

- S’paske fjetur akoma ti? Mirë, deri në çastin që më tha se më do, - thashë me pëshpërimë në errësirë.

- Ç’do me thënë “deri”? A nuk është çka ke dashur gjithë këtë kohë? Je shumë budallaqë; gjithë ajo qurravitje për hiçgjë! – u përgjigj Edi. – Natën e mirë! – tha dhe u kthye në krah.

- Në fakt, sonte mund t’i kem dhënë vetes diçka vërtet për t’u qarë. Ai më tha se më do mbasi i thashë që ishte koha për mua të gjeja burrë. Qysh do ta lija të qarën të vinte dëm unë? U ndjeva edhe më keq, kur më tha që është shpërngulur këtu në qytet Studenti këtë vit. Ti nuk mendon se ka ardhur këtu që të jetë më afër meje, apo jo?

- Jo, më, çne? Jam e sigurt që ka ardhur se ka qejf të ngrihet një orë më herët dhe të bëjë pesë kilometra në këmbë çdo mëngjes në vajtje dhe pastaj papë në kthim nga shkolla, - tha Edi tashmë e ulur në krevat.

- Epo tani... më mirë herët se vonë! Sa më gjatë që ta zvarris, aq më tepër do të më dhembë, - thashë, tashmë duke u fundosur në krevatin tim prej

suste me krahët e varur nga gjunjët dhe kokën në të djathtë. – Jam e lodhur. Kam nevojë të fle. Më fal që të zgjova! – vazhdova dhe fillova të zhvishem për gjumë.

- Mirë do të bësh! Mirë do të dalë, po hë! Ja do ta shikosh! – tha Edi dhe u shtri për të fjetur.

Vetëm pak ditë pas javës së parë të vitit të ri shkollor, vura re një burrë në të tridhjetat e hershme, që po më ndiqte për disa ditë, sa herë dilja nga shkolla. Ishte pak më i gjatë se unë me trup të imët, flokë të verdha të drejta, të imta e të ndara mënjanë; një përpjekje e dështuar për të maskuar flokët në rënie e sipër. Edhe vetullat mbi sytë e vegjël e të gjelbërt i kishte të verdha. Henri, më në fund, mblodhi kurajon të më ndalonte për t’u prezantuar.

- A mund të ec pak me ty? – më pyeti, tashmë duke ecur përbri meje rrugës për në konvikt.

- Se mos është bulevardi im! Mund të ecësh ku të duash! – iu përgjigja pa ia hedhur sytë fare. Nuk ndjehesha aspak e kërcënuar nga zëri i tij i butë dhe i ndrojtur. Po dukej sikur isha në vijë me planin tim. Ai propozoi që t’i binim nga rruga e gjatë, përmes qytetit dhe unë pranova. Po më udhëhiqte drejt territoresh të panjohura mes pallateve, kur fillova të ndjehesha paksa në siklet. Por vendosa të mos e tregoja ankthin tim edhe për pak. Henri, më në fund, ndaloi para njërit prej pallateve dhe më pyeti:

- Më duhet të marr diçka brenda. Do të vish për disa minuta?

- Jo. S’ka gjë! – iu përgjigja e vendosur dhe shtova, - Po të pres këtu.

- Mos ki frikë. Jam i butë si qengji i Bethlehemit, - tha ai duke këmbëngulur që të shkoja me të brenda apartamentit.

- Jo, jo. Shko bëj shpejt e shpejt çfarë ke për të bërë dhe unë po të pres këtu përjashta, - iu përgjigja edhe më e vendosur, por disi e paqartë për qëllimet e tij të vërteta. “S’ka se si të mendojë seriozisht që unë do të shkoja të shtrihesha me të!” – mendova e lebetitur, por nuk e dhashë veten.

Pastaj, ç’do me thënë “qengji i Bethlehemit”? E dija nga ditët e mia të pushimeve verore në fshat që qengjat ishin krijesa të buta, të paqme dhe të padëmshme, që i mbaja në qafë me shumë dëshirë, por këtë llojin e Bethlehemit nuk e kisha dëgjuar kurrë. Me siguri që nuk ishin të jargavitur, siç ndjehesha në praninë e Henrit.

Henri e kuptoi që nuk kishte shpresë se do të shkoja brenda me të dhe ndërroi planin edhe për vete. Vazhduam të ecnim përmes lagjes derisa

erdhëm te qyteti Studenti nga një rrugicë e pasme, ku nuk kisha kaluar kurrë. Ndalua për disa minuta nën strehën e një godine përballë konviktit tim për t'u mbrojtur nga pikat e shiut që sapo kishte filluar. Nuk i kisha kushtuar shumë vëmendje muhabetëve të tij të kota gjatë gjithë kohës. Më rrinte mendja vetëm tek Teo. Kur u shfaq papritur duke ecur ngadalë përpjetë kodrës me një shok, m'u ndal fryma për një çast dhe ndjeva një valë të zjarhtë që më përshkoi gjithë trupin – nga maja e kokës deri tek këmbët – me çdo hap që afrohej. Teo ktheu kokën për nga shoku i tij në të majtë dhe më pa mua. Më vështroi drejt e në sy për një çast të shkurtër, pastaj uli sytë dhe vazhdoi të ecte në kalim sikur nuk më njihte.

Disa minuta më vonë, shiu pushoi dhe unë u futa në dhomën time duke u ndjerë e zbrazët, e mundur dhe e këputur. Edi nuk ishte në dhomë, ndërsa unë po ndjeja një nevojë të thellë për të folur me dikë. Vendosa të shkoja nga dhoma e motrave.

- Sot qenka ditë e përkryer për cigare! – thashë, siç u ula në dysheme duke u mbështetur te krevati i motrës së Dorit përballë shoqes sime të klasës.

- Dukesh një çikë pa qejf. Ç'e bëre veten e qeshur me xixa? – pyeti Dori.

- Që thua ti, vetja me xixa po fshihet tani dhe vetes së hidhëruar i do shpirti diçka të hidhur! – thashë.

- Mund të sajoj më diçka, - u përgjigj Dori dhe më ndezi një cigare.

Fillova të thithja dhe m'u kujtua menjëherë pse nuk pija duhan.

- Ke pirë ndonjëherë ndonjë nga këto? – pyeti Dori duke më parë sytë e përlotur nga mbytja dhe vështirësia për të marrë frymë.

- Herën e fundit që kam pirë cigare kam qenë gjashtë vjeçe! – shpjegova ndërmjet kollitjeve të dhunshme. – Vëllai im pesëmbëdhjetëvjeçar në atë kohë sapo e kishte filluar duhanin dhe më mburrej me unazat e tymit që nxirrte nga goja. Isha e mahnitur dhe doja të bëja të njëjtin marifet, por nuk mundja, - vazhdova. – “Duhet ta thithësh tymin brenda dhe pastaj do të mund ta nxjerrësh jashtë”, – më tha im vëlla dhe unë e provova prapë, këtë radhë, duke marrë frymë thellë në të njëjtën kohë që thitha. E ndjeva nxehtësinë deri në loçkë të mushkërive dhe fillova të kollitesha duke vuajtur për ajër, ndërsa tim vëllai po i merrej fryma nga të qeshurat me mua.

- Iiiii, vëllezër mistrecë! – tha Dori duke qeshur.

- Një herë tjetër, më tha të hapja dorën përpara vetes, se gjasme do të më jepte një dhuratë të vogël, pastaj shkundi cigaren me gishtin tregues mu në pëllëmbën time të hapur dhe qeshi prapë me fytyrën time të zhgënjyer.

- Nuk të paska ecur fare me cigaret ty kështu! – tha Dori buzagaz duke treguar boshllëkun e lezetshëm midis dy dhëmbëve të saj të parë të sipërm.

- E kujt i ka? Po kur më merrte paratë? Im atë më jepte nga një pesëlekëshe në ditë për të blerë akullore në verë. Nganjëherë më zinte gjumi në vapë duke pritur për akullorexhiun që shtynte karrocën e akullores. I shtrëngoja paratë fort në dorë, por kur zgjohesha, dora më ishte hapur dhe paratë ishin zhdukur.

- Hajde të të bëjmë një çikë të bukur! – tha Dori, siç u ngrit nga krevati duke kërkuar kompletin e saj të tualetit. Motrat kishin rrobat, tualetet, rripat, çantat dhe muzikën më të fundit. Dori u ul prapë në krevat dhe unë u mbështeta pas tij me kokën në prehërin e saj për një trajtim makiazhi.

- Ja ku është! – tha Dori kur më pa të buzëqeshja me përpjekjet e shoqes sime për të më sjellë humorin. – Nëse nuk na duan, nuk na meritojnë! – vazhdoi ajo duke më shkuar laps të zi mbi qepalla.

- Më duket se e kam llokoçitur vetë këtë radhë. Më pa duke u llafosur me një tjetër para godinës sonë.

- Me kë, mi?

- Me dikë që u dukte si më gomar i squt; si më i pjekur e i gatshëm për t’u shtruar. I kisha folur për këto gjëra dhe tani dukej shumë e besueshme që po punoja drejt realizimit të qëllimit. E quaj në Henri.

- Është ndonjë çikë mall i pashëm ky Henri, të paktën?

- Jo! Ka flokë të verdhë dhe sy jeshilë, por nuk është shumë i gjatë dhe vjen si i shpëlarë. E njeh?

- Më vjen keq të ta them këtë, por nëse flasim për të njëjtin person, jo vetëm që është një copë mishi, por është edhe i martuar. Vetëm me ato gjëra merret gjithë ditën; shkon “gjun” studentet, - tha Dori.

-Uaaaa, të ka faj qurrashi! Sepse nuk e hiqja dot këtë ndjesinë e jargëve për të. Po që të ishte i martuar, nuk ma priste mendja kurrë. Si guxon, një herë? Po kur më tha të vija në një apartament me të dhe ngeli duke më siguruar se sa i butë ishte. Çfarë qurraveci i ndyrë! Sa më shumë që e mendoj aq më shumë më ngrihen nervat dhe më pështiroset.

- Eeeh! Ai merr çelësa hua nga fëlliqësira të tjerë dhe i përdor për raste të tilla. Ke shpëtuar për qime! – tha Dori.

- Nuk do t’i kisha shkuar kurrë brenda dhe kisha besim që nuk ishte fizikisht i aftë të provonte ndonjë idiotësi me forcë, por më vjen turp nga vetja që i erdha pas avazit edhe për aq sa ndenja. Vate dhe plani im i fejesës! – thashë pothuajse e çliruar që nuk shkoi mirë, por ende e shqetësuar që e gjithë përvoja kishte prodhuar efektin e kundërt tek “kupa” që doja në të vërtetë.

Mora pasqyrën, zhbirova shkrijen e fundit të talentit të Dorit mbi fytyrën time dhe u ndjeva si kukuvajkë. – Falemnderit për cigaren dhe makiazhin, po jam e bukur vetëm kur ndjehem e lumtur. Rrofsh që më zbulove Henrin e vërtetë! Ndjehem më mirë tani. Po shkoj të bëj ndonjë detyrë para darke.

- Natën e mirë, e dashur, dhe mos harro! Do të kalojë edhe kjo! – tha Dori duke mbyllur derën pas meje.

U ngjita lart për te dhoma ime dhe iu qava ca më tepër Edit që tashmë ishte kthyer në dhomë.

- Hajde marrim drekën sa pa ngelur pa të! Do të ndjehesh shumë më mirë pasi të hash, - tha Edi dhe unë bëra siç sugjeroi ajo.

Shkuam te mensa, mbushëm sahanët me nga një garuzhde fasulesh dhe racionin prej dy gjysma fete buke dhe u kthyem për t'i ngrënë bashkë te tavolina në dhomën tonë.

- Kisha harruar sa uri kisha. Nuk kam ngrënë asgjë gjithë ditën, - thashë pothuajse e gëzuar që ushqimi ishte diçka konstante edhe në një ditë si kjo.

- Edhe unë, megjithëse hëngra mëngjes, - miratoi Edi.

- Kaq vonë sa po hamë drekën, nuk ka rëndësi fare nëse hëngrëm mëngjes apo jo. Nuk e kuptoj sesi nuk arrij dot të ha shumicën e mëngjeseve. E di që është humbje parash, por s'kam qenë kurrë ndonjë llupëse për mëngjes. E kam më mirë të fle sesa të ha, - i thashë.

- Sikur të kishim nga një dashnor të pasur që të na ushqente me gjëra të mira! – uroi Edi, me sa dukej, jo edhe aq e kënaqur me gjellën e mensës.

- Uuu po! Ta mbaj mend atë darkën e biftekut që hëngra me Bertin! – ia ktheva.

- Ç'ë do që kjo e bën vetëm të pasur, jo dashnor! – ma priti Edi.

Tamam atëherë dëgjuam një trokitje, pamë nga dera, ku një studente e ndrojtur futi kokën dhe tha: “Është një djalë poshtë që kërkon Edin. Më drejtuan te kjo dhomë”.

- Mirë kanë bërë, falemnderit! – iu përgjigj Edi. Më pa me sy të hapur nga habia dhe shtoi, - Kësaj i thonë ‘fjala jote n’vesh t’Perëndisë’!

- Jo po do tallemi këtu! Vetëm se unë u ngopa tani, - iu përgjigja në mbarim të gjellës.

- Kush tha që është i pasur?

- Pa vish rrobat më eksituese që ke para se ta takosh ti, atë bëj! Na ndero ti këtë radhë! – thashë me shaka dhe vendosa të bëja ca detyra, por sapo hapa librat, mendja më përsëriste skenën e mëparshme të buzëqeshjes së ngrirë të Teos fillimisht dhe pastaj fytyrën e tij indiferente, si për të thënë “Vazhdo,

ti, vazhdo; as që më bëhet vonë fare! Për pak sa kujtova se ishe mall më i mirë se të tjerat” kur më pa duke qendruar nën strehë me burrin e botës. M’u ndërpre në mendimet nga hyrja e Edit në dhomë.

- Kaq shpejt? Kush ishte? – e pyeta.

- Ishte njëri nga anët tona, nga Kreshpani – një fshat pranë timit, por nuk e kam takuar ndonjë herë më parë. Kishte ikur në Greqi me gjithë të tjerët dhe tani është kthyer të gjejë nuse. Dikush nga fshati i kishte thënë që im atë ka një çupë të mirë në shkollë dhe ai i shkreti erdhi të bënte parjen, - tha Edi.

- Nga Greqiaaaaa! Uuuuu! Edhe mund të jetë i pasur. Sa shpejt, me të vërtetë! Po material dashnori, ishte? – e pyeta.

- Eh! Sikur dy vjet në Greqi do t’i fshijnë fshatarin nga surrati; lëkura si shuall i kuq dhe flokët e përvëluara në diell. Vë bast që po i dukej vetja spice me pantallonat terital me vija të holla, - u përgjigj Edi dhe buzëqeshi paksa e zhgënjyer.

- Aha! Nuk qenka, atëherë! Vë bast që është fshatar edhe në Greqi. Kishin fshatra me bagëti dhe ulla atje. Vetëm se ata i kanë të tyret. Ne kujtonim se sapo të dilje nga Shqipëria, rrugët ishin të shtruara me flori dhe gjethet ishin para. Nuk do të dilni as një herë të vetme?

- Sigurisht që do dal. Kam vendosur të dal dhe t’i nxjerr një darkë të shijshme. Po vjen të më marrë mbas shkolle nesër mbasdite. Deri atëherë, do t’i kem pyetur të gjithë në klasë për restorantin më të mirë në qytet! – u përgjigj Edi.

- Hë më të lumtë! Vetëm më kujto kur të hash kafshatën e parë. Mua këtu më ke; me gjithë fasulet tona të dashura.

Të nesërmen, pas shkolle, po vrisja mendjen se si po ia kalonte shoqja ime për darkë. Nuk po më pritej ta pyesja për gjithçka. Kur Edi u kthye nja dy orë mbas shkolle, e njoha fytyrën e saj të zhgënjyer dhe pyeta: “Si kaluat?”.

- Siç mund të pritet nga një fshatar cingun! – tha Edi qartësisht e zhgënjyer nga takimi.

- Çfarë ndodhi?

- Erdhëm vërdallë për një kohë të gjatë dhe unë ngela duke i hedhur kunja për restorantet, që më kishin sugjeruar shokët e klasës. Ai nguli këmbë që të shkonim te “pesëmbëdhjetëkatëshi”, moj dermane, - m’u përgjigj Edi për “të thatin” e vetëm të Tiranës.

- Pa darkë?!

- Pa darkë! Vetëm një xupë!

- Dhe mua desh më erdhi keq që humbe fasulet këtu! – e ngacmova me

të qeshur.

- Eee, hajde të hamë fasulet me gjithë fetën e djathit që rrëshqet brenda nga an'ë pjatës dhe qulloset. Mmmm! – ma priti Edi para se të shkonim në mensë.

- Nuk më besohet që nuk të çoi për të ngrënë! – vazhdova me habi, ndërsa po zbrisnim shkallëve.

- Do ta ketë nuhatur që nuk po luaja mendsh për të dhe mendoj që një xupë ishte çmimi i mjaftueshëm për aq kohë sa i kushtova! – tha Edi duke i rënë inati. – Arrite të lexosh ndonjë gjë sa isha jashtë?

- Jo. Nuk mund të përqendrohesh. Më ngeli mendja tek e djeshmja, dy javët e fundit dhe lëmshi që i bëra vetes. Sa arrogante paskam qenë që mendova se do ta rrokja një burrë si me sustë! – iu përgjigja në një ton ndërgjegjësues e disi të mundur.

- Oh, mos u dorëzo kaq shpejt! Në fakt, kam një ide, - tha Edi, ndërsa po dilnim nga mensa pas darke.

- Çfarë?

- Ik e foli!

- Kujt, moj?

- Po Teos, o, kujt tjetër?

- Të ka lënë mendja? – pyeta, fillimisht e tronditur, pastaj duke u mësuar me idenë jo dhe aq absurde po të kisha guximin. – Si?

- Shkoji, moj, te konvikti dhe dërgo dikë ta lajmërojë, siç bëjnë ata sa herë vijnë e na kërkojnë.

-Po, pra. Çunat i bëjnë këto gjëra, ata ndjekin vajzat e jo anasjelltas. Megjithëse është shumë tunduese kaq të thjeshtë sa e bën ti. Pse më duket kaq e pamundur mua?

- Se je pulë fare! Do të vij me ty po të duash? Çfarë do të ishte më e keqja që do të ndodhte? Ai del jashtë me turinjin, por, sapo të sheh, shkrin i tëri nga dashuria dhe pajtoheni.

- Mirë, por do të vish edhe ti me mua që të duket si vizitë shoqërore, - pranova unë. – Kam një parandjenjë të keqe. Nuk shikoj ndonjë çupë tjetër rreth e rrotull. Më duket sikur po lutem për dashuri, - vazhdova duke mermëritur dhe ankuar gjithë rrugicës së errët për tek konvikti i çunave të klasës.

- Jo, ti po e ushqen dashurinë! – tha Edi dhe pastaj i tha njërit prej çunave që po hynte në konvikt të kërkonte Tanin, shokun tonë nga elektrikja.

- Po. Vetëm pasi e qëllova vetë, - ia ktheva.

- Mendoje më tepër si vaksinë. Të dhemb fillimisht, por është e dobishme

se përgatit trupin për sëmundjen e vërtetë, nëse të kap.

- Je edhe e guximshme edhe gallatë! – buzëqesha. – Shpresoj të kesh edhe shënjestër.

Disa minuta më vonë, Tani doli jashtë dhe na përshëndeti të dyjave.

- Kemi ardhur për Teon. Do të na e lajmërosh pak, si djalë i mrekullueshëm që je? – pyeti Edi shokun e saj të klasës.

- Opo trap, thuaj më mirë! Desh kujtova se erdhët për mua! – u përgjigj Tani me shaka. – E di se pse keni ardhur këtu dhe kam frikë se ai nuk është i disponueshëm tani.

- Që do të thotë...? Nga e di ti? Ai as që nuk e di që jemi këtu, apo e di? – pyeti Edi.

- Po, e di. Bashkë ishim kur më kërkoi “lajmësi” juaj, - ia ktheu Tani.

- Ohuu, përpiqu edhe një herë për mua, të lutem! Thuaji që nuk e mbajmë gjatë, - këmbënguli Edi.

- Do ta provoj edhe një herë për ty, por s’besoj se ka për të ndodhur, - u përgjigj Tani dhe iu ngjit shkallëve sërish.

Në pritëm poshtë para godinës. U ndjeva më keq me çdo minutë që kalonte dhe çdo vështrim të dyshimtë që hasja nga studentët që po ktheheshin nga mensa.

- Edi, më duket se e kam qelbur për fare këtë radhë. Ai nuk është i zënë! Thjesht nuk do të më shikojë mua. Nuk e parashikuam këtë rezultat.

- Jo, këtë jo! – u përgjigj Edi këtë herë pa mundur ta fshihte shqetësimin midis vetullave të saj.

Kur u kthye Tani disa minuta më vonë, unë kuptova atë që kisha pritur me frikë për dy javë.

- Nuk vjen, Mirela! – tha Tani me ton të zyrtë.

- I paska vajtur “vaksina” në eshtë! – thashë duke ulur sytë sikur të fshihja krenarinë time të plagosur me një shaka. – Rrofsh, Tani! Mirupafshim!

- Oh, po unë harrova të përmendja që vaksinat kanë edhe efekte anësore dhe shkaktojnë reagime të ndryshme në njerëz të ndryshëm, - vazhdoi Edi siç u kthyem për tek godina jonë ende të tulatura.

- E di, - iu ktheva, e prekur nga përpjekja e shoqes sime për të lehtësuar një situatë që mua më dukej shumë më serioze. – M’u skuq e gjithë kofsha një herë pas një vaksine që më bënë në kopsht. Ti sikur ke lindur për këto gjëra, kur flet për vakcina e të tjera si këto. Je në degën e gabuar, e dashur. Ti duhet të ishe ajo që studionte për mjekësi, - shtova në përpjekje për të ndërruar temën e turpshme të rënies pas dashnorëve dhe të refuzimit prej tyre.

- Ashtu them dhe unë, e kam në gjak! Gjyshi im ishte mjek kur nuk kishte narkozë dhe i shkulte gangrenat me duart e tij. Pastaj ua mbushte plagën me ilaç dhe i dërgonte në shtëpi, - tregoi Edi me krenari.

- Burrë me shtyllë! Burrë që ka marrë parasysh rrezikun, ka bërë gjënë e duhur e ka shpëtuar jetë! Ti duhet të mburresh që je prej të njëjtit gjak si ai! Ku ka burra si ata tani? – thashë me kokën e varur duke parë hapat e mia rrugës për në dhomë.

- Hëngrën mirë; kishin shtyllë të ushqyer. Me çfarë do ta forcojnë shtyllën tani? Me fasule? Fukarallëk, maskarallëk!

- Ti e ke inatin me fasulet akoma, apo jo? – qesha dhe mendova: “Lum unë për një shoqe si Edi në këtë çast!”. – Këndvështrim interesant, ama! Kisha nevojë për të dhe për të qeshurën.

- Nga ana tjetër, ishte shtypja dhe uria që na dhanë guximin t’i jepnim dërmën sistemit të kalbur. U deshën ca shtylla goxha të forta për ta bërë këtë, apo jo? – vazhdoi Edi.

- Ashtu është. Ke të drejtë. Megjithëse, unë e kisha fjalën për një lloj trimërie tjetër. Me sa duket, dashuria është tjetër lloj kafshe.

- Berti duket se i ka të dyja llojet, - tha Edi në ngacmim. – E pe kur dha fjalimin tek tubimi i së premtes së kaluar tek piramida?

- E pashë. Më pa edhe ai, por mendoj se ka për ta mbajtur fjalën për të më lënë të qetë. Vështirë për t’u besuar, ë? Më buzëqeshi dhe përshëndeti me kokë nga larg.

- Pra, ti mendon se Berti është jashtë loje? – pyeti Edi.

- Më duket sikur boll t’i jap një shenjë interesi dhe do të kthehej menjëherë, por nuk do ta bëja. Megjithëse atë kisha në mendje kur i thashë Teos për planet e mia të fejesës.

KAPITULLI X

NDEZUR

Kishin kaluar dy javë që kur kisha parë fytyrën e Teos, dhe po mendoja që kush kishte nxjerrë thënien e vjetër popullore “Larg syrit, larg zemrës!” ia kishte futur kot. Sa më tepër kohë kaloja larg tij, aq më tepër mall kisha. Kur Edi propozoi të shkonim nga tregu pranë spitaleve, unë u hodha përpjetë për mundësinë që mund ta shikoja rastësisht. Kaluam përmes tregut për njëfarë kohe pastaj m’u kujtua shoku im i fëmijërisë, Herkuli.

- Edi, kam një ide. Po sikur të vete të takoj Herkulin? Ia di numrin e grupit. Nuk janë në të njëjtin grup, por kush e di, mbase kanë leksionet ose seminarët bashkë ose afër njëri-tjetrit.

- Tani po mendon si unë. Do të dëshonte gjë Herkuli?

- Asfare. Vete e takoj herë pas here. Një herë e takova te sheshi gjatë demonstratave dhe ai më ftoi të rrija në dhomën e së dashurës atë natë. Kishte shumë trazira dhe dukej gjendja shumë e nderë për t’u kthyer në qytetin Studenti aq vonë. Gjithmonë ka menduar si vëlla për mua! – kujtova.

- Shko gjeje, atëherë! Do të vesh vetë, apo jo?

- Patjetër. Për sa kohë që mendoj se po shkoj vetëm për të takuar Herkulin, nuk kam problem.

- Mirë, atëherë, të vaftë mbarë! – më uroi Edi dhe unë u drejtova për të ndërtesa kryesore e shkollës për të parë orarin për atë orë. Pastaj shkova te spitali ku duhej të kishte seminarin tjetër. Mbërrita te ndërtesa njëkatëshe me një strehë që mbulonte tri shkallët për te dera dykanatëshe prej xhami e hyrjes kryesore. Ndërsa po i afrohesha shkallëve, hodha një sy të shpejtë për Herkulin nëpër grupin e zhurmshëm të studentëve që po prisnin orën e ardhshme të seminarit. Sa më afër hyrjes vija, aq më i heshtur bëhej grupi, ndërsa kthenin kokat për të më parë duke u afruar.

U kujtova që kisha veshur një palë pantallona të kuqe të gomuara me brez të lartë dhe një bluzë pambuku të bardhë me vija të holla të verdha

horizontale me mëngë të gjata dhe të futur në pantallona. U skuqa nga vëmendja që tërhoqa dhe shpresova që Herkuli të mos ishte aty. Guxova të ngre sytë edhe një herë shpejt e shpejt siç iu afrova shkallëve dhe papritur pashë Teon ulur në shkallën e sipërme, pranë një studenti tjetër, me kokën varur e të mbështetur mbi gjurin e majtë. M'u duk sikur më rrahu zemra një goditje më tepër, si atëherë kur i kisha dëgjuar zërin nga poshtë dritares. Vazhdova të ngjitja shkallët drejt hyrjes duke kaluar vetëm disa centimetra pranë supit të tij dhe nuk dija ç'të bëja. Nuk kisha menduar se çfarë do t'i thosha po ta takoja. Nga njëra anë, po uroja që të mos më shikonte as mua as gjithë reagimin që më dhanë moshatarët e tij duke menduar se kishte të bënte me pantallonat e mia shumë të kuqe e të ngushta. E dija që kjo nuk kishte për të ndodhur në çastin që më kapi cepi i syrit shokun e Teos duke i rënë me bërryl në brinjë. Nga ana tjetër, të shihja atë ishte arsyeja e vërtetë për të cilën kisha ardhur kaq larg.

Pyeta një nga studentet pranë derës nëse e kishte parë Herkulin.

- Herkuli nuk është në këtë grup, - ma priti ajo.

U ktheva mbrapsht shumë e çuditur që gjeta grupin e Teos në vend të Herkulit dhe mendova se do ta kisha lexuar orarin gabim. Ngrita sytë përsëri, siç fillova të zbrisja shkallëve, dhe pashë Teon më këmbë përballë meje.

- Njatjeta! – tha ai dhe më zgjati dorën për t'u takuar.

- Njatjeta! – iu përgjigja unë duke i dhënë dorën e paaftë për të mbajtur buzëqeshjen. – Çne këtu ti?

- Çne unë?! Unë jam atje ku duhet. Pyetja është çne ti? – ma ktheu edhe ai duke buzëqeshur.

- Unë shkova nga tregu dhe thashë të takoja Herkulin. I pashë orarin dhe tregonte që duhej të ishte këtu për këtë orë që vjen. Nuk e kuptoj si e kam ngatërruar, por më vjen mirë. Si je ti? – e pyeta dhe e vështrova drejt e në sy.

Filluam të largoheshim nga godina përgjatë rrugicës së ngushtë nga hija në diell. Ndalua disa metra larg shkallëve dhe Teo u përgjigj: “Mirë jam” duke më parë në sy dhe unë ndjeva papritur sikur gjithçka ishte mirë vërtet. Edë kishte patur të drejtë; çdo gjë do të ishte mirë, po ta shikonim njëri-tjetrin sikur edhe vetëm një herë. – Por kam mësim tani, - vazhdoi Teo duke hedhur një sy të shpejtë drejt shokëve të klasës, që filluan të futeshin brenda dalëngadalë.

- Po, e di, vazhdo! – thashë ende shumë e lumtur dhe mendova: “Një karikim i tillë më mjafton për tërë muajin tani”.

I shtrënguam dorën njëri-tjetrit dhe unë fillova të largohesha duke u përpyekur me gjithë ç'kisha të mos vrapoja dhe kërceja me hov para se t'i

dilja nga pamja. E dija që kisha plot mundësi për ta bërë atë para çdo pellgu të vogël nëpër trotuaret nga këtu deri tek fjetorja ime. Nuk prisja dot sa t'i thosha Edit gjithçka mbi ngatërresën e mrekullueshme të orarit dhe fytyrën e çelur të Teos kur më pa.

- Më dukej sikur mund ta dëgjoja tek mendonte: “Do ta lija mësimin e do të ikja me ty, me një grimcë shenje prej teje!” – i thashë Edit kur e pashë më vonë atë mbasdite.

- Pse nuk i the? – pyeti Edi.

- Po sikur ta kisha gabim? Pastaj, isha aq e lumtur që e pashë, saqë doja të kërceja dhe këlthisja vetëm, - shtova.

Të nesërmen, kur u kthye Edi nga shkolla, vura re urgjencë në zërin e shoqes sime duke më pyetur me një frymë: “Ku ishe pas shkolle?”.

- Drejt e këtu; kisha pak orë sot. *Presori* i orës së fundit nuk erdhi fare dhe unë u ktheva, - ia prita paksa e shqetësuar se mos kisha humbur ndonjë ngjarje kush e di se çë.

- E merr dot me mend kë pashë sot? – pyeti Edi duke marrë veten pasi u ul në krevatin e saj.

- Kë? – e pyeta duke uruar të ishte Teo, por e zhgënjyer që më kishte shpëtuar rasti.

- Teon, moj, kë tjetër?

- Ku e takove? Vajte nga spitalet prapë?

- Jo. Pse bredharake si ty jam unë? Unë rri në shkollë.

- Erdhi ai te shkolla jonë? – pyeta e habitur. – Uaaa! Më ka kthyer vizitën! – buzëqesha e kënaqur.

- Po, dhe më pyeti për ty. Pastaj më tha që të kishte gjetur ca bateri dhe donte të t'i jepte, po i futi menjëherë në xhep. Sa kam qeshur! Kishte frikë mos dilja vullnetare për të t'i sjellë ty.

- Shumë e lezetshme! – buzëqesha dhe u hakërrova, - Arrh, që s'isha atje!

- Prit! Pastaj tha që do kalonte nga dritarja më vonë, kështu që bëhu gati! E bëra me vrap shumicën e rrugës deri këtu që të të thosha vetë.

U ngrita, lava sytë, sqetullat dhe këmbët dhe ndërrova teshat. Vesha një palë geta të bardha, një bluzë krepë të gjerë, të bardhë me stampa lulësh të mëdha dhe këpucë kanavace ngjyrë blu.

- Ia fut kot, Mirela! Ku vete me geta të bardha?! – pyeti Edi duke përfytyruar barin e gjelbër, dheun, etj.

- Se ku dëgjova kohët e fundit që getat e bardha t'i tregojnë kofshët një çikë më të mbushura, - ia ktheva unë si gjithmonë e pasigurt për gjymtyrët

e mi të hollë e të gjatë.

- E di ti që gjithë dynjaja i vlerëson shalët e gjata dhe të holla? Shiko gjithë modelet. Bile ato veshin edhe taka të larta që t'i bëjnë shalët të duken edhe më të gjata e më të holla.

- Epo ne jemi shqiptarë. Gjithë bota me botën, ne me Kozma Rrotën! – ia ktheva unë.

S'vonoi shumë e Teo thirri nga poshtë dhe unë vrapova te dritarja për t'iu përgjigjur. I buzëqesha dhe ia bëra me dorë dhe mendova se po ma kthente edhe ai përshëndetjen me dorë, po kur tha “vetëm pesë minuta” e kuptova se nuk po e përdorte dorën për të më përshëndetur. Vrapova poshtë me gëzim që u kthye, por paksa e paqartë nga koha e tij e kufizuar. “Ndoshta po vjen vërtet vetëm sa për të më dhënë bateritë. Po pse mos t'ia jepte Edit, pastaj?! Apo ka ardhur të më lërë gradualisht?” – mendova në përpjekje për të përgatitur veten për rastin më të keq.

- Më tha Edi që më pate gjetur bateritë; sa i zoti je! – i thashë kur ndalova përballë tij për ta takuar.

- Të premtova që do të t'i gjeja! – u përgjigj Teo dhe u kthye për të ecur tatëpjetë kodrës.

- Kujtova se nuk mund të qëndroje shumë gjatë! – i thashë me habi.

- E kisha fjalën “vetëm pesë minuta do të t'pres!”, - m'u përgjigj Teo.

- Aha! – ia ktheva unë. “Ti po ti! Na vdiqe me gjithë pesë minutat e tua!” – mendova duke kujtuar pritjen e tij të gjatë te teatri në një nga takimet e para dhe fillova të ecja përkrah tij me kënaqësi.

Sa shumë doja ta kapja për krahu me të dyja duart dhe të tërhiqja veten ngjitur pas trupit të tij! Por nuk guxova nga frika se më shihnin të njohurit dhe shoqet ose nga frika se mos po supozoja shumë herët që çdo gjë ishte vaj. Nuk kisha ndërmend të përmendja asgjë nga ngjarjet e muajit të shkuar, sikur të mos kishte ndodhur asgjë. Nëse për mirë a për keq, nuk më pëlqenin fare grindjet. Në mendjen time, kjo kishte qenë e tëra një lojë trimërie, në të cilën Teo dukej se kishte dalë fitimtar, sepse ai erdhi pasi kisha shkuar unë tek ai. Çuditërisht, as ai nuk po përmendte gjë.

Në fund të kodrës, në të dalë të qytetit Studenti, papritur pashë Omarin duke ardhur drejt nesh dhe ndjeva sytë e tij gjykues që digjnin si zjarr mbi fytyrën time si për të më thënë: “E di tamam se ku po shkon dhe çfarë do të bësh!”. Ula sytë derisa u afrua dhe pastaj i ngrita prapë shkurtimisht sa për ta përshëndetur.

Siç e kisha marrë me mend, kur e takova Omarin herën tjetër, ai filloi të këndonte, “another one bites the dust” (e hëngri dhe një tjetër).

- E de boll tani, - i thashë, - nuk ka për të dalë gjë! Ajo, rrezik, ishte hera e fundit që më pe me të.

- Pse flet ashtu? – pyeti Omari.

- Sepse e qelba. As që nuk e di pse u kthye këtë radhë. Nuk e kisha parë që prej një muaji.

- Mbase erdhi se e mori malli për ty.

- Ose “e mori uria”! – ia prita duke nënkuptuar që Teo mund të ishte në të vetëm për nevoja fiziologjike tani. – As që nuk tha nëse do të kthehej prapë ndonjëherë! – shtova.

- Mos u ki merak! Sapo “ta marrë uria” prapë, këtu e ke, - ngacmoi Omari.

- Po, pra! – thashë duke rrotulluar sytë. – Sepse më krijohet ndjesia që kjo është problematike! – shtova.

Siç kisha parandjerë me frikë, nuk e pashë më Teon deri natën e mbrëmjes, më se një muaj më vonë, gjatë sezonit të provimeve që shënoi mbarimin e semestrit të parë të vitit të fundit shkollor. Një grup shokësh të klasës vendosi të bënim edhe një mbrëmje të fundit para se të shpërndaheshin të gjithë në drejtime të ndryshme për përgatitjen e diplomave gjatë semestrit të dytë e të fundit. Djemtë vendosën ta bënin mbrëmjen në një prej dhomave të vajzave dhe unë shkova për t’i kërkuar leje drejtorit të qytetit Studenti që të lejonte dhjetë a dymbëdhjetë djem të vinin te konvikti i vajzave për mbrëmjen e vallëzimit, kërkesë që, për çudi, ai e miratoi. Tek po bëhesha gati për mbrëmjen, dëgjova të më thirrej emri nga poshtë dritares dhe shkova të përgjigjesha. Poshtë ishin Timo dhe disa nga shokët e tjerë.

- Hë, re! Ja, erdha! Një minutë sa t’ju marr! – u thashë gjithë entuziazëm për mbrëmjen.

- E, po puna është se kemi sjellë një më tepër me vete. Se mos na nxjerrin telashe për ta futur brenda, - tha Timo.

- Kush është? – pyeta edhe më e ngacmuar nga mendimi që mund të ishte Teo.

- Është Teo, - shtoi Timo gjithë kënaqësi që po ma jepte vetë lajmin e mirë.

- Erdha! – thashë dhe i zbrita shkallët me një frymë.

Nja dy shoqe klase nga konvikti, që ishin po aq të ngazëllyera të shihnin djem në konvikt për herë të parë, erdhën me mua te dera e hyrjes për t’i shoqëruar lart në grupe të vogla. Unë qëndrova te hyrja e godinës për të verifikuar secilin të ftuar dhe vajzat i shoqëronin lart për tek dhoma e

mbrëmjes në katin e katërt. Vajzat kishin vendosur të përdornin një prej dhomave më të mëdha treshe, ku Tina dhe Selvi, ish-shoqet e dhomës së Edit, rrinin këtë vit me një nga shoqet e klasës sime.

Unë përshëndeta me kokë dhe i buzëqesha Teos, që më kaloi mu përpara syve. M'u mbush zemra me gëzim nga prania e tij e shumëpritur dhe mezi po prisja të filloja mbrëmjen. E kisha vënë manjetofonin te tavolina në fund të dhomës në të majtë të dritares, por m'u desh të kaloja nga dhoma ime disa dyer më poshtë në korridor për të marrë kasetat të tjera. Pak para se të futesha në dhomën time, hodha sytë drejt dhomës së mbrëmjes dhe pashë Teon që po qëndronte në prag dhe po shikonte drejt meje. U futa në dhomën time dhe u përpoqa të mbushesha me frymë. Gjithçka kishte ndodhur kaq shpejt sa unë nuk kisha patur kohë të mendoja për këtë vizitë të papritur nga Teo, që më bëri sa të lumtur aq edhe të hutuar.

- Po rri te dera. Nuk di ç'të bëj, Edi! – i thashë shoqes sime, që po hidhte dorën e fundit të tualetit. – T'i flas sikur çdo gjë shkon sahat, por që të parët një herë në hënë është normalja e re ose ndëshkimi im, apo të mos i flas fare sepse nuk jemi më bashkë? Por në qoftë se ai mendon se nuk jemi më bashkë, pse është këtu, atëherë? Ndjem e rraskapitur që pa filluar fare së kërcyeri.

- Epo ai për mua s'ka ardhur, e! Sapo të fillosh së kërcyeri do të vish në veten e qeshur prapë. Hajde ikim tani! Të gjithë ty po të presin se ti e gjallëron mbrëmjen! – tha Edi dhe ia mbajti për nga dera ndërsa unë e ndoqa me kasetat e tjera në dorë.

Kur u futa në dhomë, i gjeta disa nga shokët e mi ulur nëpër krevate dhe ca të tjerë më këmbë duke folur me njëri-tjetrin. Të tjerë akoma duke parë fotografitë e modeleve amerikane dhe evropiane gjysmë-lakuriq të varura në mure. Shkova drejt e te manjetofoni dhe futa një kasetë të "AC-DC", grupit tim të preferuar për momentin, sa për të thyer akullin e gjallëruar ambjentin. Edi kishte të drejtë! Sapo dëgjova muzikën, fillova të kërcëj në mes të dhomës dhe disa nga çunat u ngritën në grup. Krijuan një rreth sa lejonte gjerësia e dhomës dhe kërcenin në mes me radhë me gjithë të tjerët përreth duke bërtitur, duartrokatur e fërshëlyer. Leo vinte vërdallë dhomës dhe na filmonte me kamerën që i kishte sjellë një kushëri i vet nga Amerika. Teo ishte ulur në fund të dhomës përpara dritares dhe po shikonte i qetë duke pirë cigare kur iu afrua Leo me kamerën e drejtuar mbi të. Teo e ktheu fundin e ndezur të cigares brenda gojës vetëm me buzë dhe e nxori përsëri – një thagmë që nuk e kisha parë kurrë më parë!

- Uaa! – thashë e mahnitur duke u ulur në karrigen përbri tijës. – Si e bëre?!

- Me punë, - më tha duke më parë në sy dhe duke shfryrë një shtëllungë tymi drejt meje. Valëvita dorën para fytyrës për të davaritur tymin. – Boll pive, se u helmove! Më pëlqen shumë kjo këngë. Do vish të kërcëjmë? – e pyeta dhe, para se të kishte mundësi të më përgjigjej, e mora për dore dhe e tërhoqa në pistë.

- Prit! Dale të fik cigaren një herë! – tha Teo dhe e lëshoi bishtin në dysHEME. E shkeli dhe përdrodi këmbën mbi të nja dy herë. Pataj mbështolli krahun e djathtë rreth belit tim, më mori dorën e djathtë me të majtën e tij dhe më mbajti shtrënguar pas vetes duke kërcyer ngadalë me “Careless Whisper” (Pëshpërime e pakujdesshme). Mbylla sytë dhe mbështeta kokën mbi supin e tij me buzët pranë gushës që më kishte munguar aq shumë.

Sa po mendoja ta cikja me buzë, dëgjova zëra të lartë nga qendra e dhomës duke bërtitur “Me grusht, Edi, me grusht!”. U afruam drejt qendrës së dhomës ku vëmendja e të gjithëve ishte mbi Edin dhe Timon, që ishin mbërthyer për flokësh. Dëgjoja thirrjen e dëshpëruar të Edit: “Lëshoma flokun!”, ndërsa përkulej për të liruar tensionin. Leo qarkonte rreth tyre me kamerën në dorë duke filmuar gjithçka, veçanërisht shalët pothuajse të zbuluara të Edit ndërsa ulej në bisht. Timo i përgjigjej: “Ti e para!” dhe të dy vazhdonin të qeshnin duke tërhequr njëri-tjetrin gjithnjë e më poshtë derisa Edi përfundoi krejtësisht në dysHEME e shqetësuar për fijet e rëna dhe fundin e shkurtër. Unë nuk dija si të reagoja ndaj gjithë kësaj zallamahie, por e dija shumë mirë që nuk mund të bëja dot asgjë për të shpëtuar asnjërin prej tyre nga kokëfortësia e vet. Kisha besim që dhimbja do të rëndonte përfundimisht më shumë se sa krenaria dhe do ta zgjidhte situatën qesharake, në të cilën gjendeshin pa ndonjë arsye ashiqare.

- Leo, kur do ta shikojmë videon e gjithë këtyre xhirimeve të tua? – pyeti një nga studentët.

- Që tani, po deshët! – ia ktheu ai dhe filloi të kthente mbrapsht xhirimin e disa prej minutave të fundit ndërsa ne e rrethuam kokë më kokë për t’i parë. – Nuk ia shikojmë dot kasetat me sistemin tonë SECAM. Të shoh mbase e shndërroj më vonë.

Teo u ul sërish në karrigen e tij te dritarja dhe unë iu ula pranë. Doja t’i flisja dhe të kërcëja me të ca më tepër, por ngelën duke më marrë për të kërcyer shokët e klasës, sidomos Timo. Edhe pse mbrëmja ishte në një konvikt gocash, kishte prapëseprapë më pak vajza se sa djem dhe Teo po

bënte të ftuarin e ndrojtur që nuk e tepron duke dalë përpara shokëve që e ftuan. Herë pas here, vajza nga dhoma të tjera fushin kokën për të shuar kureshtjen e ngjallur nga zhurma e pazakontë dhe djemtë fillonin të bërtisnin në kor që të vinin brenda, por i trembnin më keq.

- Me provimin e fundit merr fund edhe semestri i parë dhe shkolla me gjithë të. Ke për të përgatitur ndonjë temë për diplomën gjatë katër muajve të fundit? – pyeta Teon kur gjeta një minutë të lirë për t'iu ulur pranë.

- Jo, kam vetëm dy provime për të dhënë në fund të vitit, për të cilët na jepet gjithë koha deri atëherë për të mësuar. Do ta përdor këtë kohë për të mësuar në shtëpi. Më ka sjellë im atë nga Greqia një Opel të vjetër me karroceri dhe kam qenë duke nxjerrë patentën.

- Hajde! U bëre me makinë tënden!

- Po, pra, po! Një vjetërsirë e vogël është, po tani mund të ndihmoj edhe babin për sipërmarrjen e tij, ndërkohë që mësoj për provimet.

- Të lumtë! Kushedi si ndihesh, si burrë i madh e i pavarur.

- Është qejf vërtet! – miratoi Teo. – Po ti?

- Unë nuk kam makinë akoma, - e ngacmova dhe vazhdova, - Do rri këtu. Më kanë caktuar një inxhinier me përvojë nga posta qendrore e Tiranës për të më ndihmuar për studimin. Kam gjetur ca materiale interesante në italisht për fibrat optike dhe po mendoshesha të përqendrohesha në to.

- Tingëllon premtuese! Do të punosh nga posta apo shkolla? – pyeti Teo.

- Do të kem shumë për të shtypur në kompjuter dhe shkolla i ka vënë të gjithë në dispozicion të maturantëve për diplomën. Jam e sigurt që do të më duhet të shkoj te inxhinieri shpesh për ndihmë. Nuk kam ndonjë mall për t'iu kthyer në Fier, kështu që sa më vonë aq më mirë.

Pas disa orësh kërcimi nën tiujt e gjithë këngëve të repertorit tim, të Edit dhe të Dorit, mbrëmjes sonë të fundit i erdhi fundi. Vajzat shoqëruan djemtë nëpër shkallë në të dalë, gjë që doli më e vështirë sesa dukej. Disa nga djemtë sorollateshin nëpër dhoma të tjera duke filmuar vajzat që lëshonin klithma nga vizita e papritur. Unë zbrita përkrah Teos nëpër shkallët e errëta dhe shpresova më kot për një puthje që nuk kishte për të ndodhur me gjithë të tjerët vërdallë. Në të dalë, i urova natën e mirë edhe më e përmalluar sesa para se ta shihja.

- Sapo mendoj që e kam harruar, ai shfaqet sërish dhe unë mbetem në vend numëro! – iu ankova Edit, ndërsa ajo akoma tërhiqte me kujdes nga koka fijet e shkulura të flokut. – Të dhemb koka?

- Gomari! – u ankua Edi për Timon. – M'i shkuli edhe ato pesë qime që më kanë ngelur. Shiko si po më bien.

- I shoh. Më vjen shumë keq. Janë vërtet gomerë nganjëherë.

- Si vajti me Teon? – pyeti Edi. – Ju pashë duke u llafosur te cepi, por, me sa duket, nuk ndenji sonte.

- Jo! Ndoshta atë po shpresonte kur po shikonte nga dhoma para se të fillonte mbrëmja! As që më vajti mendja ta pyesja për një vizitë e jo më të rrinte gjithë natën! – thashë duke kuptuar papritur çfarë ide e hatashme do të kishte qenë.

- Sa e leshtë që je! Vë bast se ata që deshën të rrinin u zhdukën nëpër dhoma! – tha Edi.

- Rrezik ke të drejtë. Ishte errësirë nëpër shkallë. Se mos numërova unë sa ikën. Ama ty do të të ishte dashur të ikje nga dhoma! – thashë duke u përpjekur t'i mbushja mendjen vetes se ishte më mirë që nuk ndenji.

- Pun'e madhe! Do ta kisha bërë me gjithë qejf për ty, - u përgjigj Edi.

- Jo! Do na kishin parë shumë dhe do ta merrnin vesh.

- Unë nuk e kuptoj nga kush fshihesh ti tani, se të gjitha shoqet e tua dhe gjithë shokët e tij e dinë.

- E, punë e madhe, - ia prita, - iku ajo tani! Me bast që është në gjysmën e rrugës për Berat. Më tha që ka marrë makinë dhe do merret me biznesin e t'atit.

- Eh! Do ngopet edhe me xhirot e këtu do vijë prapë! Gjumë tani! – tha Edi duke fikur dritën.

- Natën e mirë! – iu përgjigja nga shtrati im dhe fillova të rishikoja me sytë e mendjes gjithë kërcimin dhe gjithë muhabetet e asaj nate me Teon si mënyra më e mrekullueshme për të vënë veten në gjumë.

Disa javë më pas, i kisha kaluar të gjitha provimet përfundimtare dhe kisha filluar të punoja për përgatitjen e diplomës në një nga laboratorët e kompjuterave përkrah disa prej shokëve të kursit. Kishte qenë ftohtë dhe me shi për disa ditë dhe tani isha e gëzuar që dielli po ndriçonte sërish. Dola përjashta që të shullëhesha pak në diell, kur pashë Tanin dhe Timon gjithashtu duke qëndruar në diell para hyrjes së fakultetit.

- Brrrr, sa ftohtë bën atje brenda? – thashë duke u afruar.

- Po duhet bërë një çikë pushim. T'i themi? – tha Tani duke u kthyer nga Timo.

- Çfarë të më thoni, ore? – pyeta duke vështruar sa njërin, tjetrin.

- Jo. Më mirë mos! – ia ktheu Timo.

- Çfarë të më thoni? – përsërita me zë pak më të ngritur.

- E, mo, i themi se gjynah! Në mos tani, ka për ta marrë vesh më vonë, - kundërshtoi Tani dhe vazhdoi, - po unë them t'i nxjerrim ndonjë lekë për lajmin.

- E di ç'keni ju? Nuk jam dhe aq kurioze! Po të jetë me rëndësi, më gjen lajmi vetë! - thashë dhe u ktheva kurrizin. – Kam një thes me punë për të bërë brenda në vend që të lodh kokën me ju të dy, - vazhdova dhe fillova të kthehesha drejt laboratorit.

- E mirë, atëherë, po i themi që nuk të bëhej vonë! – tha Tani dhe qeshi nën hundë.

Sa mirë i njihja! Në momentin që nuk doja t'ia dija, u kisha tërhequr vëmendjen e plotë. Ah sikur të kishte funksionuar kështu edhe me atë për vëmendjen e të cilit kisha aq shumë nevojë! Këta nuk do të lejonin kurrë t'u shpëtonte rasti për të më vënë në lojë. Ndalova, u ktheva dhe i pashë duke zbritur shkallët.

- T'i thoni kujt, ore? Ku vini? – u bërtita dhe fillova t'i ndiqja. Tani e dija me siguri që kishte të bënte me Teon, por nuk isha gati të shqetësohesha ende.

- Në fakt, erdhëm të të jepnim një lajm të keq, po ti nuk do t'ia dish fare! – tha Timo duke parë nga Tani çdo dy-tri fjalë.

- Hë, po ju dëgjoj! U kënaqët tani? – i pyeta në pritje. Ishin shumë të zotë në improvizim aty për aty, sidomos kur konin njëri-tjetrin.

- Teo ka bërë aksident me makinë! – tha Tani akoma me fytyrë serioze.

- Ku? Qysh? – pyeta ende duke shpresuar që ishte vetëm një lojë, por disi e shqetësuar që mund ta kisha gabim.

- Rrugës për Kakavijë! – tha Tani.

- Çfarë ndodhi?

- Po ngjiteshin përpjetë në ca kthesa të forta dhe papritur hasën akull në rrugë. Makina rrëshqiti dhe Teo humbi drejtimin. Pastaj makina u përplas në një hendek në anë të rrugës. Ishin me fat që përfunduan në atë anë të rrugës, se nga ana tjetër ishte greminë.

- Ku është tani? Si është? – pyeta me zemër të ngrirë nga ideja që mund të kishte rënë në greminë. Kisha udhëtuar asaj rruge me qindra herë që fëmijë dhe e dija përmendsh. Edhe pse shokët e mi mund të ishin duke ekzagjeruar sadopak, filloi të më përzihej në stomak prej kujtimit të të vdekurve në atë rrugë ndër vite nga kamionët e batuar me karroceri plot me njerëz.

- Është në spital në Berat dhe ne po shkojmë për ta parë. Thamë se mbase doje të vije edhe ti me ne. Doje gjë? – pyeti Tani, ndërsa vazhduam të ecnim

drejt stacionit të autobusit.

- Patjetër! Unë sebeb dua, po nuk jam e sigurt në do t'i pëlqente atij. Po sikur të jenë ata të shtëpisë atje? – u përgjigja duke zhbiruar për ndonjë shenjë që po talleshin.

- Nga ana tjetër, sjellja e kësaj atje mund të mos i bëjë mirë. Nuk duhet të eksitohet në gjendjen që është! – u kthye Timo nga Tani.

- E ç'gjendje na qenka kjo? – pyeta unë duke gjetur si përfundim ecejaken e stisur midis të dyve, që e kisha kërkuar gjatë gjithë bisedës.

- Me vjen keq, po është më mirë të jesh e përgatitur për atë që ke për të parë! – tha Tani pa e mbajtur dot më seriozitetin.

- Mirë thua ti; rrezik as nuk i hedh më sytë po ta shikojë ashtu si është katandisur dhe do t'ia këpuste shpirtin më keq. Më mirë s'e çojmë fare! – u përgjigj Timo.

- Do t'i lini torturat ju të dy dhe më tregoni të vërtetën tani? – pyeta më kot duke e ditur që më kishte zënë rrota bishtin t'u vija pas avazit.

- Pse aq keq t'u duk ty? – vazhdoi Tani ndaj Timos sikur unë të isha e padukshme.

- Nga ato që shpjegonte Ardi, dukej gjendja goxha e rëndë! – ia priti Timo.

Hoqa dorë nga pyetjet dhe nuk e mbaja dot të qeshurën me lojën e tyre duke e ditur që sa më tepër të pyesja, aq më gjatë do të më duhej të prisja për një përgjigje që kishte shumë të ngjarë të mos ishte aspak e vërtetë. Në fund të fundit, humori ishte pikërisht ai që më kishte tërhequr në shoqërinë e tyre, kështu që vendosa të shijoja “shfaqjen” deri në Berat.

Ashtu si edhe më parë, sapo kuptuan që më kishte humbur interesi në “të vërtetën”, Tani u përpoq të më sillte edhe një herë në të.

- Që thua ti, – filloi të shpjegonte ngadalë, me çdo rrokje të shqiptuar si copa magneti të thithura mbi sipërfaqe çeliku, - ka thyer tri brinjë në të majtë. Doktorët ia ngjitën gabim kur ia hodhën gjithë gjoksin në allçi, - vazhdoi ai duke prekur majat e gishtave përkatës të zhvendosur me një, – kështu që ai ha një çikë nga e majta kur ulet.

- Eee, një çikë, - ia mbajti Timo duke vënë gishtin tregues dy centimetra mbi të madhin. – Jam i sigurt që i punon akoma.

- Opo të shërohet një herë! – ia priti Tani.

E dija me siguri tani që po talleshin paq dhe po qeshja me zë duke ecur mes tyre drejt stacionit të autobusit, ndërkohë që akoma nuk isha e sigurt i ç'grade ishte trillimi i tyre.

- Mirë thua ti! Shiko si qesh kjo! – tha Tani duke u kthyer nga Timo. – Po ta sjellim me vete, do ta bëjë për të qeshur dhe rrezik t’i thyhen brinjët prapë nga e para.

- Më mirë akoma; mbase ia ngjisin mirë doktorët këtë radhë! – ia ktheva.

- Operacion prapë?! – u përgjigj Timo. – I ziu Teo!

- Iu bë vonë kësaj! – ngacmoi Tani

Kur mbërritëm tek stacioni, unë iu ngjita shkallëve të autobusit të parë të linjës së Beratit, ndërsa dy të tjerët po flisnin me shoferin përjashta. Disa minuta më vonë, hipi edhe Timo në autobus dhe mezi e mbante të qeshurën kur bëri me kokë për nga dera dhe tha “Hajde!”.

- Ku, ore? – e pyeta edhe pse tashmë e dija përgjigjen dhe u ndjeva e çliruar që më kishin gënjyer, gjë që do të thoshte se Teo ndoshta ishte mirë, siç e kisha menduar gjithë kohën, por edhe paksa e zhgënjyer për rastin e humbur për ta parë së shpejti. U ngrita nga sedilja e parë dhe dola përjashta, ku Tani me Timon po qeshnin rehat me gisht nga unë.

- Avash, mo, se u shkritë fare! – thashë duke u kthyer përbri tyre për në konvikt. –E ç’kuptim kishte e gjithë kjo? Si nuk përtuat, xhanëm?

- Na kishte sjellë shoferi ca ushqime dhe gjëra nga shtëpia. Ishte gjith’ajo rrugë. Na shkoi më mirë me ty, apo jo? – ma ktheu Timo.

- Po, pra, po! Po aksidenti, apo ia futët kot? – guxova të pyesja prapë edhe pse e dija që kjo do t’u jepte municion për në kthim.

KAPITULLI XI

NDËRGJEGJËSIM I RI

Dimri po kalonte dalëngadalë duke i lënë vendin pranverës. Ditët po zgjateshin dhe mimozat e mia të dashura po shpërthenin sërish me aromën dhe ngjyrën diellore të luleve të tyre. Në një mbasdite të tillë po kthehesha nga qendra, kur më ndaluan dy vajza të huaja.

- Flet anglisht? – m'u drejtua njëra prej tyre në anglisht.

- Po! – ia prita me dëshirë duke menduar se ishin turiste amerikane që pyesnin për ndonjë adresë.

Që kur e kisha filluar në klasë të pestë, e kapja me kënaqësi çdo rast që më jepej për të folur anglisht. Fotografia ime e parë me ngjyra ishte marrë me aparatin polaroid të një turisti gjerman në gërmadhat antike të Apollonisë pranë vendlindjes. Apollonia ishte destinacioni më i preferuar për udhëtimet shkollore të përvitshme, por edhe për turistët e huaj nën drejtimin dhe kontrollin qeveritar. Një grup turistësh na u afruan mua dhe dy shoqeve të mia me pyetje për emrin e një peme vendase dhe unë nuk ngurrova të hidhesha në shpjegim, derisa u avit me shpejtësi përkthyesi i tyre i vrazhdë me emërim nga shteti, i cili i tërhoqi tutje në mënyrë që të mos flisja më me ta.

- Shkëlqyeshëm! Duam të të japim këtë! – tha turistja amerikane duke më dhënë një fletushkë të vogël dhe vazhdoi në rrugë të vet. Kur fillova të lexoja fletushkën, e kuptova që vajzat ishin misionare të Krishtit, dy prej të shumtëve që kishin filluar të hynin në vend mbas shembjes së komunizmit dhe predikonin shpëtimin në emër të Jezu Krishtit.

Shteti i mëparshëm komunist përndoqi dhe vrau shumicën e klerikëve që nuk mundën të arratiseshin dhe ndaloi me ligj ushtrimin e gjithë besimeve fetare që nga viti një mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e shtatë. Shkatërroi pothuajse të gjitha kishat dhe xhamitë në vend. Të vetmet xhami dhe kisha ende më këmbë funksiononin thjesht si monumente kulturore ose simbole historike. Edhe para komunizmit, shumica e shqiptarëve e njehsonin

fenë mylsimane me pushtimin pesëqindvjeçar turk dhe atë ortodokse me megalomaninë greke në Jug.

Bektashizmi ishte sekti fetar në zonën ku jetonte familja ime dhe, me sa kuptoja unë, besimi fetar trashëgohej brez pas brezi. Edhe pse mami kishte frikë nga Perëndia si fuqia e mbinatyrshme që shikon gjithë të ligat dhe ndan gjykimin sipas bëmave, nuk ushtronte ndonjë gjë shpirtërore përtej yshtjeve të rastit me lutje dhe vaj. Sa herë e pyesja babin për praninë e Perëndisë, ai e nuk e mohonte ekzistencën e një fuqie hyjnore të mbinatyrshme, megjithatë shtonte se askush nuk ka parë gjë as nga hëna. Pastaj kur isha pak më e rritur, babi tregonte historira abuzimi seksual të dervishit në një teqe mbi malin e Tomorit. E fillonte tregimin i qetë dhe menjëherë ziente nga inati me budallallesjen e njerëzve që i nënshtroheshin një turpi dhe talljeje të tillë. Plaku i shtëpisë duhej ta dërgonte nusen e sapomartuar të të birit te dervishi për ta “kënduar” që të mbarsej. “U, shyqyr! Shyqyr! Ndodhi ‘mrekulli’ nëntë muaj më vonë!” bërtiste babi me nerva dhe i quante gomerë që i hanin këto broçkulla.

Ina, shoqja e ish-dhomës sime, vinte nga një familje ortodokse dhe unë e kapja veten shpesh duke dëshiruar të kisha edhe vetë një prejardhje të tillë. Në mendjen time, e lidhja krishtërimin me qytetërimin perëndimor, një jetesë e idealizuar në mendjet e rinisë krejtësisht të izoluar të erës komuniste.

Siç e lexova të gjithë fletushkën, rreshti që përshkruante besëlidhjen e shkruar në gjak më kërcëu nga faqja drejt e në shpirt. Gjithçka mendoja në atë moment ishin përgjakja ime dhe premtimi i Teos që isha nuse atë natë, pothuajse një vit të shkuar. Madje, fletushka sugjeronte se Jezusi e derdhi gjakun e tij për këdo që besonte në të dhe, nëpërmjet besimit, mund të isha pjesë e besëlidhjes së shpëtimit dhe përjetësisë me Perëndinë. Ideja që, në fund të fundit, mund ta zgjidhja vetë fenë time ishte shumë mikluese, por provimet dhe jeta rrodhën para se të bëja diçka për këtë zbulim disa muaj më vonë.

Bashkësia ortodokse greke kishte rindërtuar së fundi dhe kishte rihapur kishën ekzistuese në Tiranë pas dekadash shkatërrimi dhe braktisjeje. Turma njerëzish po vinin ta shikonin; të rinjtë nga kurioziteti, të moshuarit nga bindjet e tyre. Kur Ina dhe Rita, që gjithashtu vinte nga familje ortodokse dhe ishte kthyer nga Fieri për të punuar në kryeqytet, vendosën të merrnin pjesë në ceremoninë e së dielës së bashku, shkova edhe unë me to. Pritëm për t’u futur brenda në një radhë të gjatë njerëzish që dilte nga oborri përpara kishës dhe vazhdonte në trotuar. Shumica u futën brenda duke puthur ikonat

nga muri i djathtë mbi altar, duke vazhduar më pas në murin e majtë duke puthur pikturat e Jezusit e shenjtorëve mbi mur si dhe duke bërë kryqin me dorë. Më vinte rëndë të bëja kryqin apo të puthja pikturat në mur, por më mbështolli një ndjenjë solemniteti dhe përuljeje si kurrë më parë.

Pastaj u ulëm në stola dhe dëgjuam leximin nga vargjet e Biblës që krahasonte fjalën e Perëndisë me farën që binte në katër lloje të ndryshme dheu. Në të dalë nga kisha, një nga priftërinjtë po shpërndante dhjata të reja në shqip. Tani kisha Biblën time të parë! E solla Biblën me kopertinë të kuqe në dhomë, fillova ta lexoja me raste dhe më mahnisnin çdo herë idetë që gjeja në të, pa e ditur se ai libër do të më ndryshonte gjithë kursin e jetës në mënyra që as i kisha marrë me mend kurrë.

Një mbrëmje të ngrohtë nga fundi i qershorit, erdhi Omari me disa lajme interesante.

- Një shoku im që punon te diskoja në qendër më tha se po kërkojnë një kamariere. Më duket se po përpiqen të konkurojnë me rivalët. Ke dëgjuar për klubin e zotërinjve jo shumë larg prej diskos?

- Jo, më duket, - iu përgjigja. – Edhe?

- Pronari ka sjellë valltare nga Rumania, po nga ato të Demi Murit ama.

- Uaa! Kanë ardhur “dhe-mi-muret” e Shqipërisë tani? – pyeti Edi me habi. – Sa shpejt po ndryshojnë kohët!

- Je i sigurt që kamariere po kërkon diskoja? – pyeta prapë.

- Sigurisht! Nuk do të të sugjeroja kurrë gjëra të tilla! – tha Omari.

- Më duhet të mendohem një herë, - thashë e joshur. – Nuk më besohet që mund të gjej punë që tani! – vazhdova pothuajse e ngacmuar nga ideja e të mbeturit në Tiranë.

Kisha dëgjuar plot për diskon si një nga të paktat e para në qytet, por nuk kisha qenë as atje as te ndonjë tjetër që nga nata e hapjes së të parës. Mjaftuan reklamat prej asaj nate për të më mbajtur larg të gjithave për ca kohë.

- Ata të mitë nuk janë aq të lumturuar sa ç’dukem unë në reklamë mu përpara lajmeve të mbrëmjes. Tani të vete t’u them që edhe punoj atje? Do shkrihen fare me këtë! Si thua ti, Edi?

- Epo tani ditët e punës së siguruar na lanë shëndenë. Nuk është se po të presin punët radhë edhe në Fier. Në mos i pastë ngelur tyt eti ndonjë dopjo gjashtë, mund të përfundosh në trenin e plevitosur dy orë çdo mëngjes për

të thithur aromën e qelbët të rafinerisë së naftës në Ballsh, krah për krah inxhinierëve të tjerë, - më kujtoi Edi.

Nën sistemin e vjetër, qeveria lokale emëronte të gjithë të diplomuarit në vende pune sipas specialitetit të tyre, edhe pse jo sipas dëshirës apo ëndrrës së secilit. Kisha dëgjuar plot historira kuadrosh me diploma mësuesie që dërgoheshin në fshatrat e largëta të luginave mes Alpeve të thepisura, ku dukej dielli vetëm disa orë në ditë gjatë dimrit. Po të mos paraqitesha te komiteti ekzekutiv për emërim pune këtë verë, mund t'i bëja marshalla punës si inxhinierë. Nga ana tjetër, sistemi i vjetër po shkërmoqej dhe nuk kishte më garanci për punësim të sigurt.

- Po të paktën je në shtëpi me familjen tënde sërish, - vazhdoi Edi dhe buzëqeshi si për të më thënë “Me bast që aty nuk të kishte vajtur mendja”.

“Shumë interesante do ishte!” – mendova e tutur nga ideja e të banuarit me prindërit, vëllanë dhe nusen e tij pasi kisha jetuar e pavarur për pesë vjet. Po të më duhej të zgjidhja ndërmjet zhgënjimit të prindërve të mi që ende nuk kisha gjetur burrë dhe marrjes së miratimit nga vëllai i madh për çdo gjë që vishja apo për kudo që shkoja, më mirë të pastroja tavolinat një herë për një herë.

- E ç'ka këtu për t'u menduar? – u hodh Omari. – Ja, unë ndjenja! Gjithë punët me para janë në Tiranë. Nuk është e thënë të jesh kamariere përgjithmonë, po kështu mund të mbahesh ndërsa shikon për qindra mundësira më të mira.

- Kollaj për ty se ti je marrë me anglishten gjithë jetën. Vetëm atë kërkojnë organizatat ndërkombëtare.

- Anglishtja jote është e shkëlqyer. Nuk do kesh asnjë problem të gjesh një punë me rrogë të mirë.

- Sa është rroga atje? – pyeta gjithnjë e më e ëmbëlsuar ndaj idesë së të mbeturit në Tiranë.

- Dyzet në muaj, - tha Omari, që do të thoshte dyzet mijë lekë. – Por mund të fitosh trefishin me bakshishe. Çdo mashkull duhet të paguajë dy mijë lekë vetëm për t'u futur në derë. Kjo heq qafe shumicën e alabakëve.

- Mirë, - pranova, - po e shikoj një herë.

- Mirë, hajde! – tha Omari duke më tërhequr nga krahu.

- Që tani?! – ia prita e befasuar dhe me këmbë të përtuara.

- E pse jo?

- Mirë thotë, pse jo? – u hodh edhe Edi.

- Nuk është një çikë si vonë? – pyeta duke rezistuar edhe një herë ndaj një vendimi që ende më vinte në siklet. Pothuajse nuk më ishte dashur kurrë të

vetëvendosja. Edhe gjellët e përditshme ishin të papritura edhe pse i merrnim me mend.

- Ata as që nuk e hapin para shtatës. Do të jemi tamam në kohë, - tha Omari dhe ia mbajtëm drejt qendrës që të tre.

Me përjashtim të një kolibeje të vogël betoni, që mbulonte hyrjen si dhe shkallës së gjatë e të thepisur, e tërë diskoteka ishte nën tokë. U futëm poshtë dhe në të majtë vura re një banak të kompletuar me pasqyra deri në tavan. Pasqyra të tjera në të majtë vazhdonin përgjatë pistës së vallëzimit.

Omari na prezantoi me banakierin që i kishte thënë për vendin e punës. Ndërsa ai shkoi të merrte drejtorin, unë po admiroja arkitekturën e harqeve të mëdha prej tulle që ndanin zonën e uljes në të djathtë nga ajo e pistës së vallëzimit në të majtë. Rreth dymbëdhjetë tavolina ndaheshin prej njëra-tjetrës me nga dy kolltuqe deri në fund të sallës. Ndërsa iu afrova pistës së vallëzimit nga harku i mesëm, vura re edhe dy tavolina të tjera në të djathtë, para panelit ndarës të dixheit. U ktheva te hyrja kur pashë drejtorin që kishte dalë për të na takuar.

Petriti, në të dyzetat, me një buzëqeshje të gjallë, më takoi me duar të forta.

- Mirëserdhe te disko-klub “Shqipëria”! – tha ai.

- Falemnderit! – iu përgjigja duke buzëqeshur. – Shoku im, Omari, më tha që keni një vend të hapur për kamariere dhe erdha t’i hedh një sy vendit.

- Ashtu vërtetë! Mirë të ka thënë! Mos je studente? – pyeti Petriti.

- Diplomohem për dy javë nga inxhinieria elektronike, - iu përgjigja me krenari.

- Mirë, atëherë. Ne e hapim pas disa minutash dhe e mbyllim kur largohet klienti i fundit. Shoferi ynë i posaçëm dhe unë e bëjmë me radhë për t’i kthyer të gjithë punonjësit në shtëpi në fund të turnit. Kemi personel të hatashëm. Ke për ta parë vetë kur të të prezantoj me të gjithë.

- Domethënë mund të filloj që sonte?! – pyeta e mahnitur dhe e tmerruar. Gjithë rrugës për këtu, i kisha vënë shpresat në pengesën e fundit, atë të mospranimi prej tyre.

- Po, pra! Mendoj që po të fillosh në një ditë jo shumë të ngarkuar si e enjtja, do të ishte më e lehtë si fillim, - u përgjigj Petriti me sytë e rrumbullakët brenda qepallave të mbajtura hapur si me fije shkrepe në vetullat e ngritura.

- Po unë nuk jam gati. As veshjen nuk e kam për punë! – këmbëngula duke ulur sytë te fundi verëf i verdhë i trikotuar e me tre sërë.

- Pse? Shumë mirë më dukesh mua! – ma priti ai.

- Nuk keni uniforma?

- Jo. Vish ç'a të duash! – tha Petriti duke bërë çdo përpjekje për të mos i ikur. E nuhati që kisha pasiguri për vendimin tim për të ardhur dhe kishte frikë se nuk do të kthehesha po të mendohesha ca më gjatë ose po të kërkoja punë gjetiu.

- Unë nuk u kam thënë as prindërve. Po sikur të shkoj t'u them këtë të dielë dhe të kthehem në punë të hënën? – ngula këmbë me takt.

- Më mirë puno sot e nesër mbrëma dhe shko te të tutë të shtunë e të dielë. Fundi i javës gjithmonë ka më shumë ngarkesë, - u përgjigj Petriti me të njëjtën këmbëngulje. – Oh! Se për pak harrova. Të thashë që edhe dixhei ynë është duke mbaruar të njëjtën degë me ty? Duhet ta njohësh Nedin, besoj, - shtoi Petriti.

- Edhe Nedi këtu punon? Ku është? – pyeta shumë e kënaqur dhe e çliruar kur dëgjova që edhe një inxhinier tjetër i ardhshëm dhe mik i ngushtë nuk pa donjë të keqe me të punuarit në një vend si ky.

- Po, ja tek e ke, te kthina në fund.

Hodha një hap majtas përballë kthinës në fund të pistës dhe ia bëra Nedit me dorë. Më përshëndeti edhe ai dhe foli në mikrofon: “Hë, moj çupë, ç'bën këtu?”

- Punokam edhe unë këtu tani! – ia prita me zë të lartë pa i besuar as vetë.

U ktheva tek drejtori, Omari dhe Edi e u kujtova të pyes: “Mos keni vend për dy kamarierë?”

- Jo, më vjen keq! Siç e sheh edhe vetë, ky është lokal i vogël dhe ne kemi edhe dy kamarierë të tjerë. Si thua, atëherë? – pyeti edhe një herë.

- Ndjem shumë më mirë tani që shikoj edhe Nedin këtu, por prapë më duhet t'u them prindërve nga e diela.

- Patjetër! Mirë se na erdhe në personel! – miratoi Petriti gjithë dëshirë dhe ma shtrëngoi dorën sërish.

- Më duket se gjeta punë! – u thashë shokëve të mi duke qeshur, ndërsa i përcolla nëpër shkallë.

- Ashtu më duket edhe mua! – ma priti Edi, gjithashtu e mahnitur se sa lehtësisht më kishte ndodhur. – Mua do më duhet të kthehem në Fier! – psherëtiu.

- Mos u ligështo! Jam e sigurt që edhe unë atje do të përfundoj sapa të bëjnë njërën ata të mitë që punoj natën nëpër disko-klube pas gjithë picirrave

që hoqën pesë vjet me radhë për të më mbathur e ushqyer! – ia ktheva. – Natën e mirë, Omar! Falemnderit! Megjithëse nuk jam e sigurt nëse më ke bërë nder apo qeder.

- Shumë mirë do dalë, mos e vrit mendjen! Studentët punojnë gjatë shkollës gjithandej nëpër botë, - më siguroi dhe shoqëroi Edin për në konvikt.

Në të kthyer brenda, vura re portierin, një djalë i qeshur e i shkurtër, që u përul në përshëndetje për herë të parë si anëtare e personelit. Unë buzëqesha dhe ia ktheva përshëndetjen, ndërsa i kalova përbri dhe zbrita shkallët për në klub. Petriti më prezantoi me gjithë të tjerët, siç erdhën një nga një për punë. E kalova shumicën e natës së parë në punë duke vëzhguar dy kamarierët e tjerë. Vura re me admirim sa të çiltër dhe miqësorë ishin me njëri-tjetrin dhe u ndjeva e mirëpritur nga të gjithë. E vetmja femër tjetër në lokal ishte një grua e martuar në të tridhjetat, që ndihmonte mbrapa banakut. Mbrëmja kaloi shpejt. Madje, m'u dha mundësia t'u shërbeja edhe unë disa prej myshterinjve e të zija ca lekë prej bakshisheve. Siç premtoi, Petriti na ktheu të tërëve nëpër shtëpira në fund të turnit me *Renault*-në e tij të kuqe sportive.

- Si vajti? – më pyeti Edi të nesërmen.

- Mirë, më duket. Nuk më besohet që jo vetëm kërcej gjithë natën po edhe paguhem. E keqja është se më duhet të zgjoj portierin te hyrja poshtë që të më hapë derën për natë, - ia ktheva.

- Lekë do ai. Boll ta majmësh mirë dhe ta hap derën me një këmbë. Po ky është problem afatshkurtër. Konvikti do mbyllet pas një jave për pushimet e verës, - tha Edi.

- Do vete të pyes kushërirën e mamasë; mbase më lë të rri me familjen e saj për nja dy muaj derisa të rihapet konvikti në shtator. Një problem edhe më akut se ai është se si do t'ia them Teos. Nuk di as si ta bëj as se si do ta presë ai. Nuk më dha kurrë përshtypjen e ndonjë xheloz, po njeriu njihet vetëm pasi është vënë në provë! – thashë.

- Nuk më duket se e ka fituar të drejtën të bëhet xheloz për ty apo të të ketë të gjithën për vete. Mezi vjen për të të takuar një herë në muaj! – tha Edi.

- Vetë e kam fajin për atë, po meqë ra fjala, zëre sikur ka ardhur. Po sikur të vijë kur të jem në punë? – e pyeta. – Do t'i shkruaj një shënim të vogël që t'ia japësh ti. Mos i thuaj gjë për punën time, të lutem! Dua ta bëj vetë, personalisht, - vazhdova.

- Patjetër! – u përgjigj Edi.

U ula dhe fillova t'i hedh dy fjalë në një copë letre të vogël: “*I dashur Teo! Kam diçka të rëndësishme për të të thënë. Mund të më gjesh në dhomë*”

para orës gjashtë e tridhjetë mbas dite ose në shkollë gjatë ditës. Të kam shpirt!”.

Sigurisht, siç e kisha parandjerë, Teo kishte ardhur të më thërriste më vonë atë mbrëmje, pasi kisha ikur në punë. Edi i ishte përgjigjur nga dritarja dhe i kishte hedhur shënimin e vogël që i pata shkruar.

- Si nuk i shpëton asgjë! – ia ktheva Edi kur më tha të nesërmen.

- Ç’ka për t’i shpëtuar? – u përgjigj Edi duke u bërë gati për shkollë.

- Gjithçka! Gjithmonë kapem me presh në dorë! Imagjinoje tani! Ka një muaj që s’është dukur këtej, por sapo bëj diçka për të cilën ndjehem fajtores, e ke këtu. Herën e fundit që e pashë më kaloi te këmbët me Opel-in, ndërsa po shkoja në shkollë me gocat.

- Dhe nuk ndaloi të të takonte? – pyeti Edi e revoltuar.

- Asnjëra nga gocat nuk e dinte për ne. Pastaj, ç’a do thoshte? Megjithëse ndaloi para shkollës dhe ne e arritëm. Na bëri të tërave një xhiro para se të futeshim në laborator. U ula mu mbrapa tij. Më vinte t’i fërkoja zverkun dhe supet ose t’i përkëdhelja flokët, po e mbajta veten. Sa shumë më ka marrë malli!

- Pse nuk u ule përpara?

- Dikush tjetër u tregua më e shpejtë. Ishte qejf edhe mbrapa në karroceri duke u troshitur e rrokullisur sa nga një anë në tjetrën, sa herë që e kthente me shpejtësi, - thashë e lumturuar që kishte ardhur, por e trishtuar që më kishte shpëtuar një rast i rrallë për ta takuar.

- Edi, kam shumë merak. Po sikur mos ta pëlqejë punën që kam, po nuk thotë gjë për arsyen që the qëparë?

- Jam e sigurt që do ta nuhatësh. Nuk më duket nga ata që të ndryn në kullë.

- Pashë edhe një ëndërr të çuditshme sot në mëngjes.

- Si e pe?

- Pashë veten me gjinj të mëdhenj, të bardhë e të bukur! – i tregova.

- Uuuuu! Më duket se ia more mendjen me letrën. Gjnjtë nuk mund të jenë veçse dashuri. Do ta shikosh së shpejti dhe do mrekulloheni bashkë! – u përgjigj Edi duke ngritur vetullat e saj me hark të plotë.

- Uuuuu! Të lumshin buzët e vogla! – ia prita me të njëjtin zë të zgjatur e dëshirues.

- Më duhet të iki tani. Mirupafshim! – tha Edi dhe u ndamë secila për në klasën e vet.

Kisha punuar disa orë në temën time të diplomës kur erdhi Tani në laborator dhe më pëshpëriti nga mbrapa veshit: “Se kujt i erdhi një shënim i

vogël goxha i frikshëm mbrëmë”.

- E pe edhe ti? – qesha duke shtypur në tastierë. E njoha të folurën e shtruar dhe të shkoqitur të Tanit dhe u ktheva. – U tremb me vërtë?!

- Ashtu m’u duk mua. Nuk dinte ç’të priste. Megjithëse, unë mendova se letra ishte e shkurtër dhe e ëmbël. I imagjinoja letrat e dashurisë qesharake dhe të gjata.

- Po nuk ishte letër dashurie; thjesht një shënim i vogël. Pa dale, dale një herë! Të la ta lexoje? – e pyeta e çuditur. – Opo as një pordhë nuk lëshoj dot pa e marrë vesh gjithë qyteti!

- Është qytet i vogël; pastaj ato të tuat janë edhe me erë edhe më zë! – ma ktheu duke qeshur. – Ku ishte, një herë?

- Nuk ta them dot akoma pa ia thënë atij një herë, - ia ktheva me të qeshur.

- Epo nuk pritkam gjatë, atëherë!

- Është këtu?! – pyeta duke mbuluar gojën me dorë që të mos më dëgjoheshin piskamat nga shokët e klasës. E ruajta punën shpejt e shpejt, dola nga programi dhe e tërhoqa Tanin përjashta për krahu.

- E ke te fundi i shkallëve, - u përgjigj Tani duke shpejtuar këmbët e tij në ndjekje të të mijave në vrap e sipër.

Teo ishte te fundi i shkallëve me nja dy elektriksa, shokë të tij që nga shkolla e mesme. Kur iu afrova, Tani më prezantoi me ta dhe u ndjeva sikur po lejohesha të hyja në rrethin e tyre. Pas disa minuta shakash dhe të qeshurash, djemtë vendosën të shpërndareshin dhe unë u thashë mirupafshim. Fillova t’u ngjitesha shkallëve e zhgënjyer me vizitën e shkurtër me Teon. Nuk i fola dot as vetëm për vetëm. Vate dhe ëndrra ime romantike!

- Nuk do rrish një çikë me mua ti? – pyeti Teo me një shprehje lypëse në fytyrën e tij fëmijërore dhe gjithçka po mendoja në atë çast ishte: “Përgjithmonë, po të duash!”. Po me zë thashë: “Oh, m’u bë sikur dëgjova që u the çunave se nuk mund të rrish gjatë dhe se duhet të kthehesh”.

- Ashtu u thashë atyre, po kam pak kohë për ty, - buzëqeshi dhe filluam të ecnim drejt kioskës së vogël në të djathtë të shkallëve, ku bleu dy kanaçe me Pepsi diete dhe më dha njërën prej tyre.

- Nuk të pëlqen “Coca Cola”? – e pyeta.

- Jo, më pëlqen Pepsi më shumë. Ke pirë ndonjë? – pyeti.

- Jo. Vetëm “Coke” një herë, - thashë dhe ktheva një gllënjë. – Nuk më duket se i dalloj dot nga njëra-tjetra.

- Pak dallojnë, po dallojnë, ama.

- Ndoshta ngaqë ka kohë që kur kam pirë “Coke”.

Teo nxori nga xhepi dhe më dha letrën.

- Oh, e solle me vete, ë? Çfarë kujtove? – e pyeta dhe buzëqesha.

- Mendova: “E bëri më në fund! Do jetë fejuar dhe del me jaranin e ri darkave!”. I kam rënë në të?

- Asgjëkundi! – iu përgjigja duke qeshur. – Desha vetëm të të thosha se kam filluar punë para se ta dëgjoje nga të tjerët. Nuk isha e sigurt nëse do ta miratoje vendin ku punoj.

- Nuk duhet t’u thuash prindërve një herë? – pyeti Teo.

- Kam ndërmend t’u them nesër. Do të shkoj në shtëpi këtë javë. Po mendova se do të të pëlqente ta dije edhe ti.

- Pa hë? – pyeti Teo.

- Të paraqes kamarieren e parë në një diskotekë shqiptare! – shpalla me krahë hapur.

- Hajde! – tha edhe Teo me të njëjtin ton dhe unë nuk mund t’i kapja asnjë grimcë ironie në zë. Nuk m’u duk se pati ndonjë kundërshtim. – Kjo do të thotë që do të rrish në Tiranë gjatë verës.

- Po. Ajo ishte arsya kryesore për punën. Po që zura edhe lekë mbrëmë! Më erdhi mirë, po nuk e di si do ta presin ata të shtëpisë.

- Të vafte mbarë! – uroi Teo duke u drejtuar lart për nga parku mbrapa korpusit qëndror. E dija tani që do të më dilte ëndrra e atij mëngjesi siç e kishte përkthyer Edi. U ulëm në tokë midis pemëve dhe rrezet e diellit po shkëlqenin ndërmjet gjethëve.

- Si ke qenë? Këtej nga brinjët si mirë dukesh! – i thashë duke i ngritur bluzën anash. – Edhe për t’u ulur goxha drejt dukesh! – shtova duke mbledhur buzët për të mbajtur të qeshurën.

Teo qeshi dhe tha: “E mora vesh, e mora. Të kishin bërë për ujë të ftohtë!”.

- Kishte ndonjë gjë të vërtetë në atë histori? – pyeta tashmë duke qeshur.

- Ëëë ... pjesa e destinacionit tim ishte e vërtetë me gjithë rrugët e akullta. Rrëshqita në një kthesë dhe makina rrëshqiti drejt hendekut, po pata fat. Mirë që më vajti mendja në kohë që ta ktheja timonin në drejtim të rrëshqitjes, gjë që bie ndesh me intuitën në këto raste. Përveç kësaj, makina është aq e vjetër saqë frenat nuk i zënë gjithmonë. Më duhet ta ngas zbatshur që ta mbërthej pedalën e frenave me gishtat e këmbëve dhe t’i jap disa herë lart e poshtë derisa të zënë si përfundim.

- Uaa! “Si përfundim” mund të mos ndodhë në kohë. Ke qenë me shumë fat vërtet! – thashë duke u ndjerë fajtorë që e kisha mospërfillur me humor.

- Të shkuara, të harruara tani! – tha Teo dhe u afrua për të më puthur.

E kisha ëndërruar këtë çast për një kohë të gjatë. Mbylla sytë dhe thashë se po lundroja kur na cikën buzët. Mbështolla krahët rreth qafës së tij dhe e putha gjatë e ëmbël. Një rreze e artë dielli më ra përmes gjethesh në sytë e mbyllur dhe u kujtova që po putheshim në mes të ditës për herë të parë. Tani që shkolla pothuajse kishte mbaruar për të dy, e dija që momente të tilla do të ishin të pakta e të rralla dhe vendosa të përjetoja me shpirt çdonjëren prej tyre. Ah sikur t'i ktheja akrepat e orës disa muaj mbrapsht dhe të filloja nga e para gjithë kohën që kisha humbur me lojrat e kota të fejesës!

- Ke vendosur çfarë do të bësh pas shkolle? – guxova ta pyes. Doja të dëgjoja të vërtetën, sado e dhimbshme.

- Kam një mundësi për në Angli. Nja dy shokë kanë shkuar para meje dhe thonë që është e bëshme, por më duhet të bëj disa përgatitje një herë.

Isha e ndërgjegjshme që ishte vetëm çështje kohe para se të largohej nga vendi, siç kishin ikur mijëra para tij, megjithatë ende nuk më mjaftonte për ta përballuar. – Rrugë të mbarë! – mezi munda të nxjerr nga goja dhe heshta.

- Më duhet të ngrihem tani, - tha Teo zemërthyer. – Ku do të rrish gjatë verës?

- Kam ndërmend të pyes kushërirën e mamasë, që banon në Tiranë të Re, të rri me të derisa të hapen konviktet prapë në shtator.

U ngritëm dhe Teo më përcolli deri te hyrja e shkollës. E përshëndeta me dorë dhe u ktheva për të punuar edhe ca në diplomë para se të kthehesha në shtëpi. Kur hyra në laboratorin e kompjuterave, gjeta njërin nga shokët e klasës duke punuar në kompjuterin tim. Më pa, buzëqeshi dhe tha: “Seriozisht e ke?! Nuk të vjen zor nga vetja?!”.

Qesha dhe ia prita: “Ku e dija unë që do e merrte vesh gjithë bota? Pas sa përpjekjesh u fute?”.

- Një! – u përgjigj Rezi dhe më liroi karrigen.

- Lashë nam! – ia ktheva dhe vendosa të shtoja një shkronjë në emrin e Teos, që e kisha përdorur si fjalëkalim me muaj të tërë.

U ktheva në shtëpi për dy ditë. Nga koha që qeveria e re pluraliste i dha familjes truall falas, prindërit dhe vëllezërit i ishin futur punës rëndshëm për të ndërtuar shtëpitë e tyre. Loni kishte dërguar konfeksione që i merrte në Greqi lirë ose falas dhe babi i shiste përditë te pazari anës Gjanicës

shumëngjyrëshe prej kimikateve industriale të derdhura në të.

Pazari kishte gjallëri dhe zhurmë; plot me njerëz që blinin e shisnin lloj-lloj mallrash, shumica e të cilave vinin nga Greqia. Atmosfera e tregut ishte e gëzueshme me gjithë pluhurin, vapën dhe erërat. Pazari më dukej pothuajse aq festiv sa një herë e një kohë, kur shkoja me babin dhe vëllezërit të dielave për të parë qengjat dhe kaposhët e detit në shitje. Mungonte vetëm bagëtia këtë radhë. Babi dhe Xhimi kishin mbledhur para të mjaftueshme për të blerë gurin e themeleve të shtëpisë së re. Vëllai i madh ishte martuar tashmë dhe i zoti i shtëpisë po e humbiste durimin për rikthimin e plotë të shtëpisë së tij. Familja ishte në ankth për të ndërtuar shtëpinë sa më shpejt që të mundnin.

Kisha gjithë ditën që përpiquesha të zgjidhja fjalët më të përshtatshme për lajmin tim. Ndër vite, kishte qenë gjithmonë më e lehtë t'ia thosha mamit një herë. Kur isha e vogël, nuk i thosha dot babit as për gërvishjen më të vogël që kisha marrë në gju kur pengohesha e rrëzohesha për tokë. E humbiste toruan dhe fillonte të bërtiste: “Ku i ke sytë? Mos i mbaj përpjetë si Shaban Fetahu!” duke tallur një bashkëfshatar që, me sa dukej, i mbante sytë përpjetë kur ecte dhe pengohej e binte shpesh.

Edhe pse reagimi i tij në shumicën e rasteve ishte i pamëshirshëm, e dija që e bënte nga dashuria dhe shqetësimi për të mirën time. Megjithatë, më i habitshmi nga të tërë ishte reagimi i tij ndaj një sulmi kundër meje në klasë të katërt.

Shkolla ime fillore, një ndërtesë dykatëshe me tulla e çati tjegullash, kishte një oborr të vogël me lulishte, ku nxënësit rreshtoheshin sipas klasave çdo mëngjes para mësimit. Shumica e fizkulturës bëhej në fushën veriore të ndërtesës në vjeshtë e pranverë ose në palestrën që zinte krahun e shtuar jugor të shkollës gjatë muajve të ftohtë të dimrit. Një mur tulle gjashtëdhjetë pond i lartë rrethonte të gjithë oborrin e shkollës, mbi të cilin djemtë vinin në provë drejtpeshimin dhe forcën para mësimit ose gjatë pushimit. Ndërtesa ishte shumë e vogël për të nxënë të gjitha klasat, kështu që përdorej me dy turne. Klasat e pesta deri në të tetat e përdornin në mëngjes nga tetë deri në dymbëdhjetë, kurse nga e para deri tek e katërta e përdornin nga një në pesë mbasdite.

Një mbasdite, kur po kthehesha nga shkolla, disa çuna pak më të mëdhenj që shkonin në shkollë në mëngjes, na zunë pritë mua dhe shoqeve me të cilat po kthehesha për në shtëpi. Fillova të vrapoja, por dy prej tyre më kapën dhe më shtynë derisa më vunë me shpinë pas murit të një pallati. Para se t'u

kuptoja qëllimin, njëri prej tyre filloi të shkulte gjithë kopsat e fëshfëshes sime të gjelbër, ndërsa tjetri më mbante të mbërthyer pas muri, dhe pastaj ikën të dy me vrap. U trondita dhe u fyeva.

Kur arrita në shtëpi, fillova të qaja sapo më pyeti babi se ç'kisha. Nuk e dija çfarë më trembte më tepër: sulmi i kopsave apo reagimi i tim eti. Për mahninë time, këtë radhë, im atë e mbajti qetësinë gjatë pyetjeve, edhe pse unë nuk ua dija emrat asnjërit prej djemve. Më mori për dore dhe mbeti i heshtur gjatë gjithë rrugës duke shkuar për t'i gjetur. I pashë djemtë duke luajtur në errësi pranë pallatit të tyre dhe i tregova babit se cili prej tyre më kishte shkukur kopsat. Babai iu afrua dhe e kapi djalin, ndërsa unë ndenja disa metra mbrapa. Mezi po prisja për çastin e ëmbël të hakmarrjes, ku im atë e rrihte derisa e bënte halas, por nuk ndodhi asgjë e tillë. Pashë tim atë duke u përkulur dhe folur me të për dy-tri minuta dhe pastaj filloi të ecte drejt meje për të më çuar në shtëpi.

- Çfarë ndodhi? Ai ishte, jam e sigurt! – ngula këmbë goxha e zhgënjyer.

- E pyeta i kujt ishte që ta çoja tek i ati, por, kur më tha që nuk e kishte babanë, më erdhi keq! – ma ktheu babi dhe kështu u pa edhe puna e hakmarrjes sime. Nga ana tjetër, atë natë, pashë një veti të tim eti që nuk e kisha parë kurrë më parë. – Po më premtoi që nuk do të të ngacmojë më kurrë! – vazhdoi babi dhe unë isha shumë e kënaqur që im atë më doli për zot dhe më mbrojti, edhe pse nuk iu desh të rrihte njëri.

E kisha vënë re që sa më shumë u kalonte moshja, aq më të dhembshur e të duruar bëheshin prindërit e mi. Pastaj, tani kishin nevojë për çdo lloj ndihme që mund t'u jepja për të ndërtuar shtëpinë e re. Kështu që kur më pyeti mami pse kisha ardhur në shtëpi me vetëm një javë shkollë për të mbaruar krejtësisht, unë iu përgjigja: “O ma, kam gjetur punë në Tiranë”.

- Domethënë nuk do të kthehesh në shtëpi pas shkollë? – pyeti ajo.

- Po! – ia prita.

- Do të të lënë të rrih në konvikt gjatë verës? – vazhdoi mami me një pyetje tjetër, e kapur në befasi dhe pa ditur si të reagoje. Kjo ishte aq e re për ta sa ishte edhe për mua. Vetëm se unë kisha qenë e pavarur për pesë vjet. *S'ka se si të jetë dhe aq ndryshe.*

- Jo. Konviktet mbyllen gjatë verës. Thashë të pyesja Balen, kushërirën tënde, mbase rrija me të për një dy muaj derisa të hapen prapë në shtator.

- Mirë, atëherë, po vij dhe unë me ty të flas me të. Ato gjithmonë në krahe më kanë pritur. Moj, nuk më the – ku do punosh? – pyeti mami.

O ç'ma mblodhi! Ngeci karkaleci!

- Kam filluar punë kamariere në një disko, - i thashë pa përmendur orarin që ta ndaja lajmin në “kafshita”.

- Kamariere, moj?! – pothuajse bërtiti mami. – Po gjithë ajo shkollë ku derdhe trutë?

- Mund të gjej diçka tjetër ndërkohë që jam në Tiranë, o ma, - ia prita në përpjekje për ta qetësuar. Kur mami po reagonte në këtë mënyrë, as që guxoja të përfytyroja ç’do të thoshte babi. – Nuk do punoj atje përgjithmonë. Kjo është diçka e përkohshme derisa të gjej punën e vërtetë.

- Ça t’thotë nëna? Ti u rrite tani; nuk të jap dot mend! – tha mami, si gjithmonë me besim që i kisha peshuar me kujdes mundësitë e mia dhe kisha marrë vendim të matur. E dija që nuk mund të ishte më larg së vërtetës, por as reagimi i kundërt prej saj nuk kishte për të ma ndërruar mendjen e ngjeshur. Ëndërroja shumë për të ardhmen time, por rrallë bëja plane përtej së nesërme. Rrokullisesha pas së tatëpjetës që më shtronte përpara çdo ditë.

Ama, të bindja vëllanë gjithëzëbirues ishte tjetër hesap. Më duhej të siguroja atë dhe babanë që kurrë nuk do të kthehesha nga puna natën vetëm; megjithëse kishin ende dyshime për gjithë idenë e të moskthyerit në shtëpi pas shkolle.

Gjithçka shkoi edhe më mirë seç e kisha planifikuar me kushërirën e mamasë. E bija, Balja, ishte një vejushë e re që kishte mërguar në Zvicër kohët e fundit. I la adoleshentët e saj nën kujdesin e s’ëmës, që banonte në një apartament në të njëjtën lagje, dhe ia lëshoi me qera një pjesë të shtëpisë së saj një plake të ve që banonte atje me të birin e martuar, nusen e tij dhe të porsalindurin e tyre. I biri punonte roje te një hotel në lagje gjatë natës, ndërsa nëna me nusen rrinin në shtëpi me foshnjen. Unë do të rrija në dhomën e madhe të papërdorur, që kishte një sustë dopjo pa dyshek, një televizor dhe një sobë. Mami mori hua një jorgan të vjetër nga kushërira për ta shtruar mbi sustë dhe një çarçaf për t’u mbuluar.

- Qysh do më zërë gjumi në dyshekun tim duke menduar brinjët e tua çdo natë? – tha mami pothuajse duke qarë.

- Mos u mërzit, o ma! Jam e re. Pastaj, vetëm dy muaj janë!

- Po iki me mendje mbrapa! – tha nëna e shqetësuar.

- Behar është. Është ngrohtë; do bëj si do bëj.

- Po ai çuni që përmende herën e kaluar? – pyeti mami me ndrojë e frikë

se mos më largonte me shumë pyetje personale. Edhe pse e doja nënën, nuk më vinte mbarë t'i hapsha për dashurinë time.

- Ai po ikën, o ma! – iu përgjigja duke ia prerë ndonjë shpresë të kotë që mund të kishte patur deri atëherë.

- S'ka gjë. Le të ikë ai përpara, të stabilizohet, pastaj të merr edhe ty më vonë! – u përgjigj mami menjëherë, si gjithmonë me shpresë, si gjithmonë optimiste. Gjithmonë shihte zgjidhjen kur nuk mundej asnjë tjetër në familje dhe unë e admiroja për këtë.

- Ah, moj ma! – psherëtiva në përgjigje. – Sikur!

KAPITULLI XII

MIRUPAFSHIM APO LAMTUMIRË?

Vajtja në punë nga banesa e re ishte edhe më e lehtë. Ecja pak më këmbë deri te stacioni i urbanit që më çonte deri te puna. Një mbrëmje të ngrohtë korriku, ndërsa autobusi i mbushur po ndalonte te stacioni i dytë, vura re dikë që po ma bënte me dorë nga sedilja e shoferit të një makine në anën tjetër të rrugës. E njoha Teon menjëherë dhe zbrita nga autobusi. Teo parkoi anës trotuarit, doli nga makina dhe kaloi rrugën e ndriçuar me vrap drejt meje. I shtrënguam dorën njëri-tjetrit dhe u puthëm në faqe, ndërkohë që njerëzit hipnin e zbrisnin në autobus.

- Je duke shkuar në punë?

- Po, - ia prita e befasuar nga rastësia e mrekullueshme. – Nuk më besohet që më dallove në një autobus plot me njerëz!

- Po të kërkoja. Mendova që mund të jesh në këtë linjë tani që jeton në këtë anë të qytetit. Është shtëpia larg që këtu? – pyeti Teo.

- Jo. Është te stacioni para këtij në këtë anë të rrugës, te kthesa. Është e vetmja shtëpi private në mes të pallateve, - iu përgjigja duke parë nga njerëzit e paktë që kishin mbetur për të hipur në autobus. Teo e vuri re që na kishte mbetur shumë pak kohë dhe tha: “Do të të kisha çuar unë në punë, po të mos kisha t’atin e një shoku me vete”.

- S’ka gjë, - ia ktheva, - mund ta kap këtë po të vrapoj tani.

E putha në faqe dhe vrapova e lumtur te urbani.

Kur u ktheva nga Fieri disa javë më vonë, qeraxheshka e kushërirës, me të cilën banoja tashmë, më lumturoi kur më tha se kishin ardhur të më kërkonin nja dy djem. Do ta kisha ngritur në krahë dhe do ta kisha puthur fishkaraqen, po të mos ma kishte ndrydhur gëzimin aty për aty me pakënaqësinë dhe kritikën e saj të hapur për vizitën. Me sa dukej, jo gjithkush gëzohej me mua për lajme kaq të mrekullueshme.

Papritur u kujtova se sa shumë më mungonte shoqja ime e shtrenjtë, Edi. Doja t'i thosha që Teo kishte ardhur të më takonte. Më merrte malli për gjithë “bëmat” tona së bashku. Si një herë, kur po vërdalloseshim nëpër kryeqytet në kthim nga kursi i kompjuterave, që kishim vendosur ta bënim dy herë në javë gjatë muajve të fundit të shkollës, kryesisht ngaqë orët e mësimit bëheshin te një godinë pranë fakultetit të mjekësisë. Qeshja sa herë kujtoja se si vendosëm të sfidonim faturinon e autobusit. Edi i tha që nuk kishim para për biletat atë radhë, ndërsa kafshonte një mollë që kishim blerë te tregu.

- Po mollën? Kishe para për të? Për çfarë tjetër kishe para? – pyeti faturino dhe befas mbërtheu çantën e Edit dhe ia tërhoqi nga krahu. Edi u befasua edhe më tepër kur e goditi në kokë me çantën plot me ushqime, ndaloi autobusin dhe na hodhi të dyjave përjashta.

- Uuuuu! Na i theu të gjitha vezët! – tha Edi e alarmuar, ndërsa qeshnim e shtrëngonim shalët fort mbi njëra-tjetrën që mos të na shpëtonte në anë të rrugës. Sapo e morëm veten, iu afruam një kioske dhe i kërkuam pak ujë për të larë të përbrendshmet e çantës nga gjithë vezët e thyera.

- Iku dhe bileta e qyllit! – thashë ende duke qeshur.

- Nuk të lejohet të sjellësh burra këtu! E kam nusen të re! – më përmendi në të tashmen e pakëndshme zëri i bezdisur i Arqilinit.

- Mos ki merak! – i thashë me një buzëqeshje të qetë dhe vazhdova për te dhoma ime.

Arqilini më ndoqi nga mbrapa dhe vazhdoi: “Pak se na zgjon përnatë që të të hapim derën...”

- As unë nuk kam qejf të të zgjoj, po është një çikë e vështirë për mua të përdor çelësin kur ti e mbyll derën me lloz nga brenda, - ia preva ende e qetë por e vendosur.

Nuk mund ta kuptoja se si mund të ishte robi i ëmbël e i kujdesshëm një ditë dhe po aq acarues ditën tjetër. S’kishin kaluar as tri ditë që kur ishim ulur në bisht pranë njëra-tjetrës siç do të ulesha me nënën time për të larë domatet në oborrin prej çimentoje para shtëpisë. I isha treguar edhe e vëmendshme ndaj përfitimeve të larjes së domateve me furçë e sapun sado e çuditshme që më dukej.

Disa ditë më vonë, Teo më befasoi kur erdhi te shtëpia mbasdite vonë me Skendin, prindërit e të cilit ishin shpërngulur në Londër para tij. Tani që ishte diplomuar prej Unversitetit këtu, ata i kishin gjetur një bursë studimi dhe e kishin rregulluar t’u shkonte atje. Këtë mbrëmje, erdhën të më merrnin dhe të tre iu drejtuam shkollës për të përkthyer notat dhe diplomat me qëllim që t’i noterizonin në mëngjes.

- Shiko dhe mëso si bëhen! – më tha Teo. – Kush e di, mund të të duhen edhe ty një ditë!

- Si jemi bërë fije-fije! – psherëtiva e pezmatuar nga ikja e ardhshme e Teos.

Kur mbaruan së shtypuri gjithçka, dolëm me kopjet e shtypura në mbrëmjen e ngrohtë e të këndshme. Rrugët ishin plot me njerëz që bënin xhiron e zakonshme në bulevardin e ndriçuar nga dritat e bardha mbi trotuare. U ulëm përjashta para një kafeneje mbas Institutit të Lartë të Arteve për një mbrëmje të mrekullueshme.

- Po më vete ora për punë! – thashë duke u ngritur më këmbë. – Falemnderit për koka-kolën dhe rrugë të mbarë nesër, Skendi!

- Prit! Një grup nga klasa do vijnë të më përcjellin te aeroporti. Nuk do vish të më fërkosh zverkun për mbarësi nesër? – pyeti Skendi dhe u kthye nga Teo. – Ka ca duar kjo... si darë!

Dhe menjëherë vuri dorën mbi gojë.

- Skendi! Nuk të mban gjë fare! – ia prita unë. – Oh, harrova të ta thosha këtë! Kur i thashë mamit që e shleva të gjithë rrugën për Pogradec me paratë që më paguat ti dhe Nedi për masazhin, asaj nuk i pëlqeu ideja fare. Sec kishte të bënte me të ngrehmen e “myshterit” a diçka e tillë.

- Mos ki merak, Skendi. I di të gjitha. M’i tha që atë natë, - tha Teo.

- Ti ishe i dehur. Ku i mban mend? – e pyeta me çudi.

- Mund të kem qenë një çikë i dehur, po mbaj mend çdo gjë nga ajo natë. Mbjaj mend edhe korsënë tënde ngjyrë blu të ngjitur pas trupit dhe shalët e zbathura në mëngjes, - u përgjigj Teo duke qeshur.

- Më përgjove! – këlthita duke i rënë me grusht në krahun e djathtë. – Skendi, të betohem kontrollova para se të çohesha. Hodha sytë nga krevati i tij dhe ai po flinte top, - thashë dhe iu ktheva Teos: “Po bëje sikur po flije gjithë kohën?”.

- Të kisha mu përpara syve. Kizhnjam ç’a të bënjam unë? – ma priti Teo.

- S’kishte. Nuk kishte faj! – e mbështeti Skendi duke qeshur me beratshen e ekzagjeruar të Teos. – Eh! – psherëtiu. – Ikën ato ditë!

- Ditë më të mira paskëtaj vijnë; as mos e kthe kokën mbrapa. Vende më të mira, shkolla më të mira, e ardhme më e mirë për ty! – e urova dhe e utha në faqe poshtë pallatit të tij.

- Takohemi nesër këtu. Do kemi plot vend në makina po vendose të vish me ne. . . ose po të jesh zgjuar deri atëherë, më mirë të them.

- Patjetër. Këtu më ke. Natën e mirë! – i thashë dhe fillova të largohesha.

- Nuk të ngelet qefi ta përcjell për në punë, apo jo? – i tha Teo Skendit.

- Aspak! Më kanë ngelur akoma gjëra për të paketuar.

Unë e Teo vazhduam drejt bulevardit dhe pastaj përmes rrugicës diagonale të parkut të mugët. Teo më tërhoqi poshtë një qeparisi madhor dhe aty u puthëm si për lamtumirë. Ikja e Skendit na kishte lënë të dyve duke menduar për ndarjen tonë të ardhshme, një ndarje e vërtetë këtë radhë.

- Kur do nisesht? – guxova ta pyes.

- Së shpejti. Ndoshta pas një muaji, pak a shumë, - tha Teo. – Po do të kaloj nga Greqia.

- Si i bëhet? – e pyeta përsëri.

- Sa futesh në Greqi, je në Bashkimin Evropian. Me një pasaportë false italiane pesëqinddollarëshe mund t'i hipësh avionit për kudo brenda Evropës, - shpjegoi Teo.

- Do të shkoje në Amerikë, po të të jepej rasti? – pyeta edhe një herë.

- Është shumë larg! – u përgjigj Teo pas një ngurrimi të shkurtër. – Çne?

- Ka rënë fjala kohët e fundit. Nuk më duket se ta kam përmendur që babi im kishte një kushëri që luftoi kundër gjermanëve nga radhët e Ballit Kombëtar gjatë Luftës së Dytë Botërore. Kur komunistët morën pushtetin në dorë pas lufte dhe filluan të përndiqnin e vrisnin opozitën, ai u fsheh ca kohë në Shkodër. Sapo nuhati që komunistët i kishin rënë në gjurmë, u arratis për në Jugosllavi. Pasi kaloi disa vjet atje dhe më vonë në Itali, përfundoi në Sh.B.A. Tani është kthyer për një vizitë të gjatë dhe gjithë familja po gëzohet që është akoma gjallë. Por kthimi i tij ka mbushur shumë prej nesh të fisit me shpresa dhe ide për jetën në Amerikë. Jo se më ka premtuar ndonjë gjë, po i bëri shumë përshtypje anglishtja ime. Edhe të birin, që ishte në ushtrinë amerikane, e kanë caktuar të punojë këtu për disa muaj. Atij, nga ana tjetër, nuk ia mbusha dot mendjen me anglishten time. Më dha diçka për të përkthyer nga shqipja në anglisht për zyrën e tij dhe unë e qelba, – kujtova me të qeshur përkthimin tim fjalë për fjalë të “ndihmave” që përkoi me sëmundjen e SIDA-s në anglisht.

- Amerika është shumë larg! – përsëriti Teo.

- Mirë atëherë, ja ku erdhëm edhe tek puna ime e famshme. Mirupafshim nesër?

- Po. Do të vij të të marr – ndoshta nga ora dy? – pyeti Teo.

- Mirë, - iu përgjigja.

Kur më thirri Teo të nesërmen nga oborri i vogël para shtëpisë, u hodha me gëzim nga vendi dhe dola me vrap përjashta. Kisha veshur një fustan që më pëlqente shumë; basmë e bardhë me kallamishte të bluave të ndryshme,

me bel të këputur dhe fundin pas trupit. Pjesa e mbrapme dhe e përparme lidheshin me fjongo te supet.

- Hë, më, të zgjova? – pyeti Teo buzagaz e me gropëzën në faqe.

- Jo, jo! Fjeta gjithë ditën. Se mos do t'i jap llogari vjehrrës unë.

- Pashë njërën një herë që dukej si vjehrrë e keqe, – tha Teo për Arqilinin.

– Kush është?

- Oh, e paske vënë re! Është qeraxheshka e kushërirës sime.

- Nuk dukej fare e kënaqur herën e fundit që erdha për të të kërkuar, - tha Teo.

- E di. E gjeta akoma me inat tre ditë më pas. Unë isha gati për betejë derisa më tha që ishte nga Berati pastaj shkruva. Ra fjala edhe për ty dhe doli që të njihje xhaxhanë.

- Botë e vogël! – tha Teo.

- Një ditë, para se ta dija që të kishte nip, kishte ardhur të na rregullonte televizorin në të njëjtën dhomë ku po flija.

- Ai ka qenë. Është teknik televizorësh, – tha Teo.

- Makinë e re?! – thashë e çuditur kur pashë një “Volvo” të zezë të parkuar në anë të rrugës.

- Ëhë. Më në fund, hoqa dorë nga Opeli i vjetër.

Kur arritëm para pallatit të Skendit, u takova me disa nga shokët e klasës që kishin ardhur t'i uronin Skendit rrugë të mbarë dhe ta shoqëronin për në aeroport. Edhe pse ishte ëndërr për shumicën e të rinjve që njihja të iknin nga vendi për një të ardhme më të mirë, tani që çasti i shumëpritur ishte këtu për njërin prej tyre, ishte e vështirë t'i shmangeshe trishtimit dhe boshllëkut që nuk guxonte kush ta zinte në gojë. Nuk e gjeja dot nëse kishte të bënte me nisjen e një shoku tjetër apo ikjen e viteve të shkollës dhe rinisë me të duke shkarë me shpejtësi në të shkuarën. Po secili e kishte ndarë mendjen që kjo ishte një e mirë e garantuar për Skendin.

- Uaa! Do jemi si ndonjë delegacion trupi diplomatik! – thashë.

- Do të kemi në makinë edhe gjyshin, gjyshen dhe motrën e Skendit, - më tha Teo.

Kur erdhi momenti për të hipur nëpër makina, unë u drejtova për derën e pasme të makinës së Teos për t'i lënë gjyshit të Skendit vendin e parë.

- Më mirë uluni bashkë mbrapa, - ndërhyri Teo me shkathtësi para meje dhe u hapi gjyshërve derën e pasme. – Kjo lloj makine e ka motorrin përpara. Është më mirë të kemi më të shumtën e peshës mbrapa për drejtpeshim, - shtoi.

Gjyshërit e Skendit bënë siç u ishte thënë dhe u ulën në ndenjësën e pasme. Unë kafshova buzët dhe ula kokën, ndërsa kalova përpara makinës për nga ana e pasagjerit, duke u përpjekur me vëshitrësi të mos qeshja me arsyetimin qesharak të Teos. Më kënaqi shumë përpjekja e tij për të më ulur përkrah vetes. Më dukej sikur sa më shumë i afrohej ikjes, aq më i guximshëm bëhej për dashurinë tonë dhe aq më pak e shqetësonte fakti që na shihnin bashkë. Familjet e Teos dhe të Skendit ishin të tyret dhe unë e dija që do të ishte vetëm çështje kohe para se të flisnin për mua. Gjyshërit e Skendit më dukeshin shumë të mirë dhe kisha përshtypjen që ndjenja ishte reciproke.

Gjithë rrugës për në aeroport, Teo e mbajti manjetofonin ndezur me këngë shqiptare nga një këngëtar kosovar shumë i mirënjohur i muajve të fundit. Ishin më së shumti këngë të një mërgimtari që përgjerohej për t'u kthyer tek dashuria dhe atdheu që kishte lënë mbrapa. E pabesueshme! Herën e fundit që Teo shpërndante ndonjë tingull muzikor ishin gërvishtjet e metaliksave, vargjet e të cilëve nuk i kuptoja as kur i lexoja.

*“Ëndërr, o ëndërr,
dëshirën ti çoja asaj,
dhe thuaji më të dashurës,
se unë një ditë do t'kthehem në atdhe.”*

Zëri i çjerrë i këngëtarit kosovar më rrënoqethi, kurse vargjet më përlotën me çdo shikim prej Teos, ndërsa këndonte në shoqërim të të gjithë këngës... sikur të ishin vetë premtimi i tij ndaj meje.

I dhamë Skendit puthjen e lamtumirës atë ditë të nxehtë korriku në aeroport. Kur Teo më solli pranë shtëpisë, më premtoi se do të vinte të më takonte para se të largohej nga vendi.

Siç më premtoi, dy javë më vonë, Teo kishte parkuar makinën e tij të re para diskos dhe po qëndronte para portës, duke më pritur të vija në punë.

- Çfarë e papritur e mrekullueshme! – i thashë siç i shtrënguam dorën njëri-tjetrit e u puthëm në faqe.

- Si je? – pyeti Teo.

- Mirë, po ti?

- Mirë. Pothuajse gati për rrugë, - u përgjigj.

- Po shoh që e ke akoma Volvon, - i thashë.

- Punon mirë. Do të të bëj një xhiro?

- Me shumë dëshirë, po më fillon puna tani.

- Mbase merr nja dy orë leje, - sugjeroi Teo.

- Mirë, prit të vete ta provoj, - i buzëqesha dhe shkova brenda.
- Zbrita nëpër shkallë dhe e gjeta Petritin ulur te banaku. – Drejtor, më duhen nja dy orë leje, - i thashë, e sigurt që do të më linte.
- Ne për pak e hapim, - më kundërshtoi. – Tani do ikësh ti?
- Ti e di që nuk vjen njeri për dy orët e para. Të luteeeeeem! – iu luta sikur po i kërkoja babit lekë për akulllore. Më ecte gjithmonë me të. As Petriti nuk më rezistoi dot.
- Takim i ëmbël, kështu? – përgjoi.
- Ëhë! – i buzëqesha. – Ti ke qenë vetë i ri, apo jo?
- Ooh, lëre se ujë të zi i kam nxjerrë! Një herë... – filloi të tregonte çka dukej si një nga aventurat e rinisë së tij, sa për të më ngacmuar.
- Ma thuaj kur të kthehem. Falemnderit! – ia preva dhe u nisa drejt shkallëve.
- Të jesh këtu për një orë, - bërtiti duke vënë gishtin mbi orën e dorës.
- Si urdhëron! – iu ktheva “gatitu” dhe u ktheva prapë drejt shkallëve dy nga dy.
- Kam shef fantastik dhe ngordh për mua. Kemi një orë kohë, - i thashë Teos. U futa në makinë dhe u nisëm.
- Është e vështirë t’i thuash “jo” të qeshurës tënde, - miratoi Teo.
- Të thashë që më mori në punë në vend? – e pyeta.
- Jo, po e marr me mend, - u përgjigj Teo.
- Një herë, para se ta hapnim për publikun, i kishte ardhur një shoqe për ta takuar. Ai ma bëri me shenjë dhe unë i vajta me dy sparkata në ajër. Kur ndalova te tavolina, po qeshnin të dy dhe dëgjova drejtorin t’i thoshte “është fantastike” dhe porositi një pije për të, - tregova duke i rënë në të që po mburrja veten dhe ndërrova temë menjëherë. – Kjo makinë duket më e re se ajo tjetra, - thashë duke soditur rreth e rrotull brenda makinës.
- Është edhe më e sigurt, – shpjegoi Teo duke e ngarë drejt lindjes, në kalim të qytetit Studenti. Doli nga rruga drejt një zone të pyllëzuar dhe parkoi midis pishave. Teo rrotulloi një dorezë në anë të ndenjësës së tij për ta shtrirë.
- Si e bërë? – e pyeta duke u përpjekur të gjeja të njëjtën dorezë në të djathtën e ndenjësës sime.
- Përkulu pak përpara; nuk duhet të mbështetesh mbrapa duke rrotulluar dorezën. Prit, se ta tregoj unë, - tha Teo pothuajse me pëshpërimë duke u përkulur mbi mua për të arritur dorezën në të djathtën e ndenjësës sime, po iu prish mendja rrugës dhe ra mbi buzët e mia. U puthëm me epsh duke

u përpjekur të lëshonim mbështetësen në të njëjtën kohë. Zgjati shumë më tepër sesa do të donim me peshën e të dyve në mbështetëse. Nuk e kisha ndjerë peshën dhe djersën e tij mbi trupin tim prej muajsh siç e ndjeva atë natë të nxehtë gushti. E dija që do të ishte edhe më gjatë derisa ta shihja sërish, por ky sepse po më dukej si një fillim i ri në fund.

- Lamtumirë ... apo mirupafshim? – e pyeta kur mbërritëm para diskos pas një ore.

- Mirupafshim! – tha Teo. – Do kthehem! – premtoi dhe unë e besova që e kishte përnjimend, sepse gjithmonë e kishte mbajtur fjalën. – Pyetja është a do jesh ti akoma këtu, apo do kesh kapur ndonjë avion për Amerikë a kush e di se ku? Në fund të fundit, vë bast që shikon lloj-lloj meshkujsh të pasur te puna tani, – vazhdoi duke më ngacmuar.

- Uuuu! Për pak sa tingellove xheloz tani. Po më rriten veshët, po këtu më ke! – i premtova e kapur në befasi nga shqetësimi i tij i mirëfilltë nën maskën e ironisë. Gjithmonë kisha supozuar se do të ishte ai që do të më linte dhe unë kisha vendosur të rrija në pritje deri atëherë. As që më kishte ndodhur të mendoja që i shkonte mendja ndonjëherë se do të isha unë ajo që do ta lija. – Nuk do të shkoja asgjëkundi pa ty! – vazhdova. – Megjithëse, është për të lënë mendtë sa të pasur janë ca e ca. Një herë, një bankier italian më la një bakshish tre herë më të madh se sa pagoi për pijen e vetme. Po kur më tha që do të më kishte marrë në punë po ta kisha diplomën për ekonomik?! Nuk kam parë kurrë kaq shumë para. As që më duhet të përdor paratë e rrogës. Mund t'ia dal vetëm me bakshishet. Një herë tjetër, një shqiptar më la dy grushta të mbushura me pesëqindëshe dhe mijëshe të bëra shuk. Boll të mbajta, se ke gjithë atë rrugë për të bërë deri në shtëpi sonte. Udhë të mbarë! – i thashë dhe e putha edhe një herë në faqe.

- Prit! – tha Teo, siç po dilja nga makina. – Mund të jem në Greqi për nja dy muaj duke pritur për pasaportën. Mund të më marrësh në telefon tek i njëjti numër që të dhashë verën e kaluar.

- Mirë. Do të të marr pas një jave sa për të parë që mbërrite mirë. Natën e mirë! – i thashë. Mbylla derën e makinës dhe qëndrova në trotuar derisa Teo nuk dukej më.

U ktheva për në gropën e zhurmshme nën dhé. Bëra një kthesë të shpejtë majtas për në banjo që të sigurohesha që bluza e kuqe e pambuktë ishte plotësisht e futur në pantallonat e kuqe të gomuara. I vura të dyja duart mbi lavaman dhe mora frymë thellë. M'u bë sikur më solli në vete tarazirën e gjithë emocioneve të skajshme. Doja të këlthisja nga gëzimi që kisha qenë

me të sërish, por, çuditërisht, kisha edhe paqe për nisjen e tij; gëzimin për rimëkëmbjen e dashurisë sonë, por dhe bindjen që nuk do ta shihja, ndoshta, për një kohë të gjatë. I ktheva shpinën pasqyrës për të parë rripat e hollë të kryqëzuar nga dy anët e v-së së hapur duke krijuar rombe të vogla midis shpatullave dhe u ktheva në punë me buzëqeshje në shpirt.

Petriti ma vuri re fytyrën e lumtur dhe vendosi të më ngacmonte: “A pa pa, shiko, shiko si i ndrin nuri!”.

- Falemnderit! – i pëshpërita.

- E mbaj mend si sot kur isha i dashuruar. Sa herë doja ta takoja, i hidhja një gur të vogël nga poshtë dritares. Ajo kacavirrej nga dritarja dhe pastaj bridhnim rrugëve të dy. I ati nuk e kishte idenë që ajo kishte qenë me mua gjithë natën.

- Uuu! Paske qenë rrugaç ti?! – thashë me çudi që Petriti praktik dhe me mendje allish-verishi kishte edhe një dell romantik.

- Bënim gallatë të madhe kur ishim të rinj, - tha me psherëtimë, - pastaj jeta u bë e ngarkuar dhe e mërzitshme.

- Gjynah që nuk punon edhe gruaja këtu me ne! Si duket bëhesh i mërzitshëm kur shkon në shtëpi, se rrotullamet me *Renault* kur na çon nëpër shtëpia natën janë shumë më tepër seç më mban qejfi mua.

- Të paktën unë nuk e përdor makinën për të vrarë qentë rrugës si Roberti, - tha Petriti.

- E vërtetë. Nganjëherë ai i afrohet shumë trotuarit me shpejtësi të madhe dhe më tmerron. Po dhe pa qenë një çikë i luajtur nga mendtë, nuk mund të jesh pjesë e këtij kolektivi.

- Spontan! – më korrigjoi Petriti.

- Si atë natë që na çove deri në plazh pas pune në tre të mëngjesit? – kujtova me kënaqësi.

- Të rrimë shtrembër e të flasim drejt tani; nuk ishte qejf?

- Ishte. Nuk kisha bërë kurrë ndonjë gjë të tillë më parë. Noti me fustan ishte shumë qejf. Shumica as që u fut në ujë. Ishte edhe frikë, ama, pa parë se ç'mund të lundronte nën detin pis të zi.

- Tani, desha të diskutoja një çështje pune, për të cilën kam nevojë të më ndihmosh, - tha Petriti serioz.

- Çfarë është? – pyeta kurioze.

- Dua që të hiqesh si sekretarja ime për një ditë. Pas nja një jave, na duhet të shkojmë në lindje për blerjen e një birrarie që po privatizon qeveria. Kemi marrë pjesë në një tender dhe na duhet të bindim zyrtarët e bashkisë që ne

jemi zgjedhja më e mirë. Detyra jote do të jetë të ulesh në mbledhje dhe të dukesh e bukur. Qëllimi im për të të prurë ty me vete është që ata t'i kenë sytë tek unë, por mendjen tek ty gjatë bisedimeve. Si thua?

- Nuk kam qenë kurrë matanë Pogradecit. Pa problem, - iu përgjigja duke u përpjekur të fshihja ndonjë dyshim që më ngjallte një udhëtim i gjatë me drejtorin, edhe pse nuk kisha dalluar kurrë prej tij as provokimin më të vogël. Në fakt, vendosa të përqendrohesh në mundësinë për të parë vendlindjen e mamit të Teos; për të parë me sytë e mi çfarë i bënte gratë e këtij qyteti kaq krijuese dhe punëtoare me duar, biza dhe shtiza.

Pas një jave, siç ma kishte shpjeguar Petriti, përfaqësuesit nga bashkia lindore erdhën te klubi në mbrëmje dhe unë ua shërbeva pijet në zyrë. Kur mbaruan së diskutuari hollësitë e marrëveshjes, unë u lehtësova kur dëgjova që Petriti ofroi t'i kthente në mëngjes dhe ata ranë dakord. Dy zyrtarët dhe Petriti u kthyen nga banesa ime të nesërmen në mëngjes dhe më morën me vete në makinë.

Kur arritëm buzë liqenit, Petriti propozoi një devijim të vogël për zhytje në liqen.

- Jo! – ia pritëm njëzëri. Kisha sjellë një palë ndërresa për mbas mbledhjes, po nuk më shkoi mendja të sillja kostum banje.

M'u kthyen dyshimet kur Petriti mori një dhomë me qera në një hotel në qendër të qytetit sapo mbaruam mbledhjen. Vendosa ta justifikoja që kishte nevojë për një sy gjumë para se të niseshim për kthimin e gjatë brenda së njëjtës ditë. Në fund të fundit, kishim punuar shumicën e natës në disko dhe nuk mundëm të ngopeshim me gjumë në mëngjes. U ngjita lart për në dhomë dhe ia mbatha drejt e te ballkoni, ndërsa Petriti u fut në banjo.

- Po i hedh një sy pamjes nga ballkoni derisa të më vijë radha të ndërrohem, - thashë.

Kur dëgjova që kishte dalë nga banja, u futa në dhomë dhe e gjeta Petritin brenda shtrojave të krevatit të vetëm në dhomë, mbështetur në bërryl. Po bëhej gjithnjë e më e vështirë të bëja budallanë. Megjithatë, solla çantën në banjo dhe u ndërrova me tutat gri dhe xhaketën e trikotuar me zinxhir përpara, pasi vешa të dyja palët e të mbathurave që kisha sjellë me vete; lejlatë me brez të lartë mbi dantellat e verdha si edhe sutjenin sportiv të kompletit lejla.

- Do ti që ai tregu poshtë te rruga po ma bën gixili që nga ballkoni? Merr një sy gjumë ti sa të dal një xhiro nga qyteti unë.

- Nuk do të marrësh edhe ti një dremë? – guxoi të pyeste më në fund.

- Jo. Do flesh më rehat po ta zësh të gjithë krevatin, që të na kthesh sakllam. Shihemi pas nja dy orësh, ndoshta?

- Si të duash, po do bëhesh pishman.

- Mos ki merak për mua. Unë mund të fle edhe rrugës. Ti duhet të ngasësh makinën. Fli tani, – i thashë dhe mbylla derën në të dalë. – Huh! – shfryva e çliuar që nuk ishte më tepër se një propozim tafti-bafti nga drejtori im. Kalova dy orët e tjera nëpër treg dhe rrugët pranë hotelit dhe u përpoqa të mos shqetësohesha për udhëtimin e kthimit për në kryeqytet.

Petriti propozoi përsëri që të zhyteshim në liqen, ndërsa po i afroheshim, por unë nuk thashë asgjë. Më pëlqente shumë noti dhe ngordhja për një çikë rast të futesha në det apo liqen vetëm po të kisha veshjen e duhur për të. Sa më tepër i afrohej rruga bregut, aq më i madh tundimi im. Më në fund u dorëzova dhe thashë: “Ti që do zhyteshe në liqen!”

Pa mbaruar mirë fjalinë unë, Petriti papritur ktheu timonin djathtas drejt një rrugice zhavorri që të çonte disa metra për te bregu i liqenit.

- Bëra shaka. Është shumë ftohtë! – qesha, ndërsa Petriti filloi të zhvishte pantallonat dhe këmishën brenda në makinën e parkuar.

- Do ta lëmë makinën ndezur që të jetë e ngrohtë kur të kthehem, - m'u përgjigj.

- Që të na e marrin edhe makinën edhe teshat me gjithë të? – pyeta gjithnjë e më e shqetësuar sa më shumë mendohesha.

- S'ka këmbë njeriu, - u përgjigj dhe vrapoi për në liqen në të mbathura. E ndoqa edhe unë me vrap për në liqen që ta bëja zhytjen në të ftohtë sa më të shkurtër. Dielli po perëndonte dhe liqeni ishte shumë më i ftohtë se deti në këtë kohë të vitit. U zhyta e tëra dhe iu largova bregut me not.

- Dukesh çuditërisht në formë. Të imagjinoja kockë e lëkurë, - tha Petriti pasi u ktheva dhe po ecja në ujë përbri tij. Buzëqesha dhe bëra “vezën” duke tendosur muskulin e krahut siç më kishte mësuar im vëlla. Filluam të dridheshim nga të ftohtët sapo dolëm pjesërisht nga uji dhe vrapuam për në kabinën e makinës.

- Mirë që e le motorin të ndezur! Kot s'ka thënë ai i pari: “Me gusht bashkë ikën dhe vapa, Zoti na ruajtë ç'dimër vjen mbrapa”, – recitova duke kërcitur dhëmbët, siç fillova të vishesha me duar të dridhura. Petriti, edhe ai duke u dridhur, më mbërtheu për qafe dhe më tërhoqi për të më puthur, por unë ula kokën në çast dhe i dola nga “krraba”. Vazhdova ta shtyja me të dyja duart derisa ndaloi, i bindur që po e luftoja me gjithë fuqinë që kisha dhe jo sa për sy e faqe.

- Nuk kam dhe aq ftohtë sa e bën ti, - shtova më pas, ende duke u përpjekur ta shkrija tensionin me humor. Megjithëse tashmë, qëllimet e drejtorit tim ishin më se të qarta, mendova se nuk ishte asgjë më tepër se një përpjekje e rastit që çdo burrë ia quan për detyrë vetes kur është në një vend të mbyllur vetëm për vetëm me një femër pa lidhje gjaku për një mbasdite të tërë.

Pata një herë një bisedë të tillë me Timon për këtë teori, kur e kisha pyetur nëse ishte e mundur për dy shokë të gjinive të kundërta të flinin në të njëjtën dhomë për një natë të tërë pa u përzierë fizikisht me njëri-tjetrin. – Ndoshta; po të jetë ajo shumë, shumë, shumë e shëmtuar! – më ishte përgjigjur Timo.

- Kokëdërre! – tha Petriti dhe filloi të ngiste makinën në rrugën kryesore për Tiranë.

Unë nxora në heshtje dy nga pjeshkët e ëmbla e të lëngshme që kisha blerë te tregu dhe i dhashë një Petritit.

- Më zuri gjuha lesh, më zuri, me ty, - vazhdoi duke ngrënë pjeshkën.

- E ke nga pjeshka, - ia prita unë dhe Petriti qeshi me zë.

Hëngrëm e qeshëm për mbetjen e kthimit si dy miq të vjetër që sapo e kishin vënë kufirin te thana dhe nuk u duhej ta bënin më kurrë.

Mbërritëm në disko pak pasi ishte hapur dhe unë u ktheva te pasqyra midis dy banjove për të shtruar flokët e harbuar nga uji i liqenit. Beni, banakieri i ri, doli nga banja e burrave dhe më hodhi një shikim me ca sy gjykues si kurrë më parë, sikur ta kisha zhgënjyer.

Beni ishte një djalë bukurosh me trup Stalone, lëkurë transparente të bardhë dhe flokë të shkurtër, një gjë e rrallë mes të rinjve të Shqipërisë pas-komuniste. Të jepte përshtypjen e një “të forti” fillimisht, por, sapo filluam të flisnim, Beni nxori në pah edhe dhëmbët e bardha rruazë.

- Ç’ke? – iu përgjigja. – I futa një të lame në liqen.

Beni vazhdoi në kalim pa thënë asnjë fjalë dhe unë nuk e dallova dot nëse më besoi. Sa më gjatë që vrisja mendjen për këtë, aq më tepër arrija në përfundimin që askush nuk do të më besonte, po nuk kisha ndër mend të ndjehesha fajtores për hiçgjë. Kjo ishte gjëja më e mirë e të jetuarit në qytetin e madh ku, praktikisht, as nuk njihja e as nuk më njihje njeri. Ndryshe nga qyteti i vogël prej nga vija, ku thashethemet udhëtonin vajtje-ardhje dhe anasjelltas, këtu, nuk i jepja llogari askujt përveç ndërgegjes sime. Kjo derisa takova nga java Omarin, shokun tim prej vitesh.

Tashmë, shkolla kishte filluar rishtas dhe unë e kisha lënë me gëzim plakën mbrapa për një dhomë në katin e dytë të konviktit të vjetër, në të cilën banoja me një studente të inxhinierisë që e njihja prej dy viteve të mëparshme.

- Dëgjova që ke filluar me Petritin tani? – tha Omari i zhgënjyer.
- Në asnjë mënyrë! – e mohova kategorikisht. – Akoma nuk më njeh aq sa të besosh që do të bridhja me një burrë të martuar?

- Më tha njëri që të kishte parë në makinë me të gjatë ditës, - vazhdoi Omari.

- Kush të tha? Dale se e gjej vetë! Ish-banakieri? – e pyeta.

- Po. Madje, ai mendon se ti je arsyeja për të cilën e pushuan, - u përgjigj Omari.

- Çne? Nuk ka kuptim fare. Unë mezi i flisja me gojë. Ishte shumë i pakëndshëm dhe i vrenjtur gjithë kohës, aspak tip banakieri, - thashë me bezdi.

- Ai mendon që drejtori të ka fiksion dhe e pushoi atë si dikë që e shikonte me sy kritik ose rival, - vazhdoi Omari.

- Uaa! Ai kujtonte se drejtori më kishte fiksion para se të më shikonte me të? – pyeta e çuditur që nuk e kisha vënë re vetë. – Unë as vetë nuk kisha dalluar gjë derisa bëmë udhëtimin, - vazhdova.

- Domethënë paske qenë në makinë me të? – ngriti zërin Omari. – Na bëre lëmsh!

- Unë nuk e mohova që isha, veçse aspak për arsyet që trillonte ai. Vajtëm në Korçë. Drejtori i madh po përpiqet të blejë birrarinë dhe Petriti më solli me vete duke menduar që mund ta ndihmoja duke i prishur mendjen shitësit me bukurinë time, - thashë, siç ktheva kokën mënjanë. Ngrita edhe duart anash supeve si për të vënë fytyrën në kornizë dhe nuk mund të mos qeshja me gjithë këtë keqkuptim. Omari buzëqeshi dhe u duk i çliruar. – Ashtu më tha mua, të paktën. Unë duhej të isha sekretarja e tij për një ditë. Ç’faj kam unë se vuajnë mileti nga iluzionet, megjithëse ia qërova edhe ato, - vazhdova. – Pastaj, ti e di që unë jam akoma e dashuruar. E kam antenën të kthyer vetëm në një drejtim. Ndoshta prandaj nuk kap sinjale nga drejtime të tjera.

- Nuk ka ikur jashtë ai? – pyeti Omari.

- Iku, po dashuria është një gjendje mendore që nuk mund të ndizet e fiket aq lehtë sa të kalosh kufirin.

- Për njëfarë kohe! Nuk e ke dëgjuar “larg syrit, larg zemrës!”? – ma ktheu Omari.

- Ajo mund të jetë e vërtetë, po sa herë që dëgjoja “filani ra në dashuri!”, e përfytyroja dashurinë si një gropë. Në qoftë se dikush ra në të, a nuk do t’i duhej të zvarritej për të dalë? Sa më e thellë gropa, aq më e vështirë dhe e gjatë zvarritja! – i thashë dhe pastaj i rashë në të që ky nuk ishte Omari

i zakonshëm. – Nuk të shkojnë fare fjalët e urta popullore. Më pëlqen më shumë kur më bën për të qeshur me të forta sesa kur më jep mend. S’paske fjetur mirë mbrëmë!

- Jo. Në fakt, të kam patur shumë në mendje kohët e fundit, - tha Omari dhe më pa drejt e në sy. Pastaj shtoi, - Më duket se po ndjej për ty.

Më kapi krejtësisht të papërgatitur, edhe pse Edi dhe shoqe të tjera fillimisht e kishin marrë shoqërinë tonë gabimisht për diçka më tepër dhe më kishin ngacmuar për të. Doja të bërtisja: “Jo, jo, jo edhe ti!”, por e dija që duhej të tregoja shumë kujdes me të. Omari dukej në dhimbje duke pritur kundërshtimin tim dhe unë nuk dija çfarë t’i thosha.

Vetëm një “Ohoo!” munda të nxirrja si fillim. – Nuk di ç’të të them. Çfarë pret prej meje? – vazhdova.

- Më lër të të ndihmoj “të zvarritesh” dhe të të kursej shumë kohë dhe dhimbje, - tha Omari dhe unë nuk ndjeva asgjë veçse dhembshuri.

- Më vjen shumë keq, Omar, por kjo gropa ime është goxha e thellë dhe ty do të të duhej të bëheshe shkallë për mua që të dilja jashtë dhe unë nuk ia lejoj vetes të shkel mbi ty. Duhet të gjesh e të biesh apo të hidhesh në gropën tënde. Kjo ku jam unë nuk mban më dhe unë nuk jam akoma gati të dal. Po iki brenda tani, - i thashë dhe i ktheva shpinën për t’u futur në godinë sa më shpejt që të mundesha pa vrapuar.

Gjatë dy javëve të ardhshme u përpoqa me sa munda ta shmangja Omarin edhe pse ai vazhdonte të më fishkëllente nga poshtë dritares, por nuk mund të fshihesha më gjatë. Nuk kisha ndonjë përgjigje më të mirë, por vendosa ta përballoja të vërtetën edhe një herë. Më duhej të tentoja të refuzoja edhe një herë një nga shokët e mi më të ngushtë. Kur u takuam sërish poshtë godinës sime, Omari më pyeti me zërin e tij çapajev: “Ku ke humbur ti? Kam kohë që s’të kam parë”.

- Ja vërdallë. Gjumë e brumë e punë. Si je ti? – e pyeta me frikë nga përgjigja që mund të merrja.

- Mirë jam.Ti nuk po më shmangesh prej shakasë herën e fundit që u takuam, apo jo? – pyeti.

- Çfarë shakaje? E kisha harruar fare! – i thashë duke i ardhur pas avazit me kënaqësi. Dukej se edhe ai e vlerësonte miqësinë time sa unë të tijën dhe kjo më kënaqte. Miqësia jonë mund të kishte marrë një goditje nga “shakaja”, por unë e dija që do të kishte qenë shumë më keq në çdo mënyrë tjetër. Kur vinte puna tek dashuria, diapazoni i vëmendjes së Omarit ishte sa i një ketri. Kisha besim që do të vinte në vete sapo t’i priste shtegun një bukuroshe tjetër.

KAPITULLI XIII

SËRISH NË RRUGË

Pas ikjes së Teos, shumicën e mendimeve të mia e konsumonte ideja ngacmuese e telefonatës për t'i dëgjuar zërin. Pothuajse një javë pas mbrëmjes sonë të fundit, eca përmes lulishtes së vogël për tek një kabinë portative telefonash që e kishte ngritur shërbimi postar shtetëror për të përballuar kërkesat pëmbytëse të popullit për të komunikuar me të dashurit e tyre nëpër botë. Pasi prita në radhë për një gjysmë ore, më në fund i dëgjova zërin e dashur edhe një herë dhe më kujtoi sa shumë më mungonte që tani.

- Mirëmbërëma, Teo! Jam unë! – i thashë. – Nuk më besohet që të kapa me përpjekjen e parë. E paske hedhur me sukses “gardhin” e parë, - vazhdova.
– Si je?

- Mirë jam. Ja, po pres të më vijë pakua. Po ti? – m'u përgjigj.

- Mirë jam edhe unë, - iu përgjigja me zë të butë. – Edhe sa kohë beson se do të jesh aty para se të ikësh?

- Ndoshta nja dy muaj. Atje do të banoj me ca shokë të tjerë që kanë ikur para meje dhe tani kanë zënë një hyrje me qera. Po pate gjë me se të shkruash, po të jap numrin e telefonit të hyrjes.

- Nuk kam gjë me vete, po s'ka gjë. Të marr prapë në telefon, - iu përgjigja.

- Mirë! Ah, sikur të ishe këtu tani! – tha Teo dhe ajo ma mbushi zemrën me gëzim për një muaj të tërë. Kur arrita të flas me të herën e dytë, Teo kishte marrë gjithë dokumentat e nevojshme dhe ishte gati për rrugë për në Angli. Më dha numrin e ri të telefonit dhe shtoi: “Dua të të them diçka tjetër para se të na shkëputet linja”.

- Po. Të dëgjoj, - ia prita unë.

- Të gjitha këto që m'u deshën mua për të vajtur në Angli mund të bëhen edhe për ty, po të mundësh të kalosh prapë në Greqi. Si thua? – më pyeti Teo dhe unë nuk dija ç'të bëja nga gëzimi. Edhe sikur vetëm zërin t'i kisha dëgjuar do të më kishte mjaftuar. Siç kishte parashikuar mami, ai po ofronte të më merrte me vete dhe do të bashkoheshim një herë e përgjithmonë.

- Më duket mrekulli! – arrita të thosha duke përmbajtur britmën që po më shpërthente gjoksin. – Atëherë më duhet të nxjerr pasaportën dhe një vizë greke. Radhat për to zgjasin me muaj, edhe sikur të mundësh të gjesh një, - shtova dhe menjëherë më vajti mendja te një tregtar grek shumë i këndshëm, i gjatë dhe simpatik që erdhi një herë në disko me një zonjë. Vetëm ngaqë i kisha përshëndetur dhe uruar mirëseardhjen në gjuhën e tij amtare herën e parë, ai sillte shumë përzemërsisht sa herë vinte dhe më linte bakshishe të mira. M'u kujtua edhe debati që bëri me zonjën, me sa dukej, xheloze për atë çka ajo mendonte se ishte bakshish i tepruar. Nuk arrita të dëgjoja se çfarë tha ajo, por kur ai iu përgjigj dëgjueshëm: “Vajza flet greqisht, more!”, sikur nuk kishte sesi të mos e shpërblente një kënaqësi të tillë, i dha fund debatit.

E pashë që erdhi në disko edhe disa herë të tjera vetëm, kur ulej te banaku dhe përpiquej të hynte në bisedë me mua. Më duhej vetëm të mblidhja ca guxim dhe ta haja turpin me bukë për disa minuta duke i kërkuar një vizë greke. Dhe ashtu bëra kur erdhi herën tjetër. Më dha kartvizitën dhe më ftoi në zyrën e tij për një takim të nesërmen.

Kur mbërrita te zyra e tij, e shndërruar nga një hyrje apartamenti, siç ishin shumica e zyrave të reja private, më përshëndeti sekretarja e tij e gjatë dhe shumë e bukur, gjë që më çliroi nga frika që po hyja vetëm në një apartament për të takuar një të huaj të pashëm. Ndërmarrjet private ishin një koncept vetëm dyvjeçar në vend dhe ishte një pellg i turbulluar shpesh nga prostitucioni. Një e re si unë duhej të kishte shumë kujdes me kufijtë jo dhe aq të dukshëm.

Kisha pësuar një mësim të tillë jo shumë kohë më parë, kur njëri prej drejtorëve të një organizate të Kombeve të Bashkuara në qytet kishte ardhur një natë në disko i rrethuar nga disa prej bukurosheve që punonin për të. Ishte një burrë i shkurtër mustaqespicë në të gjashtëdhjetat, me prejardhje iraniane. Dukej se e njihte Petritin personalisht. Kur erdha për t'u sjellë porosinë, e dëgjova duke thënë në anglishten e rënduar nga theksi i lindjes së mesme: “Unë mund të ta merrja sa të hapësh e të mbyllësh sytë po t'i ofroja një vend pune te zyra ime”.

E kuptova që e kishin fjalën për mua dhe buzëqesha duke menduar sa të drejtë kishte. Do ta doja shumë një punë dite të paguar mirë, ku do të flisja

anglisht për më të shumtën e ditës në një organizatë kaq të respektuar. Në fund të fundit, për një punë të tillë e kishte patur fjalën edhe Omari gjithë kohën. Por kujtova se plaku po thoshte gjëra të tilla sa për t'u mburrur derisa më dha kartvizitën e tij dhe më kërkoi ta takoja të nesërmen në sallën e pritjes së hotel Dajtit. Unë ngela pa mend nga mundësia dhe fshiva mënjanë çdo dyshim mbi vendin e takimit thjesht ngaqë ishte e dielë. Do të kishte patur më shumë kuptim të më merrte në intervistë te zyra e tij, po atëherë do t'i ishte dashur të priste edhe një ditë më tepër. “Qenka edhe ai po aq i kënaqur të më punësojë sa jam unë për të punuar për të!” – mendova.

Megjithatë, të nesërmen në mëngjes, u paraqita te salla e hotelit në kohë. Kur u takuam, plaku tha se i duhej të kalonte nga shtëpia e tij për të marrë diçka dhe mua më vinte rëndë të refuzoja ose të mendoja ndonjë sebep të shpejtë për të dalë nga situata. *Do ketë rrjedhur nga mendtë po të jetë duke planifikuar çka po mendoj unë! O kam unë mendje të ndyrë që më vete për kësi gjërash, ose po më ulëret intuita: “Mos shko!”*

U ula me të në sediljen e pasme të makinës si në gjemba duke menduar për vendet më të volitshme ku mund ta godisja për ta mposhtur. Më erdhi ndër mend një histori e vjetër që më kishin thënë vëllezërit për një zënie të shkurtër të një fqinjit tonë. Sa e goditi kundërshtarin në grykë me anën e shuplakës së tendosur, kundërshtari i tij ra në shesh pa frymë, me gjuhën në fyt.

Kur mbërritëm tek shtëpia e tij, plaku më ftoi brenda për një filxhan çaji. E ndoqa brenda, ku gjetëm një usta shqiptar duke punuar në ca riparime të kuzhinës. *Falemnderit, Zot! Mora frymë e çliruar dhe ngela duke kafshuar buzët që të mbaja të qeshurën. Nuk isha e sigurt çfarë më lumturoi më tepër: fakti që Perëndia më kishte dalë në mbrojtje edhe një herë apo thjesht që m'u kursyen detajet e shëmtuara të asaj çka kishte plaku ndër mend.*

Plaku e kishte të vështirë të fshihte inatin dhe zhgënjimin e tij. E përshëndeta ustanë me buzëqeshjen më të sinqertë, duke falenderuar atë dhe Perëndinë me gjithë qenien time. Nuk më duhej ndonjë fe e madhe të shikoj dorën e Perëndisë duke më tërhequr nga budallallëku im në mëshirën dhe hirin e tij herë pas here. E lamë shtëpinë dhe u futëm përsëri në makinë. Shoferi na çoi te zyra, ku bëra intervistën e duhur, si përfundim.

- Arsyeja për të cilën po të marr në intervistë është se kam një vend të hapur. Ndhmësja ime personale është duke u larguar për një detyrë tjetër dhe më duhet ta zëvendësoj. Sapo të ikë, vendi është i yti! – premtoi ai në fund të intervistës.

E falenderova dhe u largova tashmë e pasigurt nëse duhej të ndjehesha e gëzuar për mundësinë e re të punësimit apo të rrija sa më larg një njeriu

të tillë. Sekretarja që po ikte më kishte thënë që puna rezultonte në shumë udhëtime jashtë shtetit me shefin. Më bezdiste ideja e të qenit në të njëjtin hotel me të gjithandej nëpër botë. Por m'u kursye mëdyshja më në fund, kur sekretarja e tij u bë pishman për largimin e saj.

Bota e punës ishte shumë më e ndryshme nga ditët e shkollës; më kishte hapur sytë ndaj realitetit. Më kishte bërë të kuptoja që mosha dhe pamja nuk kishte të bënte fare me shpresat e një burri për gratë e reja. Siç kisha dëgjuar tim atë të thoshte sa herë shikonte ndonjë grua të bukur përkrah një burri të shëmtuar: “Opo në femër ka pjesë edhe qeni!”.

- Pse do të shkosh në Greqi? – më pyeti tregtari grek duke më shkundur sërish në të tashmen.

- Për të shkuar pas një djali që dua, – iu përgjigja me sinqeritet dhe ula sytë nga zori. Ndjeva një afsh të nxehtë duke m'u lëvriur në gushë e faqe.

- E di ti që, kur isha unë i ri dhe i dashuruar, - tha, - udhëtova me kilometra dhe orë të tëra për të shkuar e takuar vashën që doja? Nëse të do vërtet, është ai që duhet të vijë tek ty në vend që ta ndjekësh ti.

- Me tha vetë që të shkoja tek ai. Nuk kam ndër mend të rri në Greqi. Është vetëm një hap për të kaluar në Londër, - iu përgjigja paksa e ndrydhur nga e vërteta në përgjigjen e tij. Po nuk prisja ta kuptonte mahnitjen e Teos dhe gjithë të rinjve shqiptarë me botën e jashtme dhe liritë që gëzonte. – Nuk është se më la mua. Unë thjesht nuk jetoj në shtetin e duhur! – u përpoqa gjithsesi.

Më kërkoi pasaportën dhe më premtoi se do të bënte ç'ishte e mundur të më siguronte çka i kisha kërkuar. E falenderova sinqerisht dhe u largova me një ndjenjë të mrekullueshme që të kap kur ndeshesh me mirësi të mirëfilltë, pa prapaska. Ja ku ishte prapë: ajo ndjenja e pagabueshme e hirit hyjnor, shpresa gjithmbështjellëse që çdo gjë do të dilte mirë.

Teo kishte mbërritur në Angli dhe unë mezi po prisja t'i shkoja atje së shpejti. Njoftova drejtorin për nisjen time të ardhshme dhe ai filloi të merrte në intervistë ish-studente të tjera të bukura e të reja që kishin ndjekur shembullin tim për të ndenjur në kryeqytet pas përfundimit të shkollës. Shefi mori në punë Rudinën, një vajzë të gjatë, të bukur dhe me trup të lidhur, e cila ishte marrë gjithë jetën me basketboll e unë kisha një shtysë të pandalshme për të bërë mundje krahu me rulen. Ndoshta kishte të bënte me pengun që nuk më kishin lejuar të luaja basketboll dhe tani doja të provoja forcën time. Ose ndoshta isha xheloze që shefi më zëvendësoi që pa ikur ende dhe doja një çikë hakmarrje të ëmbël para se të ikja për fare. Rudina e pranoi sfidën

me besim dhe u ulëm të dyja përballë njëra-tjetrës në kolltukun e parë të rrethuara nga dy kamarierët e tjerë dhe shumica e personelit mbështetës.

Sapo filloi ndeshja, unë e kuptova që Rudina ishte një kundërshtarë e denjë, siç e kisha imagjinuar duke gjykuar nga krahët e saj të gdhendur. Fillimisht, krahu i Rudinës po anonte mbi timin derisa ndesha sytë e zinj të Benit, që kaloi aty pranë drejt fundit të diskotekës. Mora zemër dhe ndjeva një forcim të papritur të krahut që erdhi nga nuk e di se ku. E shtyva krahun e kundërshtares drejt e pastaj në anën e saj, pikë në të cilën Rudina e tërhoqi nga ndeshja dhe u ngrit në këmbë para se ta përfundonim. Unë kërceva nga vendi me gëzim duke bërëtitur pa besuar as vetë: “Fitova! Fitova!” pa i vënë veshin arsyeve të Rudinës se gjoja nuk ishte gati.

- Mund të të dukem me fiksime për këtë që do të të them tani, po mua m’u duk sikur më dhe fuqi nga e jotja kur kalove! – i thashë Benit më vonë te banaku. – Ndoshta më ndihmoi fakti që pashë krahët e tu masivë dhe mora kurajo si me magji. Mos po uroje që të fitoja unë? – vazhdova.

- Edhe sikur; e çë pastaj? Beson ti se është e mundur të sjellësh diçka në ekzistencë vetëm duke uruar? – përqeshi Beni.

- Kam dëgjuar një herë zyshën e teorisë marksiste-leniniste në gjimnaz të tallej me këtë ide për të përshkruar fetarët e perëndimit, por arsyetimi i saj kundër vetë idesë tingëllonte i vulgarizuar dhe aspak bindës. Po ti, beson se është e mundur? – e pyeta.

- Unë besoj se ka shumë më tepër në botën shpirtërore seç (nuk) na është mësuar, - u përgjigj Beni dhe më thithi edhe më tepër. Një djalë i ri që mendonte për botën shpirtërore!

- E di; si ëndrrat që shikoj shpesh.

- Çfarë lloj ëndrrash? – pyeti Beni.

- Më shumë llojet paralajmëruese – ato që parashikojnë të ardhmen. Ato s’ke si i justifikon. Më e frikshmeja që kam parë deri tani ka qenë për një dajën tim që më donte fort. Vdiq para dy vjetësh dhe më kishte dalë në ëndërr nga dy herë si për të më kërkuar t’i veja te varri, por nuk ua vura veshin ëndrrave për disa muaj, pa qenë e sigurt se çfarë duhej të bëja. Vetëm më shfaqej dhe buzëqeshte, por në të tretën, sikur më kërcënoi. Po rrinte më këmbë në fund të shkallëve të shtëpisë sime dhe nuk pranonte t’u ngjitej derisa të shkoja ta ngrija në krahë. Kur e ngrita, papritmas u rëndua shumë, m’u përthyen gjunjët dhe desh rashë nën peshën e tij. Kur i thashë mamasë, që e njej frikën e Perëndisë, ajo këmbënguli që t’i vija veshin ëndrrës dhe t’i shkoja te varri. I hipa autobusit për tek e bija e tij e martuar, që është vetëm disa vjet më e madhe se unë dhe banon një orë nga fshati ku i ishte varrosur i ati.

Ajo u çudit kur më pa në sezon shkolle, por kur i shpjegova arsyen e vizitës sime, nuk ngurroi të më shoqëronte. “Kam dashur të shkoja atje edhe për vetë”, - tha dhe u nisëm të dyja më këmbë në anë të rrugës duke shpresuar për ndonjë makinë të rastit. Nuk kaloi shumë, kur një djalë i ri në të njëzetat e vonshme kaloi me makinë dhe ndaloi për të na pyetur se për ku ishim. Ai pranoi të na merrte dhe, edhe pse me frikë, ne u futëm të dyja në ndenjësën e pasme të makinës së tij dhe u nisëm për rrugë. Po rrinte në heshtje dhe, pasi e kishte ngarë për disa minuta, e ndali në anë të rrugës dhe doli nga makina. Ne vështroam njëra-tjetrën edhe më të frikësuar se më parë dhe filluam t’i luteshim Perëndisë. Pastaj hodha sytë mbrapa makinës dhe pashë shoferin në ecejake disa herë, duke pirë duhan dhe gjithçka mendoja ishte se po përpiqej të gjente një mënyrë se si të na përdhunonte. Më në fund, u fut në makinë dhe filloi ta ngiste sërish derisa mbërritëm të sigurt në vend.

- Nga e di ti që do t’ju përdhunonte? – kundërshtoi Beni.

- Mund të ketë qenë e tëra në imagjinatën time dhe të kushërirës, po fakti është që unë u ndjeva e kërcënuar dhe për këtë më paralajmëroi ëndrra, - ia ktheva.

- Bëj shaka. Në fakt, unë merrem edhe vetë një çikë me ëndrrat, – tha Beni.

- Çfarë do të thuash? – e pyeta.

- Ke për ta parë vetë kur të flesh sonte. Po mos e mbyll dritaren! – tha Beni.

- Nuk është se do ngjiteshe deri në kat të dytë, apo jo? – pyeta pa e pasur idenë se ç’kishte ndër mend.

- Jo ashtu si mendon ti! – tha Beni dhe qeshi duke shijuar paqartësinë time.

- Dhe unë kujtoja se vetëm grave u interesonin këto gjëra, - vazhdova duke kujtuar fqinjen që më shikonte filxhanin ndonjë herë dhe gra të tjera myslimane, për të cilat kisha dëgjuar së fundi. Qindra nëna mërgimtarësh nëpër botë çonin ndonjë veshje të fëmijëve si shenjë tek vendet “e mira”. Sillnin qirinjtë për të nderur dhe para për të lënë atje në shpresë të dëshpëruar për ndonjë lajm nga fëmijët e tyre.

Por kur e pashë në ëndërr shokun e punës po atë natë, u trondita vërtet.

Isha shtrirë në krevatin tek kur erdhi Beni nga dritarja e dhomës dhe u shtri përmbri meje. Fillimisht, m’u bë si të ishte një vëlla i vogël, që kishte nevojë për ngrohtësi dhe rehat, por, kur u përpoq të rrotullohej mbi mua, e shtyva mbrapsht me autoritet atje ku ishte, si për t’i thënë: “Mos e tepro!” dhe ai u bind, si të ishte kapur në faj.

Kur u zgjova, nuk më besohej sa e gjallë më ishte dukur ëndrra. Do të ishte shumë e çuditshme t'i dilja përballë atë ditë në punë. Kur mbërrita atje, Beni vetëm sa më hodhi një sy me ngërdheshje, si për të thënë: "Hë, si t'u duk?" dhe po priste përgjigjen time pohuese. Ia ktheva me buzëqeshje dhe tunda kokën.

- Ti edhe e di që ndodhi? Si e bën? – e pyeta duke u ndjerë në siklet për sa dinte nga ëndrra. – Nuk ka as kuptim!

- Ti e le dritaren hapur, - u përgjigj duke fshirë banakun.

- Lesh me qime! – ia prita ende e çuditur. – Domethënë boll të mbyll dritaren dhe ndoshta të lutem para se të fle?

- Lutu sa të duash; nuk më ndalon dot! – m'u përgjigj Beni.

- Unë mund t'i lutem Perëndisë për çdo gjë dhe ai e bën për mua.

- Çdo gjë? – pyeti Beni.

- Çdo gjë! – iu përgjigja me bindje. – Ashtu e lexova në Bibël dje. Puna është të mbaj mend që të lutem, siç bëra rrugës për te varri i dajës, e mban mend?

- Siç të thashë, ajo mund të ketë qenë e gjitha në kokën tënde ose thjesht rastësi, - debatoi Beni.

- Janë shumë për të qenë rastësira. Dëgjo këtë tjetrën. Një ditë, kur po dilja nga shkolla me shoqen e dhomës, po binte shi dhe ne ndalua për disa minuta nën kolona duke pritur që të pushonte shiu sado pak. Më vajti mendja të lutesha që të ndalonte shiu. Vetëm disa çaste pasi mbarova së luturi, pamë babanë e shoqes sime duke iu ngjitur shkallëve. Ai kishte ardhur që nga Fieri për punë dhe shoferi i tij e kishte kaluar nga shkolla për të takuar të bijën për disa minuta. Ai na çoi të dyjave me makinë deri në konvikt dhe mua nuk më besohej sapo ç'kishte ndodhur. Perëndia nuk e ndaloi shiun, por na dha të dyjave një xhiro në të thatë deri ku na duhej të shkonim.

Beni doli shpejt e shpejt nga banaku dhe erdhi e më mori për dore. – Hajde me mua. Dua të të tregoj diçka.

I ndoqa hapat e tij të shpejtë nëpër shkallë, mbas godinës deri te buza e një grope dhjetë metra të thellë, që një firmë Zvicerane kishte gërmuar pas disko-klubit për të ndërtuar një hotel me parkim të nëndheshëm.

- Po të kesh vërtet aq besim sa thua se ke, hidhu dhe nuk ke për t'u vrarë, – tha Beni.

Unë hodha sytë poshtë në greminën artificiale për një çast. Diçka brenda vetes më thoshte të mos e bëja, por nuk ishte e tëra frikë. Nuk i trembesha hedhjes apo dhembjes aq sa të bërit për budalla.

- Nuk e di pse, po nuk më duket e drejtë të lutem në atë mënyrë, - i thashë dhe u kthyem brenda. Më vinte inat që nuk gjeja dot fjalët tamam se përse nuk ishte ide e mirë.

- Pse nuk e pohon që nuk ke dhe aq besim sa thua?

- Ndoshta ke të drejtë, por më duket e kotë të lutesh për diçka të tillë. Nuk është se ti më shtyve papritur, ose isha në rrezik jet'a vdekje për arsye që nuk i kisha në dorë, - iu përgjigja ende duke u përpjekur ta kuptoja jo vetëm për Benin, por edhe për veten time.

Më trazoi mendimet gjatë pas diskutimit tonë. Të nesërmen, hapa Biblën mu tek pjesa ku djalli vendosi të tundonte Jezusin pasi kishte agjëruar për dyzet ditë. Pothuajse kërceva dhe bërtita me gëzim kur lexova se si djalli e tundoi Jezusin që të hidhej nga maja e tempullit, siç më kishte cytur Beni një natë më parë. Ishte sikur Perëndia e kishte parë dhe dëgjuar çdo gjë që kishte ndodhur dhe tani po më jepte përgjigjen që më ishte dashur aq shumë një natë më parë. Nuk më pritej sa t'ia thosha Benit të gjitha. Sapo mbërrita në punë atë mbrëmje, iu afrova me buzët vesh më vesh dhe i thashë: "E gjen dot se çfarë lexova në Bibël sot?".

- Çfarë? – pyeti Beni.

- Shikoje vetë! – i thashë duke shtyrë mbi banak Biblën e hapur që ta lexonte.

Beni e lexoi dhe buzëqeshi, po nuk tha gjë.

- Perëndia iu përgjigj edhe kësaj pyetjeje! – thashë me ngazëllim. Nuk kisha më asnjë dyshim që Perëndia ishte i vërtetë dhe shumë pranë.

Sigurisht, marrja e vizës greke brenda dhjetorit e forcoi edhe më tepër besimin tim që asgjë nuk është e pamundur me Perëndinë. Ndjehesha përgjithësisht sikur po shkisja majë një dallge të lartë në këtë pjesë të jetës sime. Ndjehesha e bukur, e dëshiruar, energjike dhe me besim në vetvete.

Nga fundi i dhjetorit, po kaloja edhe një herë kufirin për në tokën e bukur e tashmë të njohur të Greqisë duke ëndërruar ribashkimin me dashurinë time. Kalova natën e vitit të ri, më të festuarën e vitit në Shqipëri, me vëllanë dhe familjen e tij. Hëngrëm kaposh deti të pjekur dhe bakllava, siç bënim gjithmonë në shtëpi, por më mungonin gjithë këngët dhe koncerti variete me të cilat ishim mësuar natën e fundit të vitit e deri në orët e para të mëngjesit të vitit të ri. Për ta bërë edhe më të trishtueshme, Maria vendosi të kërcente sipas një bejteje që ma këndoi, pasi kishte pirë nja dy gota vere:

*“O trëndafili me vesë,
sakëm se kërkon martesë,
sa të vesh njëzet e pesë!”*

Nëse kjo ishte ndonjë lloj profecie, ishte zhgënjyese; më thoshte të prisja të paktën edhe një vit e një çerek për t’u martuar.

Disa ditë më vonë, një nga komshiet erdhi me vrap duke thirrur emrin tim jashtë dere.

- Mirela, telefon për ty! – tha ajo me një frymë dhe filloi të vraponte prapë për te shtëpia e saj pas meje. Vrapova me sa fuqi që kisha për te telefoni i komshies.

- I thashë të merrte prapë pas dhjetë minutash, - shpjegoi Tula kur pashë receptorin e mbyllur.

- Falemnderit! – iu përgjigja e ndrojtur nga shikimet gjykuese të prindërve të moshuar të Tulës.

Tula dukej e kënaqur që isha kthyer prapë në lagjen e saj dhe ofroi të më tregonte gjithë shtëpinë derisa të binte zilja e telefonit. Ajo dhe prindërit e saj banonin në katin e dytë të shtëpisë së tyre trekatëshe prej betoni dhe tullash me bijën e madhe dhe familjen e saj në katin e sipërm. E gjithë shtëpia ishte shtruar me pllaka mermeri të zeza me ujëra të bardha – dyshemeja më e bukur dhe e pastër që kisha parë ndonjëherë. Babai dhe mamaja e Tulës ishin të parët që i kishin ofruar ndihmë dhe përkrahje vëllait tim dhe familjes së tij të re kur kishin ardhur fillimisht në qytet.

Ra zilja prapë dhe zemra ime kërcu me të. Vrapova përmes korridorit për tek telefoni në sallon, ngrita receptorin dhe dëgjova zërin qetësues të Teos në anën tjetër. Ndjeva nxehtësinë në faqet e skuqura, ndërsa fqinjët soditnin fytyrën time të lumtur, dhe u ula te karrigia përbri telefonit, duke u përkulur përpara si për të fshehur gëzimin.

- Paske kaluar! – tha Teo.

- Pate ndonjë dyshim ti? – iu përgjigja buzagaz.

- Njësoj si herën e parë kalove këtë radhë?

- Jo. Mora vizë të rregullt gjashtëmujore. Ma gjeti një tregtar grek që vinte shpesh te diskoteka.

- *Cherchez la femme!* – tha Teo, së cilës iu përgjigja me të qeshur. Kishte të drejtë; të qenit femër kishte avantazhet e veta.

- Si je ti? – e pyeta.

- Po shtrëngoj jastëkun, - tha ai dhe unë u gajasa përsëri.

- Mos më bëj për të qeshur. Po ngordhin këta të marrin vesh se çfarë po themi.

- Komshinjtë?

- Po. Janë shumë të mirë, po duken një çikë fanaticë për këto lloj gjërash, - iu përgjigja.

- Shkruaj adresën time para se të më mbarojnë paratë e kartës. Këtu do t'i dërgosh paratë dhe fotografitë për pasaportën, - tha Teo dhe unë i kërkova Tulës një laps e letër.

- Do t'ia kërkoj paratë vëllait se vetë nuk kam, - iu përgjigja pasi shkrova adresën.

- As unë nuk të ndihmoj dot. M'u desh t'i merrja hua të miat dhe nuk kam gjetur punë akoma. Pastaj, po përpiqem të filloj shkollën, - tha Teo.

- Do bëj si do bëj. Mund të më duhet të gjej një punë vetë këtu.

- Shpejt! – tha ai.

- Mirë, - ia ktheva dhe nuk prisja dot sa të shkoja të pyesja vëllanë.

Falenderova Tulën dhe prindërit e saj dhe e bëra gjithë rrugën në shtëpi me sparkata. Atje po më priste Maria me ankth për t'i dëgjuar të gjitha.

- Ai ishte? – më pyeti.

- Po! – ia prita unë e çelur.

- Çfarë të tha?

- Po shtrëngon jastëkun mes shalëve, - i thashë dhe u futa në shtëpi.

- Haaa! – qeshi Maria duke hedhur kokën mbrapa e duke kërkuar hollësisë të tjera.

- Pak folëm – besoj është shumë shtrenjtë – po i mora adresën. Ai po më pret t'i shkoj atje, - i thashë tim vëllai reagimi i të cilit, nga ana tjetër, nuk ishte dhe aq i gëzueshëm.

- Ku do vesh, moj? – pyeti dhe unë e dija nga vetullat e tij të mbledhura si re të ngarkuara që po afronte stuhia.

- Në Londër! – ia prita. – Më duhet vetëm një pasaportë, të cilën ma gjen ai për pesëqind dollarë siç gjeti të tijën.

- E kush të pret atje? – pyeti Loni prapë.

- Ai, ore! – iu përgjigja, gjithashtu me vetulla të ngrysur.

- Çfarë të ka ty ai? Ku është ai? Nuk e njoh fare. Po të dojë të vijë të të kërkojë dorën për martesë, jam më se gati të flas me të. Ose të dërgojë prindërit e tij tek yt atë dhe të të kërkojë si duhet. Nuk bëhen kështu këto gjëra! – përfundoi Loni.

- Ai nuk është këtu që t'i bëjë ashtu gjithë këto gjëra. Ato janë thjesht formalitete. Nuk jemi më në mot'n e baba Qemos, - ia prita e nevrikosur. –

Do m'i japësh paratë, apo jo? – vazhdova.

- E ke menduar ndonjëherë ti? Po sikur të të marrë pesëqinddollarshin me kush-e-di ça tjetër që të ka marrë dhe as i dëgjojmë zërin e as i shikojmë surratin më?

- Më ka vajtur mendja, po ai nuk është fare nga ata. Ne e duam njëri-tjetrin. Më lër të shkoj të bashkohem me të, - iu luta duke provuar zë më të qetë.

- Ty të ka lënë mendja, moj! Qysh do ta bëja një gjë të tillë? Ça t'i them tyt eti kur të më marrë në telefon herë tjetër që të flasë me “Lelën e babit”? Edhe sikur ta marrësh pasaportën, a nuk do jetë e falsifikuar? Ja të kapi policia rrugës dhe të degdisi në burg kush e di se ku? – u përgjigj Loni edhe më i skandalizuar, siç zbulonte një nga një gjithë të këqiat që mund t'i ndodhnin motrës së tij të vogël.

- Nuk jam më kalama! Mbush njëzetekatër për dy muaj! – i thashë dhe psherëtiva e mundur.

E dija që im vëlla kishte plot arsye me vend, përveç parave, për të mos më lënë të ikja, por nuk kisha ndër mend t'i vija kushte dashurisë sime të brishtë e të largët, sidomos ndonjë gjë që dukej si manipulim për të detyruar Teon të martohej me mua. U ndjeva e gozhduar për muri duke përpëlitur duar e këmbë e paaftë për të lëvizur përpara, por vendosa të gjeja një punë mu aty ku isha dhe t'i bëja paratë vetë. Ah sikur të kisha qenë një çikë më e mençur me paratë nga ditët e punës në diskotekë, në vend që t'ia jepja rrogat sime mëje! T'i kisha kursyer bakshishet, në vend që t'i bëja qejfin vetes me televizor të ri dhe gjoks pule të pjekur para pune pothuajse çdo natë. Megjithatë, pesëqind dollarë ishin, prapëseprapë, para e madhe.

Kishin kaluar pothuajse dy muaj dhe Teo nuk më kishte marrë më në telefon. Kjo po fillonte të më shqetësonte dhe po më bënte të mendoja se diçka nuk shkonte, edhe pse kisha frikë të mësohesha me këtë mendim. U përpoqa ta mbaja veten të zënë me punën e re që më kishte gjetur Maria për të mbledhur luleshtrydhe në një serë lokale. Pjesa më e vështirë e punës ishte zgjimi në pesë të mëngjesit. Pastaj ecja pesë minuta në errësi për te vendi i takimit për të kapur kamionin që mblidhte punëtorët nëpër lagje para se t'i çonte te serat e luleshtrydheve. Mbikqyrësi më vuri me një grua të shkurtër e të ngjeshur që të më tregonte si të mblidhja luleshtrydhet e pjekura dhe të më nxiste të mbaja ritmin me të tjerët. M'u deshën nja dy ditë, por si përfundim

munda t'i arrija. Mbajtja parasysh e qëllimit final më ndihmoi për dhimbjen e mprehtë të kërbishtit nga të ulurit në bisht tetë deri në dhjetë orë në ditë.

Sapo mora rrogën e parë, vendosa t'i bëja një zë Teos. Më frikësonte e vërteta që mund të përballoja pasi të flisja me të, por padija ishte edhe më keq. Mendova edhe arsyen për ta marrë në telefon, në rast se dilja si qaramane apo e paduruar. Shkova te posta qendrore, ku mund të flisja nga një kabinë e qetë dhe i rashë numrit. Teo e ngriti mbas dy-tri dopjo zillesh dhe unë dëgjova edhe një herë zërin e tij të mrekullueshëm, për të cilin kisha aq shumë mall.

- Si je? – e pyeta.

- Mirë jam. Po ti? – m'u përgjigj.

- Gjeta punë. Mbledh luleshtrydhe në një serë. Është punë e rëndë dhe më dhemb mesi gjithë ditën, - i thashë pa e kuptuar që po qahesha dhe peshkoja për mbështetje. Kjo ishte pjesa ku e prisja të më thoshte: “Ah, i shkreti unë për ty!” në përgjigje.

Në vend të saj, tha: “Puna të bën mirë. Do të të mësojë vlerën e lekut!”, duke më lënë pak të zhgënjyer kur shmangu supin që më duhej për t'u qarë. Kështu që m'u duk e kotë t'i përmendja mundësinë për një punë më të lehtë që më kishte ofruar së fundi një pronar lokal nga ana tjetër e qytetit, i cili kishte ardhur te shtëpia një ditë pasi na kishte ardhur për vizitë inspektori që më kontrollloi vizën.

- Rrofsh për kurajon! – i thashë. – I more fotografitë e mia për pasaportën? – e pyeta për të ndërruar temë.

- I mora. Paskë ndryshuar shumë që kur kam ikur. Të mbaja mend shumë më simpatike! – tha me shaka nga ana tjetër.

- E kush del mirë për pasaportë? – ia prita e indinjuar nga humori i tij pa takt.

Nuk e dalloja dot më nevojën apo padurimin për të më pasur atje siç e kisha dëgjuar herën e fundit që folëm. Teo dukej i shtruar dhe me besim në jetën e tij të re dhe mua më tmerroi edhe më tepër ideja që nuk i pëlqeja më. Kështu që më vonë atë ditë, kur Maria sugjeroi t'i zverdhja flokët edhe më, unë fillova pa humbur kohë. Bleva një kuti të re boje dhe Maria m'i leu flokët në shtëpi. Sapo më preku boja zhapën e kokës, fillova të ndjeja një djegie intensive gjithandej dhe nuk u përmirësua as pasi e lava. Kur pashë veten në pasqyrë, e urreva ngyrën e re, shëmbëlltyrën e re dhe mënyrën se si më bënte të ndjehesha. Ngela duke krruar kokën dhe shkukur flokët për të gjetur derman, por më kot. Ah sikur ta ktheja kohën mbrapsht dhe të filloja nga e para!

Nga e para... çfarë ideje! Papritmas, më mbyti një dëshirë për ta rruar

të gjithën. A nuk kishte thënë mami që duhej të ma kishte bërë që kur isha bebe? Mami besonte se një rruarje e mirë do ta trashte dhe forconte qimen, por nuk i bëri zemra kurrë të më rruante kaçurrelat e verdha. Sa më shumë mendohesha, aq më e fortë bëhej ndjesia, derisa u bë vendim. Dola te oborri për të kërkuar Robertin, vëllanë e Maries, një djalë nga fundi i të njëzetave, që sapo ishte fejuar dhe kishte ardhur në Greqi për të zënë ndonjë lek para se të martohej. I ishte bashkuar familjes pak pasi kisha ardhur unë dhe do të rrinte me ne për ca kohë. Kishte qeruar depon përdhese përbri shtëpisë dhe e kishte kthyer në dhomë gjumi për veten e tij.

- Berti, do më bësh një nder? – e pyeta duke mbajtur me zor të qeshurën me vendimin tim impulsiv.

- Çdo gjë për ty! – m'u përgjigj Roberti.

- Merre briskun dhe futi një të rruar kësaj rradakes sime, - i thashë.

- Pse?! Je e sigurt? Nuk duket dhe aq keq! – tha i befasuar dhe i argëtuar në të njëjtën kohë.

U përpoq të më mënjanonte nga një vendim për të cilin mund të pendohesha për një kohë të gjatë, por çdo përpjekje për të më ndërruar mendjen e ngjeshur, pasi e kisha ndarë, vetëm përforconte bindjen time për të vazhduar gjithsesi.

- Po sikur të të bëhet pasaporta dhe të të duhet të ikësh për Londër? Qysh do t'i dalësh përpara dashnorit? – vazhdoi, por as ironia e tij nuk bëri punë.

- Pse, ç't'u bë ty? – e pyeta, siç u ula në karrige përjashta para banjës dhe dhomës së Robertit.

- Si, moj, ç'm'u bë mua? Më ke premtuar motorin sa të vesh në Londër.

- U, po. Po vajta, do të ta dërgoj motorin me apo pa të. Rruaje tani! Nuk duroj dot më.

- Sa shkurt?

- Zero. Po në zhaptë, ama! – e sigurova dhe ai vazhdoi me *Bic*-un, ende duke qeshur nën hundë pa u besuar syve.

- Obobo! Do bëhesh pishman si qeni! – tha Roberti me frikë se do të zgjohesha nga hipnoza dhe do t'ia vija fajin atij që më erdhi pas avazit gjatë shembjes momentale të gjykimit tim.

Nuk ç'bëhej dot ç'ishte bërë tashmë. Për çudinë e tij, unë nuk u "përmenda" kurrë. Shkova dorën mbi kokën zmerile dhe mora frymë e çliruar me heqjen e gjithë flokut. M'u duk sikur kisha hequr një barrë të rëndë nga shpatullat dhe floku i ri do të sillte një fillim të ri. Tani do të kisha një arsye më tepër për të kthyer mbrapsht çdo fqinj që përpiqej të më bindte të dilja darkave me të birin.

Herën tjetër që shkova për të mbledhur luleshtrydhe, dëgjova punëtorët e habitur tek pëshpërisnin mbas shpine: “Ishte goc’e bukur!”. Bëra sikur nuk kuptova asgjë nga ç’thoshin dhe bëra timen për të mos u vënë veshin, por presioni dhe turpi doli më i fortë se vullneti im, kështu që vendosa të flija vonë të nesërmen dhe nuk shkova më për të mbledhur luleshtrydhe.

Pronari i lokalit ishte po aq i habitur dhe i zhgënjyer të më shilte pa flokë të nesërmen, kur erdhi të më merrte për një turne në punën e re të mundshme.

- Ç’e gjeti? – pyeti Marien sapo pa kokën time të rruar.

- I bëri reaksion boja e flokëve! – shpjegoi Maria.

Qëndrova te lokali për nja dy orë dhe ndoqa udhëzimet e pronarit për të qenë sa më e qeshur me klientët, por unë nuk isha më e gëzueshme dhe e sigurt në vetvete. Nuk mund ta kuptoja nëse i kisha humbur me humbjen e flokëve apo ngaqë isha në dhé të huaj dhe kuptoja shumë pak nga gjuha. Sido që të ishte, unë nuk isha më ajo që kisha qenë në diskotekën që lashë mbrapa, ku isha në qendër të vëmendjes së gjithë klientëve beqarë, duke kërcyer dhe vrapuar mes të dehurish të lumtur, ndërsa korrija sa komplimenta po aq edhe bakshishe. Tani isha e ndrojtur dhe mezi i flisja ndokujt. Shefit iu desh të më kujtonte të buzëqeshja disa herë brenda dy orëve që kalova atje.

- Nuk e bëj dot! – i thashë si përfundim dhe mora një taksì për në shtëpi.

Sa më pak dilja nga shtëpia, aq më e vështirë bëhej të dilja sërish. Kishin kaluar muaj dhe Teo nuk kishte telefonuar. Po zhytesha gjithnjë e më thellë në realitetin e ngrysur që as që kishte për të më telefonuar më kurrë, por nuk e kisha idenë se pse. Thjesht nuk e imagjinoja dot përkrah një gruaje tjetër, por nuk kisha guximin ta telefonoja dhe ta merrja vesh.

Megjithatë, fillova të mendoja se mos depresioni im kishte edhe një arsye tjetër – një më pak “të natyrshme”. Fillova të lloishesha nëse Maria kishte patur të drejtë kur më kishte paralajmëruar për Tulën dhe t’ëmën.

Po më dukej e vështirë të besoja gjithë lajmet e fundit për magjinë e zezë në zonën tonë dhe vdekjet e të rinjve të shkaktuara prej saj, edhe pse nuk ishte hera e parë që kisha dëgjuar gjëra të kësaj natyre. Kisha dëgjuar plot historira magjie kur isha e vogël, megjithëse jo të së njëjtës peshë, por nuk mendoja kurrë se gjëra të tilla mund të ndodhnin në një komb besimtar në Krishtin si ky.

Hera e parë që dëgjova për magjitë ishte tek dasma e çuditshme e xhaxhait tim. Isha shumë e vogël dhe nuk e kuptova pse xhaxhai po e ngrinte nusen në krah mbi një gardh manaferrash që rrethonte kopshtet e gjyshit në vend që të kalonte nga rrugica e hyrjes. Më vonë, dëgjova që xhaxhai, në kundërshtim

me babanë tim që zhvlerësonte çdo gjë fetare, ishte shumë i kujdesshëm, veçanërisht në dasmën e vet. Kishte dëgjuar për nja dy gra të liga të lagjes, që e kishin për zakon të rrëzonin thonj dhe qime të prera të bëra shuk në rrecka të koklavitura me shpresë që t'i shkelte nusja dhe dhëndri rrugës për te pragu i derës. Supozohej të ndillnin zënka dhe sherr në familje dhe, si përfundim, të prishte martesën. E xhaxhai im nuk ishte duke e vënë në provë vërtetësinë e bestytnisë.

Por a mund të ishte magjia ajo që po i ushqente problemet e mia? Maria ishte e para që e sugjeroi. Aq sa pak të ngjarë kishte teoria e saj, duke marrë parasysh dëshpërimin tim për përgjigje, kishte më tepër kuptim se sa heshtja e të dashurit tim të humbur prej kohësh.

- E mban mend kur na sollli një tavë peshku Tula me t'ëmën një herë dhe ti kullufite gjithçka kishte ngelur? – kishte sugjeruar Maria.

- S'e kisha idenë që nuk e kishe bërë ti atë. Ishte shumë e mirë! Do ta kisha ditur po të mos isha aq e lodhur dhe e uritur nga puna në fushë gjithë ditën e ditës, - e ngacmova. – Thashë shpyqyr që kishte ngelur ca për mua.

- Kur s'të lë të ngordhësh për të ngrënë unë ty dhe tët vëlla për ditë, - ma priti Maria.

- Bëj shaka; ti je kuzhinieri e mrekullueshme! – i thashë. – Unë nuk kam ngrënë kurrë makarona më të mira se të tuat. Po a nuk gatuanin komshinjtë për ty më parë? – e pyeta.

- Gatuanin kur erdha në fillim. Ishin shumë të mirë për sa kohë që ishim nevojtarë. Pastaj kur na panë të ngriheshim e të ecnim me këmbët tona, hyri xhelozia.

- Po pse mendon se mund t'i kenë bërë diçka këtë radhë? – pyeta në përgjigje.

- Sepse ti i bën xhelozë. Vë bast që në ato pak muaj që ke ti këtu si vizitore, ke pasur më shumë kërkesa sesa Tula gjatë gjithë jetës, - vazhdoi Maria. – Duhet të kishim përdorur telefonin e një komshiu tjetër dhe ti duhej ta kishe mbrojtur një çikë më mirë atë që konsideron të çmuar. Mos ji kaq naive dhe e çiltër me gjithkënd që të del përpara herë tjetër. Të tregoi ajo ndonjëherë ndonjë gjë për veten e saj?

- Jo, po ti vetë the që asaj nuk i ndodhin dhe aq në jetë. Ajo ka qenë shumë e mirë me mua. Më mori me vete natën e karnavaleve. Veshëm maska dhe shkuaam derë më derë. Ishte qejf! – thashë e hutuar.

- Asnjë nuk thotë dot gjë me siguri. Nuk pamë gjë. Thjesht po të them që kur s'i mban dot as vetë sekretet e tua, mos prit të t'i mbajë dikush tjetër.

Ndodhi menjëherë pasi të mori në telefon. Nuk të mori më në telefon pasi hëngre tavën, sikur u bë pishman brenda natës.

- Ashtu ndodhi vërtet, po prapë . . . Unë isha në shtëpinë e tyre të Premten e Zezë, para Pashkës. Ata nuk hëngrën as mish për një javë të tërë deri të dielën e Pashkës. Si mundet robi të ndjekë me kaq fanatizëm ritet e krishtërimin dhe të ushtrojë magjinë e zezë në të njëjtën kohë? – pyeta duke u rrokur me mendimet e mia.

- Me të njëjtën fytyrë që shkojnë në kishë çdo të dielë për “t’u rrëfyer dhe pastruar nga mëkatet javore” pasi kanë parë filxhanët e kafesë për të parë “fatin” gjithë javën. Pse, kujton ti, nuk besoj në Krishtin e tyre unë? – u përgjigj Maria. – Ç’ë mirë po të vjen ty nga leximi i Biblës tënde çdo ditë? – vazhdoi.

- Më mahnit – këshillat e Jezusit dhe këndvështrimi i tij! Më duket sikur po më flet mua personalisht. Më qetëson. Provoje një herë. Mbase nuk do të ishe aq e nevrkosur sa je, duke bërë titur dhe mallkuar tim vëlla e nipërit e mi me gjëra të tmerrshme të paimagjinueshme, - i thashë.

- Nuk zë mallkimi i nënës. Nga i babait ruaju! – u përgjigj Maria.

- Unë nuk mbaj mend të na mallkonte as nëna as babai, - i thashë.

- Nuk është se kishte të bënte me leximin e Biblës, apo jo? – u përgjigj Maria.

- Jo. Fatkeqësisht, ata e nxunë kuptimin e mallkimeve nga përvoja e tyre. Jam e sigurt që kanë të dy figura shumë të gjalla bebesh të vdekura dhe varresh të hapura që ti i uron kaq lirshëm mbi djemtë e tu dhe vëllanë tim. Po t’i dëgjonte mami gjithë gjërat që u thua, do të t’i thante buzët dhe do t’i kthente të gjitha mallkimet mbi kokën tënde.

- Ç’thua, moj? – pyeti Maria.

- E dije ti që unë jam, në fakt, foshnja e tetë në familje? Mami bëri një dy djem të manekur para se t’i vdiste një vajzë një vjeç e gjysmë. Pastaj Verën trevjeçare e zuri meningjiti, ndërsa mami ishte duke lindur një djalë tjetër të manekur. Vera u paralizua kur i morën doktorët ujë palce për analizë dhe vdiq pas gjashtë muajsh, - tregova.

- E tmerrshme! Loni nuk m’i ka thënë kurrë këto. Prandaj të përkëdhelën ashtu ty ata. Ti ishe e shtrenjt’e vogl’e babil! – u përgjigj Maria.

- Edhe unë mavi dola, me kordon të mbështjellë rreth e rrotull fytyrës si djemtë e manekur më parë, po u ndodh një komshie në sallën e lindjes n’atë çast dhe e dinte pengun e s’ime mëje për një çikë çupë. Komshia ishte e shoqja e një doktori dhe i shkante fjala në spital. Kur pa që isha vajzë,

filloi t'u lutej mamive të bënin ç' ishte e mundur për të më shpëtuar dhe ashtu bënë. Mami tha që unë isha amaneti i plotësuar i t'atit. Kishte vdekur një vit e një javë para datëlindjes sime.

- Ndërsa ti kishe njerëz që po bënin ç' ishte e mundur të të shpëtonin, unë kisha njerëz që shfrynin nga inati që dola vajza e katërt në familje. Tim eti as që i bëhej vonë fare nëse rroja a vdisja që kur linda. Më mbështollën me një paçahure dhe më lanë të vdisja pranë oxhakut. Babai donte një djalë me patjetër. Po nënes i erdhi keq për mua, se i ngjaja një çupe trembëdhjetëvjeçare që i kishte vdekur nga temperatura e lartë! – tha Maria.

- Gjynah! S'e kisha idenë! – thashë duke ndjerë edhe unë keqardhje për kunatën. Refuzimi ishte diçka që nuk më shkonte kurrë për shtat. Dukej se nuk i shkonte as asaj.

- Nënja e mori përsipër të udhëtonte te gjendja civile më e afërt për të regjistruar lindjen time, meqë kisha lindur në shtëpi. Para se të nisej, pyeti tim atë çfarë të ma vinte emrin dhe im atë ia priti: “Mut, nuk ia ke vënë?”, - vazhdoi Maria dhe unë nuk e mbajta dot të qeshurën.

- Më fal, po është sa për të qeshur aq sa dhe për të qarë! – thashë duke qeshur. – Prandaj e ndërrova emrin kur u rrite ti? Ja, sot po e marr vesh që Refije do të thotë “mut” në turqisht! – vazhdova me ngacmim.

- Do të ta jap së prapthi në atë kokën e zbathur! – m'u hakërrua Maria duke ngritur dorën sikur do të bënte siç kërcënoi.

- Më fal, më fal, po ma solle në shteg! – i thashë duke sforcuar fytyrën serioze, ndërsa ajo vazhdoi, - Ma vuri emrin pas së bijës së vdekur, po, kur mbusha trembëdhjetë, edhe unë rashë me temperaturë të lartë dhe nënja u tremb se mos përfundoja si e bija. Më çoi te një baba bektash të më këndonte dhe jetova. Atje ma ndryshuan emrin.

- Uaaa, çfarë historie! Rrezik nuk e dije që edhe mami e çoi Xhimin te një baba si ai për ta kënduar kur lindi. Dervishi i shpoi veshët dhe im vëlla mbajti vëth floriri si shenjë e veçantë mbrojtje derisa vajti shtatë vjeç. Njëra nga vrimat është e hapur edhe sot e kësaj dite. Nuk i vdiq më asnjë bebe paskëtaj. Mua më duket se Xhimi ishte i përkëdheluri në shtëpinë tonë. Unë gjithmonë mendoja që kisha lindur pa dashje, se pasi djemtë u futën në shkollë, mami u kthye në punë, sikur ta kishin mbyllur hesapin e bebeve. Nëntë vjet më pas, unë përfundoj në çerdhe. Ajo akoma ndjehet fajtores për këtë, por, po të mos kishte vajtur në punë, nuk do të kishte marrë dot pension.

- Nuk i kam me shpirt asnjë nga mallkimet. Ndodh në inat e sipër, po nuk kam gjë në shpirt, - tha Maria.

- Mbase jo në shpirt, por duhet t'i kesh në kokë, se robi mendohet pa flet. Shumica e njerëzve, të paktën.

- Shiko çfarë lexova në Bibël për ato që diskutuam dje, - i thashë Maries të nesërmen, edhe një herë e mahnitur nga përkatësia e leximeve të mia. E kisha hapur Biblën tek Mateu 12:33: “Pema njihet nga fryti. O pjellë nepërkash! Si mund të flisni mirë kur jeni të këqij? Sepse ç’ka zemra qet goja. Njeriu i mirë nga thesari i mirë i zemrës nxjerr gjëra të mira, por njeriu i keq nxjerr gjëra të këqia nga thesari i tij i keq”, së cilës Maria iu përgjigj me tërbim.

- Ç’më bërtet mua? Bibla e tha. Mua më mahniti prapë që më ra ta lexoja mbi diçka që sapo kishim diskutuar dje. Sikur Perëndia po e dëgjonte dhe mori pjesë në bisedën tonë. Për këtë e kam fjalën kur të them që Fjala e Perëndisë më mrekullon, – iu përgjigja, në përpjekje për të qetësuar Marien e tërbuar, megjithëse nuk i zgjaste kurrë inati me mua.

KAPITULLI XIV

RRUGA E GJATË E KTHIMIT

Kaloja shumicën e ditës duke u kujdesur për dy nipërit e mi, ndërkohë që gjithë të tjerët shkonin në punë. Pjesa më e bukur e kësaj detyre ishte t’i vija të flinin për gjumin e drekës. E vija tetëmuajshin në karrocë dhe, sado që e zinte gjumi brenda minutit të parë të kasetës së “metaliksave” që kisha sjellë nga Shqipëria, vazhdoja ta dëgjoja të gjithë kasetën deri tek “Asgjë tjetër nuk ka rëndësi”, më e bukura nga të gjitha; *Kaq afër, pavarësisht sa larg . . .*

E kaloja kohën që më mbetej duke qëndisur qindra petale shumëngjyrëshe dhe gjethe në një mbulesë tavoline paje që më kishte gjetur Maria për ta punuar nga shtëpia. Pak pasi kisha përfunduar së qëndisuri mbulesën e tavolinës, Marica, fqinja përballë, ofroi të më merrte me vete tek një punishte e vogël ëmbëlsirash ku punonte vetë. Pronari ishte zemërmirë dhe më paguante çdo ditë. Nuk u tutën as nga qimja ime në mbirje, që tani dukej më e errët dhe e dendur se më parë, siç kishte pasur mami ndër mend gjithë kohës. E mirëprita si paranë ashtu edhe rastin për të dalë nga shtëpia dhe për të dëgjuar biseda të rriturish pas një kohe kaq të gjatë brenda katër muresh. Më pëlqeu mënyra se si e bënin bakllavanë; përdornin peta të gatshme drejtkëndshe me të cilat mbështillnin arrat e thërrmuara në vend që t’i shtronin mbi to.

M’u kujtua e varfra nëna ime, që, pasi zinte brumin, hapte dyzet a pesëdhjetë petë me petës e me duar. Zgjaste gjithë ditën dhe duheshin të gjithë pjesëtarët e familjes për të thyer arrat e, me raste, edhe për të ngrënë ndonjë, sa për një tepsi të rrumbullakët dyzetpondëshe. Por Viti i Ri ishte e vetmja festë e vitit që festohej me bollëk dhe shumica e nënave që njihja mendonin se ia vlente gjithë mundi.

Loni bleu edhe një Vespë dhe më la ta ngisja për në punishte një herë. Siç po e ngisja përposhtë një tatëpjete të thepisur, filloi të më kapte frika nga

skara metalike në fund që mbulonte një kanal kullues dhe unë shtrëngova dorezën e gazit duke e përshpejtuar në vend që ta ngadalësoja. Kur mbërrita tek skara, ktheva pak timonin për nga dheu në anë të rrugës që t'i shmangesha skarës dhe humba drejtimin e motorçikletës. Motorçikleta u kthye mënjanë dhe rrëshqiti në mes të rrugës së përpjetë, ndërsa unë mbeta e shtrirë në rrugë pranë saj. E sulmuar dhe e mundur, më vinte vetëm të rrija ulur mu aty ku kisha rënë, të varja turinjte dhe ta shfryja inatin me grusht mbi asfalt, po frika se mos më shtypte ndonjë makinë duke ardhur nga mbrapa kodrës më bëri të ngrihesha dalëngadalë. Ngrita motoçikletën dhe fillova ta ngisja sërish për në punë. Kur më pa pronari gungën e grirë të bazës së gishtit të madh të këmbës së majtë që po kullonte, më ktheu mbrapsht për atë ditë.

Pashë vëllanë në rrugën para shtëpisë duke më buzëqeshur nga larg.

- Ta rrëzova motorin! – i thashë sapo ndalova para shtëpisë.

- Edhe unë që po mendoja: “Sa motoriste e përgjegjshme që është!”.

- Pse?

- Se pashë që kishe ndezur sinjalin e kthimit majtas në kthesë, - tha vëllai ende buzagaz dhe filloi të hulumtonte gërvishtjet nga fundi i majtë. Pastaj vuri re plagën time të hapur. – Ohooo! E paske rrafshuar gungën e majtë! O burra, prapë nesër; mbase rregullon edhe të djathtën! – tha me shaka, ndërsa unë qesha përmes dhimbjes, e çliruar që reagimi i tij nuk ishte aspak siç do të kishte qenë i tim eti në kushte të tilla.

Loni ishte i shtruar, i qetë dhe pothuajse i gëzuar për çdo gjë mekanike që prishej, në mënyrë që ta zbërthente, ta hetonte si funksiononte dhe pastaj ta rregullonte.

Me raste, vëllai më merrte me vete për ta ndihmuar të lyente shtëpitë. Më mësoi si të prisja cepat me furçë para se t'u hynte mureve me rryl. Më e bukura në lyerjen e shtëpive ishte lyerja e një shtëpie të bardhë verore buzë detit. Shtëpia ishte në një gji shkëmbor dhe kishte një shkallare dërrasash deri poshtë në plazhin e bukur plot me gjemba deti dhe detin e thellë e të kulluar. Ishte një pushim i mrekullueshëm, i paplanifikuar e i paguar.

M'u deshën disa muaj pune intensive, po, nga fundi i verës, i kisha të gjitha paratë që më duheshin për pasaportën dhe, çka ishte më e rëndësishme, sepëri i shumëpritur për të telefonuar Teon. Edhe pse e dija që gjasa për t'iu bashkuar në Angli po pakësohej me çdo ditë që nuk më telefononte,

më lumturonte qoftë edhe një rast për t'ia dëgjuar zërin dhe, me shpresë, një shpjegim për heshtjen e gjatë, edhe sikur të nënkuptonte fundin e asaj marrëdhënieje. Isha si në gjemba duke pritur Teon të ngrinte telefonin në anën tjetër. Kishte kaluar një kohë e gjatë qëkur i kisha dëgjuar zërin e butë, por ia njoha sapo tha “Alo”.

- Alo. Jam unë, Mirela, - i përgjigja duke menduar: “Në rast se më ke harruar zërin meqë nuk më ke marrë në telefon për një kohë të gjatë!”. Po e mbajta veten dhe e pyeta me qetësi: “Si je?”.

- Mirë jam! – m’u përgjigj ai.

- I bëra paratë më në fund! – i thashë duke u përpjekur të tingëlloja sa më e ngazëllyer, sikur të mos kishte asgjë që s’shkonte. – Të t’i dërgoj tani? – e pyeta edhe pse e dija përgjigjen.

- Jo! – tha Teo, i paaftë për të fshehur fajin në zë.

- Pse?! – guxova të pyes duke kafshuar buzën e dridhur menjëherë dhe duke përtypur lëmshin e vogël të lotëve që se pse po më kalonte nga fyti.

- Sepse nuk mund të vish!

- A mund të më thuash pse? – e pyeta. Mbajtja e të qarit po bëhej më e vështirë nga çasti në çast.

- Jo! Ha gjatë. Nuk bëhet në telefon! – tha Teo dhe faji në zërin e tij po kthehej në trishtim, gjë që më ngatërroi edhe më shumë. Besoja akoma me gjithë qenien time që më donte, por nuk arrija të kuptoja se çfarë vazhdonte të na mbante të ndarë.

- Më do akoma? – i bëra pyetjen, përgjigjen e së cilës më duhej ta dëgjoja me doemos. Siç e kisha ndjerë gjithë kohës, Teo u përgjigj: “Po!” pa asnjë përtesë, e cila, sigurisht, më ngatërroi edhe më tepër. Sapo u sigurova sërish për dashurinë e tij, lëmshi i vogël në fytyrë u zhduk dhe kryeneçësia mori frerët në dorë.

- Po sikur të t’i dërgoj paratë gjithsesi dhe ti më dërgo pasaportën? Të premtoj që nuk vij asgjekundi pranë teje! “Të paktën derisa të më rriten flokët!” – mendova. – Mund të filloj vetë nga e para gjekundi tjetër në Evropë! – vazhdova e vendosur për të dalë nga shtëpia e tim vëllai, nga dëshpërimi im, nga pritja e gjatë dhe e ngujuar.

- E çfarë të bësh? – qeshi nën hundë me protestën time prej llasticeje.

- Mund të gjej punë si kamarierë, apo jo? Atë di si ta bëj! – ngula këmbë më kot.

- Po! Atë e besoj që e bën mirë, po jo! – u përgjigj i vendosur dhe unë e dija që nuk mund të bëja asgjë për t’i ndërruar mendjen. E besoja që Teo

më thoshte gjithmonë të vërtetën, gjë që e vlerësoja si gjë të rrallë mes moshatarëve të tij. Nëse nuk donte t'i përgjigjej një pyetjeje, shpesh më thoshte: “Mos më pyet që mos të të gënjej!” dhe unë e dija kur duhej të tërhiqesha. E dija edhe që as im vëlla askush tjetër në familje nuk do të më linte të bëja ndonjë marrëzi si të ikurit vetëm.

U mendova për një çast dhe nuk munda të gjeja ndonjë gjë tjetër për t'i thënë.

- Kjo është lamtumirë, atëherë! – i thashë, pothuajse me pëshpërimë.

- Lamtumirë! – u përgjigj edhe ai me po atë zë të thyer dhe asnjërit prej nesh nuk i bënte dora të mbyllte telefonin i pari. Disa sekonda më pas, dëgjova një “klik” dhe pastaj e mbylla edhe unë.

U ktheva kokëvarur duke u përpjekur të fshihja sytë e përplotur nga kureshtarët kalimtarë. A thua se floku tejet i shkurtër nuk mjaftonte për një shikim të dytë nga shumica. “Pse? Pse? Pse?” – më përsëritej në kokë si kasetë e prishur gjithë rrugës për në shtëpi. Nuk kishte kurrfarë kuptimi. Më tha edhe që më do! As dëgjimi i një përfundimi të shqiptuar qartë nuk mjaftonte për një mbyllje të kënaqshme. Kisha më tepër pyetje tani se sa para se të flisnim. Tani uroja të mos e kisha ditur me siguri; ashtu do të mund të vazhdoja të mbaja shpresën gjallë.

Atë natë, u ktheva e u stërktheva në shtrat për një kohë të gjatë. U ngrita prapë në gjunj mbi krevat për t'u lutur para një fotografie të vogël me kornizë të Jezusit. E kisha mbajtur fotografinë dhe Biblën me vete qëkur i kisha marrë nga kisha ortodokse në Tiranë. Varej në mur në lartësinë e fytyrës sime kur rrija në gjunjë mbi krevat. Lutjet u kthyen në lot dhe më në fund vura kokën në jastëk me gjunjët e mbledhura nën vete. Më dukej vetja si e kapur në grackë, duke u vërtitur mes një korridori të gjatë me shumë dyer të mbyllura dhe pa rrugëdalje. E vetmja derë që mund të hapja ishte ajo e pak momenteve të ëmbla me Teon, por dilja shpesh prej saj dhe përplasesha në derën e kyçur të “Pse?”-së. Mbase po të martohesha me grekun e vobektë në cep të lagjes sa për të marrë një pasaportë greke, atëherë mund të udhëtoja gjithkund në Evropë. Pastaj e pashë veten me nga një valixhe në duar duke u larguar nga shtëpia e tim vëllai sikur të kthehesha mbrapsht për në shtëpi.

Rrezja e diellit të mëngjesit, që e gjeti udhën mbi krevatin tim midis qepenave të mbyllura por të paputhitura, më zgjoi edhe më të dëshpëruar tani që një ëndërr e keqe e kishte konfirmuar makthin e një dite më parë. Ah sikur t'i mbaja qepenat të mbyllura gjithë ditën dhe të vazhdoja të flija! Stomaku më rëndonte si gjyle dhe vetëm ideja e të ngrënit ma shtonte dhimbjen. Nuk

kisha dëshirë të flisja me asnjë përveç nipërve të mi të vegjël, të cilët i çoja shpesh te parku me orë të tëra vetmie dhe ca më tepër stuhie mendimesh.

Kisha disa ditë në këtë gjendje kur Odisea erdhi me vrap te porta: “Telefoni për Mirelën”, - bërtiti që nga rruga para portës dhe vrapoi përsëri për te dyqani i tij. Rrëshqita këmbët nëpër shapka dhe vrapova pas tij pothuajse duke u penguar prej tyre. Sapo u futa në dyqan, dëgjova zërin e lartë e të kulluar të Pavarotit të madh që po mbushte dyqanin me vargjet e shqiptuara qartë të Caruso-s:

*“... te voglio bene assai,
ma tanto, tanto bene sai. . . ”*

U ndala në vend dhe lotët më mbushën sytë si prej një burimi nga thellësitë e shpirtit, ndërsa Pavaroti përfundoi refrenin. U ktheva menjëherë për t’u fshehur nga sytë zhbirues të Odisesë dhe për të mbledhur veten. Pastaj iu drejtova atij duke pritur një shpjegim për mungesën e telefonatës dhe u ndesha me sytë e tij që tashmë po më ndiqnin me dhembshuri e shqetësim.

- I thashë të të merrte prapë pas pesë minutash, - shpjegoi duke bërë me gisht nga telefoni dhe unë kujtova se e kishte fjalën për mamin. Më duhej vërtet ta mblidhja veten për të. Zilja e telefonit ra prapë dhe Odisea fiku magnetofonin. Ngrita receptorin dhe u përgjigja: “Alo!” me zë të fikur.

- Alo, Mirela! Ina jam.

- Oh, çfarë mrekullie që të dëgjoj zërin! – i thashë sinqerisht e lumtur të dëgjoja fjalë nga një mike e dashur që më kujtonte të shkuarën e lumtur, por edhe kurioze për arsyen që e kishte shtyrë për t’i hyrë telashit, së pari, për të gjetur numrin tim këtu dhe, së dyti, për të shpenzuar për telefonatën.

- Si je?

- Mirë! – i mbajta përgjigjet e shkurtra nga frika se mos qaja sërish.

- Çfarë bën akoma në Greqi? Kthehu në shtëpi! – vazhdoi ajo dhe, për herë të parë në një kohë të gjatë, m’u duk ideja më e përkryer. U lodha duke u përpëlitur dhe pritur. – Ke marrë ndonjë lajm nga Teo? – vazhdoi.

- Po, para ca ditësh. Nuk jam duke shkuar në Londër.

- E di.

- Nga e dije?

- Fola në telefon me Skendin nga zyra ime dhe më tha të njëjtën gjë. E di pse?

- S’e kam idenë. Të shpjegoi gjë Skendi ty?

- Nuk të tha gjë Teo? – tentoi Ina.

- Jo. Nuk mundej nga telefoni. As unë nuk e shtyva. Po ti, e di pse? – pyeta sërish me ankth për të marrë, më në fund, një përgjigje për arsyen e pritjes sime torturuese për nëntë muajt e fundit.

- E di! Ishte e ëma. Ajo mori vesh planet e birit të vetëm për të të marrë me vete dhe nuk iu nda me telefonata derisa ai i dha fjalën për të kundërtën! – shpjegoi Ina.

- Dhe ai e dëgjoi e iu bind si çun i mirë mamaje që është! Çfarë kishte kundër meje ajo? – pyeta me zë, edhe pse gjithçka mendoja ishin netët e punës në diskotekë.

U lehtësova të mësoja që ajo tjetra për të cilën më kishte lënë ishte vetëm e ëma, por u trishtova që një arsye kaq budallaqe sa tekat e nënës së tij më kishte tronditur mua e ndoshta edhe Teon për nëntë muajt e shkuar dhe kishte shkatërruar dashurinë tonë të brishtë.

- Vetëm kaq di, e dashur. Kthehu tani! Mos humb kohë duke ndenjur aty! Këtu kanë vërshuar lloj-lloj NGO-sh tani. Jam e sigurt që do të gjesh një punë me rrogë të majme gjëkund, edhe sikur të mos jetë në zanat.

- Do vij, do vij. Falemnderit shumë që më more në telefon! Nuk e ke idenë sa nevojë kisha, - iu përgjigja e mallëngjyer nga shqetësimi dhe dashuria e mirëfilltë e shoqes sime.

Dhe ashtu bëra: siç e kisha parë veten në ëndërr. Herën tjetër që më mori Xhimi në telefon, e njoftova që kisha vendosur të kthehesha në shtëpi dhe ai më premtoi se do të më priste në kufi. Paketova gjithçka munda të nxija në valixhe dhe çantën e shpinës dhe i hipa autobusit për kthim. Ndërsa autobusi i ra nga parku ku kisha kaluar aq shumë kohë me nipërit e mi të vegjël, e ndjeva që do të më merrte malli për ta.

Ishte tetor 1994. Sapo kisha kaluar nga Greqia në Shqipëri dhe po zhbiroja përmes turmave të udhëtarëve për Xhimin, vëllanë e madh, që të më priste dhe të më sillte në shtëpi. Ja ku ishte, duke ngritur dorën për motrën e tij të vogël. E pashë dhe tërhoqa drejt tij valixhen e rëndë gri përmes rrugës me pluhur. Kisha veshur xhinset e kuqe të gomuara, më të rehatshmet e mia, që tashmë më rrinin të lira në bel dhe gjymtyrë.

- Mezi të njoha! Ti dukesh sikur sapo ke dalë nga Auschwitz, moj! Nuk të ushqeunyt vëlla atje? – pyeti i turbulluar nga floku im tre-cantimësh, fytyra e hequr dhe kockat e dala të legenit në të dyja anët e barkut të lugët.

- Bëra kurën e rrushit nga hardhia mbi oborr këtë javë që shkoi! – ia ktheva, ndërsa m'u afrua dhe më përqafoi me dhembshuri. Vëllai ngriti valixhen e rëndë dhe ecëm të dy drejt autobusit.

- Pse po haje vetëm rrush? – më pyeti, po e kuptoi menjëherë që po futej në një temë shumë të dhimbshme për mua dhe vazhdoi: “Aq keq ishte Maria?”, duke më dhënë një rrugëdalje nga përgjigjet e vërteta të mungesës së oreksit.

Edhe unë përfitova nga rasti: “Është me nerva gjithë kohës. Bërtet dhe mallkon Lonin e djemtë dhe nuk i bëhet vonë fare që e dëgjon lagjja, paçka se s'kuptojnë shqip. Të mërzitet jeta e të vjen turp të jetosh ashtu dita-ditës!”.

- Qysh durove dhe aq?

- Po prisja të më rritej një çikë floku.

- Po e, re! Po kjo si të erdhi? – pyeti Xhimi.

- Më bëri reaksion boja dhe vendosa të filloja nga e para! – i thashë buzagaz, duke luajtur me pyetjet e vëllait deri në shtëpi.

Familja ishte futur në shtëpinë e re në maj të atij viti. Kishin mbaruar dhe mbuluar dy dhomat lindore, korridorin dhe banjon në fund të tij, po dy dhomat e tjera në perëndim ishin ende mure tulle të zbuluara. Ishte e çuditshme të vija në një shtëpi të re me shkallë të drejta në hyrje dhe ballkon të gjerë e të gjatë sa gjithë gjerësia e shtëpisë. Mami gëzohej të më tregonte shtëpinë po aq sa gëzohej që isha kthyer.

- Hajde! Më në fund u bërë me banjo brenda me gjithë sqollën alla frënga. Po kjo? – e pyeta duke parë një kablllo të zezë të përkulur mbi derën e banjës.

- Dajua yt nuk i ka përfunduar të gjitha instalimet akoma, - u përgjigj mami.

- Kështu që as dushi nuk është gati, apo jo?

- Të ngroh nëna ujë me kazan! – tha mami dhe filloi menjëherë të ndizte furnellën e vjetër të vajgurit në dyshemenë e banjës.

- Mrekulli, ma! Nga vjen uji? – thashë dhe fillova të mbush kazanin vetë.

- Kemi pusin tonë në oborr. Lidhëm një pompë të shtrenjtë me tubot dhe për sa kohë që kemi drita kemi edhe ujë.

- Janë ndonjë çikë më të qendrushme dritat tani? Shoh që përdor edhe sobë elektrike për të gatuar.

- Jo dhe aq keq. Vijnë e ikin. Prandaj po e mbaj akoma këtë mavraqen e vjetër; mall e kemi kur s'kemi drita.

- Po shkoj të zbraz valixhen dhe t'i vë rrobat nëpër sirtarë derisa të bëhet uji gati për t'u larë, – thashë dhe mami më ndoqi nga pas për të më ndihmuar e për të parë rrobat e reja që kisha sjellë. Ndërsa vija rrobat në sirtarë, pashë nja dy copa atllasi të vjetër që ime më i kishte ruajtur për të bërë jorganë për pajën time. Nxora rozën, e shpalosa në të gjithë gjatësinë dhe e mbështolla rreth supeve, duke admiruar shkëlqimin ndërsa i shkoja dorën mbi sipërfaqen e lëmuar.

- Oh, ma! Sa fustan i bukur do të dilte ky! Si thua? Bëjmë të verdhën jorgan. Kur them “bëjmë” e kam fjalën që të paguajmë një zanatçeshë për ta bërë këtë radhë, - i thashë dhe qesha. Qeshi edhe ajo nën hundë. E dinte tamam se për se po e ngacmoja.

Na kishte ardhur një herë nëna për vizitë para se t'i binte paraliza dhe nënë e bijë vendosën të bënin një jorgan me copa të vjetra, ndërsa unë shikoja dhe i ndihmoja duke u shkuar fillin në gjilpërë ose duke mos u ngatërruar nëpër këmbë. I vunë copat e qepura mbi njëra-tjetrën në dysheme dhe filluan t'i ildisnin bashkë në anë të kundërt të njëra-tjetrës duke punuar rreth e rrotull e drejt qendrës. Erdhi babi brenda dhe i paralajmëroi me ironi: “Se mos na e qepni me gjithë qilim!”. Mami, si gjithmonë, nuk ia vuri veshin ironisë së tij dhe vazhdoi ildisjen duke drejtuar kurrizin e lodhur herë pas here. “Mirë gomari që na ngordhi, po s'na lënë rehat as mizat. Pak se po na dhemb kurrizi, po do durojmë edhe qoqet e tua ne?” – ia priti.

Mbas disa orësh, pasi e kishin mbaruar gjithë punën, nënë e bijë e ngritën jorganin e përfunduar dhe lëshuan një “Uuuuu!” kur u ngrit edhe qilimi me të në disa vende. Të gjithë ia plasëm gazit; pastaj mami shtoi: “Uuu! Kush dëgjon tët atë tani?!”.

- E jotja është; bëje çfarë të duash ti. Do dilte shumë i bukur edhe fustan. Ty të shkon shumë roza, - tha mami duke miratuar dhe duke më bërë qejfin, si gjithmonë.

- Na duhet të gjejmë një rrobaqepëse të mirë tani që jemi në lagjen e re. Ke zënë ndonjë shoqe të mirë këtu? – e pyeta.

- Kam, po nuk qep asnjëra, – tha me keqardhje. – S'kishte ç'na duhej, po të mos ma kishte shitur me vrap yt atë makinën qepëse.

- E kishim?

- Po, ka vite. E blemë dhe ai, pastaj, ia shiti fqinjës që qepte gjithë rrobat e tua.

- E jona ishte *Butterfly* i saj?! – pyeta e çuditur duke kujtuar se si prisja ulur pranë makinës qepëse duke vëzhguar me kujdes në pritje të provës për një fustan apo palë pantallona të reja që më kishte qepur.

- Po. Yt atë nuk mendonte se mund të mësoja të qepja. Komshia, nga ana tjetër, punonte në rrobaqepësi.

- Rrobaqepësia që qepte uniforma doku blu për punëtorët?

- E, ajo, - u përgjigj mami. – Punonte atje tetë orë në ditë pastaj vinte në shtëpi dhe qepte për lagjen. Tani që u rrite ti, mund ta kishe mësuar ta përdorje për vete.

- Nuk ia vlen të mërzhitesh tani! Qe më e dobishme atje ku qe, gjithsesi!

- Unë kujtova se qepte e ëm'e Edlirës, - tha mami.

- Qep, - ia prita paksa e hutuar. Jetonin goxha larg për provat.

- E dije ti që kanë ardhur me shtëpi këtu në qytet tani?

- Jo! Vërtet?! – pyeta me ngazëllim. Edi një vrap pele më tutje! Sa më kishte marrë malli!

- I ati i Edit bleu një ndërtesë qeverie që u privatizua kohët e fundit, - tha mami dhe më tregoi se ku ishte tamam.

- Oh, mezi po pres të vete ta takoj!

- Rrezik të është ngrohur uji tani, - tha mami.

Nxora disa tesha nga valixhja për t'u ndërruar dhe u kyça në banjë. Hoqa bluzën, e vara në kabllon e përthyer mbi derën e banjës dhe preka shkarazi me dorë majën e telit të ngarkuar me rrymë. Më drodhi të tërën deri te këmbët e zbathura mbi çimenton e lagët; nuk e mora vesh kurrë se si nuk më përplasën për muri dyqindinjëzet volt.

- Ai kablli paska rrymë! – i thashë mamit dhe babit kur mbarova së lari dhe u ula te shkallët përjashta.

- Uuu! Të zuri? – pyeti mami.

- Më drodhi një çikë, - iu përgjigja – Mos vjen direkt e nga shtylla?

- Po, - tha mami. – Allahu na ruajt! – vazhdoi e tronditur. – Haj-ujk, haj-ujk! Ç't'u desh atje që vajte e preke?!

- Vara rrobat. Nuk kishte grep gjëkund, - ia prita me shfajësim, e habitur që këtë radhë nuk ishte im atë ai që më vinte faj.

Po prisja me tmerr momentin kur do të më pyeste për çdo gjë që kishte ose nuk kishte ndodhur në Greqi. Më trembte nevriku i tij, fjalimi i tij: “Të pata thënë një mijë herë të mos ngatërroheshe me njeri para se të vinte të llafosej me mua. Kështu e pësojnë ato që nuk i vënë veshin këshillës së prindërve . . .” e të tjera, e të tjera me radhë. Po meqë duhej kapërcyer edhe ky lumë, ç'bëri tani, ç'bëri më vonë? Në fund të fundit, në kishte ndonjë rast ku dëmi im ishte rezultat i drejtpërdrejtë i vendimeve të mia, ishte ky.

Vetëm se, në kundërshtim me ç'prisja unë, ai, ulur siç ishte te shkallët, po pinte me qetësi kafënë e mbasdites që i kishte bërë mami, sikur të mos

kishte dëgjuar asgjë nga ato që kisha folur për sulmin e fundit. Më pa me sytë e dashur kafe të errët, që i ishin zvogëluar e thelluar edhe më në ballë, dhe pyeti: “Ç’u bë me atë çunin nga Berati?”.

Mos! Hajde duroje këtë tani!

- Nuk ishte gati për mua ai, o ba! – iu përgjigja me sytë e ulur nga shkallët.

- Ka Tirana djem plot! – u përgjigj po aq qetë babai im i dashur, duke më kapur krejtësisht të papërgatitur. *Mos më bënë gjë veshët?! M’u duk sikur tha: “Ka Tirana djem plot!”*. E pashë në sy dhe do ta kisha përqaftuar po të mos kisha frikë se më kapte ndonjë ngashërim. Nuk mund t’i lija të më shikonin edhe më të mërzhitur nga ç’dukesha.

- Edhe unë atje po mendoj të shkoj, po duke filluar me një punë një herë, - ia prita me buzëqeshje në vend të lotëve.

- Mirë do bësh! – tha ai.

Të nesërmen në mëngjes, mora shumicën e parave që kisha sjellë nga Greqia dhe shkova t’i depozitoja në bankë. Pastaj shkova të befasoja Edin në anën tjetër të qytetit. Shtëpia e tyre e re ishte jashtë shinave të trenit, siç ishte edhe shtëpia jonë e re. U përqaftuam, u puthëm, u përlotëm e çuçuritëm, pastaj nxora copën e atllasit nga çanta e shpinës dhe pyeta mamin e Edit nëse mund të më qepte një fustan me të. Ajo pranoi me mirësi dhe filloi të më merrte masat.

- Çfarë modeli ke ndër mend? – pyeti Xhevua.

- E pashë modelin në një film para se të ikja për Greqi dhe më ngeli mendja. Atje ishte lejla, po edhe në rozë shumë bukur do të dukej. Ishte i gjatë deri në fund të këmbëve, pas trupit me një bisht verëf nga mbrapa në vend të së çarës për të ecur. Mbaj mend ca të mbledhura përpara rreth e rrotull vitheve, që mund t’i fillojmë si pala nga mbrapa, përgjatë zinxhirit. Kishte mëngë të gjata dhe një si perde mbi jakën e hapur përpara dhe mbrapa. Perdja dukej si e mbledhur me rrudha tek supet.

- Tingëllon shumë bukur, po nuk e di në do mund ta bëj sipas dëshirës tënde. Kjo copa rrëshqet shumë, - u përgjigj mami i Edit paksa e ndrojtur nga përshkrimi im.

- Jam e sigurt që do t’ia dalësh! Më ka thënë Edi se ç’mjeshtre je!

Shkova dhe dy-tri herë të tjera për provën dhe, më në fund, ish-jorgani im u bë një fustan i gjatë e i bukur; ashtu siç e kisha përftyrtuar.

Një mbasdite, vendosa të kaloja nga një shok i shkollës së mesme, me të cilin kisha vazhduar miqësinë gjatë viteve në të njëjtin universitet, ku ai

studioi për inxhinieri mekanike. Shumica e shokëve ishin shpërndarë nëpër botë tashmë, por Andi banonte akoma në shtëpi me prindërit e vet.

- Sa mirë që të gjeta! – i thashë e kënaqur që e gjeta në shtëpi.

- Ç’kemi? Me se merresh tani? – më pyeti.

- Po ushqehem për t’u mëkëmbur nga përvoja greke. Them të kthehem prapë në Tiranë për punë. Po ty, të pëlqen puna këtu? – e pyeta.

- Fare! – ma priti. – Po më janë ngjallur shpresat për një mundësi vize kanadeze; them të bëj një kërkesë. Do vish të ikim bashkë? – tha Andi, me dritë në sy nga ideja e atypëratyshme dhe unë ngela pa fjalë për një çast. Ne nuk kishim qenë kurrë më tepër se dy miq të mirë gallatash para shkolle ndërmjet leksioneve. As që nuk tentova të kuptoja se ç’donte të thoshte me “bashkë”, sepse ishte e kotë. E kisha bërë mendjen top.

- Unë nuk lëviz më nga Shqipëria për vete! – i thashë me vendosmëri dhe Andi ishte i bindur që e kisha sinqerisht.

- Aq keq ishte Greqia?! - u përgjigj me kuriozitet.

- Nuk është për mua mërgimi. Shihemi vërdallë, - e përshëndeta dhe ika.

- Mirupafshim! – ma ktheu Andi dhe u fut brenda.

NJË LINDJE E RE

Disa ditë mbas kthimit nga Greqia, paketova teshat dhe një të pestën e parave të mia, pjesën që nuk kisha depozituar, dhe u nisa drejt kryeqytetit. Ishte shumë e vështirë të ecja nëpër qytet duke shpresuar të shihja të dashurin tim papritur dhe po aq papritur të kujtohesha: “Ah, po, ai nuk është më këtu!”. Nuk kishte rëndësi sa të tjerë i ngjanin; asnjëri nuk ishte ai. Tirana ishte qyteti i populluar më i zbrazët në botë!

Takova Ritën, që kishte ardhur në Tiranë me punë, dhe ndenja me të për dy ditët e para. Rita kishte siguruar një dhomë në konviktet e Inxhinierisë së Ndërtimit.

Më tha për një grua që shikonte fatin në lagjen përballë konvikteve. Edhe pse me dy mendje, shkova te apartamentet duke u ndjerë sikur të kishte diçka shumë të gabuar tek të parët e një fallxhoreje – a thua se çdo i panjohur rreth meje në rrugë e dinte se ku po shkoja dhe pse – por e gëlltita krenarinë dhe vazhdova drejt apartamentit pak më e vendosur me çdo hap. Nëse nuk mund ta shikoja në botën e këtushme, ndoshta mundesha në të përtejmen.

Papritur, ndjeva një pickim therës nga mbrapa, në rrëzë të zverkut. I rashë me shuplakë atje ku ndjeva pickimin dhe pashë një bletë që ra në shesh. E shkela me mllef dhe dhimbje, por ende e vendosur për të vazhduar me zbulimin në të ardhmen time. Dukej se nuk isha vetëm unë e etur për përgjigje duke pritur me orë të tëra nën diellin e nxehtë. Ndenja në një radhë të gjatë që shtrihej nga disa metra para pallatit dhe deri tek apartamenti në katin e tretë. Sa më shumë i afrohesha fallxhores, aq më e tendosur isha. Dëgjova dikë në radhë të thoshte se nuk jepte gjithmonë përgjigje të favorshme.

Ishte më në fund radha ime për t’u futur në hyrje. Më drejtuan tek dhoma

e fallxhores me pesë a gjashtë të tjerë, burra e gra, të gjithë ulur nëpër karrige rreth e rrotull dhomës. *Ç'është kjo?! Nuk flas as vetëm për vetëm me të? Si do t'i rrefej më të thellat e dëshirave dhe të vështirësive të mia para gjithë këtyre njëjërëzve? Më mirë të më kishin pickuar edhe dhjetë bletë të tjera se sa të duroja një përukje të tillë. Por ishte shumë vonë dhe nuk gjeta dot kurajon të ngrihesha e të dilja.*

U ula si në gjemba derisa fallxhorja m'u drejtua mua: "Po ti?"

Si do t'ia thosha tregimin më të rëndësishëm të jetës sime në disa sekonda? Molloçita disa fjalë dhe, sapo zura në gojë mamanë e Teos, ajo m'u kthye: "Po të të donte ty ai, nuk do t'i kishte marrë dorën s'ëmës! Ja, pyet këtë çunin këtu! Do ta kishe pyetur mamanë ti?"

I hodha sytë nga djali i ulur pranë meje, që dukej po aq i tulatur nga arroganca e saj dhe i mbajti anën: "Jo!"

Dola më e trishtuar se sa hyra, duke u ndeshur me logjikën e fallxhores, ndërsa vërdallosesha rrugëve të qytetit. *Nuk mund të më marrë të vetmen arsye që kam për prishjen tonë. Ka edhe djem që i dëgjojnë nënat e tyre. Siç nuk kanë ca të tjerë kurajon për t'iu kundërvënë baballarëve kokëshkretë, të dhënë pas parave! (Iu deshën tim vëllai, Lonit, disa përpjekje para se të ngulte këmbë për t'u martuar me atë që deshi.)*

E para ishte e bukura Vanthia, dashuria e parë e tim vëllai: "Është pa shkollë!" – tha babi. Pastaj erdhi Valbona me gërshetin e gjatë e të zi nga shkolla e arteve në qytet. Këtë radhë, "Artistët vdesin të varfër!" ishte se bëpi i tim eti dhe vëllai iu bind sërish zemërthyer. Pastaj Asia, shoqja ime e shkollës, e qeshur, e dashur: "Kjo është nga fshati; shumë vështirë për ta punësuar!". *Ja, pra, fallxheshkë! Ca e ca u binden prindërve! Ah që s'i vura veshin paralajmërimit të bletës e të kthehesha mbrapsht!*

- Vajte te fallxhorja? – më pyeti Rita më vonë atë mbasdite, kur u ktheva e lëshuar dhe e këputur nga të ecurit nëpër vapë.

- Vajta.

- Edhe?

- Ishte skëterrë. Pa vajtur atje, më pickoi një bletë në zverk. Sikur të mos mjaftonte kjo, fallxhorja praktikisht më bërtiti. Ishte harbutkë, e ligë.

- E kisha dëgjuar që vjen një çikë si me huqe, - tha Rita duke mbajtur të qeshurën.

- Sikur ishte urrejtje me shikim të parë. Nuk më besohet sa idiotë të tjerë si unë kishte, që paguan të shkonin e t'u bërtiste asisoj.

Rita ndezi radion në dhomë dhe mua më kapì veshi një lajmërim për një grup ungjilltarësh nga Suedia që thërriste këdo në qytet për t'u mbledhur në

një nga stadiumet e Tiranës. Ishte një lajm frymëzues shprese dhe shpëtimi që ra si ujë i ftohtë në fytyrën tim të tharë. M'u kujtua bjondja ungujlltare amerikane që më kishte dhënë fletushkën e parë të krishterë dhe ndjeva një shtytë të fortë për të shkuar te mitingu për të përjetuar ngazëllimin të shtunën e ardhshme.

Unë e Rita e kaluam një pjesë të mirë të asaj nate duke bërë luftë me një mi në dhomë, kështu që të nesërmen në mëngjes vendosa të kthehesha në qytetin Studenti për një dhomë timen. Para se të vija në Tiranë këtë radhë, kisha parë Teon në një ëndërr shumë të gjallë duke më thirrur nga poshtë së njëjtës dritare që kisha patur vitin e fundit të shkollës. Do ta dija nëse ëndrra ishte paralajmëruese nga dhoma që do të më caktonte kujdestarja e godinës. Shkolla kishte një muaj që kishte filluar tashmë dhe gjithçka i kishte mbetur për mua ishte dhoma e fundit në katin e parë me dritare me hekura; aspak si ajo që kisha parë në ëndërr. U zhgënjeva dhe e shpërfilla ëndrrën thjesht si dëshirë, po, kur mbikqyrësja më premtoi të më njoftonte sapo t'i dilte ndonjë tjetër në katet e sipërme, u mbusha sërish me shpresë.

Tani që kisha siguruar dhomën, më duhej një punë para se të më mbaronin të gjitha paratë që kisha me vete. Nuk doja të tërhiqja paratë që kisha depozituar në bankë. E fillova kërkimin e punës nga bosin im i vjetër, Petriti, duke i kërkuar një letër rekomandimi. Më përshëndeti me përzemërsi, por dukej shumë i shpërndarë. Megjithatë, pranoi të nënshkruante çdo gjë që doja për sa kohë që nuk i duhej ta shkruante vetë.

U nisa drejt ish-universitetit tim për të shtypur letrën që më duhej si edhe historikun e punës. Iu ngjita shkallëve me qejf deri në katin e fundit, ku Dori tani ishte laborante kompjuterash për gjithë studentët e inxhinierisë.

- Çfarë kënaqësie që të shoh prapë! – tha Dori dhe më përqafoi.

- Edhe ty! Të shkon shumë presorllëku! – ia prita.

- “Presorleshi” thuaj. Është e mërzitshme dhe paguan si punë shteti. Më duket vetja kot – sikur shtrydha trutë pesë vjet që të vë në gjumë adoleshentët.

- Seriozisht e ke? Nuk duket ashtu që këtej nga unë. Duket me shumë prestigj dhe rëndësi, - ia prita duke menduar që Dori i thoshte sa për të më bërë qejfin meqë nuk kisha një karrierë timen.

- Gjete dhomë? – më pyeti.

- Gjeta. Është si qeli burgu, po më premtuan që do të jetë e përkohshme. Ajo çka më duhet tani është një historik i mirë pune dhe një letër rekomandimi. Po shpresoja mbase mund të përdorja një nga këta kompjuterat për t'i shtypur.

- Patjetër! Për sa kohë të të duhet! – u përgjigj Dori dhe më uli në një

kompjuter në qoshen pranë dritares. – Kur nuk kam laboratore në orar, më duhet të shtyp shënime të shkruara me dorë. Janë plot karaktere të veçanta dhe hanë shumë kohë. Këtu jam po pate ndonjë pyetje.

- Nuk kam shumë material për historik pune. Nuk dua të përmend ndonjë nga punët që kam bërë deri më sot, sepse nuk kanë lidhje me çka dua të bëj kështu e tutje, por, të paktën, mund të vë shkollën dhe kurset e kompjuterave. Falemnderit që po më lë ta bëj këtu! Mos të rrezikoj punën?

- Aspak! Asgjë për t'u shqetësuar! – u përgjigj Dori dhe iu futëm punës të dyja.

- Hajde nga dhoma më vonë që të llafosemi! – tha kur mbarova.

- Mirë! – i premtova dhe ika.

Po ecja përmes sheshit të madh para stadiumit kur dëgjova një fishkëllimë që e njoha në çast. Buzëqesha, ktheva kokën djathtas dhe pashë Omarin, shokun e vjetër, si gjithmonë të kënaqur. Po zbriste nga shkallët e daljes së stadiumit, i njëjti ku kisha bërë fizkulturën gjatë dy viteve të para në fakultet.

- Ça bën këtu ti? Unë të dija rrugës për Londër! – më pyeti me zë të lartë duke u afruar.

- Më la avioni! – ia ktheva me shaka me shpresë që t'u jepja fund pyetjeve.

- Si je? – më pyeti buzagaz dhe më përqafoi gjatë.

- Mirë jam; po kërkoj punë tani, - i thashë duke i treguar letrat që sapo kisha shtypur te laboratorit i kompjuterave të Dorit. – Po ti? – ia ktheva me pyetje që të fliste për veten e vet në vendin tim.

- Sapo dola nga ky lokali i ri që kanë hapur te stadiumi. Kanë mbirë lokale dhe restorante gjithandej si kërpudhat pas shiut. Po rrija me ca amerikanë.

- Për ta punon tani?

- Po, por tani po shkoj të takoj të fejuarën për drekë.

- Je fejuar?! Urime! – u shpreha me kënaqësi dhe habi që Omari po shtrohej. – Të lumtë!

- Eee, falemnderit! Do ta takosh? Është vërtet e lezetshme. Kam përshtypjen që ju të dyja do të bëheni shoqe menjëherë, - këmbënguli dhe unë pranova.

Omari kishte të drejtë. Elda, e fejuara e tij, ishte bukuroshe. Kishte sy të qeshur dhe kaçurrela të verdha të gjata.

- Omari më ka folur shumë për ty, - tha ajo. – Është kënaqësi që takohemi më në fund.

- Kemi qenë shokë me vite. Gjithmonë më bënte për të qeshur. Shpresoj që

ty të të bëjë të lumtur. Dukesh shumë e lumtur që tani. Urime! – i thashë.

Të tre shkuam te një restorant i ndërtuar me trarë druri mes pemëve mbrapa shkollës sime të shkuar. Kush e dinte që mënyra më e mirë për të dalluar nga konkurrenca në këtë tendencë të marrë pas perëndimit, Evropës, Amerikës ishte të ktheheshe tek tradita, e vjetra, rrënjët?

- Ça qejfi! – thashë kur pashë shiltetë e vëna në shesh për t'u ulur në dysheme. – Më duket sikur jam në fshat, me pushime te Nëna. Oh, paska edhe sofër! – u shpreha gjithë mall për sofrën. – Tamam si ajo që vinte mami mbi prehër për të hapur petët me petës.

- E dija që do të të pëlqente një vend i tillë! – ma priti Omari.

- Rrezik ai që e ka krijuar dhe ndërtuar do të jetë ndonjë shqiptar që ka jetuar jashtë shtetit dhe e mori malli për Atdheun. Sa çudi! Turmat brenda nuk mbahen sa të dalin prej këtej dhe ata që dolën mezi presin të kthehen e të puthin dhenë.

Sikur të ishte ashtu edhe për një më tepër prej tyre!

- Ku ta di unë? Unë po shikoj nga brenda, - tha Omari, - por ti nuk është se u ktheve për këtë, apo jo? – përgjoi Omari edhe një herë.

- Jo, por, sapo u ktheva, u betova të mos iki më kurrë; u betova para se të zbuloja që Shqipëria u shndërrua në të fisme dhe të pasur në mungesën time. Shiko këto fileta pule të mbështjella me djathë! Nuk kam ngrënë kurrë ndonjë gjë më të shijshme. Falemnderit që më sollët me vete! – thashë jo më dhe aq e trishtuar që pylli i dashur i kujtimeve të mia po ciflosej pak nga pak nga tregtia.

- As mos e zër në gojë. Amerikanët paguajnë shumë mirë dhe organizojnë mbrëmje të mëdha, - tha Omari buzagaz. – Do shikoj për ndonjë gjë dhe do të të them. Ka plot skuadra të vogla që vijnë e ikin e që kanë nevojë për përkthyes gjithë kohës.

- Dëgjova që paska plot edhe hollandezë e suedezë.

- O, do kesh dëgjuar për mitingjet e ungjilltarëve në stadium.

- Po dhe do të doja shumë të shikoja se ç'bëhet.

- Shkojmë bashkë. Në qytet Studenti po fle tani? – pyeti Omari.

- E njëjta godinë, por mund të ndërroj dhomë më vonë, - i thashë, e nderuar që mikut tim jo vetëm që nuk i kishte ngelur qejfi, por dukej edhe i kënaqur të më takonte.

- Ka edhe italianë, - shtoi Elda. – Dëgjova për një firmë italiane që po merr në punë shumë njerëz për të futur të dhëna në kompjuter, vetëm se ka standarde të larta për shpejtësinë e shtypjes. Duhet të konkurosh një herë.

- Falemnderit! Do të shkoj ta provoj.

- Njëri nga amerikanët që njoh na ka ftuar tek shtëpia e tij sonte në darkë. Punon për departamentin e shtetit amerikan tek ambasada amerikane. Hajde edhe ti, po deshe. Mund të përfitosh nga njohja me të. Ai njezh shumë njerëz në qytet.

- Pa ju prishur punë juve, - thashë duke menduar se jetonte te blloku, ku kishin zyrat shumica e tyre tani, por ndërsa vazhduam të ecnim në drejtim të kundërt, e kuptova që miku amerikan i Omarit banonte në një lagje krejt tjetër, që nuk e njihja.

Ishte një shtëpi përdhese me oborrin plot me agrume të rrethuar me mur në një lagje të qetë në mes të Tiranës. Dejav kishte marrë me qera që ne të tjerëve na dukej një sasi përrallore parash. Ai ishte beqar, tullac, i shkurtër, shumë energjik, bujar dhe miqësor – një çikë më tepër ndaj femrave të njoma. Më vonë, zbulova që i pëlqente të jepte dhe gjente kënaqësi në një mbrëmje të mirë.

- Nuk jetoka te blloku, atëherë, - thashë unë.

- Jo. Është një çikë më larg dhe e futur në qendër, po më duket se i pëlqen lagjja e qetë.

Nuk mund të mos ndjehesha e privilegjuar që kisha parë një grimcë të amerikanëve, kur kushëriri im amerikan i caktuar me detyrë në Tiranë nga ushtria amerikane, më merrte me vete nëpër darka me shokët e vet vetëm një vit më parë. Prisja e qetë në sallon, ndërsa ai ndërronte uniformën, dhe vëzhgoja shokët e tij që silleshin si kalamaj duke parë filma me përplasje makinash. Më mahniste mënyra se si e sillnin me vete një copë atdhe; si breshka zhguallin. Gjithë propaganda komuniste kundër imperializmit agresiv amerikan, me të cilën isha rritur, vetëm sa i kishte bërë më magjepsës në sytë tanë, me disa përjashtime. Kur njëri prej shokëve të kushëririt tim doli nga diskoja pa paguar faturën e tij dhjetëdollarëshe, çerekun e rrogës sime mujore, më la të zhgënjyer dhe të çuditur. “Këta sikur marrin nga gjashtë milionë në muaj!” – mendova.

- Do ketë qenë i dehur dhe ka harruar, - e shfajësoi kushëriri im, që dukej i turpëruar nga patrioti i vet dhe e shleu vetë detyrimin e tij.

Deri në atë kohë, kisha kaluar nga ambasada çdo mëngjes rrugës për shkollë. Gjithë territori rrethohej nga një gardh hekurash pothuajse dy metra i lartë dhe një portë e ruajtur rëndshëm me roje. Sa herë që futej një makinë përmes portës së lartë, rojet e kontrollonin nga poshtë për bomba. Megjithatë, unë mund të futesha drejt e brenda në shtëpinë e njërit prej punonjësve.

Po mendoja e qetë në divanin pranë vatrës kur Dejav filloi të luante një këngë që kisha dëgjuar kohët e fundit në dhomën e Dorit, me të cilën nuk

kisha të ngopur.

*“Nuk mund të jetoj,
nëse e jetuara është pa ty,
Nuk mund të jetoj,
nuk duroj dot më.”*

- Do të flemë këtu sonte në njërën nga dhomat e miqve, - tha Omari para se të shkonte për të fjetur.

- Ç’thua, mo?! Po unë? – pyeta me alarm. – Nuk është një çikë si vonë për mua të kthehem vetëm?

- Fli edhe ti këtu. Ka vend plot, - u përgjigj Omari dhe më nxori çarçafët dhe batanijet për t’u shtrirë në divan.

Pasi Omari dhe e fejuara e tij shkuan për të fjetur, Dejav m’u afrua kur u kthye nga kuzhina dhe si pa të keq tha: “Je rehat në divan? Je më se e mirëpritur në krevatin tim, po të duash!”.

- Jo, falemnderit! – ia prita, ndërsa u struka në divanin e tij, duke sjellë batanijen te gryka. – Shumë mirë jam në divan.

- Mirë, atëherë. Si të duash. Natën e mirë! – tha dhe iku në dhomën e vet po aq i shkujdesur. *Amerikanët! Meshkujt!* Tunda kokën në mosbesim dhe fjeta me gjithë rrobat veshur atë natë.

Ngjarja tjetër ngazëllyese paskëtaj ishte e shtuna në stadium. Siç e kishim diskutuar herët atë javë, Omari më shoqëroi tek mitingu i madh.

- Ça qejfi! – i thashë Omarit, sërish e lumtur që isha midis njerëzve të mi, në vendin tim. – Më duket si një nga ato ditët e pakta të gëzimit të fitores pas një ndeshjeje futbollit.

- Kurse mua më kujtohet koncerti i Albanos dhe Rominës i tetëdhjetenëntës.

- E mbaj mend! Ishte elektrizuese, sidomos kur kënduan “Liberta”. Mori zjarr si shkëndija në kashtë.

Pas predikimit shurdhues dhe energjik, pamë të mahnitur se si predikuesi ftoi gjithë të sëmurët dhe sakatët në qendër, para platformës. Shumë prej të cilëve që mbaheshin më këmbë nga patericat ose miqtë për të shkuar atje u kthyen me këmbët e tyre duke u hedhur e kërcyer me ngazëllim për shërimin në emrin e Jezusit. M’u mbush zemra nga mahnitja dhe gëzimi si kurrë më

parë. Kjo ishte e vërteta! U ndjeva sikur kërkimit tim shpirtëror i kishte ardhur fundi. Ah sikur të isha ulur më afër! Sikur të kisha ardhur vetëm! Do të isha atje poshtë, duke u ngazëllyer me ta! Vendosa të shkoja përsëri tek mbledhja e tyre te kinema Agimi që të nesërmen.

Edhe pse po e lexoja Biblën përditë dhe Perëndia më ishte shfaqur në Fjalën e Tij disa herë, nata e kaluar ishte e para kur isha sfiduar ta vija besimin te Jezusi si mënyra e vetme e shpëtimit dhe hyrjes në mbretërinë e Perëndisë. Kisha vendosur ta hidhja këtë hap sonte. Sa më shumë që dëgjoja, aq më shumë doja nga predikimi i gjallë i pastorit buçues suedez me ecejaket dhe hedhjet e tij gjithandej platformës, duke më gjallëruar dhe mbushur shpirtin e uritur me fjalën e Perëndisë. Tani e kuptova se çdo të thoshte Jezusi me “Njeriu nuk do të jetojë vetëm me bukë, por me çdo fjalë të Perëndisë”. Kinemaja u mbush me të qeshura e të qara, shërime e lutje, lëvdime e këngë. Në fund të predikimit të tij, pashë e mahnitur se si të rinj e pleq vërshuan përpara për thirrjen e shpëtimit. Unë ngurrova të shkoja përpara me ta, por përsërita të njëjtën lutje që bënë ata atje:

“I dashur Jezus! E kuptoj që jam mëkatore dhe që Ti më deshe aq shumë sa dhe jetën tënde për mua në kryq. Unë besoj se ti je biri i Perëndisë, Shpëtimtari im dhe Zoti im. Të thërras në emër, Jezus, të më bekosh me begatinë, mbrojtjen dhe premtimin tënd të jetës së përjetshme. E vë jetën time në duart e tua dhe të ftoj në zemrën time. Të lutem, m’i fal mëkatet! Më jep një mendje të re, një zemër të re dhe një fillim të ri në jetë. Më udhëhiq në vendimet e mia të përditshme, që të kthehem nga mëkati dhe të ec në paqen tënde. Më mbush me praninë tënde që tani. Falemnderit që më dëgjon lutjen dhe po fillon këtë marrëdhënie me mua! Unë besoj në premtimin tënd se jam e falur dhe e shpëtuar. Falemnderit për këtë bekim të madh! Amen!”

Çfarë nate e mrekullueshme! Jezusi prej të cilit kisha lexuar dhe që e kisha kërkuar për më se një vit tani më kishte gjetur vetë dhe ishte Zoti im, shpëtimtari im dhe mbreti im. Ai ishte i imi dhe unë isha e tija. Tani i përkisja diçkaje më të madhe e më të lartë se gjithë shqetësimet dhe pasiguritë që më rrethonin. Kisha dikë, premtimin e të cilit mund ta besoja dhe t’i mbështetesha, dikë që më donte pa kushte; ashtu siç isha: zemërthyer, e ndrydhur, në nevojë. Ndjeva sikur m’u ngrit një barrë e rëndë nga supet dhe mund të fluturoja gjithë rrugës deri në konvikt atë natë tetori të 1994-s.

Mezi prisja të kthehesha me gëzim te vendi i mbledhjes së kishës te

kinema Agimi çdo të mërkurë mbrëma dhe çdo të dielë në mëngjes.

Një javë më vonë, Omari më ftoi në një mbrëmje tjetër që e organizoi me miqtë e tij amerikanë. Rrallë më duhej ndonjë arsye për të vajtur nëpër mbrëmje, por këtë nuk do ta humbisja gjallë në botë. Do të bëhej në vetë vilën e ish-diktatorit komunist – ai që e shkoi shumicën e jetës duke i mbushur mendjen popullit (dhe ndoshta vetvetes) që imperializmi amerikan është agresiv – që do të mbetet agresiv edhe sikur një dhëmb t'i ngelet në gojë.

Do jetë duke u kthyer përmbys në varr tani!

Salloni i hyrjes kishte fuçi të mëdha të mbushura me kanaçe birre dhe pijesh të gazuara në akull. Grupe njerëzish qëndronin më këmbë duke u llafosur. Omari më prezantoi me disa prej tyre, shqiptarë dhe amerikanë.

- Kjo është Fabiola, - tha Omari duke më treguar njëren prej shoqeve të tij shqiptare, një vajzë ezmere e shkurtër me flokë të shkurtra të oksigjenuara. – E ke nga Berati. Ju të dyja duhet të keni plot për t'u llafosur.

- Edhe ti nga Berati je? – më pyeti Fabiola duke vrarë mendjen nëse e njihnim njëra-tjetrën.

- Jo, po ka të dashurin, - u përgjigj Omari.

Nuk më besohet që e tha këtë!

- Vërtet? Si e ka emrin? – pyeti Fabiola pa humbur kohë.

- Teo, - u dorëzova unë dhe asaj i ndrinë sytë.

- Teo nga mjekësorja? Mosha jonë? Me syze?

- Po, po dhe jo. Nuk e kam parë ndonjëherë me syze, - i thashë dhe m'u kujtua menjëherë. – Po tani që më thua ti, mbaj mend që i mblidhte sytë shpesh.

- I vinte një çikë zor që mbante syze. Do t'i kesh pëlqyer shumë vërtet. Domethënë ti na qenke “ajo”. S'ka faj! – tha Fabiola dhe më nguli sytë e qeshur e të çiltër.

- Isha, - psherëtiva. – Është në Londër tani. Omari nuk la shumë vend për hamendje.

- E dija për ty para se të thoshte gjë Omari. Unë e Teo kemi qenë në të njëjtën klasë në gjimnaz. E kisha shumë xhan dhe kemi mbetur miq të mirë që atëherë. Erdhi më tha për ty kur filluat të dilnit bashkë. Dukej shumë i lumtur.

- Ooo! Ti do të jesh e dashura e tij e parë! Edhe ai më tregoi për ty. Më tha edhe që erdhi të të thoshte për mua! – iu përgjigja e çuditur nga bota e vogël në të cilën jetojmë dhe e kënaqur nga reagimi i Fabiolës. – Uaaaa! Sa e çuditshme!

- Po hë, de. Duhet të mblidhemi ndonjë ditë dhe të llafosemi në ndonjë vend më të qetë.

- Amen!
- Mos je e krishterë? – pyeti Fabiola me sy edhe më të ndritshëm.
- Po, por foshnje fare; megjithëse kam mbi një vit që lexoj dhjatën e re. Po ti? – e pyeta shumë e ngazëllyer që po gjeja një besimtare tjetër për të ndarë gëzimin tim të sapogjetur pa frikën e talljes.
- Po, - u përgjigj Fabiola me buzët vesh me vesh. Dukej edhe ajo po aq e lumtur të më kishte gjetur.
- Tani vonë kam blerë të gjithë Biblën e plotë: dhjatën e vjetër dhe të re. Po ti, e lexon Biblën?
- Posi jo. Ke gjetur kishë të mirë? – pyeti Fabiola.
- Po. Quhet “Fjala e Jetës” dhe mblidhen tek kinema Agimi dy herë në javë. Po themelohet nga një predikues suedez.
- E jona nga hollandezët, po ne kemi predikuesin tonë shqiptar të mrekullueshëm tani. Edhe ai nga Berati është. Mund të vish te kisha ime kur të duash, - tha Fabiola dhe më tregoi orarin e takimeve te kisha e saj.
- Edhe kisha jonë po përgatit nja dy predikues të rinj shqiptarë, por mua akoma më pëlqen predikuesi suedez më tepër. Do të vij ta provoj kishën tënde ndonjëherë.
- Mrekulli! Hajde më gjej dhe ulemi bashkë.
- Hajde! Ju të dyja paskeni vërtet plot për të llafosur, - ndërhyri Omari dhe më tërhoqi për dore për të kërcyer, ndërsa Fabiola dhe e fejuara e tij vazhduan të llafoseshin anash.
- E dije ti që unë e Fabiola paskemi dashur të njëjtin djalë? Si ka mundësi? – pyeta Omarin duke kërcyer. – Më pëlqen dhe më duket se i pëlqej edhe unë asaj.
- Po nuk është se ai e la atë për ty, apo jo?
- Nuk besoj, se ne u takuam tre vjet e gjysmë pas shkollës së mesme, po prapë, mendoja se do ta kisha dalluar ndopak xheloz.
- Prandaj nuk të urren; edhe për faktin që nuk e ke as ti tani, - tha Omari me ngërdheshje.
- Ose mund të ketë të bëjë me dashurinë e Krishtit që mbulon një shumicë urrejtjesh. Kam shkuar prapë te kisha qëkur shkuam bashkë te stadiumi.
- Mir’o mirë! – ma priti Omari pa ma vënë veshin. – Po më thërrasin. Mund të më duhet të shkoj për të marrë birra të tjera me Dejvin. Na këtu, kërce ca me Armandon, - tha Omari dhe para se ta pyesja kush ishte, u gjenda përballë një djaloshi të pashëm e të qethur pastër, pak më i gjatë se unë.

- Hej, - buzëqesha e ndrojtur. – Nuk është e thënë të kërcejmë po nuk deshe. Je shok me Omarin?

- Po, - tha Armando. – Është gallatë fare.

- Njeh gjithë dynjanë. Po shkoj të kërkoj një pije te fuçia, - i thashë, ndërsa dola nga sheshi i vallëzimit, më të shumtën për t'iu shmangur muhabetit të sforcuar me një krejtësisht të panjohur në një dhomë të zhurmshme plot e përplot me njerëz, por Armando më ndoqi te fuçia dhe, po ashtu, filloi të kërkonte një birra.

- Paska patur të drejtë Omari; këto fuçitë po boshatisen shpejt, - tha Armando.

- Ja ku po vjen me furnizimin e ri, - thashë unë, kur pashë Omarin duke ardhur drejt grupit tonë, që tani përfshinte edhe Adrianin, të cilin Omari e kishte patur në klasë gjatë shkollës dhe tani e kishte në dhomë.

- Ç'kemi, Adrian? Nga ke qenë?

- Erdha pak më vonë.

- Do kthehesh në konvikt sonte?

- Po. Po ti?

- Po. Mos ik pa mua! – i thashë.

- Patjetër! – ma priti.

- Do rrish edhe shumë?

- Jo. Çështje minutash. Po vete vonë.

- E di! Edhe tani në njëmbëdhjetë më mbyllet dera. Ja, sa të vete të falenderoj Omarin, - i thashë dhe shkova ta kërkoja.

- Po iki unë. Më shoqëron Adriani për në konvikt. Rrofsh që më ftove prapë! U kënaqa!

- Shihemi mbrëmjen tjetër.

- Cilën? – e pyeta.

- Mbrëmja “Hallouin”, - u përgjigj Omari.

- Ç'është mbrëmja “Hallouin”? – e pyeta.

- “Hallouin” është një festë amerikane. Nuk e di çfarë feston apo historinë e saj dhe nuk më bëhet vonë, po di që duhet të vish e veshur si personazh nga ndonjë libër ose film i njohur edhe pi. Hajde, po deshe.

- Patjetër, po nuk kam çfarë të vesh nga këto që thua ti. Megjithëse kam një fustan shumë të bukur! – iu përgjigja dhe mezi po prisja një rast për të veshur fustanin prej atlasë rozë që më kishte qepur mami i Edit. Puna ishte se nuk dukej si ndonjë personazh i njohur.

- Nuk është e thënë të kesh ndonjë gjë të bukur apo të veçantë. Sa më

qesharake të dukesh, aq më e gjetur është veshja. As unë s'kam vendosur çfarë do jem.

- Ooo, do jetë si karnavalet që festonin në Greqi. Ata vinin maska.

- Diçka e tillë. Amerikanët e festojnë në ditën e fundit të tetorit.

- Mirë, do shoh se ç'mund të sajtoj, – ia prita e kënaqur që isha ftuar sërish.

- Armando do na tregojë mua dhe Eldës një restorant të ri nga liqeni nesër. Kam dëgjuar gjëra të mira për të. Do të vish me ne?

- Mirë, - i thashë pa u menduar gjatë, një vendim për të cilin u bëra pishman të nesërmen.

Gjithë rrugës në kthim nga restoranti, Elda e Omari ecën para nesh – mua dhe Armandos – duke u puthur e kuisur me njëri-tjetrin. Tani dukeshim si dy çifte, një ide shumë e sikletshme për mua në atë kohë dhe nuk dija as nga t'ia mbaja. Armando dukej si *tirons* shumë i sjellshëm dhe nuk ishte dhe aq më i zoti se unë për takimet e sajuara enkas.

- Omari më tha që ke mbaruar për elektronikë, - tentoi Armando me bisedën e sforcuar këtë radhë.

- Po, por ndërsa unë humba pothuajse një vit në Greqi, shumica e shokëve të mi janë rregulluar nëpër punëra të mira. Tani po kërkoj të njëjtën gjë edhe unë, - iu përgjigja. – Po ti, me se merresh?

- Unë punoj te spitalet. Mbarova për mjekësi një vit para teje dhe tani po bëj specializim për pathologji.

- Për s'mbari, - ia ktheva.

Nuk kisha të shkëputur nga Teo. Këdo që takoja dhe ngado që shkoja ma kujtonin. *Rrofsh për përpjekjen e mirë, Omar!*

KAPITULLI XVI

NJË DHOMË E RE

Gjatë javës, kalova shumë prej mbasditeve vetëm në dhomë duke menduar e medituar në heshtje, ndërsa thurja me shtiza një shall të gjatë rozë për dimrin e ardhshëm. Kisha sjellë turra akriliku dhe shtiza të trasha të drunjta nga shtëpia.

Një mbasdite, vendosa të pushoja nga thurja dhe shkova të blej ca bukë e sallam te kioska e vogël në anë të hyrjes së pasme për në qytet Studenti. Kioska ndodhej ndërmjet konvikteve femërore të studenteve të Shkencave Natyrore dhe atyre të Ekonomikut. Para se të mbërrija te kioska, dëgjova të më thërriste në emër një zë mashkulli nga mbrapa. Ktheva kokën nga rruga dhe pashë një nga shokët e Teos, student i elektrikes, që më buzëqeshi dhe mbajti hapat nga shokët e tij duke më pritur për ta takuar. Ia ktheva buzëqeshjen paksa e befasuar që denjoi të më jepte të njohur. Mund të më kishte kaluar nga mbrapa dhe unë as që do ta kisha marrë vesh kurrë që ishte pranë. Fillova t'i afrohesha edhe unë. U ndjeva e respektuar dhe ... mos! E mallëngjyer! M'u kujtua papritur sa shumë mall kisha për atë dialekt nga Berati dhe çdo gjë tjetër që më kujtonte Teon. Siç iu afrova, fillova të ndjeja të njëjtin lëmsh në fyt, një paralajmërim i shkurtër i lotëve të nxehtë paskëtaj.

- Si je? – më pyeti dhe më vështroi me sytë e dhembshur sapo u takuam.

- Mirë, - mezi nxora menjëherë para se të qaja. Ula sytë për të fshehur lotët e derdhur. I fshiva lotët dhe u përtypa me zor disa herë, ndërsa bëra dhe një përpjekje tjetër për të folur, por gjithçka munda të nxjerr ishte një buzëqeshje e shtirë dhe pëshpërita: “Më fal!”. I ktheva shpinën me shpejtësi për t'u kthyer prapë te kioska, me frikë se mos më shihte supet e dridhur me ngashërim. I përdora ato pak minuta të pritjes në radhë për t'u qetësuar dhe mbledhur veten, por sa më shumë i afrohesha radhës për të blerë, aq më e

pështirë më dukej ideja e të ngrënit. *Kam humbur oreksin.* “Në fakt, ideja e të agjëruarit për njëfarë kohe më duket gjeniale tani!” – vendosa papritur, ndërsa dola nga radha dhe u ktheva në dhomë me sa shpejtësi kisha. “Sa shumë njerëz që ka gjithandej! Shumë që ma kujtojnë. Pse të mos jetë ai vetë? Vetëm një më duhet, vetëm ai një. Ma kthe prapë, o Zot, të lutem!” – mendova pa e kuptuar që kisha kaluar në lutje. *A nuk shkojnë bashkë lutja dhe agjërimi? Aq e rëndësishme është për mua! Për sa kohë që nuk i them askujt që po agjëroj për burrë. Kur agjërova në mbështetje të çështjes studentore gjatë grevës së urisë, duke qenë në shtëpi dhe pranë ushqimeve, sigurisht që mund të agjëroj në një dhomë konvikti pa një thërrime. Pastaj, tani kam Shpirtin e Shenjtë për të më ndihmuar!* E bëra mendjen top: “Do të agjëroj për tri ditë. Tri ditë janë agjërim i njohur për mua. Duhet të më ndihmojë edhe thurja me shtizat”.

Megjithatë, planet e mia nuk e kishin parashikuar vizitën e papritur nga mamaja ime e shqetësuar po atë mbasdite.

- Ma! – u shpreha me habi. – Ça bën këtu ti?
- Ke kaq kohë që ke ikur. Erdha të shikoj çka bën.
- S’ka as dy javë. Hë, si thua? Të dukem ndonjë çikë më mirë?
- Shumë, - tha mami. – Edhe flokët të janë rritur e zbukuruar.
- Vajta edhe i preva një herë sa për t’u dhënë formë nga fundi mbrapa.

Tani duken të shkurtra me qëllim. Si janë nga shtëpia?

- Ne mirë jemi, po shirat po na kërcënojnë muret e dy dhomave të pambuluara, - tha mami dhe unë ndjeva faj për paratë e mia që po rrinin në bankë, ndërsa ishin kaq të nevojshme për familjen. Po të gjeja një punë sa më parë, atëherë mund t’i lëshoja.

- Nuk kam filluar punë akoma, ma, - iu përgjigja duke u përpjekur më kot të shfajësoja veten dhe aty për aty ndërrova temë. – Te Balja do të rrish sonte? Nuk kam mbulesa për krevatin tjetër këtu.

- Po, - ma ktheu. – Hajde edhe ti nesër për drekë.

Kjo duhet të jetë pjesa ku sapo u shkund kafazi i djallit nga lutja ime dhe vendimi për të agjëruar, kështu që më sulmon me mamanë që më fton për të ngrënë gjellë shtëpie për drekë te kushërira e saj! Nuk mund t’i thosha që po agjëroja, kështu që i premtova se do të shkoja ta takoja, gjithsesi.

Të nesërmen, rrugës për te Balja, u luta që Shpirti i Shenjtë o të ma largonte tundimin e ushqimit o të më ndihmonte të mbaja premtimin për të mos ngrënë për tri ditë. Pranë universitetit, takova rastësisht Ilirin, një shok klase përbri të cilit kisha marshuar në njërën prej demonstratave studentore që rrëzoi gjithë makinerinë komuniste. Ai kishte kapërcyer gardhin e

ambasadës zvicerane disa muaj pas demonstratave, por ishte kthyer dhe diplomuar. Ishim takuar e llafosur vërdallë universitetit nja dy herë që kur isha kthyer. Iliri kishte siguruar një vend pune si inxhinier i mirëmbajtjes për të vetmin stacion televiziv shtetëror në majë të Dajtit, nga ku dukej gjithë qyteti poshtë si në pëllëmbë të dorës. Ai punonte me turne shumëditore, duke patur trefishin e ditëve pushim në qytet.

- Ç'kemi? – më përshëndeti kur u takuam.

- Hiç, asgjë. Je pushim këto ditë? – iu përgjigja.

- Po, orari im i jashtëzakonshëm. Për ku kështu?

- Në fakt, më ka ardhur ime më dhe po më pret te shtëpia e kushërirës për drekë. Po nuk dua të ha atje dhe po vras mendjen për një arsye për të mos vajtur.

- Ta jap unë me gjithë qejf. Në fakt, kam një këtu me vete, - tha dhe hapi e mbylli shpejt anën e majtë të xhaketës për të më treguar një litroshe vere të kuqe.

- Që kur ke filluar të mbash shishe vere me vete ti? – e pyeta.

- Mos pyet. Di një lokal të qetë në një qoshe mbas “Arteve”. Po deshe, uleri qetë në një tavolinë dhe bëhemi tapë të dy.

- Të pimë verë pa ngrënë asgjë?

- Edhe hamë, – nguli këmbë Iliri. – Paguaj unë këtë radhë, meqë jam i vetmi me rrogë, – shtoi, sikur të kishte frikë mos e merrja këtë për ndonjë takim të dashurish po të paguante ai.

- Aty është puna; nuk mund të ha tani.

- Oh, kujtova se thjesht nuk doje të haje tek kushërira ose po i shmangeshe mamasë.

- Jo, është një çikë më e koklavitur.

- Mirë. Nuk hamë. Porosis vetëm dy Koka Kola për gotat dhe nuk na nget njeri për sa kohë të duam. Njoh njërin nga kamarieret, - premtoi dhe ma mbushi mendjen. *Vetëm për të ngrënë e bëra betimin; nuk thashë ndonjë gjë për të mos pirë!*

Kaluam përmes restorantit për tek tavolinat përjashta dhe Iliri zgjodhi një tek cepi i fshehur nga tavolinat e tjera. Edhe pamja e rrugës ishte e kufizuar nga kacavjerrëset e rritura nëpër kangjellat e larta të gardhit të hekurt. Iliri bëri ashtu siç kishte thënë dhe ne filluam të pinim e bisedonim.

- Të kam thënë unë ty që për pak sa u bëra modele një herë për një student të skulpturës? – e drejtova bisedën larg temës së agjërimit.

- Edhe një herë, pse nuk mund të hash ti? – pyeti Iliri.

Mos!

- Se po agjëroj.

- Nuk e dija që ishe myslimane aq e përkushtuar. Mos është gjë Ramazani?

- Nuk jam myslimane! Gjékundi! Edhe të krishterët agjërojnë. Ti duhet ta dish. Ke lindur në familje të krishterësh.

- Që kur na je bërë e krishterë ti?

- Kisha dy vjet që e mendoja, po tani vonë u krodha – ke parasysh, kur bën lutjen e shpëtimit e të tjera si këto. Nuk jam mësuar akoma me fjalorin e ri. Më duket si gjuhë e huaj.

- Uaa, urime! – u përgjigj Iliri dhe mua m’u bë qejfi që nuk u tall me vendimin tim. – E shkaktoi ndonjë gjë? – vazhdoi.

- Ndoshta një, ndoshta shumë gjëra. Nuk e di. Ndoshta u lodha duke ia dalë vetëm. E vura Perëndinë në provë disa herë dhe Ai e kaloi. Jeta është shumë më e lehtë kur ke ndihmë për ngarkesën. Me sa duket nuk jam aq krenare sa të mos pranoj ndihmë. Më duket se krenaria është pikërisht ajo që e pengon shumicën e njerëzve për ta pranuar Perëndinë. Mbaj mend që ajo më pengoi të dilja përpara te altari për thirrjen e shpëtimit. Më shqetësonte më tepër se ç’do të mendonin të tjerët: “Pse po shkon ajo? Çfarë plage apo sekreti fsheh që po lutet për ndihmë?”.

- Kishe ndonjë? – kapi Iliri rastin me shkathtësi.

- Fatkeqësisht, po. Dhe ti ma kujton shumë fare, gjë që është arsyeja kryesore për të cilën shoqërohem me ty. *Obobo! Mos e thashë me zë këtë?*

- Ou! – u shpreh Iliri dhe lëshoi duart anash karriges duke u mbështetur në të dhe duke më parë me sytë blu të mundur që përtej tavolinës.

E paskam thënë me zë, atëherë!

- Më fal, më fal! – thashë me nxitim duke mbuluar me dorë të qeshurën fajtores. – E dija që nuk ishte mirë të pirët esëll.

- E ke dëgjuar ti atë shprehjen: “ç’ka barku, nxjerr bardhaku”? – tha Iliri.

- E kam dëgjuar dhe jam dakord me të. Vetëm se mendoj që mund të kisha treguar një çikë më tepër finesë për të zgjedhur fjalët, po të mos kisha pirë aq shumë.

Aq sa pa takt mund të kishin qenë fjalët që kisha zgjedhur, po aq e qetë ndjehesha që e kisha krasitur deri në rrëzë ndonjë iluzion që Iliri mund të kishte pasur për një marrëdhënie me mua. Iliri ishte një shans i pashëm për bashkëshort, por unë isha akoma e marrë pas dikujt tjetër. Sa më shpejt t’i sqaroja gjërat, aq më mirë për të dy.

- Opo të lumtë ty! Bjeri, moj, bjeri, se mban ky samari im, Mirela! – ma priti me një ngërdheshje.

Kaluam nja dy orë duke pirë, me të qeshura, lot, qurre, e të qeshura prapë dhe shishja mbaroi.

- Falemnderit që humbe kohë me mua, - i thashë shumë më e dehur se Iliri.

Më mbajti për krahu, ndërsa u ngrita më këmbë, dhe ecëm të dy deri te pallati i kushërirës së mamasë.

- U kënaqa! Duhet të humbasim kohë prapë, - tha Iliri.

Edhe unë isha e kënaqur që e mori veten shpejt nga guximi im i tepruar dhe mund të vazhdonim të ishim thjesht miq.

Mami m'u lut prapëseprapë që të haja diçka, por, në ato momente, gjithçka doja ishte të shembesha mbi një divan gjëkund e të flija gjumë dhe ajo u dorëzua. Kur u zgjova nga dremitja e gjatë, mami më prezantoi me Petrefin, kushëririn e saj të parë, dhe të bijën e tij trevjeçare, Yllkën, që ishin ulur në dhomën e pritjes. M'u këput shpirti kur mora vesh se Yllkën e vogël e kishin nxjerrë me sëmundje të keqe në veshka dhe i ati do ta çonte në spital të nesërmen në mëngjes.

Më vonë mbasdite, mami vendosi të kthehej në shtëpi dhe unë e përcolla te stationi i autobusit.

- Do ikja pa merak po të kishe vënë diçka në gojë. Pse nuk hëngre një çikë?

Nuk mund t'i shmangesha më sime mëje. “Zot, më fal që po tregoj prapë!” – u luta duke mbajtur mend porosinë e Jezusit për të agjëruar e dhuruar në fshehtësi, për t'u lutur në dhomëzën time, pa ia shpallur gjithë botës, siç bëjnë hipokritët.

- Se po agjëroj, o ma.

Nuk isha e sigurt nëse kjo përgjigje i pëlqeu më tepër.

- Për sa kohë? – pyeti.

- Për tri ditë. E kam bërë më parë gjatë grevës së urisë. E mban mend?

- E mbaj, po ti je shumë e dobët tani. Nuk mund të agjërosh aq gjatë. Pse po agjëron?

- Pse mendon ti se po agjëroj, o ma? Mos duhet ta shpall me ndonjë parrullë?

- E marr me mend. Ke folur me të qëkur je kthyer? – pyeti mami.

- Jo. Nuk jam gati ta telefonoj akoma, po i kam premtuar që do ta pres, - iu përgjigja.

- Epo mirë, - tha mami. – Bëj si të të thotë zemra, - shtoi me një psherëtimë të thellë.

E dija që mamit i dhimbte shpirti dhe shqetësohej për mua. I dhashë një të puthur në faqe dhe e ndoqa me sy tek hipi në autobus. Mora frymë e lehtësuar që e kisha kaluar me sukses ditën e parë të agjërimit dhe vendosa të kënaqesha me arritjen e asaj dite.

Po nuk më dilte nga mendja kushërira ime e lezetshme dhe ndjeva një rëndesë për të bërë diçka.

Të nesërmen, bëra ca burani dhe ia çova kushëririn në spital. E gjeta të trishtuar, të këputur dhe vetëm, duke pritur në ankth që doktorët të mbaronin analizat e së bijës. E dija që më duhej të lutesha me të, po nuk munda të mblidhja kurajon që ta pyesja. Ah sikur ta sillte vajzën te një nga shërbesat e lutjes te kisha ime! Do të shërohej krejtësisht. Ose mund të sillja unë “luftëtarët” e lutjes nga kisha ime këtu. Jezusi premtoi që, nëse dy a më tepër do të mblidheshin në emrin e Tij, Ai do të ishte i pranishëm.

Të nesërmen, pas shërbesës së të mërkurës mbasdite, u bashkova me disa nga besimtarët e rinj në shtëpinë e njërit prej tyre për një grup të vogël lutjesh. Pas mbledhjes, u kërkova të vinin me mua te spitali dhe të luteshin për kushërirën time të vogël. Ata pranuan njëzëri dhe erdhën pas meje te dhoma e spitalit të Yllkës. U lutën për Yllkën dhe gjithë të tjerët në dhomë.

I shkova prapë kushëririn mëngjesin e ditës së tretë dhe ai ende nuk kishte marrë asnjë përgjigje. Ndjehej i pafuqishëm për të bërë gjë dhe pa kokërr leku për rryshfete. M’u kujtua Armando dhe me hezitim vendosa të shkoja t’i kërkoja ndihmë. “Kur s’i kushtova një çikë më tepër vëmendje!” – po mendoja rrugës për te pavioni i tij. Shpresoj të mos e marrë këtë si përpjekje tunduese. U zhgënjeva për kushërirën, por u çlirova për vete që nuk e gjeta Armandon në punë atë ditë.

Endja përmes spitaleve duke kërkuar Armandon më dha aq kurajo sa të shikoja edhe një herë se ç’bëhej me Teon, por jo aq sa për ta marrë në telefon. E vetmja rreze e vobektë në realitetin e Teos që më binte ndër mend tani kalonte nga gjyshërit e Skendit. Ata kishin qenë të ëmbël dhe të dashur herën e parë që i kisha takuar dhe kjo më jepte besim të mjaftueshëm sa për t’u bërë një vizitë. Do ta dëgjoja me kënaqësi çdo gjë që mund të më thoshin sado e parëndësishme që t’u dukej atyre. Do të më gëzonte gjithë ditën – ndoshta gjithë muajin.

Të shtunën tjetër, pasi kisha përfunduar tri ditët e agjërimit, bleva një pako kafe të vogël dhe iu ngjita shkallëve për te apartamenti i prindërve të

Skendit. Para se të trokisja, u hap dera dhe gjyshërit e Skendit po qendronin në korridor duke përcjellë një mike – një grua e moshuar, e shkurtër, e veshur krejt me të zeza dhe me shefon të zi në kokë. Po tani?! Që të tre pushuan së foluri dhe më panë për një çast të shkurtër, pastaj u duk se nënës së Skendit iu kujtua kush isha sapo u buzëqesha në përshëndetje.

- Më falni! Paskam ardhur në kohë të papërshtatshme...! – por ma prenë fjalën para se të mbaroja.

- Jo, jo, jo! Kushërira jonë sa po ikte. Hajde ulu brenda, - tha nëna dhe më tregoi dhomën e pritjes. U ula dhe prita, ndërsa ata i pëshpëritën mysafires së tyre për disa minuta dhe pastaj erdhën brenda.

- Si je? – pyeti gjyshi.

- Mirë, falemnderit! Po ju, si jeni? – i pyeta dhe u lashë pakon e kafesë mbi tavolinë.

- Oh, kot je harxhuar, - tha nëna. – Ne mirë jemi, si pleq dhe vetëm që jemi. Shyqyr Zotit për vizitorët që na vijnë ndonjë herë. Ajo gruaja që pe duke dalë është tez’e madhe e Teos. Dhe vetëm aq iu desh syve të mi të mbusheshin sërish. *Jo tani!* Shtrëngova nofullat, por nuk munda t’i ndaloja dhe lotët kokëfortë filluan të rrokulliseshin qetë-qetë. *Mbase nuk shikojnë mirë nga sytë e plakur!* Por gjyshi i vuri re dhe tha: “Mos u mërzit për atë!”, së cilës gjyshja ia priti që nga kuzhina: “Mirë të thotë, dava kaurësh! Janë të tërë kaurë nga e ëma. Ajo u fut pykë në mes”.

- E mora vesh, - qesha e prekur edhe më tepër nga përpjekja e tyre e dhembshur për të më qetësuar qoftë edhe duke përfolur familjen e Teos, sojit të tyre. Më e forta ishte që unë isha bërë “kaure” edhe vetë tani. Fatkeqësisht, nuk e gjeta dot guximin t’ua thosha këtë. Nëna e Skendit doli nga aneksi me një tabaka me të ëmbla dhe një teke liker qershie.

- Falemnderit! – i thashë, siç piva një gllënjë nga likeri i shijshëm që kishte bërë vetë. Të pirët nga gota gjithmonë më ndihmonte të pushoja së qari. Sa herë më bënte për të qarë im vëlla, Loni, më gënjente me një gotë të madhe plot me ujë dhe mua më vinte zor të filloja së qari prapë pasi kisha pirë. – Keni marrë vesh gjë nga Skendi? – e pyeta.

- Po, është shumë mirë. Mburremi me të! Po shkon në shkollë prapë, - tha gjyshi.

- Skendi është djalë i shkëlqyer dhe shok i mrekullueshëm. Më la pa mend kur më dërgoi mua dhe tri shoqeve të tjera të klasës nga një varëse floriri sapo kishte mbërritur në Angli. Ishte gjëja më e bukur që ka bërë njeri ndonjëherë për mua. Gëzohem shumë që i ka vajtur mbarë dhe i uroj gjithë të mirat!

- Falemnderit! – ma priti gjyshja.

- Atëherë, ishte kënaqësi që ju pashë përsëri të dyve. Shyqyr që jeni mirë me shëndet dhe keni njëri-tjetrin, - thashë, siç u ngrita për të ikur.

- Rrofsh që na dole! Hajde prapë sa herë të kesh nevojë për t'u llafosur, - u përgjigjën dhe më përcollën te dera e jashtme, siç kishin përcjellë tezen e madhe të Teos.

“Mirë që nuk kisha veshur xhinset e ngushta apo të gomuarat!” – mendova duke ulur sytë tek çizmet e zeza kamoshe të mbuluara poshtë gjunjëve nga fundi gri, i njëjti që kisha veshur herën e parë që takova Teon pas udhëtimit në Pogradec. As Teo e askush tjetër me të cilët kisha folur nuk e kishin shqiptuar arsyen e së ëmës kundër meje. Më rrinte mendja tek orët e vona të punës në disko ose opiniononi që kisha lënë për mënyrën se si vishesha.

Rrugës për në konvikt, vendosa të kaloja nga universiteti, po Dori kishte ikur për atë ditë.

Po zbrisja shkallëve të jashtme, kur pashë Timon te fundi i tyre duke u ngjitur.

- Timo! – bërtita me gëzim që pashë një fytyrë të njohur dhe iu hodha në krahë për ta përqaftuar.

- E paske prurë kokën, më? – tha Timo, që dukej po aq i lumtur të më shikonte, duke buzëqeshur me sytë e vegjël të rrudhur tek bishti.

- Po, falë kuçedrës, - thashë dhe ai e kuptoi në çast se për kë e kisha fjalën.

- Kujdes me epitetet! Do të ishte zakon i keq, ke parasysh, po të përfundonit në të njëjtën familje, a ku di unë.

- Eh, është mbyllur me kohë ai kapitull, - iu përgjigja dhe papritur ndjeva inat dhe një dëshirë për hakmarrje për herë të parë. *Ku ka më mirë se sa me shokun e tij më të ngushtë? Nuk më besohet që edhe më shkoi nëpër mendje! Pse jam unë aq mendjekalbur nuk do të thotë që janë dhe gjithë të tjerët. Timo nuk do ta bënte kurrë një gjë të tillë. Apo jo?*

- Ou, ashtu thua tani. Nuk dorëzohesh kollaj ti, - tha Timo dhe unë ndjeva skuqjen nga mendimet e mia të turpshme. *Edhe ai ka më shumë besim se unë!*

- Nuk jam dorëzuar, po edhe me zor nuk futem në një familje që nuk më do, - ia ktheva.

- Ou, do t'u mbushet mendja, - u përgjigj Timo pastaj vazhdoi, - Ça po bën për punë? Apo po peshkon për ndonjë burrë të pasur? – ngacmoi.

- Akoma në kërkim, - i erdha pas avazit. – Asgjë! – i thashë dhe fillova të

këndoja: “Asgjë nuk krahasohet, asgjë nuk krahasohet me ty!” nga refreni i së vetmes këngë që dija prej Sinead O’Connor.

- Aty i ke rënë pikës; njerëz si ai janë të paktë e të rrallë. Nga ajo e more frymëzimin për modelin e flokëve? – ngacmoi prapë duke iu referuar kokës pothuajse të rruar të këngëtares.

- E paske marrë vesh ti? – ia prita. – U nxi fare ca kohë.

- Dëgjova që nuk dilte as dielli andej, - miratoi Timo buzagaz.

- Pastaj zbulova që nuk dukesh fare si ajo.

- Po atë ta kisha thënë unë ty.

- Sa mirë që ca gjëra nuk ndryshojnë kurrë. Si gjithmonë, i gatshëm për të vërtetën e pamëshirshme, - iu përgjigja dhe heshta për disa sekonda, në mëdyshje për të ndarë me Timon gëzimin tim më të fundit. Timo mund të kalonte gjithë ditën duke u argëtuar me besimin tim të sapogjetur. *E çë se tallet? Aq më tepër gurë të çmuar për kurorën time të përjetshme!*

- Në fakt, kam gjetur dikë rishtaz, - vendosa. – Kam gjetur Krishtin, ose më mirë të them, më gjeti Ai mua. Lexoj Biblën përditë dhe pres me padurim të shkoj në kishë dy herë në javë.

- Je bërë edhe ti një nga ata koqet e kishës?

- Jo. Unë ashtu kam qenë gjithmonë. Tani kam gjetur vendin.

- E hëngri dhe një tjetër. Në qytet Studenti po rri akoma?

- Po. Atje po shkoj edhe tani. Po ti, ç’bën këtu në Tiranë? Apo do vish këtu për fare?

-Jo, jo. Kam shumë gjëra nëpër duar atje ku jam. Më ka ikur edhe vëllai me nusen në Greqi. Kam për t’u kujdesur për prindërit dhe një biznes të ri.

- Biznes? Përveç punës si inxhinier?

- Eee. Po prodhoj ujë të gazuar.

- Po prodhon diçka, si në fabrikë, me punëtorë? – vazhdova me habi.

Timo sipërmarrësi!

- Eee. Jam pronari, dora vetë, - tha Timo buzagaz.

- Të lumtë! Unë nuk kalova dot as provimin e të shtypurit për një firmë italiane. Isha shumë e ngathët. Më ka ndihmuar Dori me historikun e punës e të tjera si këto.

- Po nga Telekom i ke vajtur?

- Jo. Akoma.

- E di kush është shef atje?

- Jo. Kush?

- Arturi, *presori* ynë i frikshëm i telekomunikacioneve.

- Turi, i forti?

- Po, - u përgjigj Timo duke qeshur.

- As që bëhet fjalë fare, atëherë.

Shefi kishte qenë një nga profesorët gjatë vitit të katërt në universitet. Ishte beqar nga fundi i të njëzetave drejt një të ardhmeje shumë premtuese në fushën e tij; sa inteligjent aq edhe hijerëndë. Ishte mbi një e tetëdhjetë i gjatë dhe nga trupi muskolor dukej sikur sapo kishte dalë nga një film romakësh me trupa Hollivudi; një paketë goxha tërheqëse po të mos i vije veshin personalitetit të tij të paafrueshëm dhe këmbëve të shtrembra që përfundonin në vithe praktikisht të padukshme, mjekrën e dalë përpara dhe ballin në zmadhim e sipër që nuk i shkonte fare me kaçuben e kaçurrelave në pjesën tjetër të kokës. Numëroja me vete të gjitha karakteristikat e tij të padëshirueshme sa herë që më duhej të vija në kontakt me të, me qëllim që të zbutja efektin e hijes së tij të rëndë mbi mua.

- Pse? Ta kërkoj gjë?

- Ti rrezik s'e mban mend fare, po ke qenë atje kur ndodhi. Po kthenim një detyrë kursi te klasa e tij dhe një grup prej pesë a gjashtë prej nesh po prisnin te dera që të na thërriste brenda një nga një. Kur më erdhi radha mua për t'i dhënë projektin, profesori i hodhi një sy. Pastaj ngriti vetullat e trasha harkore dhe më pa me ngulm me sytë e mëdhenj e të zinj. "Ke ndonjë pyetje?", - tha nëpër dhëmbë me atë nofullën e poshtme të bezdisshme. "Jo!"; - ia prita unë sa më serioze. Isha shumë në siklet që isha vetëm në klasën e tij edhe pse i kujtoja vetes që ju ishit të gjithë vetëm dy-tre metra më tutje, mbrapa derës së mbyllur.

- Se mos do bënim ndonjë budallallëk ne për të rrezikuar notat tona për ty, - u përgjigj Timo me qeshjen tinëzare. - Aty ishe vetëm.

- Sa mirë ta di tani, po atëherë nuk mendoja se do të guxonte të bënte ndonjë budallallëk me të gjithë ju mbrapa derës. Nejse, mua vetëm atje më rrinte mendja në atë kohë. Sa më trembte! Pastaj, siç e pata parandjerë, tha: "Hajde të më takosh sa herë të kesh pyetje për ndonjë gjë ose të kesh nevojë për ndihmë; për shembull ndonjë mbasdite javës tjetër". E falenderova dhe ia mbatha që andej nga sytë këmbët. Pastaj, sapo dola, ti më ngacmove për të. Nuk e di nëse e the ngaqë më pe flakërimë apo ashtu pyete çdonjërin nga ato që dolën nga klasa e tij atë ditë. Vetëm se mbaj mend që isha si e paralizuar dhe nuk studioja dot as për sezonin e provimeve.

- Nuk do të të ishte duhur po të kishe bërë siç të tha ai, - ngacmoi Timo sërish duke qeshur.

- Po, po. As kisha ndër mend t'i kërkoja "ndihmë", as i kërkoja. Kisha frikë

nga hakmarrja e tij kur të vinte koha e provimit, meqë nuk kisha bërë çfarë kishte nënkuptuar, por, për çudinë time, më kaloi edhe pse nuk e meritoja.

- Ashtu duket ai, po nuk është i keq. Më ka ofruar një vend pune këtu në Tiranë disa herë. Edhe pasi ia refuzova, më tha që mund të shkoj ta takoj po të bëhem pishman.

- Nuk ma merr mendja që do të bënte të njëjtën gjë për mua. Më duket se i kishte me sy të mirë shumicën e djemve në klasë – nuk jam e sigurt për ne vajzat.

- Jam i sigurt që pëlqente vajzat më tepër; vetëm se jo për aftësitë e tyre inxhinierike, - u përgjigj Timo me shaka sërish, por vazhdoi, - Nejse, unë prapë mendoj që të shkosh ta pyesësh. S'të kushton gjë.

- Mbase edhe shkoj. Do të kthehesh në shtëpi sonte? – e pyeta.

- Jo. Do fle në konvikt. Mbase vij të takoj nesër – ndoshta nga dreka.

- Unë do të jem në kishë deri nga dreka nesër, - iu përgjigjja.

- Do të të thërras nga dritarja. Po nuk u përgjigje, atëherë do ta di që nuk je kthyer.

- Mirë! Shihemi nesër, - miratova dhe u skuqa sërish duke u futur në godinë.

Pse do të më takojë Timua prapë? Nuk i thamë të gjitha? Po sikur të jetë edhe ai i vetmuar dhe po më lexon mendimet? Apo s'ma lexonte mendjen gjithmonë kur kërcenim. Edhe sikur të jetë, Timo do të vuante nën gunë dhe nuk do të hante mbeturinat e dikujt tjetër. Si do ta vinte hakmarrja çdo gjë në vend, gjithsesi? Vetëm sa do të shkatërronte një apo dy miqësi të mira. E de avash, o truri im i vogël! Ai është thjesht një shok me nostalgji për ditët e rinisë së shkuar, siç jam unë.

Përgjegjësja e godinës ishte ulur te hyrja, pranë rojes së derës, dhe më thirri sapo më pa që u futa në godinë për te dhoma ime.

- Të gjeta një dhomë të re në katin e katërt, - tha ajo dhe mua më ngrinë këmbët në vend. Më drithëroi mendimi që ëndrra e fundit që kisha parë me Teon duke më thirrur nga poshtë dritares edhe mund të ishte profetike, por kur më tregoi numrin e dhomës, zbulova se ishte në anën e kundërt të dhomës në ëndërr dhe gufimi im u shua po aq shpejt sa ishte formuar. Por më mjaftoi për të më kujtuar sa shumë më mungonte dhe se si nuk mund të bëja kurrë ndonjë gjë që do të lëndonte atë apo të dashurit e tij.

- Do të jesh në dhomë me një studente të vitit të parë të elektronikës nga Berati, - shtoi përgjegjësja.

- Sigurisht! – qesha nën dhëmbë dhe rrokullisa sytë ndaj një kujtese tjetër.

Nuk paskam shpëtim nga këta njerëz! Sikur janë tentakulat e padukshme të Teos që shtrihen që nga Londra duke më parë e më ngacmuar në çdo mënyrë të mundshme!

Falenderova përgjegjësen, disi e befasuar që e mbajti fjalën dhe vazhdova për tek dhoma ime në katin e parë. U shtriva në krevat për të pushuar për disa minuta nga një ditë e gjatë më këmbë para se të filloja transferimin. Nuk më dilte nga mendja nofka që i kisha ngjitur më parë me Timon mamasë së Teos dhe uroja të kisha ndonjë mënyrë për t'i tërhequr mbrapsht ato fjalë. “Më fal, o Zot!” – u luta dhe hapa Biblën. Ra hapur tek Mateu 19:5-6 dhe unë u rrënoqetha kur lexova: “...Për këtë arsye njeriu do ta lërë babanë dhe nënën e vet dhe do të bashkohet me gruan e vet; dhe të dy do të jenë një mish i vetëm. Dhe kështu ata nuk janë më dy, por një mish i vetëm; prandaj atë që Perëndia ka bashkuar, njeriu të mos e ndajë!”.

O Zot! Çfarë je duke thënë? Nuk bëhet më me porosi se kaq! Kam shumë frikë të ngazëllem që jo vetëm Perëndia e njeh bashkimin tonë, por po premtan edhe të shkëpusë lidhjen e Teos me t'ëmën. E përqafova Biblën në kraharor dhe m'u duk sikur do të më shpërthente zemra nga gëzimi që po përpiqesha të frenoja. U ktheva përmbys, fundosa fytyrën në jastëk dhe e lëshova të gjithë me një britmë. Tani kisha plot vend për të fshehur Fjalën e Perëndisë thellë në shpirt.

Po e bëja me kënaqësi lëvizjen në një kat të sipërm edhe pse nuk ishte tamam dhoma që kisha pritur. Të paktën ishte në të njëjtin kat. Mblodha rraquet e mia dhe u ngjita në katin e katërt, në të njëjtën dhomë ku kisha kërcyer me Teon për herë të fundit.

Shoqja e re e dhomës ishte një vajzë e bukur, e qetë, e gjatë dhe e hollë me shalë të gjata si prej skulpture. Flokët e dendura, të zeza me shkëlqim i arrinin deri në vithe. Disa baluke i mbulonin ballin e lartë mbi vetullat e zeza paksa të tërhequra nga gërsheti mbas kokës së saj të vogël.

Qafa e gjatë e Mirës, shpina e drejtë dhe çdo gjë tjetër e qëndrimit të saj të përkryer ulërinte “balerinë” në radarin tim dallues ndaj balerinave. *Çne balerina në shkollë inxhinierie?* Nuk i rezistova dot kureshtjes sime.

- Ti dukesh si balerinë. Je marrë ndonjëherë me balet? – e pyeta pas përshëndetjes sonë fillestare.

- Jam marrë, - buzëqeshi e kënaqur që e vura re, - nga klasa e pestë deri në klasë të tetë.

- Ua, çfarë mrekullie!

U mrekullova që jo vetëm më në fund takova një balerinë të vërtetë nga afër, por më binte të ndaja edhe dhomën me një.

- Pse e le?

- Sepse shkolla e koreografisë që do të vazhdoja pas shkollës së mesme u mbyll atë vit. Pata fat që ndodhi ndërsa mundesha akoma të bëja kalimin në gjimnaz. Po të kisha vazhduar me baletin në shkollë të mesme, ai do të kishte qenë fundi i shkollimit për mua dhe do të kisha përfunduar në tekstilet e Beratit.

- Dhe tani bëhesh inxhinierë elektronike; alamet shkëmbimi. Më e bukura këtu është që mbase mësoj edhe unë ndonjë marifet baleti – kuptohet, po të duash ti të më mësosh, - buzëqesha me shpresë.

- Patjetër, - ma ktheu edhe Mira buzagaz.

E kapja veten duke admiruar dhe imituar qëndrimin e Mirës. Edhe ajo dukej se më mësonte me kënaqësi çdo gjë që doja të dija për baletin.

- Si ka mundësi që je vetëm në dhomë pothuajse dy muaj pas fillimit të shkollës? – e pyeta me zë.

- Nuk isha vetëm. Banoja me një shoqe shtatzënë dhe të dashurin e saj.

- Ç’thua, moj?! Lejohen djem në godinë tani?

- Varet nga çmimi. Ku ke qenë ti?

- E ngujuar në shtëpinë e tim vëllai në Greqi.

- Oh, epo mirë atëherë, mirë se na u ktheve në korrupsionin tonë demokratik, - tha Mira.

- Është i njëjti korrupsion që ka qenë gjithmonë; demokracia vetëm sa i hoqi kapakun, - ia ktheva duke mbajtur mend se si më lejonin në godinë pas orarit për çmimin e duhur. – Po pastaj, ç’u bë me çiftin e lumtur?

- Ata më linin shpesh përjashta duke pritur te dera pas shkolle; nganjëherë edhe nga një gjysmë ore, pastaj përpiqeshin të më mbushnin mendjen që nuk po bënin ndonjë gjë. U bënë të mërzitshëm, kështu që unë u ankova.

- Të lumtë! Lum unë! – ia prita sinqerisht.

Mëngjesi i së dielës pasardhëse më gjeti duke u zgjuar në dhomën time të re, duke i qeshur agimit. Gjatë gjithë viteve të mëparshme të jetës sime në konvikt, kisha admiruar pamjen e perëndimeve të zjarrta. Mëngjeset në atë anë të godinës ishin të errta, sidomos me perdet e rënda të mbyllura. Më kishte kushtuar një provim në vitin e dytë, siç fjeta edhe nja dy orë pasi shokët e mi kishin filluar provimin me shkrim.

Këtë të dielë, vendosa të shkoja te kisha e Fabiolës. Ishte një kishë prej dyqind e ca besimtarësh që takoheshin në një sallë të madhe në katin e dytë

të Estradës Tirana, vendodhja zyrtare e trupës humoriste profesioniste të Tiranës. Nuk m'u desh shumë kohë që ta gjeja në turmë. Sapo më pa Fabiola te hyrja e pasme, erdhi me krahë hapur dhe më përqafoi sikur të takonte një mike të vjetër.

Njerëzit tek kisha Rilindja kishin të njëjtat fytyra vezulluese që kisha parë tek njerëzit e kishës sime. Fabiola më shoqëroi dhe më prezantoi me shumë prej tyre, që përqafonin e puthnin njëri-tjetrin, vërtet të ngazëllyer që ishin në shtëpinë e Zotit së bashku. Ndërveprimi im me besimtarët e tjerë ishte i vetmi ndryshim ndërmjet kësaj dhe kishës sime, ku më mjaftonte të ulesha në radhët e pasme, duke vëzhguar e duke u mrekulluar me përvojën adhuruese të të tjerëve dhe përgjigjen e Shpirtit të Shenjtë pa njohur e pa më njohur njeri – gjithmonë në përpjekje për të qenë sa më e padukshme; e fundit në hyrje, e para në dalje. Po nga java në javë, u mësova me njohjen dhe ndërveprimin në kishën e Fabiolës. Në fund të fundit, nuk ishim dhe aq shumë. Krishtërimi ishte një përvojë e re dhe e rrallë për shumë në brezin tim; mirë ishte ta kërkonim dhe gëzonim njëri-tjetrin. Më dukej sikur tani i përkisja jo vetëm Perëndisë dhe Krishtit, por edhe një grupi njerëzish të një mendjeje. Gjithçka thoshte Bibla për njësimin në Shpirtin e Shenjtë bëhej e gjallë në mbledhje të tilla të gëzueshme.

Fjalët e predikuesit të ri, simpatik dhe orator pikonin si vaj mbi shpirtin tim të plagosur. Çdo fjalë vlente; çdo fjalë ishte kuptimplote. Konfirmoi pendesën time për çdo mendim të mbrapshtë hakmarrës dhe tradhtues që kisha patur një ditë më parë. Vendosa të mos kthehesha në konvikt menjëherë pas shërbesës, siç i kisha premtuar Timos. Faji i thyerjes së premtimit për ta takuar dhe pritja e tij po më rëndonte shumë më pak në ndërgjegje se sa rezultati i mundshëm shkatërrues i takimit tonë. Në fund të fundit, aq faj mund ta justifikoja duke i kujtuar vetes që Timo as që nuk do të më gjente dot, meqë kisha ndërruar dhomën nga një ditë më parë.

Po kthehesha ngadalë për në konvikt, kur takova Nardin nga Erseka. Nardi kishte qenë në të njëjtën klasë dhe shok i mirë i Edit. Nuk e kisha parë që nga diplomimi, pothuajse një vit e gjysmë të shkuar.

- Po ti, ç'bën këtu në Tiranë? – e pyeta pas përshëndetjes sonë fillestare.

- Po shoqëroj dhe përkthej për nja dy bosa italianë që takova në Ersekë. Ata po përpiqen të krijojnë një copë tregu për telefona celularë, - ma ktheu Nardi. – Po ti?

- Unë sapo jam kthyer nga Greqia dhe tani po kërkoj punë këtu, me shpresë. Po rri me shokë në konvikt?

- Jo, zakonisht rri me italianët. Paguajnë për strehimin dhe dietat bashkë me rrogën.

- Duket si goxha punë.

- Mirë është. Është Edi këtu me ty? – pyeti Nardi.

- Jo. Ajo jeton me familjen, që tani rrinë në Fier, dhe shkon e vjen me tren te rafineria e naftës në Ballsh. Është inxhinieri elektrike te panelet e komandimit.

- I lumtë! – ma ktheu Nardi.

- Shkova një ditë me të te puna pasi u ktheva nga Greqia. Të qelb er'e naftës atje. Gjithë ajo naftë është praktikisht mbi tokë. E nuhasja gjithmonë kur kaloja andej rrugës për tek fshati i mamit dhe babit, po është krejt tjetër kur e thith gjithë ditën e ditës.

- Epo mirë, bëji shumë të fala nga unë kur ta shohësh herë tjetër. Do të ishte mirë të ishim mbledhur edhe një herë si njëherë, - tha Nardi dhe tanimë e kuptova që ne të gjithë kishim mall për të ritë e shkollës.

- Patjetër, - i premtova.

- Te konviktet po rri?

- Po.

- Po të mos jesh e zënë sonte, të ftoj të vish me mua dhe italianët për darkë. Jam i sigurt që do të kënaqeshin në shoqërinë tënde. Po deshe, mund të sjellësh edhe ndonjë shoqe me vete, - tha Nardi.

- Nuk kam plan tjetër për sonte. Vij me dëshirë. Falemnderit! Do t'i them Dorit dhe të motrës të vijnë edhe ato. Italishtja e tyre është shumë më e mirë se imja. Ti e mban mend Dorin, shoqen time të klasës nga Durrësi, apo jo?

- Po, thuaju të dyjave. Sa më shumë, aq më mirë! Të vij nga ora shtatë? – pyeti Nardi.

- Mirë, - rashë dakord dhe ia mbatha për te dhoma e Dorit për të parë nëse ishin kthyer nga shtëpia. Nganjëherë nuk ktheheshin nga Durrësi deri të hënë në mëngjes.

- Qenke kthy, mi? – u shpreha me gëzim kur Dori më hapi derën.

- Sapo. Si je? – m'u përgjigj Dori duke shpaktuar teshat dhe ushqimet që kishte sjellë nga shtëpia.

- Mirë! Gjeta një dhomë të re dhe një balerinë për shoqe dhome në katin e katërt, - ia prita në humor të mirë. - Më ftoi edhe Nardi sonte për darkë me nja dy italianë.

- Paskë qenë e zënë! Shoku i Edit? – pyeti Dori.

- Po, ai. Është djalë i mirë, po do të ndihesha shumë më mirë po të vinit

edhe ju me mua. Pastaj, më është ndryshkur italishtja nga ndenjta e gjatë në Greqi. E filloj fjalinë në italisht dhe më ngecet truri në një fjalë greke. Si thoni?

- E mbaj mend Nardin; paksa i ndrojtur. Si thua ti Enxhi? – Dori pyeti të voglën.

- Si qejf më duket mua! Pse jo? – u përgjigj Enxhi duke buzëqeshur me gropëzat e lezetshme në faqe dhe një shkëndijë në sytë e butë e të zinj me qerpikë të errët e të kthyer vetvetiu. Kishte flokë të zeza të dendura e me onde poshtë supeve, me baluke të ndara në mes të ballit të saj të vogël anash vetullave të plota.

Edhe pse kishin një vit diferencë, sjellja dhe afërsia e motrave me njëra-tjetrën më ngjante me atë të binjakëve. E donin dhe e respektonin njëra-tjetrën si nuk kisha parë kurrë më parë dy motra të tjera. Nuk i shikoja kurrë të kishin zili apo të ziheshin me njëra-tjetrën. Enxhi respektonte pjekurinë e Dorit dhe Dori admironte Enxhin e i bëhej mburojë çiltërsisë së saj.

- Për s'mbari! Falemnderit! Nardi do të vijë të na marrë aty nga shtata. Unë po shkoj të shtrihem për një dremkë dhe pastaj do të bëhem gati, - u thashë dhe iu ngjita shkallëve për në dhomën time të re.

Nardi u kthye brenda orës shtatë siç kishte premtuar. Dori, Enxhi dhe unë e takuam para godinës dhe ecëm me të deri në rrëzë të kodrës, ku dy shokët e tij italianë po prisnin më këmbë pranë makinës së tyre. Mauricio, në të tridhjetat, ishte më i gjati nga të dy, me flokë të verdha kaçurrela, sy të gjelbër, paksa i mbushur. Franko ishte fjalaman, me flokët tipike të zeza e të ndritshme, si të lëpira, dhe lëkurën e ullinjtë.

Megjithëse u përpoqa t'i mbaja përgjigjet e mia sa më të shkurtra, disi arrita t'i tërhiqja vëmendjen Mauricos. U çudita pak kur m'u kthye, nga gjithë të tjerët e mundshëm, dhe tha: "Sa mirë e zotëron Italishten! Nga televizori e ke mësuar, siç kam dëgjuar që kanë bërë shumica e shqiptarëve të brezit tënd?"

- Falemnderit që më bën qejfin, por më mirë kuptoj se sa flas, - ia prita. – Aq pak sa di, siç e ke marrë vesh, e di nga TV, po babit i takon merita që më mësoi dhjetë numrat e parë, - u përpoqa me italishten time të çalë.

- Po ai, ku i mësoi?

- Gjatë luftës. Kur kapitulloi Italia, familja e tim eti strehoi disa ushtarë italianë që kishin pushtuar Shqipërinë dhe i fshehu nga gjermanët, që, se për

ç'arsye, po i ndiqnin këmba-këmbës për t'i vrarë, - iu përgjigja duke kaluar në anglisht ose duke i kërkuar Dorit ndihmë.

- Sa e çuditshme më duket dhe më vret pak ndërgjegjja që pothuajse një komb i tërë vetëm shtatëdhjetë milje përtej Adriatikut flet gjuhën time, ndërkohë unë zor se kam ditur gjë për ekzistencën e jo më për gjuhën e tij.

- Mund t'ia vësh fajin mureve të lartë komunistë për këtë. Na bënë të padukshëm nga bota, por ngjyrat e botës më verbuese ndaj nesh. Momentin që iu prezantua televizori popullit anembanë, komunistët e humbën kontrollin mbi izolimin, - ndërhyri Dori dhe vazhdoi, – Kur njerëzia morën televizorët e parë, mësuan shumë shpejt të modifikonin antenat për marrje më të mirë të kanaleve sllave dhe italiane.

- Ju kishit ca sinjale të forta dhe programe mahnitëse. Edhe im atë i pëlqente reklamat e solucioneve pastruese me gratë e bukura dhe çarçafët e bardhë, që thaheshin nën diellin e fshatit, ose dyshemetë me pllakat e shkëlqyera, - shtova unë duke kujtuar me mall.

- Gjithë njerëzia ngulej para ekraneve për serialin e Tarzanit çdo pasdite, - vazhdoi Dori. – Gjithmonë vrisja mendjen nëse e shikonte edhe sekretari i rinisë së qytetit në ditët që nuk na bënte politikë edhe ne fëmijëve. Organizonte mbledhje me nxënësit e tetëvjeçares që kishin nota të mira, ku i udhëzonte si të dilnin nëpër qytet dhe të shkruanin adresat e shtëpive ose apartamenteve me antena të modifikuara që t'ia raportnin atij.

- E mbaj mend, - u hodha unë.

- Si për të spiunuar ndaj fqinjëve të tyre?! – shtoi Mauricio me habi.

- Po, po nuk e quanin kurrë ashtu. Ne thjesht po bënim detyrën tonë shoqërore në luftën e klasave, për mbrojtjen e kombit nga armiqtë e brendshëm dhe të jashtëm edhe llaka-llaka-llaka... – ia ktheu Dori. – Nuk e kuptoj pse partia vendosi që t'i lejonte televizorët në vend, - vazhdoi.

I ramë qytetit vërdallë me makinën e tyre dhe hëngrëm në një restorant të mirë italian me karaoke, ku Franko na qerasi për darkë. Kur vuri re që po hasja vështirësi me makaronat e gjata, ai filloi të tregonte me ngadalë. Duke mbajtur lugën me dorën e majtë tangent me pjtën, Franko nguli pirunin në nja dy fije në anë dhe i tërhoqi tek luga. Pastaj filloi të rrotullonte pirunin mbi lugë disa herë derisa asgjë nuk varej më prej tij dhe e futi në gojë. Uaa! Nuk e kisha idenë që ekzistonin rregulla të posaçme për të ngrënë makaronat. Mami gjithmonë i kishte thyer fijet e gjata në gjatësi kafshite para se t'i ziente.

Pas darke, ata na kthyen para se të mbyllej konvikti në njëmbëdhjetë, por na ftuan të shkonim me ta përsëri të nesërmen për darkë dhe ne pranuaam.

KAPITULLI XVII

NJË PUNË E RE

Ishte tashmë java e fundit e tetorit kur dëgjoja disa buçitje topi të ndjekura nga një breshëri automatiku jashtë dritares sime. Po kur u zgjova mëngjesin e asaj të enjteje, u çlirova të zbuloja që kishte qenë ëndërr. Pastaj u gëzova kur u kujtova çfarë më kishte thënë mami për kërcitjet e pushkëve në ëndërr. Do të thoshte se do të dëgjoja lajme të mira; sa më e zhurmshme kërcitja, aq më i mirë lajmi. Kisha shumë nevojë të dëgjoja lajme të mira pas disa ditësh të pafrytshme në kërkim pune.

Më vonë atë mbasdite, Adriani erdhi me disa lajme vërtet shumë të mira.

- Janë nja dy amerikanë që punojnë për projektin e pyjeve dhe kanë nevojë për dikë që të shtypë në kompjuter. Unë e di që ti je duke kërkuar punë dhe thashë që me këtë mund të fusje këmbët në derë derisa të dilte ndonjë gjë më e përhershme. Është vetëm disa ditë, por të paguajnë për fjalë, - tha Adriani kur e takova para godinës.

- Faleminderit! – iu përgjigja e kënaqur dhe mirënjohëse që nuk e rroku punën për vete. – Ku duhet të paraqitem?

Adriani më dha adresën e zyrave të tyre të përkohshme dhe unë shkova për t'i takuar që të nesërmen në mëngjes.

Skuadra dyshe amerikane kishte ngritur zyrë në një hotel të ri, të vogël, dykatësh. Ata më pritën me kënaqësi dhe më dhanë gjithë të dhënat që duhej të fusja në një listë në një dhomë më vete në katin e dytë.

- Meqë je duke përdorur *Excel* në vend të *Word*, ne mendojmë të të paguajme me orë. Bie dakord me tre dollarë orën? – pyeti Rikardi, udhëheqësi dhe më i vjetri nga të dy, duke më parë pothuajse me frikë mos nuk ishte e

mjaftueshme. *Amerikanët! Janë yll!* Nuk po u besoja veshëve. Doja të bërtisja “Aleluja!” dhe të hidhesha nga gëzimi, po buzëqesha dhe thjesht thashë: “Po, jam dakort”.

U zhyta gjithë kënaqësi në orë të gjata pune duke shtypur gjatë gjithë fundjavës së fundit të tetorit. Sapo u paraqita për punë të hënën, mëngjesin e *Halloween*-it, shefi më përshëndeti me një buzëqeshje dhe më caktoi ngarkesën e punës për atë ditë.

- Po të kerkoja në televizor mbrëmë, - tha, ndërsa po ngjitesha shkallëve për te vendi i punës sime. Ndalova e hutuar, me vetulla të mbledhura dhe kokën mënjanë. – Tek konkursi për “Miss Albania”, - vazhdoi duke shijuar hutimin tim.

- Oou! – i buzëqesha. – E bukur kjo!

Edhe pse thjesht një kompliment, ishte kënaqësi ta dëgjoja, sidomos pas muajve të gjatë pa flokë. Pothuajse besova që isha e bukur prapë.

- Falemnderit! – i thashë dhe vazhdova shkallëve duke qeshur nën vete me kujtimin e përpjekjeve të Omarit për të më mbushur medjen të merrja pjesë në konkursin e bukurisë të qytetit Studenti para konkursit të parë “Miss Albania” dy vjet të shkuara. Kur i numërova gjithë arsyet se pse propozimi i tij ishte qesharak, si gjinjtë e mi “atletikë”, flokët e shkurtër, etj..., ai më ndërpreu, - Ti do fitoje “Miss Bytha”.

Kur e pashë Omarin disa ditë më vonë, projekti amerikan i pyjeve kishte përfunduar.

- Ku ke qenë ti? Ke humbur një festë fantastike, - tha Omari.

- Kisha punë. Jam e sigurt që do të kemi festa të tjera, por më duhej të mbaja punën jetëshkurtër për sa kohë e pata, - i thashë dhe, për herë të parë, nuk më erdhi aspak keq që kisha munguar në një festë. – Pastaj, nuk pata as kohë të gjeja një komplet të përshtatshëm, - vazhdova.

- E, mirë. Sa për amerikanët dhe festat e tyre, ke të drejtë. Bëjnë festë çdo të premte mbrëma duke filluar te ambasada amerikane. Të gjithë amerikanët në vend mblidhen te ambasada në një bunker brenda oborrit nën tokë, të cilin e kanë shndërruar në pijetore. Takohen, përshëndeten dhe pinë nga një birrë para se të dalin me makina për darkë nëpër restorante dhe për të kërcyer nëpër disko më pas. Nganjëherë, organizojnë vrapime ose ngjitje nga bregu ose nga malet të shtunave.

- Pse s’thua ti?! Bëkan qejf të madh! – iu përgjigja.

- Mund të vish edhe ti kur të duash, - tha Omari.

- Unë?! Brenda ambasadës amerikane? Uaa!

- Se mos do futesh te zyrat. Bunkeri është më vete nga zyrat, po pse jo. Dalë unë garant për ty, - tha Omari dhe mua nuk më besohej ende. Hyrje në “kështjellën” amerikane! Nuk isha shmpirë akoma nga fakti që kisha fituar në gjashtë ditë paratë e një muaji të tërë, ose dy, po të mos i harxhoja nëpër festa dhe darka si ato që sugjeronte Omari.

- Uaa, rrofsh! Mbase edhe vij. Më duhet të gjej një punë tjetër që të paguaj për gjithë këto qejfe dhe darka që thua.

- Nuk i lë njeri të paguajnë vajzat, megjithëse mirë do ishte të gjeje një punë. Të dha shefi ndonjë letër rekomandimi? – pyeti Omari.

- Më dha. Më çuditi. Me sa mbaj mend, shkroi që iu duka shumë inteligjente, përshtatem me shpejtësi dhe shumë e këndshme në bashkëpunim. Si të duket? – përfundova mburrjen me një buzëqeshje.

- As që e vija në dyshim. Tani duhet të zbukurosh një çikë historikun e punës që të tregojë këtë përvojën e re.

- Ide e shkëlqyer! – iu përgjigja dhe ashtu bëra.

I kërkova Dorit të përdorja një nga kompjuterat e laboratorit të saj përsëri. Siç po ngjisja të njëjtat shkallët madhore që ishin transformuar nga shkallët e së ardhmes sime në ato të së shkuarës mu përpara syve, më kapi paniku për kohën që po më shkiste si vaji përmes gishtave; njerëzia po shkonin në punë përditë. “Po unë, çfarë po bëj me kohën time, o Zot? Më duhet edhe mua një punë, tek e cila të shkoj çdo mëngjes. Të lutem më ndihmo të gjej punën e duhur!” – u luta siç hyra në laboratorin e kompjuterave pa frymë nga vrapi në ngjitje të pesë kateve.

- Me vrap i bëre shkallët prapë, mi? – pyeti Dori duke buzëqeshur me hapësirën e lezetshme midis dy dhëmbëve të parë.

- Ti më njeh mirë tani. Më pëlqen vrapi, sidomos kur kam një destinacion.

- Ja ku e ke, - tha Dori dhe më tregoi kompjuterin që mund të përdorja.

- Kjo është edhe më e vështirë se sa e para. Dua të shtoj atë pak përvojë që pata nga puna e fundit me kompjutera dhe amerikanë, por ishte vetëm për disa ditë. Si ta them që të ketë ndonjë lloj efekti?

- Je me fat, se duket që ta paska zgjidhur shefi këtë.

- Për se e ke fjalën? – pyeta dhe ia mora Dorit nga duart letrën e rekomandimit dhe fillova ta lexoja sërish. – Je gjeniale, e dashur! – u shpreha, siç lexova fjalinë e parë të letrës së tij: “Gjatë muajit të tetorit dhe në nëntor...” – Mos duhet të më vrasë ndërgjegja për këtë?

- S’ke pse. Ti punove vërtet gjatë tetorit dhe nëntorit. Mbaroje dhe gjej

një punë të mirë! – urdhëroi Dori me autoritet dhe unë e mora me gëzim, siç vazhdova duke shtypur e shpresuar që asnjë nga punësuesit e ardhshëm nuk do të më pyeste me hollësi për kohën në këtë punë. Dëshpërimi dhe urgjenca që ndjeva për t'u lutur në ngjitje të shkallëve për këtu po shndërrohej tashmë në parandjenjë kaq të vërtetë saqë pothuajse mund ta shiyoja.

Vendosa ta përdor këtë inerci për të mbajtur fjalën që i kisha dhënë vetes dhe Timos. Si përfundim, mora guximin dhe shkova të pyesja profesorin për ndonjë vend të mundshëm në zanat.

Ishte akoma e vështirë ta takoja edhe tani që nuk ishte më profesori im, por, siç kishte thënë Timo, nuk kisha çfarë humbisja përveçse një çikë krenari. Kisha lexuar së fundi në Bibël që krenaria vjen para rrëzimit dhe më bënte mirë ta humbisja të tërën. Edhe pse profesori ndoshta nuk më mbante ndonjë mëri, kishte të drejtën ta ruante vendin e punës për një inxhinier me mesatare shumë më të mirë se timen. Kështu që e besova kur më tha se nuk kishte ndonjë vend të hapur për mua në atë kohë, por sugjeroi që të kërkoja te një nga qendrat periferike në qytet. Ndoqa sugjerimin e tij dhe shkova te qendra periferike, ku takova Latin, një nga shokët e klasës.

Lati kishte qenë djali i parë që kisha vënë re në një leksion me mbi dyqind e ca studentë të elektrikes dhe elektronikës së vitit të parë. Ishte një nga më të gjatët, me trup të gdhundur, gjithmonë i veshur mirë e i krehur me kujdes dhe gjithmonë i sjellshëm.

- Mirela! – më përshëndeti me dhëmbët e tij rruazë, të bardhë e të përkryer. – Ç'bën këtu ti?

- Më dërgoi shefi. Më tha që është hapur një vend rishtaz. Këtu po punon ti?

- Po. Prit të të gjej drejtorin, - tha Lati dhe shkoi ta kërkonte.

- Falemnderit! – thashë nga mbrapa, e prekur nga gatishmëria e tij për të lënë çdo gjë që të më ndihmonte mua. Disa minuta më vonë Lati u shfaq me drejtorin, një burrë i moshuar, i shkurtër, tullac, që më priti mirë, ndoshta prej Latit dhe emrit të shefit. Drejtori tha se kishte vërtet një vend të hapur, por i duhej të mendohej për ca kohë dhe më kërkoi të shkoja prapë pas një jave. Mua m'u duk sikur tha: "Po e ruaj vendin për një mashkull ose dikë me ca përvojë më tepër" dhe e dija që nuk mund të më ngrihej mendja.

Siç po kthehesha në bulevardin kryesor drejt Universitetit, duke menduar sa pak shanse kisha, takova Ilirin që ishte pushim ato ditë.

- Paskë zbritur nga mali prapë! Si je? – e përshëndeta.

- Si derr nga mërzia, po ti?

- Ohoo! Je bërë pishman që je kthyer nga Zvicra?

- Jo! Aspak! Më mirë inxhinier i mërzitur këtu se sa të mbush qeset me ushqime në Zvicër. Ç’ë ke atë? – pyeti Iliri duke treguar me kokë nga fleta e palosur e historikut të punës sime.

- Thjesht historiku im i ri i punës. Ndjem një çikë më me shpresë tani që kam ca përvojë të vërtetë pune në të.

- Në fakt, unë po shpresoja të të shihja sot. Lexova një lajmërim pune në gazetën e së dielës së shkuar dhe mendova se mund të të interesonte. Ke dëgjuar për fondacionin Soros?

- Pak. Mos është ai që po ndërton shkolla në zonat e pazhvilluara? – iu përgjigja duke parë me kureshtje gazetën që më dha Iliri.

- Ata janë dhe po marrin në punë shumë inxhinierë ndërtimi, recepsionistë që dinë anglisht, sekretare, përkthyes, etj. Mbye gazetën, po deshe.

- Falemnderit, Ilir! Je yll fare! – i thashë, siç fillova të lexoja lajmërimin. Pastaj mbajta mend lutjen e vetëm nja dy orëve më parë dhe nuk mund të mos i buzëqeshja Zotit tim: “Sa shpejt!”.

- Më qeras për drekë kur të marrësh rrogën e parë, - tha ai duke buzëqeshur me sytë e përkryer ngjyrë blu të thellë. – Kam dëgjuar që paguajnë mirë.

- Patjetër! – miratova. – E dija që më pëlqeje më tepër se sa për sytë e tu të bukur, - i thashë dhe buzëqesha. Tani më tepër se kurrë m’u duk se e meritonte nofkën “Alen Delon” që i kishim ngjitur gjatë viteve të shkollës prej ngjashmërisë së tij me aktorin francez të filmave “Zorro” dhe “Tulipani i zi”.

- Ç’ë do që nuk i dukeshin ashtu asaj që më duhej, - tha Iliri dhe mua m’u kujtua mahnitja dhe përpjekjet e tij për të bindur shoqen time të dhomës, Inën, para dhe gjatë demonstratave studentore.

- E di. Me sa duket është me të ngjitur. Duhet dy, pa të bëhet, - thashë dhe mbeta pa fjalë. *Ja ku jemi, pothuajse katër vjet më pas dhe Iliri ende është duke menduar për atë që i shkau nga duart. Pak a shumë si unë.*

- Mezi po pres të vete ta dorëzosh këtë te Sorosi, - i thashë, në përpjekje për të ndërruar një temë që, me sa dukej, ishte akoma e dhimbshme. – Nuk më besohet që e shpallën në gazetë për ta parë dhe kërkuar të gjithë. Pa miqësira, pa të njohura apo të futura nga brenda, - i thashë duke imagjinuar mijëra hallexhinj të tjerë duke vërsuar për te puna ndërsa unë rrija këtu akoma.

- Shko, shko! Shihemi vërdallë.

- Oboboo! Thotë që duhet t’u jap një numër telefoni për të më kontaktuar. Qysh do bëj?

- Me këtë nuk të ndihmoj dot. Po vë bast që Bledi ka telefon në shtëpi dhe më duket se sapo e pashë të futej brenda. E di që edhe ai jep mësim tek

fakulteti, kështu që mund ta pyesësh përditë për të parë nëse të kanë marrë në telefon, – tha Iliri.

- Shkëlqyeshëm! Më mirë ta kap para se të më ikë për sot. Falemnderit edhe një herë! – thashë në të ikur.

- S'ka problem!

E gjeta Bledin në fakultet dhe i shpjegova situatën time. *Sa shokë të mrekullueshëm kam pasur gjithë jetën!* Bledi ma dha numrin e telefonit pa ngurrim për ta vënë në kërkesën e punës dhe më uroi mbarësi.

Rrugës për në konvikt, u ktheva nga fondacioni i Soros për të plotësuar një kërkesë pune si dhe për të lënë historikun tim të punës për njërin nga vendet që po reklamoni në gazetë. Fondacioni kishte marrë me qera një godinë të tërë dykatëshe në rrëzë të kodrës së qytetit Studenti. *Sa e përkryer do të ishte kaq afër konviktit tim, po ta merrja këtë punë, o Zot! Nuk do të më duhej as të zbrisja për në qytet, përveç mbrëmjeve. U po, ka plot nga këto për të vajtur. Sa kot dhe boshe më duken, duke ditur që Teo nuk është në asnjërën prej tyre!*

Megjithatë, u takova me Omarin, Eldën dhe të tjerët atë mbrëmje tek lokali i ri te parku anës bulevardit kryesor. Lokali, të cilin Omari e quante “lokali pa emër”, meqë nuk kishte emër akoma, ishte i mbushur me tym, zhurmë dhe të rinj e ca jo dhe aq të rinj. Honda e kuqe, sportive, e vogël e Davidit, makina më e bukur që kisha parë ndonjëherë, ishte parkuar para lokalit që ta admironin të gjithë. Omari kishte zënë nja dy tavolina në një cep. Gjeta një vend bosh ndërmjet Omarit dhe Fabiolës dhe porosita një birrë.

- Sa mirë bërë që erdhe prapë, - më përshëndeti ajo dhe më prezantoi me katër çuna të tjerë që ishin ulur te tavolina tjetër. – Këta kanë mbaruar për inxhinieri rrugësh, rrugeçer me një fjalë, - vazhdoi Fabiola pasi u ulëm. – Braçen e kemi një çikë delikat sonte. Luajti futboll kundër amerikanëve dhe e mundën. I ka parë hëna jashtë të huajt. I vajti e dashura në Zvicër për studime pas-universitare dhe nuk u kthye më. U martua me një tjetër dhe ndenji atje; ia këputi shpirtin Braçes, - paralajmëroi Fabiola.

- Ai duket edhe si goxha kallëp kështu! E pabesueshme, por ndodhka dhe e anasjellta!

Kisha ardhur te lokali me përtesë. Omari ishte i vetmi që njihja mirë prej kohësh dhe, tani që ai ishte i fejuar, nuk prisja shumë vëmendje as prej tij. U ula qetësisht duke pirë birrën dhe duke qeshur për njëfarë kohe me shakatë e reja të shokëve të Fabiolës, pastaj iu ktheva Omarit për ta pyetur për banjën.

- Ta marr unë çelësin; banja është përjashta nga mbrapa, - tha ai dhe më tërhoqi karrigen nga mbrapa siç u ngrita duke ulur fundin e ngushtë deri

në mes të kofshëve. Dëgjova disa të qeshura nën dhëmbë nga mbrapa dhe ktheva kokën menjëherë për të kapur Davidin me të dyja duart pas formës së vitheve të mia deri përgjatë kofshëve. E gudulisur nga komplimenti i tij, tunda kokën sërish dhe qesha, ndërsa ai mblodhi gishtat e tij para buzëve dhe i shpalosi pas një puthjeje – italisht për “e shijshme”.

Kur u ktheva dhe u ula pranë tij ende duke u ngërdheshur nga shenjat e tij të heshtura, u bë serioz dhe tha: “Kam dëgjuar që na je bërë fetare”. *Uaa! Davidi serioz! Ose po përpiqet të më afrohet duke folur për gjëra që më interesojnë!* S’kisha për të rënë në atë grackë.

- Më vjen mirë që e ke marrë vesh, - iu përgjigja.

- Të lumtë! – tha, për çudinë time të këndshme. Kujtoja se amerikanëve u pëlqente Perëndia dhe feja. – Vetëm mos lejo njeri të të shtyjë në gjëra që nuk do të bësh, - vazhdoi.

- Mos ki merak..., - ia prita pa e kuptuar plotësisht, por m’u kujtua mbledhja e lutjeve të së mërkurës së kaluar. Disa nga besimtarët u lutën përreth meje që të merrja dhuntinë e gjuhëve, madje edhe duke më cukur më kot për t’u dorëzuar dhe rënë. Po vrisja mendjen nëse Davidi e kishte fjalën për diçka të tillë, por nuk denjova t’i thosha për përvojën time të fundit. Lokali i zhurmshëm nuk ishte vend për muhabete fetare, sidomos për të gjetur diçka të përbashkët me apo inkurajim nga një aventurier si Davidi. Sepse kisha ndjenjën që duhej të rrija sa më larg tij me ç’të mundja.

Edhe pse do të kisha qenë më se e kënaqur në dhomë duke lexuar Biblën, më erdhi mirë që u bëra me Omarin këtu. Gjithë “komplimentat” e Davidit dhe vëmendja e papritur nga shokët e Fabiolës ishin një ngritje e vetëbesimit tim të plagosur. E papritura më e madhe për atë natë erdhi nga Omari.

- E vure re si t’i kishte ngulur sytë njëra nga vajzat e ulura përballë teje? – tha ai pasi ikëm të gjithë nga lokali për të kërcyer në disko.

- Jo, po tani që e përmende, e kapa duke më parë nja dy herë.

- Ishte e dashuruar pas atij libanezit të gjatë, me të cilin shoqëroheshia unë ca kohë. E mban mend si shkrihej pas teje kur punoje në disko?

- E mbaj mend: xhaketë meshini të zi, shumë i gjatë, me qeshje simpatike dhe sy shumë ngulitës. Veçanërisht mbaj mend që mendoja se sa më i lumtur dukej nga shumica e myslimanëve që njihja, por mbaj mend edhe që nuk doja të kisha të bëja fare me asnjë nga Lindja e Mesme, edhe sikur të mos kisha qenë e dashuruar vetë. Kjo nuk po ma vë fajin mua, apo jo?

- Jo. Ajo thjesht urren në përgjithësi ekzistencën e lozonjareve të natyrshme si ty.

- Unë as që nuk i dhashë të kuptonte ndonjë lloj interesi të birit të botës. As edhe një të qeshur shoqërore.

- E di, po asaj nuk i bëhet vonë.

- Ai po të ishte i dashuruar pas saj, nuk do të kishte sy për njeri tjetër. Dhe po të mos e donte ai, ekzistenca ime lozonjare asaj i bëri nder.

- Mos e vrit mendjen për atë. Kot që e hapa këtë muhabet. E rregullove dot historikun e punës ti? – pyeti Omari.

- Po dhe e dorëzova te fondacioni Soros. Ka ca vende të hapura të përkohshme. Më duhet të shkoj të pyes pas një jave edhe te një punë tjetër si inxhinierë. Megjithëse janë pothuajse Krishtlindjet. Amerikanët rrezik ikin nga qyteti për pushimet e Krishtlindjeve.

- Për s'mbari! Ikin për Krishtlindje, po nuk besoj se do i vënë kyçin fare, - më inkurajoi Omari.

- Amen! Te cila disko po shkojmë sonte?

- Është bërë një e re andej nga shkolla jote.

Mbërritëm te diskoja e re pranë fakultetit, ku nuk kisha qenë ndonjëherë më parë. U ula në njërin prej kolltuqeve duke parë gjithë ata që kërcenin me partnerët e tyre, ndërsa mua më mungonte tmerrësisht i imi. Befas, m'u kujtua pse i isha shmangur shumicës së ftesave të Omarit për mbledhje të këtij lloji.

Po mendohesha nëse Mira, shoqja ime e dhomës së re, kërcente mirë në muzikë rroku. Kishte përmendur një herë që të ishte balerinë nuk ishte e thënë që të zotëroje edhe sheshin e diskos, por ndoshta do t'i pëlqente me raste ndonjë shkëputje e vogël nga studimet. Miqësia jonë nuk ishte aq e hapur sa ajo që kisha shijuar me Edin, por ishte në rritje gjithsesi. Mira ishte si motra e vogël që nuk e pata kismet, për të cilën gatujaja me kënaqësi për sa kohë që ajo pastronte tavolinën dhe lante enët më pas.

Herën tjetër që shkova te lokali pa emër, pyeta Mirën nëse donte të më shoqëronte dhe ajo pranoi me dëshirë. Dukej se i pëlqeu shumë jo vetëm kërcimi në të njëjtën disko më pas, po edhe vëmendja nga shokët më të mëdhenj në moshë.

- Ku e gjete këtë? – pyeti Omari, ndërsa Mira kërcente e veshur me një kostum të kuq basme me lule të vockla, të zeza. Mëngët verëf të bluzës shkonin me pantallonat kaubojse.

- S'ka ç'të duhet ty! Ti je i fejuar, apo harrove? – i thashë duke mbuluar sytë e Omarit me dorë dhe duke i kthyer kokën nga e kundërta.

- Jam i fejuar, jo i vdekur! – ma priti duke kthyer kokën prapë te sheshi i vallëzimit.

- E kam në dhomë. E gjen dot nga është? – e pyeta në përgjigje.

- Berati? – e gjeti Omari menjëherë.

- Ëhë. Nuk i shpëtoj dot.

- E njeh Fabiola?

- Do ta marrim vesh kur të na vijë. S'e kam parë akoma, - ia prita dhe hodha një sy vërdallë. – Kujto qenin, bëj gati shkopin! Tani sa u fut brenda me ca nga çunat e gallatës së herës së kaluar.

- Nga bredh ti? – e pyeti Omari, kur na u afrua te kolltuku.

- Në punë. Ç'kemi?

- Po diskutonim nëse e njihje shoqen e re të dhomës së Mirelës, - pyeti Omari.

- E njoh, - tha Fabiola duke parë nga sheshi i vallëzimit. – Është e bij'e doktorit. Ti e solle këtu? – m'u kthye Fabiola.

- Po.

- Nuk është një çikë si e vogël ajo për këtë lloj ambienti? – pyeti Fabiola dhe unë u ndjeva fajtores, po e mbrojta vendimin tim gjithsesi.

- Diskua? Ajo është mu në lulen e rinisë për këtë. Ne jemi ato që duhet të jemi nëpër shtëpëra me burrë e me çiliminj për të pirë për gjumë. Pastaj, nuk ia ndajmë sytë.

- Të mos ia ndaj unë sytë? – tha Eduarti, më i vogli nga shokët e Fabiolës dhe vajti te sheshi i vallëzimit.

- Mua më vini në gjumë, - ngriti dorën Braçja si ndonjë çamarrok në klasë.

- E shikon? – tha Fabiola.

- Avash! Është gocë me mend ajo. Edhe Eduarti po duket goxha i përgjegjshëm, - ia prita, duke i parë të kërcenin bashkë.

Mbrëmja e këndshme përfundoi meqë neve, konviktorëve, na duhej të ktheheshim para se të na mbyllej dera për natën. Isha shumë e qetë që kisha sjellë Mirën me vete, sikur të kisha një dëshmitare për të vërtetuar se nuk po bëja ndonjë gabim në gjithë shoqërimet dhe mbrëmjet e mia. E kishte bërë pritjen gjatë javës pak më të durueshme.

U shtriva në krevat dhe hapa Biblën për të lexuar për disa minuta para se të flija. “Njeriu vjedh Perëndinë” – më kapi syri një titull shumë përpirës të një paragrafi nga kapitulli i tretë i Malakias dhe vazhdova të lexoj:

“Unë jam Zoti. Nuk ndryshoj; prandaj ju, o bij të Jakobit, nuk jeni konsumuar. Që në ditët e etërve tuaj ju jeni larguar nga statutet e mia dhe nuk i keni respektuar. Kthehuni tek unë dhe unë do të kthehem tek ju”, thotë Zoti i ushtrive. “Por ju thoni: “Si duhet të kthehemi?”. Një njeri do të

vjedhë Perëndinë? Megjithatë ju më vidhni dhe pastaj thoni: “Çfarë të kemi vjedhur?”. Të dhjetën dhe ofertat. Mallkimi ju ka qëlluar, sepse më vidhni; po, mbarë kombi. Sillni gjithë të dhjetat në shtëpinë e thesarit, që të ketë ushqim në shtëpinë time, dhe pastaj më vini në provë për këtë gjë”, thotë Zoti i ushtrive, “nëse unë nuk do t’i hap pragjet e qiellit dhe nuk do të derdh mbi ju aq shumë bekim sa nuk do të keni vend të mjaftueshëm ku ta shtini. Përveç kësaj, do të qortoj shumë për ju gllabëruesin, me qëllim që ai të mos shkatërrojë më frytin e tokës suaj dhe vreshti juaj nuk do të rreshtë të sjellë për ju fryt në fushë”, thotë Zoti i ushtrive.

Çfarë premtimi i mrekullueshëm! Sa kohë e përkryer që e lexoj një pjesë të tillë siç jam duke kërkuar punë. *Perëndia po më denjon ta vë në provë dhe atë do të bëj!* E mblodha mendjen që të jepja një të dhjetën e parave që kisha fituar nga puna e shkurtër më e fundit, por nuk më dilte nga mendja: “Po sikur të mos e kisha lexuar kurrë këtë? Çfarë thesare të tjera po humbisja duke mos e lexuar të gjithë Biblën rregullisht?”

Ishte tashmë e mërkura e fundit e dhjetorit dhe koha për të përballuar vendimin e drejtorit të stacionit periferik të telekomit. Siç e kisha imagjinuar gjithë javën, drejtori vendosi t’ia jepte vendin e punës një inxhinieri tjetër më me përvojë, që ishte pushuar nga një stacion tjetër për kunjë.

Po kthehesha nëpër bulevard e dekurajuar dhe e trishtuar prej lajmit, duke u përpjekur të kuptoja gjithçka po ndodhte. Isha ndjerë shumë e sigurt për këtë punë, pothuajse sikur e meritoja tani që kisha bërë tamam siç më kishte thënë Perëndia. E kisha vënë në provë dhe kisha dhënë të dhjetën. Por nuk kisha dyshuar akoma kur dëgjova Bledin të më thërriste nga disa metra përpara. Fshiva lotët shpejt e shpejt para se të ngrija kokën.

- Ku ke qenë ti? Nuk kam lënë vend pa të kërkuar dje dhe sot. Të morën në telefon ata të Sorosit.

Nuk po u besoja veshëve!

- Unë as kisha mbaruar së qari akoma. Sapo më refuzuan nga puna e telekomit.

- Hajde, mblidhe veten tani dhe, o burra, te kjo tjetra. Të vaftë mbarë! – uroi Bledi dhe vazhdoi rrugën.

- Falemnderit! – ia prita dhe fillova të falenderoja Perëndinë e të lutesha që të shkonte me mua gjithë rrugës deri te zyra e Sorosit. “Tani po, që ka kuptim. Ndoshta kjo do të jetë arsyeja që më refuzuan nga tjetra”, - mendova, siç ngjita shkallët për në katin e dytë, tek dhoma e pritjes. Disa çaste më vonë,

u hap dera e brendshme e zyrës dhe doli një amerikan i hollë nja pesëdhjetë e ca vjeç.

- Përshëndetje, - tha me një buzëqeshje të shtirur nën mustaqet e thinjura duke mbajtur derën hapur për mua. Ai hoqi udhën për te zyra e tij dhe unë e ndoqa e tmerruar nga pyetjet që mund të më bënte për punën e mëparshme.

- Ulu, të lutem, - filloi. – Mua më quajnë Robert. Jam drejtori i përkohshëm derisa të kthehet i përhershmi nga pushimet. Sa e vështirë ishte për t’u gjetur!

- Kërkoj të falur, - mërmërita. – Banoj akoma në konvikt këtu lart dhe atje nuk kam telefon. M’u desh të përdorja telefonin e një shoku nga qyteti poshtë dhe atij iu deshën nja dy ditë të më lajmëronte. Ju falemnderit për durimin!

Sa më tepër që flisja, aq më e guximshme bëhesha. I kujtova vetes magjepsjen time pas anglishtes që kur fillova ta mësoja në klasë të pestë. Ja ku po më jepej rasti për t’u shfaqur e shkëlqyer edhe një herë. Zëre se është shitësja e librarisë ca katërmëdhjetë vjet të shkuara, kur unë e dy nga shoqet e mia shkuam për të blerë “Një për të gjithë e të gjithë për një”. Ajo na dëgjoji tek lexuam titullin një nga një dhe vendosi që unë kisha theksin më të mirë.

- E shoh që paske punuar për projektin SARA? – pyeti drejtori duke parë letrat nëpër duar. Ndjeva afshin e nxehtë duke m’u ngjitur nga gusha.

- Po.

Tani duhej t’i mbaja të shkurtra dhe të përpikta të gjitha përgjigjet ndaj pyetjeve të tij lidhur me punën për skuadrën amerikane të mëparshme.

- Mirë, atëherë, mund të fillosh të premten tjetër, – tha z. Robert më në fund. *Falemnderit, Zot, që nuk pyeti me saktësi se sa kohë kisha punuar për ta. Prit, më duket se sapo më morën edhe në punë! Aleluja, Jezus!* – Eshhtë detyrë e përkohshme një mujore si sekretare e njësisë inxhinierike. Rroga është njëqindëdhjetë dollarë, - vazhdoi drejtori, siç u ngrit më këmbë dhe më shtrëngoi dorën për t’u ndarë.

- Falemnderit, zotëri! – iu përgjigja. *E përkohshme është pesë herë më gjatë se gjashtë ditë. E dija që mund të të besoja ty, o Zot!* Vrapova dhe falenderova Perëndinë gjithë rrugën përpjete për në konvikti, por faji i përvojës së punës së mëparshme po më rëndonte me çdo hap.

Të nesërmen herët në mëngjes, isha akoma e shtrirë në krevet e mbuluar nga mëdyshja për t’i thënë shefit të ri të vërtetën e plotë. Hodha sytë nga e majta dhe pashë Mirën, shoqen e dhomës, tashmë duke studiuar për provimin e saj të ardhshëm. “Sa e lumtur jam që u kam dhënë fund atyre!” – mendova dhe nxora Biblën e xhepit nga poshtë jastëkut për leximin e mëngjesit. Do të

lexoja Biblën shumë më tepër sesa shkencën e elektroneve të librave të Mirës që as nuk shihen as nuk preken. Dëgjova një trokitje të ndrojtur në derë dhe u ngrita ta hapja.

- Përsëndetje! Mua më quajnë Stefaní.

Një zonjushe e gjatë amerikane me flokë të gjatë e të verdhë dhe njolla të kuqe në faqet buçko po qëndronte te dera e dhomës sime.

- Njatjeta, - i ktheva përsëndetjen dhe i bëra shenjë të futej brenda shpejt. Shumica e xhamave në dritaret e banjave ishin të thyera, gjë që krijonte rryma shumë të ftohta nëpër korridore. E mbylla derën menjëherë sa u fut dhe vrapova për në shtratin tim.

- Flisni anglisht? – pyeti me sy të qeshur, siç u ul nga këmbët te krevati i Mirës, ndërsa unë rrëshqita drejt e nën mbulesat e mia të ngrohta.

- Flasim, - ia prita unë.

- Bibla është ajo që po lexon?

- Po, - ia ktheva unë me kënaqësi.

- Ma merr mendja që ju jeni besimtare në Zotin, atëherë.

- Po, - iu përgjigja e qeshur, - të dyja.

- Nuk po ju marr më kohë, atëherë, - buzëqeshi dhe u ngrit të ikte. – Po ju lë nja dy fletushka, po të keni ndonjë pyetje.

- Kam unë një pyetje, nëse nuk të vjen keq, - i thashë duke i bërë shenjë të ulej edhe ca më gjatë.

- Patjetër, - u ul ajo dhe unë fillova t'i tregoj për mëdyshtjen time të fundit.

Ajo e dëgjoi me durim të gjithë tregimin tim për ekzagjerimin e kohës që kisha punuar në të vërtetë para se të merresha në punë për emërimin e fundit dhe tha: “Unë mendoj që të shkosh e t'i thuash të vërtetën shefit të ri”.

- Po mua më vjen shumë rëndë t'i pranoj historinë e zbukuruar të punës dhe kam frikë se humbas punën po t'i them, - iu përgjigja e pakënaqur me përgjigjen e saj, kështu që vendosa të pyes Perëndinë.

Sapo misionarja e re amerikane u largua, iu luta Perëndisë për falje dhe mëshirë dhe pastaj hapa Biblën mu tek tregimi i gruas së kapur në mëkat. Kur lexova fjalët e Jezusit ndaj gruas: “Shko dhe mos mëkato më!”, mbylla sytë, u shtriva në shtrat dhe thashë me zë: “Të dua, Jezus! Falemnderit për mëshirën tënde! Nuk do të gënjej më kurrë!” Ndjeva paqe dhe të njëjtin gëzim që më kapte sa herë që Perëndia vetë më fliste për nevojën time specifike. *Sa pranë, sa i gjendur dhe i përpiktë është sa herë që më duhet!*

- Çfarë të tha? – pyeti Mira me sytë e saj të zinj e me xixa si dy yje me bisht. Gëzimi im në Zotin ishte ngjitës.

- Shko dhe mos mëkato më! E kupton? “Më” do të thotë kështu e tutje, si në të ardhmen.

- Aleluja! – gëzoi edhe Mira me mua.

- Tani mund të filloj të ngarkoj teshat e palara për t’i çuar në shtëpi. Ky vit ka për të qenë një vit i mbarë. Qoftë një vit i ri i lumtur edhe për ty! – i urova Mirës dhe fillova të paketoja.

Gjithë udhëtimi për në shtëpi kaloi shpejt. Mami dhe babi ishin po aq të lumtur për lajmin e gëzueshëm.

- Ah, moj ma, më vjen ta festoj me të madhe këtë vit. Ku do gjejmë një pishë të vogël për ta zbukuruar? – pyeta mamin. Vetëm disa ditë kisha kaluar në shtëpinë e re në lagjen e re.

- Është një pishë e madhe në anë të rrugës. Presim një degë nga ajo dhe e zbukurojmë.

- Mirë, hajde, - thashë me gëzim dhe u hodha në vend duke kërkuar një sharrë a hanxhar.

Vajtëm te pisha e madhe të dyja, mami me krahun pas belit tim, vërtet e lumtur që isha kthyer në shtëpi. U ngjita aq lart sa më duhej, preva një degë dhe e lëshova të binte. Pastaj zbrita me kujdes, mora degën dhe u ktheva në shtëpi. E ngrita degën në cepin verilindor të korridorit, vendi më i dukshëm nga hyrja, dhe fillova ta zbukuroja me pambuk të shkrifur dhe zinxhira letrash me ngjyra.

Herën e fundit që kisha qenë pranë një peme të vitit të ri, siç e quanin komunistët, kisha qenë në klasë të katërt. Disa nga nxënësit më të dalluar nga çdo shkollë fillore në qytet ishin ftuar tek festa e vitit të ri në shtëpinë e pionerëve, një qendër veprimtarish për fëmijët e qytetit. Secilit fëmijë iu dha nga një lodër para se të shikonin një koncert. Ceremonia mbaroi me “babagyshin” e vitit të ri, që ishte në të vërtetë një fëmijë i bukur i veshur me kostum e kapuç të kuq, duke ardhur nga mbrapa skenës e duke buzëqeshur e përshëndetur të gjithë me dorë si edhe babagyshi i vitit të vjetër, që i lëshoi vendin dhe përshëndeti lamtumirë në dalje.

Mami filloi të tëhollonte petët për bakllavanë, një ndërmarrje më vete e një dite të tërë edhe me ndihmën time, ndërsa babi dhe vëllai çanin arrat. Sa mirë që isha në shtëpi për festë! Sa më pëlqente era e bakllavasë së pjekur!

Mbasditen e natës së vitit të ri, mami mori thikën dhe bëri për nga dera.

- Ça do bësh me të?

- Do t’i pres kokën darkës, - ma priti me të qeshur.

- Prit! Dua ta bëj unë këtë radhë, - i thashë, paksa e pasigurt por e vendosur, gjithsesi. *Ky është kurban për ty, o Zot!*

- Me gjithë mend e ke? – pyeti mami, ndërsa po bllokonte në një cep pulën më të madhe në oborr.

- Po. Dua të më quhet si kurban për Perëndinë, një “Falemnderit, Zot!” për punën e re.

- Amin! – miratoi mami dhe më dha pulën e sapokapur. – Mos hezito dhe mos e lësho pasi t’i kesh prerë kokën. Do të vazhdojë të hidhet e të përplasë pendët për disa sekonda derisa të ngordhë, duke spërkatur gjak gjithandej, në gjithçka ke veshur.

- E kam parë.

E shtriva pulën në tokë, ia vura krahët e palosura nën këmbën e majtë dhe këmbët nën të djathtën time. Ia tërhoqa lehtë kokën mbrapa me dorën e majtë dhe e thera në grykë me shpejtësi me thikën e mprehtë.

- Na marrtë të ligat e shtëpisë! – tha mami, sikur të më kujtonte mua, por më tepër veten, pse nuk duhej t’i vinte keq. *Duhet të jetë e vështirë t’i rrisësh që kur dalin nga veza dhe pastaj t’u presësh fytin disa muaj më vonë.*

- Amen! – i përgjigja e çliruar që mori fund shpejt. Mami e mori pulën dhe e futi në një tenxhere me ujë të përvëluar. Pastaj, sapo t’ia duronin duart, e nxori pulën nga tenxherja dhe filloi t’i shkulte gjithë pendët e nxehta e të njoma dhe të pastronte të përbrendshmet gati për ta pjekur.

- Do ta pjekësh edhe kokën këtë radhë? – e pyeta dhe fillova të qeshja.

- Jo. Me kaposhin e detit, do të kemi plot, - qeshi edhe ajo dhe unë e dija që e mbajti mend.

- Jo se do t’ia haja kokën. Nuk kam ngrënë më asnjë që herën e fundit që poqe një kile të tërë dhe unë hëngra më shumë seç mund të mbaja.

- Kohë të vështira! – psherëtiu mami. – Vajti ora për të zënë brumin e kulaçit, - shtoi dhe nxori miellin nga dollapi.

- Do të fshehësh një monedhë këtë radhë? Nuk jemi më kalamaj, o ma.

- Ia lëmë Xhulios ta gjejë këtë radhë, - tha mami për nipçen tonë nëntëmuajsh.

- Sa i zgjuar që është! – i thashë. – Po mbahej mbas divanit pranë meje dhe filloi të ngatërrohej me kasetat e mia kur i thashë: “Po ik, o Xhulio, ik tani!”. Qysh filloi të qante ai dhe iku vërtet këmbadoras. Nuk më besohej që do ta kuptonte qortimin aq i vogël. Sa keq më erdhi dhe e mora për qafe menjëherë.

- Është shumë i zgjuar, vërtet, - miratoi mami.

Ishte më në fund koha për darkën. Gjithçka ishte mbi tavolinë dhe gjithkush ulur gati për të ngrënë kur babi pyeti për verën dhe mami iu përgjigj aty për

aty: “Një shishe për Lelën dhe tjetra për ne të tjerët”, pas së cilës im vëlla nuk e përmbajti dot bezdisjen.

– Po pse, moj ma? Pse do pika ajo një shishe të tërë vetëm, ndërsa ne të katërt një shishe?

- Nuk ka nevojë për debat, - u hodha menjëherë. – Mua as që më pëlqen vera. Gjysëm gote sa për të bërë gëzuar boll e kam.

- Nuk është puna aty, - u përgjigj Xhimi. – Është tek dallimi i hapur me të cilin na trajton ne të tjerëve sa herë që je ti këtu.

- Po e kam larg, prandaj, - u justifikua mami. – Mezi e shoh një herë në kaq kohë. Ju hani e pini çfarë të doni këtu në shtëpi.

- Eeeh, - ia priti vëllai. – Më mirë pranoje që e do më shumë se ne dhe ta dimë.

- Më sa dallohen gishtat e dorës. Pa hë priti, pa; ta shoq cili të dhemb më shumë? – ia priti mami.

- E de mirë, boll tani, - ndërhyri babi. – Nuk di si ta presë sa më mirë. Hajde, gëzuar dhe kështu u mbledhshim ngahera! . . . Dhe kjo i dha fund debatit.

Nuk lashë program televiziv pa parë deri në orët e mëngjesit. Më ishte mbushur mendja që dita e parë e vitit të ri duhej të më gjente zgjuar e të gëzuar që i gjithë viti të kalonte po ashtu.

KAPITULLI XVIII

NJË VIT I RI

U ktheva në Tiranë më pesë janar të njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetepesës, e gëzuar për të shkuar në punën e re të premtën. Por, me t'u zgjuar në mëngjes, u tmerrova kur mbajta mend ëndrrën që sapo kisha parë për humbjen e punës. Në çdo ditë tjetër para shpëtimit në Krishtin, do ta kisha humbur toruan, por tani e dija si ta sillja gjithçka te këmbët e kryqit në lutje: “Perëndi, unë e di që puna ime është dhuratë nga ty dhe nuk ka gënjeshtar në botë, të këtejme apo të përtejme, që do të mund të më bindte për të kundërtën. Nëse armiku përdori edhe shkrimet për të tunduar Jezusin, e di që mund të përdorë një ëndërr për të më shkundur besimin tek ty. Të dërmoj ty, djall, dhe gënjeshtarit e tua, në emër të Jezu Krishtit. Amen!”

Hapa Biblën me duart të dridhura për racionin tim të mëngjesit të Fjalës së Perëndisë. Bibla u hap te psalmi i parë për herë të parë: “Lum njeriu që nuk ecën sipas këshillës së të pabesëve, që nuk ndalet në rrugën e mëkatarëve dhe nuk ulet bashkë me tallësit, por që gjen kënaqësi në ligjin e Perëndisë dhe që mendon thellë ditë e natë mbi ligjin e tij”. “Tamam si unë, o Zot!” – mendova duke qeshur dhe vazhdova leximin. “Ai do të jetë si një pemë e mbjellë gjatë brigjeve të ujit, që jep fryt në stinën e tij dhe të cilit gjethet nuk i fishken dhe gjithçka bën do të ketë mbarësi”.

Mbaje me shëndet, gënjeshtar! E more vesh? Çdo gjë që bëj do të jetë e bekuar!

Vetëm aq më duhej për atë ditë. Tani kisha premtimin e Perëndisë që do të bekonte çdo gjë që bëja. *Falemnderit, o Zot, që më siguron sërish!*

Kur u paraqita për punë po atë mëngjes, po ndjehesha fitimtare dhe e gëzuar deri në çastin që më pyeti shefi: “Ku ke qenë gjithë javën?”

Ndjeva dobësimin e gjunjëve dhe zbehjen e fytyrës, por mbajta mend me shpejtësi premtimin e atij mëngjesi nga Perëndia dhe e mbërtheva sikur të varesha me një dorë nga taraca e një pallati pesëkatësh.

- Në shtëpi për festat, - iu përgjigja me zë të mekur. – Nuk më the të kthehesha të premtën tjetër?

- Të thashë. Të mërkurën. Kështu që e premtja tjetër do të kishte qenë pas dy ditësh, apo jo?

- Më vjen shumë keq! Të kam keqkuptuar krejtësisht. Mendova...

- S'ka gjë, - ma fali, buzëqeshi dhe m'u bë sikur u ngjita sërish mbi taracë. Mora frymë e lehtësuar. *Falemnderit, Zot! Unë e di që ti i mban premtimet. Përpyekje me meritë, djall gënjeshtari, po vër majat nga ke thembrat këtë radhë!*

Shefi më dha nja dy faqe me tekst shqip për t'u përkthyer në anglisht, të cilën e redaktoi më pas. Shumica e ditës së parë të punës kaloi duke ndjekur një vajzë tjetër nga njësia e financës që po më tregonte përdorimin e telefonit.

Telefonat! Tani kam një telefon mu në tavolinën time gjithë ditën e ditës që të më marrë kush të dojë. Më dukej sikur Teo ishte mu në anën tjetër të kësaj kutie, vetëm dy zile më tutje. “Kaq afër, pavarësisht sa larg ...”

Mos! Tani do më ngelet kjo dreq kënge në kokë gjithë ditën! Sa më gjatë i ngulja sytë telefonit, aq më tepër mall ndjeja, duke uruar gjithë kohës që ta dinte numrin si me magji dhe të më merrte në telefon. Thirrjet personale ndërkombëtare nuk lejoheshin, por mund të bëja sa thirrje lokale të doja. Fillova me Fabiolën. I dhashë lajmin e mrekullueshëm për punën time të re dhe numrin e telefonit.

- Ameeeeen! – u gëzua. – Urime! Ku është zyra?

- Është pranë konvikteve, por po dëgjoj që do të vendosemi poshtë nga qyteti, përballë ambasadës amerikane në një vilë katërkatëshe, ku kati i parë do të jetë kuzhina dhe mensa e punonjësve.

- Mrekulli! Lavdi Perëndisë!

- Amen! Të lumtë goja!

- Një grup nga të zakonshmit do mblidhen te Davidi sonte. Po organizon një mbrëmje pokeri për disa shokë të ngushtë. Do të vish?

Uuuuuu! Qenkam me “të ngushtët” unë tani?!

- Me gjithë qejf. Do t'i them shoferit ... të besohet që edhe na çojnë nëpër shtëpira me makinë një nga një? Do t'i them të më zdrypë andej nga puna jote dhe vemi bashkë atje.

- Për s'mbari! Mirë, atëherë! – u përgjigj Fabiola dhe mbylli telefonin.

E takova Fabiolën para punës së saj më vonë atë mbasdite dhe të dyja u nisëm për nga shtëpia e Davidit. Tani që punoja edhe vetë, ndjehesha shumë më e lirshme për të shkuar mbrëmjeve me të punësuar të tjerë. Ky ishte një grup shumë më i vogël nga mbrëmja e fundit: shumica burra amerikanë dhe disa vajza shqiptare. E kisha akoma të vështirë të mësohesha me faktin që isha e denjë për të qenë këtu, duke folur gjithë anglishten që kisha ëndërruar midis ndoshta ca prej amerikanëve më të arrirë e duke cimbidhur byreçkat më të shijshme e më të lezetshme. *Rrofsh, o ba, që këmbëngule të rrija në shkollën ku jepej anglishtja dhe jo rusishtja si gjuhë e huaj!*

Disa nga burrat, me gjithë Davidin, po pinin puro dhe luanin poker rreth tavolinës, ndërsa Elda, Omari, Fabiola, unë dhe një dy amerikanë që nuk i kisha parë ndonjëherë më parë, po llafoseshim e kërcenim në korridorin e pamobiluar të mbushur me muzikë.

- Mos merresh gjë me ndërtim trupi? – pyeti Fabiola një nga amerikanët muskulozë.

- Jo, por merrem goxha me fizkulturë, - iu përgjigj ai me buzëqeshje. – Përshëndetje, një herë. Mua më quajnë Skot, - vazhdoi ai, duke u prezantuar.

- Përshëndetje! Fabiola, - ia ktheu ajo. – Shkon rregullisht në palestër atje në Amerikë?

- Shkoj, po ka plot ushtrime që mund t'i bësh thjesht duke përdorur peshën tënde, - tha Skoti dhe filloi t'i tregonte Fabiolës ushtrime hapash të mëdha përpara, ndërsa i kërcenin prej nën të xhinseve muskujt masivë të kofshëve. Tashmë, shumica jonë në korridor filluam të provonim hapat e shtrira dhe pompat.

- Kjo mbrëmja qenka gallatë e madhe, por po na vete vonë, Fabiola. Më duhet të vras mendjen për t'u kthyer. Këtu do flesh sonte ti?

- Jo. Jam për rrugë për Berat nesër që në mëngjes.

- Lum ti! – thashë me zili.

- Do të vish? – pyeti Fabiola.

Çfarë marrëzie e mrekullueshme!

- E rregullova me shoferin e Skotit për vajtje-ardhje. Na çon edhe në konvikt sonte, - vazhdoi.

- Si e bëre?

- Çfarë bëra? Skotit nuk i bëhet vonë.

- Më quajnë sytë të vij në Berat edhe një herë. Ka kohë.

- Ke qenë më parë?

- Ëhë! – i thashë dhe u skuqa nga kujtimet. – Ça gallate do ishte sikur të gjenim një mënyrë apo sebeb për të vajtur te shtëpia e Teos.

- Nuk më duhet, - ma priti Fabiola. – Unë jam shoqe nga shkoll'e mesme. Mund të shkoj si rastësisht të pyes për të sa herë të dua.

- Vërtet?! Nuk e ke problem? Po sikur mos të të mbajë mend e ëma?

- Atëherë do t'ia kujtoj unë.

- Amaaaaan! Ça ylli që je! Ku do takohemi nesër?

- Të ngelet qejfi ty të vij të fle te dhoma jote sonte?

- Asfare! Kemi një krevat të tepërt në dhomë dhe Mira është me sezon në shtëpi.

- Pastaj shoferi i Skotit na merr të dyjave në mëngjes. Pasi të shkojmë te mamaja e Teos, ti kthehu prapë në Tiranë me shoferin.

- Plan fantastik dhe i frikshëm, - qesha si me guduli.

- I frikshëm?

- Eee, meqë e ëma është arsyeya kryesore që jemi akoma të ndarë. Ajo ndoshta më urren, - thashë, po thellë në vetvete ndjeva paqe, siç kujtova vargun e Biblës për njeriun që lë nënën e babanë.

- Ajo as nuk të njeh ty.

- Pikërisht! Kështu që nesër, të paktën, do të ketë një fytyrë që të shkojë me çfarëdo që mendon për mua.

- Prit të vete t'ia them Skotit “komplotin” tonë të udhëtimit sa për ta ditur që po vjen edhe ti.

- Mirë, - pranova.

- Në rregull, - dëgjova Skotin të thoshte që përtej korridorit.

Shoferi i tij na solli në konvikt dhe Fabiola kaloi natën në dhomën time. Kurse mua nuk më zinte gjumi nga ngazëllimi. Mbase mund t'i hidhja edhe një sy shkarazi shtëpisë që nga dera e hyrjes për të freskuar kujtimet në zbehje.

Kur mbërritëm në dhomë, unë e Fabiola u ulëm në karrige përreth furnellës elektrike – një platformë qeramike me ulluqe në formë u-je, ku kalonte rezistenca e zbuluar.

- E di e ëma e tij që ju të dy ishit të dashurur apo vetëm që ishit shokë shkolle? – pyeta Fabiolën, ndërsa ngrohja duart mbi furnellë.

- Nuk jam dhe aq e sigurt që ishte dashuri; dashuriçkë, ndoshta. U përkëdhelëm disa herë, po ziheshim shumicën e kohës.

- Ziheshe me Teon?! – pyeta me habi duke e patur të vështirë ta përfytyroja. – Ne nuk arrinim dot as të llafoseshim, jo më të ziheshim. Ndoshta ngaqë nuk patëm shumë kohë.

- Ju ishit të zënë me gjëra të tjera, - buzëqeshi Fabiola dhe më shkeli syrin.

- Kurse ju nuk? – kapa momentin për të përgjuar.

- U zhveshëm një herë lakuriq, - qeshi nën hundë, - po nuk bëmë gjë.

Domethënë edhe Teo ndoshta ishte i virgjër. Gjithë ajo bujë që më donte më shumë se të dashurat e tjera që kishte pasur para meje!

Mëngjesi i së nesërme më gjeti në mëdyshje për llojin e veshjes në të cilën doja të më shikonte mamaja e Teos. Doja të vishja xhinset e zbardhura me shtrat të shkurtër dhe funde të gjera, por më duhej të dukesh një çikë më e mbledhur. I vura mënjanë dhe vendosa të vishja pantallonat e gjera ngjyrë qumështi me llastik në brez që më kishte qepur një komshie në Fier.

- Nuk më besohet që palët më të thjeshta të pantallonave që kam tani janë ato për të cilat më bëri për të qarë im vëlla se nuk i miratonte.

- Pse? – pyeti Fabiola duke parë pantallonat për të gjetur arsyen.

- Kur i pa në fillim, unë kisha veshur edhe jelekun. Thjesht më pa, më tha të rrotullohesha dhe prapë nuk shprehej dot pse nuk i pëlqenin. Më në fund, vendosi që ishin shumë amerikane prej gjithë të bardhës. Nuk ishin as të ngushta.

- Kur dëgjoj gjëra të tilla, ndjehem me fat që nuk kam vëllezër. Ku është jeleku?

- Vrimat e krahëve do të ishin shumë të ngushta mbi këtë bluzë.

- Të shkojnë pantallonat me bluzën bojë ulliri.

Dolëm nga konvikti për tek makina e bardhë e markës “Land Rover” që po na priste para godinës. Unë iu drejtova derës së prapme dhe u befasova të shihja Skotin që, po ashtu, ishte ulur mbrapa dhe sugjeroi që Fabiola të ulej përpara. “Ndoshta gjithmonë mbrapa ulet kur e nget shoferi. Në fund të fundit, kështu bëjnë edhe njerëzia nëpër taksitë e filmave amerikanë!” – arsyetova, por sepse nuk mjaftoi për të ma mbushur mendjen plotësisht. Ndoshta ngaqë nuk dukej rehat duke u ulur pjerrtaz, që të mos i nguleshin gjunjët te mbështetësja e përparme e ndenjësës ku ishte ulur Fabiola.

Sapo kishim filluar udhëtimin për Berat, kur Skoti m’u kthye dhe tha, pothuajse duke pëshpëritur: “Njoh dikë që duket si shalët e tua”.

- Ëë, edhe mund të ketë një rrez të tjerë shalët e të cilëve ngjajnë me të miat?! – iu përgjigja pak e hutuar.

- Jo, Mirela, - ndërhyri Fabiola në shqip. – Të tha që ky njih njërin të cilit i pëlqejnë shalët e tua.

- Ooou! – iu përgjigja, tani edhe më e ngatërruar dhe disi e turpëruar. – Çfarë? Pse? Shalët e mia prej kali?

- Pse thua ashtu? – pyeti Skoti tashmë edhe ai paksa i turpëruar që Fabiola dhe shoferi e kishin dëgjuar komentin e tij.

- Ashtu m’i përshkruan shokët e fakultetit në fillim, kur analizuan gjithë gocat e klasës. Mendova se ishte ngaqë janë të holla e të gjata. Mund t’i kenë vënë re gjatë një loje futbollit që po luanin çunat gjatë stërvitjes ushtarake në vit të parë. Desha të luaja dhe unë me ta dhe ata më vunë të ruaja portën, por dikush nga skuadra kundërshtarë e shkelmoi topin e vogël prej llastiku mu përmes shalëve të mia, mbi gjunj e shënoi gol, - e kujtova me mall.

- Keni bërë edhe stërvitje ushtarake në fakultet?

- Po dhe ishin kohët më të bukura me shoqërinë. Vishnim uniforma të gjelbra dhe kapele e marshonim nëpër kodrat e pyllëzuara të qytetit Studenti me “Kallash” mbi supë. E mban mend, Fabiola?

- Ku harrohet ajo? Ishte pushka më e madhe se unë, plumb e rëndë. Sikur nuk më mjaftonin çizmet.

- Ne duhej të ngrinim edhe radiot. Meqë ishim inxhinierët elektronikë të së ardhmes, stërvitja jonë përqendrohej kryesisht në komunikimin me radio, po kjo merrte vetëm një pjesë të shkurtër të ditës. Luanim futboll dhe tregonim barsaleta pjesën tjetër.

- Interesante! E dinit ju që ata të radiove janë të parët që qëllohen në luftë? – pyeti Skoti.

- Jo-o! “Harruan” të na e thoshin profesorët atë. Po s’do mend që armiku do të donte të shkëpuste komunikimin të parin. As që më kishte shkuar mendja ndonjëherë. Nuk para mendonim për luftë.

- Qëlluat ndonjëherë me fishekë të vërtetë?

- Posi jo! Aty ishte gjithë lezeti. Megjithëse kishim qëlluar plot që në shkollë të mesme. Partia e merrte shumë seriozisht stërvitjen tonë luftarake; gjithmonë gati për të dhënë edhe jetën, po të ishte nevoja, për mbrojtjen e atdheut nga pushtimi imperialist amerikan. I ke parë bunkerët tanë prej betoni të përforcuar me hekur anës bregut?

- I kam vënë re, - tha Skoti dhe qeshi nën hundë.

Papritur filloi në radion e makinës kënga “Të lutem më fal” nga Brian Adams dhe zemra ime sa s’kërceu nga gjoksi duke më kujtuar se ku po shkonim. Unë e Fabiola filluam të këndonim pas tij nëpër dhëmbë duke u tundur në vend. Edhe me muzikën, sa më afër që i vinim Beratit, aq më

shumë emocione kisha. Fabiola drejtoi shoferin përmes qytetit për te hyrja e pallatit të Teos dhe ata të dy pritën në makinë gjithë kohën që ne ishim lart. Isha kurioze nëse Skot e kishte idenë se ku dhe pse po shkonim në këtë vend para se të linim Fabiolën te shtëpia e saj.

- Kam shumë frikë, Fabiola, - i thashë, siç po ngjitnim shkallët e mirënjohura. Fabiola i ra ziles dhe mami i Teos hapi derën. Fytyra e saj e habitur tregoi se nuk e kishte idenë se kush ishim, por, sapo Fabiola u prezantua, ajo na ftoi brenda tek dhoma e pritjes. “Do ta kenë liruar dhomën nga frigoriferët!” – mendova dhe u ula qetë-qetë në divan. Fabiola bëri shumicën e muhabetëve. Pyeti për Teon dhe jetën e tij të re në Londër, ndërsa unë shikoja me nënqeshje dhomat e njohura përtej koridorit.

E ëma e Teos jo vetëm që iu përgjigj gjithë pyetjeve të Fabiolës, por u ngrit e na sollti një album me fotografitë e Teos nga Londra. Aspak siç e kisha imagjinuar. Ishte e mirë, fliste me zë të butë dhe dukej shumë e re! Kishte flokë të errët të lidhura bisht dhe sy të butë kafeje që shponin me kureshtje. Më kishte dhënë një rreze jo vetëm të fytyrës së tij të dashur, por edhe të jetës së tij të qeshur në Angli. Vështrova përmes fotografive duke qeshur me flokët e tij të shkurtër të prera karé. Sa mirë dhe sa i lumtur dukej! Unë po shijoja akoma albumin kur Fabiola më kapi krejtësisht në befasi: “Mirela, e ke njohur Teon ti?”

Po kjo pik'e zezë? Tani e ëma më di emrin! Doja të zhdukesh. Po kjo pse më bën pyetje që ua di përgjigjen? Çfarë të them?

- Eëëë, jo, - iu përgjigja pas një ngurrimi ashiqar dhe ndjeva afshin përvëlues të më ngjitej nga gusha deri në faqe. *Mos! Sapo gënjeva! Sapo e mohova!*

E ëma u ngrit dhe na nxori nga një gotë likerit tradicional. Kisha tmerr ta shikoja në sy dhe mezi thashë “falemnderit!” për likerit. Thitha një gllënjë të vogël nga gota teke dhe ula sytë prapë te albumi.

- Duhet të dalim tani. Mos ta lëmë shoferin të presë shumë gjatë, - tha Fabiola, siç u ngrit të ikte dhe unë e ndoqa me padurim. E ëma e Teos na përcollti te dera e jashtme. Fabiola e falenderoi dhe unë zbrita nëpër shkallë e çliruar që kishim dalë prej andej.

- Nuk më besohet kjo që bëmë! – thashë duke u hedhur përpjetë me ngazëllim, kur mendova që ishim mjaft larg. – Nuk di si të të falenderoj! Më duhej ta bëja këtë. Në mos për t’i fituar zemrën, të paktën për t’ia bërë më të vështirë që të flasë kundër meje. Nuk jam e sigurt nëse arrita gjë me mërmërimat dhe skuqjet e mia, po tani më ka parë. Po i ra në të se kush jam.

- Oh, nuk e ke idenë! Ti e kishe kokën ulur gjithë kohën duke parë fotografitë, por ajo të kishte ngulur sytë dhe nuk t'i shqiste edhe kur i flisja unë.

- Vërtet?! – vezullova me lumturi. – Edhe mua më dukej sikur po më digjte, po nuk isha e sigurt. Do ta kemi bërë lëmsh fare, – thashë duke mbajtur të qeshurën. – Çne e dashura e parë që ndihmon të dashurën e dytë?

- Kështu e ka dashuria e Krishtit.

- Ëhë, derisa më bëre atë pyetjen e llahtarshme. Nuk dija ku të fshihesha pas asaj përgjigjeje. Më kapi krejt pa mendje. Ç'të zuri?

- Nuk e di se si më erdhi. Po përpiqesha të mbaja muhabetin gjallë.

- E, varja! Ndoshta ishte më mirë që u pengova, gjithsesi.

Ishim ende duke qeshur kur hymë në makinë. Shoferi e çoi Fabiolën te shtëpia dhe Skoti vazhdoi të rrinte ulur në ndenjësën e pasme edhe pasi zbriti Fabiola. U bë edhe më e qartë kur ai propozoi që unë të rrija te vila e tij në plazhin e Durrësit për atë natë. *Kjo qenka dita e të papriturave të zorshme!* Në çdo rrethanë tjetër, do të kishte qenë mrekulli të kaloja natën në një nga vilat e paprekshme të ish-komunistëve. Po qëllimet e këtij robi nuk ishin aspak të qarta. Pa anoja drejt mendimit që kishin të bënë me një marrëdhënie njënatëshe dhe unë nuk kisha kurrfarë interesi.

- Kur të kthehet shoferi nesër për të marrë Fabiolën, kalon këtej, të merr edhe ty dhe ju çon të dyjave në Tiranë.

- Më duhet të jem në kishë në Tiranë nesër që në mëngjes, - iu përgjigja pa ngurrim.

- Në atë rast, të çon shoferi im në Tiranë sa më herët dhe pastaj kthehet në jug për të marrë Fabiolën nesër mbasdite, - nguli këmbë Skoti.

- Jo, jo! Nuk jam fare nga ato që u del gjumi herët. Më bie më mirë të fle në dhomën time dhe të jem një vrap pele nga kisha nesër.

Me sa duket nuk e ka idenë fare se ku isha dhe çfarë po kërkoja. Ose ndoshta nuk do t'i bëhej vonë edhe po ta dinte që kisha dashnor.

- Do të kthehesh për një vizitë, atëherë? – pyeti sërish.

- E mirë, një vizitë. Ne të gjithë kemi qenë kureshtarë për vilat e partisë mbrapa kangjellave, gjithmonë të ruajtura me ushtarë, - pranova.

- Unë bëj makarona të mira. Të pëlqejnë hudhrat? – pyeti Skoti dhe unë papritur pata një bllokim truri të çastit e nuk më kujtohej çfarë ishte “garlic” (hudhra) edhe pse më tingëllonte si fjalë e dëgjuar. Sa turp! Skoti filloi të vizatonte skica të vogla qesharake thelpinjsh me dredhka në majë, por mua nuk më vinte asgjë ndër mend. Skoti pyeti edhe shoferin nëse e dinte atë fjalë, po as ai nuk e dinte. Po më kapte frika se mos kisha bërë një gabim të

madh duke i pranuar ftesën, por u ndjeva e detyruar pas gjithçkaje që kishte bërë ai për mua dhe Fabiolën. E kalova mendjen në marsh lutjeje për pjesën e mbetur të udhëtimit. I njëjti Perëndi që më kishte shpëtuar sa e sa herë më parë do të më çlironte me besim sërish nga gracka ime mendjelehtë. Një gjë ishte e sigurt: nuk kisha asnjë iluzion për ta mposhtur këtë fizikisht.

Shoferi e ngau makinën në dalje të rrugës kryesore dhe u kthye në hyrjen e bllokut, përmes portave të hekurta dhe, sa hap e mbyll sytë, unë tashmë isha brenda bllokut të pushimeve të aparatçikëve ish-komunistë. Skoti jetonte në një nga vilat e bukura dykatëshe, por unë nuk mund t'ia lejoja vetes të humbisja vëmendjen tani. Pasi zbritëm nga makina, hodha sytë mbrapa dhe pashë që shoferi nuk po vinte me ne të dy. *Uuu, vetëm!* U ktheva mbrapsht dhe i thashë të më merrte në orën shtatë po atë mbasdite. Shoferi pa nga shefi i vet disa metra më tutje dhe ngriti zërin në anglisht: “Këtu më ke në shtatë!”. *Të marrtë purtha shalët me gjithë besnikërinë tënde! Shqiptarët dhe mahnitja e tyre me amerikanët!* Tashmë, Skoti po ecte drejt meje e shoferit dhe u hodh: “Hë, edhe ti tani! Të paktën tetë, meqë nuk po rri sonte”.

- Mirë, shtatë e gjysmë, atëherë. Dua të sigurohem që nuk ngelem jashtë konviktit.

Të dy ranë dakord dhe unë e Skoti u futëm brenda. Ai shkoi drejt e në kuzhinë dhe filloi të bënte makaronat që kishte premtuar gjatë rrugës në kthim nga Berati.

- Çfarë bën ti për qeverinë amerikane që të bie të jetosh në një nga banesat më të lakmuara në vend? – e pyeta duke parë nga deti i lëmuar në errësirë vetëm pesëdhjetë metra përtej derës së qelqtë dhe duke menduar sa do të doja të kridhesha një çikë.

Unë nuk punoj për qeverinë amerikane. Imja është kompani private nafte, - u përgjigj Skoti që përtej hapjes katrore të madhe mbi murin që ndante kuzhinën nga dhoma e pritjes.

- Aaa! Prandaj nuk je me qendër në Tiranë, - thashë dhe u ktheva me fytyrë nga kuzhina.

- Po edhe përfaqësuesit e qeverisë nuk punojnë të gjithë nga kryeqyteti, - ma ktheu Skoti, tashmë duke mbajtur një thelb hudhre në dorë. Unë qesha dhe thashë: “E dija që ishte diçka qesharake dhe që do të qeshja sapo të mbaja mend!”.

Skoti i mbaroi përgatitjet për salcën dhe erdhi në dhomën e pritjes. Vështrova jashtë derës prej xhami e tensionuar dhe e frikësuar me çdo hap të madh që hidhte drejt meje. *U shqyrr!* Mora frymë e lehtësuar, kur vura

re me cep të syrit që ndaloj para stereos. *Mos! Kjo do të thotë që do të luajë muzikë. Ja ku po ul edhe dritat. Po merr tatëpjetën shumë shpejt kjo punë! Si i bëhet për atë idenë e të notuarit? Nuk kam rroba banje, pa. As sutjena, xhanëm. E çë pastaj?*

Po më punonte truri me mbingarkesë duke u përpjekur që të nxirrte diçka për të bërë, ndërsa ziente uji për makaronat. Gjithçka veç asaj që po bëhej gati të bënte ky.

- Sa do të doja të futesha për not tani! – i thashë dhe e kapa Skotin krejt të papërgatitur.

- Tani, tani?!

- Po. Ke ndonjë këmishë tënden që ta marr hua?

- Është natë përjashta dhe shtatë janar!

- Deti është gjithnjë më i ngrohtë në darkë, - i thashë me një buzëqeshje prej fitimtareje.

Skoti iu ngjit shkallëve dhe më solli një kanotierë të zezë të stërmadhe me hapje po aq të mëdha për krahët. Nxitova për te banja e ngazëllyer dhe e frikësuar në të njëjtën kohë: e ngazëllyer që do të futesha në det dhe e frikësuar që do të notoja vetëm në detin e zi skëterrë. Hoqa të gjitha teshat e mia, përveç të mbathurave prej dantelle, dhe vesha kanotierën e tij. Vrimat e hapura për krahët më zbrisnin deri poshtë belit. Do të më duhej të mbaja mend mos të përkulesha përpara. Dola nga banja, kalova përmes dhomës së pritjes në majë të gishtave të zbatshur ndërsa Skoti shikonte dhe tundte kokën duke qeshur: “E çmendur!”

Vrapova gjatë gjithë rërës së ftohtë duke bërtitur e ulëritur “Alelujaaaaa!” deri te bregu. Vazhdova vrapin përmes dallgëve të ftohta dhe rashë me shpinën në ujin e zi, siç falenderova Perëndinë për mrekullinë mahnitëse të detit, qoftë ditë apo natë, verë apo dimër. As që e ndjeva të ftohtin më. Dy mendime më shkuan nëpër mend. E para, si isha pagëzuar në emrin e Krishtit dhe e rilindur në Frymën e Shenjtë, por ende jo në ujë. *A mund të quhet ky pagëzimi im në ujë, Zot?* Mendimi tjetër ishte dita e shenjtë ortodokse greke e Epifanisë, kur hedhin një kryq të rëndë në ujë çdo vit më gjashtë janar dhe kushdo që përballon ujin e ftohtë dhe e nxjerr kryqin nga thellësitë do të ketë një vit të bekuar. Megjithëse isha një ditë vonë për këtë.

Disa minuta më vonë, dola nga uji dhe pashë Skotin në breg duke më pritur me një peshqir të madh, që ma mbështolli rreth shpine. Nxitova mes rërës së ftohtë drejt e në banjo për një dush të nxehtë. *Oh sa mirë! Mund të harxhoj dhe ca minuta të gjata me dushin këtu.*

Kur dola nga dushi, e veshur me të njëjtat rroba që kisha gjithë ditën, nuhata darkën e shijshme që Skoti kishte mbaruar së gatuari vetë nga fillimi në fund. Mora pjatën time dhe u ula në dhomën e pritjes në sheshin para kaloriferit për të tharë flokët dhe për të sjellë shpirtin në vend. Megjithatë, Skoti ishte goxha i vështirë për t'u hequr qafe. Mori edhe ai pjatën e vet dhe u ul në kolltukun përballë meje.

- Pse po ulesh në dysheme? – pyeti.

- Që të jem pranë ngrohjes. Po thaj flokun. Edhe pak dhe vjen shoferi yt. Nuk dua të dal jashtë me flokë të lagur. Është ftohtë.

- A thua? – tha me ngërdheshje dhe unë qesha disi fajtores për mbasditen e tij zhgënjyese.

- Ishte shumë frikë noti në errësirë. E kisha bërë një herë më parë, po në verë dhe me një grup shokësh nga puna.

- Çfarë lloj pune ka not nate në detyrë? – pyeti Skoti kureshtar.

- Punë qejfi. Isha kamariere pijesh për gjashtë muaj para një viti e ca. Një natë, drejtori, që nganjëherë na çonte të gjithëve me makinë nëpër shtëpira, vendosi të na sillte në plazh.

- Paska qenë vërtetë punë qejfi. Ku ishe kamariere?

- Në një disko.

- Sa e gjetur për ty! Të kam parë duke kërcyer, - tha Skoti dhe çoi pjatën e tij të zbrazët dhe timen në kuzhinë. – Meqë ra fjala te të kërcyerit, do të të pëlqente të kërcjeje me mua?

- Jo dhe aq. Që tani? – u zvarrita.

- Mirë do të ishte.

- Epo mirë, - ngrita supet me bezdi që do t'i afrohesha aq pranë një krejtësisht të panjohuri në shtëpinë e tij pa këmbë njeriu tjetër vërdallë.

Më mori dorën në të tijën dhe mbështolli krahun e madh, të gjatë e me gunga muskujsh masivë përreth kurrizit tim duke u lëkundur ngadalë sa në një anë në tjetrën. Kujtimi i kërcimit të fundit vetëm me dikë në shtëpinë e tij e bëri këtë vallëzim edhe më të vështirë. S'kishte rëndësi vëmendjen e sa burrave tërhiqja; më mungonte Teo më tepër. Sidomos tani që kisha takuar nënën e tij, më ishte rিপërtërirë shpresa.

Skot duhet të ishte ndjerë po aq i bezdisur nga ky vallëzim koti, sepse më ndërpreu mendimin: “Do ta shikosh pamjen e detit nga lart?”

- Do të ishte një çikë si shumë errësirë për të dalluar gjë, po hajt mo, - i thashë dhe e ndoqa shkallëve, pa e kuptuar që rruga për te ballkoni kalonte përmes dhomës së gjumit.

“O na dhjeu! Nuk mbaka më ujë pilafi!” – mendova duke u ndjerë e alarmuar dhe budallaqë, por eca sa më shpejt dhe larg tij që të mundesha, drejt e te ballkoni.

- Oh, shushurima e valëve! Ky parmaku ka lartësinë e përkryer për t’u shtritur, - thashë siç ngrita këmbën e majtë drejt e mbi parvazin prej betoni dhe harkova krahun e djathtë mbi kofshën e ngritur. – Ti bën hapa të shtrirë për ndërtim muskujsh, po vë bast që nuk e bën dot këtë edhe pse je shumë më i gjatë, - e ngacmova. Sa më qesharake të isha, aq më tepër më dukej se po thyeja gjendjen e nderë.

- Jo, nuk e bëj dot, - ma priti Skoti duke buzëqeshur dhe duke më parë me ngulm sikur të mendonte: “Nuk të marr vesh fare!”.

Sa zbritëm prapë poshtë, shoferi ishte kthyer për të më sjellë në Tiranë, siç kishte premtuar. U çlirova me mirënjohje në shpirt për mbrëmjen pa ngjarje.

U gëzova që, më në fund, u gjenda vetëm në shtratin tim, duke përqaftuar jastëkun dhe duke medituuar mbi gjithë fotografitë e reja të Teos që kisha parë atë ditë. Rashë në gjumë duke u lutur që Perëndia të zbuste nënën e Teos për të më pranuar.

Pashë veten duke ecur përgjatë një rrugice të vjetër të ngushtë Berati, të shtruar me kalldrëm, me mure guri në të dyja anët, që fshihnin oborre kalldrëmi të shtëpive private të gurta. Siç po i afrohesha një porte të drunjte në të djathtë, njoha mamanë e Teos që ishte ulur në një sokak në anë të portës. Sapo më pa duke iu afruar, u ngrit më këmbë dhe lëvizti të dy krahët e shtrirë përpara drejt portës së hapur mbrapa saj, sikur të më ftonte në shtëpinë e saj pa thënë asnjë fjalë, por unë i buzëqesha dhe vazhdova të ecja drejt duke e kaluar, gjithashtu pa thënë asnjë fjalë.

U zgjova dhe kuptova që kisha parë një ëndërr: një përgjigje të lutjes sime të natës së mëparshme. Ishte shumë e qartë që nëna e Teos kishte ndërruar mendje për të më pranuar, por mua po më ngacmonte fakti që refuzova të futesha brenda. *Pse nuk u futa brenda?*

Mezi po prisja që të kthehej Fabiola. Më duhej të ndaja zbulimin tim të ri me të si ajo që bëri të mundur takimin tim me nënën e Teos, por e dija që nuk do të mundja dot deri të hënën në mëngjes. Tani për tani, do të mjaftohesha me falenderimin ndaj Perëndisë mes besimtarësh të tjerë mirënjohës. Tani që Perëndia më tregoi pranimin tim prej nënës së Teos, kisha shpresë të re. “Tani do të ma japësh, Zot?” – vazhdova të shtyja me lutjen time këmbëngulëse. Se mos aty ishte halli! Sa më tepër që mendohesha për këtë, aq më tepër isha dakort me fallxhoren.

Pastaj m'u kujtua Elio, një shok klase i fakultetit, që donte një vajzë nga elektrikja kundër dëshirës së të ëmës. Ai e la shkollën kur kapërceu gardhin e ambasadës gjermane para se të mund t'i thoshte së dashurës, por, mbasi kishte qenë në Gjermani nja dy muaj, u kujtua për të. Mori në telefon të ëmën dhe iu lut që të shkonte t'ia gjente të dashurën në shkollë. Edhe pse nëna e kishte luftuar me mish e me shpirt ndërsa ata të dy dilnin bashkë, ajo shkoi ta gjente vajzën dhe i kërkoi t'i priste të birin. Por, e dashura kishte vazhduar me jetën e saj dhe i tha s'ëmës që Elio të shkonte të rrihte ujë në hava të Gjermanisë.

I dashuri im kishte ikur prej pothuajse një vit e gjysmë dhe akoma nuk kishte mbledhur dot guximin ndaj s'ëmës për hir të dashurisë sonë. *Prapëseprapë, unë do ta vë shpresën tek ty, Zot!*

Kur takova Fabiolën të hënën mbasdite, e kisha humbur entuziazmin për ëndrrën, sidomos çikën e fundit që më kishte ngacmuar që atë natë. *Pse nuk do të futesha në shtëpinë e saj?*

- E dërgoi Skoti shoferin për të të marrë dje? – e pyeta Fabiolën.

- E dërgoi. I kishe bërë shumë përshtypje shoferit. U mahnit edhe më kur i thashë se pse kishe ardhur në Berat me mua.

- Me se u mahnit? Me pritën që i zumë mamasë së shkretë?

- Jo. Me faktin që ke pritur me besnikëri një të dashur të munguar për një kohë të gjatë.

U skuqa nga lavdërimi dhe ula sytë: “Nuk është se po pres atë. Është thjesht se nuk më ka dalë në shteg ndonjë gjë e krahasueshme ose më e mirë”.

- Si ia kalove me Skotin në kthim?

- Të besohet që më kërkoi të rrija për tërë natën? Nuk e di çfarë mendje kishte, po nuk kisha plan për ta marrë vesh. As që nuk e kisha vënë re që më kishte kunjë derisa filloi të llafosej për shalët e mia në makinë.

- Më tha, - tha Fabiola duke buzëqeshur.

- Kur?

Në kthim nga Berati, unë e shoferi ndalua te vila për një vizitë para se të më sillte në Tiranë dje. Të tha që është i martuar?

- Jo!! Vërtet?! – pyeta e tronditur por edhe më e gëzuar që nuk kisha kaluar natën. *Perëndi, si më shpëton!*

- Më tregoi edhe fotografinë e së shoqes. E ka zvicerane. S' ishte ndonjë bukuri e rrallë. M'u duk edhe sikur e dëgjova t'i thoshte vetes nëpër dhëmbë “Budall!”, siç ma mori fotografinë e saj nga duart për ta vënë prapë mbi komodinë. Më la përshtypjen që ishte bërë pishman që ishte martuar me të.

- Ia fut kot! – ia prita.

- Dukej sinqerisht i prekur nga vizita jote.

- Ashtu t'u duk vërtet? E ç'rëndësi ka kur është i martuar, apo jo? Nuk më besohet që nuk më shkoi as nëpër mend! Një burrë aq i pashëm sa ai ... sigurisht që është i martuar. “Mollën e mirë nuk e lë njeri të bjerë në shesh” thoshte gjithnjë një kushëriri im.

- Ti nuk po sugjeron që ne nuk jemi të mira, apo jo? – tha Fabiola.

- Nuk e kam idenë se çfarë po ndodh me ne. Shpresoj të jemi ende duke u pjekur në pemë. Unë çoku kam qenë nga ato të vonëtat, po ta mendosh hollë-hollë.

- Po, që ha një çikë nga të çmendurat. Më tha që kishe vajtur për not në errësirë.

- Të tha? – qesha. – Po nderej gjendja shpejt. Më duhej të largohesha, të thyeja heshtjen, ritmin. Më duhej të parandaloja çfarë ishte duke ardhur.

- Ia dole?

- Po. Falë Perëndisë! Bëri ca makarona. Hëngrëm dhe kërcyem një çikë. Ishte bezdi. Pastaj vendosi të më tregonte pamjen nga kati i dytë në fund.

- Do mblidhen prapë sonte tek Davidi. Do të shkosh?

- Di gjë në do të jetë Skoti atje?

- Nuk e kam idenë, - mblodhi supet Fabiola.

- Nuk do të di si të sillem po të jetë, po nuk më bëhet vonë. Sidomos tani që e di që është i martuar, - iu përgjigja dhe shkova me të.

Siç pata frikë, Skoti erdhi tek mbrëmja më vonë, por unë vetëm sa e përshëndeta me kokë nga larg dhe evitova me kujdes bisedat apo praninë e tij gjatë gjithë mbrëmjes. As ai nuk bëri ndonjë përpjekje të tepërt për të më folur. E kapa duke më parë nja dy herë nga përtej dhomës plot me njerëz dhe nuk e pashë më kurrë pas asaj nate.

KAPITULLI XIX

NJË ZYRË E RE

U përzieva me të njohurit, Omarin, Eldën dhe Adrianin, për më të shumtën e kohës gjatë mbrëmjes. Takimi me të huaj të saponjohur, shumica burra, ishte interesant dhe informativ, por unë gjeja më shumë kënaqësi në kërcim se sa t'i afrohesha një të panjohuri për bisedë. Amerikanët, nga ana tjetër, nuk e kishin për gjë fare të të afroreshin duke të përshëndetur me një "Hai!" dhe duke vazhduar kaq natyrshëm me mahnitjen e tyre pas kulturës, vajzave të bukura, ndryshimeve të shpejta dhe themelore të vendit, etj.

- Urime për punën e re! Të thashë që nuk do ta kishe problem për ta gjetur, - tha Omari.

- Falemnderit! Jam shumë e qetë që jam në punë tani.

- Sorosi ka dy zyra në Tiranë. Te cila je ti? – pyeti ai.

- Sapo u transferuam te një ndërtesë katërkatëshe pranë Radio-Televizionit.

Unë kam dhomën e vogël me diell për pritjet në katin e dytë. Pothuajse gjithë muri i jashtëm është xham me drejtim nga jugu dhe unë shullëhem në diell gjithë ditën ndërsa u përgjigjem telefonave. Më pëlqen shumë! O, dhe i gjithë kati i parë është kuzhinë dhe mensë. Kemi kuzhinieren më të mirë në qytet.

- Për s'mbari! Edhe ju paguajnë mirë edhe ju ushqejnë!

- Më duket se e kuptuan që nuk i dilet për drekë vetëm me një gjysmë ore, meqë nuk ka vende për të ngrënë asgjëkundi rreth e rrotull zyrës.

- Vë bast që edhe shefat e punës tënde vijnë te mbrëmjet e ambasadës. Hajde edhe ti ndonjëherë.

- Ngele duke më thënë; mbase e provoj këtë të premtë. Kam qenë e zënë, - i thashë dhe i shkela syrin Fabiolës buzagaz.

- Me se? – e kapi Omari gjestin.

- Vajta në Berat. Më çoi Fabiola te shtëpia e Teos dhe takuam "mamanë".

- Akoma me atë ti? Pse e harxhon kohën kot? – tha Omari pa e fshehur bezdinë.

- Shpresa është e vështirë për ta hequr qafe dhe Perëndia më ka dhënë plot, - iu përgjigja.

- Të ka marrë në telefon që kur je kthyer? – pyeti Omari.

- Jo tamam. Ishte më tepër me shkrim. Në Bibël, - ia prita, duke bërë sikur nuk e kuptova.

- Na shkrive fare! Epo jo, atëherë.

- Nuk thashë që ma dha shpresën Teo; ma dha Perëndia.

- Çfarë të tha Perëndia?

- Më tha që njeriu do ta lërë nënën e babanë dhe do të bashkohet me gruan e tij dhe të dy do të bëhen një.

- Sipas asaj radhe? – pyeti Omari.

Auu! Sidomos nga dikush që as nuk e ka hapur Biblën ndonjëherë, e jo më ta ketë lexuar.

- Shpresoj që Perëndia të mos jetë sqimatar për radhën e punës, - vazhdoi.

- Ashtu shpresoj edhe unë, - ia ktheva duke buzëqeshur paksa e tronditur nga brenda. *Mirë ma bëri! Do bëja ironiken unë.* – Ai nuk ma di numrin, - vazhdova duke justifikuar Teon, - gjë që është arsyeja që kam menduar ta bëj vetë. Mund ta marr në telefon shkurtimisht; sa për t'i dhënë numrin e ri të punës.

- Dhe po nuk të mori në telefon as atëherë? Si do ta justifikosh pastaj?

- Nuk e di. Të jemi shëndoshë, - ia prita e frikësuar nga përgjigja e vërtetë e pyetjes së Omarit, por e kisha ndarë mendjen dhe guximin për t'i dëgjuar zërin edhe një herë.

Të nesërmen në mëngjes, pasi kisha përfunduar gjithçka që më duhej për punën në tavolinë, ngrita receptorin dhe fillova t'i bija numrit të Teos. *Ah! Ato dy zile të shkurtra!* Po më përcëlluhej fytyra dhe po më rrihte zemra fort e shpejt.

- Alo, - u përgjigj Teo.

- Alo, - iu përgjigja me zë të mekur. – Mirela jam. Si je?

- Hë, më! – ma ktheu Teo me zë të ulët e të qetë, si për të thënë: “E di kush je”. – Mirë jam. Nga po më merr? – pyeti.

- Mos ki frikë! U ktheva në Tiranë dhe kam gjetur punë te fondacioni Soros tani, - ia prita me kraharor të ngrohtë ngaqë i dëgjova zërin ose nga dielli që shkëlqente përmes dritarës. Çka doja t'i thosha në të vërtetë ishte: “Thuaji mamasë që kam një punë të nderuar dite tani”.

- Të lumtë! Po mbaje!

- E di. Nuk duhet të bëj thirrje ndërkombëtare, por të mora sa për të të dëgjuar një çikë zërin. Mirë, po e mbyll tani. Mirupafshim!

- Mirupafshim! – u përgjigj Teo dhe unë e mbylla.

Vetëm kaq?! Prapë nuk dija ç'të mendoja. Nuk donte të fliste me mua apo kishte vërtet merak mos humbisja punën duke e marrë në telefon? Nuk arrita as t'i jepja numrin e telefonit. E vetmja gjë që arrita ishte të merrja krahë e të fluturoja e lumturuar gjithë ditën ... vetëm se prapë pa kurrfarë ideje se ç'mendonte ai. Në fund të fundit, nuk ka rëndësi se çfarë thotë apo bën për sa kohë që ka çfarë të thotë i miri Zot dhe Ai ka folur. "Më mjafton kjo, o Zot? Nuk më duhen dy konfirmime për të ditur që je ti dhe jo imagjinata ime që hyn e zgjedh sipas dëshirës vargjet që më interesojnë? Do të më japësh edhe një tjetër, të lutem?" – u luta dhe prita.

Hapa Biblën dhe lexova me sy skifteri dhe zemër të hapur, por nuk ndodhi asgjë deri mëngjesin tjetër. Kur u zgjova, e kuptova që kisha parë Teon në ëndërr. U shfaq më këmbë përballë meje në largësi dhe tha: "Kthehem në shtator".

O Zot! Si nuk rresht kurrë së më magjepsuri! Kush jam unë që nderon me përgjigje çdo kërkesë që kam, të madhe apo të vogël? Perëndia i gjithësisë përkulet poshtë, deri këtu poshtë tek një liliput si unë për të folur me mua; mendimi më mbush sytë me lot! Tashmë e kisha edhe konfirmimin e dytë. Teo është duke u kthyer! Si ka mundësi? Nga fotografitë dukej i stabilizuar atje ku ishte. U regja me ëndrrën dhe e solla me herë të tëra në mendje gjithë atë javë.

Mezi po prisja t'ia tregoja këtë zbulim të fundit Fabiolës. Më duhej t'ia thosha personalisht. Kisha një arsye më tepër për të shkuar te mbrëmja e bunkerit tani. Disa minuta pas orës shtatë të premtën mbasdite, prita para portës kryesore të ambasadës amerikane derisa roja në koliben e vogël thirri Omarin, që tashmë ishte futur brenda. Omari më pa me gëzim dhe më bëri me shenjë të futesha. Ecëm bashkë përmes shkurreve të kopshtit dhe mbajtëm djathtas për nga bunkerit i nëndheshëm.

Në fund të shkallëve ishte një amerikan ulur mbi një karrige të lartë, të cilit po i lustronte këpucët një shqiptar i ulur para këmbëve të tij. Dhoma ishte plot me njerëz që rrinin më këmbë, biseda dhe tym. Në cepin e përtejme të dhomës, ishin nja dy veta që po qëllonin shigjeta të vogla mbi një tabelë shënjestre të varur në mur. *Ai u dukërka si qejf i llojit tim!* Ndoqa Omarin kokulur përmes turmës për te banaku, ku ai më porositi një birra.

- Do edhe ca kikirikë? Shkojnë me birrën.

- Jo, jo. Rrofsh! Më mjaftojnë karbohidratet e birrës. Po lëre, se e blej vetë tani.

- E di që e blen vetë, po si herë e parë që është dhe meqë të kam ftuar unë... Mirë që erdhe! – u përgjigj Omari dhe, po aq papritur, iku të llafosoj me dikë tjetër në dhomë. Ngela më këmbë pa ndonjë qëllim apo njeri me të cilin të llafosesh. Nuk mund as të gjeja një cep të zbrazët për t'u ulur e pirë birrën në qetësi. Këto më dukeshin minutat më të kota në të gjitha mbrëmjet amerikane.

Pastaj papritur, një amerikan nga fundi i të pesëdhjetave ose fillimi i të gjashtëdhjetave m'u drejtua me zë të lartë, fytyrë të qeshur dhe sy të zgurdulluar: “Unë të mbaj mend ty! Ti je ajo kamarierja bukuroshe e diskotekës”.

- Njatjeta! – ia prita me zë të ulët, sikur do ta ndihmoja të ulte të tijin. – Edhe unë të mbaj mend ty. Qenke akoma këtu! Shumë e pazakontë. Nuk vijnë e ikin shumica juaj brenda muajsh? – shtova në përpjekje të kotë për ta nxitur që të fliste për veten e vet në vend që të fliste për mua. Ai nuk ua vuri veshin fare fjalëve të mia, u kthye nga dy prej shoqëruesve të tij dhe vazhdoi me po atë ton: “Ishte kamarierja më e mirë; bukuri natyrale, pa tualet!”.

Unë po skuqesha nga turpi duke ulur sytë; nuk dija ku të fshihesha.

U çlirova kur pashë Fabiolën dhe Eldën duke u futur pak më vonë. U prezantova admiruesin tim të vjetër, si për t'i drejtuar vëmendjen edhe një herë larg meje e drejt tyre: “Na këtu, fol me këto tani!”.

Pastaj u shfaq një fytyrë tjetër e njohur mbrapa turmës dhe më bëri shenjë me dorë. Ia bëra edhe unë me dorë shefit tim dhe vazhdova të bisedoja me shoqet e mia.

- Omari kishte të drejtë. Shefi im qenka këtu vërtet, - i thashë Eldës dhe Fabiolës. – Seç kam një parandjenjë që nuk ka për të dalë për mirë.

- Mos është ai që po vazhdon të shikojë këtej nga ty? – pyeti Elda.

- Vërtet? – pyeta dhe ktheva kokën për ta verifikuar. – Eh, ç'na gjeti! Shpresoj të mos marrë vesh edhe ai se çfarë kamariere e madhe pijesh kam qenë një herë e një kohë, - thashë, tashmë duke patur edhe një arsye më tepër për të qenë e tmerruar nga ditët e mia të punës në disko.

Kur shefi im përsëriti të njëjtën shenjë duke palosur dy gishtat e dorës së djathtë drejt vetes, unë e kuptova që kishte të njëjtin kuptim në anglisht siç kishte në shqip: “Hajde këtu!”

- Më duket se po të thërret atje, - tha Elda.

- Pse do të më flasë? Ne nuk jemi në zyrë tani, – u përgjigja dhe dalëngadalë çava mes turmës së dendur drejt tij, e druajtur që e kisha bërë të priste.

- Më vjen keq! Kujtova se thjesht po më përshëndesje, - i thashë me një buzëqeshje.

- Si u fute këtu? – pyeti Roberti me habi.

- Më ftoi një shok i imi dhe vuri firmën për mua, - ia prita disi në mbrojtje. As unë nuk mendoja se më takonte të isha aty. – Edhe ai punon me amerikanët, - vazhdova duke kërkuar Omarin nëpër turmë, sikur t'ia vija fajin atij për qenien time aty. Në fund të fundit ideja kishte qenë e tija.

- Ke kohë që vjen këtu?

- Jo. Kjo është hera e parë. Duhet të jetë hera e parë edhe për ty, përndryshe do ta dije nëse kisha qenë këtu më parë ose jo, - lllomotita duke mbajtur sytë nga i njohuri i diskos në lutje që të mos i afrohej shefit tim. – Më duket se shokët e mi po bëhen gati për të dalë për darkë, - vazhdova në përpjekje për t'u shkëputur.

- Unë hëngra para se të vija këtu, - vazhdoi shefi im.

- Kaq herët? Megjithëse kur ha njeriu drekën që në dymbëdhjetë, e merr uria që në gjashtë.

- Kur e ha drekën ti?

- Shumë më herët tani që kemi kuzhinë te puna. Aq erë e mirë sa vjen gjithë ditën është e pamundur të mos e mbajmë mendjen tek e ngrëna. Megjithëse, gjatë viteve të mia studentore më ikte mëngjesi pa ngrënë shumicën e kohës dhe nuk kthehesha në konvikt, ku ishte mensa, derisa të mbaroja klasat, aty nga ora dy ose tre. Pastaj darka mund të hahej edhe nga ora nëntë ose dhjetë. Nuk kishte restorante të çastit deri nga vitit i fundit, por edhe atëherë, kjo do të kërkonte para të tepërta që ne nuk i kishim si studentë që ishim.

- Mban vërtet erë shumë e mirë në zyrën tonë. Më duket se kemi kuzhinieren më të mirë në vend.

- Ashtu është! – iu përgjigja. – Ishte kënaqësi që u pamë jashtë zyre! Mirë, atëherë, unë po kthehem te shoqet e mia para se të më humbasin nga sytë. Është bërë si kopsht zoologjik këtu.

- Shihemi në punë të hënën, - u përgjigj shefi im duke ma bërë me dorë, shumë më i lirshëm sesa isha mësuar ta shikoja në punë.

U ktheva tek vendi i mëparshëm që të kërkoja shokët e mi, por nuk i shihja më. Vendosa t'i bashkohesha grupit që po luante me shigjeta, që të mos dukesh si fyell duke qëndruar kot më këmbë. Po shikoja për Fabiolën, Omarin dhe Eldën, kur më zuri syri një burrë simpatik të gjatë në distancë, duke buzëqeshur dhe folur me shokët e tij, ndërsa herë pas here më hidhte nga një sy. Hapi anën e djathtë të xhakavendos së tij bezhë për të futur dorën në xhep dhe i doli gjoksi i bëshëm. Uuuuu! Gjoks të tillë kisha parë vetëm në

pikturat e Mic Sokolit, heroit kombëtar që sakrifikoi jetën duke zënë grykën e topit osman me gjoksin e tij.

Disa çaste më vonë, ai po qëndronte përbri meje. – Përshtëndetje! Mua më quajnë Majk, - përshtëndeti me buzë në gaz dhe më zgjati dorën. – Shkurt për Majkëll.

Gjithçka po mendoja ishte: “Kush të pyeti?”, por nuk mund t’ia lija dorën ngret, kështu që shtriva timen dhe ai ma shtrëngoi fort.

- Përshtëndetje, - iu përgjigja, gjithashtu me mirësjellje dhe ndalova së hedhuri shigjetat. – E di që Majk është shkurt për Majkëll. Majkëll Xhekson është shumë i dëgjuar këtej.

- Po ti, si e ke emrin? – këmbënguli Majkëll me kokën mënjanë dhe tashmë i vura re sytë e bukur bojë qielli dhe flokët gështenjë ende të njomë, të krehur mbrapa që përfundonin në kaçurrela te zverku.

- Mirela, - i thashë dhe e vështrova me zbavitje, siç u përpoq ta shqiptonte disa herë me vështirësi.

- Është gjuhë e vështirë për t’u shqiptuar me gjithë ato “r” të rrokullisura, megjithatë kam arritur të mësoj nja dy fjalë: *drejt, majtas, djathtas dhe mbrapa*, - u mburr Majkëll për përpjekjet e tij si ndonjë djalë i vogël dhe mua më bëri vërtet përshtypje. Shumicës së të huajve që kisha takuar në Shqipëri deri më sot u dukej shumë e vështirë të mësonin gjuhën time amtare dhe as që nuk e merrnin mundimin. Ndjeva kënaqësi që Majkëll të paktën tentoi. Pastaj, çdo fjalë shqipe që fliste tingëllonte më e lezetshme nga goja e tij, kështu që unë vendosa ta nxisja edhe më.

- Bravo! Ja dhe dy të tjera: *lart, poshtë*, - i thashë siç tregova me gisht lart pastaj poshtë.

- Lart, poush, - përsëriti pa m’i ndarë për asnjë çast sytë e kaltra.

- Pothuajse. Mungesa e “ë”-së në fund të *poshtë* është e tolerueshme, por “t”-ja duhet shqiptuar me domosdo. Do të rrih gjatë në Shqipëri që po mëson gjuhën? – e pyeta.

- Vetëm tre muaj, po jam me shërbim në Vlorë. Nga sa kam vënë re, atje nuk flitet anglishtja dhe aq shumë, - vazhdoi.

- Na qenke *lab*, atëherë, - e ngacmoi Omari me theks të ekzagjuar jugor, që u fut në bisedë. Majkëll më pa për përkthim.

- *Lab* quhet një i fortë nga Vlora. Ashtu i ngacmojmë dhe u themi “vrime”. Demek se u bëhet gjoksi vrimë nga që i bien shumë kur mburren për trimërinë e tyre. E kam të vështirë të ta përkthej humorin.

- E kuptoj. Më ka rënë rruga ndesh me nja dy, tashmë. E kuptoj humorin; nuk ishin dhe aq trima kur u bëra ballë.

- Tamam, po unë jam e fundit të të vë nofka ty apo ndonjë tjetri nga Vlora. Unë jam nga Fieri, qyteti fqinj në veri të Vlorës. *Labët* na quajnë *laluc*. Më duket se ka të bëjë me llucën e përhershme të fushave tona. Megjithëse, ka plot baltë edhe në kodra. Na konsiderojnë frikakakë, të përlulur, që gjithmonë hapim rrugë. Ata janë nga malet, ne nga fushat, etj.

- Cilat male?! Këto kodrat anës bregut?

- Po he de! – u përgjigja unë. – Po ato janë më të larta se fushat e rrafshita në të cilat jam rritur unë. Megjithëse prindërit e mi lindën e u rritën në kodrat e Mallakastrës dhe u transferuan në Fier më vonë me punën e babit. Jo se ka ndonjë nofkë më të mirë për mallakastriotët, xhanëm. Atyre u thonë *kërcikuq*; o nga i ftohti i dimrit o nga djegia e diellit në verë.

- Paskeni gjithatë variacion nofkash për një vend kaq të vogël!

- Po, po, s'ka si folklori, - qesha. – Por mjaft fjalor të kam dhënë për një natë. Se mos të vonova për darkën. Ishte kënaqësi që u njohëm, Majk, - i buzëqesha dhe fillova t'i ktheja shpinën për të kërkuar Fabiolën.

- Ku do të mbliidheni për darkë? – pyeti Majkëll.

- Nuk e di akoma. Atë po përpiqem të marr vesh, - i thashë dhe vazhdova të çaja përmes kallaballëkut drejt Fabiolës, që po bisedonte në italisht me dy burra. Pastaj vura re Majkun duke ecur mbas meje. – Fabiola, ky është Majku, - e prezantova, - dhe po më pyeste se ku kemi plan për të ngrënë paskëtaj, - vazhdova.

- Mirëmbërëma prapë, Majk! – i buzëqeshi Fabiola dhe m'u kthye mua. – Jemi takuar nëpëmjet shokëve të mi të rinj këtu. Këta janë Xhuzepe dhe Xhovani. Punojnë me Majkëll.

- Mirëmbërëma! – përshëndeta italianët e rinj.

- *Ciao, bela!* – tha Xhovani me buzët vesh më vesh duke më marrë dorën për ta puthur. “Të kanë faj italianët? Të bëjnë të ndjehesh si personi më i rëndësishëm në dhomë!” – mendova me nënqeshje. Edhe mund të mësohesha me komplimentat gudulitës. Megjithatë, mjekra e shkurtër, e thinjur mbi dorën time ishte pak si tepër.

- Xhuzepe dhe Xhovani po planifikonin të shkonin për pica dhe më kanë ftuar edhe mua të shkoj me ta, - shpjegoi Fabiola. – Do të vish edhe ti me ne? Vë bast që edhe Omari dhe të tjerët po shkojnë në të njëjtin vend.

- Patjetër! – pranova.

E lamë ambasadën amerikane dhe dolëm në rrugën ku Majku kishte parkuar një *Chevy Blazer* ish-ushtarak të gjelbër, tashmë të lyer të bardhë. Meqë nuk kishte vende për të gjithë në *Blazer*, Majkëll ofroi vendin e tij për të ecur vetë më këmbë dhe Xhuzepja vendosi të ecte më këmbë me të.

Xhovani u përpoq më kot të ndizte automjetin për disa minuta. Dukej se i kishte rënë bateria. Disa minuta më vonë, një amerikan që po ngiste një *Chevy* tjetër na premtoi se do të kthehej për ne sapo të zbriste ngarkesën e parë. Ai u kthye, siç premtoi, dhe na çoi te piceria, por Majkëll dhe Xhuzepe nuk kishin mbërritur ende. Pritëm për ta edhe për disa minuta.

- Ku ishit juve? – i pyeti Xhovani kur erdhën më në fund.

- Kur erdhëm herën e parë dhe pamë që nuk ishit këtu, u kthyem prapë tek *Blazer*. Na bëtë merak, por pastaj pamë *Blazer* atje ku e lamë me bateri të shkarkuar. E morëm me mend që kishit gjetur makinë tjetër, kështu që edhe ne u kthyem mbrapsht, - tha Majkëll.

- Duket se gjithë bunkeri paska vendosur të vijë këtu për darkë. Më duket se do na duhet të presim shumë gjatë për të ngrënë, - tha Xhuzepe. – Unë them ta lëmë fare muhabetin e picave. Jemi në gjysmë të rrugës për te *La Piazza*, - shtoi.

- U tha, u bë, - ra dakord Majkëll dhe të gjithë filluam të ecnim ca më tej drejt *La Piazza-s*.

- U përpoqët edhe ju ta ndiznit *Blazer*? – pyeti Fabiola Majkun dhe Xhuzepen.

- Po. Misioni ynë ka disa prej tyre dhe të gjithë përdorin të njëjtin çelës, - u përgjigj Xhuzepe në anglisht.

- Po janë më se dhjetëvjeçarë, - shtoi Majkëll.

- Çfarë misioni është? – pyeti Fabiola.

- Po ta thamë, do na duhet të të vrasim, - u përgjigj Majkëll me shaka dhe shokët e tij italianë filluan të qeshnin.

- Një mision i rëndësishëm, - shtoi Xhovani.

- Zëre se nuk pyeta, atëherë, - u përgjigj Fabiola.

- Është një mision i OKB-së, - tha Xhuzepe.

- Unë e di që ke mësuar ca shqip tani. Po italisht flet apo kupton ndopak? – e pyeta Majkun, megjithëse ma merrte mendja që nuk kuptonte.

- Di ca spanjisht që më ndihmon pak me italishten, po jo dhe aq, - u përgjigj Majkëll. – Flasin shumë shpejt.

- Pa le dialektin, - u hodh Xhovani nga e djathta ime. - *Nord, sud*.

- Mirë që flasin italianët anglisht, atëherë, - u përgjigja. – Ku ke mësuar spanjisht? – pyeta Majkun sërish.

- Ma do puna të udhëtoj nëpër shumë vende të Amerikës së Jugut, zakonisht nga një muaj.

- Sa qejf!

- Me raste, - u përgjigj Majkëll.

Shyqyr që kisha Fabiolën me vete, e cila e fliste italishten rrjedhshëm. Po shpresoja të kishte bisedë të mjaftueshme për të tre italianët, ndërsa unë flisja anglisht me Majkëll, por Xhovani më rrinte mbi kokë gjithë rrugën për te *La Piazza*. Na ndërpriste bisedën me komente ose pyetje në italisht dhe mua kjo më dukej pak e pahijshme kundrejt Majkut, meqenëse ai nuk kuptonte pothuajse asnjërin prej tyre. Unë vazhdova t'i përgjigjesha në anglisht. Po velesha me vëmendjen e Xhovanit për atë natë. Nuk e kisha menduar se do të më lodhte aq shpejt.

Sapo mbërritëm tek restoranti, përshëndetëm disa të tjerë nga misioni i Majkut, që po prisnin për një tavolinë, dhe u futëm brenda në të njëjtën kohë.

Një kamarier i ri, shumë simpatik, i veshur me një këmishë me jakë të bardhë e jelek atllasi të zi, na hoqi rrugën për tek tavolina më e madhe në një dhomë më vete në fund të restorantit. Rrugës për tek tavolina, kaluam përpara violinistit më të famshëm në vend, që kishte qenë profesionist me Ansamblin e Ushtrisë Popullore dhe tani po luante ëmbëlsisht këngë popullore me orkestrën e tij në qendër të restorantit.

- Fabiola, shiko! – thashë e shtangur nga prania e një artisti kaq të shquar në një vend kaq të rëndomtë sa një restorant. Majkëll ngadalësoi hapat me mua dhe hodhi sytë nga orkestra. – Violinisti është me famë të madhe, - i shpjegova Majkut. – Se si më duket që e shoh të japë shfaqje gjëkund tjetër nga skena kombëtare.

- Uaa, vërtet! – miratoi Fabiola, por vazhduam për tek tavolina. – Qenka shpërbërë ansambli!

Majkëll u ul në një karrige në të majtën time dhe Fabiola në të djathtë. Pasi kamarieri mori porosinë, orkestra filloi të luante këngët më të dashura popullore njëra pas tjetrës. Unë e Fabiola u pamë sy në sy dhe nuk duruam dot më. Pa thënë asnjë fjalë, filluam të këndonim me dy zëra, që mua m'u dukën në harmoni të përkryer. Sa më mirë që tingëllonim, aq më trime dhe më të vendosura bëheshim në zë. Kisha tmerr të shikoja rreth e rrotull tavolinës në fytyrat e të huajve të tjerë, por fytyrat e qeshura të Xhuzepes dhe Xhovanit po rrezatonin admirim në të djathtë të Fabiolës. Edhe pse nuk kuptonin asnjë fjalë nga ato që po këndonim, mua më dukej se po u pëlqente shumë shfaqja jonë. Dalëngadalë, tingujt e orkestrës po bëheshin më të dëgjueshëm, sikur po afroheshin. *Oh, po vij në këtu!* Ia tregova Fabiolës me gisht që të kthehej t'i shikonte, ndërsa vazhduam të këndonim, tashmë të shoqëruara nga muzika

e gjallë e violinistit më të zotë në komb. Dikush nga tavolina jonë kishte shkuar të sillte orkestrën që të na shoqëronte. Po ndjeja gjakun e ndezur në fytyrë në fund të këngës, kur filluan të duartrokisnin e fishkëllenin për mua e Fabiolën të gjithë në tavolinë.

- Paske zë shumë të bukur, - tha Majkëll. Tani i ishin tharë flokët dhe dukeshin të verdha me disa baluke të përdredhura kaçurrel mbi ballin e tij të ngushtë por të lartë.

- Falemnderit! Më vjen keq, po nuk mund t'i rezistonim! Ato që kënduam ishin këngë dashurie të kënduara sipas traditës nëpër dasma. Më vjen keq që nuk mund të kuptoni fjalët, se ato janë gjysma e bukurisë së këngës, - iu përgjigja.

- U kënaqa, gjithsesi, - ma priti Majkëll.

Argëtimi, të qeshurat dhe vëmendja vazhdoi për disa orë, siç kaluam nga restoranti tek diskoteka për të kërcyer. Sa më gjatë që rrinim, aq më e dukshme po bëhej vëmendja e Majkut ndaj meje. U ndjeva e bukur dhe në qendër të vëmendjes sërish. Më në fund, kur vura kokën mbi jastëk atë natë në dhomën e konviktit, u kujtova që nuk kisha menduar për Teon për një mbasdite të tërë. Akoma nuk më ishte dhënë rasti për t'i thënë Fabiolës ëndrrën time të fundit. “Ndoshta herës tjetër. Kush e di ç'plane të marra kanë kurdisur Omari me Davidin për fundjavën tjetër”, - mendova në mirëpritje të argëtimit.

- E gjen dot kë pashë sot? – pyeti Fabiola disa ditë më vonë, kur u takuam pas pune.

- Kë? – pyeta me kureshtje.

- Xhuzepen.

- Ou, - ia prita paksa e zhgënjyer. *Pse mendoi se më intereson?* – Edhe? – vazhdova e paqartë.

Xhuzepe kishte qenë shumë i sjellshëm atë natë, por nuk kisha vënë re asgjë më tepër se sa mirësjellje. Pastaj, ai ishte më i shkurtër se unë . . . po të më duhej të merrja me mend ndonjë, do të ishte Xhovani. Ai dukej sikur nuk më ndahej atë natë. *Oh! Sa egoiste që jam! Ndoshta i pëlqen Fabiolës.* – Ju të dy do të shkonit shumë si çift! – u shpreha me gëzim.

- Jo, jo! – u përgjigj Fabiola. – Është i zënë.

- Vërtet? – pyeta e zhgënjyer. – Nuk më vajti mendja.

- Nuk është i martuar, vetëm i fejuar, po e gjen dot si e mora vesh?

- Jo. Si? – pyeta akoma pa kuptuar. Nuk mund të kuptoja se ç'kishte të bënte me mua apo edhe Fabiolën, fejesa e Xhuzepes.

- Filluam të llafoseshim dhe pastaj ai më pyeti për ty: “Si ka mundësi që Mirela nuk ka akoma ndonjë të dashur?”.

- Kur i bëtë gjithë këto muhabete?

- Atë natë, mbas darke te diskoteka. Ti po kërceje.

- E çfarë i the?

- Të vërtetën, - u përgjigj Fabiola. – Po nuk ma vuri veshin fare. Ai tha që po të mos kishte qenë i fejuar me një vajzë që e donte shumë, do të të kishte marrë hopa, pa diskutim. Tha që ti je nga ato lloj femrash që merret për grua.

- Vërtet? Më bëhet qejfi! Por...

- Nejse, pjesa më e rëndësishme është arsyeja që po fuste hundët, - ndërpreu Fabiola.

- Po hë, de. Pse? Kur vetë është i rregulluar.

- Po futej për Majkun.

- Edhe ai nuk është i martuar, apo jo?

- Jo. Më siguroi Xhuzepe. Tha edhe që Majkëll është nga ata të forcave speciale amerikane që kur u jepet urdhri të hidhen nga gradaçela, e zbatojnë, bien më këmbë dhe vazhdojnë marshimin.

- Më shkrive, - qesha. – Kështu i përshkruante im atë nazistët.

- Më duket se tha që në Amerikë quhen Fokat e Marinës. Majkëll kishte dhe të forta.

- E kapa kaq gjë. Gjatë darkës, unë kisha ulur kokën të shikoja çorapet, se ndjeva që u kapën te tavolina, kur ngacmoi Majku: “Ça po kërkon?” dhe unë ia prita: “Më duket se po më ikën fija e çorapes”. Pastaj ai u përgjigj: “Dal’ ta kap unë”. Ti e di që unë aq dua për të qeshur, sidomos pas një çikë vere apo një birre.

- Xhuzepe tha që Majku të pëlqen shumë, po ti duhet ta kesh marrë me mend aq gjë tani. I biri i botës as që uli sytë një herë; as te pjata e vet. Mund t’i kishin dhënë gurë për të ngrënë dhe ai do t’i kishte kullufitur. Nuk t’i shqiti sytë asnjëherë!

- Ku i pe gjithë këto gjëra ti? Si më shpëtuan mua?

- Kur po këndonim bashkë; unë e shikoja në krah tënd.

- E pashë që po ma varte rëndshëm, po ashtu po bënte edhe Xhovani. Sa të ngatërruara!

- Xhovani është i martuar.

- U legeni! Po ç’dreqin do, pastaj? Ti i paske bërë detyrat mirë! Edhe unë kujtoja se mblesëria është art në humbje. Epo kot e kanë, se mua nuk

më pëlqen as njëri as tjetri, - iu përgjigja pa mundur ta fshihja zemërimin e papritur.

- Mos ngaqë je akoma duke menduar për Teon?

- Ndoshta, - ia prita duke kuptuar që Fabiola nuk e meritonte tonin tim. – Nuk më ndahen ëndrrat. Më ndodhi prapë para ca netësh.

- Qysh e pe? – pyeti Fabiola.

- Thjesht duke ndenjur më këmbë përballë meje në distancë dhe tha: “Kthehem në shtator”.

- Ah, Mirela, moj zemër! – ma priti Fabiola. – Ashtu i ndodhi edhe një shoqes tjetër që kam. Pati një ëndërr kështu si e jotja, sikur i dashuri i saj po kthehej nga Greqia.

- Edhe?

- Asgjë. Ajo e priti për shumë kohë, po ai nuk u kthye kurrë.

“E çë pastaj?” – mendova me vete, por fara e dyshimit ishte mbjellë dhe unë po e lejoja të rritej me çdo ditë që kalonte. E besova ëndrrën dhe nuk kisha dyshim që ai do të kthehej. Problemi ishte: ja, u kthye, çfarë do të bëja unë pastaj? Fillova të analizoja gjithë skenat e mundshme me sy praktik për herë të parë.

Po sikur të kthehej dhe të vinte të më takonte? A nuk do të priste të reagoja siç kisha bërë shumicën e rasteve që ishim bërë bashkë në të kaluarën? Po të mos rezistojta dhe t’i jepesha dëshirës së tij, a nuk do të ishte kthim në jetën e mëkatit me ndërgjegje të plotë? Si qeni që i kthehet së vjellës së vet? Nuk do të rrezikojta shpëtimin e pamerituar? Para shpëtimit tim në Krishtin, e dija që ç’ka po bëja ishte gabim. Por tani që më ishin hapur sytë, që kisha shijuar dhuratën hyjnore, isha bërë pjestare në Frymën e Shenjtë, kisha shijuar Fjalën e mirë të Perëndisë dhe mrekullitë e jetës së ardhshme, do të ishte sikur po e poshtëroja dhe kryqëzoja nga e para birin e Perëndisë. Nuk më dilte nga mendja Hebrenjve 6:4-6. Pjesa më e frikshme e këtij skenari ishte që do të ishte e pamundur për mua, po të bija në tundim, të sillesha sërish në pendesë.

Nga ana tjetër, nuk mund ta përmbaja veten dhe t’ia mohoja kontaktin fizik pa pasur frikë keqkuptimin e tij ndaj shndërrimit tim të mirëfilltë si manipulim për ta detyruar të martohej me mua. Dhe vetë e kisha fajin për këtë. Le të bërtisja “Ujku!” sa të doja (i shkreti Berti po të më kishte dashur vërtet!). Gjithsesi, nuk mund të merresha me të njëjtën lojë torturuese përsëri.

Skenari im i tretë do të ishte që Teo kthehej, më besonte që shndërrimi im ishte i mirëfilltë dhe pranonte të vazhdonte me martesën. Martesë!

Uou! Mendja ime nuk kishte qenë kaq zanore për këtë më parë. Sikur më kishte ngulur sytë: “Ja ku jam. Po tani çfarë do të bësh?”. Prapë nuk mund të martohesha me një të pafë. Do t’i duhej edhe Teos të kalonte përmes të njëjtit shndërrim, sepse Bibla thotë: “Mos hyni në një zgjedhë bashkë me të pafetë, sepse ç’lidhje ka drejtësia me paudhësinë? Dhe çfarë afrie ka drita me terrin? Dhe ç’harmoni ka Krishti me Belialin? Ose ç’pjesë ka besimtari me jobesimtarin?”.

Nuk mund ta përfytyroja kurrë një person kokëfortë, inteligjent dhe krenar si Teo të përulej ndonjëherë para Perëndisë dhe t’i kërkonte falje. Dhe nëse nuk mund ta bënte atë, do të thoshte secili në udhë të vetë përsëri. Edhe ideja e të priturit përgjithmonë më dukej më e lehtë sesa të kaloja nëpër një ndarje të dytë.

“Kam humbur rrugën, o Zot! U lodha duke pritur, me plaçka në krah sa nga një dhomë konvikti në tjetrën. Dua një shtëpi timen dhe një burrë herët se sa vonë; nuk dua të pres deri në shtator sa për të m’u këputur shpirti prapë. Po sikur të ma gjesh ti burrin këtë radhë, o Perëndi? E di që të besoj ty më shumë se veten për të gjetur atë që më përshtatet. Ti e shikon të gjithë tablonë nga lart; fillimin dhe fundin. E provova vetë dhe bëra një lëmsh të madh”, - u luta dhe m’u kujtua ëndrra që pashë me mamanë e Teos duke më ftuar në shtëpi. *Domethënë kështu e refuzova atë dhe të birin. Ëndrra merr kuptim të plotë tani.*

Në vend që të shkoja tek ambasada amerikane për mbrëmjen e së premtes në bunker, unë e Mira shkuam te lokali pa emër për t’u takuar me Fabiolën. E gjetëm te tavolina me shokët e saj: Braçen, Eduardin dhe Gentin, duke diskutuar një udhëtim për në Vlorë, qytetin e bukur bregdetar në gji të Karaburunit.

- Ide fantastike! Me se do të shkoni? – pyeta.

- Mos deshe të thoshe me se do të shkojmë? – më korrigjoi Genti dhe unë u kënaqa që isha përfshirë në këtë bërthamë të ngjeshur karagjozësh. Tani që kisha provuar hidhërimin e refuzimit, isha gjithnjë e kujdesshme për të mos u futur atje ku nuk isha e mirëpritur. Doja të sigurohesha që dëshira e tyre për të qenë në shoqërinë time ishte më se e qartë. – Me mashinën time, - vazhdoi.

- Do të vijmë edhe ne? – pyeti Mira.

- Sigurisht, - tha Eduardi.

- Si do na nxërë të gjithëve? – pyeta unë.

- Me të ngjeshur! – tha Braçe. – Do bëjmë vend për ju të dyja.

- Si sardelet në kanoçe, - shtoi Eduardi. – Pastaj, kjo mashina e ka bagazhin goxha të madh.

- Un' nordh për içik det. T'u rrit' nera, or tëi! – thashë duke pritur gjithë dëshirë një udhëtim që do të thyente monotoninë për disa orë.

U nisëm të nesërmen në mëngjes. Genti po ngiste makinën dhe shakatë, ndërsa Braçe ishte ulur në anën e pasagjerit, mu përpara meje. M'u duk sikur isha kthyer mbrapa në kohë, në ditët e fakultetit me shokë si vëllezër. Pa mendje, si me refleksin e të ngrënit, mbërtheva muskujt e qafës dhe të supeve të Braçes dhe fillova ta ndrysha.

- Oh! – rënkoj. – Sa me fat jam!

- Nuk është e drejtë, - tha Genti sapo e vuri re. – Unë po bëj gjithë punën këtu.

- Jam e sigurt që Eduardi ka duar më të forta se të miat, - ia prita. – Ai kot po rri mbas teje.

- Unë i kam duart e zëna, - tha Eduardi duke shkelur syrin, me krahun e shtrirë mbas supeve të Mirës që ishte ulur pranë tij.

Pas disa orësh udhëtimi drejt jugut, ndalua për të shtrirë pak këmbët dhe për të ngrënë drekë te një restorant në mes të një pylli pishash përgjatë rrugës. Pastaj vazhduam drejt jugut dhe mbërritëm në Vlorë mbas dite vonë. Deti ishte i qetë dhe blu i thellë duke lëpirë shkëmbinjtë e bregut nën restorantin ku kishim vendosur të hanim darkë.

- Ju vjen keq të futem një çikë shpejt e shpejt para se të erret? – pyeta dhe fillova të dilja nga rruga, tatëpjetë shkëmbinjve masivë nën rrugë.

- Ç'bën, moj? – ma priti Braçe menjëherë dhe pothuajse vura re alarm në zërin e tij. – Është ftohtë! Do ftohesh!

Tingëllonte tamam si vëlla i madh, asnjë nga të mitë, po prapë.

- Mos e vrit mendjen për të, - ndërhyri Fabiola. – Ajo ka parë edhe më ftohtë. Tani është praktikisht pranverë për Mirelën.

Hoqa xhinset dhe bluzën dhe u shtriva ngadalë mbi ujë vetëm me rrobat e banjës ngjyrë blu saks.

- Paske ardhur e përgatitur! – vuri re Braçja duke më ndjekur nëpër shkëmbinjtë e mëdhenj poshtë rrugës.

- Patjetër. Nuk lë udhëtim pranë detit të më vejë dëm.

Notova disa metra para se të kthehesha në shpinë kur pashë Braçen tashmë në ujë duke notuar drejt meje.

- Ça bën, ore? Nuk është se do ta bësh ujin më të ngrohtë, - i thashë. – E de, e, mbarova. Desha sa të futesha vetëm për një çikë, - thashë dhe fillova të notoja drejt bregut për të shmangur afërsinë me të në ujë. Ai u kthye mbrapsht dhe të dy kaluam nëpër shkëmbinjtë për tek bregu me guriçka nën rrugë. Fshiva më të shumtën e ujit me duar dhe kërceva pupthi në vend për disa sekonda para se të vishesha.

Pastaj iu ngjitëm të gjithë një rrugice të ngushtë, të shtruar me pllaka guri, me palma të mëdha në të dyja anët, degët e të cilave na vareshin mbi krye. Rrugica të çonte drejt e tek restoranti me pamje nga rruga gjarpëruese dhe deti i gjerë e i thellë nën të.

- Oh, kjo pamje të lë pa frymë! – thashë, siç u ulëm për të ngrënë të gjithë bashkë. Braçe hoqi xhaketen e tij dhe ma hodhi shpatullave.

- U rrofsh, po nuk është dhe aq ftohtë, - thashë duke kërcëllitur dhëmbët dhe duke menduar: “E kaloi trishtimin për humbjen e të dashurës ky apo thjesht po i vjen keq që kam ftohtë?”.

- Vërtet? – ma ktheu Braçe, duke më ndërprerë zinxhirin e mendimeve të paudha.

- Pastaj, ti je ujë për vete, - iu përgjigja.

U kthyem në Tiranë vonë të shtunën në mbrëmje me kohë të mjaftueshme për të pushuar para se të shkoja në kishë të nesërmen.

Edhe pse u sigurova që të mos më ndalte asgjë për në kishë atë të dielë, prapëseprapë mbërrita me vonesë për shërbesën. Lavdërimi dhe adhurimi i hapjes nga grupi i vajosur i këngëtarëve të rinj që ma çonte shpirtin peshë sa herë i dëgjoja kishte mbaruar.

Këtë radhë, kur hyra në kishë, dëgjova predikuesin e ri shqiptar duke thënë: “...sepse do të bëjmë shumë dasma në këtë kishë këtë vit” dhe mua m’u drodh zemra. “Amen!” – bërtita me besimtarët e tjerë, ndërsa eca midis radhëve të stolave, dhe e dija që Ai e kishte fjalën për dasmën time. *Zoti i qiejve dhe tokës po më flet sërish! Po i përgjigjet lutjes sime të javës së kaluar për një burrë. Kush e di kush do të jetë!*

Sikur të mos kishte mjaftuar vëmendja e dy tre fundjavave të fundit prej amerikanëve, italianëve dhe Braçes, takova rastësisht Nardin që më dha të falat më të përzemërta nga Mauricio.

- Të fala pastë! – ia prita me habi. – Më mbaka mend?!

- Të mban mend the? Burri i botës po luan mendsh për ty!

- Që kur kështu? Ai sikur ishte mirë kur e pashë për herë të fundit, bile ca si i ndrojtur.

- I bëre goxha përshtypje.
- Qysh? Unë mezi fola gjithë kohën. Ai mezi foli.
- Nuk e di se si, por është duke ardhur së shpejti dhe do të të takojë prapë,
- tha Nardi.
- Nuk ma do mendja, Nardi. Nuk merrem me të huaj. Nuk di si të them “të keqen” në italisht.
- Mos! Do dërrmohet fare.
- Më vjen keq! – i thashë, por nuk e kisha sinqerisht. Nuk ndjehesha fare përgjegjëse për ndjenjat e lënduara të Mauricios. Nuk më dukej se kisha bërë ndonjë gjë për t’ia ushqyer.

KAPITULLI XX

NJË PREMTIM I RI

Kur më erdhi ime më në fillim të shkurtit, kisha marrë rrogën e parë në punën e re. Ia dhashë lajmin e mirë me gëzim dhe shtova: “Nuk ke pse shqetësohesh më për pajën time”. Po mami nuk ishte në qejf për shakatë e mia dhe ma ktheu: “Shyqyr! Një shqetësim më pak nga lista. Kemi pa mbuluar gjysmën e shtëpisë akoma”.

- Mbase më bëhet kontrata e përhershme dhe pastaj mund të ndihmoj pak. Shiko, ma, - i thashë siç hapa Biblën tek psalmi i parë. – Më premtoi Perëndia që do të bekojë çdo gjë që prek me dorë, – thashë dhe i lexova psalmin nënës sime.

- Amin, o Zot! – miratoi mami.

- Kur të vij në shtëpi, do vete nga banka që të tërheq paratë që solla nga Greqia. Përdorni ato për të mbuluar shtëpinë, - i premtova.

- Meqë përmende pajën, t’u dha rasti ta vishje atë fustanin që të qepi mami i Edit? – pyeti mami.

- Jo. Për pak e vешa tetorin e kaluar, por m’u desh të punoja. Them ta vesh për ditëlindje.

- Uu, po! Mirë që më kujtove. Yt atë më ka dërguar me ultimatum këtë radhë: “Thuaji çupës të martohet këtë vit! Edhe për një çikë mbush njëzetepesë,” – tha.

- Pa diskutim, ba! Ja dal’ të nxjerr një burrë nga xhepi.

- E di, e di, po ka merak ai, - tha mami.

- Për mua apo për vete? Se mos i ngelem në derë apo *n’katuat*? Thuaji mos të ketë merak fare! Nuk kam ndërmend të kthehem në shtëpi.

- Mos, o Zot! Pse nga ato je ti? Ty të ka nëna të bukur, të gjatë, si sorkadhe. Kush nuk të merr ty? Ai e ka fjalën që nuk po rinohesh. Mos e mbaj hundën përpjetë, po të doli ndonjë rast i mirë.

- Mirë, o ma, mirë.

Gjithë mbrëmjet dhe argëtimet e fundit më kishin bërë të ndjehesha e begenisur; aspak siç kishte frikë im atë se po katandisesha. Megjithatë, isha e ndërgjegjshme që nuk do të zgjaste për shumë kohë. Tani për tani, do të gëzoja gjithçka me të cilën Perëndia më kishte bekuar dhe do ta lëvdoja për çdo dhuratë, me gjithë punën time të re.

Po ecja e lumturuar në bulevardin kryesor për në kishë, kur dëgjova një zë të njohur që po më thërriste nga mbrapa atë mëngjes të freskët të një të diele shkurti. Ktheva kokën dhe pashë vetë personin për të cilin i kisha folur Teos gjithë natën në Pogradec.

- S'ka mundësi! – pothuajse bërtita. – Të përfytyroja në skajin tjetër të botës tani. Apo në Greqi? Le që atje është e dashura, apo jo? Oh, prit! Harrova që ajo shkoj atje me të fejuarin, me të cilin u fejua ndërsa ishte akoma duke dalë xhiro me ty, apo jo?

- Gëzohem që të shoh edhe unë! – tha Altini buzagaz, duke u përpjekur të evitonte një temë që dukej ende e pakëndshme edhe për të. – Dukesh mirë! – vazhdoi.

- Duhet të dukem goxha mirë, po doli nga goja jote.

- Unë gjithmonë kam menduar që ishe e pashme. Nuk ta kam thënë më parë? – pyeti në mbrojtje.

- Në fakt, më the një herë. Kishte të bënte me trupin tim ose me fustanin e ngushtë që kisha veshur tek e njëjta mbrëmje ku ishe edhe ti në fillim të vitit të katërt. Por unë kujtova se po më manipuloje për diçka që doje prej meje, gjë që më bën të vras mendjen: “Po tani, çfarë do?”

- Asgjë! Thjesht të pashë dhe desha të të përshëndesja. Nuk ma mori mendja se do më mbaje akoma mëri.

- Nuk kam mëri, në fakt. Vetëm një çikë sarkazëm. “Hakmarrja më takon mua”, – thotë Zoti, - “unë kam për të shpaguear”.

- Mos! Të paskan gjetur edhe ty?

- Pse, edhe ty? – pyeta duke rrezatuar ngazëllim.

- Oh, jo, jo, jo! – ma mohoi menjëherë. – Krishtërimi nuk është për mua. Megjithëse u përpoqën.

- Edhe?

- Edhe asgjë. Vështirë ta përtyp.

- Çfarë ke kaq të vështirë?

- E kuptoj pjesën e Perëndisë, po Jezusi ç'hyn këtu? Si futet në të gjithë këtë “ekuacionin e Perëndisë”?

- Jezusi është biri i Perëndisë! – ia prita unë duke mbledhur vetullat. – Çfarë ka të vështirë këtu?

- Çfarë do të thotë kjo? Si funksionon në sferën hyjnore?

- E ke parasysh; biri i Perëndisë si në “farën” e Perëndisë.

- Ohohoo! – bërtiti Altini dhe hodhi kokën mbrapa duke qeshur me mosbesim. – Nuk më besohet ç’më dëgjuan veshët.

Qesha edhe unë dhe nuk më besohej as vetë që e kisha thënë, por e mblodha veten për një moment dhe vazhdova: “Perëndia bëri gjithë botën. Pse është kaq e pabesueshme për ty që të ketë një bir? Ai bën çfarë të dojë. Është Perëndi. Nuk më ka borxh ndonjë shpjegim. Pastaj, unë as që e vras mendjen për gjërat teknike”.

- Kurse unë po. Ti e di që jam inxhinier. Edhe ti je.

- Uuuuu! Nuk ta hedh dot njeri ty! – e përqesha. – Epo unë jam me fat që nuk ma priste dhe aq dhe tani as që e përdor zanatin.

- Ku po punon?

- Po përkthej për fondacionin Soros. Po ti?

- Unë jam akoma në kërkim, - u përgjigj Altini.

- Lutju Zotit. Unë iu luta dhe Perëndia m’u përgjigj, kështu që jam nisur rrugës për ta falenderuar tani dhe çdo të dielë.

- Ku?

- Në kishë. E imja mblidhet tek kinema “Agimi”, po sot po shkoj te kisha e një shoqeje. Më pëlqen një çikë më shumë pastori i tyre. Do të vish ta provosh?

- Mirë, - pranoi Altini dhe më shoqëroi për mbetjen e rrugës deri te kisha.

- Unë thjesht nuk e marr vesh se çfarë humbet robi nga të besuarit. Unë veçse bekime kam parë që kur e kam vënë besimin tek ai, - vazhdova.

- Nuk më duket se e kemi në dorë të zgjedhim në besojmë a jo. Është dhuratë që e ke ose nuk e ke. Nuk më duket se jam bekuar nga natyra me të.

- Ke folur si besimtar i vërtetë. Edhe unë vras mendjen për këtë ndonjëherë. Besojmë se na ka zgjedhur Perëndia dhe ashtu e ka shkruar që nga fillimi apo besojmë një herë, dhe prandaj zgjidhemi të jemi pjesë e përjetësisë me të? Sido që të jetë, unë jam shumë mirënjohëse që jam brenda.

U futëm në shenjtërore së bashku dhe qëndruam më këmbë mbrapa radhës së fundit të ndenjësive. Nuk m’u desh shumë kohë para se të mbështillesha në adhurimin e gëzueshëm të bashkëbesimtarëve të tjerë dhe nuk e vura re deri më vonë që Altini nuk ishte më pranë meje.

Herën tjetër që e pashë Altinin sërish, ishte në një mbrëmje të ftohtë e të lagësht në fillim të marsit. Unë sapo kisha marrë rrogën e dytë; ishte pothuajse dyfishi i rrogës së parë. Nuk më pritej të jepja të dhjetën sërish dhe të shikoja si do të më bekonte Perëndia herën tjetër.

Ishte shumë çudi të dëgjoja emrin të më thirrej nëpër korridoret e konviktit si gjatë ditëve studentore. Shkova përmes korridorit të gjatë për tek dritarja e banjës që të shikoja hyrjen e godinës, por të gjithë çunat ishin nën strehën e gjerë ose nën çadrat e mëdha të zeza. Dola poshtë dhe pashë Altinin duke pritur para hyrjes.

- Qenke ti! – thashë me çudi. *Po tani, ç’do?* – Të kërkova te kisha, po ti u zhduke.

- Ee, nuk desha të të shkëpusja nga adhurimi pasionant. Ika pa u ndjerë.

- Aha. Mirë, pra; tani e di ku mblidhet kisha, kështu që mund të shkosh edhe vetë. Si je?

- Mirë. Erdha të të them që gjeta punë.

- Aleluja! Mrekulli! – u gëzova, po prapë nuk e kuptoja pse zgjodhi ta ndante lajmin me mua. *Ndoshta as këtij nuk i kanë mbetur dhe aq shumë miq këtu nga të shkuarit.* Në fund të fundit, mërguan shumë më tepër djem se sa vajza.

- E kam rrogën 200 dollarë në muaj, - tha Altini dhe filloi të rrihte mbi pëllëmbën e majtë një tufë mijëshesh.

- U të lumtë! – ia prita.

- Po ti, sa e ke rrogën? – pyeti Altini.

“Aha! Prandaj paske ardhur këtu; për të krahasuar të ardhurat e për të ma bërë gixili!” – kuptova me shpejtësi dhe nuk e mbajta dot një nënqeshje të lehtë. *Nuk më besohet që kisha rënë brenda për këtë njeri dikur.* Iu zvogëlua koka dy masa në sytë e mi. “Nuk mund t’i zë besë vetes, o Zot! Të lutem, zgjidhe ti këtë radhë. Me siguri!” – thashë një lutje të shpejtë me vete dhe u përgjigja me sy të rrudhur, sepse e dija që dhjetë dollarët e mi më tepër do ta dërrmonin egon e tij të sëmurë. – Dyqindedhjetë, po më filluan me njëqindedhjetë muajin e parë. Mund të ta ngrenë rrogën muajin tjetër. Unë i dhashë Perëndisë të dhjetën e parë të rrogës së parë dhe Perëndia pothuajse ma dyfishoi muajin e dytë. Ka thënë Jezusi që atyre që janë besnikë me pak, do t’u zihet besë me shumë. Perëndia e mban fjalën gjithmonë, - vazhdova me një frymë, në përpjekje për të zbutur goditjen dhe për t’i dhënë lavdinë Perëndisë në të njëjtën kohë.

- Apo jo, ‘re! – m’u përgjigj Altini dhe unë sepse pata një ndjesi që nuk

kishte ardhur për të më thënë vetëm këtë. – Po tjetër, me se po merresh tani? – vazhdoi, ndërsa hodhi një sy të shpejtë nga shiu. *E pabesueshme!* Po të mos kishte qenë për shiun, Altini do të më kishte kërkuar të dilja me të. Sa e sa netë të tëra e kisha pritur dhe uruar të vinte të më thërriste dhe tani që ishte këtu as që më bënte përshtypje. Hm!

- Hiç, asgjë, - ia prita, - punoj gjatë javës, kërcej me shokë në fund të javës dhe me Perëndinë të dielën. Jeta është e mirë. Perëndia është i mirë!

- Interesante! Ku kërcen me shokë?

- Ka pas filluar tek ambasada amerikane kohët e fundit pastaj ka vazhduar nëpër restorante dhe disko më mbrapa.

- Si futesh në ambasadë?

- Me miq, - u mburra me kokën e ngritur mënjanë. – Bëjnë edhe plot gjëra të tjera qejfi; megjithëse nganjëherë vrapojnë me orë të tëra si della pa ndonjë vendmbërritje apo arsye të veçantë dhe e quajnë qejf. Javën që shkoi, shënuan një shteg pesëkilometërsh nga plazhi i Durrësit, - llogotita pastaj kuptova që e kisha keqësuar edhe më një situatë që filloi keq. Jo vetëm që po merrja më tepër para se Altini, por dukej se edhe po argëtohesha më tepër.

- Të lumtë! – u përgjigj ai, por unë e dija që në të vërtetë donte të thoshte: “Gjynah që nuk je më ajo nevojtarja e ngjitur, e varur që mbaj mend unë, e cila priste në dhomë gjithë mbasditen dhe gjithë mbrëmjen që t’i trokisja në dritare!”. *Jo-o, nuk jam më, sepse Biri më ka çliruar, dhe jam e lirë vërtet! Nuk e kam lënë më në dorë të njeriut të më lumturojë. Më lumturon Krishti!*

- Po bëhet vonë dhe ftohtë. Po futem brenda tani, - i thashë. – Urime edhe një herë! M’u bë qejfi vërtet për ty!

- Shihna vërdallë, – tha Altini dhe u kthye drejt shiut të butë nën çadrën e zezë. U ngjita lart për në dhomë duke qeshur me ndjenjën e hakut të marrë dhe fajit, në të njëjtën kohë.

U shtriva në shtrat dhe hapa Biblën për të lexuar racionin e darkës. Ra hapur në tregimin e Ruthit dhe gjëja e parë që më kapi syrin ishte një titull: “Ruthi martohet me një burrë bujar”. Nuk e mbajta dot të qeshurën ndaj një konfirmimi tjetër të premtimit të Perëndisë për një burrë për mua. Vazhdova të lexoja të gjithë tregimin atë natë. Ishte një histori mahnitëse e hidhërimit të mbuluar nga një dashuri pa kushte, besim dhe shpengim.

Herën tjetër që lexova Biblën, ra hapur tek kapitulli i tetë i Ligjit të Përtërirë. Kur arrita tek vargu i gjashtë, filloi të më rrihte zemra gjithnjë e më fort.

“Prandaj zbato urdhërimet e Perëndisë, të Zotit tënd, duke ecur në rrugët e tij dhe duke ia pasur frikën; sepse Zoti, Perëndia yt, po të sjell në një vend të mirë, një vend me rrjedha uji e me burime që dalin nga luginat dhe nga male; një vend me grurë dhe elb, me vreshta, me fiq dhe shegë; një vend me vaj ulliri dhe mjaltë; një vend ku do të hash bukë sa të duash, ku nuk do të të mungojë kurrgjë; një vend ku gurët janë hekur dhe ku do të rrëmosh bakër nga kodrat.

Kur të kesh ngrënë e të jesh ngopur, atëherë do të bekosh Zotin, Perëndinë tënd për vendin e bukur që të ka dhënë. Ruhë mirë të mos harrosh Zotin, Perëndinë tënd duke mos zbatuar urdhërimet e tij, dekretet e tij dhe statutet e tij që po të jap sot. E të mos ndodhë që, pasi të kesh ngrënë e të jesh ngopur dhe të kesh ndërtuar e banuar në shtëpi të bukura dhe kur të të jenë shumëzuar kopetë, argjendi e floriri, të të rritet mendja dhe të harrosh Zotin, Perëndinë tënd, ... e të thuash me vete ‘e kam ngritur këtë pasuri me forcat e mia dhe me duart e mia’.

Por kujto Zotin, Perëndinë tënd, sepse ai të jep forcën për të fituar pasuri për të ruajtur besëlidhjen për të cilën ai iu betua etërve të tu, ashtu siç është në fuqi sot.

Por në qoftë se ti harron Zotin, Perëndinë tënd, dhe shkon pas perëndive të tjera dhe u shërben atyre dhe bie përmbys para tyre, unë sot shpall solemnisht para jush se do të vdisni me siguri. Do të vdisni si kombet që Zoti zhduku para syve tuaj, sepse nuk i jeni bindur zërit të Zotit, Perëndisë tuaj.”

Sapo mbërrita në punë të nesërmen në mëngjes, telefonova Fabiolën për t’i thënë gjithçka më kishte thënë Perëndia një natë më parë. Edhe këtë radhë, ajo foli me zërin e arsyes së ftohtë, si një jorgan i lagur mbi zemrën time të zjarrtë dhe tha: “Po ai nuk e ka fjalën për ty në veçanti apo fjalë për fjalë. Për ne besimtarët e sotëm, toka e premtuar është parajsja që shkojmë me Krishtin, kur të kthehet për të na marrë të gjithëve”.

- Po i di, moj, i di të gjitha ato, po kjo m’u duk shumë më e gjallë. Më duket vërtet sikur Perëndia po më çon gjëkund, në një vend të përshkruar diku tjetër si vendin ku rrjedh qumësht e mjaltë, - ia prita duke u përpjekur të bindja shoqen për zbulimin dhe bindjen time të fundit. – Ndjehem e lehtë, si me pendë. Jam shumë e lumtur!

Kisha lexuar plot për profecitë e ardhjes së dytë të Jezusit dhe Fabiola kishte të drejtë biblikisht, por mua nuk më ishte mbushur mendja për zbatimin këtë radhë. Diçka në shpirt më thoshte që Perëndia po më bënte një premtim dhe një besëlidhje me mua dhe, këtë radhë, besimi im ishte i patundur si shkëmb.

Kur bëra bashkë gjithë premtimet profetike për burrë dhe tani këto të tokës së premtuar, fillova të mendohesha nëse njëra kishte të bënte me tjetrën; nëse, si përfundim, burri do të ishte i huaj. Sa qesharake! Sidomos ngaqë sapo e kisha përdorur pikërisht këtë sebeb për të refuzuar të ngratin Mauricio.

Sa u ngrys e premtja, mua filloi të më griste fyti dhe digjte balli. Në vend që të shkoja te mbrëmja e ambasadës, ndenja në dhomë dhe piva çaj të nxehtë. Mira vendosi të shkonte dhe, kur u kthye, më njoftoi që një grup nga të mbrëmjes kishin vendosur t'i ngjiteshin malit të nesërmen, të shtunën në mëngjes.

- Edhe po ra shi? – e pyeta.

- Diell a shi, - pohoi Mira. – E di ti që Majkëll ishte atje sonte? – tha Mira me sy të qeshur. – Ka shumë të forta!

- Kështu më thonë të gjithë. Do vejë dhe ai me të tjerët nesër në mëngjes? – pyeta me zë të ngjirur.

- S'besoj, - tha Mira.

- S'po shkoj as unë, atëherë, - vendosa. – Kam temperaturë. Ngjitja përpyjetë malit nëpër shiun e ftohtë me orë të tëra nuk më kruan fare si ide. Në fakt, them të iki në shtëpi nesër. Kam nevojë të më bëjnë hyzmet për një dy ditë, - thashë dhe ashtu bëra që të nesërmen në mëngjes.

Mami më bëri çaj dhe supë pule dhe më shërbeu gjithë ditën e shtunë dhe shumicën e së dielës. Deri të dielën mbasdite, më kishte ulur temperatura dhe unë isha sërish gati për trenin.

Mami më përcolli te stacioni i trenit për xhiron e “inkuizicionit” ritual, por sytë e saj të butë e të gjelbër gjithmonë më bënë të ndjehesha e detyruar t'i kënaqja kureshtjen me diçka. Nuk kisha ndonjë gjë konkrete përveç premtimit të Perëndisë dhe nuk më vinte mirë ta torturoja para kohe, por, në të njëjtën kohë, më duhej të dija çfarë do të mendonte për martesën me një të huaj.

Më duhej patjetër bekimi dhe miratimi i prindërve për zgjedhjen e burrit të ardhshëm, sepse mendoja që kushtëzonin trashëgimin e lumtur. Kisha dëgjuar mjaft histori fatkeqësish të sjella mbi martesë të pabekuara nga prindërit. Edhe leximet e fundit në Bibël ma kishin përforcuar nderimin e nënës e të babait si e vetmja porosi e shoqëruar me premtimin e një jete të gjatë e të begatë.

- Po ja..., - fillova ngadalë, pothuajse me përtesë. – Le që jo, jo, - ndalova dhe qesha me cep të buzës.

- Hë, hë, më thuaj, - u lut nëna me përgjërëm.

- Po ja, është një amerikan që më kanë thënë nja dy shoqe se tregon interes për mua. Po të ishte e vërtetë, si do ta prisje ti martesën time në Amerikë?

- Uuuu, jo! Është shumë larg! – tha mami dhe unë u çlirova. Në fund të fundit, nëse çka kisha lexuar ishte vërtetë qëllimi i Perëndisë për jetën time, miratimi apo mungesa e tij prej nënës sime do të ishte një provë e mirë dhe do të më hiqte barrën e vetvendosjes nga shpatullat.

- Mirë! Nuk e bëj. Mirë që të pyeta; që ta di se si mendon për këtë, - iu përgjigja.

Po iu deshën nënës sime vetëmohuese vetëm disa sekonda për të kuptuar që mosmiratimi i saj ishte për interesin e saj në vend që të ishte për timin dhe tha: “Jo, jo! Mos e prish fatin për hatrin tim!”.

- Ç’ta bën mirë babi kur të thotë “Haxhi pishmani”! – buzëqesha dhe u përkula përpara për ta përqaftuar. I hipa trenit dhe u ktheva në konvikt të dielën mbrëma.

Mbasditen e së premtes pasardhëse, vendosa të shkoja te apartamenti i Fabiolës dhe pastaj të shkoja me të tek mbrëmja në ambasadë. Ajo kishte marrë apartament në qytet pranë stacionit të trenit. Ishte pothuajse mug dhe trotuari ishte plot me njerëz që ecnin lart e poshtë. Ditët po zgjateshin e po ngroheshin. Rruazat e verdha të luleve nëpër pemët e mimozave po mbushnin me aromën e tyre rrugët e dashura të kryeqytetit tim përsëri. Pranvera ishte pothuajse këtu me gjithë ditëlindjen time të njëzetepesë, para së cilës, siç më kishte paralajmëruar kunata, nuk mund të martohesha. Por tani ishte vetëm pesë ditë më tutje dhe ideja papritur më mbështolli gjithë trupin si një batanie e ngrohtë leshi. Nuk mundesha më vetëm të ecja. Fillova të vrapoja duke përshkuar me dredha përmes turmës në ecje e me ndonjë sparkatë në erë në çdo pesë a gjashtë hapa.

Papritmas, pashë Majkun duke ecur përballë meje përkrah një të huaji tjetër dhe ngadalësova vrapin në hap. Majkëll nuk më vuri re derisa i buzëqesha dhe ia bëra me dorë në kalim, “*Hai*, Majkëll!”.

- Ou, *hai!* – ma ktheu Majkëll i kapur në befasi që më shihte kaq papritur në një vend kaq të parastësishtëm dhe ndaloi për të më shtrënguar dorën. – Ky është Bob! Punojmë bashkë në Vlorë, - prezantoi ai shokun e vet, një burrë të hequr, nga gjysma e dytë e të pesëdhjetave me mustaqe të thinjura që i fshihnin dhëmbët e parmë si prej lepuri.

- Gëzohem që u njohëm, Bob! – buzëqesha duke takuar edhe atë.
- Nuk po vjen te mbrëmja e ambasadës sonte? – pyeti Majkëll.
- Po vij. Po takohem me Fabiolën te shtëpia e saj, një herë. Banon mbas këtij hoteli. Pastaj do të vijmë të dyja andej.

- Mirë, atëherë, - u përgjigj Majkëll, - shihemi atje më vonë.
- Mirupafshim, - ia prita dhe vazhdova rrugën. Nuk më mbahej gazi dhe vrapi për rastësinë e çuditshme gjatë gjithë rrugës së mbetur për te Fabiola. Si ka mundësi?!

- Të kërkoja kur iu ngjitëm malit të shtunën e shkuar, - tha Majkëll më vonë atë mbrëmje, kur u takuam te bunkerit. – Shoqja e dhomës tënde erdhi.

- U zgjova me temperaturë atë mëngjes dhe vendosa të shkoja në shtëpi që të më merrte mamaja me të mirë. Por, para se të ikja, pyeta Mirën kur u kthye nga diskoteka një natë më parë, nëse do t'i ngjiteshe malit edhe ti dhe ajo nuk mendoi se do të shkoje.

- Ou, patjetër që shkova! U bënë bashkë disa miq shqiptarë me ca amerikanë që punojnë këtu dhe u takuam nga ora tetë te sheshi Skënderbej. I hipëm autobusit për njëzetë lekë deri te rrëza e Dajtit dhe pastaj u ngjitëm më këmbë. Po binte shi dhe unë isha vetëm me një bluzë dhe xhinset, po shkova gjithsesi. Na u deshën nja tri orë përgjatë një të përpjete të thepisur. Unë u regja, u bëra qull. Në majë të malit po binin flokë dëbore të mëdha e të rënda. Atje u ulëm në një restorant të vogël dhe morëm vesh që po kthehej një autobus për në Tiranë. I hipëm të gjithë duke u dridhur nga të ftohtit, kush më shumë e kush më pak.

- Ee, më tregoi Mira edhe për autobusin edhe sa ftohtë kishit gjithë rrugën.

- Edhe xhiroja me autobus ishte interesante, se autobusi ishte shumë i vjetër dhe pikonte gjithandej. Çudia më e madhe ishte që u kënaqëm, gjithsesi. Unë isha dhe një çikë i lodhur ngaqë kisha kërcyer deri në orën një të mëngjesit një natë më parë.

- Edhe ajo më shpëtoi. Nuk isha mirë.

- Mirë që ndjehesh mirë tani! Je e zënë nesër në mëngjes? – pyeti Majkëll duke më kapur në befasi. – Po më afrohet dita e nisjes dhe do të doja të shikoja disa nga muzetë kombëtarë në qytet. Do të m'i tregosh?

- Sigurisht, - ia prita jo dhe aq e sigurt. Do të ishte hera e parë që dilja me Majkun vetëm për vetëm. Të ngrënat nëpër restorante dhe kërcimet nëpër disko me gjithë grupin ishin shumë më të rehatshme se sa shoqërimi i Majkut vetëm nëpër qytet, qoftë edhe ditën. Nuk e dija pse ndjehesha aq në siklet.

Ndoshta ngaqë dukej si një takim i qëllimshëm, edhe pse i stisur si një detyrë përkthimi. *Ehu, iku ajo tani!* Ishte shumë vonë të ndërroja mendje.

Pas restorantit, pothuajse të gjithë u drejtuan për nga diskoteka. Unë kërceva këngën e parë me Majkëll, po nuk më la ndonjë mbresë me kërcimin e tij prej ariu, derisa më ngriti peshë në mes të pistës me krahët e tij të fortë dhe më hodhi në erë si pupël. Më kapi po aq me siguri në rënie dhe unë e gjeta veten duke shtuar listën imagjinare të të gjitha gjërave që më pëlqenin prej Majkut.

Erdhi Omari ku isha ulur ndërmjet vallëzimeve dhe filloi të bërtiste: “E di ti që po të vjen ditëlindja për pesë ditë?”

- E di. Kurse jotja për katër. Mezi po pres! – ia prita me zë po aq të lartë për t’ia dalë muzikës pastaj u ktheva nga Majkëll: “Unë e Omari kemi lindur një ditë nga njëri-tjetri”.

- E dije që e Xhovanit është një ditë pas tëndes? – vazhdoi Omari.

- Nuk e kisha idenë, - iu përgjigja.

- Do t’i kombinojmë të treja mbrëmjet në një.

- Do bëjmë mbrëmje? Mrekulli! – thashë me gëzim. – Do të ftoj gjithë shokët e mi. Kur dhe ku?

- Meqë bien të martë, të mërkurë e të premte, unë e Xhovani e biseduam dhe vendosëm të planifikojmë veprimtari për të shtunën pasardhëse. Si thua?

- Shumë mirë!

- Fola dhe me amerikanët dhe ata thanë që mund t’i kombinojmë me veprimtaritë e ambasadës për të shtunën. Do të shkojnë të gjithë te vilat e bllokut në Durrës gjatë ditës, pastaj kthehemi në Tiranë për ta mbyllur me pije dhe kërcim te diskoteka pranë Universitetit.

- Uuuuu! Edhe plazh, edhe kërcim? Aq më mirë! Atëherë, mund të vish edhe ti, Majkëll, si i ftuar i Xhovanit, - i thashë Majkut, kur u kujtova që ishin nga i njëjti projekt.

- Po, e di. Më ka ftuar tashmë, - u përgjigj Majkëll i kënaqur.

- Mrekulli! Ka për të qenë një mbrëmje e madhe. Ahhh! Apo s’kam edhe fustanin! Po do të jetë në dy vende të ndryshme. Do më duhet të bëj edhe një fustan tjetër gati, - vazhdova me ngazëllim, më tepër duke planifikuar me zë sesa duke folur me ndonjë në veçanti.

Vajti ora për ne konviktorët të ktheheshim dhe Majkëll ofroi të na kthente në konvikt mua, Mirën dhe Adrianin. Kur iu afruam makinës, Majkëll vendosi, pa ndonjë arsye të dukshme, të ngjitej mbi kapakun e motorit të

Chevy-it të tij, prej nga dukej si një vogëlush i lumtur me kaçurrelat e verdha. *Uuuu, edhe spontan!* As që mendova dy herë për t'iu bashkuar mu atje. Në fund të fundit, ngordhja për t'iu ngjitur një çikë pemëve. Kjo nuk mund të ishte dhe aq ndryshe. Fillova të ngjitesha dhe Majku shtriu dorën për të më tërhequr lart. Tani ishin dy të marrë të lumturuar në majë të *Chevy-it*. Si përfundim, zbritëm dhe Majkëll na çoi në qytet Studenti.

Të nesërmen në mëngjes, Majkëll erdhi të më merrte me *Chevy-in* e tij të bardhë dhe e ngau makinën për te muzeu kombëtar, në anën jugore të sheshit Skënderbe.

- Nuk jam edhe aq e sigurt se cila është hyrja këtu, - thashë me turp syve.

- Ti ke qenë këtu, apo jo? – pyeti Majkëll.

Nxitova shkallëve për tek dera dhe e hapa me përpjekjen e parë. *U, shqyr!* – mora frymë e lehtësuar dhe u ktheva nga Majku duke mbajtur derën hapur për të.

- Vetëm një herë, para dhjetë vjetësh. Erdha me klasën në vitin e parë të shkollës së mesme. Ishte udhëtimi i parë shkollor jashtë qytetit.

- Po ti ke jetuar këtu për pesë vjet gjatë viteve të shkollës së lartë, apo jo?

- Nuk më tërhiqte dhe aq historia në shkollë, kurse muzetë më dukeshin të mërzitshëm, pa lidhje. Më tërhiqte shkenca shumë më tepër. Pastaj doli që gjithçka na ishte mësuar në histori ishte njëlloshur nga komunizmi, gjithsesi. Ende nuk e kam idenë se çfarë ishte e vërtetë dhe çfarë ishte dogmë.

Ecëm ngadalë përmes muzeut dhe kuptova që Majkëll mund t'ia kishte dalë edhe vetë. Pothuajse çdo objekt i shfaqur ishte përshkruar edhe në anglisht edhe në shqip. Pastaj pashë një statujë të madhe të një ushtari me muskuj të ekzagjeruar gjoksi dhe m'u kujtuan të Majkut kur e pashë për herë të parë. Vendosa që do të ishte një rast me vend për t'i bërë një kompliment. Iu afrova statujës me përmasa njerëzore mbi pedestal dhe, në majë të gishtave, shtriva dorën e majtë mbi muskulin e majtë të gjoksit të statujës. I rashë lehtë me dorë masës së bronzitë nja dy herë me admirim të dukshëm për një gjoks të madh mashkullor, pastaj hodha sytë nga Majkëll me një buzëqeshje të qëllimshme. Buzëqeshi edhe ai dhe unë e dija që e mirëpriti komplimentin tim “të rafinuar”. *Ja që muzetë nuk qenkan dhe aq pa lidhje!*

Pastaj Majkëll pyeti: “Çne kjo shqiponja me dy koka në flamurin tuaj?”.

- Një legjendë thotë që shqiponja e shëndetshme fluturoi përkrah të plagosurës dhe e mbarti në shpëtim. Po si ka ardhur koha tani, mund të ketë kuptim për kombin e ndarë më dysh; shqiptarët e Shqipërisë dhe ata të

Kosovës të lënë jashtë kufijve të Shqipërisë në Konferencën e Paqes.

- Nuk është flamuri juaj shumë më i vjetër sesa Konferenca e Paqes së 1913-s?

- Tamam! – ia prita. – Të thashë unë që nuk më jepej shumë për këto gjërat e historisë, - vazhdova duke justifikuar veten.

- Dëgjova diku që dykrenarja e flamurit shqiptar e ka prejardhjen nga përkrenarja e familjes së Skënderbeut dhe simbolizon unitetin ndërmjet dy feve kryesore: myslimanëve dhe të krishterëve ortodoksë.

- Megjithëse myslimanët dhe të krishterët shqiptarë kanë jetuar në paqe që prej shekullit të pesëmbëdhjetë, në atë kohë, Skënderbeu dhe familja e tij luftuan kundër pushtimit osman për njëzetepesë vjet dhe parandaluan përparimin e tij drejt perëndimit. Nuk kishte myslimanë në Shqipëri para asaj kohe, por Iliria, nga ana tjetër, siç quhej Shqipëria në kohën e apostullit Pal, ishte njëri prej vendeve ku vetë ai shpalli Ungjillin e Krishtit. Këtë e di nga Bibla. Pali flet për këtë tek Romakëve 15:19, – iu përgjigja pak më me besim në vetvete.

- Ajo që më the për kuptimin aktual është një çikë e frikshme.

- Pse?

- Sepse do të thotë që makinat e propagandës janë në punë për luftë të mundshme kundër serbëve për të rimarrë Kosovën për Shqipërinë.

- Mirë thua ti; shikoj plot kosovarë të rinj nëpër qytet, por mendova se janë thjesht të lumtur që janë të lirë për të vizituar mëmëdhenë. Megjithëse, nuk njoh ndonjë në jug të kufirit të përgjërohet për të shkuar e parë Kosovën.

- Më duket se ka një çikë më tepër në këtë muhabet. Unë e di që ushtarët tanë po stërvisin një numër të madh kosovarësh për t'i përgatitur për luftë me Serbinë.

- Kjo është arsyeja e vërtetë për të cilën je këtu? Më tha Fabiola që ti je me ca forca speciale amerikane.

- Jo. Ajo ka ndodhur shumë kohë më parë, kur isha i ri dhe i shkujdesur. Tani jam këtu që të vë në zbatim embargon e Kombeve të Bashkuara kundër serbëve dhe të hetoj kalimin e armëve dhe të naftës që po ndodh pavarësisht embargos. Përpiqem t'i them policisë në Vlorë që duhet të ndalojnë së ndihmuari Serbët me naftë, megjithëse ajo është nxitja kryesore e ekonomisë atje tani. Sapo serbët të mbarojnë punë me kasaphanën në Bosnje, kanë për t'iu kthyer Kosovës.

- Uaa! – thashë e mahnitur me njohurinë e Majkut, po për më tepër që i kushtonte kaq vëmendje politikave shqiptare dhe të ballkanit. – Unë as që

kam menduar ndonjë herë më parë për këto gjëra.

Sapo dolëm nga muzeu, në të djathtë, i tërhoqa vëmendjen drejt një pjese të ngritur të sheshit që tashmë ishte vend për një park të vogël makinash elektrike që përplasen. Ishte rasti im i vetëm për të përmirësuar mesataren time të historisë.

- Tani ja ku kemi një copë historie që mund të të interesojë dhe që unë e njoh personalisht, - thashë duke i treguar piedestalin në shesh. – E di çfarë ishte mbi atë piedestalin e madh?

- Jo, - u përgjigj Majkëll.

- Shumë më tepër histori se sa heshtja brenda muzeut kombëtar. Ndoshta ashtu më duket mua, sepse kjo ka ndodhur vetëm katër vjet më parë mu përpara syve të mi; më saktë, para ekranit të televizorit. Ishte piedestali për statujën gjigante të ish-diktatorit komunist. Populli i Tiranës e rrëzoi përtokë dhe e hoqi zvarrë deri te qyteti Studenti më njëzet shkurt të njëmijëenëntëqindënëntëdhjetëenjëshit; ditën e tretë të grevës së urisë për shtatëqindnjëzetetë studentë. A thua se ishte shpërblimi ndaj studentëve që filluan gjithë revolucionin që shembi sistemin e kalbur. Mijëra përkrasë ishin mbledhur më parë atë ditë përpara Kinoklubit në qytetin Studenti, ku studentët grevistë kishin kyçur derën nga brenda për tri ditë. Ata kërkuan heqjen e emrit të diktatorit nga Universiteti, depolitizimin e sistemit arsimor shqiptar dhe shfuqizimin e dekretit të mbrojtjes së monumenteve kombëtare si ky. Gjithashtu, kërkuan lirimin e të burgosurve politikë që po mbaheshin ende nëpër burgjet e tmerrshme të Burrelit, Spaçit dhe Qafë-Barit.

- Po ti, more pjesë në grevën e urisë?

- Jo. Unë kisha ikur në shtëpi pas sezonit të provimeve, pastaj qeveria urdhëroi mbylljen e Universitetit – besoj për të shmangur gjullurdinë e studentëve, gjë që ndodhi gjithsesi. Po unë e bëra grevën e urisë në shtëpi. E fillova sapo mora vesh që kishte filluar dhe vazhdova derisa mbaroi. Kisha disa shokë të ngushtë brenda, me gjithë Omarin. Unë i pashë në televizor si në gjemba turmat e revoltuara, të udhëhequra nga nënat dhe motrat e grevistëve, kur filluan të marshonin nga qyteti Studenti duke mbushur rrugët e kryeqytetit dhe duke brohoritur “Ushtria është me ne!” “Policia është me ne!” gjithë rrugës.

- Çfarë përvoje duhet të ketë qenë! – tha Majkëll, ndërsa iu ngjitëm shkallëve të sheshit.

- Ishte elektrizuese. Nuk na besohej që po i jepnin të gjitha në lajme. Kur mbërritën turmat te sheshi qëndror, disa nga demonstruesit hodhën kablo

të mëdha rreth qafës së statujës dhe filluan ta tërhiqnin nga të gjitha anët. Statuja e lartë shtatëmetroshe filloi të lëkundej sa nga një anë në tjetrën pak nga pak derisa u përmbys e tëra me gjëmim. Ishte e pabesueshme! U duk sikur u përmbys njeriu vetë dhe miti i tij me gjithë të.

- Dhe tani është kthyer në shesh garash për makina përplasëse.

- Mua më duket si përdorim shumë i dobishëm i hapësirës, - ia prita me shumë dëshirë për ta provuar, por u kujtova që nën kapardinën e kuqe prej taftaje kisha veshur një fustan të shkurtër cope të gomuar, të bardhë e pa rripa – një komplet shumë i papërshtatshëm për t’u ulur vetëm disa centimetra nga asfalti. Nganjëherë, më shkante mendja se mos ishte, në fakt, vetëm fund i ngushtë.

- Nuk ke hipur ndonjëherë? – pyeti Majkëll

- Jo, - iu përgjigja.

- Hajde, pra! – tha Majkëll pa humbur kohë.

Mbërtheva ato pak kopsa që kishte fëshfëshja e kuqe, ndërsa Majkëll bleu biletat. U futa në makinën e vogël elektrike dhe shijova xhiron gjithë përplasje duke mbërthyer me të dyja duart si me pincë fundet e pakopsitura të kapardinës.

Kaluam mbetjen tjetër të mbasdites së bashku, hëngrëm darkë dhe pastaj u bashkuam me shokët e tjerë për një dy orë kërcimi në disko.

KAPITULLI XXI

NJËZETEPESË

Më vonë, po atë javë, pas shërbesës së të mërkurës mbasdite, një nga besimtarët në kishë po më shoqëronte për një pjesë të rrugës për në qytet Studenti. Shërbesat e të mërkurës gjithmonë ma çonin shpirtin peshë. Megjithatë, kjo e mërkurë ishte e veçantë. Ishte ditëlindja ime e njëzetepestë. Më ishte mbushur zemra me shpirtin e së qeshurës gjatë gjithë shërbesës. Më dukej sikur po fillonte një kapitull i ri, një kapitull i lumtur këtë natë.

Sapo kaluam njërën nga urat e Lanës, përroin që përshkon Tiranën përmes, pashë Tanin, shokun tim nga elektrikja. Buzëqeshi nga larg dhe pothuajse vrapuam në krahët e njëri-tjetrit. *Sa më ka marrë malli për ditët e shkollës!* U përqaftuam pastaj u kujtova ta prezantoja me shokun e ri besimtar. Tani reagoi pak i hutuar, por besimtari na uroi natën e mirë dhe na la vetëm.

- Kush ishte? – nuk e përmbajti dot kureshtjen Tani.

- Asnjë i llojit që po mendon ti. Pse, nuk duket? – ia prita duke aluduar për shtatin e tij më të shkurtër dhe moshën disa vjet më të re.

- Ishte ora që më ngatërroi më tepër.

- Sapo dolëm nga kisha dhe ai po më shoqëronte një pjesë të rrugës në kthim meqë është errësirë. Është histori e gjatë, po unë jam e krishterë tani, - i thashë ende e ngazëllyer për lajmin tim. – Ai është i krishterë me taban. Më pëlqen kur ballafaqojmë koncepte biblike bashkë.

- E kam marrë vesh.

- Vë bast që të ka thënë Timua.

- Po. Më parapërgatiti që mund të na kesh shkarë nga duart tani, - tha Tani duke qeshur. – Si ke qenë?

- Asgjë përveçse gjëra të mrekullueshme më kanë ndodhur që kur e vura jetën time në duart e Krishtit. Provoje edhe ti.

- E lesh, lesh! – u përgjigj Tani. – Ku kam nge unë për këto gjëra!

- Edhe unë kam qenë e zënë. Me punë, me mbrëmje... Meqë ra fjala, sot mbush njëzetepesë. Këtë javë janë edhe ditëlindjet e nja dy shokëve të tjerë dhe kemi ndër mend të mblidhemi këtë të shtunë që vjen. Konsideroje këtë si ftesë dhe thuaji edhe Timos të vijë.

- Mirë, do vij, - premtoi Tani. – Ku po punon? Prapë te diskoteka?

- Në asnjë mënyrë! Megjithëse më shkoi mendja kur më erdhi shefi i vjetër te zyra e re një ditë. Unë sapo kisha mbaruar punë për atë ditë dhe po dilja kur ai më ndaloi me ulërimën e frenave të *Renault*-së mu para këmbëve. Në fillim u tremba pak, pastaj e pashë kush ishte mbas timonit. Më kërkoi që të shkoja të punoja te diskoteka prapë.

- Edhe ti e ktheve mbrapsht?

- Sigurisht.

- As për ndonjë orë nga fundi i javës? Ishte pare e mirë, me sa mbaj mend unë.

- U përpoq të më bindte edhe me këtë, po e shtuna është Shabat. E di çfarë është?

- Jo.

- Është dita e shtatë e javës; dita kur Perëndia e bëri pushim nga gjithë puna që bëri pasi krijoi botën në gjashtë ditët e para.

- Nuk janë për çifutët këto gjëra?

- Ashtu kujtoja edhe unë derisa pashë këtë, - i thashë dhe nxora Biblën nga çanta dhe e hapta tek Isaia 56:6 për ta lexuar nën dritat e rrugës: “Bijtë e të huajve që janë bashkuar me Zotin për t’i shërbyer, për të dashur emrin e Zotit dhe për të qenë shërbëtorë të tij, tërë ata që respektojnë të shtunën pa e përdhosur dhe që i përmbahen me vendosmëri besëlidhjes sime, do t’i çoj në malin tim të shenjtë dhe do t’i mbush me gëzim në shtëpinë time të lutjes”.

- Nuk e paska ekzagjeruar Timo fare, atëherë, - tha Tani duke qeshur me ironi, ndërsa fshiu duart me njëra-tjetrën si për të shkundur pluhurin.

- Nuk dal nga dhoma pa të. E lexoj për ditë. Unë besoj se Perëndia po më bekon me shumicë për shkak të kësaj. Më pëlqen puna; paguhem shumë mirë dhe ndjehem e vlerësuar. Po kur na mbajnë mend edhe datëlindjet!

- Avash, tani, se do na shkrihesh fare për ndonjë amerikan atje.

- Pothuajse të gjithë janë shqiptarë; vetëm nja dy nga shefat janë amerikanë dhe nuk janë fare ashtu si mendon ti. Megjithëse u mahnitën një herë kur hapta një shishe vere pa hapëse shishesh.

- Ju japin edhe verë? A ka ndonjë vend pune për mua aty? – pyeti Tani me shaka.

- Ishte një mbrëmje për njërin nga shefat e përkohshëm që iku.
- E hape me peshqir pas murit?
- Ëhë. Kemi ca kolona betoni nëpër zyrë dhe unë përdora njërin prej tyre.

E mora shishen...

- Edhe ata të zunë besë të mos e thyeje? – ndërpreu Tani.
- Duhet t’u jem dukur kompetente.
- Hapuni se po vjen baristja këtu! – përqeshi Tani.
- Se ku gjeti njëri një peshqir nga kuzhina poshtë. Të thashë gjë që na japin edhe drekën falas?

- Jo, por jam i sigurt që jua nxjerrin nga rroga.

- Punë e madhe! Ia vlen. Shumicën e ditëve vetëm atë ha në njëzetekatër orë. Ne jse, e mora shishen dhe fillova ta godisja fundin ndaj peshqirit të palosur kundrejt murit. Vetëm të shikoje sytë e shefave kur doli tapa përgjysmë pak nga pak me çdo goditje. Pastaj e nxora me kujdes me dhëmbë.

- Ec aty! Më bëhet qejfi për ty! – ma ktheu Tani dhe vazhdoi. – Në qytet Studenti banon akoma?

- Atje, akoma; në të njëjtën godinë. Atje do të flesh sonte, apo do të kthehesh në shtëpi?

- Fle më rehat në shtëpi, - u përgjigj Tani.

- Edhe mua po më vjen në majë të hundës kjo jeta konviktore.

- Ditët e mira paskëtaj vijnë, - recitoi Tani vargjet e mirënjohura të një poeti të madh të Rilindjes shqiptare.

- Amen! – e mirëprita urimin e tij sikur të ishte profetik. – Ore, se harrova të të pyes! Po ti pse ke ardhur këtu sot?

- Oo, çështje zemre, - u përgjigj me psherëtimë.

- E njëjta që mbaj mend unë nga shkolla?

- E vetm’e derës.

- E ç’ke tani? Ju shkollën e mbaruat të dy. Ti po, me sa duket, nuk ike gjëkund. Çfarë ju pengon?

- Nuk do të vijë në Berat. “Nuk e lë dot babanë vetëm”, - thotë.

- E di ti që ka plot nga tanët që po ikin nga qytetet e tyre dhe po shpërngulen këtu në kryeqytet? Pse nuk vjen ti këtu në vend që të vijë ajo atje? Kështu mund të jetë edhe ajo pranë t’atit, - pyeta.

- Edhe ç’të bëj me të mitë pastaj? Po të kisha mundur t’i lija që të vija këtu, mund t’i kisha lënë të ikja një çikë më tutje.

- Si në matanë kufirit?

- Po.

- Punë dreqi! – psherëtiva edhe unë.

- Lëmsh, lëmsh. Meqë ra fjala, po ti ke marrë gjë vesh nga Teo? – pyeti Tani – pikërisht pyetjen që po përpiquesha të evitoja që kur u takuam. Ende një plagë e hapur në shpirtin tim.

- E mora në telefon para nja dy muajsh, sapo fillova punë.

- Edhe?

- Asgjë. Kishte merak se mos humbisja punën prej telefonatës, kështu që i ra shkurt. Nuk dija ç'të mendoja, po nuk më mori më në telefon.

- Nuk bëhen me telefon këto muhabetë. E mira është të diskutohen shtruar, po ai është shumë larg për këtë, - u përgjigj Tani.

Edhe pse dukej sikur po justifikonte shokun e vet, Tani kishte të drejtë. Edhe unë e kisha patur të vështirë t'ia thosha nga telefoni të gjitha gjërat që më kishin mbajtur zgjuar me netë të tëra.

- Ja edhe ti që i bërë personalisht nuk duket se qullose ndonjë gjë më tepër... po mbase e ngjeve ndonjë çikë? – i shkela syrin dhe Tani qeshi fort.

- Ti ta heq trurin! Na vajti dëm gjithë ai moment prekës që kishim! Sapo më kujtove pse ishim shokë, - tha Tani ende duke qeshur. – Mbjaj mend një herë që na kishte parë nga larg ty, mua dhe Timon duke qeshur ajo dhe më pyeti më mbrapa: “Për çka qeshni kaq fort sa herë që ju shoh bashkë?” – a thua se donte të merrte pjesë.

- Kur të llafosesh herë tjetër me të dhe ajo ka zili të qeshurën time, thuaji: “Zemra dhemb edhe në qeshje” thotë Bibla, po thotë edhe që një zemër e gëzuar është ilaç i mirë. Hajde, merre vesh! – ia ktheva dhe shtova: “Ditë të mira paskëtaj vijnë, apo jo?”

- *Amin!* – u përgjigj Tani. – Mirë e thashë, më?

- Ec aty, me “gjuhën”. Do Biblën time? Marr tjetër nga kisha.

- Mos e tepro! – ma priti Tani buzagaz.

- E mirë, de, mirë. Më gufon zemra mua. Mos harro të më vish te ditëlindja! – i thashë siç e mora për qafe shokun e vjetër.

- Do përpiqem, - tha Tani dhe u ndamë tek ura e Elbasanit, ku unë iu ngjita kodrës për në qytet Studenti.

Më në fund, erdhi dhe e shtuna. Ishte një mëngjes i bukur marsi me diell dhe prania e shumë prej shokëve të mi të fakultetit e bëri edhe më të gëzueshme. Ishte si një ribashkim i vogël.

Kishin ardhur gjithë shokët e Xhovanit, me gjithë Majkëll, si edhe shokët

e Omarit. U mblodhën të gjithë bashkë dhe hipën nëpër makina për te blloku i vilave në plazh të Durrësit.

Mira, Dori, Enxhi dhe unë hipëm në *Chevy*-in e Majkut. Po më dukej vetja sikur isha në një autobus shkolle fillore për në Apolloni kur filluam të bërtisnim: “Shoferi do raki që të eci me shpejtësi”. Sa më fortë bërtisnim, aq më shpejt e ngiste Majku, gjë që nxiste vajzat të bërtisnin edhe më fort. Bërtitja u kthye në klithmë kur Majkëll mori një vendim aventurieri për të kaluar makinën që kishte përpara në një rrugë të ngushtë dykalimshe kundrejt trafikut në ardhje. Pas një psherëtime të shkurtër çliruese që mezi i kishim shpëtuar një përplasjeje ballë për ballë, filluam sërish nga duartrokitjet dhe britmat. Ndjehesha si e dehur nga e qeshura dhe frika e përplasjes.

Kur mbërritëm te plazhi, shumica e amerikanëve filluan vrapin pesëkilometërsh, ndërsa unë e shoqet e mia po rrinim në plazhin e bukur me diell. Majkëll vazhdoi të qëndronte me mua dhe shoqet e mia. Nxori një kuti të vogël tavlle dhe filloi të rendiste gurët.

- Sa më pëlqen kjo lojë! Luaja herë pas here me vëllanë në Greqi, - i thashë Majkut, ndërsa isha ulur në rrëzë të molit prej betoni në plazh.

- Ta mban? – tha Majkëll dhe filluam një lojë tavlle.

- Nuk të mjaftoi të më mësoje historinë e vendit tim ty, po do të më mundësh edhe në të vetmen lojë që di? – e pyeta.

Majkëll buzëqeshi me sytë e butë e të kaltër dhe vazhdoi të luante me disa nga shokët e mi. Pastaj u kujtova që njëra prej shoqeve të mia qepte rrobat e veta gjatë viteve të shkollës.

- Jeta, kam një copë atllasi të bardhë dhe doja ta bëja fustan. Është diçka që mund të ta besoj ty?

- Patjetër! – u përgjigj Jeta dhe më caktoi datën për të më marrë masat. – Ke ndonjë ide për modelin?

- Kam, në fakt. Po e imagjinoja deri te gjuri, me kopsa përpara, me fundin verëf. Është shumë copë e derdhur; besoj se do të rrijë mirë në trup. Mund të mos kem copë të mjaftueshme për fund rrethor të plotë, kështu që po mendoja ta bëje me tetë copa. Bëhet?

- Po. Tingëllon shumë bukur. Pse të bardhë? – pyeti Jeta dhe më shkeli syrin buzagaz. – Mos je bërë për të uruar gjë?

- Jo, jo, - ia prita. – Asgjë më tepër se një parandjenjë tani për tani. Ndoshta ka të bëjë me njëzetepesën që sapo mbusha. Në fakt, doja ta kisha bërë për ditëlindje, po nuk arrita dot. Megjithëse, sot do të kishte qenë një çikë ftohtë për të. Do të vish në mbrëmje te diskoteka më vonë? – ndërrova temë.

- Nuk ma do mendja. Do të ishte shumë vonë për t'u kthyer në shtëpi. Ja u çlodha këtu. U kënaqa që erdha.

- Edhe unë. Ishte mrekulli që u takuam me të gjithë.

Pas xhiros së plazhit, u kthyem në kryeqytet për një pushim dhe ndërrim teshash, para se të dilnim për te diskoteka në mbrëmje. Mezi po prisja të vishja fustanin e gjatë e të ngushtë prej atllasi rozë dhe takat e bardha. Majkëll erdhi të na merrte mua dhe Mirën para godinës rreth orës gjashtë mbasdite.

Kur mbërrita tek diskoteka, u gëzova shumë kur pashë gjithë njerëzit që kishin ardhur të merrnin pjesë në festën time. Hyra në disko duke u fshehur pas Majkut dhe Mirës. E dija që veshja ime ishte një çikë e tepruar për rastin, por mendova se disko do të ishte e errët, me zhurmë dhe me hare. Pastaj, më lejohej si një e treta e arsyes për këtë mbrëmje të madhe.

U befasoja dhe u gëzova shumë kur pashë Timon në anën tjetër të diskos, siç iu drejtova grupit të shokëve të mi të klasës.

- Erdhe! – pothuajse gërthita dhe e përqafova.

- Gëzuar ditëlindjen! – ma priti Timo buzagaz.

- Falemnderit! Dhe falemnderit që bërë gjithatë rrugë. Shpresoj të kënaqesh. Oho! Më duket se më duhet të jap fjalim tani, - thashë sapo pashë Omarin para kthinës së dixheit me një mikrofon në dorë dhe Xhovanin më këmbë përbri tij. – Po mos guxo të ikësh pa kërcyer një herë me mua. Ti je akoma partneri im numër një në vallëzim.

- Nuk iki, - premtoi Timo. – Vazhdo me fjalimin!

Më thirri Omari dhe unë përfundova mes tij dhe Xhovanit duke pritur për radhën time për të falenderuar gjithkënd që kishte ardhur te mbrëmja e ditëlindjes sime. Omari e përfundoi fjalimin e tij me thirrje për birrën e parë falas për të gjithë.

Pastaj tërhoqi vëmendjen e të gjithëve për tek torta e madhe. Shumë kënduan “*Gëzuar ditëlindjen!*” në anglisht dhe na rrethuan mua, Omarin dhe Xhovanin tek fiknim me frymë një qerre me qirinj të vegjël të ndezur e të ngulur mbi tortën e madhe me marengë të bardhë dhe thërrime arrash në anë.

Ndërsa njerëzia filluan të kërcenin, unë zgjodha Majkëll për të parin. E dija që donte të kërcente me mua.

- Falemnderit që na gjezdise gjithandej sot! Çfarë dite e mrekullueshme ka qenë deri tani! – i thashë.

- Je e mirëpritur! – ma priti Majkëll dhe ndaloi së kërcyeri për një çast. Futi dorën në xhepin e tij të djathtë dhe nxori një zinxhir ari të sheshtë prej

kutisë së vogël të veshur me kadife vishnje.

- Gëzuar ditëlindjen! – tha dhe ma vendosi varësen rreth qafës duke e mbërthyer mbrapa.

- Oh! Sa e bukur! Falemnderit! – iu përgjigja, pa u besuar syve. Më preku vërtet bujaria e Majkut. Nuk dija çfarë të thosha. Kishte qenë shumë i mirë dhe i gatshëm gjithë ditën dhe kjo ishte “thelë mbi bishtit”, kur thoshte im atë. E përqafova dhe vazhduam të kërcenim për ca kohë.

- Nuk po më pritet sa t’ua tregoj shoqeve! – thashë dhe vija dorën mbi varëse çdo minutë si për t’u siguruar që e kisha ende rreth gushës.

Sapo mbaroi kënga, falenderova Majkun edhe një herë dhe fillova të ecja drejt shoqërisë sime. Sapo mbërrita matanë pistës, filloi kënga tjetër dhe shumica e shoqeve të mia ishin ngritur për të kërcyer. Timo ishte ende ulur duke folur me të tjerët. E tërhoqa drejt pistës. Ishte një e ngadaltë tjetër dhe unë ndjeva krahun e ngurtë të Timos rreth shpinës sime të rrëshqitshme që po më tërhiqte pranë vetes.

- Avash me tërheqjen! – qesha si e gudulisur. – Se mos trazojmë xhelozit.

- Po bën përpara, kështu? – ngacmoi Timo.

- Nuk kam tërhequr kurrë kaq shumë vëmendje sa në këto muajt e fundit. Sikur po rinohem, jo sikur po plakem.

- O, të siguroj unë që është kjo e fundit, - tha Timo, si gjithmonë duke i vënë pikën.

- E di atë, po më pëlqen të besoj që jam zbuluar me vonesë ose ndoshta lulëzova më vonë se të tjerët.

- Po më e re se shumica e zhgorrave të martuar, me të cilët shoqërohesh këto ditë, je.

- Ka edhe ca të rinj. Ti sa vjen e bëhesh më i lig! – ia prita, po kisha frikë se kishte të drejtë edhe këtë radhë.

- Ja, më trego ndonjërin dhe të them unë.

- Askush që mund ta marr seriozisht, po ky ma tërhoqi vëmendjen menjëherë, - thashë dhe kërcita gishtat e i tregova varësen e re.

- E mirë, jepi ca, - u përgjigj Timo me një qeshje tinëzare.

- Vetëm atje të rri mendja.

- Atje na rri të gjithëve, - ma ktheu Timo. – Amerikan është?

- Po, por nuk më duket se kërkon vetëm aq. Jo se do t’i jepja, po ai as që ka kërkuar. Kjo ndoshta është varëse njëqinddollarëshe. Do të shpenzoje ti aq shumë në “ca” të mundshme?

- Unë jo, po ai edhe mundet. Ça janë njëqind dollarë për një amerikan me rrogën e tij? – ma ktheu Timo.

- E mirë, nuk krahasohen ashtu. Ia fus kot edhe unë. Ti je më i mençur se aq, - ia prita.

- Ai me të cilin po kërceje është? – pyeti Timo.

- Po, - ia ktheva dhe pashë rreth e rrotull për të kërkuar Majkun, por nuk munda ta gjeja. – Nuk e shikoj më tani. Në fakt, nuk shikoj as Ilirin. Desha të kërceja edhe me të.

- Epo nuk ua del dot të gjithëve. Çne me Ilirin?

- Ka qenë shok i mirë. Ai më tha për punën dhe unë i premtova drekë me rrogën e parë.

- E mbajte?

- Ëhë. Hajde drekë, hajde!

- Pa hë.

- Ai zgjodhi restorantin. Ishte një kioskë e bukur prej qelqi mu në anë të Lanës. Kur u futa brenda, më mahniti një pemë e madhe e gjallë mu në mes të restorantit. Më bëri shumë përshtypje dhe u kënaqa që nuk e kishin sakrifikuar për të ndërtuar restorantin, por e ndërthurën në ndërtesë. Sapo piva aq verë sa të më mjegullonte shikimin periferik...

- Se mos të ka plasur ndonjëherë ty se kush po shikon apo çfarë po mendojnë! – ndërpreu Timo duke qeshur dhe parashikuar fundin e rrëfimit tim.

- Tamam! Ti ndoshta e more me mend; më duhej t'ia hipja pemës, si për ta përqafuar.

- Në fakt, po prisja t'i kishe bërë shurrën! – tha Timo duke qeshur. – Si qen.

- Si e dehur, thuj! – qesha. – Si nëpër tym më kujtohet Iliri duke u përpjekur disi për të arsyetuar kundër idesë. Më duket se kishte më shumë hallin e reputacionit të tij, se sa hallin e ngjitjes sime me taka të larta.

- Nuk theve qafën? Megjithëse, nuk bie rrufeja në hale!

- Ishte trangu goxha i trashë dhe pothuajse horizontal. Nuk ishte dhe aq e vështirë për sa kohë që ecja maja-maja. Nejse, shpresoj të mos jetë ndjerë i lënë pas dore sonte. Mendova se kishte plot vajza për të kërcyer. Po ti pse nuk po kërceje, meqë ra fjala?

- Vështirë të hahesh me gjithë të huajt e pasur që ke sjellë këtu.

- E de e, kishte plot për të gjithë.

- Unë gjeta “ca” për vete, - qeshi Timo me hundën e sytë e mbledhur rrudhë sërish. – Gjynah të qahem.

- Gjete opingat! – thashë, ndërsa i rashë me grusht në supin e majtë dhe qesha me të.

- Po shpresonte Iliri për ca? – përgjoi Timo.

- Ëëë... Nuk jam e sigurt. As ai nuk ka kërkuar, por kemi dalë disa herë

bashkë. Shpresoj që jo; të paktën jo në mënyrën që e percepton ti “ca”-në. Të thashë unë; ka qenë shumë e ngjeshur turma rreth meje që kur jam kthyer nga Greqia. Më duket se është vetëm një provë.

- Provë për se?

- Për besimin tim ndaj përzgjedhjes së Perëndisë, - i thashë duke tentuar fjalimin e besimit me Timon edhe një herë. Pothuajse isha gati të rrezikoj talljen e tij për lutjet e mia që Perëndia të më gjente një burrë sipas shijes së vet.

- Ohooo! Filloi prapë kjo tani! – rrokullisi sytë Timo siç kisha dyshuar. – Qysh, më?

- Lëre fare, - ia prita paksa e thyer si çdo herë që dikush tallej me Perëndinë tim shumë të vërtetë dhe besimin tim në Të.

- Më thuaj, - këmbënguli Timo duke e kapur që më kishte ngelur qejfi, por ma kishte thyer entuziazmin për të ndarë Perëndinë me të për herë të dytë. Sa herë përpiqesha dhe pritesha me këmbët e para, e përfytyroja veten duke shkundur nga këmbët pluhurin e vendit ku unë dhe Krishti, brenda meje, ishim refuzuar dhe ndjeja grimca të shoqërisë që shkundeshin bashkë me të.

- Shumë zhurmë këtu për muhabete të tilla, gjithsesi. Ta them herë tjetër, - iu përgjigja me pendim.

- E mirë, - pranoi Timo. – Po më vete vonë edhe mua.

- Mirë, nuk të mbaj. Falemnderit që erdhe! U kënaqa shumë!

- Natën e mirë! – tha Timo dhe u largua nga mbrëmja.

Unë u ula për njëfarë kohe duke çlodhur këmbët dhe duke kërkuar Majkëll nëpër sallë, po nuk dukej gjëkund. Po filloja të mendoja që kishte ikur nga mbrëmja pasi më pa të kërceja aq afër me Timon. Nuk kërceja kurrë aq afër dhe lirshëm me njeri tjetër. Paskësja patur të drejtë të mendoja se po i bëja njerëzit xhelozë. “Mos! Tani nuk kam me se të kthehem në konvikt!” – u kujtova.

M’u shkëput filli i mendimeve kur Xhoni, një mjek ushtarak amerikan në të tridhjetat më doli përpara më këmbë duke më kërkuar për vallëzim.

- Me kënaqësi! – ia prita paksa e çuditur.

Unë e Xhoni kishim qenë në të njëjtët grupe për shumicën e dimrit, por nuk kishim biseduar shumë me njëri-tjetrin. Ishte gjithmonë i sjellshëm gjatë atyre pak ndërveprimeve që patëm. Shyqyr që po kërcenim *rrok-en-roll*.

- Gëzuar ditëlindjen, me këtë rast! – tha Xhoni duke m’u përkulur te veshi.

- Falemnderit! – buzëqesha me terbjat. – Po kënaqem!

- Nuk më besohej që po rrije ulur, si goca e mbrëmjes që je.

- Sa ironike është që e thua këtë! Unë që po mendoja: “Nuk më besohet që më kërkoi dikush për të kërcyer një herë!”.

- Pse kështu?

- Sepse, në përgjithësi, më duhet të marr situatën në dorë për t’i kërkuar vetë kur dua të kërcëj. Pothuajse nuk më merrte njeri fare në pistën e vallëzimit gjatë shkollës së mesme.

- Di dhia ç’është tagjia? Unë mendoj që ti kërcen shumë bukur!

- Uu, falemnderit! Vajti haka tek i zoti; sidomos kur e dëgjoj prej dikujt që është nga vendi i rrok en rollit! – thashë e kënaqur.

- Siç e sheh edhe vetë, nuk është se unë jam ndonjë specialist vallëzimi!

- Gjynah! Unë do të ta kisha kërkuar deklaratën me shkrim dhe do ta vija në kornizë, - thashë me shaka.

- Po përpiqesha të të thosha që më pëlqen të të shikoj kur kërcen, edhe pse nuk di të kërcëj vetë.

- Bëj shaka. Edhe ti për bukuri kërcen, - ia prita tashmë e shqetësuar që kjo bisedë po kthehej në furça lajkash – gjë që nuk e kisha aspak për qëllim. Mbaja mend që Elda kishte përmendur një herë se Xhoni ishte i martuar dhe kishte tre fëmijë. – Kemi parë ca MTV vitet e fundit dhe kemi njëfarë ideje se si bëhet. Prandaj më duket kaq për së mbari; je i lirë të lëvizësh si të duash, për sa kohë që mban ritmin, ama!

- E vërtetë! – u përgjigj Xhoni.

Vazhduam së kërcyeri deri në mbarim të këngës. Pastaj u përkula me respekt dhe i thashë: “Falemnderit për vallëzimin! Do të më falësh tani. Më duhet të shikoj çfarë do bëjmë unë e Mira për t’u kthyer në konvikt. Po vete ora”.

- Ju çoj unë, - u hodh Xhoni pa hezitim.

- Nuk të ngelet qejfi ta lësh mbrëmjen kaq herët?

- Aspak! Pastaj mund të kthehem prapë po të dua, - tha.

- Falemnderit shumë! Prit të vete të marr Mirën. Erdha!

E gjeta Mirën në pistë dhe e mora për dore drejt daljes, ku po na priste Xhoni. Na çoi me makinë deri te hyrja e godinës. Doli nga mikrobusi bezhë *Volkswagen* dhe mori për nga ana e pasagjerit për të na hapur derën nga jashtë.

- Falemnderit edhe një herë! – thashë, siç u afrua për një të puthur të radhës në faqe.

- Je e mirëpritur! – tha Xhoni dhe papritur ktheu kokën për të më kapur buzët me të tizat para se t’i arrinin në faqe duke më lënë pa fjalë. *Po kjo ç’qe?! Do ketë ndryshuar mënyra e përshëndetjes për “natën e mirë” kohët e fundit dhe unë nuk e paskam marrë vesh!* Po ngordhja nga kurioziteti të

pyesja Mirën nëse e “përsëndeti” edhe atë në të njëjtën mënyrë, po më vinte rëndë t’i thosha. Përveç kësaj, çfarë do të bëja me një përgjigje negative prej saj? Qesha nën hundë gjithë rrugës deri në dhomë duke tundur kokën, por e lashë me mendimin “Çunat!” dhe rashë për të fjetur.

Kishte qenë një ditë e gjatë, e lodhshme dhe argëtuese, por prapë nuk kisha gjumë. Ngela duke shkarë gishtin e mesit nëpër varësen e re të artë dhe po ndjehesha keq që nuk kisha kaluar pak më tepër kohë me Majkun në diskotekë. U ndjeva borxhlie për një dhuratë kaq të shtrenjtë dhe vendosa t’i vija gjërat në vend sapo të gdhihej.

Të dielën, herët në mëngjes, shkova tek i vetmi dyqan bizhuterish që dija dhe bleva një varëse floriri për tetëdhjetëmijë lekë me plot kohë për të kapur shërbesën e së dielës në kishë më pas. Edhe pse dhurata nuk ishte dhe aq origjinale, isha e çliruar dhe e kënaqur me blerjen time. Do të ishte një dhuratë e mirë lamtumire. Edhe pse kisha qenë shumë e disiplinuar për t’i mbajtur ndjenjat dhe imagjinatën time nën kontroll, nuk mund të mos ndjehesha e trishtuar dhe e zbrazët kur mendoja që Majkëll po ikte. Më kishte pëlqyer që dikush që kujdesur për mua dhe më kishte begenisur vazhdimisht dy muajt e fundit.

Pas shërbesës, mora guximin drejt qendrës S.A.M., ku po hanin drekë nja njëzeteca shokë të punës së Majkut në një tavolinë të gjatë përjashta. Pashë shkurtimisht, pavarësisht nga ndeshja me shumë sy kureshtarë, duke u përpjekur të gjeja Majkëll, por po më vlonte gjaku në fytyrë dhe u ktheva para se ta shikoja. Ktheva kokën edhe një herë për të parë kush më thirri në emër dhe pashë Ildën që po ngrihej nga tavolina duke ecur drejt meje.

Isha njohur me Ildën nëpërmjet mbrëmjeve të ambasadës amerikane në dy muajt e fundit. Ajo ishte ulur përbri Çarlit, njëri prej amerikanëve që punonte te ambasada. U kënaqa shumë që ajo ndodhi atje dhe më shpëtoi së gjenduri bosh para kaq shumë njerëzve që tashmë më njihnin nga mbrëmja e ditëlindjes së një nate më parë.

- Do të ulesh të hashë drekë me ne? – ofroi Ilda me bujari.

“Absolutisht jo!” – mendova, po ia ktheva: “Jo, jo, falemnderit!”

- Të ndihmoj dot me ndonjë gjë, atëherë?

- Në fakt, po kërkoja Majkun. Mendova se do ta gjeja këtu, por e paskam patur gabim! – iu përgjigja pak e çuditur, sepse njoha disa prej fytyrave që punonin me të.

- Prit të pyes, - tha Ilda dhe unë u tërhoqa disa hapa më tutje tavolinës.

- Po më thonë që Majkun e kanë dërguar në Sofje të Bullgarisë për një javë. Ke ndonjë porosi për të?

- Asgjë me rëndësi. Më befasoi me një dhuratë mbrëmë te ditëlindja dhe unë i solla diçka në kthim. Ia jap ndonjë herë tjetër, po e pashë prapë. Edhe nëse s'ndodh, nuk është ndonjë qamet i madh, - iu përgjigja duke u përpjekur të bindja veten më tepër se Ildën dhe gjithë dynjanë që nuk po ndodhte asgjë mes nesh.

- Duhet të kthehet këtu një herë para se të kthehet në ShBA. Je e sigurt që nuk do të ulesh me ne për drekë? – pyeti Ilda edhe një herë.

- Absolutisht! Më fal që të shkëputa edhe ty nga dreka. Falemnderit! – ia prita.

- Asgjë fare. Mirupafshim! – u përgjigj Ilda dhe unë ika.

U paraqita në punë të hënën e parë të vitit tim të njëzetegjashtë dhe u përshëndeta me një të papritur të mrekullueshme – një kontratë të re. Kontrata e re më ngriti nga pozita e përkohshme si recepcioniste në atë të sekretares së përhershme të zyra ngjitur. Tani isha sekretarja dhe përkthyesja e bërthamës së inxhinierëve për sa kohë që projekti kishte fonde.

Gjithçka po mendoja ishte se sa e lumtur isha që kisha një shoqe e cila, e dija, që gëzohej për mua si për veten e saj. Perëndia tha: "...duke i folur njëri-tjetrit me psalme, himne dhe këngë frymërore, duke kënduar dhe duke lavdëruar Zotin me zemrën tuaj, duke falenderuar vazhdimisht për çdo gjë Perëndinë dhe Atin në emër të Zotit tonë, Jezu Krisht;” dhe ashtu më dukej se bëja sa herë e ndaja çdo bekim timin me shoqen time besimtare. Sapo kalova te tavolina ime e re në të njëjtën dhomë me inxhinierët e ndërtimit, mora në telefon Fabiolën për t'ia thënë të gjitha.

Nga e premtja, u takuam te vendi i zakonshëm i takimit, tek lokali pa emër. E gjeta Fabiolën ulur me Braçen dhe Gentin, dy shokët e saj shakaxhinj, që na çuan në Vlorë si dhe Xaken, kryeshakaxhiun. Humori i tij i mrekullueshëm theksohej edhe më tepër nga gunga mbi hundë e sytë e rrumbullakët dhe aftësia e tij për t'u tallur me to.

- Motra e Xakes ka dhënë informatikë te fakulteti yt, - tha Fabiola gjatë prezantimit fillestar me Xaken.

- Ajo brunia me lëkurën e bardhë si porcelan dhe sytë e bukur të zinj? – pyeta, pa e fshehur habinë time prej mundësisë që ata të dy të kishin të bënë me njëri-tjetrin në ndonjë mënyrë.

- Dora vetë! – u hodh Xakja para se të kërkoja të falur për reagimin tim ashiqar.

- Po Xakja i kompenson me mendje ato që i mungojnë në pamje, - i doli Braçja në krahë.

- Se mos së motrës i mungojnë mendtë, - fola nëpër dhëmbë, me sytë e ulur mbi tavolinë. – Informatikë? Huh! – shtova duke u futur edhe më thellë.

- Ho-ho! – ma kthyen që të tre duke bërtitur e qeshur me të madhe. – Xake, u shtrua në qoshe kjo e reja, - shtoi Genti ende duke qeshur.

- Kështu të dua, - buzëqeshi Xake. – Birrën e ke nga unë sonte, - vazhdoi. – Ia mbaka çupkës!

Një orë e një birrë më vonë, ajri në lokal u bë i padurueshëm nga gjithë duhani dhe njerëzia. Vendosi ta merrnim gjullurdinë tonë përjashta dhe filluam të ecnim në bulevardin kryesor. Ishte një mbrëmje shumë e këndshme nga fundi i marsit. Ishte tashmë zyrtarisht pranverë dhe moti po ngrohej. Unë kisha vendosur të vishja një fustan të kuq të trikotuar pa mëngë nën kapardinën time të kuqe. Fustani kishte një hapje të rrumbullakët në shpinë, tegel të mbledhur rrudhë anash dhe një të çarë nga fundi deri mbrapa gunjëve; pak i lehtë për temperaturën përjashta, por ishte pranverë, gjithsesi.

Në fakt, gjithë qenia ime atë natë ishte në pritje. Mezi më pritej për gjënë tjetër, ditën tjetër, javën tjetër... të ardhmen dhe gjithçka do të sillte. Më dukej sikur po rrëshqisja përpara, ndërsa shokët e mi ecnin përbri meje.

“Kush është, o Zot?” – pyeta me vete. Më kishte ngrënë përbrenda e njëjta pyetje për javë të tëra. “Nuk mund të jetë Majkëll. Vetëm një javë e ca mbetet pasi të kthehet”, - mendova dhe menjëherë sikur dëgjova një mendim të zëshëm në përgjigje: “Unë bëra botën për një javë”.

Sa e qartë dhe e thjeshtë! M’u bë sikur m’u zhvendosën sytë për një sekondë, ndërsa shikoja hapat e mia në trotuarin e gurtë. Buzëqesha nën zë. Sapo më kishte ndodhur biseda e parë e drejtpërdrejtë me Perëndinë pa ndihmën e Biblës. Doja të bërtisja “Aleluja!” nga thellësia e mushkërive, por vura dorën mbi gjoks sikur të përmbaja rrahjet e zemrës brenda tij.

Gjithçka mund të shikonte Xakja, ama, ishin takat e mia të bardha duke u vënë ngadalë njëra para tjetrës.

- Unë kujtoja se ti dhe Fabiola jeni shoqe të ngushta, - tha duke më kthyer nga hyjnorja në mishtoren.

- Edhe unë ashtu kujtoja, - ia ktheva, me habi. – Ke marrë vesh ndonjë gjë ndryshe ti?

- Po pse vesh taka të larta kur ecën përbri saj, atëherë? – ngacmoi Xakja.

- Për të fshehur këmbët e mia të mëdha, - buzëqesha. – Sa më të larta

takat, aq më e vogël gjurma. Ti më kupton, Fabi, apo jo? – u ktheva nga shoqja ime.

- Perëndia i lë gjërat të rriten deri në përsosje. Cave nga ne nuk iu desh aq gjatë sa të tjerëve, - tha Fabiola në përgjigje.

- Amen! Perëndia është i mirë! – miratova me një të qeshur të fortë, mundësia ime për t’u shfrehur.

Sapo hymë në diskotekë, errësira dhe kitara bas më rënduan në shpirtin e ngritur peshë edhe më rëndë sesa lajkat e Xakes në kurriz të shtatit të shkurtër të shoqes sime. U ndjeva sikur nuk më takonte të vija më në disko. Të paktën derisa dëgjova “*Lejdi in red (Zonja me të kuqe)*”. Pastaj vendosa: “Ndoshta vetëm këtë radhë!”.

- Tamam për ty! – tha Braçe, siç qëndroi më këmbë para meje me sy lutës. – Mund të ma falësh këtë vallëzim, zonja me të kuqe? – pyeti me dorën e shtrirë.

U, po! Harrova që kam veshur fustan të kuq sonte!

- Tani na e mbushe mendjen! – buzëqesha pa ia vënë veshin komplimentit të tij dhe u ngrita për të kërcyer me Braçen. Ndjehesha e detyruar të tregohesha e kujdesshme dhe e ndjeshme prej çka më kishte thënë Fabiola për përvojën e tij të dhimbshme me dashurinë e fundit, krejtësisht e ndërjegjeshme për brishtësinë e tij dhe timen. Tendosa krahët për të mbajtur një largësi miqësore, ndërsa kërcyem ngadalë me një nga këngët e mia më të dashura, por po bëhej fizikisht e lodhshme për të rezistuar për më tepër se një këngë. I qëndrova deri në fund të këngës dhe e falenderova me një përkulje.

Nuk më pritej sa të isha vetëm në krevat, për të medituar mbi ndodhinë time të fundit me Perëndinë. Nuk vendosja dot çfarë më lumturonte më tepër; fakti që Perëndia më foli sërish apo përgjigja e tij e nënkuptuar. Nuk tha troç që ishte Majku; vetëm se mund ta bënte në një javë po të donte. Më duhej edhe një konfirmim tjetër më i qartë.

E lexova Biblën me etje çdo ditë gjatë javës së fundit të marsit për ndonjë emër a gjurmë, por asgjë nuk më kërceu si herën e fundit. *Se nuk ka punë tjetër Perëndia që të lozë kukamfshefthi me mua përditë!* Zbulimi i javës së shkuar më mjaftonte për të më çelur nurin edhe me afrimin e largimit të Majkut. E dija me gjithë qenien time se do të dilte për mirë sido që të shkonte puna. *Më ngazëllon dhe adhuroj një Perëndi të besës. Ai më njeh më mirë seç njoh veten dhe ka të ardhmen time në pëllëmbë të dorës.* Vendosa që një varëse e artë ishte shumë dhuratë e trishtuar dhe pa imagjinatë për largimin e Majkut. Kisha vënë re që Majku ngrinte pantallonat shpesh, kështu që vendosa të dilja për t’i blerë një rrip lëkure.

KAPITULLI XXII

=====**NJË ËNDËRR E RE**=====

Të premten tjetër, ditën e fundit të marsit, kur shkova te ambasada amerikane, e kapa veten duke kërkuar firmën e Majkut në librin e vizitorëve tek porta. *Qenka kthyer!*

E pashë mes gjullurdisë dhe ai erdhi sapo më pa. *U shyqyr! Nuk i paska ngelur qejfi nga mbrëmja e ditëlindjes sime!*

- Përshëndetje, Majkëll! – e përshëndeta. – Si je?

- Mirë, - m'u përgjigj buzagaz, - mora ca lajme shumë të mira nga familja; u bëra xhaxha përsëri si sot një javë. Po ti?

- Unë kam qenë hallë këtu e pesëmbëdhjetë vjet të shkuara dhe nipi më i vogël sapo mbushi një vjeç dje. Jo edhe aq i brishtë sa një i posalindur, apo jo? – ia ktheva.

- Jo dhe aq, - buzëqeshi Majkëll, paksa i pasigurt nëse e kisha kuptuar pyetjen e tij apo e bëra kastile.

- Urime! Na rrofshin nipçet nga njëqind vjeç!

- Gëzuar! – u pëgjigj Majkëll në shqip. – Më thanë që më kishe kërkuar, - tha me shikim kureshtar.

- Është e vërtetë. Të pata blerë një dhuratë lamtumire dhe erdha të ta jepja tek qendra e komandës, por Ilda më tha që ishe në Sofje të Bullgarisë. Mision brenda misioni?!

- Jo, jo! Më tepër një pushim brenda pushimeve. Më thanë të çlodhesha dhe ta merrja shtruar.

- Seriozisht? Çne?

- Politika. Isha bërë person i rrezikshëm dhe më dërguan me pushime në hotelin më të mirë në Bullgari për të mbajtur dëmin nën kontroll. Fatkeqësisht, ishte larg Shqipërisë.

- E thua këtë sikur të pëlqen Shqipëria, - e ndërpreva, e kapur në befasi nga krenaria ime kombëtare.

- Sigurisht që më pëlqen. Ia kam kaluar shumë mirë dhe kam zënë shumë miq këtu, - u përgjigj Majkëll dhe unë e besova që e kishte sinqerisht. Çdo gjë prej Majkut dukej e mirëfilltë. Megjithëse kjo nuk ishte e vështirë përbri Xhovanit.

- Vajta për vizitë edhe në Fier, vendlindjen tënde, - vazhdoi.

- Vërtet? Përse? Nuk ka ndonjë gjë për të parë! – i thashë, por mendova: “Uuuu! Po më bën biografinë!”. Siç bënte familja e dhëndrit para se të ndante mendjen për nusen e djalit. Dërgonin lajmësin për të hulumtuar e bërë pyetje për qëndrimin politik të familjes së saj, të kaluarës së saj personale, ndonjë gjurmë dashurish apo ndjenjash të mëparshme, etj.

- Dola vërdallë. Ishte qytet i këndshëm, - tha Majkëll dhe pastaj vazhdoi, - Përdora telefonin satelitor të qeverisë sime për të të marrë në telefon te numri i punës një herë, por më doli një plakë. Ishte numër banese.

- Vërtet?! – pyeta me habi. Sa më tepër kohë kaloja me Majkun aq më tepër bindesha që nuk ishte vetëm dëshira e Xhuzepes. Sjellja e Majkut dukej dhe tingëllonte gjithnjë e më tërheqëse. – Ku e gjete (jo) numrin tim? – vazhdova me zë.

- Ia mori Xhovani Fabiolës, - u përgjigj Majkëll. – Duhet t’ia kem marrë gabim.

“Ose ta dha gabim!” – mendova. Nuk do të më çudiste aspak fakti që Xhovani e kishte bërë me qëllim. Sa herë që më afrohej, më krijonte ndjesinë e qenit të jargosur, por nuk ia lejova kurrë vetes të ofendohesha personalisht nga sjellja e tij. Thjesht mendoja që ai nuk mundej ta mbante veten pranë çdo gruaje të gjallë e në lëvizje. Nuk ia vlente t’i thosha ndonjë gjë të keqe për shokun e vet tani që Majkëll ishte në dalje e sipër. Kështu që në vend të saj i thashë: “Mirë, pra. Ja ku është numri im tani. I ngjan ndopak atij që ke ti?”.

- Pothuajse, po jo tamam, - buzëqeshi Majkëll. – Do të përpiqem të të telefonoj përsëri ndonjë herë nga java.

- Mirë, - ia ktheva buzagaz, teksa ndoqëm të tjerët në dalje të bunkerit. – Para se të harroj, këtë erdha të të sillja kur të kërkova javën që shkoi, - i thashë tek nxora rripin e mbledhur nga çanta dhe ia dhashë.

- Hah, më paske blerë rrip! – tha Majkëll dhe filloi ta vinte menjëherë.

- Mendova se do të të vinte ndoresh. Sa herë hidhja sytë nga ty, të shihja duke ngritur pantallonat.

- Edhe ti e paske vënë re! Më duket se kam rënë në peshë që kur kam

ardhur në Shqipëri. Kisha një rrip të mirë, po nuk e gjej dot më. Më duket se ma vodhi përkthyesi.

- S'është çudi. Vjedhja është një kriter kualifikues për një vlonjat që të martohet. Nuk i jep njeri nuse po nuk tregoi se mund të vjedhë, - thashë.

- Atëherë nuk jam duke i imagjinuar gjërat, - tha Majkëll.

- S'ma merr mendja. Mbaj mend dajën (megjithëse nuk ishte vlonjat) që nxiste djemtë të vidhnin nga kooperativa – bile i vinte në sedër për paaftësinë e tyre për të vjedhur, - thashë unë.

- Është e vështirë të respektosh të drejtën e pronës së tjetrit pa pasur tënden, - ma ktheu Majkëll.

- Njerëzit, veçanërisht në fshat, ndjenin njëfarë të drejte pronësie ndaj asaj që kishte qenë e tyre para konfiskimit të tokave të tyre dhe pastaj të kolektivizimit të gjësë së gjallë.

- Do të duhet të paktën një brez për të çbërë gjithë dëmin që i ka bërë komunizmi kësaj kulture. Edhe pse keni një qeveri demokratike tani, ligjet e pronësisë nuk janë shumë të qëndrueshme. Kjo i bën investuesit e jashtëm të maten mirë para se të vijnë për të investuar në vend, - shpjegoi Majkëll.

- Edhe unë që kujtoja se ishe thjesht polic – objekt i barsaletave pa fund këtu! – i thashë edhe një herë e hipnotizuar nga thellësia e njohurisë së Majkut mbi gjendjen politike të vendit tim.

- Jam, - buzëqeshi, - por kam edhe diplomë në shkencat ekonomike. Më pëlqen ta mbaj veten në korrent të ngjarjeve të vendeve të ndryshme, sidomos atyre që vizitoj për punë, - shtoi.

- Edhe ti me departamentin e shtetit je, si Davidi, që udhëton në gjithë këto vende të ndryshme?

- Jo. Jam agjent special me shërbimin e doganës amerikane.

- Uuuuu! Si agjentët e CIA-s apo të FBI-së? – e ndërpreva. – Vetëm me ç'kam dëgjuar nga filmat amerikanë.

- Në njëfarë mënyre; vetëm se agjencia ime është shumë më efikase se sa FBI. Do të duheshin nja dhjetë a dymbëdhjetë agjentë të FBI-së dhe dyfishi në personel mbështetës për të bërë punën e një agjenti të doganës, - tha Majkëll. – Po unë jam me bërthamën ajrore kundër kontrabandës së drogës. Ndonjëherë, duhet të ndërpritet rruga e drogës që në vendin e nisjes, para se të mbërrijë në Sh.B.A.

- Domethënë edhe fluturon?

- Kemi disa avionë të vegjël *Cessna 182* dhe helikopterë *Blackhawk* për gjurmim, por unë nuk jam piloti, megjithëse kam bashkëfluturuar vetë i dytë disa herë.

- Mos je ti ai me mitralozin e madh që del jashtë nga ndenjësja e pasme? – e pyeta duke ngritur zërin gradualisht gjithë emocion e duke sjellë ndër mend Rambon.

- Po, - u përgjigj Majkëll i zbavitur nga reagimi im.

- Nuk ju qëllojnë nga poshtë njerëzit që ndiqni? Apo ashtu ndodh vetëm nëpër filma? – pyeta si një kureshtar i vogël me një milionë pyetje.

- Jo. Ndodh edhe në ndjekjet e vërteta. I qëllojmë edhe ne menjëherë. Vetëm se ndërsa betejat në shumicën e filmave zvarriten për minuta të tëra, në realitet ato marrin fund brenda disa sekondash.

- Nuk ke frikë? – pyeta me mahni.

- Kam parë shumë më keq, - u përgjigj Majkëll. – Në fakt, ime më nuk priste të kaloja të njëzetedytat, - vazhdoi.

Edhe pse Xhuzepe ishte kthyer në Itali, nuk e di pse përfunduam me më tepër njerëz në makinë sesa mund të nxinte një *Blazer* për të vajtur te piceria Magelani. Xhovani doli vullnetar të ngiste makinën sërish, por këtë radhë nuk eci asnjë më këmbë. Pesë nga ne u bënë piring në ndenjësën e pasme: unë ulur tërthor mbi prehërin e Majkut dhe Mira mbi të Samit me një italian tjetër të shtrydhur në mes, të gjithë duke qeshur me mosbesim gjithë rrugës deri atje.

Kur mbërritëm tek piceria italiane, unë u ula në të djathtë të Majkut në një tavolinë shumë të gjatë me kë tjetër veçse Xhovanin në të djathtë dhe pothuajse gjithkënd tjetër nga bunkerit. Duke pritur që të na vinte ushqimi, nuhatjes sime nuk i shpëtoi dot era e djersës së kripur të Majkut, që vinte nga sqetulla e tij e djathtë. Vinte një erë paksa më e fortë se ajo e mamasë sime dhe kjo më pëlqeu shumë. Më sollli ndër mend gjithë netët e fëmijërisë, kur mbështillesha në krevat pas saj, duke thithur krahun e saj të butë e të bardhë.

Pas darke, vura re që Majkëll ndenji pas për të folur me kamarierët.

- Çfarë ka? – pyeta më mbrapa.

- Disa ikën pa paguar për darkën, - tha Majkëll, - po u kujdesa unë për to.

“Edhe bujar, edhe i përgjegjshëm, tamam si ai që u martua me Ruthin në Bibël!” – mendova dhe buzëqesha me vete, teksa hodha hapat ngadalë drejt daljes. “Merre shtruar, çupëel! Peshku në det, tigani në zjarr!” – qortova veten për t’i vënë frerë ngazëllimit tim. *Akoma duke pritur për atë konfirmimin e dytë, o Zot. Sa për t’u siguruar që ishte ti dhe jo imagjinata ime që merr kot shpesh kur shoh ëndrra me sy hapur.*

Të gjithë hipën nëpër makina për një xhiro tjetër troshitëse deri tek ndalesa tjetër, vallëzimi. Majkëll më kërkoi të kërcëja një të ngadaltë me të

dhe unë pranova me gëzim. Vendosa dorën e majtë mbi supin e tij të djathtë dhe mbështeta krahun mbi të tijin. E ula “mburojën” për disa minuta, duke u afruar një çikë më tepër me çdo lëkundje. Tani mund të ndjeja kofshën e tij duke u fshirë midis të mijave herë pas here me çdo hap dhe unë nuk po bëja asnjë përpjekje për ta shmangur. Ishte java e fundit për Majkëll dhe ky ishte vallëzimi ynë i lamtumirës. Kishte qenë i mirë, i kujdesshëm, bujar, besnik, i gjendur dhe i këndshëm sa herë që kishim qenë së bashku. Kërcyem pranë e pranë për një kohë të gjatë pa folur një fjalë. Në fund të këngës, siç më shoqëroi për t’u ulur, Majkëll theu heshtjen e trishtueshme dhe pyeti: “Meqë java e ardhshme është e fundit për mua në Shqipëri, do të mund të më tregojë disa vende të tjera nëpër qytet nesër?”.

- Patjetër! – pranova me gatishmëri. – Megjithëse, teknikisht, meqë ti e nget makinën vetë, je ti ai që na çon gjithandej. Falemnderit!

- Je e mirëpritur! Po vij të të marr nga ora dhjetë te konvikti yt atëherë, - tha Majkëll dhe unë pohova me kokë sa nga njëra anë në tjetrën.

- Shqip apo anglisht ishte kjo shenja e kokës? – pyeti ai duke qeshur.

- Hah! I paske vënë re sinjalet tona së prapthi, ë? – pyeta.

- Më informuan që në fillim për kuptimin e kundërt të pohimit dhe mohimit me kokë, – tha Majkëll në përgjigje.

- Më fal! Harroj t’i përkthej shenjat e kokës. Po! – pohova me kokë lart e poshtë dhe konfirmova gojarisht. – Në orën dhjetë. Kur pohon mami im me kokë, i shton edhe një lëkundje vertikale, që është paksa më e ndryshme se sa thjesht kthimi i fytyrës sa nga një anë në tjetrën.

- Po për jo-në? – pyeti Majkëll. – Ajo më duket tamam si po-ja jonë.

- Ajo është vërtet një çikë më e vështirë. Ngrihet koka lart në vend që të ulet poshtë.

- Por përsërite këtë nja dy herë rresht – dhe unë nuk e mbaj mend në ç’drejtim ishte bërë fillimisht – edhe...

- Edhe vaj me det, thuaj! – miratova. – Merr tatëpjetën shpejt. Meqë ra fjala për keqkuptimet; një herë dëgjova për një nga amerikanët, që nuk fliste fare shqip, tek po tregonte për një rast me një berber shqiptar, që gjithashtu nuk fliste anglisht përveç “po” dhe “jo”. Amerikani vë gishtin tregues nja një centimetër mbi gishtin e madh dhe shton “kaq hiq”. Berberi shqiptar thotë “po” dhe vazhdon me qethjen derisa amerikani ngelet me një cantimë flokë dhe një hakërrimë të zemëruar.

- Kurse berberi pa bakshish, - tha Majkëll ende duke qeshur. – Fatmirësisht, unë kam ndenjur shumë nëpër vende të tjera. E kam goxha të mprehtë komunikimin.

- Dhe një fytyrë prej foshnjeje, - shtova në përgjigje.
- Ee, po i zhgënjeu nja dy alabakë në Vlorë.
- E mbaj mend që përmende diçka herën e parë që u takuam, por nuk e kuptova dhe aq mirë. Si ndodhi?

- Ishte natën vonë. Unë vura re dy rrugeçer që po na ndiqnin mua dhe Bobin dhe u hodhëm nga ana tjetër e rrugës. U hodhën edhe ata. Unë e Bob u futëm në një dyqan për të parë nëse po na ndiqnin vërtet. Kur dolëm përjashta, ata ishin aty, kështu që unë u afrova. Desha ta zgjidhja vetë vendin dhe kohën për t'u ndeshur, po kjo i trembi dhe ikën. Tipike për rrugeçërit!

- Uou! – u shpreha e mahnitur. – Vë bast që ata as që e prisnin fare prej një të huaji. Përgjithësisht, ne i perceptojmë turistët si bythpambukë të pasur, të shkëputur nga realiteti e që jetojnë në botën e çudirave.

- Dhe ndoshta ke të drejtë për ca prej tyre. Duhet para për të parë botë me sy, po unë as udhëtoj me paratë e mia, as jam turist, - tha Majkëll duke qeshur nën buzë.

- Duhet të jetë e vështirë për ata që vijnë për herë të parë, - ia ktheva.

- Kolegu me të cilin isha caktuar të punoja para Bobit e kishte për herë të parë. Atë e kishte paralizuar frika. Shkuam një herë te një manastir të kthyer në hotel për t'u takuar me një nga bashkëpunëtorët tanë që punonte atje.

- Mos ishte ai manastiri në kodër, siç del nga vendlindja ime rrugës për Tiranë? – e pyeta.

- Po, atje është, - pohoi Majkëll.

- Kam qenë atje me shkollën në një ekskursion, - e ndërpreva me ngazëllim.

- Është arkitekturë e lashtë shumë e bukur. Na u desh të kalonim një natë aty dhe kolegu im refuzoi të dilte nga dhoma e tij gjatë gjithë kohës që ndenjëm atje. Po të gjykoje nga fytyra e tij, a thua se po na bombardonin. Si përfundim, kërkoi ta kthenin prapë në Shtetet e Bashkuara vetëm disa ditë pasi kishte mbërritur këtu. E di unë ku mund të gjejmë njerëz të zotë për këtë mision, por nuk bën vaki t'i lejojnë t'u largohen të tjerë nga programi për të cilin punoj. Ata do kenë qenë në gjumë kur m'u dha ky emërim.

- Mos po thua që italianët nuk janë të zotë?

- Unë jam miqësuar me italianët, por ata janë të paorganizuar dhe qeveria e tyre nuk u jep para, - u përgjigj Majkëll. – Sh.B.A.-ja po e financon përpjekjen këtu, por italianët nuk e kanë idenë se kush ka cilën pajisje. Ndërkohë që unë isha në Sofje, fatkeqësisht, njëri prej njerëzve tanë goditi një fëmijë pranë Vlorës me një nga makinat tona.

- Mos! Është mirë fëmija? – pyeta.

- Po, por nuk kishte vajtur askush ta shikonte derisa u ktheva unë nga Sofja.

- Jo ngaqë ishin të paorganizuar, besoj.

- Jo! Kishin pasur frikë. Kur u ktheva në Vlorë, shkova ta gjeja dhe t'i takoja familjarisht. Pagova shpenzimet mjekësore të fëmijës, që do t'i kalojë. I ishte thyer një eshtër e shpatullës. I pashë grafinë. E lashë familjen shumë të kënaqur që u shqetësuam aq shumë për aksidentin.

- Miqtë e tu janë trembur kot. Populli im është popull i shumëvujtur.

- Bëjnë vërtet një jetë të vështirë, - miratoi Majkëll.

Mëngjesi i së shtunës erdhi nja dy orë më herët seç e prisja. Papritur, hapa sytë në shtrat dhe menjëherë u ngrita ndenjtur duke parë rreth e rrotull dhomës sime të konviktit. Oh, ishte ëndërr! Oh, çfarë ëndrre! Perëndia sapo më kishte dhënë konfirmimin e dytë, për të cilin kisha pritur për një javë. Nuk pata më dyshime për atë që kishte zgjedhur Perëndia si burrin për të cilin isha lutur dhe kisha pritur me muaj. Sa shumë doja ta ndaja me Mirën, por ajo ishte ende në gjumë. Unë nuk kisha më gjumë në sy, edhe pse nga drita e paktë në dhomë dukej se ishte ende shumë herët. Hodha sytë nga dritarja dhe pashë agimin me vezullim të artë midis dy perdeve të verdha. Zoti ma kishte mbushur gojën me qeshje dhe zemrën me gëzim përsëri. Nuk dija si ta falenderoja. Hapa Biblën dhe lexova për njëfarë kohe duke falenderuar Perëndinë nga zemra.

Perëndia më kishte treguar qartë se kishte zgjedhur Majkëll. Vetëm tani po shpresoja që Perëndia t'i kishte treguar edhe Majkut të njëjtën gjë. Përndryshe, si do ta dinte për ëndrrën time dhe vullnetin e Perëndisë për ne të dy? Unë nuk mund t'i thosha, por e dija që Zoti do të gjente një mënyrë.

Ndërrova mendje për ta ndarë ëndrrën time me shoqen e dhomës, megjithëse më dukej sikur do të më shpërthente gjoksi. Perëndia më kishte dhënë një gur të çmuar shumë të rrallë dhe unë duhej ta mbaja të fshehur sa më thellë e sa më gjatë që të mundesha.

Fillova të bëhesha gati për të dalë me Majkëll, që dërgoi një studente për të më thirrur emrin në korridor pak para orës dhjetë. Vrapova shpejt te dritarja e lavanderisë në fund të korridorit për t'ia bërë me dorë dhe pastaj renda poshtë shkallëve për ta takuar.

Hipëm në makinë dhe Majkëll e nisi. Dielli po shkëlqente përmes xhamit të përparmë dhe unë nuk mund të fshija buzëqeshjen nga fytyra ime. Majkëll e vuri re dhe pyeti: “Përse qesh?”

- Pashë një ëndërr qesharake që më zgjoi që në pikë të mëngjesit dhe nuk më del nga mendja, - iu përgjigja.

- Si ishte? – pyeti Majkëll.

- Sikur po martohesha te kisha ime te kinema Agimi, - qesha. – Pashë veten duke qëndruar më këmbë përpara, poshtë platformës, me dhëndrin në të djathtë. Pastori suedez, themeluesi i kishës sime, po qëndronte mbi platformë përballë nesh duke vënë dorën e tij mbi kokën time dhe pastaj të dhëndrit, si për të na bekuar ne dhe martesën tonë. Ta merr mendja kush ishte dhëndri?

- Shpresoj të isha unë! – u përgjigj Majkëll.

- Ti ishe! – i thashë dhe nuk m’u besua që kisha kapërcyer një hendek që e mendova të pakalueshëm vetëm një orë më parë. *Kaq ishte, Zot? Kjo na qenkësh mënyra jote e mbinatyrshme për t’i thënë Majkut ëndrrën time?*

Ra heshtja në makinë. Majkëll u bë shumë serioz dhe nuk tha asnjë fjalë për nja dy minuta, por unë sa nuk ia dëgjoja intensitetin e të menduarit. Pastaj e theu vetë heshtjen e sikletshme me një pyetje: “Ke qenë ndonjëherë larg familjes?”

- Kam jetuar në Greqi, larg prindërve, por me vëllanë dhe familjen e tij vjet për rreth tetë muaj, - ia ktheva.

- Te vëllai me djalin njëvjeçar?

- Jo. Ai jeton në Fier me prindërit e mi. Ai që është në Greqi ka dy djem tani, - shpjegova shumë e çliruar që biseda jonë po anonte drejt një teme shumë më të rehatshme. – Ku do që të shkosh sot? – vazhdova, ndërsa Majkëll e ngau makinën përmes qytetit.

- Eëë, ti ma ke treguar muzeun kombëtar. Kisha ndërmend ndonjë vend tjetër?

- Të pëlqen muzika klasike?

- Më pëlqen, - u përgjigj Majkëll.

- Është një koncert sonte te Artet, por fillon nga ora gjashtë mbasdite. Deri atëherë, mund të shkojmë të marrim Dorin te shtëpia e saj në Durrës dhe bëjmë xhiro nga plazhi, - propozova duke menduar: “Më duhet mendimi i një mamaje. Po ma pëlqeu mami i Dorit, mbase ma pëlqen edhe mami im”. Pastaj pyeta: “Ti e mban mend Dorin, apo jo?”

- Po, e mbaj mend. Ishte te ditëlindja jote, në mos gaboj?

- Tamam, - ia prita.

- Mirë atëherë, jemi për Durrës, - pranoi Majkëll dhe më hodhi një shikim të qeshur. *U, shyqyr! U çel prapë!* – Nga e njeh Dorin? – pyeti Majkëll.

- E kam pasur në klasë për pesë vjet në inxhinieri. Ishim vetëm katër vajza mes njëzeteca djemsh në grupin tonë, që përbëhej prej gjithë studentëve që kishin bërë anglisht gjatë shkollës fillore dhe të mesme. Leksionet i bënim bashkë me ata të frëngjishtes dhe rusishtes dhe ndaheshim për seminare dhe laboratore.

- Sa mirë që mësove anglisht! – tha Majkëll.

-E. Ndjehem shumë me fat që shkolla ofroi anglisht në klasë të pestë; atëherë e filluam gjuhën e huaj në shkollë. Rusishtja dhe anglishtja ndërroheshin çdo dy vjet te shkolla ime, po pati shkolla që ofronin edhe frëngjisht.

- Edhe Dori te Soros-i punon? – pyeti Majkëll.

- Jo. Ajo punon tek fakulteti. Mua më pëlqen më shumë të jem përkthyesë sesa inxhinierë. Paguhem edhe më mirë ashtu.

- Po pse zgjodhe inxhinierinë, pastaj?

- Nuk e zgjodha. E zgjidhte shteti shkollën në të cilën përfundonim pas së mesmes.

- Përse e ke fjalën? – pyeti Majkëll.

- Në fund të çdo viti, seksioni i arsimit të komitetit ekzekutiv të rrethit mbante një mbledhje të gjatë, ku anëtarët diskutonin dhe caktonin çdo maturant të rrethit që plotësonte kushtet në degën që do të studionte për katër-pesë vjetët e ardhshëm, në varësi të fushës.

- As që nuk ju pyesnin çfarë donit të studionit?

- Secili tregonte tri degë në fletëkërkesë, por, përgjithësisht, studenti me mikun më të fortë në komitet i afrohej një çikë më tepër degës që ëndërronte. Pastaj, që të bëheshe përkthyes, duhej ta bëje edhe shkollën e mesme për gjuhë të huaja. Unë e kisha humbur atë rast. Kishte vetëm tri shkolla të tilla në vend dhe asnjëra prej tyre në qytetin tim. Im atë dhe vëllezërit nuk do të më linin kurrë të jetoja në konvikt që katërmbëdhjetë vjeçe.

- Si e zgjodhën elektronikën për ty?

- Histori e gjatë, - thashë duke e kujtuar me dëshirë, - por si përfundim ishte hiri i Perëndisë.

- Kemi gjithë ditën, - buzëqeshi Majkëll.

- Elektronika as që më kishte shkuar në mendje. Lakmohej shumë dhe më e afërta që kisha menduar me të ishte inxhinieria mekanike, sepse ishte fakulteti më i vështirë në universitet, zakonisht i rezervuar për ata që kishin

nota të shkëlqyera, po që nuk kishin mik. Miku im i vetëm në komitet që mendoj se mund të ketë pasur të bëjë me vendimin e tyre ishte drejtori i shkollës sime.

Drejtori ishte një burrë i hollë ezmer me flokë pis të zeza që i krihte lart, si im atë. Ishte shumë inteligjent, disi autoritar dhe shumë i respektuar në qytet. Kjo e fundit mund të kishte të bënte me vulën që i kishte vënë së ardhmes së mijëra maturanëve për pesëmbëdhjetë vjetët e shkuar.

Në fillim të maturës, ra nga detyra si shef i seksionit të arsimit në atë të drejtorit të shkollës sime. Me sa duket, i shkonte fjala ende me komitetin, sepse pëshpërimita e tij në veshin e duhur ishte i vetmi shpjegim që mund të nxirrja për emërimin tim në fakultetin që përfundova.

- E bënte për shumicën e maturanëve? – pyeti Majkëll.

- S'besoj. Ishim me qindra. Dukej sikur sa herë që vinte drejtori për kontroll në klasën time, kisha radhën për t'u ngritur e marrë dhjetë në mësim para klase dhe para tij, i ulur diku në një bankë nga fundi i klasës. Për çudinë time, ndodhi edhe në palestër një herë për kontrollin e zyshës së fizkulturës, e cila më zgjodhi mua nga njëzeteca vajza për të demonstruar drejtpeshimin me një këmbë të shtrirë mbrapa, majë trarit të ekuilibrit, e veshur vetëm me një bluzë të bardhë e kilota të zeza!

- Të përfytyroj me lehtësi duke e bërë atë, - buzëqeshi Majkëll. – Duhet t'i kesh lënë mbresë për një kohë të gjatë.

- M'u duk sikur kisha dalluar nga të tjerët jo vetëm në mësim. Drejtori im tregonte mirënjohje edhe për veprimtaritë e mia joshkolllore, si kur këndova solo në koncertin vjetor të pranverës ose kur drejtova një mësim të hapur tërësisht në anglisht. Isha gjithandej nëpër shkollë atë vit.

- E mbaj mend kur këndove atë natë tek "La Piazza". Ke zë të bukur! – admiroi Majkëll.

- Sikur të mos mjaftonin këto, gjatë mbrëmjes së maturës, se si ma shkrepiti që të merrja drejtorin për të kërcyer dhe kisha besim që nuk do të ma prishte. Mora guximin përmes turmës së nxënësve dhe i kërkova me përulje drejtorit tim hijerëndë të kërcente me mua.

- Drejtori yt i shkretë nuk kishte nga t'ia mbante! – tha Majkëll.

- Shumica e moshatarëve të mi kishin prindër të rinj me pozita dhe miqësira që bënin përndjekjen. Im atë kishte dalë në pension atëherë; nuk kishte çfarë t'i ofronte si shpërblim.

- Pse, ti kishe? – ngacmoi Majkëll.

- Mua m'u desh të merrja frerët në dorë vetë. Bëj shaka! – ia ktheva

buzëqeshjen. – Nuk planifikova asnjërën prej tyre. Edhe që e kërkova të kërcente me mua ishte një lajthitje e çastit. Ai ishte burrë me taban. Gjatë vallëzimit, më pyeti se për çfarë e kisha hedhur bursën. “Pa fyer mësuesit”, - ia ktheva unë, - “nuk kam as talent as dëshirë të jap mësim. Edhe pse kërkova mjekësi për hir të tim eti, as unë nuk dua të merrem me gjak, as im atë nuk ka aq miq sa të ma sigurojë. Prandaj jam përgatitur mendërisht për më të vështirën e të gjithave, inxhinierinë mekanike”. Nëse drejtori im kishte të bënte me zgjedhjen përfundimtare, isha shumë e kënaqur që vendosi të devijojë nga mekanikja në elektronikë, se unë bëra mekanikë një semestër dhe nuk ia thosha fare, - përfundova.

Kur unë e Majkëll mbërritëm tek shtëpia e Dorit, të dyja motrat dhe nëna e tyre u shtangën kur na panë. Gocat e përshëndetën Majkëll me ngazëllim dhe më ngulën sytë me pikëpyetje.

- Është java e tij e fundit në Shqipëri, - shpjegova, duke u përpjekur të fshihja arsyen time të vërtetë për ta sjellë Majkun në shtëpinë e tyre. – U afruam një çikë si shumë duke kërcyer mbrëmë në disko dhe ai mori zemër; më kërkoi t’i tregoja ca vende përreth.

- Po ti sikur ia tregove një herë më parë, apo jo? – ngacmoi Dori.

- Ee, - thashë buzagaz, - do ia kem treguar shumë mirë atëherë dhe u kthye për ca të tjera. Po i kemi parë të gjitha vendet e bukura në Tiranë, kështu që thashë të ndërronim peizazhin, - vazhdova. – Do më ndihmoni ju t’i tregojmë ca plazhe mahnitëse?

- Patjetër, - u hodh Dori dhe Enxhi miratoi me kokë. – Gjynah që nuk e çuam dot andej nga veriu, nga liqejt e Lurës apo Alpet që të lënë pa mend! – vazhdoi Dori në anglisht.

- Kam qenë në veri. Kam parë kështjellën më të vjetër në Evropë, - tha Majkëll.

- Ke qenë në Shkodër?! – pyeta me habi. – As unë nuk kam qenë te kalaja e Rozafës.

- As unë, - tha Dori. – Ta thanë legjendën? – pyeti ajo.

- Jo. Cilën legjendë? – pyeti Majkëll.

- E shikon sa e rëndësishme është të kesh shoqëruesin e duhur? – thashë duke qeshur nga Dori.

- Cilën legjendë? – pyeti Majkëll sërish.

- Legjendën e kështjellës, - u hodh Dori. – Ta them unë. Na ishin një herë tre vëllezër që kishin tri gra të bukura, më të resë prej së cilave sapo i kishte lindur një djalë. Vëllezërit vendosën të ndërtonin një kështjellë në kodrat shkëmbore mbi luginën midis dy lumenjve të Bunës dhe Drinit. Ata punonin deri vonë ditë për ditë dhe gratë u sillnin drekën me radhë. Po çdo mëngjes, kur ktheheshin në kantier, i gjenin muret të rrënuara. Të demoralizuar dhe pa zgjidhje, pyetën një plak të urtë për këshillë. Ai u tha që muret kanë nevojë për flijim njerëzor – dikë që donin shumë – dhe pastaj muret do të qëndronin. Vëllezërit e diskutuan me njëri-tjetrin dhe vendosën të flijonin njëri nga gratë – atë që do të sillte drekën të nesërmen. Gruaja e flijimit do të varrosej në muret e kështjellës. U betuan që nuk do t'u thoshin grave për vendimin që kishin marrë, por vetëm i vogli e mbajti fjalën.

Të nesërmen mbasdite, dy nuset e mëdha nxorën nga një arsye për të mos marrë udhën e mallkuar. Më e reja, Rozafa, doli vullnetare me dëshirë dhe shkoi në vend të tyre. Kur Rozafa mbërriti në vend, burri i saj i hidhëruar i shpjegoi me lot në sy marrëveshjen e vëllezërve. Ajo do të bëhej flijim dhe do të varrosej në muret e kalasë që ta mbaronin së ndërtuari. Rozafa nuk protestoi, por kishte merak për foshnjën. E pranoi fatin e saj me kusht që t'i linin jashtë njërin gjë për të ushqyer të birin, njërin sy për ta parë, njërin dorë për ta përkëdhelur dhe njërin këmbë për t'i tundur djepin. Thonë që qumështi vazhdon të pikojë sot e kësaj dite prej mureve të kështjellës, - përfundoi Dori.

- Mahnitëse! Megjithëse unë do të kisha rënë dakord me një vendim të tillë vetëm në rast se asnjëri prej vëllezërve nuk do të lejohej të shkonte të flinte në shtëpi atë natë. Po hajt mo, legjendë është, - tha Majkëll.

- Na falni sa të ndërrohemi nga pizhamat, - tha Enxhi dhe të dyja motrat na lanë me mamanë e tyre në dhomën e pritjes.

- Si thua? – e pyeta mamin e Dorit në shqip e i buzëqesha me sy të mbledhur rrudhë.

- Unë them ta mbash fort e mos ta lëshosh! – tha mamaja sikur të më kishte blerë mendjen dhe unë u kënaqa shumë me përgjigjen. *Iku një mama; tani kam edhe një!*

Sapo vajzat u bënë gati, të gjithë zbritëm shkallëve dhe hipëm në *Blazer*. Dori dhe Enxhi u ulën mbrapa dhe pyetën nëse mund të sillnin një shok me vete. Majkëll pranoi dhe ne morëm Vlashin te shtëpia. Vlashi kishte qenë shok i motrave që nga shkolla e mesme. Vinte i ndrojtur por i sjellshëm, me flokë të zeza mbi supe dhe dinte ku të na çonte në qytet një çikë më mirë se sa shoqet e mia.

- Vlash, - pyeti Dori pasi na prezantoi të gjithëve, - e mban mend si shkohet te ajo kafeneja e re nga plazhi?

- Po, - iu përgjigj Vlashi i gatshëm. – Ju çoj unë.

Rreth dhjetë minuta më vonë, mbërritëm te një restorant i rrethuar nga disa pisha në një kodër mbi detin e qelqtë. Rrezet e diellit pasqyroheshin mbi sipërfaqen e lëmuar të ujit që reflektonte një dritë të bardhë e vezulluese rreth e rrotull nesh. Majkëll nxori aparatën fotografikë dhe ne kaluam shumicën e asaj dite të bukur të parë të prillit duke folur, qeshur e duke marrë shumë poza. Flokët e Majkut ishin tharë tashmë dhe drita e diellit shkëlqente përmes kaçurrelave të tij të verdha. Më ngriti peshë e më mbajti para duarve si tabaka, ndërsa vetë qendroi më këmbë për një nga pozat, pastaj më mbajti në prehër për një tjetër, ndërsa vetë u ul mbi një shkëmb. Majkëll po trimërohej gjithnjë e më tepër pas çdo fotografie dhe unë ndjehesha më afër dhe më pak e rezervuar, edhe pse nuk kisha kurrfarë ideje se çfarë po mendonte për ëndrrën time.

Unë e Majkëll u kthyem në Tiranë në kohë për një xhiro nga parku pranë Arteve para se të fillonte koncerti. Ishim vetëm e të heshtur sërish.

- Unë erdha të kërkoja prapë te mbrëmja e ditëlindjes, po ti kishe ikur herët, - theva heshtjen.

- Të pashë duke kërcyer me dikë tjetër dhe mendova që e kishe të dashur.

- E di për kë e ke fjalën. Ai është thjesht një shok i vjetër nga shkolla. Na ka shkuar githmonë kërcimi bashkë. I dashuri im iku jashtë shtetit pas diplomimit për të vazhduar studimet në Londër. Pak pasi iku, më kërkoi që të shkoja dhe unë pas tij duke kaluar nga Greqia, po pastaj u bë pishman dhe harroi të më thoshte edhe mua.

- Prandaj ishe në Greqi? – pyeti Majkëll.

- Ëhë, duke pritur të më dërgonte pasaportën që më duhej për të kaluar nga Greqia për në Itali dhe përfundimisht në Angli. E prita rreth nëntë muaj, por ishte pritja më e gjatë dhe më e vështirë e jetës sime. Nuk kam për ta bërë më këtë, - thashë dhe heshta. – Po unë pata përshtypjen se ti i dije të gjitha këto. Fabiola më tha që Xhuzepja po e pyeste për mua nga ana jote dhe ajo ia tha të gjitha.

- Nuk e dija. Xhuzepë vetëm më tha që ishe vajzë e mirë dhe e lirë nga çdo lloj përkushtimi, e lirë si zog.

- Yll Xhuzepja, po vetëm Perëndia është i mirë! – thashë duke qeshur dhe mbajta këmbët. – Duhet të kthehem po deshëm të kapim koncertin.

Majkëll pranoi dhe filluam të ktheheshim drejt Institutit të Lartë të Arteve. Bëra me dorë nga njëra anë e rrugicës, drejt barit dhe fillova me një barsaletë: “Na ishte një herë një djalë i ri në punë të vet, duke bërë pompa në park. Kaloi njëri, e pa duke bërë ushtrime dhe ndaloi. I erdhi rrotull, e pa dhe ca pastaj i thotë: ‘Ore, e di ti që të ka ikur dashnorja ty?’”.

Majkëll vuri buzë në gaz dhe unë u zhgënjeva paksa që nuk qeshi aq fort sa kisha qeshur unë kur e kisha dëgjuar barsaletën për herë të parë. *Sa të vështirë e kam të përkthej humorin!*

Pas koncertit, u kthyem në makinë dhe Majkëll filloi ta ngiste drejt konviktit tim. Papritur ndaloi në anë të rrugës sapo kaloi stadiumin para se të futej në rrugën e Elbasanit dhe parkoi. “O-o!” – mendova, po para se të mendoja gjë tjetër, ai rrëshqiti në anën time të ndenjësës, mbështolli krahun rreth belit tim dhe më puthi fort. “Po ky ku i kishte fshehur gjithë këto buzë? Nuk dukej të kishte shumë nga jashtë!” – mendova përsëri. M’u duk sikur puthja i vuri vulën; sikur kishim një jetë të tërë që njiheshim dhe tani i përkisnim njëri-tjetrit.

- Do të isha i çmendur të të ktheja në shtëpi sonte! – tha Majkëll pas puthjes së eprhme. – Po unë jam i çmendur, - përfundoi pas një pauze të shkurtër dhe rrëshqiti prapë pas timonit. E futi makinën në rrugë dhe më ktheu në konvikt.

KAPITULLI XXIII

PËRPJEKJA E PARË

Nuk mora lajm nga Majkëlli të hënën dhe nuk i thashë askujt as për ëndrrën që kisha parë e as për takimin tonë të gjatë të së shtunës. Të martën në mëngjes, sapo mbërrita në punë, sekretarja e re bukuroshe, më dorëzoi një shënim të shkurtër me shkronja shtypi të mëdha. Kishte mbërritur pak më parë atë mëngjes, me faks:

Për: MIRELA MUKAJ

Nga: MAJKËLL KLAIN

E DASHUR MIRELA, PO PËRPIQEM TË TË MARR NË TELEFON, POR TË DYJA LINJAT JANË TË LIDHURA ME NJË FAKS OSE KOMPJUTER. DO TA PROVOJ PRAPË MË VONË.

MIRELA, UNË TË DUA DHE DUA TË MARTOHEM ME TY KËTË TË SHTUNË NË VLORË.

NA DUHET TË MARTOHEMI SA MË SHPEJT QË UNË TË MERREM ME VIZËN TËNDE PARA SE TË KTHEHEM NË SHTETET E BASHKUARA. PËRNDRYSHË DO TË DUHEN SHUMË MUAJ PËR TË TË NXJERRË VIZËN. UNË NUK MUND TË TA GJEJ KËTU NË SHQIPËRI UNAZËN QË KE PARË NË ËNDËRR, POR KUR TË VISH NË KALIFORNI, DO TË TË BLEJ UNAZËN QË DO. HË PËR HË, DO TË NA DUHET TË PËRDORIM NJË UNAZË PREJ KËTU.

Buzëqesha, tek lexova shënimin duke u futur në zyrë dhe u lëshova në karrigen time. Nuk m'u besohej syve. Ra zilja e telefonit në tavolinën time dhe unë e ngrita menjëherë.

- Kam njëfarë z. Klain në linjë për ty, - tha sekretarja.

- Po, falemnderit! – ia prita dhe ajo bëri lidhjen.

- Alo, - dëgjova zërin e Majkut, që tingëllonte më i hollë nga telefoni. – E more faksin tim? – pyeti ai.

- E mora. Sapo e lexova disa herë. Po qeshja kur lexova për shqetësimin tënd për unazën. Jam e sigurt që ajo pjesë është simbolike. Nuk më bëhet shumë vonë për bizhuterira, - iu përgjigja me ngazëllim.

- Sot kam lënë një takim me priftin te kisha ortodokse këtu në Vlorë për më vonë.

- Mirë, - i thashë, po isha ca e ngatërruar dhe në fakt po mendoja: “Po dasma e ëndrrës ishte te kisha ime. Ajo pjesë nuk m'u duk simbolike”.

- Do të të marr në telefon sapo të flas me të, - tha Majkëll dhe e mbylli.

Mori sërish në telefon nja dy orë më mbrapa pak i zhgënjyer. Majkëll tha që dasma te kisha ortodokse vinte si kusht nja dy muaj këshillimesh paramartesore dhe nuk mund të bëhej atje. Unë mora frymë e lehtësuar dhe ia prita: “Të thashë unë, ishte te kisha ime këtu në Tiranë”.

- Që mos të gëzohesh para kohe për këtë, folja me disa zyrtarë të tjerë këtu dhe ata më thonë që asnjë martesë kisha nuk njihet nga shteti dhe pa atë nuk mund të marrim dot vizën tënde. Ne duhet të martohemi te Bashkia. Po vij në Tiranë nesër që të të marr te puna nga ora dhjetë.

- Mirë, - miratova sërish. “Po nuk është as atje!” – kundërshtova me vete. Nuk më bëhej vonë fare çfarë kishin thënë zyrtarët. Unë e kisha shumë të qartë se çfarë kishte thënë Perëndia dhe ashtu do të dilte. As ishte në dorën time ta bëja të ndodhte, as të kundështoja më kot për këtë.

Të nesërmen në mëngjes, erdha në punë me fustanin tim atllas të bardhë që më kishte qepur shoqja ime, Jeta, geta xhami ngjyrë mishi dhe këpucë të bardha. Kisha fytyrë të qeshur dhe një zemër të mbushur që sa s'po më shpërthente nga gëzimi.

- Ua, ua, ua! – tha njëra prej shoqeve të zyrës me habi. – Ç'janë gjithë këto të bardha dhe ky surrat i ndritur? Po shkon në ndonjë dasmë pas pune?

- Ç'dasmë, moj? Të mërkurën? – ia prita buzagaz dhe u ula në karrigen time. Ishte shumë e vështirë të përqendrohesh në punë duke parë nga dritarja për një *Chevy Blazer* të bardhë çdo dy minuta. Rreth një orë para se të mbërrinte Majkëll vendosa që ishte koha t'i thosha Fabiolës. Ajo e ngriti receptorin menjëherë.

- Alo!
 - Jam unë. Nuk do ta besosh se çfarë më ka ndodhur dje.
 - Çfarë? – pyeti Fabiola me padurim.
 - E mban mend kur kujtova se Perëndia po më çonte në një vend të premtuar?
 - Po. Edhe? Hë.
 - Mirë dëgjo tani, - i thashë dhe fillova t’i lexoja faksin e Majkut të një dite më parë, ndërsa Fabiola këlthiste nga ana tjetër në mbarim të çdo fjalie.
 - Ameen! Ameen! Alelujaaa!
 - Po vjen të më marrë sot që të martohemi te Bashkia, por do të na duhen nja dy dëshmitarë atje. Do të vish?
 - Ameen! Ameen! – vazhdoi të këlthiste Fabiola e papërmbajtur. – Patjetër! Di gjë Mira?
 - Nuk i kam thënë askujt deri tani.
 - Vë bast që edhe ajo do të donte shumë të vinte. Do të telefonoj Xhonin menjëherë pastaj vemi e marrim te shkolla.
 - Për së mbari. Falemnderit!
 - Mirë, po e mbyll tani. Perëndia është i mirë! – tha Fabiola.
 - Gjithmonë! – ia prita para se ta mbyllte.
- Kur pashë *Blazer*-in e Majkut të parkuar në rrugë para godinës, kapa shefin tim, mbikqyrësin e bërthamës së inxhinierëve sapo hyri në zyrë. Majk ishte një burrë në të pesëdhjetat, i gjatë, paksa i shëndoshë me flokë të bardha. Ishte shumë e lehtë për t’i folur, po unë prapë e kisha të vështirë t’i kërkoja çka kisha ndër mend.
- Z. Majk, mund të të pyes për diçka? – i thashë, ndërsa lutesha për kurajo dhe fjalët e duhura.
 - Shkrepe, - tha z. Majk duke buzëqeshur.
 - A mund të më japësh nja dy orë leje?
 - Sigurisht, - u përgjigj ai dhe unë mora frymë e çliruar. Pastaj shtoi: “Për ku kështu? Dukesh goxha festive sot. *Mos! Thashë se ia hodha!*”
 - Po shkoj te Bashkia të martohem, - i pëshpërita.
 - Z. Majk mbeti me gojë hapur.
 - Urime! Merre gjithë ditën pushim. Gjithë javën, xhanëm, - tha me fytyrë të qeshur.
 - Falemnderit! – u përgjigja dhe pashë nga dritarja Majkëll ende duke pritur në makinë. Majk hodhi sytë në të njëjtin drejtim dhe pyeti: “Amerikan?”, së cilës ia prita në miratim me kokë.

- Do të jesh njëra prej nesh tani. Gooool për amerikanët! – brohoriti dhe shtoi, - Paska qenë burrë me fat!

Unë i buzëqesha dhe ia prita: “Jam unë fatlumja!”.

Vrapova poshtë shkallëve dhe eca drejt *Blazer*-it. Majkëll doli nga makina, më përqafoi dhe më puthi.

- U the gjë? – pyeti për shokët e mi të zyrës.

- I kërkova nja dy orë leje shefit në anglisht. Më dha pushim gjithë javën. Nuk jam e sigurt nëse e mori vesh njeri tjetër, po nja dy nga zonjat po më ngacmonin për fustanin e bardhë më parë. Fabiola, Mira dhe Xhoni do të na takojnë te Bashkia si dëshmitarë. Fabiola nuk mbahej nga gëzimi në telefon.

- Hajde për hajër na daltë! – tha Majkëll vendosmërisht dhe filloi me makinë drejt Bashkisë.

Kur mbërritëm atje, pashë Fabiolën dhe Mirën përjashta duke na pritur. Xhon dhe Sam, gjithashtu nga Misioni i Asistencës së Sanksioneve, i dhanë dorën për ta uruar, ndërsa Mira dhe Fabiola më përqaftuan duke u hedhur e duke këlthitur nga gëzimi.

Iu ngjitëm shkallëve brenda për në katin e dytë dhe gjetëm derën e gjendjes civile. Pashë një çift tjetër që po prisnin te dera, por kur u afrova, i njoha të dy. Ervini ishte një shok shumë i mirë që e njihja nëpërmjet Vilmës, por ishte edhe kushëriri i parë i Bertit. Vajza që po priste me të ishte e njëjta që kisha parë duke ecur përkras Bertit natën që më kishte kërkuar të festoja Pashkët me të dhe shokët e tij. Vilma kishte dëgjuar që ajo ishte e dashuruar pas Bertit, ndërsa ai më këndonte mua serenata.

- Ervin! Po ti, çne këtu?! – e pyeta me habi.

Ervini buzëqeshi dhe shpjegoi sa më pak që të mundte: “Është një çift tjetër brenda. Po presim radhën për ta çuar nëpunësen te Berti”.

Qëkur isha kthyer nga Greqia, kisha dëgjuar për burgosjen e Bertit për kontrabandë cigaresh, por e kisha harruar fare. As Ervini e as e fejuara e kushëritit të tij nuk dukeshin të etur të më jepnin hollësira. Vetëm se më mahniti fakti që ajo, jo vetëm që e priti gjatë gjithë viteve që ai u sorollat, por tani ishte e gatshme të martohej me të edhe ndërsa ishte i burgosur.

Për këtë lloj dashurie e ka fjalën Bibla kur thotë: “Dashuria është e durueshme ... nuk mendon të ligën ... mban gjithçka, beson gjithçka, shpreson gjithçka, duron gjithçka”? Nëse po, atëherë unë nuk e kisha dashur Teon, sepse as nuk kisha pritur, as nuk kisha shpresuar e as kisha duruar gjithçka. Po pse po më ha ndërgjegjja me lënjë, atëherë? Pse ishte në

ëndrrën e dasmës sime, më këmbë në radhët e fundit duke më shoqëruar me sy në heshtje, siç po dilnim nga kisha unë e Majkëll?

- Po ti? – ma ktheu edhe Ervini me pyetje.

- Po martohem me Majkun këtu, - ia prita dhe ndjeva gjykim për herë të parë. Nuk kisha patur kohë të mendoja për perceptimin e martesës sime të shpejtë me një amerikan në gjendje prej shokëve të mi jobesimtarë. Ndjeva një shtysë për t'i dhënë Ervinit një llogari të hollësishme të shenjave dhe mrekullive të Perëndisë për martesën time me Majkëll, por do të kishte qenë për arsyen e gabuar; jo për t'i dhënë lavdinë Perëndisë, por për të pastruar ndërgjegjen time prej fajit që ndjeja. Ishte e kotë.

- Urime! – tha Ervini.

- Edhe ti! – i thashë vajzës dhe shtova, - Shumë të fala dhe urime Bertit prej meje!

“Sa çudi që do të martoheshim në të njëjtën ditë, vetëm se me dy persona të ndryshëm!” – mendova.

Çifti tjetër doli dhe Ervini tha: “Mbaroni ju një herë, meqë neve na duhet ta marrim nëpunësen me vete”.

U futëm të gjithë brenda zyrës së vogël dhe nëpunësja na kërkoi çertifikatat e lindjes.

- Nuk e kam me vete, - u përgjigj Majkëll, - po kam pasaportën.

- Më vjen keq, por nuk është pasaporta ajo që kërkohet, - tha nëpunësja në shqip. – Më duhet çertifikata e lindjes, me emrin e babës, nënës, etj., - vazhdoi ajo.

- Po e di unë emrin e babait, - kundërshtoi Majkëll më kot. – Ta them unë.

- Më vjen keq, zotëri, - përsëriti nëpunësja dhe unë nuk mendoja gjë tjetër veçse: “Të thashë që nuk është këtu, është te kisha ime!”.

Të gjithë, përveç meje, dolën disi të zhgënjyer që nuk ishim martuar, por ende nuk e kishin marrë veten nga e gjithë ideja dhe shpejtësia me të cilën po përmbushej. Unë e dija vullnetin e Perëndisë dhe planin e tij për këtë dasmë, por më vinte po aq mirë të dëgjoja edhe për martesën në vijim. Majkëll ngadalësoi hapat për të krijuar ca largësi nga “dëshmitarët” tanë dashamirës dhe me zë të ulët më premtoi: “Nuk të prek derisa të martohemi!”. I zgjedhuri i Perëndisë kishte integritet dhe donte ta fillonte martesën tonë për së mbari. *Lëvduar qoftë emri yt, o Zot, për një konfirmim tjetër të zgjedhjes tënde!*

- Mund ta planifikojmë siç e pashë në ëndërr tani – tek kisha ime? – pyeta në dëgjimin e gjithë të tjerëve.

- Cilën ëndërr? – pyeti Fabiola.

- E pashë të gjithë dasmën në ëndërr të shtunën në mëngjes. Më zgjoi që në pikë të mëngjesit.

- Dhe nuk the asgjë?! – tha Mira.

- Nuk i thashë askujt, përveç Majkut, deri më sot. Unë nuk u kam thënë as prindërve të mi. Dësh u martua e bija dhe ata as që e kanë idenë. Më duhet të vete t'u them vetë tani që kam disa ditë leje.

- Ma trego ëndërrën! – këmbënguli Fabiola. – Te kisha jote ishte?

- Po, me kinemanë plot me njerëz dhe pastorin duke na bekuar të dyve me dorë mbi kokë, një nga një, - shpjegova.

- Po çfarë po bëje këtu atëherë?

- Majkut i thanë që çertifikata e kishës nuk njihet nga shteti, gjë që është e vërtetë. Kjo do të thotë që nuk mund të më nxjerrë dot vizën për të ikur me të. Prandaj donte ta provonte me rrugën ligjore një herë. Më duhet të flas me pastorin për të dielën, po ata nuk mblidhen deri vonë mbasdite.

- Po sikur të shkojë Mira te kisha, ndërsa unë e ti kthehem sot? Të lë ty te prindërit e tu dhe pastaj të marr të dielën kur të kthehem, - propozoi Majkëll dhe mua më pëlqeu ideja edhe pse më tmerronte t'ua tregoja prindërve. *Po sikur mos ta pëlqejnë?*

- E ke problem, Mira? – e pyeta.

- Aspak! – pranoi ajo e gatshme. – Shkoj u them unë. E lëmë për nga ora gjashtë?

- Mirë më duket. Duhet të bëhet mbasdite, sepse në mëngjes bëhet shërbesa. Të lutem, shko thuaju orën edhe atyre të punës sime.

- Mirë, ik, bëj qejf! Mos u shqetëso për asgjë këtej! – shtoi Mira po aq e lumtur sa unë.

- E dinit që ka një “hash” në Llogara këtë fundjavë? – pyeti Xhoni, që e kishte fjalën për vrapin –tradita e amerikanëve për paraditen e çdo të shtune. – Majk, po ti ke qenë në Llogara? Ka ca kabina të lezetshme të fshehura mes gjelbërimit të kodrave në jug të Vlorës, para se të kalosh qafën për në detin Jon. Është një mrekulli! Atje do i kesh të gjithë këtë të shtunë.

- Kam kaluar mes pemëve dhe matanë qafës për në det, po nuk kam ndenjur te kabinat, - u përgjigj Majkëll. – Mirela do të jetë në shtëpi me prindërit e saj, kështu që mund edhe të vij me ju atje të shtunën.

- Mirë, atëherë. Kalofshi mirë! – përshëndeta shoqet e mia dhe ato u larguan në makinë me Xhonin.

- Kalojmë dot nga dhoma ime një herë, që të heq fustanin e dasmës unë? – pyeta Majkëll. – Më duhet edhe Bibla.

- Po, por më parë shkojmë te ambasada që të fillojmë procesin e vizës për ty, - u përgjigj Majkëll.

Vizë për Amerikë! Sa hap e mbyll sytë! Unë vetëm burrë të kërkoja, o Zot. Ti po më jep edhe vendin e ëndrrave për sa e sa njerëz. Si Solomoni që kërkoj vetëm urtësi, po Perëndia i dha edhe pasuri e lavdi. O Zot, sa më do! Sa uroj të të kisha njohur më parë. Sa uroj ta kisha ruajtur veten për burrin tim. Ndoshta do të më kishe kursyer këtë turp që po më gërryen nga brenda tani. Më fal, o Zot!

Pasi plotësuam fletëkërkesën për vizë fejeje tek ambasada amerikane, Majkëll më çoi te konvikti për t'u ndërruar. Mora disa tesha dhe Biblën time të vogël.

- Nuk largohem shumë pa Biblën, - i thashë Majkut. Pastaj mblodha gjithë guximën që kisha brenda meje dhe shtova: “Desha të të paralajmëroj që Perëndia do të jetë gjithmonë i pari në jetën time. Shpresoj mos të të vijë keq për këtë”.

- E di. Nuk më vjen keq, - buzëqeshi Majkëll.

- Po ti vjen menjëherë pas tij, - thashë tek hipëm në makinë dhe vazhduam jugut, drejt shtëpisë sime dhe qytetit ku ishte caktuar Majkëll me punë, së bukurës Vlorë.

- Sa punëtor i keq jam! – përsëriste Majkëll, në faj që nuk po punonte në ditë jave.

- Po ti sikur the që ata nuk duan të hetosh, gjithsesi.

- Po, po prapë...

- Pastaj, ti po martoheshe. Nuk marrin leje nga puna për këtë njerëzia andej nga anët tuaja? – e pyeta.

- Nga ku vij unë, këto gjëra bëhen në fund të javës. Pastaj, unë sapo u ktheva nga një javë pushimesh në Sofje.

- Sikur ua kërkoje ti. Unë mendoj se po e përdor shumë mirë kohën. Meqë nuk të lanë të punoje, ti vajte u martove, - i thashë. – Avash tani! Se mos ke për t'u dalë prindërve përpara e t'u thuash: “Qeshni! E vogla juaj e vetme po martohet pas katër ditësh!” – shtova dhe ndjeja frikën gjithnjë e në rritje me çdo kilometër drejt vendlindjes sime.

- Katër ditë janë më tepër se asnjë, - buzëqeshi Majkëll. – Po të ishim martuar sot, nuk do ta kishin parë fare.

- E vërtetë, - iu përgjigja dhe u përpoqa të imagjinoja veten duke ua thënë pas pilafit. Nuk mund të vendosja dot nëse ajo do të kishte qenë më e vështirë apo më e lehtë. – Po të isha martuar sipas traditës, sonte do të kishte qenë

mbrëmja e parë, - vazhdova. – Fqinjët, kushërinjtë dhe shoqëria fillojnë të kërcëjnë pas orkestrës me klarinetë, def dhe fizarmonikë të mërkurën, të enjten dhe të premten në darkë. Me zbutjen e komunizmit, orkestrat filluan të bëheshin më “imperialiste” me kitaret elektrike shurdhuese dhe xhez. Për dasmën e vëllait tim, babi mori me qera një çadër të madhe në oborr dhe vuri stola rreth e rrotull. Pastaj njerëzia kërcyen në mes deri natën vonë. Në shtëpinë e dhëndrit, mbrëmja vazhdon edhe të shtunën mbrëma, ndërsa familja dhe të ftuarit e nuses bëjnë darkën.

- Pa dhëndrin? – pyeti Majkëll.

- Po. Është nata e fundit e nuses me familjen e saj. Pastaj dhëndri, i shoqëruar nga krushqit e zgjedhur prej familjes së tij, vjen te shtëpia e saj të dielën në mëngjes që ta sjellë në shtëpi për banketin me familjen dhe të ftuarit e tij të dielën mbasdite.

- Më vjen keq që nuk u martove dot sipas traditës shqiptare, - tha Majkëll.

- Ou, mos të të vijë keq fare! Jam e lumtur që po martohem në kishë. I kam admiruar gjithmonë nëpër filmat perëndimorë. Edhe kur kishat shqiptare hapën dyert, pas shembjes së komunizmit, një dasmë kishe as që më kishte shkuar nëpër mend, meqë nuk isha e krishterë deri tetorin e kaluar. Por kam përshtypjen që ty do të të kishte pëlqyer një dasmë tradicionale shqiptare.

- Duket qejf i madh, po nuk më bëhet vonë, për sa kohë që marr nusen time të bukur, - tha Majkëll duke më parë me sytë e kaltër e të qeshur. – Po sikur të vish me mua në Vlorë? – vazhdoi, ndërsa po i afrohem qytetit tim. – Mund të bëhemi bashkë me gjithë të tjerët te vrapi në Llogara të shtunën. Të dielën që në mëngjes, marrim prindërit e tu rrugës për Tiranë për dasmën, - propozoi Majkëll duke më hedhur nga një sy për të parë reagimin tim.

- Më pëlqen shumë më tepër se sa të përballem me prindërit e mi. Pastaj, kaloj edhe më tepër kohë me ty. Mirë! – thashë e lumtur dhe e befasuar. Tani të shkretët prindërit e mi do të ngeleshin vetëm me disa orë paralajmërim.

E kaluam Fierin dhe vazhduam drejt jugut deri në Vlorë. Majkëll ndaloi te apartamenti i tij me qera, ku më prezantoi me disa nga komshiet e tij të dashura dhe të vegjlit e tyre.

- Sa i rregullt apartamenti yt! Edhe dush edhe satelit! Hajde luks, hajde! – i thashë.

- I vunë për mua edhe dushin edhe TV me satelit. Kam apartament të mirë. Pronarët janë prindërit e një polici financiar, që u pëlqen qeraja e madhe. Dolën nga shtëpia dhe lanë gjithçka, me gjithë fotografitë e familjes, kur morën vesh sa do t’i paguaja.

- Sa u paguan? – pyeta me kureshtje.
- U paguaj gjashtëqind dollarë, që përfshin edhe pastrimin e teshave.
- Pse s'thua që ia paskan hedhur pensionit ata? – ia ktheva.
- Janë gjyshër të mirë. Banojnë në shtëpinë e tyre kur nuk jam unë aty, por largohen kur kthehem papritur. Për mua, le të rrinë po të duan, po kanë frikë se mos më ngelet hatri dhe humbasin qeraxhiun e pasur, - u përgjigj Majkëll.

– Hajde shkojmë nga zyra ime, - vazhdoi Majkëll dhe më mori për dore.

Duke u kapur për dore në mes të ditës, më dukej vetja si Lel'e kimetshme e babit. Majkëll ma lëshoi dorën vetëm që të takonte një burrë shqiptar. Nuk arrija ta kuptoja pse burri i tundte gishtin Majkut duke i thënë: “Na kishe thënë që nuk po kërkoje grua”. Pastaj m'u kthye mua dhe pyeti: “Nga je?”.

- Nga Fieri, - ia prita unë, - jemi gjitonë.
- Mirë, mirë, urime! – tha burri dhe u largua.
- Kush ishte ai? Pse tha ashtu? – pyeta Majkëll më pas.
- Është shefi i policisë. Kemi punuar bashkë. Mbajti edhe një drekë për nderin tim një herë. Më duket se shpresonte të bija në dashuri dhe të martohesha me të bijën.

- Është e bukur?
- Kishte fituar “Miss Vlora” një vit, po ishte shumë e re për mua.
- Pse sa vjeçe është? – e pyeta.
- Sapo mbushi njëzet, - m'u përgjigj Majkëll.
- Po ti, sa vjeç je? – pyeta sërish duke menduar: “Po edhe unë vetëm pesë vjeç më e madhe jam”.

- Tridhjetë e nëntë, - u përgjigj Majkëll me shqetësim në sy për reagimin tim.

- Pothuajse dyzet?! – pyeta e habitur.
- Ëëë . . . pak a shumë. Sa vjeç kujtove se isha?
- Ndërmjet njëzetënëntë dhe tridhjetetë. Do të të bënte katër deri në tetë vjet më të madh se unë. Mami dhe babi im kanë shtatë vjet diferencë dhe s'mbahet mend qëkur janë martuar.

- Do akoma të martohesh me mua? – pyeti Majkëll me kokën mënjanë, pothuajse duke varur turinjtë.

- Po, de, po! – iu përgjigja. – Edhe pse jam unë e befasuar, Perëndia nuk është. Ai e dinte gjithë kohës sa vjeç ishe. Pastaj, kur mund të marrësh njëzetvjeçaren Miss Vlora tani që je pothuajse dyzet, as që do të bëhej fjalë për mua në të njëzetat e tua.

- Vetëm ngaqë jam amerikan. Prindërit e saj duan ta heqin nga jeta e

vështirë këtu. Ajo nuk ka punuar kurrë më parë; vetëm shikon telenovela në shtëpi. E ëma gatoi dhe serviri gjithçka te dreka që dhanë për mua e Bobin, ndërsa ajo ndenji ulur në divan gjithë kohës, - u përgjigj Majkëll.

“U vlerësoka puna edhe në Amerikë!” – mendova dhe e vura vësh në vesh, por thashë: “Ndoshta e ëma po ju nxiste që të llafoseshit me njëri-tjetrin”.

- Ndoshta, - u përgjigj Majkëll, - po nuk dukej sikur i pëlqente ndonjë gjë fizike. Unë jam shumë person i lëvizshëm dhe mezi po pres për një jetë aktive me ty, - vazhdoi Majkëll dhe më afroi për një puthje.

- Edhe unë,- buzëqesha dhe e putha.

Kur mbërritëm te puna e Majkut, të gjithë u gëzuan për lajmin tonë dhe na uruan të dyve. Na ftuan mua e Majkun që të shkonim me ta të nesërmen matanë qafës për në Himarë anës bregut. Thanë që duhej të shkonin për të marrë rrogat atje.

- Është rrugës për te kabinat, ku do të bëhet vrapi të shtunën, - i shpjegova Majkut. – Shokët e tu të punës mund të na lënë atje në kthim nga Himara, - vazhdova.

- Mirë, vijnë. Falemnderit! – miratoi Majkëll dhe u kthyem në shtëpi.

- Duket se të gjithë të duan. Po pse të quajnë Van Damme? – e pyeta.

- Rashë keq një ditë nga biçikleta kur po e ngisja për herë të parë. Shtrembërova rrotën e parme dhe mendova se nuk do t’i jepja biçikletës për një kohë të gjatë, por ustai tek i cili më çoi dikush nga pazari, e rregulloi për dy minuta me një çels-tubo dhe një vegël tjetër për telat. Rashë si me fluturim. Falë Perëndisë, mbaja mend akoma si të bija me rrokullisje *Judo*-je... apo më mirë të them e bëra pa menduar. Vetëm ca gërvishtje të lehta nga rruga pësova në bërryl dhe dorën e majtë. U bëri përshtypje njerëzve, prandaj më ngacmojnë e më thonë Van Damme.

- Është shumë i famshëm në Shqipëri tani.

- Kjo këtu është *brektorja* ime më e preferuar, - tha Majkëll për çka dukej si një apartament në kat të parë shndërruar në dyqan. Nuk e dalloja dot çfarë shisnin derisa u afrova pak.

- Oo, byrektore, - qesha dhe korrigjova shqipërimin e tij të adhurueshëm.

- Çfarë thashë unë? – pyeti Majkëll.

- Ti the brek-tore. Një mungesë y-je dhe ti na e ktheve byrekun në të mbathura, - i shpjegova ende duke qeshur. Majkëll qeshi me mua dhe përsëriti “burek” disa herë, ndërsa unë vazhdova të qesh me buzët e tij të mbledhura siç luftonte më kot për të krijuar zanoren “y”.

- Çfarë të pëlqen tjetër këtu? – e pyeta duke e cytur për fjalë të tjera shqipe.

- Çokolatë me lajthi, - u përgjigj Majkëll në shqip duke e vënë theksin në rrokjen e parë të lajthisë në vend të së dytës dhe unë qesha sërish.

Iu ngjitëm shkallëve të apartamentit të Majkut dhe Bob erdhi për vizitë. I dha Majkut të dhënat e fundit në çështje pune dhe më kërkoi t'i përktheja disa gjëra. Në mbrëmje, Majkëll i kërkoi fqinjes që të flija në shtëpinë e saj dhe ajo pranoi e mahnitur. E putha të fejuarin tim për “gjumë të ëmbël” dhe shkova me fqinjen në apartamentin ngjitur.

Të nesërmen në mëngjes, u zgjova më herët se zakonisht dhe po vendosja nëse do të shkoja tek apartamenti i Majkut. Komshia, së cilës nuk i besohej që kishin mbetur akoma burra të ndershëm në botë, pale amerikanë të ndershëm, duke pritur me durim deri në ditën e dasmës, më nxiti me një buzëqeshje: “Ik, moj, merre për qafe dhe thuaji burrit mirëmëngjes”.

Trokita lehtë në derën e apartamentit të Majkut, me ndrojtë se mos ishte ende duke fjetur. Ai e hapi derën menjëherë me një filxhan kafeje në dorën e majtë.

- Mirëmëngjes, ëmbëlsirë, - tha dhe u përkul përpara për një të puthur.

- Nuk të zgjova, apo jo? – e pyeta.

- Aspak. Kam bërë dhe dush. Kafe?

- Jo, falemnderit! Nuk më pëlqen kafeja, - ia prita.

- Mua më pëlqen shumë, - tha Majkëll dhe vuri filxhanin mbi tavolinë duke u afruar ku isha ulur unë. U ul pranë meje dhe filluam të putheshim. U shtrimë përballë njëri-tjetrit në divanin e ngushtë me gjuhë të pleksura. E dija që nuk duhej t'ia kisha vënë veshin fqinjës. – Po të ftohet kafeja, - i thashë.

Majkëll ndaloi dhe u përgjigj: “Duhet të bëhemi gati për të shkuar në punë. Bob do të mbajë *Blazer*, ndërsa ne shkojmë me shqiptarët në Himarë”.

Unë u ngrita dhe shkova në banjë. Qëndrova para lavamanit dhe hapa çezmën. Disa pika uji të ftohtë mbi kokë më trembën dhe bërtita. Pastaj qesha me idenë që Majkëll kishte kthyer kokën e dushit mbi lavaman për shaka. Dola nga banja duke fshirë kokën me një peshqir dore dhe gjeta Majkun në korridor duke qeshur me gjithë shpirt.

- Ore çamarrok!

- Kush? Unë?!

U bëmë bashkë me ca nga administrata e policisë financiare në një mikrobus dhe u nisëm për Himarë. Unë e Majkëll u ulëm në fund, ndërsa

gjithë të tjerët hidhnin e pritnin romuze me njëri-tjetrin duke na ngacmuar. Rruga kalonte përmes një tuneli të prerë përmes një humnere shkëmbore që binte thikë në det. Tunelit po i bëheshin riparime, kështu që shoferi vendosi të kalonte nga rruga e vjetër e pashtuar që gjarpëronte mbi kodër.

Në gjysmë të shtegut të ngushtë, mikrobusi ndaloi dhe ne dolëm të gjithë nga makina. Unë e Majkëll vëzhguam shoferin tonë, shefin e tij dhe një burrë tjetër me uniformë duke u përpjekur me gjithë fuqinë që kishin të shtynin skeletin e një ishmakine sa për të hapur rrugën që të kalonte mikrobusi ynë. Dhanë e morën për njëfarë kohe, po as që e luajtën dot nga vendi. Ndërsa po diskutonin ç'të bënin, Majkëll shkoi tek makina e zhveshur dhe e shtyu nga rruga vetëm, duke na lënë të gjithëve gojëhapur. Po unë nuk isha vetëm e mahnitur nga forca e tij fizike. “E shikoni burrin tim?!” – mendova edhe krenare.

- Tani e kuptoj pse e quani Van Damme, - u thashë të saponjohurve të mi shqiptarë.

- Edhe unë do e bëja po të isha në dashuri si ai, - tha shoferi.

- Ti, po ti, - ia priti shefi. – Ka ngrënë mirë ai, jo si unë e ti që jemi rritur me thërrime.

Majkëll qeshi, tek i përktheva gjithçka që po thoshin shqiptarët për të dhe filloi të tregonte: “Të më kishe parë në të ri. Kisha një herë një motor Suzuki GT550 dykohësh që m’u prish duke bërë xhiro. E lashë në anë të rrugës dhe u ktheva në shtëpi më këmbë për të marrë kamionin tim *Toyota*. E ngava kamionin ku kisha lënë motorin dhe e parkova në anë para tij. Ndërsa po vendosja motorin pas kamionit, ndalon mbas meje një polic dyshues dhe fillon të më pyesë për motorin për t’u siguruar që nuk isha duke e vjedhur. Nuk kam për t’i harruar kurrë bebet e zmadhuara të syve të tij tek më pa të ngrija peshë motorin dyqindcakilësh me duart e mia nga toka në kamion”.

- Uoou! Tha gjë? – pyeta e mahnitur.

- Jo. Mbeti i shtangur tek e falenderova për ndalesën. Do të isha mërzitur shumë po të ma kishte vjedhur njeri motorin.

Hipëm të gjithë në mikrobus dhe vazhduam ngjijtjen drejt qafës së malit deri në krye, duke lënë mbrapa një gjelbërim të dendur që mbulonte të dyja anët dhe gjirin blu teposhtë. Ndalua në anë të rrugës për të parë një pemë shumë të veçantë – pishën flamur. Trungu i pemës është i ndarë më dysh nga natyra në krye me shumicën e degëve të anuara pothuajse horizontalisht si flamur në valëvitje.

Majkëll ia dha aparatit fotografik njërit prej bashkëpunëtorëve dhe ai

na nxori fotografi pranë pemës së famshme. Majkëll më ngriti peshë e më mbajti në çdo lloj mënyre, ndërsa fotografi shkrepse aparatin mbi të qeshurat dhe gëzimin tim.

Vazhduam zbritjen në anën tjetër dhe ndaluam sërish për fotografi të tjera të pamjes magjepsëse në të djathtë. Hipëm mbi shkëmbinjtë e mbuluar me myshk duke vëzhguar retë e bardha poshtë, që mbulonin si me vello gjithçka nën to.

Kur mbërritëm në fund të qafës, megjulla ishte ngritur, dielli po shkëlqente dhe deti ishte i lëmuar si qelqi. E shikoja në sytë e Majkut sa shumë donte të notonte në të.

- Futu! – e nxita.

- Nuk kam veshur kostum banje, - ma priti.

- Nuk i bëhet vonë njeriu. Futu nga mbrapa atyre shkëmbinjve të mëdhenj. Sapo të jesh në ujë, nuk të shikon njeri çfarë ke veshur, gjithsesi.

Majkëll u bind dhe bëri siç i sugjerova. Shkoi mbrapa shkëmbinjve, u zhvesh në të mbathura dhe u fut në det.

“Ah, sikur të futesha edhe unë me të!” – mendova duke qëndruar përbri shokëve të tij e duke nxjerrë Majkëll në fotografi tek notonte në thellësi duke krijuar një valë të lehtë nga mbrapa.

- Pse nuk futesh edhe ti? Apo ke ftohtë? – pyeti njëra nga gratë, sikur të më kishte lexuar mendjen.

- Aq më qan syri sa... I ftohti nuk më bezdis fare, po as unë nuk solla kostum banje me vete, - i thashë, megjithëse mungesa e sutjenave ishte në fakt çfarë po më mbante.

- Kur s'ë ndaloi atë... - ma priti ajo. – Shko edhe ti nga mbrapa shkëmbinjve siç bëri ai.

Dhe vetëm aq shtysë m'u desh. I lashë aparatën asaj dhe kalova në majë të gishtave mbi shkëmbinjtë deri tek kthina. Hoqa çizmet kafe prej kamoshi, xhinset, xhakëtën xhinse dhe bluzën dhe u fundosa në detin vaj vetëm në të mbathura. Notova drejt Majkut, që tashmë po notonte në kthim. Më puthi dhe më mbajti në krahët e tij të fortë, ndërsa notonte vetëm me këmbë.

- Sa notar i madh që je! – i thashë. – Dukeshë si nëndetëse nga bregu.

- E kam filluar notin që i vogël dhe kam notuar shumë në ushtri, - u përgjigj Majkëll. – Kur të vish në Shtetet e Bashkuara, do të të mësoj si të notosh mirë.

- Mirë, - pranova dhe filluam të notonim drejt bregut. – Bëre gjithë atë potere për kostumin e banjës, edhe pse i kishe të mbathurat me ngjyrë. Nuk më duken dhe aq ndryshe nga një kostum banje i kuq.

- Ndoshta ngaqë burrat veshin breçka në këtë anë të Atlantikut. Ne i përdorim të gjata në Sh.B.A., përveç notarëve atletë.

Pasi u veshëm, hipëm prapë në mikrobus dhe iu ngjitëm sërish qafës në rrugën e përdredhur deri në krye. Kur mbërritëm atje, retë e bardha ishin zhdukur, por mua më kënaqi edhe më tepër nga lart bukuria e zbuluar e detit të kaltër për kilometra të tëra në horizont. Nuk dallohej ku mbaronte deti e ku fillonte qielli.

U kthyem te restoranti, ku shefi na kishte rezervuar një tavolinë të madhe dhe kishte porositur drekën më parë, kur u ngjitëm nga Vlora. Majkëll i kishte dhënë dhjetë mijë lekë të vjetra për të mbuluar shumicën e kostos së drekës, por shefi ia shtyu dorën mbrapsht, duke i thënë: “Nuk shkon dollari këtu”.

- Janë lekë, - ia priti Majkëll, por shefi buzëqeshi dhe nguli këmbë: “Janë false. Ta kanë bërë me hile te valuta”.

Majkëll qeshi dhe u dorëzua.

Kur u kthyem tek restoranti, qengji ishte shkuar në hell mbi shpuzë përjashta. Kamarieri i shërbeu Majkut të parit: një thelë mishi të madhe që mbulonte gjithë pjatën. Majkëll pa pjatën pastaj mua.

- Është bishti, - i thashë, mes të qeshurave të të tjerëve me fytyrën e hutuar të Majkut për bishtin e ngrehur. – Është thela më e madhe dhe gjithmonë i çohet mikut më të nderuar, - vazhdova duke qeshur me romuzet e të tjerëve për bishtin. Majkut nuk iu mbush mendja dhe as që e preku bishtin me dorë. Hëngri thelën e vogël në anë të pjatës dhe gjithë sallatat dhe perimet e mrekullueshme që shoqëronin atë drekë të paharrueshme.

Vazhduam të qeshnim, të hanim e të pinim me orë te tavolina e shtruar përjashta. Pasi provoi verën e kuqe, shefi këmbënguli që Majkëll të provonte një teke raki – pija e zgjedhur për burrat në Shqipëri.

- Me fund, - tha shefi herën e dytë, pasi pa Majkun që mezi e preku me buzë pijen e fuqishme e të kulluar herën e parë. Po Majkëll priti sa ngritën kokat gjithë të tjerët, siç pinë teken e tyre, dhe me shkathtësi hodhi mbas koke, në shkurret mbrapa tij, gjithë ç’kishte gota brenda. Ishin të gjithë pak a shumë të dehur në atë moment dhe nuk vunë re gjë ose bënë sikur nuk panë gjë.

Na lanë tek fshati turistik me kabinat e vogla dhe ikën. “Më rruat mua që nuk fjeta me Majkëll një natë më parë!” – mendova sapo u futëm në kabinë. Kishim edhe tre netë vetëm deri të dielën në mëngjes, por Majkëll i mbeti besnik premtimit të tij, edhe pse po digjej nga epshi.

Të shtunën në mëngjes, ndërsa Majkëll u fut në dush, unë guxova të hapja Biblën. Kisha frikë të lexoja se ç'kishte për të më thënë Perëndia për dy netët e fundit që kisha fjetur në të njëjtin shtrat me Majkëll, edhe pse veshur. M'u duk sikur kisha shkelur në ca kallo atje lart duke e tepruar, por u luta të më falte dhe u drodha e tëra kur lexova: “E dija që do të silleshe me pabesi dhe që do të quheshe “kryeneç” që në bark të nënës. Për hir të emrit tim, do ta shtyj për më vonë zemërimin dhe për hir të lavdisë sime do ta përmbaj që mos të të shfaros. Ja, unë të kam përpunuar, por jo si argjendi; të kam vënë në provë në poçen e pikëllimit. Për hir të vetvetes, vetëm për hir të vetvetes e bëj këtë: si mund të lë që të përdhohet emri im? Nuk do t'ia jap lavdinë time dikujt tjetër”.

Oh! Falemnderit, Zot, për mëshirën dhe faljen tënde!

KAPITULLI XXIV

PËRPIEKJA E DYTË

Kur mbërritën gjithë shokët tanë për vrapin të shtunën në mëngjes, ne dolëm nga kabina për herë të parë në dy ditë. Fabiola m'u lëshua duke vrapuar e duke më përqaftuar me ngazëllim: “Erdhe! Sa mirë bërë që erdhe! Kalove nga prindërit?”.

- Jo, nesër, kur të kthehemi. E patëm të vështirë të ndaheshim, - ia ktheva.

- Urime! – tha Omari dhe të tjerët që na rrethuan, ende të habitur nga vendimi ynë vetëtimë për t'u martuar.

- Mira e konfirmoi dasmën me kishën tënde për në orën gjashtë të dielën mbasdite, - shtoi Fabiola.

- Shkëlqyeshëm! – iu përgjigja e çliruar që kjo ishte një gjë më pak për t'u shqetësuar. – Më duhet akoma një fustan nusërie.

- Edhe unazat, - shtoi Majkëlli.

Unë e Majkëlli vendosëm të bëheshim bashkë me të tjerët në shtegun e vrapit më vonë atë mëngjes. Ecëm përmes drurëve, ndërsa të tjerët vrapuan në një shteg të shënuar me shkumës. Unë iu ngjita pemëve dhe bëja poza akrobacie mbi trungje të rëna pemësh për aparatën e Majkut.

Mbas garës, u mblodhën të gjithë në një rreth të madh secili me nga një krikëll birre në dorë. Fituesit e kategorive të stisura aty për aty, e bënë me radhë për t'u njohur në mes të rrethit duke pirë birrën dhe pastaj duke e vendosur përmbys mbi kokë, pavarësisht sa e zbrazët ishte. Pastaj Çarli dhe Xhovani filluan të na shtynin drejt qendrës mua e Majkun si “çifti i ditës” dhe filluan të brohorisnin: “Pi, pi, pi...”. I pimë birrat me një frymë dhe kthyem përmbys krikllat mbi kokë. Pastaj Çarli filloi të brohoriste sërish: “puth, puth, puth...” dhe të gjithë rreth e rrotull u bashkuan si në kor. Majkëll

mbështolli krahun rreth shpinës sime dhe më tërhoqi pranë vetes për një puthje të gjatë mes brohorimave dhe duartrokitjeve të miqve rrethues.

E kisha harruar fare ekipin e televizionit që e kishte shoqëruar dhe filmuar të gjithë ngjarjen derisa i pashë të vërtiteshin me kamerën nga jashtë rrethit, ndërsa unë e Majkëll putheshim në mes. “Si nuk i shpëtoj dot asnjë hileje, ‘re aman!” – thashë me vete duke përfytyruar me tmerr çastin kur prindërit dhe vëllai im do të na shikonin duke u puthur në lajmët kombëtare të mbrëmjes para se të më jepej mundësia për t’u thënë vetë. Por, më vonë, u çlirova kur dëgjova nga ekipi që rubrika speciale mbi marrëdhëniet e mira midis të rinjve shqiptarë e amerikanë do të transmetohej në lajmet e mbrëmjes së të dielës.

Herët në mëngjesin e së dielës së nëntë prillit, Majkëll mori hua *Chevy*-in e Xhovanit dhe ne filluam zbritjen për Vlorë. Majkëll ndaloi tek apartamenti i tij për të marrë rrobat e mira dhe pastaj vazhduam për në qytetin tim të lindjes. Nuk kisha qenë kurrë më në siklet se atë mëngjes. Sa më tepër i afroshim lagjes sime, aq më intensivisht lutesha. U luta që prindërit e mi ta pëlqenin dhe ta miratonin Majkëll si burrë për mua. Hodha sytë nga Majkëll dhe thashë: “Sa frikë kam! Po ti?”

- Kam parë edhe situata më intensive se kjo, - u përgjigj me buzë në gaz.

- Sigurisht që ke parë, - thashë dhe mora zemër nga qetësia e tij.

E ngau makinën e madhe përmes rrugës së pashtuar, me gurë e me gropa të mëdha lere të krijuara prej shirave të dimrit dhe e parkoi disa metra larg shtëpisë së prindërve të mi. “Tani nga do t’ia mbaj?” – mendova. *Zot, eja me mua, të lutem!*

Sapo zbritëm nga makina dhe filluam të ecnim drejt shtëpisë, një qen i lagjes iu lëshua Majkut duke lehur sa kishte në kokë. Unë e harrova fare frikën e përballjes me prindërit. Ca nga frika, ca nga turpi që kisha frikë nga qentë e lagjes sime, u fsheha mbrapa Majkut, ndërsa ai vazhdoi përpara. Kur iu afrua qeni, Majkëll u ul në bisht dhe filloi të fërshëllente duke u përpjekur ta ledhatonte. Qeni u qetësua dhe filloi të na vinte rreth e rrotull nja dy herë. *E pabesueshme!*

- Ç’bën?! – e pyeta me habi. – Do të të kafshojë.

- Është qen miqësor; do vetëm sa t’ia varësh një çikë, - m’u përgjigj Majkëll.

- Nga e kupton ti që është miqësor? Po i del gurmazi nga të lehurit.

- Po tund bishtin.

- Është i lëshuar, - ia prita duke vrarë mendjen pse Majkëll po përdorte për qenin një përemër vector njerëzish. – Duhet të mbahet i lidhur ditën dhe

të lëshohet natën për të mbrojtur shtëpinë, - ngula këmbë me “it” (përemri vetor për kafshët), por mora frymë e lehtësuar kur pashë që Majkëll kishte të drejtë. *Ndoshta qeni që leh nuk të ha vërtet!* Nuk kafshoi asnjërin prej nesh dhe u kthye te gardhi prej nga doli.

- Me sa duket, nuk të pëlqekan qentë! – tha Majkëll.

- Jam rritur me mace. Komshia kishte një qen femër. Polli disa këlyshë një herë dhe shoqja ime, Diana, shkoi t’i ushqente, po buçja i kafshoi dorën dhe Dianës iu desh të bënte tetanoz në bark; tri gjilpëra të thella mu në bark, - kujtova dhe u drodha e tëra. – Unë po luaja në të njëjtin oborr me vajzat e tjera kur ajo shkoi të konte këlyshët e vegjël.

- Po mirë, ajo po mbronte këlyshët e vet. Ka qenë thjesht ndonjë keqkuptim, - u përgjigj Majkëll me të qeshur.

- Po, po. E shkreta Diana që e mori vesh pasi u tromaks.

Mbërritëm tek porta e rëndë metalike e prindërve të mi. Shtyva derën e vogël në njërën anë të portës dhe u futa në oborr. Majkëll më ndoqi në hyrjen e gjerë prej çimentoje që ndante oborrin në mes, me bunkerin gjysmë sferik në të djathtë. Mami doli nga dera me nipçen në krahë dhe më përshëndeti me një tingull të gëzueshëm në zërin e saj prej sopranoje.

- Uuu! Kush na erdhi! – thirri mami dhe më përqafoi me krahun e lirë. Takoi Majkun dhe më pa me habi.

- Ma, ky është Majkëll. E mban mend atë amerikanin që të përmenda herën e fundit që folëm bashkë? – e pyeta dhe ia prezantova Majkut. - Majkëll, kjo është nëna ime.

- Si jeni? – përshëndeti Majkëll dhe unë përktheva.

U futëm në shtëpi dhe pamë babin në korridor duke ardhur drejt derës së hyrjes për të na takuar të dyve.

- Dhe ky është babi im.

- Si jeni? – tha Majkëll prapë me një buzëqeshje të shtirur dhe përkulje të lehtë përpara.

- Mirë, - iu përgjigj babi po aq i habitur sa mami. – Po ju si jeni? – pyeti dhe hoqi udhën për në dhomën e pritjes. – Punoni bashkë? – pyeti babi sërish.

- Jo, ba. Majkëll punon në Vlorë, - iu përgjigja dhe i përktheva Majkut gjithçka.

- Zotëri, unë kam ardhur të kërkoj dorën e vajzës suaj për martesë, - tha Majkëll para se mami t’i jepej mundësia të thoshte diçka. Unë përktheva fjalë për fjalë dhe pashë fytyrën e ngrirë të babit, sikur të ishte hipnotizuar.

- Uuu, ëndrra që pashë unë, - tha mami duke vënë gjithë gishtat e dorës së djathtë në faqe, në shenjë habie.

- Çfarë ëndrre? – pyeta mamin.

- Pashë një burrë që erdhi dhe na kërkoi dorën tënde për martesë. I thashë tyt eti, po nuk ma vuri veshin, - tha mami e mahnitur që i doli ëndrra pothuajse tamam siç e kishte parë.

- Edhe unë pashë një ëndërr, o ma, - i tregova unë. – Sikur unë e Majkëll u martuam te kisha ime te kinema Agimi.

- Ç'familje ka? – pyeti babi dhe unë ia përktheva pyetjen Majkut.

- Kam nënën, dy vëllezër dhe një motër, - iu përgjigj Majkëll.

- Po babai?

- Babai më ka vdekur shumë i ri. Unë isha ende i vogël kur ndërroi jetë, - iu përgjigj Majkëll.

- Mos! Sa keq! – tha babi.

- Ku janë kallaballëku? – pyeta prindërit.

- Yt vëlla me të shoqen vajtën të të kërkojnë ty. U bëmë merak; nuk ke ardhur në shtëpi për më se një muaj, - u përgjigj mami.

- Më fal! Kam qenë e zënë, - ia prita buzagaz. – Kështu del më mirë. Tani e gjithë familja mund të vijë te dasma ime, - ia shpjegova Majkut. – Im vëlla dhe e shoqja janë në Tiranë tashmë.

- Bukuri! – ma ktheu Majkëll dhe pa orën.

Para se të thoshte gjë tjetër, unë u ktheva nga prindërit. – Dasma jonë është sot në orën gjashtë te kisha ime në Tiranë. Jemi një çikë ngushtë me kohën. Unë nuk kam gjetur fustanin akoma dhe na duhet të blejmë edhe unazat.

Prindërit e mi të mrekullueshëm, që nuk ma prishnin kurrë, u ngritën dhe u veshën sa më shpejt që të mundnin. Unë veshja nipçen e vogël, ndërsa lëvdoja Perëndinë për paqen. Majkëll u ul në një nga kolltuqet e kompletit që kishte bërë im vëlla, Loni, dhe vëzhgoi me qetësi derisa babi doli i veshur me gjithë kapelen kafe.

- Nuk e ndan këtë kapele. Ia kam blerë unë kur punoja kamariere dhe i bën fiks. Tani e vesh ngado që shkon, – i thashë Majkut.

- Mos ka nevojë për ndihmë me kollaren? – pyeti Majkëll.

- Patjetër! – ia prita unë dhe sodita me kënaqësi Majkun tek lidhte kollaren e babit.

Dolëm te makina dhe unë ndihmova babin të ulej në vendin e parë. Nipçja filloi të qante sapo u ul mbrapa, kështu që babit iu desh të ulej mbrapa me mamin dhe nipin që ta qetësonte.

- Më duket se nipi im ka frikë nga kjo makinë. Ka udhëtuar vetëm me autobus, nëse e mban mend ndonjë nga udhëtimet për te gjyshërit e tjerë, - i shpjegova Majkut.

Ishim rrugës për në Tiranë, kur babi papritur pyeti: “Sa vjeç është?”.

- Tridhjetenëntë, - iu përgjigja dhe zhburova me kujdes reagimin e tim eti. “Si nuk i shpëton asgjë!” – mendova. Mua as që më vajti mendja të pyesja për moshën e Majkut, po ja që im atë nuk duket as i habitur nga përgjigja.

- Nuk e tregon, ama, - u përgjigj babi dhe pyeti sërish, - Pi duhan?

Këtë radhë isha shumë e gëzuar për përgjigjen që do të jepja. E dija sa e urrente im atë duhanin dhe sa i zhgënjyer ishte me vëllezërit e mi kur e kapën zakonin e ndyrë. – Pse nuk i fut edhe një pordhë? Je që je! – u bërtiste me nerva sa herë i gjente duke pirë duhan brenda.

- Jo! – ia prita. – Majkëll, në fakt, më tha një herë se as që do të më ishte afruar po të më kishte parë të ndizja cigare. E urren duhanin, si ty, ba, - përfundova dhe ia përmbloodha Majkut.

- Mendoj se të puthësh një duhanxhi është sikur të lëpish një tavllë duhani, - tha Majkëll dhe babi miratoi duke qeshur.

- Babit po i bën shumë përshtypje sa shofer i kujdesshëm je. Thotë që ti bën vend edhe për gomerët në anë të rrugës.

Majkëll buzëqeshi dhe tha: “Nuk kam se si të mos; duhet ta ndajmë rrugën me të gjithë. Vetëm se e kam më kollaj të merrem me gomerët se sa policinë rrugore. I kam parë si shtrydhin shoferët kur i ndalojnë në çdo katër-pesë kilometra dhe i detyrojnë të paguajnë o gjobën o rryshfetin.

- Ah, korrupsioni! – psherëtiva. – Po më mirë mos ta përkthej këtë për babanë. Ai acarohet shumë sa herë që diskutojmë gjithë “gjërat e mrekullueshme” që na erdhën me demokracinë, si çmimet gjithnjë në rritje të ushqimeve pa përshtatje të pensioneve. Policia nuk do të guxonte të të ngacmonte në një makinë me targa diplomatike, apo jo?

- Me raste, po unë bëj sikur nuk kuptoj dhe ua bëj me dorë ose u them “hellou” në anglisht, siç i parakaloj.

Disa orë më vonë, Majkëll hyri në Tiranë dhe ne lamë prindërit te shtëpia e Bales.

- Mos harro, ma. Shihemi te kinema Agimi në orën gjashtë, - i thashë dhe i putha të dy me shpresë që mpirja nga gjithë kjo histori t’u zgjaste edhe disa orë më tej.

- Jo se kam merak se do të vijnë me vonesë për sa kohë që vjen edhe babi, - i mbusha mendjen vetes me zë.

- Është mamaja zakonisht me vonesë? – pyeti Majkëll.

- Ora e babit është gjithmonë pesë minuta para. Teoria e tij është: “Më mirë ta pres se sa të më presë”, - kujtova me kënaqësi.

- Kush ta priste?

- Autobusi. Mami shkante në punë me urban. Stacioni i urbanit ishte mbrapa shtëpisë. Zakonisht, e dëgjonte duke ardhur pa dilte me vrap për ta kapur. Po nganjëherë, e bënte llogarinë gabim dhe ne e dinim që e kishte lënë për qime sapo dëgjonim britmën e saj të hollë: “Mbaje shofer!”. E shkreta nëna ime! – psherëtiva. – Gjithmonë duke shtrydhur tubetin e kohës deri në pikën e fundit. Në ato pesë minuta që im atë do të priste në anë të rrugës, ajo mund të shpëlante enët e t’i çonte te ballkoni që unë ose dikush tjetër t’i fuste në shtëpi.

- E merrte rrezikun në sy deri momentin e fundit, - tha Majkëll.

- Pastaj këlthiste e befasuar me të njëjtin zë: “Uuuuu, më la!” dhe kapte tjetrin pas gjysmë ore.

Mbërritëm tek argjendaria te blloku dhe Majkëll pagoi për dy unaza floriri nga njëzetepesë dollarë secila.

- Nuk besoj që janë flori, - më pëshpëriti.

- Janë, janë, - ngula këmbë. – Ja ku thotë këtu 14K, - tregova me gisht nga brenda unazës. – Të thashë unë që këtu janë më lirë se atje ku më bleve varësen. Pastaj, sa për shenjë janë.

Majkëll qeshi dhe u dorëzua për mungesë kohe. Vazhduam me kërkimin për fustanin e nusërisë. Kërkova në disa dyqane fustanesh me qera, por nuk munda të gjeja asgjë që më bënte apo që më pëlqente. Para se të futeshim në një dyqan tjetër, papritur më erdhi një ide.

- Hej, Majkëll, po sikur të vesh fustanin atllas që veshja te ditëlindja ime? Si thua?

- Ti je më tunduese se djalli vetë në të! – u përgjigj Majkëll dhe e lamë kërkimin.

- O burra, te dhoma ime, atëherë! – thashë dhe Majkëll e ngau makinën për në qytet Studenti.

Iu ngjita shkallëve me vrap për te dhoma ime dhe nxora fustanin nga dollapi. Vura takat e bardha dhe çantën e shpinës mbi tavolinë pastaj vrapova për në banjë. U ktheva po me vrap, mora fustanin dhe çantën dhe vrapova shkallëve për te Majkëll. Ai na çoi me shpejtësi tek hotel Tirana për të zënë dhomën për atë natë dhe për t’u bërë gati për dasmën. Majkëll iu afrua sportelit dhe tha në shqip: “Dua shumë krevat!”, po sportelisti e kuptoi çfarë donte të thoshte dhe qeshi. – Martohem sonte! – vazhdoi Majkëll në anglisht.

- Urime! Falemnderit që po rrini këtu te ne! – u përgjigj sportelisti dhe i dorëzoi Majkut çelësin e një dhome me shtrat të madh dopjo në katin e nëntë.

I hipëm ashensorit për në katin e nëntë dhe u futëm në dhomë. “Kështu na u dukërka Tirana nga ndërtesa më e lartë në Shqipëri!” – mendova, siç hodha sytë nga dritarja. Majkëll shkoi drejt e te banja dhe hapi dushin.

- Ç'bën ore? – e pyeta.

- Po lahem, sigurisht, - m'u përgjigj.

- Ku kemi kohë për t'u larë ne! Lahu kur të kthehemi, - i thashë e alarmuar.

- Nuk shkoj gjëkundi pa u larë, - këmbënguli Majkëll dhe u fut në dush ndërsa unë nxora getat nga çanta. Kur doli Majkëll nga dushi, mua më kishte kapur paniku.

- Nuk po gjej dot këpucët. Obobo! Ç'i bëra këpucët? – lllomotita, tek u sorollata nëpër dhomë duke kërkuar gjithandej.

- Kërkoji këpucët më vonë, bëj dush tani! – u përgjigj Majkëll duke nxjerrë ndërresat me nxitim nga valixhja.

- Nuk kam kohë për dush, - përsërita.

- Do bësh dush! – tha Majkëll sa më i prerë që të mundte pa kaluar në komandant reparti.

- Floku im do gjithë ditën të thahet e të rregullohet pas dushit, - kundërshtova.

- Do bësh dush! – përsëriti Majkëll dhe unë e dija që po kundërshtoja më kot dhe po shkaktoja më tepër vonesë. U futa në dush e alarmuar për vonesën dhe mungesën e këpucëve, por sapo ndjeva ujin e nxehtë në trup, më erdhi keq që më duhej të nxitoja një përvojë kaq të mrekullueshme. I premtova vetes që të bëja një tjetër më vonë atë natë. Nuk zgjidhi ndonjë nga problemet e mia të atypëratyshme, por ndjeva paqe prapëseprapë. Nuk kisha më dyshim që nuk kishim për të mbërritur në kishë brenda orës gjashtë; nuk kishte kuptim të shqetësohesha.

- I pe këpucët e mia gjëkundi? – pyeta Majkun kur dola nga dushi.

- Unë nuk po gjej as të miat, - ma priti Majkëll dhe unë ia shkrepë të qeshurit. – Do t'i kem lënë në Vlorë, - shtoi.

- U të lumtë! Do jemi njësoj, - thashë duke qeshur nën hundë, tek luftoja të vishja getat në lëkurën me lagështirë.

Majkëll nxori nga valixhja dhe më dha një palë shapka të bardha prej shajaku.

– Vish këto! I solla si shenjë kujtimi nga hoteli në Sofje.

Ëëëë! Prandaj vajte deri në Sofje ti!

- Po ti çfarë do të veshësh? – e pyeta.

- Atletet, të vetmet këpucë që kam me vete. Mirë që solla këmishë të mirë dhe xhakëtën blu. Kujt ia priste mendja që do të martohesha këtu?

- Edhe kollaren, - ia prita. – Shumë bukur dukesh. Xhaketa duket shumë mirë me pantallonat bezhë. Mos e vrit mendjen. Se mos të njuh njeri te kisha, - ia ktheva. – Vë bast që sa të vemi ne atje, ata do të kenë ikur, - shtova tek dolëm nga dhoma me nxitim.

E mbajta krehrin e vogël të përdredhur nën baluke që t’u jepja ca onde rrugës për te kisha dhe vura një çikë buzëkuq. U përpoqa më kot të vija laps të zi në sy, po e lashë fare nga frika mos e bëja më keq me troshitjen prej makinës. E gjetëm Mirën duke pritur gjithë ankth përpara derës së kinemasë. Vrapoi në buzë të rrugës sapo pa *Chevy*-in duke ardhur.

- Më në fund! – tha Mira. – Krehrin, krehrin! – tha dhe unë e shqeva nga baluket. Futa krehrin në çantë dhe ia dhashë asaj, tek nxituam drejt derës së kinemasë.

Shpupurita baluket me gishta sa për pak volum.

- Mirë duken?

- Mojt, baluket mirë janë, - ma ktheu Mira, - po këpucët ku i ke? – pyeti duke më parë nga shapkat e bardha të hotelit.

- Ka thënë Perënda: “Hiqi këpucët; je duke qendruar në tokë të shenjtë” dhe ashtu bëra, - iu përgjigja duke qeshur. Nuk mund t’i jepja ndonjë domethënie tjetër mungesës së rastësishme të këpucëve prej të dyve gjatë gjithë rrugës që nga hoteli deri te kisha.

- Duhet të kthehesh, - tha Mira.

- Ku të kthehem, mojt? Do t’i kem lënë në dhomë.

- Nuk mund të shkosh aty pa këpucë.

- Nuk i bëj të presin më gjithë atë popull brenda. Është gjashtë e njëzetë. Nuk më besohet që janë ende këtu.

- Më pyeti pastori nja dy herë, në fakt, nëse po vije apo jo, derisa i tregova ata të shtëpisë tënde në rreshtin e parë, - këmbënguli Mira.

- Kanë ardhur? Edhe im vëlla me kunatën? – pyeta.

- Po, - ma ktheu Mira. – Edhe ca shokë të shkollës. S’ka gajle se këndojnë edhe njëzet minuta të tjera sa të marrësh këpucët.

- Në asnjë mënyrë! Pastaj, edhe po të marr unë të miat, Majku prapëseprapë nuk i ka të tujat. I harroi në Vlorë. Nuk më bëhet vonë se çfarë mendojnë njerëzit për këmbët e zbathura. Jam e sigurt që është dor’e Perëndisë.

Brenda sallës së hyrjes, para se të futeshim në kinema erdhi të na takonte pastori shqiptar dhe përkthyesja e tij.

- Përshëndetje dhe mirë se erdhët në kishën tonë! – na përshëndeti pastori dhe na shtrëngoi dorën të dyve.

- Na falni që jemi kaq vonë, - tha Majkëll.

- S'ka problem, - tha pastori i ri. – Jemi gati të vazhdojmë tani?

- Po, - ia priti Majkëll me vendosmëri.

Pastaj përkthyesja pyeti: “Është Majku i krishterë?”.

- Po, - iu përgjigj Majkëll, - më kanë pagëzuar që bebe në një kishë Luterane.

- Ia ka hapur zemrën Jezusit në moshë të pjekur për ta bërë Zot dhe Shpëtimtar? – pyeti pastori sërish, këtë radhë duke parë nga unë për përkthimin dhe unë u kapa në befasi. As që më kishte shkuar ndër mend ta pyesja Majkun vetë.

A nuk janë gjithë amerikanët të krishterë? Po sikur të mos e ketë bërë atë hap të ndërgjegjshëm dhe t'ia ketë dorëzuar jetën Jezusit njësoj siç e kam bërë unë? Mos do të thotë që kisha do të na refuzojë martesën? Prit! Ia fus kot edhe unë. A nuk ishte Majku përzgjedhja e vetë Perëndisë? Sigurisht që është i krishterë!

- Po, - u përgjigja pa ia përkthyer pyetjen Majkut.

- Shkëlqyeshëm! Vazhdojmë, atëherë, - tha pastori dhe të gjithë përveç meje dhe tim eti u futën në sallën e kinemasë.

Pritëm nja dy minuta derisa filloi melodia dhe babi më mbajti për krahu ndërsa filluam të ecnim në anë të sallës së kinemasë së shndërruar në kishë.

Tani që kishte marrë fund gjithë nxitimi dhe kërkimi, me çdo hap të ngadaltë po më thellohej mendimi që po martohesha dhe e kisha babin në krah në çdo hap të kësaj udhe. Po më mbushej zemra me qeshje sërish siç më kishte ndodhur gjatë shumë shërbesave në po këtë vend. Babi eci me mua derisa u ndodha në krahë të djathtë të dhëndrit dhe pastaj u ul në rreshtin e parë përkrah mamit, vëllait dhe nuses së tij. Vura re dhe i buzëqesha kushërirës së mamasë sime, që po merrte pjesë në ceremoni me familjen time.

Ndërsa pastori e hapi shërbesën duke i uruar mirëseardhjen gjithë të pranishmëve, unë doja të dija mbresat që po i linte adhurimi i familjes sime në rilindje familjes sime në lindje. Ishte hera e tyre e parë që hynin në një vend të tillë adhurimi. U luta që të merrnin me vete shumë më tepër sesa kujtimin e martesës sime. U luta që Perëndia të mbillte një apo dy fara të

lajmit të mirë të shpëtimit nëpërmjet Krishtit dhe që zemrat e tyre të ishin tokë pjellore për atë farë që të mbinte e të rritej. U luta që Zoti t'i vadiste me të njëjtin Frymë gëzimi dhe qeshjeje që sundonte në këtë vend.

- Prandaj, Mirela, - më ktheu zëri i pastorit në ceremoninë e dasmës sime, - nënshtroju burrit tënd si Zotit, sepse burri është koka e gruas siç është Krishti koka e kishës dhe shpëtimtari i trupit. Nuk po them t'i lash këmbët çdo natë dhe t'i pish ujin! – bëri shaka pastori dhe përkthyesja me zor po përkthente duke qeshur. – Kjo është diçka që bën gruaja ime.

Majkëll përkuli kokën mënjanë me sytë nga unë duke pritur një shpjegim për të qeshurën e sallës mbrapa nesh. Ia përktheva shpejt e shpejt dhe i shpjegova: “Është një shprehje metaforike vlerësimi. Ta shpjegoj më vonë”.

- Nuk thua shyqyr që bëra dush? – u përgjigj Majkëll dhe qeshi edhe ai.

- Por, - vazhdoi pastori duke bërë shenjë me dorë për qetësi, - siç është kisha nën Krishtin, ashtu edhe gruaja duhet të jetë nën burrin e vet në çdo gjë dhe ta nderojë atë. Majkëll, - iu kthye pastori dhëndrit, - duaje gruan tënde siç e deshi edhe Krishti kishën dhe dha jetën për të që ta shenjtërojë e pastrojë me larjen e ujit të Fjalës, që t'ia paraqesë vetes një kishë të lavdishme, pa asnjë njollë apo rrudhë, por që të jetë e shenjtë dhe pa të meta. Kështu duhet ta duash edhe ti gruan si trupin tënd. Ai që do gruan, do veten.

Hodha një sy mbrapa për reagimin e familjes sime ndaj kësaj përvoje të re të vajosur me gëzim, por u zhgënjeva me fytyrën e ngrysur të tim eti. Po kafshonte buzën e poshtme; mënyra e tij për të më kujtuar sa e pahijshme ishte për një nuse të zbardhte dhëmbët gjatë dasmës së saj. *Pse nuk të qesh një herë buza, o babai im që di vetëm punë si kalë karroce?*

Përfundimisht, pastori i bëri secilit prej nesh pyetjen e shumëpritur. Majkëll u përgjigj me një “Po” të prerë dhe unë u përgjigja në anglisht. Vumë unazat në gishtin e secilit dhe pastori tha: “Tani ju shpall burrë e grua. Mund të ktheheni nga njëri-tjetri dhe të kapni duart!” – shtoi për habinë time që nuk na lejoi të putheshim. – T'ia dini për nder pastor Danit që e shtroi i pari këtë rrugë; kur nuk më la ta puthja nusen ditën e dasmës, nuk ka për t'u puthur asnjëri që martohet nga unë! – tha pastori nëpër dhëmbë, por përkthyesja e dëgjoi dhe e përktheu me zë të lartë.

Salla u ndez në të qeshura edhe një herë, ndërsa pastori falenderoi të gjithë pjesëmarrësit e dasmës së parë të kishës për atë vit. Edhe pse i lëshoi të gjithë, familja ime ndenji pak më gjatë dhe filloi të na afrohej për të na folur. Majkëll më tërhoqi te muri i faqosur me ristela druri, më mbështolli në krahët e tij dhe filloi të më puthte si në shenjë proteste ndaj mbylljes së pastorit. Nuk

dija ku të futesha nga turpi që po puthesha në sy të familjes sime, veçanërisht tim eti, por gjoksi i Majkut dukej si një vend goxha i ngrohtë për momentin. Boll që ishim martuar para se të shikonin të pthurat e një dite më parë në lajmet e mbrëmjes.

Ristelat e drunjta mbas nesh u dukën si një sfond i pëlqyeshëm për disa fotografi me familjen dhe miqtë që kishin ardhur nga “Hash”-i i Llogarasë për të marrë pjesë në dasmën tonë. Pjetri, njeriu më i gjatë që kisha parë ndonjëherë, kishte përdorur aparatën fotografik të Majkut për të nxjerrë fotografi gjatë gjithë ceremonisë.

Gjatë pak minutave të nxituara që unë e Majkëll kaluam me familjen, vura re sytë e përbotur të sime mëje dhe e përqafova fort. Aty e kuptova që im atë po e përdorte gjithë atë moralizim me kafshim buzësh gjatë ceremonisë për të fshehur dhimbjen e vërtetë të dhënies së bijës së vetme një burri krejtësisht të panjohur në një vend të largët. “Obobo! Po u del ‘magjia’!” – mendova dhe vazhdova të përqafoja kunatën time të bukur, vëllanë dhe babanë.

- Kur ikën Majkëll? – pyeti mami. – Nuk do dilni nga shtëpia për një darkë para se të niset?

- S’besoj se do t’i dalë koha. Do të kthehet në punë nesër dhe pastaj niset me avion të enjten. Edhe unë duhet të kthehem në punë nesër. E përdora gjithë lejen javën që shkoi.

- Si do të ikë pa ngrënë asnjë herë me ne? – pyeti mami sërish.

- Lëri tani, - tha babi. – Mos u bëj e bezdisur.

U kthye nga unë dhe shtoi: “Mbase gjen një ditë dhe na e sjell në shtëpi për një vakt”.

- Do të përpiqem, ba, - ia ktheva.

I përqafova prindërit edhe një herë para se të iknin dhe pastaj u kthyem tek salla e hyrjes për formalitetet me shkrim. Edhe pse e dija që nuk pinte ujë në daljen nga vendi me Majkun, në mendjen time, kjo ishte gjithsesi dita e dasmës sime; dita në të cilën u martova në sytë e Perëndisë. Kjo copë letër, e nënshkruar nga pastori dhe dëshmitarët, ishte çertifikata ime e vërtetë e martesës.

Shefi italian i Majkut, Fabricio, që gjithashtu kishte ardhur në dasmën tonë, nënshkroi çertifikatën si njëri prej dëshmitarëve pastaj tha: “Duhet të më premtoni që do t’ia vini emrin të parëlindurit sipas misionit të asistencës së sanksioneve: S.A.M. Po të mos qe për projektin tonë, ju të dy as që do të ishit njohur”.

- Dakord jam unë, - thashë dhe ktheva sytë lart nga Majkëll për përgjigjen e tij.

- Sam është emër i mirë, - miratoi Majkëll buzagaz. – Falemnderit që erdhe sot dhe për gjithë përkrahjen tënde! – shtoi.

Majkëll i dha një dhuratë të vogël pastorit, që e falenderoi dhe na uroi edhe një herë. Morëm certifikatën e nënshkruar të martesës dhe shkuam drejt e te restorant *La Piazza* për darkë, restoranti më i parapëlqyer i Majkut. Unë u gëzova kur vura re televizorin e madh në sallën e pritjes dhe ia tregova Majkut: “Mund të shikojmë veten në televizor në lajmet e mbrëmjes sonte”. Por asgjë në televizor nuk kishte të konkuruar me darkën e shijshme luksoze me peshk të freskët, verë të kuqe dhe akulloren më të shijshme prej arre kokosi që s’e kisha provuar kurrë më parë. “Mbase kapim lajmet e orës dhjetë!” – mendova drejt fundit të darkës sonë të parë si burrë e grua dhe e ktheva sërish vëmendjen nga princi im i kaltër.

Majkëll më pa me fytyrë të qeshur e sy të ndritshëm, ndërsa ngriti gotën e verës për një doll: “Qofshin gëzimet tona të thella sa oqeanet dhe dhimbjet të lehta sa shkuma e deteve!”.

- Amen! – ia prita me gjysmë zëri. *Mos duhet të them edhe unë diçka në përgjigje?* Kjo ishte detyra e dollibashit në dasmat shqiptare, zakonisht e tim eti si më i madhi prej fëmijve dhe më i fjalës për raste të tilla. *Pastaj, unë jam femër. Oh ç’kam për t’u marrë një jetë të tërë me zakone të reja!*

- Do të hash ndonjë gjë tjetër? – pyeti Majkëll duke parë pjatën time të zbrazët.

- Jo. Gjithçka ishte e mrekullueshme. Kush e di sa shtrenjtë ka për të vajtur, - shtova me faj.

- Ha sa të shohësh me sy tani. Një darkë e tillë në një restorant të këtij kalibri në Shtetet e Bashkuara do të kishte kushtuar katër a pesëfishin e këtushëm. Dua ta dish që nuk jam ndonjë pasanik. Jam thjesht një punonjës qeverie dhe po investoj tek ty, - shtoi Majkëll.

- Jam e sigurt që do të mjaftojë. Jam rritur goxha e kënaqur me shumë më pak. Do të kemi jetë të bekuar bashkë; kishim për mbles vetë Perëndinë! – iu përgjigja.

- Mblesëri e bërë në parajsë, kur themi ne në Amerikë. Unë jam nga ata që e shikojnë gotën gjysmë të mbushur, - tha Majkëll.

- Edhe unë. Domethënë, po t’i bëjmë bashkë, do ta kemi gotën gjithmonë plot, - qesha me zbulimin tim. Pastaj vura re sasinë e bakshishit që Majkëll po linte në tavolinë para se të dilte dhe thashë: “Le shumë bakshish. Ti sikur the që nuk je pasanik”.

- Çdo dollar që futet në ekonominë e vendit tënd qarkullon dhe

shumëfishohet, - shpjegoi Majkëll dhe mua më preku edhe një herë dëshira e tij për të ndihmuar vendin tim. Më dukej sikur e bënte nga dashuria për mua. Vazhdoi të shpjegonte efektin shumëfishues, por unë pothuajse nuk kuptova asgjë.

- Kot që harxhon frymën të më shpjegosh paratë mua. Nuk kuptoj asgjë më tepër se sa diferencën midis të ardhurave e shpenzimeve për të mos u futur në borxh.

Majkëll më mbajti për dore, ndërsa kaluam bulevardin e ndriçuar drejt hotelit e në ashensor për te dhoma jonë. Hapi derën dhe, para se unë të hidhja këmbën brenda, papritur, më ngriti në krahë dhe kapërceu pragun. Më vendosi me kujdes në krevat dhe filloi të më mbulonte me të puthura.

- Mirë se erdhe në shtëpi, zonja Klain! – pëshpëriti Majkëll duke më rrënqethur deri në palcë. *Kam emër të ri!*

- Sa më pëlqen emri i ri! – ia ktheva duke pëshpëritur si për të mos trazuar të puthurat.

Majkëll më zbërtheu zinxhirin e fustanit dhe ma hoqi. Ndërsa hoqi teshat e veta, unë u futa me shpejtësi nën mbulesë. Me sa dukej dasma jonë ishte po aq e vërtetë për të sa ishte edhe për mua edhe pse nuk njihej nga shteti shqiptar. Kur Perëndia është me të, kush mund të jetë kundër tij? Majkëll fiku dritat dhe m'u bashkua nën rroba për mbetjen e natës. Pritja e tij torturuese e katër netëve të shkuara mori fund dhe shpërblimi edhe më i bukur prej saj.

Nuk do të më vinte keq të shtyhej edhe ca, sa për t'u marrë me turpin e pashqitshëm meqë nuk e kisha pritur. Vazhdonte të më mundonte dhe të më rëndonte në ndërgjegje. Por mendimi alarmues i të rënit me barrë menjëherë mori prioritet sapo kuptova çfarë kishte dalë prej tij dhe ishte futur brenda meje.

- Po ti e le brenda! – thashë e befasuar.

- Eeee, - u përgjigj Majkëll me një shprehje prej fëmije në fytyrë si për të thënë: “Pse ku lihet tjetër?”.

Nxitova për në dush, sikur ta laja të gjithën përjashta. Nuk mund të vendosja nëse duhej të shqetësohesha për një shtatzëni të shpejtë që edhe mund të mos ndodhte apo të qeshja me fytyrën e tij të çuditur dhe të përqafoja të gjithë idenë e një bebeje të re. Dushi i nxehtë e bëri të vetën sërish. Ndjeva paqe dhe u kujtova që çfarëdo që të ndodhte, isha prapëseprapë mu në mes të vullnetit të Perëndisë.

Disa minuta më vonë, u ktheva në krevat dhe u shtriva përkrah burrit tim humorist, që tashmë e kishte zënë gjumi. Vura kokën mbi krahun e tij të

djathtë dhe krahun tim të majtë mbi gjoksin e tij të ngritur. Ai u zgjua dhe palosi krahun e tij mbi shpinën time në dhomën e errët. Pastaj, se nga më doli: “Më fal që nuk isha e virgjër për ty!”.

- S’ka gjë, - u përgjigj Majkëll gjysmë i përgjumur. - Mua më dukesh tamam si virgjëreshë, - shtoi dhe filloi të këndonte: “Si e virgjër, e prekur për herë të parë...”.

- Unë e kisha seriozisht derisa fillove të këndoje, - i thashë duke qeshur.

- Me të kënduarit e mi qesh ti?

- Jo, megjithëse stonon ca.

- Ngaqë nuk e di dhe aq mirë. Vetëm një këngë di, - u përgjigj Majkëll dhe filloi të këndonte me zë më të thellë dhe më të lartë.

*“Çfarë i bën një marinari të dehur,
Çfarë i bën një marinari të dehur,
Çfarë i bën një marinari të dehur,
Herët në mëngjes?”*

- Shshsh! – pëshpërita dhe vura dorën mbi gojë, si për të parandaluar të qeshurën time me zë të lartë, po ai vazhdoi të këndonte gjithsesi:

*“E vë mbi kuvertë dhe e bën ta lajë me leckë,
E vë mbi kuvertë dhe e bën ta lajë me leckë,
E vë mbi kuvertë dhe e bën ta lajë me leckë,
Herët në mëngjes!”*

Tamam kur kujtova se kishte përfunduar së kënduari, ia filloi edhe më fortë për çka tingëllonte si refreni:

*“Lart, lart, lart ngrihet,
Lart, lart, lart ngrihet,
Lart, lart, lart ngrihet,
Herët në mëngjes.”*

Majkëll vazhdoi të këndonte mbetjen e vargjeve. Pushoi pas çdo vargu për të më shpjeguar termat e vjetra të marinarëve për anijen. Unë vazhdova të qeshja me vargjet qesharake dhe të kënduarit e Majkut me zë të thelluar.

- Nuk je dhe aq më i zoti as me këngën që di, - i pëshpërita. – Më fal që të zgjova.

Mbështolli krahët nga mbrapa dhe përreth belit tim dhe më tërhoqi pas vetes. –Natën e mirë, e ëmbla ime!

- Gjumë të ëmbël! – ia prita dhe mbylla sytë për të fjetur në krahët e tij. M'u bënë sikur të ishin një shtrirje e krahëve të Perëndisë duke më siguruar për faljen dhe dashurinë e tij. *Mëshira e tij përsëritet çdo mëngjes.*

Ishim ende të shtrirë në shtrat kur pastruesja trokiti në derë të nesërmen në mëngjes. Ajo u fut në dhomë dhe instinkti im i parë ishte të fshihesha nën jorgan nga turpi që po më shikonte me një burrë në krevat. Pastaj u kujtova që burri ishte bashkëshorti im dhe u çela. Perëndia kishte shtrirë cepin e pelerinës së tij për të mbuluar lakuriqësinë time. *Falemnderit, Zot! Mëshira jote vazhdon përjetë!*

- Falemnderit që më more për grua! – i thashë Majkut.

- Je e mirëpritur! – ma ktheu me një puthje tjetër.

- Çfarë do të bësh sot? – e pyeta.

- Më duhet t'i kthej makinën Xhovanit dhe të merrem vesh me kolegun në Vlorë, por do të kthehem mbasdite. Sa punonjës i keq jam! – u përgjigj Majkëll duke u ndjerë fajtor përsëri, pavarësisht se çfarë thosha unë për mungesën e tij në punë.

- Po shkoj edhe unë në punë atëherë, - thashë dhe veshja pantallonat bluxhinse.

Kur vajta në punë atë mëngjes të hëne, më përshëndeti shefi im i çuditur.

- Po ti ç'do këtu? – më pyeti.

- Epo Majkut iu desh të kthehej në punën e vet, kështu që edhe unë erdha në punë. Do të vijë të më marrë më vonë.

- Kur ikën nga Shqipëria?

- Këtë të enjte, - ia ktheva.

- Po të merr me vete?

- Jo. Dasma e djeshme në kishë nuk mjaftoi as për shtetin këtu as për ambasadën amerikane. Bëmë kërkesë për vizë fejeje atje, por Majkëll do ta fillojë procesin edhe në Sh.B.A.; cila të bëhet më parë.

- Merre gjithë javën pushim, - tha shefi im.

- Falemnderit!

Majkëll u kthye mbasdite dhe ne kaluam katër ditët e fundit së bashku duke përkthyer dhe noterizuar çertifikatën e martesës sonë dhe notat e shkollës sime, duke blerë e duke ngrënë me miqtë tanë.

Më mbajti për dore ngado që ecëm në rrugët e mbushura të Tiranës deri në çastin që i thamë njëri-tjetrit mirupafshim tek aeroporti të enjten. Fabiola dhe Xhoni na çuan në aeroport. Në kthim, u përpoqa sa të mundja të mos

ndjehesha aq e zbrazët dhe e heshtur duke parë atletet e reja dhe duke qeshur. Fabiola e vuri re nga vendi i parë dhe pyeti: “Përse qesh?”.

- Sapo m’u kujtua përvoja jonë e blerjes së atleteve, - ia prita.

- Këto që ke veshur?

- Ëhë. Majkëll nguli këmbë që të më blinte këpucë vrapimi të rehatshme para nja dy ditësh. Më çoi te një nga ato dyqanet me këpucë të shtrenjta që janë hapur kohët e fundit me goca të bukura që të rrinë lepe-peqe. U thashë të provoja një palë tridhjetenënta; nuk më bënë. Pastaj provova një palë tridhjetenëntë e gjysmë. As ato nuk më bënë. Më kapi lemeria; më ishin bërë këmbët dyzeta!

- Jo, moj, jo, - tha Xhoni duke qeshur. – Ca firma këpucësh i kanë masat një çikë më të vogla se të tjerat.

- As nuk e dija as nuk më bëhej vonë për momentin. Nuk isha duke u kapur gjallë në botë në këpucë me numër dyzet para burrit tim të ri, kështu që i mblodha këmbët brenda këpucës tridhjetenëntë dhe i shtyta fortë pas thembrës. U pa edhe puna e rehatit tim.

- Po të dhembin këmbët tani? – pyeti Fabiola duke qeshur.

- Një çikë te gishtat. Janë çuditërsihtë të ngrohta pa.

- Do të më marrë malli për të, - tha Fabiola ende duke qeshur. – Do të më marrë malli për atë fytyrën e Majkut sa herë të sodiste. I ndrinte nuri, qeshte gjithë kohës dhe nuk t’i ndante sytë. I kishte gjithë dashuri dhe adhurim. Nuk kam parë ende burrë aq të dashuruar pas gruas: kaq hapur, kaq e demonstruar, kaq e dukshme edhe ndaj të panjohurve në një autobus kalimtar.

- Të njëjtën gjë tha edhe im vëlla te dasma, - kujtova e gëzuar që dëgjoja një konfirmim të dytë të dashurisë së dukshme të burrit tim për mua.

- Sa keq më vjen që nuk arritëm dot te dasma! Braçe nuk e priti lajmin dhe aq mirë, po të tjerët po bënë shaka për ju të dy duke thënë: “Kur shikon Majku Mirelën, shkrihet më shpejt se qiriri”, - shtoi Fabiola.

- Falemnderit! – ia prita më sinqerisht se kurrë. – Cilin lajm nuk priti Braçja mirë? Lajmin e martesës sime? – e pyeta në shqip.

- Po. U revoltua me një të huaj tjetër që mori një nga vajzat tona.

- Çne ai? – pyeta sërish duke bërë budallanë.

- Ti e dije që të donte, apo jo? – u përgjigj Fabiola duke zbuluar shtirjen time.

- Ashtu m’u duk për njëfarë kohe, por, kur nuk u bë gjë, mendova se kishte qenë imagjinata ime.

- Nuk ishte. Ti i kape të gjithë në befasi.

KAPITULLI XXV

===== **NGA KALIFORNIA ME DASHURI** =====

Iliri ishte i pari nga shokët e befasuar që erdhi të më takonte te puna. Nuk e kishte marrë vesh për martesën time derisa më pa në lajmet e mbrëmjes ditën e dasmës.

- Çfarë bëre, moj?! – më pyeti i shtangur.

- U martova unë, - ia prita dhe qesha.

- M'u desh të ktheja kokën dy herë nga ekrani.

- Çfarë dha televizori? Sa inat më vjen që nuk e pashë dot. Po haja darkë në atë kohë.

- Të tregoi duke u puthur në sy të të gjithë miletit.

- Po shpresoja që të mos njihesha ose që kamera të më kishte kapur nga mbrapa.

- Jo, jo! Kamera u soll rreth e rrotull, - përshkroi Iliri tek vazhdova të qeshja.

Tani ishte një tjetër shok i befasuar që takova në kthim nga puna një javë e ca pas dasmës sime.

- Nuk po u besoja syve kur të pashë në lajme! – tha. – “Nuk ka mundësi. Nuk është edhe aq e marrë”, mendova. Ku e gjete atë mollopupin?

- Nuk është mollopup! Pastaj, e ha me gjatësi atë pak bark që ka. Ti dy vjet ke që ke dalë nga shkolla dhe ke filluar barkun e birrës pa patur as gjatësinë për ta maskuar.

- Uuuu, avash ti, më! Po na i del krahë që tani. Që është një çikë mollopup, atë mbaje! – nguli këmbë Tani.

- S'ke faj, e ke parë vetëm në televizor. Thonë që ekrani të shton pesë kile, - ia prita. – U takuam te ambasada amerikane.

Pastaj, krejt papritur, Tani lëshoi bombën. “Është kthyer Teo!”, tha dhe më vështroi ngultas për të parë reagimin tim.

- Edhe? – ia prita duke u përpjekur me sa munda të dukesh indiferente. – E dija që do të kthehej, vetëm se jo para shtatorit.

- Nga e dije? – pyeti Tani disi i habitur që nuk më kishte kapur në befasi me lajmin.

- Më tha vetë në ëndërr para ca kohësh.

- Në tetor, në fakt. Dëgjova që po kthehet në tetor. Bëra shaka, - tha Tani.

- Epo, kurdo që të jetë, ato janë pula të ngordhura tani, apo jo? – ngrita supet duke ruajtur qetësinë.

- E, de, e. E paskam të vështirë të mësohem me idenë që ti vajte e na u martove. Ndodhi kaq papritur. Urime, urime! Jetë të lumtur!

- Falemnderit!

- Kur nisësh?

- Nuk e di ende. Së shpejti, shpresoj, - iu përgjigja dhe u ndamë.

Edhe Vilma mori në telefon të nesërmen në punë për të më uruar.

- Falemnderit! – iu përgjigja dhe i thashë me një frymë ca nga ndodhitë e fejesës sime marramendëse me dhëndrin tim të ri, Majkëll. Doja të ndaja lajmin e lumtur me gjithë shoqërinë time, por mbi të gjitha doja të ndaja ecjen e përditshme me Perëndinë. Më dukej sikur Perëndia më kishte dhënë një torte të madhe të mrekullueshme dhe unë doja t'i ftoja të gjithë shokët e mi që ta hanim bashkë.

- I thashë Nedit që u martove sapo e mora vesh, - tha Vilma.

- Është kthyer nga Italia?

- Jo, akoma, po më duket se i ka hyrë frika. Ka frikë mos bëj dhe unë të njëjtën gjë.

- Mirë t'i bëhet! Mbase “vjen nga Korça” dhe kthehet. Çfarë tha? – pyeta me frikë për ndonjë përgjigje gjykuese.

- Më pyeti nëse kam edhe unë ndërmend të bëj si bërë ti, së cilës iu përgjigja: “Po bërë ti si ai, edhe unë si ajo do bëj”.

- Hallall! Më vjen mirë që dikush po nxë nga përvoja ime, megjithëse nuk e bëra për hakmarrje. As jam e hidhur për këtë. Kam paqe në vullnetin e Perëndisë. E di që gjithçka bëhet për të mirën e atyre që duan Perëndinë dhe janë thirrur sipas qëllimit të tij.

- Jam e lumtur për ty, e dashur. Do të më marrë malli. Më shkruaj sa më shpesh që të mundesh, kur të mbërrish, - tha Vilma.

- Do të të shkruaj. Të premtoj. Ia bekoftë Zoti Nedit kthimin tek ty!

- Falemnderit! – ma ktheu Vilma dhe e mbylli telefonin.

Ky ishte premtimi im i dytë për të shkruar. Të paktën këto nuk kisha për t'i shkruar në gjuhë të huaj. Unë e Majkëll kishim premtuar t'i shkruanim njëri-tjetrit çdo ditë. Një llaf goje, pa! *Kështu është kur s'mban korrespondencë me shoqet e reja që zë në kamp pionerësh!* Mund të më kishte ardhur n'doresht tani. Majkëll e mbajti premtimin pak pasi mbërriti në shtëpi. Mora faksin e tij të parë vetëm pas pesë ditësh dhe e lexova me një frymë:

18 prill 1995

Mirela Klain

Fondacioni Soros

Për: Dokumentat e duhura me DHL

E dashur lozonjare:

Vajta për vizitë tek disa shokë sot që punojnë për INS (shërbimi i mërgimit dhe nënshetësimit). Ata do të ndihmojnë në përsheptimin e procesit me sa të munden. Unë do të paraqes një formular lutjeje I-130. Për t'u klasifikuar me statusin e të afërmit të huaj për lëshimin e vizës së mërgimit, duhet të më dërgosh te adresa ime një çertifikatë lindjeje të noterizuar me përkthim të noterizuar.

Gjithashtu, më duhet të shtypësh adresën e saktë ku ndenjëm për muajin e mjaltit. Do t'a hedh lutjen këtu në Rivërsajd. Pastaj, ata do t'ia dërgojnë dokumentat e hedhura konsullatës në Tiranë. Ata do të të marrin në intervistë atje dhe do të të kërkojnë të nxjerrësh një çertifikatë mjekësore, etj. Kur t'u jenë plotësuar kërkesat, do të të japin vizën për t'u bashkuar me mua. Mos harro, Fabricio do të të ndihmojë sapo të mbërrijnë në konsullatë dokumentat që po hedh te INS. Ti duhet të vazhdosësh të kontrollosh për të parë kur mbërrijnë në Tiranë. Mendoj se mund ta rregulloj për një çikë ndërhyrje në proces këtu në Shtetet e Bashkuara.

Të shkrova një letër në Paris dhe ta dërgova nga hoteli. Mora dhe një dhuratë për ty nga hoteli në Paris. Nuk i kam besë postës që të ta dërgoja.

Do ta kesh kur të vish këtu. Po të inçizoj edhe ca këngë vokalistesh. Po të dërgoj një pako nëpërmjet ambasadës: cigare Marlboro për Bobin, kaseta dhe të mbathura për ty dhe një flamur amerikan për lokalën e Arturit.

Të ka marrë malli për mua? Mua më ka marrë malli për ty dhe dua shumë të jesh me mua. Të Do-wa.

Me gjithë dashurinë time,

Z. Majkëll Klain

Hetues kriminal

Nuk humba aspak kohë në mbledhjen e dokumentave dhe të dhënave që më kërkoi Majkëll dhe ia postova me saktësi siç më sugjeroi. Të paktën mund të merrte letrën time të parë një çikë më herët se sa posta e rregullt. Më pëlqente puna ime edhe para se të merrja fakse të gjata që përshkruanin dashurinë e bashkëshortit tim për mua, dëshirën e tij për të ndarë jetën e përditshme me mua. Mezi po prisja të bëhesha pjesë e saj.

Sapo Majkëll mori pakon time prej DHL, më dërgoi një faks tjetër. Edhe bashkëpunëtorët e mi donin të dinin për se fliste në letrat e tij të gjata kur shikonin fytyrën time të qeshur, ndërsa lexoja fjalë dashurie në shqip:

22 prill 1995

Për: O shpirti im, Mirela

E dashur lozonjare!

E mora pakon tënde prej DHL dhe letrën tënde. (Të dua. Më ka marrë malli shumë.) Më mungon. Është e shtunë këtu. Më duhet ende të gjej një kopje të certifikatës sime të lindjes. Do të bëj kopje të noterizuara të të gjitha dokumentave ose sot ose të hënën. Dua ta bëj këtë në rast se INS humbet letrat e tua. Mund të nxjerr një palë kopje të tjera në këtë mënyrë.

INS do t'ia dërgojë pakon konsullatës. Prej andej, do ta bësh ti gjithë punën për nxjerrjen e vizës. Sapo të marrësh vesh që kanë ardhur letrat në konsullatë, mund t'i kërkosh ndihmë Fabricios. Megjithatë, mos i kërkoni ndihmë para se të mbërrijnë letrat, sepse Fabricio do të bezdisë konsullatën para se të mund të bëjnë gjë për të të ndihmuar. Kjo mund t'i inatosë me ty.

Ndodhi një shpërthim gjigand në Oklahoma të enjten. Një grup i djathtë amerikan hodhi në erë një ndërtesë federale, duke vrarë mbi njëqind njerëz. Përdorën një makinë plot me lëndë shpërthyesë. Është një javë e trishtuar për punonjësit federalë.

I çova filmat te një dyqan fotografish. Zonja që punonte atje e pëlqeu shumë historinë e takimit dhe martesës sonë. Ajo korrigjoi shumicën e gabimeve që kishte bërë dyqani në Shqipëri. Fotografitë janë shumë të bukura tani. Ata te dyqani i fotografive në Shqipëri bënë punë të mirë me pajisjet dhe kimikatet që patën, por, meqenëse janë shumë të shtrenjta për ta, ata përdorin kimikate të skaduara. Kjo i bën fotografitë shumë të errëta dhe të mangëta në ngjyrë.

Familja ime dhe miqtë nga puna i pëlqyen shumë fotografitë e tua. Të gjithë i pëlqejnë fotografitë e tua. Familja ime mezi po pret të të takojë. Disa prej shokëve të mi më kanë ngacmuar që ti je e bukur, por “çfarë i gëzohesh atij?”. Shokët më thonë që do të më bëjë mirë gruaja. Njëri prej sekretareve tona iu desh të më kujtonte që unaza vihet në dorën e majtë, jo në të djathtën. Ata më ngacmojnë e më thonë që ti duhet të vish sa më shpejt që të kujdesesh për mua.

I dërgova një pako Bobit. Ka disa sende në pako për ty, së bashku me një udhëzues për ngarje automjeti në Kaliforni që ka një provim shembull. Të lutem lexo në udhëzues kapitujt që kanë të bëjnë me rregullat e qarkullimit, rregulloret dhe si të bëhesh shofer më i mirë.

E mban mend kishën për të cilën të fola? Është vetëm dy minuta më këmbë nga shtëpia. Është kishë luterane. Më tha mamaja që kam qenë i pagëzuar në një kishë luterane (Shën Gjon në Shën Luis, Mizuri). Mamaja më tha edhe që ndoshta kisha jote është e organizuar nga kisha luterane meqë erdhi nga një vend nordik. Do kaloj nga kisha të shoh nëse më pëlqejnë dhe nëse kanë ndonjë grup që këndon.

Më mungon shumë dhe të dua këtu me mua. Nuk jam kthyer ende në punë. Të hënën paraqitem në punë. Megjithëse kam kaluar nga zyra. Kreva disa punë angari, takova familjen, bëra intervistë me DEA dhe shlyeva një kredi të dytë për shtëpinë tonë. Tani kemi borxh vetëm pesëdhjetepesë mijë dollarë në shtëpinë (apartamentin) tonë. Nuk pres t'i kuptosh financat tona menjëherë. Unë vetëm po t'i shpjegoj që t'i kuptosh me kalimin e kohës. Kjo kredi po na kushtonte dyqind dollarë në muaj vetëm në përqindje.

Im vëlla më bëri të vrapoja pesë milje me të këtë të premte. Ishte shumë e vështirë për mua, sepse nuk kisha vrapuar në mbi katër muaj. Sot do të

shkoj të notoj dy milje te palestra. Kam ndër mend të vij në formë para se të mbërrish.

Natën të shoh në ëndërr dhe rrokullisem duke zgjatur duart për ty, po ti nuk je këtu ende. Edhe shenjat më kanë ikur nga trupi tani.

Tani po filloj të të shkruaj çdo ditë, por do ta dërgoj letrën me faks të dielave. Do t'i shtoj letrës disa rreshta përditë derisa ta dërgoj të dielën. Sapo ndërrova kompaninë e telefonit. Do të duhen tetë ditë zyrtare (e hënë deri të premte) për të ndërruar shërbimin e telefonit. Ne kemi kompani private telefonash këtu. Zgjedhim prej disave. Tani për tani, çdo minutë me Shqipërinë kushton tetë dollarë. Shërbimi i ri do të kushtojë dy dollarë e pesëdhjetepesë qindarka minutin nga ora tre e mëngjesit deri në tre mbasdite. Për dy minuta mund të të dërgoj letra të gjata. Nuk besoj që shërbimi postar do të të gjente. Kur të dërgoj faks, kompjuteri më thotë nëse faksi yt e ka marrë letrën apo jo.

Mirë atëherë, po shkoj të notoj. Do të të shkruaj pak më gjatë para se të ta dërgoj këtë letër më vonë.

U ktheva. Notova pesë mijë metra sot. Në fillim, kisha frikë se mos më binte unaza në fund të pishinës. Po nuk ra, kështu që mund të notoj me gjithë të. Edhe po ra, e gjej në fund të pishinës. U ndjeva shumë mirë. Do të filloj programin e notit dhe të vrapit tani që u mësova me orarin e këtushëm. Hëngra gjellën më të preferuar për darkë - makarona; makarona domatesh me perime të ndryshme.

Dita tjetër, ose e dielë në mëngjes për mua. Është e dielë mbasdite për ty. Thuaji Mirës "njatjeta" nga unë. Kur të bëhem mbarë për të të dërguar pako me postë kërmilli, do të të dërgoj edhe ca fotografi të tuat me Mirën. "Postë kërmilli" është çka quajnë përdoruesit e kompjuterit mënyrën e vjetër të postimit, ku duhet të përdorësh pullë poste në vend të kompjuterit. Kërmilli është një molusk me guackë që duket si guackë deti dhe lëviz shumë ngadalë.

Më tha motra që duhet të instaloj një sqollë të re në banjë para se të vish. Nuk ka asgjë të keqe kjo që kam, vetëm se është e vjetër (pesëmbëdhjetë vjet) dhe ka njolla uji. Mirë është sa për një beqar si unë (NË TË KALUARËN), mjafton që të jetë e pastër edhe pse me njolla uji. Do instaloj një të re – fringo fare – për ty. Motra ime po fillon që tani të të mbajë anën.

Më duhet të rregulloj baterinë e motorit. Bateria u shkarkua sa isha i ikur. Kam një Honda Night Hawk 650. Është e 1984-ës, po e bleva të re dhe është në gjendje të shkëlqyer. Kam patur dhe ngarë motora që kur kam qenë katërmbëdhjetë vjeç. Dua të të nxjerr xhiro me motor.

Të lutem, thuaji vëllait që nuk do të isha martuar me ty po mos të të doja për gjithë jetën. Në Shtetet e Bashkuara, njerëzit do të më përgojnë sa grua të re që kam, po të ma dinë moshën e vërtetë.

Po shkoj të bëj një dush, si amerikan i llastuar që jam. Do të të shkruaj një çikë më tepër në këtë letër sot mbasdite para se ta dërgoj në darkë.

Pata një mbasdite interesante. Më thirrën në punë për disa orë. E mban mend që të thashë që ca veta hodhën në erë një godinë që vrau mbi njëqindca njerëz si edhe disa fëmijë në Oklahoma? E kapën njërin prej të dyshimëve në Kaliforninë e Jugut. Unë isha në krye të ekipit që e transportoi në një burg federal në Los Anxheles. Po të dalë fajtor, kanë për ta ekzekutuar. Nuk notova dot sot, por ia vlejti. Të dua! Kalofsh një javë të mirë! Unë shkoj tek INS të martën.

*Të Dua,
Majkëll*

Të qenit e sapomartuar dhe larg burrit ma tendosi besimin në caqe si kurrë më parë. Gjithçka kisha tani ishin letrat e tij të dashurisë dhe ato të Perëndisë. Nuk kisha nga t'ia mbaja tjetër përveçse t'i lexoja të dyja dhe ta vija besimin në planin e mrekullueshëm të Perëndisë për jetën time të re në Krishtin. U desh e gjitha ajo dhe lutjet e vazhdueshme për të mos i vënë veshin shqetësimeve dhe frikës ngjitëse të tim vëllai për martesën time katërditore me një person krejtësisht të panjohur që tashmë jetonte në anën tjetër të botës dhe ishte krejtësisht i pagjetshëm, po të vendoste ashtu.

“Po ç’kuptim do të kishte?”, i isha përgjigjur dhe kisha menduar atë që nuk mund t’ia thosha me zë tim vëllai: “Nuk mund të kishte qenë thjesht për seks, përndryshe nuk do të kishte pritur derisa të martoheshim”.

Kur më mori Majkëll në telefon për herë të parë, sekretarja ma kaloi me njoftimin: “Zj. Klain, kam Z. Klain në telefon për ty,” menjëherë para se të më lidhte.

- Alo, lozonjare! – dëgjova nga ana tjetër e marrësit.

- Përshëndetje, Z. Klain! – buzëqesha.

Majkëll e bëri qëllim në vetvete të më thërriste në emrin e ri sa herë që më telefononte apo shkruante. Më pëlqente shumë identiteti im i ri, emri im i ri. Nuk isha më e përbuzur; isha e dëshiruar, e vlerësuar, e dashuruar ashtu siç isha. *Falemnderit, Zot, që më zgjodhe mua!*

- Ke marrë ndonjë nga letrat e mia? – pyeti Majkëll.

- Po, - ia prita, - më pëlqejnë shumë. Më duket sikur po të njoh shumë më mirë nëpërmjet letrave tani që jemi larg. Nuk ishim në vete kur ishim bashkë. E gjithë zyra ime po të njeh më mirë.

- Po ua lexon letrat e mia edhe atyre? – pyeti Majkëll.

- Vetëm disa pjesë nga aventurat e tua të punës. I dëgjojnë me kënaqësi, si drejt e nga filmat. U përpoqa të të telefonoja dhe të dërgoja faks, po nuk fitem dot te asnjëri prej numrave të tu. Dëgjoj vetëm një pip-pip të shkurtër, më të shpejtë se një sinjal i zënë. Do të më duhet të të shkruaj dhe të t'i dërgoj letrat e mia me postë. Ke marrë ndonjë? – e pyeta.

- Jo. Jo me postë të rregullt, - u përgjigj Majkëll. – E more letrën që të dërgova nga Parisi?

- Jo, nuk e kam marrë, - iu përgjigja. – Si je?

- Më ka marrë malli, - u përgjigj Majkëll.

- Edhe mua. Shkova te mbrëmja e bunkerit fundjavën që kaloi dhe u duk e zbrazët. Nuk është njësoj pa ty. Të gjithë shkuan në disko më pas, por unë nuk shkova. Një nga çunat tha që mund të më ndihmonte me fakset ose edhe me postimin e letrave nga ambasada. Mund të jetë më shpejtë ashtu.

- Mirë të ka thënë; më shpejt është. Prandaj i kam dërguar një pako Bobit, që të përdorja adresën e ambasadës.

- Sa mirë që po të dëgjoj zërin! Falemnderit që më more në telefon, - ia ktheva.

- Je e mirëpritur, - u përgjigj Majkëll. – Megjithëse do të doja të të merrja më shpesh.

- E di. E lexova te letra jote e fundit se sa shtrenjtë është. Nuk e kisha idenë. Mirë, shko fli një çikë tani. Natën e mirë!

- Më shkruaj shumë letra! – u përgjigj Majkëll.

- Mirë. Edhe ti.

Dhe ashtu bëri:

E hënë, 25 prill 1995

E dashur lozonjare afërditase:

Pata ditën e parë të vërtetë në punë sot. Nesër do të shkoj në punë vonë, sepse më duhet të shkoj tek INS. M'u desh të nxirrja katër fotografi të vogla për vete si ato që nxore ti për INS.

Të porosita abonimin për dy revista: "Fit" dhe "Kucing Lajt". Do të na vijnë drejt e në shtëpi. Doja vërtetim banese për ty këtu në Kaliforni. Nganjëherë, abonimi shërben si vërtetim banimi në Kaliforni. Mbas një viti në Kaliforni, do të jetë shumë më lirë të të dërgoj në shkollë. Kam përshtypjen se ke për t'i pëlqyer edhe revistat. Bleva edhe një libër "Burrat janë nga Marsi, gratë nga Afërdita". Është libër i shumëshitur këtu në Amerikë.

Në Sh.B.A., një segment i madh i popullsisë është përpjekur të bëjë burrat dhe gratë njësoj nga çdo anë. Ky libër tregon dallimet midis burrave dhe grave dhe përpiqet t'i mësojë t'i respektojnë ato ndryshime. Ky libër thotë: "Dashuria është e magjishme dhe mund të zgjasë, nëse mbajmë mend dallimet tona". Po e lexoj librin, por më duhesh ti këtu që të praktikoj komunikimin ndërmjet marsianëve dhe afërditasve.

Pasnesër, topi kalon në anën tënde. Kjo është një shprehje nga loja e tenisit. Do të thotë që unë kam bërë gjithçka mundem derisa të plotësosh ti letrat në Tiranë. Unë do të pyes të martën sa kohë do të duhet derisa letrat të kalohen në ambasadë në Tiranë. Mbasi të kesh plotësuar letrat në Tiranë, topi do të jetë në anën time. Mund të të dërgoj një biletë ajrore për të ardhur në shtëpi. Të gjithë këtu duan të të takojnë, kështu që do të na duhet të organizojmë një dasmë. U kam thënë shumë prej shokëve të mi që punojnë për doganën në Los Anxheles për ty. Do t'i mbajnë sytë hapur për ty kur të vish në Shtetet e Bashkuara. Sigurisht, unë dua që të fluturosh drejt e në Los Anxheles.

Sot, një shoku im nga San Diego na ftoi që të shkojmë në skafin e tij shtatëmetrash në gjirin e San Diegos. Po të kem fat, mbase je këtu për ditëlindjen time.

Mirë, pra, më duhet të shkoj në palestër e të notoj. Do të të shkruaj prapë më vonë. Gjithmonë duke menduar për ty! Të dua!

Nuk arrita dot të notoj. Qenka një program special mbi luftën në Bosnje në TV. Nuk munda ta fikja. Ishte shumë e trishtueshme!

Vajta verifikova te një dyqan bizhuterish; unazat janë flori. Sa inat më vjen që telefonatat me Shqipërinë janë aq shtrenjtë! Bën vetëm pesëdhjetë qindarka minuti për vendet e tjera të Europës. Politikanët tuaj po pasurohen në kurriz të popullit tënd me telefonatat. Nuk po pres më ta dërgoj këtë letër. Mendo për bashkimin tonë nesër ose sot, për ty! Më dërgo shumë letra! Mirupafshim!

Të dua,
Majkëll

Me sa dukej Majkut i pëlqente që ua lexoja aventurat e punës shokëve të zyrës sime ose thjesht i pëlqente të më përfshinte edhe mua në rrjedhën e tij ditore, sepse nuk harronte të më shkruante diçka interesante nga puna e tij në çdo letër:

27 prill 1995

Për: Të dhëna të domosdoshme prej teje

Jam shumë i lodhur, prandaj do të përpiqem të shpjegoj qartë si të më dërgosh të dhënat që më duhen. Fluturova në helikopter gjithë ditën nga ora nëntë para dite deri në njëmbëdhjetë të natës. Ndoqëm një njeri të keq për të parë kush ishin partnerët e tij. Përdorëm një helikopter që quhet “xhet reinxhër”; është i njëjti lloj helikopteri që përdor presidenti i Shqipërisë. Dolëm shumë me sukses.

Nuk munda të përfundoja hedhjen e dokumentave për vizën tënde sot në mëngjes. Më duhet të di disa të dhëna biografike të tuat. Së pari, do të të sugjeroj se si të m'i dërgosh. Së dyti, do të rreshtoj një sërë pyetjesh të cilave duhet t'u përgjigjesh. Te lutem, shtypi përgjigjet, sepse e kam të vështirë të ta lexoj shkrimin nganjëherë. E dua shkrimin tënd, po të dhënat që vendos në formularin e INS-së duhet të jenë të përkryera. Të lutem, mbaj një kopje të pyetjeve dhe përgjigjeve. Konsullata në Tiranë do të të pyesë për këto të dhëna më vonë. Kur t'i kem marrë të dhënat për plotësimin e formularit të biografisë tënde, mund t'ia dërgoj dokumentat INS-së. INS, pastaj, do t'ia kalojë kërkesën për vizë konsullatës në Tiranë.

Mund të m'i dërgosh të dhënat me faks ose me DHL. Mos e përdor faksin e kompanisë tënde pa leje. Nëse agjencia jote pranon, ndoshta mund të paguash për koston e telefonatës për dërgimin e faksit në zyrën time. Qendra e S.A.M.-it ndoshta ma dërgon falas. Ata mund të dërgojnë faks me një sistem kompjuteri që quhet SAMSAT. Ka edhe kompani që i faksojnë të dhënat me pagesë. Nëse nuk bëhet me asnjërën nga këto, dërgoji me DHL, po të lutem dërgoji. Më mungon dhe të dua këtu sa më shpejt. Mos harro, të dua!

*Të Dua,
Majkëll*

Bëra siç më tha burri dhe i dërgova të dhënat që kërkoj edhe një herë. Prapë nuk e kuptoja pse të vetmit telefona prej të cilëve mund t'i dërgoja fakse ishin ata të ambasadës amerikane ose të qendrës S.A.M. Letrat e mia me postë të rregullt po vonoheshin shumë dhe unë nuk mund ta merrja në telefon sa herë të doja. Po nuk kishte rëndësi si i përgjigjesha. Dashuria e Majkut ishte plot për të dy:

30 prill 1995 (e dërguar me faks më 1 maj 1995)

Për: I kam hedhur dokumentat e tua për vizë tek INS

E dashur Mirela,

Më ka marrë malli të të ndjek me vrap nëpër shkallë. Të shtunën mbasdite, dola për të blerë një makinë të re me mamanë. Ajo ka ndër mend të blejë makinë të re së shpejti. Im vëlla do të shkojë me ne tek Dizni Land. Mendon se do të jetë qejf të të shikojë tek sodit për herë të parë gjithë xhirot mahnitëse dhe të reja tek Dizni Land.

Më kërkoj mamaja t'i programoj faksin e kompjuterit me numrin e faksit tënd. Kështu që mos u habit po more ndonjë faks prej saj. Kunata ime po të poston një kartolinë me sihariqin e lindjes së djalit të tyre.

Të shtunën në mëngjes, mbarova së shkruari të dhënat që më dërgove. Pastaj, bëra gjithë kopjet e kërkuara nga INS. Më në fund, e dërgova (formularin I-130) me postë parësore te qendra përpunuese e INS-së në Laguna Nigel të Kalifornisë. Do të pres nja dy ditë pastaj një shoku im, që punon për byronë e drejtësisë, do t'i telefonojë për të parë se deri ku kanë arritur. Edhe mamaja ime njeh dikë që punon në një pjesë tjetër të INS-së në Laguna Nigel. Do ta telefonojë për të parë se ç'mund të marrë vesh për procedurën e përpunimit.

Të kam përfshirë një kopje të rishkruar të të dhënave që më dërgove.

Do të punoj nga ora katër mbasdite deri në dymbëdhjetë të natës këtë javë që vjen, kështu që mund të përfundoj shumë punë. Të dua këtu dhe kjo ditë u afrua edhe më të shtunën. Më duhet të iki. Një shok do të dalë për të ngrënë mëngjesin me mua, që të më prezantojë me të fejuarën. Më duhet të punoj sonte, kështu që po ta dërgoj këtë faks tani. Të lutem më dërgo mbiemrin e vajzërisë të nënës tënde.

30 prill 1995 (faksuar më 4 maj 1995)

Mirela Klain
Fondacioni Soros

Re: Përqafime dhe puthje nga Kalifornia

E dashur Mirela,

Uroj të ishe këtu me mua, ndërsa të shkruaj këtë letër. Vetëm një turn mbasditeje më ka mbetur, pastaj kam tri ditë pushim. Kam notuar përditë, por sot më duhet të takohem me një llogaritar tatimesh. Po pata kohë më mbrapa, do të shkoj të notoj. Më ndihmon të kaloj kohën, ndërsa pres për të të parë prapë. Më ka kërkuar një shok të notoj me të për ca gara oqeanike këtë verë që vjen. Kam përshtypjen se do të ishte qejf. Tek palestra jonë, zakonisht kam korsinë time për të notuar. Nuk më shqetësojnë të tjerët që notojnë me mua në të njëjtën korsi. Jam notar shumë i fortë dhe, si përfundim, i anashkaloj shpesh. Njerëzit nuk i afrohen korsisë time. Korsitë e pishinës janë organizuar sipas shpejtësisë me më të ngadalshmit në të majtë dhe më të shpejtët në të djathtë. Ca e ca më bëjnë garë kur notoj. Unë notoj nga dyqind korsi njëherësh. Notarët e tjerë presin dhe më bëjnë garë për një korsi. Kjo më mban të ndershëm me përpyekjet e mia. Më duhet të filloj edhe vrapin, po nuk e kam filluar programin e stërvitjes.

Shpresoj të takohesh me Bobin sot për të marrë sendet që të dërgova në pakon e tij. Nuk kam marrë akoma letra me postë nga ty. More faks nga mamaja ime? Ajo më kërkoi të vija numrin tënd të faksit në kompjuterin e saj.

Do të doja të dija masat e tua trupore. Do të doja të të blija një fustan, po nuk jam i sigurt për masën e saktë. Do më dërgosh masat e tua të lutem - gjatësinë e këmbëve (nga vithet tek kyçi), mesin, bustin, gjatësinë e krahut, peshën, etj.

Gjithashtu, më duket se lashë një çantë të vogël në Vlorë. Është një çantë mesi që vishet me rrip rreth brezit. Po ta gjejë Bobi, të lutem thuaji të ta japë ty që të ma sjellësh. Ka një xhep të madh të fshehtë nga mbrapa. Kontrolllo për t'u siguruar që nuk ka gjë atje. Ky xhepi është për pistoletën. E përdor çantën këtu për të fshehur pistoletën kur punoj. Nuk është ndonjë gjë e madhe, mos u shqetëso shumë për të. Mund të blej tjetër.

Bëju të fala të gjithëve nga unë. Më kanë kërkuar dy veta t'i prezantoj me shqiptare. Ata mendojnë që kur u martova unë me shqiptare, duhet të jetë "gjëja më e mirë që nga shpikja e bukës së prerë feta-feta" – një thënie amerikane.

Tani kam diçka serioze për të diskutuar me ty. Së pari, mba mend që unë vendosa vetë të jem me ty për mbetjen e jetës sime dhe asnjë forcë e jashtme nuk do ta ndryshojë këtë. Kam një problem me një grua që jeton në bregun lindor, tre mijë milje larg. Ajo nuk do të heqë dorë nga unë. Flas me të, po nuk e marr kurrë në telefon. Po përpiqem të jem shok i mirë për të, por jam duke mbajtur largësinë emocionale ndërmjet nesh. Do të kisha dashur ta diskutoja këtë me ty me zë, që të mos ketë ndonjë keqkuptim ndërmjet nesh, por do të ishte shumë e shtrenjtë dhe lidhjet telefonike janë aq keq nganjëherë saqë mund të shkaktojnë ngatërresë.

Shokët më sugjerojnë që të prisja derisa të vije këtu për të ta shpjeguar këtë problem. Unë desha që ti ta dije çfarë po ndodhte, në rast se kjo tjetra përpiqet të futet midis nesh para se ta diskutoj me ty. Dua ta dish që unë nuk do ta lë të ndodhë një gjë e tillë.

Po iki të takohem me llogaritarin tani. Do t'ia lë kompjuterit të ta dërgojë këtë më vonë. Mirupafshim!

*Të Dua,
Majkëll*

U bë një festë e vërtetë në dhomën time natën që mora kutinë e Majkut. Më erdhën shoqet për të parë gjithë gjërat amerikane që më kishin ardhur. Disa nga gocat provuan maskën, ndërsa Enxhi na nxirrte në fotografi me kamerën njëpërdorimshe.

Majkëll kishte dërguar edhe një shishe me vitamina. Vetëm se gjynah që mua nuk më pëlqenin kokrrat e asnjë lloji. Tableta e fundit që kisha pirë ishte një antibiotik i hidhur që kur isha gjashtë vjeçe. E piva pas buke sipas recetës dhe e volla me gjithë ç'kisha ngrënë për darkë mbi çimenton e zezë të vatrës.

- Na nxirr një çikë breçkat e bukura, - tha Dori me padurim.

I nxora një nga një, duke shpresuar më kot të gjeja një palë që më bënin.

- Me sa duket këto i duken të përbrendshme joshëse! – thashë turivarur, e pazonja për të fshehur zhgënjimin me të mbathurat e pambukta me lule të vogla që mund t'i bënin sime mëje. Dhe pa dantellë!

- Duhet të kishe zgjedhur italianin, - tha Enxhi duke qeshur. – Nuk tha Nardi që të kishte sjellë dantella të bukura?

- Mashkull është edhe Nardi. I zihet njeriu besë me të përbrendshmet sot? – vazhdova lojën. – I ziu Mauricio! Më kishte sjellë edhe një orë dore të mirë. Më tha Nardi që ishte bërë meit kur i thanë që isha martuar.

- Sa dremiti ai andej, të përblau Majku këtej, - tha Dori.

- Vajta u skuqa kot, - thashë.

- Kur more kutinë sot?

- Po. Kolegu i vjetër i Majkut, shefi i tyre, sekretarja dhe ai që zëvendësoi Majkun ishin ulur të gjithë te kafeneja e hotel Tiranës. Bobi e kishte hapur kutinë për të nxjerrë disa nga sendet që i kishte dërguar Majku atij dhe njërit prej bashkëpunëtorëve në Vlorë, po i la gjithë të tjerat në kuti dhe ma dha. Unë e dija që kishte të mbathura brenda siç e dinte edhe shefi i Majkut, Fabricio, sepse nguli këmbë që t'i tregoja çfarë kisha. Do jem bërë paparune nga turpi.

- Talanët! – tha Dori.

- Në fakt, ishin të gjithë shumë të mirë. Shefi premtoi të më ndihmonte për çdo gjë që kisha nevojë dhe Bobi tha që do të vinte në Tiranë sa herë që të kisha nevojë për të. Pastaj, Fabricio u ngrit më këmbë, shtrëngoi kollaren, si përpara ndonjë fjalimi të rëndësishëm, dhe të gjithë bënë si ai. Pastaj ngriti dollinë për mua e Majkun.

- Ça qejfi! – qeshi Dori.

- Shpresoj mos të kenë lexuar edhe letrën që ishte brenda.

- Uuuu! Një letër tjetër dashurie?

- Edhe po edhe jo, - ia prita.

- Çfarë atëherë? – pyeti Dori kureshtare. – Dukesh e shqetësuar.

- Nuk jam e shqetësuar; vetëm se ndjehem paksa fajtores ose më vjen keq. Nuk e di.

- Përse? – pyeti Dori sërish dhe mori letrën që i dorëzova.

- Ja, lexoje. Është hera e dytë që shkruan për të njëjtën gjë – teknikisht e para, sepse kjo është shkruar para faksit të sotëm.

Dori filloi të lexonte letrën që kishte futur Majku në kuti:

E dashur Mirela:

Uroj të ishim bashkë tani. Megjithëse, në njëfarë mënyre, është më mirë që të kemi këtë ndarje tani për tani. Mua më duhet të përfundoj një marrëdhënie

me një grua që jeton tre mijë milje larg, në bregun lindor. Ajo ka dashur të martohet me mua për gjashtë vjet. Unë jam i lumtur me përzgjedhjen time për grua. Megjithatë, më vjen shumë keq për dhimbjen që i kam shkaktuar asaj tjetrës. Gjithashtu, ajo është shumë e zonja në manipulim njerëzish. Më bën fajtor që i kam shkatërruar gjithë jetën.

Nesër, do të bëj një intervistë me DEA. Kam shumë ndjenja të trazuara për këtë agjenci. Shpresoj të të pëlqejnë gjërat që të kam dërguar.

Me dashuri (Të dua)

Majkëll Klain

- E si qenka faji yt? Edhe po ta kishe pyetur nëse kishte të dashur, rrezik nuk do të të kishte treguar, - u përgjigj Dori. – “C’est la vie”, e dashur. Nganjëherë jemi të humbur e nganjëherë të gjetur. Meqë ra fjala te të humburit, fola me Latin para ca ditësh.

- Oh, shumë mirë! Si ishte?

- Mirë. Të bën të fala. E dije ti që vajti në Londër për një specializim pune menjëherë pas dasmës tënde? – pyeti Dori.

- Nuk e kisha idenë, - ia ktheva dhe tani e dija për çfarë do të më fliste Dori.

- Na ishte takuar një mbasdite me Skendin dhe ca shqiptarë të tjerë, me të cilët shoqërohet dhe vete në shkollë. Lati filloi të përshkruante dasmën tënde të mrekullueshme në kishë: nusen e bukur e të lumtur, dhëndrin amerikan të gjatë e simpatik, pastorin shakaxhi e me radhë.

- Ohoo! – thashë duke ndjerë afshin e nxehtë nga gusha në faqe.

- Eee! Gjeje kush tjetër ishte në dhomë duke dëgjuar tregimin e gëzueshëm të Latit.

- Teo! – thashë unë dhe menjëherë më erdhi në mend detaji i fundit i ëndrrës së dasmës sime, ku Teo qëndronte ndërmjet radhëve të fundit të stolave të kinemasë dhe më shoqëronte me sy siç i kalova pranë në dalje. *Uaa! I shërbej një Perëndie të hollësive që sapo mbylli lakun e fundit, i vuri pikën “i”-së dhe bishtin “t”-së së fundit!*

- Pas pak, Teo u ngrit i pezmatuar dhe doli nga dhoma si furtunë, - vazhdoi Dori.

- Me sa duket Lati nuk e kishte idenë kush ishte Teo, - thashë unë.

- I tha Skendi më pas, po ç’e do, ishte shumë vonë atëherë. Po na vete vonë edhe neve.

- Edhe unë kam qenë e lodhur. Kemi punuar me orë të zgjatura. Jo se ankohe, sidomos tani që paguhem një orë e gjysmë për çdo orë pune mbas orës katër. Punuam edhe për një majin. E mban mend që kam dhënë një të dhjetën që kur fillova punë nëntorin e kaluar? Perëndia është i mirë!

- Po. Jam e sigurt që është, - ma priti Dori me psherëtimë, - po nuk më duket se punon njësoj për të gjithë.

- Ashtu është. Bibla thotë që secilit i është dhënë një masë e caktuar besimi dhe më duket se mua më ka bekuar Perëndia me shumicë për këtë. Po si do ta dish tëndin derisa ta vësh në provë? Në fund të fundit, besimi vjen me dëgjim dhe dëgjimi me fjalën e Perëndisë. Unë e kuptoj duke e krahasuar me një muskul; sa më shumë ta ushtrosh, aq më tepër rritet. Sa më shumë ta lexoj Fjalën dhe ta ushtroj duke besuar dhe vepruar sipas saj, aq më tepër më rritet besimi. U mërzhita kur mora vesh që mund të duhen tre deri në gjashtë muaj që të më miratohet viza, por unë vendos të besoj Perëndinë kur më thotë: “Kush është nga ju mes gjithë popullit tuaj? Zoti Perëndia e tij do të jetë me të dhe le të niset!”

- Mirë e ke ti, po kush do të na “predikojë” neve, pastaj? – pyeti Dori duke më parë me dashuri me sytë e mëdhenj e të zinj.

- Profesionistët tek kisha ime. Do të vesh t’i provosh të mërkurën? – kapa momentin.

- E, de, e! – ma priti e mundur. – Vajti ora për gjumë.

- Urraaa! – brohorita dhe i përçolla shoqet në korridor.

- Para se të ikni, doja t’ju pyesja të dyjave nëse do të donit të vinit të punonit ca orë tek zyra ime. Jemi duke pranuar vlerësime nga ndërtues të ndryshëm për shkollat që po ndërton projekti dhe na duhen shumë duar për të futur të dhënat në evidencë. Më tha shefi të gjej sa më tepër shoqe që të mundem. Ju intereson?

- Sigurisht, por vetëm po të jetë mbasdite, pas pune.

- Sigurisht!

- T’i themi edhe Teutës? Është e lirë gjatë ditës, meqë punon natën tek gazeta. Duhet të jetë ngopur me gjumë deri nga ora katër, - shtoi Enxhi.

- Patjetër! Mirë, atëherë. Dilni nga zyra nesër, që t’ju prezantoj me shefat e mi.

- Mirë, - u përgjigj Dori dhe shtoi, - dhe që të shikojmë çfarë bukurish të tjera të ka faksuar Majku.

- Letrat janë hedhur. Tani presim.

Siç kisha parashikuar, Majkëll kishte dërguar një faks tjetër.

Për: Më mungon shumë

E dashur lozonjare!

Më ka marrë malli shumë. Kam qenë i zënë duke punuar shumë, duke shkuar herët në mëngjes për të përfunduar gjërat në zyrë. Kam notuar nga pesë mijë metra në ditë tri ditët e fundit. Sot, pasi të notoj, do të vrapoj disa milje. Dua të filloj edhe të ngre pesha, por më duhet të vij në formë më të mirë një herë. Ndoshta konkuroj përsëri në lojrat olimpike ndërkombëtare të policisë. Mbas datëlindjes sime të dyzetë, mund të më vijë sikur kam diçka për të provuar.

Mekanikët e zogjve tanë (helikopterëve dhe avionëve) më ngarkuan baterinë e motorit. Shpresoj të jetë akoma në gjendje pune. Motori ka nevojë të vihet në punë që të dalim xhiro këtë verë.

Kam disa shokë që do të telefonojnë INS-në sot. Doja të shihja nëse mund t'i shtyjmë një çikë për vizën tënde. E kam pushim të premtën, të shtunën dhe të dielën. Më duhet të vete për vizitë te disa shokë në zonën e Los Anxhelesit. Duan të gjithë të shikojnë fotografitë e tua.

Nesër, më duhet të shkoj te një llogaritar tatimesh. Kam filluar t'i zgjidh vetë që tani, por një shok po thoshte që ajo mund t'i bëjë më mirë se unë. Të shohim. Tatimet e vitit tjetër do të jenë shumë të koklavitura, prandaj dua të provoj një llogaritar tatimesh.

Kur punoj natën, e kam të vështirë të të dërgoj letra, sepse koha më e mirë për faks është kur jam në punë. Mund ta programoj kompjuterin të dërgojë faks në çdo orë. Po në qoftë se del ndonjë ngatërresë, kompjuteri rri në linjë me një dollar e pesëdhjetë qindarka minutin. Më duhet t'i rezistoj tundimit për të të telefonuar përnatë.

Më duhet të iki në punë tani, por do të ta dërgoj këtë shpejt e shpejt. Motori po punon; ka nevojë për një banjë dhe ajër në rrota. Ajrin të parin, për arsye sigurie. M'u desh kohë, por jam i kënaqur që munda ta zgjuaj motorin nga gjumi. Jemi një ditë më afër të qenit së bashku.

*Të Dua,
Majkëll*

Më në fund mora letrën që Majkëll më kishte dërguar nga Parisi po atë mbasdite. Po shkrihesha me përpjekjet e burrit tim për të shkruar fjalët shqipe siç i dëgjonte, para se të kishte ndonjë referencë nga letrat e mia.

13/4/1995

Gruas sime të dashur, Mirela. Të do-wa. Më mungon që tani. Vetëm ta shihje këtë dhomën e hotelit në Paris! Ky po, që është hotel; është mahnitës. Dhoma është shumë seksuale me statuja dhe piktura erotike. Banja ka një vaskë aq të madhe saqë dy vetë mund të bëjnë dashuri duke bërë banjë. Po të ishe këtu, nuk do gjeje derman për sa kohë të isha zgjuar.

Nuk pata probleme me doganën në Paris. Thjesht mora valixhet dhe dola jashtë. I hipa një autobusi të hotelit Hyatt, që është një zinxhir i famshëm hotelesh, dhe u regjistrova për në dhomë. Dhoma kushton tetëqindpesëdhjetë franga natën ose nën dyqind dollarë amerikanë. Dhe ky ishte çmim korporate.

Mezi po pres të filloj një jetë të re me ty. Të lutem, bëj durim! Ne do të jemi së bashku sërish. Sonte, do të ha në hotel, do të regjem në vaskë dhe do të luaj me unazën e artë në gisht. Të premtoj një jetë të mirë jashtë e brenda dhomës së gjumit. Kjo dhomë kundërmon seks dhe ti më mungon tmerrësisht. Edhe sot dhe pastaj do të jem në shtëpi dhe do të t'i shtyp letrat. Kjo do ta bëjë më të lehtë për t'i lexuar.

*Me dashuri,
Majkëll*

9 maj 1995

E dashur bukuroshe!

Pata probleme me kompjuterin, po tani është në rregull. Mund të të dërgoj fakse prapë. Mora një letër prej teje. Falemnderit! Përsa i përket kursit tënd të shoferave në Tiranë, ide e mirë. Unë do të të dërgoj në kurs makine edhe këtu në Amerikë. Do të të duhet sigurim për të ngarë makinë në Kaliforni. Sa më tepër përvojë të kesh, aq më i lirë do të jetë sigurimi. Unë

kam njëzetepesë vjet përvojë pa asnjë aksident dhe kushton një mijë dollarë në vit për sigurim. Për shkak të kohës tënde të shkurtër dhe mungesës së përvojës, do të kushtojë më tepër për të siguruar ty. Çdo kurs makine do të të ndihmojë të përftosh përvojë, po shkolla është më e lirë në Shqipëri. Mund të mësosh aftësi themelore të ngarjes së makinës në Tiranë. Këtu në Kaliforni, do të mund të mësosh aftësi të mira për shmangie përplasjesh. Meqë do të kesh patur pak përvojë ngarjeje të mëparshme, unë dua t' i japësh makinës me siguri dhe pa u vrrarë.

Kam një javë që nuk kam notuar. Do të shkoj të notoj pasi të të dërgoj këtë letër. Më mungon dhe pres me padurim për mbërritjen tënde. Nuk kam marrë vesh akoma se ku janë dokumentat e tua në INS. Kam një shok që njeh njerëz tek INS. I ka marrë në telefon për mua, por nuk kam folur me të. Iku për një mbledhje dhe nuk do të kthehet deri nga java tjetër.

Thuaju të gjithëve “përhëndetje” nga unë në Shqipëri. Më kanë pyetur dy burra për Mirën pasi panë fotografinë tuaj.

Sot, fluturoam për në Los Anxheles në xhet reinxhër (helikopter) për të ndihmuar Shërbimin Sekret. Do shkoj të bëj një filxhan kafeje para se të notoj. Do të kthehem pas një minute.

13 maj 1995

E dashur bukuroshe,

Është një çikë ngadalë puna sot, kështu që jam në gjendje të të shkruaj letër menjëherë pas dreke. Nëse bëj ndonjë gabim, është sepse dreka më bën të përgjumur. Do të ma dërgojë kompjuteri këtë letër një çikë më vonë. Tani që mund t' ia besoj kompjuterit dërgimin e mesazheve pa mbikqyrje, mund të filloj të notoj më tepër pas pune.

Sonte, do të ndërroj sqollën në banjë. Nuk ka asgjë të keqe, përveç njollave, po më tha motra që duhet të kem një “Xhon” (sqollë) të re për ty. Sqolla (alla frënga) është shpikur nga një burrë me emër Xhon Krapër. Kështu që, nganjëherë, ia thonë “Xhon” ose “Krapër”. Në marinë e quajnë “kokë”. Për mirësjellje, njerëzit pyesin “Ku është dhoma e grave ose e burrave?”. Njerëzit e sjellshëm gjithashtu mund të pyesin “Ku është banja?” edhe pse nuk kanë ndërmend të bëjnë banjë.

Okej, sapo mora një filxhan kafeje, kështu që do të të shkruaj një çikë më

mirë. Do t'i faksoj një letër edhe Xhon Shmidit sot për të parë nëse mund të të dërgoj një pako nëpërmjet tij tek ambasada. Numri i telefonit të Xhonit në Tiranë është 34 755.

Dje më erdhi kopja ime e kurseve të degës së Universitetit në Utah. Kjo është një listë klasash të drejtuara nga Universiteti për publikun e përgjithshëm dhe jo për studentët e rregullt. Kanë disa kurse të anglishtes si gjuhë e dytë, sepse është në të vërtetë një klasë për mësuesit e rinj. U duhen studentë që të praktikojnë mësimdhënien e anglishtes ndaj të huajve. Klasat janë nga dy orë në natë të mërkurave me njëzet dollarë. Ka edhe një klasë tjetër: rishikim i përgjithshëm i anglishtes për të huajt me dyqindetëdhjetepesë dollarë. Ti ia vlen çdo qindarkë. Këto klasat mbahen aq larg nga shtëpia jonë sa puna jote nga dhoma e konviktit. Mos më keqkupto; anglishtja jote është për së mbari, por kurset do të lëmonin aftësitë e tua në anglisht. Gjithashtu do të jesh në gjendje të bësh pyetje që nuk më shkojnë në mendje meqë për mua është gjuhë amtare. Telefonova edhe për të dhëna mbi IEP (program intensiv anglishteje). Është një program për studentë të huaj që janë duke u përgatitur për t'iu futur sistemit të lartë arsimor amerikan. Do të jem në gjendje t'ia heq tatimeve koston e shkollimit tënd. Nuk është se po përpiqem të të dërgoj në shkollë më vonë. Desha vetëm të sigurohesha që ti e zotëron mirë anglishten. Unë, sigurisht, mezi po pres të mësoj shqip. Dua të të them gjëra seksuale në publik pa e ditur njeri se çfarë të thashë. Ndërsa po shikoj katalogun e klasave për ty, gjeta një klasë në Aikido për vete. Gjithmonë kam dashur të mësoja Aikido. Jam marrë me Xhu-xhicu më parë.

Të Dua! Më duhet të shkoj të merrem me punë.

*Të Dua,
Majkëll*

14 maj 1995

E dashur lozonjare,

Sot është dita e nënës në Amerikë. Gëzuar ditën e nënës edhe nënës tënde! Të lutem më dërgo emrin dhe numrin e modelit të faksit tënd. Kur dërgoj fakset te zyra jote, nuk marr konfirmim prej faksit tënd. Po të marr vesh më tepër për faksin tënd, ndoshta mund të bëj diçka për këtë.

Ia kalova shumë mirë në Las Vegas. Pamë “Plant” dhe “Peixh”, dy muzikantë që kanë qenë në grupin “Led Zeplin”. Unë, sigurisht, hodha bast dy dollarët e zakonshëm. Hëngra darkë me Majk, një shok nga Dogana në Los Anxheles. Ai njuh një përgjegjës të INS-së në Uashington D.C. Majku do ta marrë në telefon në emrin tonë. Kemi tre njëerëz të ndryshëm me kontakte në INS duke u përpjekur të shtyjnë letrat e tua. Do të doja të kthehesha në Shqipëri, por nuk mendoj se do të ndodhë.

Të gjithë më paralajmërojnë për tronditjen kulturore që do të kalosh kur të vish këtu. Më kanë ofruar disa veta ftesa për darkë kur të mbërrish. Ti je shumë më e pëlqyeshme se sa unë.

Ditëlindja e tim vëllai ishte më dymbëdhjetë maj, ajo e së bijës javës tjetër dhe e imja do të jetë më njëzetedy. Do t’i festojmë më njëzeteshtatë maj. Më njëzetekatër maj, unë do t’i shkoj për vizitë motrës dhe shoqeve të saj në Palm Springs. Ajo po takohet me një mike të vjetër për darkë.

Mirela, je rehat duke pritur për të ardhur në Kaliforni? Unë dua të filloj aventurën më të madhe të jetës: martesën me një grua që e dua shumë.

*Të dua,
Majkëll Klain*

17 maj 1995

Gruas sime të dashur,

Të dua! Më mungojnë puthjet e tua. Mora një letër prej teje sot; atë me tri puthjet në faqen e pasme. Shoku im T.J. tha të të them “Njatjeta!”.

E mban mend që të thashë se më ishte prishur makina mbrëmë? Në fakt, e kisha fajin vetë. Makina nuk ishte e prishur. Unë kam një pajisje të veçantë tani që fik gjithë elektricitetin që i shkon makinës po nuk ndeze çelsin e fshehtë. Nuk e dija që kjo pajisje shkëpuste gjithë rrymën elektrike. Kujtoja se çelësi i fshehtë vetëm nuk lejonte ndezjen e makinës. Pasi kujtova se m’u prish makina, zbulova si ta operoja me saktësi. Gjithashtu, rregullova edhe problemin me kompaninë e telefonit. Kompania e telefonit bëri një gabim që rezultoi në shërbim më të paqëndrueshëm për thirrjet me Shqipërinë.

Në letrën tënde ti the se do të më mësoje gjithë fjalët e dashurisë në shqip. Këtu jam, duke pritur t’i mësoj të gjitha. Është mirë që nuk je këtu tani, se do të të merrja në krahë dhe nuk do të të lëshoja derisa të gdhijej.

Sot instalova një ftohës të veçantë për kutinë e marsheve. Kjo do të bëjë të mundur tërheqjen e një rimorkioje të vogël me makinë. Mund të marr me qera një rimorkio të vogël nga baza ushtarake. Do të jetë kollaj ta tërheqësh te një park kampimi. Më pas, e shkëput nga makina dhe e hap si një çadër të madhe mbi shasi. Mund të dalim më këmbë nëpër pyll dhe pastaj flemë në çadër kur bie nata.

Jam akoma duke telefonuar këdo që më shkon nëpër mend për të nxjerrë letrat e tua nga INS. Më duhet ta mbyll këtë letër tani që të fle një çikë. Mba mend që të dua dhe dua të ndjej trupin tënd pranë timit gjatë natës.

*Gjithë dashurinë time,
Majkëll*

KAPITULLI XXVI

ARDHJA E DYTË

Nga java e dytë e majit, më kishin lëvizur në një zyrë në katin e tretë të caktuar për futjen e të dhënave që po bëhej nga gjithë shoqet e mia. Bëra të njëjtën punë vetë gjatë ditës, derisa më vinin shoqet mbasdite vonë. Zyra ishte dy kate mbi kuzhinën. Po ia vija fajin e dremitjes së rastësishme dhe paaftësisë sime për të mbajtur sytë hapur orëve të gjata të punës derisa avujt e kuzhinës dy kate më poshtë filluan të më shqetësonin deri në atë pikë sa më përzihej. M'u kujtua kunata ime shtatzënë që e zinte gjumi ndenjtur në divan dhe gjithë mllefi që i solli nënës sime “dembelizmi” i saj, që tashmë duhej t'i shërbente një personi më tepër, në vend që të kishte një krah më tepër për ta ndihmuar. “Hah”, - qesha nën zë. “Mos jam gjë shtatzënë? Do të më thuash, Zot?”, - u luta dhe hapa Biblën e vogël.

Ra tek Isaia 44:1: “Tani dëgjo, o Jakob, shërbëtori im, o Izrael, që unë kam zgjedhur: Kështu thotë Zoti që të ka bërë dhe të ka formuar që në bark të nënës, ai që të ndihmon: Mos ki frikë, o Jakob, shërbëtori im, o Jeshurun që unë kam zgjedhur! Sepse unë do të derdh ujë mbi atë që ka etje dhe rreke mbi tokën e thatë; do të derdh frymën time mbi pasardhësit e tu dhe bekimin tim mbi trashëgimtarët e tu. Ata do të rriten në mes të barit, si shelgje gjatë rrjedhave ujore. Njëri do të thotë: “Unë jam i Zotit”; tjetri do të quhet me emrin Jakob dhe një tjetër do të shkruajë në dorën e tij: “I Zotit” dhe do ta ketë për nder të mbajë emrin e Izraelit”.

“Lavdi emrit tënd të shenjtë, o Zot! U bëftë vullneti yt!” – mendova, edhe pse jo shumë e sigurt se si ndjehesha që kisha rënë shtatzënë menjëherë. *Por, kur Perëndia thotë: “Mos ki frikë!”*, atëherë ashtu do të bëj edhe unë.

Ja lexova vargjet përsëri Mirës sapo e takova në mbrëmje. Ajo u ngazëllye për mua dhe më nxiti të takohesha me një mjek menjëherë.

- Për çfarë?! – u vrenjta. – Jam shtatzënë, nuk jam e sëmurë. Tani Omari e Fabiola me shokë të mos më bien në qafë që nuk po tregohem më “e begenisur”.

- Duhet të bësh ca analiza për t’u siguruar që je shtatzënë një herë.

- Jam e sigurt! – kundërshtova si fëmija që ka frikë nga gjilpërat. – Ma tha Perëndia këtë dhe ca më tepër. Jo vetëm që jam shtatzënë, por do të kem tre djem dhe Perëndia do t’i bekojë.

- Unë prapë them të shkosh të vizitohesh tek doktori. Po deshe, vij edhe unë me ty.

- Falemnderit! Obobo! Qysh do t’ia jap sihariqin Majkut? Po sikur të tromakset?

- Do të ishte një dhuratë e bukur për ditëlindje! – tha Mira buzagaz. – Mund ta kesh marrë vesh me siguri deri atëherë.

- Ide e shkëlqyer. Do të ishte edhe më mirë sikur të isha atje për ditëlindjen e tij. Mos! Po sikur të jem trashur deri atëherë?

- Për dy javë?! Nuk shëndoshesh aq shpejt. Megjithëse duhet të heqësh dorë nga xhinset e ngushta tani, sugjeroi Mira, por mua më rrinte mendja tek ideja e një vizite të shpejtë e të shkurtër për në Shtetet e Bashkuara. Sa më shumë që mendoja për të, aq më shumë gëzoja. Mendova se do të më linte nga mëngjesi, si shumica e ideve “të mëdha” me të cilat më zinte gjumi, por kur mbërrita në punë, mora edhe guximin të shkoja ta diskutoja mundësinë me shefin e madh.

- Erdha të të pyes nëse ekziston mundësia që unë të marrë ndonjë vizë turistike për në Shtetet e Bashkuara për nja dy javë për ditëlindjen e tim shoqi. Doja të takoja familjen e Majkut para se të... ëëë... shëndoshesha a ku di unë, - i thashë dhe ndjeva gushën në nxehje e sipër.

- Pse mendon se mund të shëndoshesh? – pyeti ai duke bërë ç’ishte e mundur që të mbante të qeshurën.

- Ti e di, mo. Me aq mirë sa hamë ne këtu, edhe bën vaki, - ia prita, tashmë duke buzëqeshur edhe vetë.

- Të kuptoj, - m’u përgjigj shefi. – Normalisht, unë do ta pyesja shefin tim për të parë se ç’mund të bëhej, por ai ka kohë që është zhdukur në Çeçeni dhe komanda jonë është në gjendje zie. Ata po shpresojnë më të mirën, por mendojnë më të keqen.

- Më vjen shumë keq që e dëgjoj këtë, - iu përgjigja. – Falemnderit, gjithsesi!

Herën tjetër që u ndesha me shefin tim, ishim në kuzhinë për drekë. Ai më pyeti: “Ke marrë vesh ndonjë gjë për gjendjen e vizës së përhershme?”.

- Ka lloj-lloj skenaresh; nga tre deri në gjashtë muaj, - thashë paksa e zhgënjyer.

- Koha do të fluturojë, - tha shefi im i mirë dhe kjo më çeli në fytyrë.

Kur ndava lajmin e shtatzënisë sime me shoqet e mia, Dorin dhe motrën e saj, Enxhi u përgjigj “Kam parë Majkun në ëndërr”.

- Si e pe? – e pyeta.

- Sikur po vinte duke fluturuar në një makinë të shkëlqyeshme, të kuqe, me krahë. Nga ngjyra e kuqe e makinës fluturuese, duket se ka për të ardhur shpejt.

“Po kjo nuk ka kuptim!” – po vrisja mendjen. – Jam unë ajo që duhet të ikë. Ai nuk ka pse vjen prapë për të më marrë, - thashë duke kujtuar çka kisha lexuar në fjalën e Perëndisë së fundi: “Ikni, ikni, dilni që andej! Mos prekni asgjë të papastër! Dilni nga ambienti i saj, pastrohuni, ju që mbartni vazot e Zotit. Por nuk do të niseni me nxitim dhe nuk do të shkoni me turr, sepse Zoti do të ecë para jush, Perëndia e Izraelit do të jetë preparoja juaj”.

- Nuk e di. Unë kështu e pashë, kështu po ta them, - u përgjigj Enxhi me sytë e ndritshëm.

Siç më kishte thënë shefi, koha po fluturonte dhe mëngjesi i ditëlindjes së Majkut më gjeti të acaruar që nuk po mundesha as t’i faksoja një urim të thjeshtë për ditëlindje. U përpoqa disa herë në telefon dhe faks, por nuk munda të futesha në linjë. Kisha një parandjenjë të mirë që do të më merrte vetë në telefon që të më jepte mundësinë për ta uruar për ditëlindje. Nga ana tjetër, kisha shumë emocion kur përfytyroja reagimin e tij ndaj lajmit të shtatzënisë sime.

Isha ende duke bërë luftë me faksin në dhomën e pritjes kur ra zilja dhe sekretarja më dha telefonin. Vendosa marrësin në vesh, tek pashë disa nga gratë e inxhinierisë duke u mbledhur shpejt e shpejt në gjysmë rrethi jashtë derës së hapur të dhomës së pritjes. Ato dëgjuan pa frymë përshëndetjen time fillestare. Nuk ishte e drejtë as për ato as për Majkëll që po paguante qimet e kokës, që unë t’i bia nga Kina. Mora frymë thellë dhe thashë ato që kisha bërë ndër mend për dy javë.

- Gëzuar ditëlindjen! Kam një dhuratë për ty.

- Vërtet? – u përgjigj Majkëll.

- Do të bëhesh baba! – thashë duke u buzëqeshur shoqeve të zyrës që po prisnin me ankth.

- Je shtatzënë?

- Po. Kam patur të përziera dhe kam qenë e përgjumur për ca kohë. Pastaj

Perëndia ma konfirmoi! – iu përgjigja duke mbledhur sytë. – Shpresoj ta mirëpresësh këtë, se Perëndia më tha që do kemi tre djem, si përfundim. Lexoje vetë, të lutem! Ishte tek Isaia 44:1-5.

- Sigurisht! – u përgjigj Majkëll dhe pyeti, - Ke qenë te doktori?

- Jo, po ashtu ngelën duke më thënë të gjithë.

- Do më bësh një nder? – pyeti Majkëll.

- Hë.

- Do t'i pish vitaminat tani, të lutem? Është shumë e rëndësishme për shëndetin tënd dhe të bebit.

- Do përpiqem, - premtova, duke përmbajtur gëzimin. Jo vetëm që burri im e mirëpriti lajmin e bebit, por e konsideronte “nder” që ne të ishim të shëndetshëm!

- Hë, çfarë tha? – pyeti Arjana, njëra nga inxhinieret e ndërtimit, pasi mbylla telefonin.

- Tha që t'i bëj nder e të pi vitaminat që më ka dërguar, - ia ktheva duke parë bashkëpunëtoret e mia të merrnin frymë lirisht dhe të gëzoheshin me mua.

Kur shkova në punë mëngjesin e së nesërme, gjeta një faks tjetër sigurues nga Majkëll.

22 maj 1995

Zj. Mirela Klain

E dashur lozonjare,

Të dua çdo ditë e më tepër. Çfarë dhurate më dhe për ditëlindje! Na duhet ta dimë me siguri nëse je shtatzënë. Prej trazirave të mëngjesit, unë besoj që je. Mos u shqetëso nëse doja fëmijë apo jo. Institucioni i martesës për ata është krijuar dhe unë e dua një fëmijë. E di që çdo fëmijë që të lind ty do të jetë i bukur dhe inteligjent si e ëma. Megjithatë, na duhet ta dijmë me siguri nëse je shtatzënë. Të lutem, shko tek një doktor! Unë dua që të pish vitaminat pas buke. Është e rëndësishme për shëndetin tënd të futësh vitamina në trup. Foshnja i merr vitaminat që i nevojiten nga nëna. Shëndeti yt mund të heqë nga mangësia e vitaminave për shkak të kësaj. Gjithashtu, të lutem, mos pi alkool gjatë shtatzënisë! Kërkimet shkencore amerikane tregojnë se pirja e alkoolit gjatë shtatzënisë rezulton në bebe më të vogël.

Unë do të përpigësja të të sillja si studente, por meqë je shtatzënë, mund të jetë më mirë të presësh për vizën I-130. Unë të dua këtu sa më shpejt që të jetë e mundur, por nuk dua të udhëtosh për në Shqipëri menjëherë pas lindjes. Gjithashtu, na duhet të mendojmë për të kursyer paratë. Do të dua të blej një shtëpi kur të jetë rritur bebi. Më duhet të shkoj në punë tani.

*Të dua,
Majkëll*

Dhe një tjetër dy ditë më pas.

24 maj 1995

*Zj. Mirela Klain
Fondacioni Soros*

Përshëndetje, dashuri!

U vizitove te doktori? Të gjithë e morën vesh në ditëlindje që do të jem baba. Një shok te INS më tha që nuk do të ishte ide e mirë të bëj kërkesë për vizë studentore, ndërsa presim për vizë I-130. Kështu që duhet të presim.

Nëna ime është infermiere me licensë dhe nusja e një shoku është infermiere e specializuar në kujdesin paralindës. Kujdesi paralindës është kujdesi për bebin në bark të nënës. Të gjitha më kanë thënë me alarm sa e rëndësishme është që të pish vitaminat. Më kanë thënë që duhet t'i pish në mbrëmje pas buke.

Të lutem, pranoje këshillën për mua. Të dua dhe dua të jesh e shëndetshme. Të lutem, më dërgo dokument nga një doktor që je shtatzënë. Po të kem deklaratë në anglisht nga doktori që je shtatzënë, mund t'i mbush mendjen përgjegjësit tim të më dërgojë në Shqipëri për tre muaj të tjerë. Mund të ma dërgosh me postë.

Familja ime do të na bëjë një dasmë të kombinuar me festën për mirëseardhjen e bebit.

Të kam postuar fletëkërkesën për një numër sigurimesh shoqërore për ty. Do të ishte edhe më mirë po të merrje një fletëkërkesë nga konsullata dhe ta plotësoje menjëherë. Dua që të të jepet një librezë sigurimesh shoqërore sa më shpejt. Më duhet numri yt që të të fus në sigurimin tim shëndetësor.

Gjithashtu, dua që të të njohin mirë ata të konsullatës, që kur të marrin letrat e tua nga INS, të ta japin vizën shpejt. Dua të jesh këtu që të të çoj te palestra ime për të notuar ditë për ditë. Gjithmonë e kam dashur nënën e fëmijës tim të jetë një dardhë lundruese në ujë. Është ushtrim shumë i mirë për disa gra shtatzëna dhe është një aktivitet i përshtatshëm për çdo fëmijë timin. Uji është elementi im natyral.

Do të sjell aparatin fotografik tek mbledhja e familjes këtë të shtunë. Do të të dërgoj fotografi të secilit dhe të shtëpisë, makinës, motorit tonë, etj. Të duhen pulla poste dhe zarfe të tjerë? Bëju të fala nga unë të gjithëve: Mirës, Fabricios, Sonjës, etj.

Po më rriten flokët. Po rris edhe mjekër e mustaqe, por ndoshta do t'i rruaj. Nuk kam mundur kurrë të rris mjekër të plotë, po tani që jam dyzet vjeç, mbase jam rritur.

Më shqetëson mendimi që mund të kesh shumë tension kur të vish në Kaliforni; shtatzënë, vend i ri, larg shtëpisë, shtëpi e re dhe nuse e re. A do të jesh e lumtur me mua vallë?

Nëse letrat e vizës tënde shkojnë siç më thonë të gjithë, mund të më vish nga tetori. Kjo do të thotë që do të jesh gjashtë muaj shtatzënë. Në qoftë se letrat zgjasin më tepër se kaq, linjat ajrore nuk do të të lejojnë të fluturosh derisa të kesh lindur. Gratë shtatzëna nuk duhet të fluturojnë gjatë muajve të fundit të shtatzënisë. Trysnia e ajrit gjatë muajve të fundit të shtatzënisë mund të shkaktojë lindjen e hershme të bebit. Më duhet të di nëse je shtatzënë, që të planifikojmë çfarë duhet bërë. Kujdesu për veten dhe bebin tonë!

*Të dua shumë,
Majkëll Klain*

Marrja e letrave prej Majkut një ditë po një ditë jo, më bënte të lumtur pavarësisht nga lajmet e trishtuara të pritjes sime të zgjatur që tashmë dukej të kishte ndryshuar në gjashtë muaj. Por unë do të doja më mirë të merresha me tensionin që shqetësonte atë dhe të isha pranë dhëndrit tim, në shtëpinë time të re, në vendin tim të ri. Vendosa të kundërshtoja çdo lajm pritjeje të zgjatur dhe të kërkoja ndihmën e luftëtarëve lutës të kishës së Fabiolës. Gjithë rrugës për në kishë, po mendoja për historinë që më kishte shtënë në shpirt Fryma e Shenjtë, atë të Davidit të vogël që mundi gjigantin Goliath vetëm me një zall të vogël dhe një palë llastiqe. Derisa mbërrita në kishë,

më kapi gëzimi i fitores që mund të shihja me sytë e besimit. *Nëse Perëndia është me mua, kush mund të jetë kundër meje?*

Mira u gëzua kur i thashë që edhe Majkëll kishte sugjeruar me të madhe që të vizitohesha tek një doktor. U dorëzova dhe mora në telefon Xhonin që të më çonte tek shoqja e tij tek klinika amerikane dy ditë më pas. Pas analizës, u ula në sallën e pritjes duke pritur konfirmimin e asaj çka dija në shpirt. Dr. Suzana doli dhe më uroi personalisht.

- Këto janë disa vitamina shtatzënie që të të mbajnë për ca kohë. Kthehu prapë për të tjera, kur t'i mbarosh, - shtoi.

- Më ka dërguar burri disa vitamina të rregullta. Jam e sigurt që do më dalin për një kohë të gjatë. Nuk më pëlqejnë ilaçet fare. Më provokojnë të vjella.

- Këto që po të jap unë janë kastile për gratë shtatzëna. Të ndihmojnë edhe ty edhe bebin.

- Nuk më shqetëson kjo. Perëndia na mban të shëndetshëm edhe mua edhe bebin.

- Je besimtare? – pyeti Dr. Suzana duke buzëqeshur.

- Po, - iu pëgjigja. – E sapolindur, para disa muajsh.

- E ke fjalën e rilindur? – qeshi Dr. Suzana.

- Po, tamam.

- Edhe unë jam e krishterë, - vazhdoi Dr. Suzana. – Ne lutemi për çdo pacient që vjen përmes dyerve tona. Por unë besoj edhe që Perëndia i jep secilit prej njerëzve të tij dhunti për t'i shërbyer njëri-tjetrit në trupin e Krishtit. Unë besoj që Perëndia më dha dëshirën dhe talentin për t'u bërë doktoreshë që të ndihmoj ty dhe besimtarët e tjerë në nevojë.

Doktoreshë Suzana të bindte me butësi e dashuri. Unë e dija që Perëndia përdorte pastorët dhe besimtarët e tjerë rreth meje për t'u lutur apo profetizuar për ndodhitë e jetës sime, por nuk kisha menduar kurrë për njerëz që ndihmojnë të tjerët në mënyrë më praktike.

- Falemnderit! – ia ktheva. – Të kuptoj shumë mirë.

Tani që e dija se Dr. Suzana do ta kuptonte dhe nuk do të tallej me përvojën e bisedave të mia me Perëndinë, vendosa t'i hapësja ca më tepër.

- Doktoreshë, unë e dija që isha shtatzënë para se të më bëje analizën. U luta dhe pyeta Perëndinë sapo ndjeva ndryshimet në trup dhe ai m'u përgjigj me ca premtime të mrekullueshme për fëmijët e mi të ardhshëm. Do të kem tre djem! – i thashë dhe nxora Biblën për t'i përkthyer nga Isaia 44:1-5. – E vetmja arsye që erdha për të bërë analizën ishte që të merrja një deklaratë me

shkrim prej një doktori amerikan. Im shoq, Majkëll, do t'ia tregojë punësuesit të tij dhe do t'i kërkojë një emërim tjetër këtu. Në atë mënyrë, mund të jemi bashkë këtu për disa prej muajve të shtatzënisë, ndërsa presim për miratimin e vizës sime të përhershme.

- Pse nuk të mori me vete pas emërimit të tij të parë?

- Sepse nuk jemi të martuar sipas ligjit. U martuam vetëm tek kisha ime. Ju ndoshta e dini që ajo nuk njihet nga shteti këtu. U përpoqëm ta bënim sipas ligjit një herë, po Majkëll nuk kishte çertifikatë lindjeje me vete. Qenkësh e domosdoshme për t'u martuar. Por në mendjen time biblike, ai duhej të shkonte përpara që të përgatiste vendin për nusen e tij – të ndërronte sqollën e vjetër me një të re e të tjera si këto.

- Aha, - u përgjigj doktoresha duke qeshur. – Kam një ide. Më lër të flas një herë me konsullen te ambasada për një vizë turistike për ty. Hajde prapë të hënën. Sido që të jetë, do të kem një përgjigje për ty deri atëherë.

- Falemnderit! – ia prita dhe dola nga klinika me një shpresë të rinuar që do ta shihja burrin së shpejti.

Të hënën në mëngjes, më telefonoi Xhoni në zyrë.

– Kam ca lajme shumë të mira për ty! – më tha.

- Çfarë? – pyeta me padurim.

- Dr. Suzana foli me konsullen dhe ajo i tha që nëse Majkëll kthehet me një çertifikatë lindjeje dhe martohet me ty sipas ligjit, atëherë mund të të marrë për fare.

- Për fare si përgjithmonë?

- Për sa kohë të duash ti, - u përgjigj Xhoni.

- Falemnderit! Edhe falemnderit që më çove te klinika!

- Je e mirëpritur! – ma priti Xhoni.

- Do t'i them Majkut sapo të më telefonojë. Falemnderit!

- Je e mirëpritur! – përsëriti Xhoni që dallohej nga zëri sa i kënaqur ishte që po më jepte lajmin e mirë.

Kur Majkëll më mori prapë në telefon në fund të majit, unë ia shpjegova zhvillimin e gëzueshëm të javës së shkuar.

- Sa kohë mendon se do të më duhet për të kryer gjithçka? – pyeti Majkëll.

- Nuk e di. Nja dy ditë, ndoshta. Perëndia është i madh! Çdo gjë është e mundur me të, - ia prita me ngazëllim.

- Kam përshtypjen se do të më duhet një çikë më tepër se dy ditë. Ndoshta është më mirë ta telefonoj Xhonin vetë që të sigurohem. Do të më duhet një javë të marr veten nga rruga, një herë.

- Aq më mirë. Mbase mund të rrish një çikë më gjatë edhe me prindërit e mi këtë radhë. Babai im u thotë të gjithë kushërinjve që e pyesin për mua që jam e fejuar. Nuk e quajti dasmë atë tonën.

- Ndoshta prandaj më duhet të kthehem dhe të martohem me ty sërish.

- Më vjen keq që do të të duhet të paguash për një udhëtim tjetër për në Shqipëri.

- S'ka gjë, vogëlushja ime, - u përgjigj Majkëll. – Ti ia vlen. Jam i gëzuar që do të të kem në shtëpi së shpejti. Nuk më besohet që mund të ndodhë kaq shpejt!

- As mua. Lavdi Perëndisë! Doli e vërtetë ëndrra e Enxhit për kthimin tënd.

- Më ka parë Enxhi në ëndërr?

- Ëhë. Kam shoqe fantastike. Të pa duke zbritur nga qielli me shpejtësi si Supermen. Po fluturoje në një makinë të kuqe me krahë.

- Më pëlqejnë shoqet e tua, - u përgjigj Majku duke qeshur. – Bëju të fala të gjithëve nga unë.

- U bëj unë, - premtova. – Edhe ato të kanë qejf. Sa herë bie fjala për ty, të quajnë “yll” ose “flori”.

- Po telefonoj Xhonin që të sqaroj ca nga këto kushtet para se të blej biletën. Të dua!

- Edhe unë!

Brenda të martës tjetër, faksi i përjavshëm i Majkut po më priste në zyrë.

28 maj 1995

Zj. Mirela Klain
Fondacioni Soros

Gruas sime të dashur,

Nuk më zë gjumi, kështu që po të shkruaj një letër. Mbrëmja e ditëlindjes sot mbasdite ishte për katër veta, me gjithë mua. Unë e mamaja u përpoqëm të të dërgonim një faks nga shtëpia e saj. Nuk e di nëse të erdhi, kështu që po përsëris veten.

Të martën, do të shkoj tek INS për të gjetur dhe marrë pasaportën time dhe dokumentat. Pastaj do të marr një vizë nga konsullata shqiptare (shpresoj).

Pastaj do vij të të marr. Të gjithë duan të të takojnë. Këtu më poshtë është një letër nga një shok i imi, Xhei. Xhei dhe Majk më erdhën për vizitë dhe më këshilluan se si të jem një bashkëshort i mirë, meqë kam qenë beqar kaq gjatë. Ata mendojnë se më duhet ndihmë për këtë çështje. Nuk mund ta besosh sa njerëz janë të gëzuar që gjeta dikë aq të veçantë sa ta marr për grua.

Më uro fat nesër. Po shkoj tek INS. Ne u përpoqëm ta dërgonim këtë faks dje por një kartë e re që futa në kompjuter nuk funksionoi si duhej. M'u deshën disa orë që ta bëja të punonte si duhej.

E dashur Mirela,

E takova Majk për herë të parë kur fillova të punoja për Shërbimin Doganor në Los Anxheles në 1987. Unë e Majku u bëmë miq të ngushtë shumë shpejt – ndoshta ngaqë ai ka shumë humor, një sy optimist ndaj jetës dhe është shumë i këndshëm.

Unë e Majk marrim pjesë në konkurime sportive ndërkombëtare. Ai është kampion noti. Unë zakonisht konkuroj vetëm në turnetë e volejbollit. Një herë, mbërrita me një frymë tek palestra për ndeshjen e parë të skuadrës sonë. Disa prej lojtarëve tanë nuk erdhën! Nuk kisha nga t'ia mbaja dhe do më duhej ta humbisja atë ndeshje, por shoku im i dhomës rregulloi orarin e tij që të luante për ne. Shoku i dhomës dhe miku i veçantë ishte Majku.

Nuk gjej dot fjalët për të të thënë sa të ngazëllyer jemi unë dhe gruaja ime, Lorilei, që do të të takojmë. Edhe pse kemi qenë të martuar për disa vjet, u bëmë prindër për herë të parë para tre vjetësh. Kishim ngarkuar plaçkat për t'u shpërngulur për në Uashington D.C. Ishte shpërngulja jonë e parë nga bregu perëndimor dhe ishim të pasigurt se ç'mund të na sillte e ardhmja. Shumicën e gjërave tona më të vlefshme si edhe qentë tanë, Banditin dhe Sendin, i kishim në mikrobuz gjatë udhëtimit tonë katërmijëedyqind kilometërsh. Nja dy mijë kilometra pas nisjes, morëm vesh që do të bëheshim prindër për herë të parë. Pasi na kaloi dehja fillestare, zbuluam se, duke u bërë prindër për herë të parë ndaj birit tonë Ien, na kishte ndodhur gjëja më e bukur në jetë.

Ne urojmë gjithë të mirat për ju të dy dhe jemi të gëzuar që dëgjojmë se ndoshta do të jesh këtu shumë shpejt. Rrugë të mbarë!

Xhei

Faksi i dy ditëve më pas më bëri edhe më për të qeshur tek lexova letrën tjetër që burri im e kishte shkruar në format gazete me tre kolona.

Lajme nga Kalifornia

Edicioni i Riversajdit

Vol. një, No. një

31 maj 1995

BURRI GJEN DASHURI NË VEND TË HUAJ, SHQIPËRI ***Të ngathtët e shërbimit federal të mërgimit dhe nënshtetëzimit:***

Pas zbulimit që shërbimi i mërgimit dhe nënshtetëzimit përpunon vizat me shpejtësinë e udhëtimit të një akullnaje, një Kalifornian shkoi te agjencia e mërgimit për të anuluar kërkesën dhe për të kërkuar t'i kthehen dokumentat origjinalë. Duket se e vetmja mënyrë që mund të sillte gruan e tij shtatzënë në Riversajd në kohë, ishte duke udhëtuar për në kryeqytetin e Shqipërisë, Tirana. Atij iu tha që nuk mund t'i ktheheshin dokumentat për disa javë. Pas një debati të nxehtë me një përgjegjës tek INS, iu dha një numër faksi ku do të dërgonte kërkesën e tij për kthim të përshtypshëm të dokumentave. Ky burrë planifikon të shkojë tek përfaqësuesi i tij në Kongres ndonjë ditë nga java tjetër, nëse kërkesa e tij nuk plotësohet në kohë.

Zotërinjtë nga Plazhi Hermosa i dërgojnë të fala Mirelës

Dy burra nga Plazhi Hermosa shkojnë për vizitë tek bashkëshorti i porsamartuar i Mirelës për t'i shpjeguar jetën e martuar beqarit të hutuar. Njëri prej burrave, Xhei, i dërgoi Mirelës një shënim dhe e ftoi për vizitë në familjen e tij në qytetin e pushimeve të Plazhit të Herмосës.

Shqipëria rrëzon kushtin e vizës për shtetasit amerikanë

Shqipëria rrëzon kushtin e vizës për mbartësit e pasaportës amerikane për udhëtime që zgjasin më pak se tre muaj. Personi që po planifikon udhëtimin për në Shqipëri është i lehtësuar të marrë vesh që viza nuk është më e domosdoshme për vizita të shkurtra në Shqipëri.

Majku do Mirelën

E dashur, të dua! Të Dua!

2 qershor 1995

*Zj. Mirela Klain
Fondacioni Soros*

RE: Të dua, të dua shumë, të dua, të dua shumë

E dashura gruaja ime,

Më ka marrë malli shumë. Jam përpjekur të të dërgoj një faks për disa ditë. Me sa duket nuk keni patur drita kur jam përpjekur. Sapo të kam nisur një letër dhe do të dërgoj këtë më pas. Mirela, më duhet të marr dokumentat e mia nga INS, që po lëviz shumë ngadalë. Të hënën, do të shkoj te një përfaqësues i Kongresit për ndihmë. Përfaqësuesi në Kongres është një politikan federal që është i përgjegjshëm ndaj zgjedhësve në zonën ku banojmë. Ai mund të jetë në gjendje të na ndihmojë. Çështja është se INS ka pasaportën time, çertifikatën tonë të martësës, fotografitë dhe çertifikatën tënde të lindjes. Unë po dërgoj kërkesën për një pasaportë të dytë. Mund t'i zëvendësojmë me lehtësi fotografitë dhe dokumentat nga Shqipëria. Pasi të marr pasaportën zëvendësuese, do të vij.

Megjithatë, më duhet të udhëtoj në San Francisko për çështje pune nga nëntë deri më pesëmbëdhjetë qershor. Shpresoj të kem marrë dokumentat derisa të kthehem. Data më e hershme që mund të kthehem në Shqipëri është menjëherë pas pesëmbëdhjetë qershorit. Po të kisha dokumentat tani, do të nisesha që nesër, por nuk mund të refuzoj punën kur edhe duke bërë këtë nuk më aftëson të vij tek ty. Shefi im do të më fusë emrin për një shpërblim që do të thotë para për ne. Ai më tha që t'i kërkoj Fabricios një letër rekomandimi për punën që bëra në Shqipëri. E dije ti që kisha kërkuar të kthehesha me punë në Shqipëri? Fabricio ma refuzoi ofertën. Mendoj se e ka bërë meqë e ka ditur që je shtatzënë dhe nuk më kishe njoftuar ende. Të dua këtu ku janë shërbimet mjekësore në dispozicion. A mund t'i kërkoj Fabricios të më shkruajë një letër rekomandimi, të lutem? Fabricio mund ta faksojë tek i njëjti numër që më dërgove faksin për ditëlindje. Do ta merrja në telefon vetë,

por jam duke shpenzuar afërsisht pesëqind dollarë në muaj duke të dërguar letrat dhe duke folur në telefon me ty. Do të më kushtonte gjashtëdhjetë a shtatëdhjetë dollarë po të flisja me të. Ti, e dashura ime, ia vlen çdo qindarkë që shpenzoj duke të folur apo shkruar.

E mora letrën e datës pesëmbëdhjetë maj. I shkreti Çarli! I ishte dashur të shkarraviste adresën tënde të kthimit dhe të vinte një pullë me adresën e tij në letër. Të lutem, mos e vër adresën tënde të kthimit në letër për të! Nuk të kam dërguar pako të tjera, sepse mendova që do të jem atje para se të mbërrijë pakua. Do të të dërgoj një pako tani që e di që do të më duhen disa javë për të ardhur.

Nuk kam akoma Bibël, por kam porositur dhe paguar për një program kompjuteri për studim të plotë biblik që përfshin pesë lloje të ndryshme biblash dhe udhëzues orientimi në një disk kompjuteri (CD). Ka lista emrash, pjesësh dhe gjërash të tjera që unë nuk i di, por që mund të bësh kërkim fjalësh dhe të kërkosh një temë në secilën prej biblave të ndryshme ose të gjitha biblat në të njëjtën kohë. Ose mund të krahasosh vetëm me shtypjen e disa shkronjave ndryshimet ndërmjet varianteve të ndryshme të Biblës. Kam një shok që është shërbëtor i Perëndisë dhe ai ma rekomandoi programin. Nuk kam shkuar në kishë dhe nuk kam për të shkuar derisa të shkoj me ty. Por e falenderoj Perëndinë gjithë kohën që të solli ty tek unë.

*Me dashuri,
Majkëll Klain*

3 qershor 1995

*Zj. Mirela Klain
Fondacioni Soros*

Re: Po vij të të marr.

E dashur Mirela,

INS m'i ka kthyer letrat. Është e dielë mbrëma tani, kështu që nuk mund t'i telefonoj agjencitë e udhëtimit për një biletë të mirë. Mora në telefon disa linja ajrore dhe bileta pa pritje ishte e shtrenjtë. Do të më duhet të pres të

paktën shtatë ditë për të bërë regjistrimet me linjën ajrore, përndryshe fluturimi do të kushtojë disa mijëra dollarë. Sikur të gjeja një biletë të lirë e të shpejtë, do të vija të martën. Megjithatë, na duhet t'i kursejmë dy mijë dollarët që do të na kushtonte një apo dy javë. Na duhen paratë për bebin. Jam akoma duke shkuar të punoj në San Francisko nga nëntë deri më pesëmbëdhjetë qershor. Do të ndjek makinat me një aeroplan të vogël Cessna. E mban mend kur të thashë që e kaloj ditën duke luajtur kukamfshefti? Njohim ca njerëz të këqinj dhe i ndjekim për të parë cilët janë partnerët e tyre dhe ku e çojnë drogën.

Do të përpiqem të vij në Shqipëri një apo dy ditë më pas. Kam ndër mend të marr dy javë pushime nga puna. Të lutem, siguro që çdo gjë të jetë gati që të të sjell në shtëpi. Do të sjell dy valixhet e mia të mëdha bosh për ty. Do të udhëtoj shumë lehtë, por do ta sjell një kostum dhe këpucë të mira. Po të duash mund të sjell edhe dy çanta dore të mëdha. I palos në valixhe në ardhje dhe ti mund t'i mbushësh në kthim. Mendo për gjërat që do të marrësh me vete.

Qeveria nuk po ma paguan hotelin këtë radhë, kështu që do më duhet të gjej hotel të lirë. Qendra Stefan ka një dhomë ku mund të rri me të lirë. Nuk do të kem as status diplomatik këtë radhë. Do të udhëtoj me një pasaportë turistike biznesi. Nuk do t'i di me saktësi datat e udhëtimit tim atje dhe të kthimit tonë derisa të flas më një agjensi udhëtimi. Të lutem më bëj të ditur çfarë do të bësh kur të më kesh atje. Të del kaq kohë për të mbaruar punët e tua para se të vish në Kalif.? Unë do të të marr në telefon nesër mbrëma, ose të hënën në mëngjes, për ty. Bëji të fala Fabricios dhe kallaballëkut të S.A.M.-it nga unë. Të dua dhe nuk pres dot sa të të marr në shtëpi!

TË DUA SHUMË!

Ua solla prindërve faksin tjetër me lajmërimin e shumëpritur të mbërritjes së Majkut, kur shkova për të marrë gjithë dokumentat që më duheshin për martesën tonë të dytë. Majku e kishte shkruar edhe këtë në formën e një artikulli gazete.

Udhëtim nga bregu në breg

8 qershor 1995

Lajme

MAJKËLL KTHEHET NË TIRANË PËR TË SJELLË NË SHTËPI GRUAN E DASHUR

Burri i Mirela Klainit do të mbërrijë në qytetin e Tiranës më 20 qershor 1995. Majkëll do të mbërrijë me fluturimin AZ-500 në 1:05 mbasdite me orën lokale. Majkëll do të bashkohet me Mirelën për të plotësuar dokumentat e vizës së Mirelës. Majkëll e Mirela do të largohen nga Tirana më 27 qershor 1995 në 1:50 mbasdite me fluturimin AZ-501. Çifti do të kalojë një natë në Romë së bashku dhe do të niset për Majami të Floridës të nesërmen në mëngjes në 9:30 paradite sipas orës lokale. Dy të lodhurit do të mbërrijnë si përfundim në Shtetet e Bashkuara më 28 qershor 1995, në qytetin e Majamit në shtetin e Floridës në orën katër mbasdite. Pritet që të duhen të paktën dy orë për të shqyrtuar dokumentat e nevojshme me INS në Aeroportin Ndërkombëtar të Majamit. Pas kalimit përmes INS dhe doganës, dyshja udhëtare do të marrë një makinë me qera në aeroport. Nëse lejon koha, Majk e Mirela mund të hanë darkë me një shok të Majkut – Arminin dhe të shoben. Majkëll e Mirela pastaj do të fillojnë udhëtimin e tyre prej dyqind milje me makinë për në qytetin e Orlandos në Florida. Sa për një ide, gjithë vendi i Shqipërisë është dyqindpesëdhjetë milje i gjatë.

Klainët kanë në plan të ndalen në një hotel rrugës për në Orlando. Më 29 qershor 1995, Klainët do të regjistrohen në një hotel në pronën e Botës së Diznit, ku do të kalojnë tri ditët pasardhëse duke zbuluar Mbretërinë Magjike dhe duke pushuar. Më 2 korrik 1995, Klainët do të fluturojnë nga Orlando me linjën ajrore American për t'u kthyer në Los Anxheles të Kalifornisë, ku çifti do të takohet me familjen dhe miqtë që duan të takojnë Mirelën.

Hallë Luiza punon pa pushim për të prenotuar biletën e çiftit

Halla e Majkut, Luiza, që është agjente udhëtimi për Pioneer Travel, i kurseu çiftit mijëra dollarë duke kërkuar dhe gjetur kombinimin më të mirë të mundshëm vajtje-ardhje për në Shqipëri. Majkëll i dërgoi hallë Luizës një fotografi të nuses së tij të re. Hallë Luiza i ktheu një shënim që thoshte: “Duket absolutisht magjepsëse – buzëqeshje rrezatuese. Urime! Mezi pres ta takoj.”

Mirela do të shkojë tek ambasada italiane për vizë kalimtare

Mirela Klain zbuloi se mund t'i duhet të dalë një xhiro nga ambasada italiane për të pyetur nëse i duhet ndonjë vizë kalimtare për të ndenjur natën e njëzeteshtatë qershorit në Romë. Nuk dihet tani për tani nëse Mirelës i duhet vizë për të dalë nga aeroporti i Romës sa për të fjetur në hotel. Pa këtë vizë, çiftit mund t'i duhet të rrijë brenda aeroportit derisa të nisen të nesërmen në mëngjes në orën nëntë e gjysmë. Çifti do të mbërrijë në Romë në orën tre e dhjetë mbasdite. Nëse u duhet të presin brenda terminalit të aeroportit, do të thotë një pritje prej më se tetëmbëdhjetë orësh.

Nensi, motra e Majkut, banon në qytetin Plazhi i Gjatë me të shoqin dhe dy fëmijët e tyre. Majkëll e Mirela ndoshta do ta kalojnë natën në shtëpinë e Ronit e të Nensit kur të kthehen në Kaliforni.

Bota e Diznit

Bota e Diznit, një version shumë i përmirësuar i origjinalit Toka e Diznit, është parku argëtues më i mirë në gjithë Amerikën. Nuk dihet me siguri nëse do të jetë e mundur për Majkun e Mirelën të shikojnë çdo gjë në vetëm tri ditë, por ata do të përpiqen. Do të ndihmohen nga fakti që do të rrijnë në një hotel pranë parkut gjigant. Kjo do ta lejojë çiftin të kthehen për pushim ndërmjet ecejakeve zhbiruese në parkun argëtues të paanë.

Festimi i katër korrikut në Sh.B.A.

Katër korriku është dita e pavarësisë së Amerikës. Kjo festë kombëtare është dita kur Shtetet e Bashkuara shpallën pavarësinë e tyre nga Britania e Madhe. Zakonisht festohet me shfaqje fishekzjarresh të panumërta dhe parada. Është një ditë pikniku dhe mbledhjeje me familjen.

Majkëll udhëton për punë në Oakland të Kalifornisë

Majk do të udhëtojë nesër për të punuar në Oakland të Kalifornisë. Do të drejtojë përgjime të personave të dyshimtë nga një aeroplan i vogël Cessna. Majkëll do të kalojë afërsisht tetë orë në ditë duke fluturuar në një Cessna 210 të vogël duke ndjekur kriminelë të dyshimtë në zonën e gjirit. Majku pritet të kthehet në shtëpi më pesëmbëdhjetë qershor. Ai do të rrijë në hotelin Hilton në Oakland gjatë kësaj kohe. Majk mund të gjendet atje ose duke kontaktuar zyrën e tij në Riversajd.

Majkëll shpall dashurinë e tij për Mirelën

Majkëll është dëgjuar të deklarojë dashurinë për gruan e tij të bukur, Mirelën: “Të dua shumë!”. Ai ishte dëgjuar duke thënë: “Po vij të të marr!”.

Kur ia përktheva letrën prindërve të mi, ata u lumturuan që Majku po vinte së shpejti dhe që po rrinte për një javë të tërë. Pastaj u kujtuan që kishin më pak se dy javë kohë për t’u përgatitur për një dasmë sipas traditës, për të cilën unë nuk po e vija shumë ujët në zjarr, por që ata këmbëngulën ta bënin.

- Po unë u martova, o ba. Pse i harxhon paratë kot? – e pyeta.

- Pse më mbytën çupat mua që të të nis pa u ndjerë? Dua të ftoj edhe unë vëllezër e motra për një dasmë të vogël. Po edhe jot ëmë do të ftojë racën e saj, - tha babi i vendosur.

- Ku do t’i vësh gjithë këta njerëz?

- E bëjmë drekën të dielën. Vijnë njerëzia në mëngjes, hanë e pinë edhe ikin mbase. Mbase marrim me qera atë lokalin e vogël të lagjes dhe e bëjmë drekën përjashta, në oborr. Hapim edhe ca tenda. Yt vëlla njeh muzikantët më të mirë në qytet për orkestrën, - tha mami.

- E bëri planin mamaja, - qesha.

- Ne kemi pothuasje dy javë. Ti e bëre tënden për katër ditë. Bëmë mama të të ngjaj.

- Pa Zotin, një vrimë në ujë do kisha bërë, - ia prita.

- Lutju Zotit prapë, atëherë! – sugjeroi mami. – Pastaj nuk ke qejf të veshësh një çikë fustan të bardhë si gjithë dynjaja? – pyeti mami.

- Unë jam me barrë, o ma. Fustani është i bardhë, sepse përfaqëson pastërtinë e një nuseje të virgjër.

- E di, po prapë. Si ndjehesh, meqë ra fjala? Je duke ngrënë mirë?

- Po të dua, ha mirë në punë. Po nuk kam oreks për asgjë përveç bukës së thekur me majonezë dhe frutave, sidomos kivi.

- Oreksi vjen me të ngrënë, - u hodh babi. – Ha sa të mundësh. Po ha për dy veta tani.

Kur mbërrita në punë të hënën tjetër, gjeta një shënim të shkurtër të papritur nga Majkëll. Shumica e faqes ishte zënë nga një pikturë e madhe e miut Miki duke puthur Minin në faqe me një çikë tekst në të majtë.

*11 qershor 1995
Zj. Mirela Klain
Fondacioni Soros*

Të dua! Të dua shumë!

E dashur lozonjare,

Një shënim të shpejtë këtu për ty. Munda të vija në shtëpi për një natë, por po nisem për Oakland pas dhjetë minutash. Kemi kapur një kriminel me gjysmë milioni dollarë në para deri tani. Je gati për të parë Botën e Diznit? Kështu shpresoj.

*Me dashuri,
Majkëll*

Majkëll përsëriti itinerarin e udhëtimit të tij edhe një herë të fundit më shtatëmbëdhjetë qershor, tri ditë para se të mbërrinte.

*17 qershor 1995
Zj. Mirela Klain
Fondacioni Soros*

E dashur Mirela! Të dua shumë!

Unë do të mbërrij këtë të martë në orën 1:05 mbasdite në fluturimin numër 500 të Alitalia-s. Shpresoj të të shoh te aeroporti. Të lutem, pyet Fabricion ose Samin nëse mund të vijnë të më ndihmojnë në aeroport! Kam disa dhurata për familjen tënde dhe nuk dua probleme me doganën shqiptare. Kam edhe një hartë të Sh.B. për Xhonin.

Ne do të nisemi për në Shtetet e Bashkuara të martën, më njëzeteshtatë qershor në orën 1:50 mbasdite në fluturimin Alitalia me numër 501. Do ta kalojmë natën në Romë. Kam rezervuar dhomë në një hotel me katër yje në Romë. Dhomën e hotelit në Romë na e ka bërë hallë Luiza dhuratë për martesë.

Më njëzetetë qershor, do të fluturojmë për në Majami, Florida. Do të mbërrijmë në orën tre mbasdite. Duhet të kalosh letrat nëpër INS. Do të

marrim një makinë dhe do ta ngasim dyqindepesëdhjetë milje për në Orlando, Florida. Do ta kalojmë natën rrugës në një motel. Nuk kam rezervuar gjë se nuk na duhet. Do ta kthejmë makinën tek aeroporti i Orlandos. Nuk do të na duhet më. Do të rrimë te hoteli “Buena Vista Palace” te Bota e Diznit. Në hotel do të rrimë tri ditë. Do të ikim nga Florida për në shtëpi më dy korrik me një ndalesë në Dallas, Texas. Do të na presë dikush; nuk e di se kush. Makina jonë është te shtëpia e mamasë sime. Ne banojmë rreth gjashtëdhjetë milje nga shtëpia e saj. Pastaj shohim e bëjmë. Më duhet të kthehem në punë më pesë korrik. Dua të të çoj në shtëpi, që të jesh rehat kur të shkoj në punë. Po dua edhe të të nxjerr një çikë vërdallë.

Pasi të mbarojmë punë me dokumentat në Tiranë, jam i tëri nën urdhrat e tua. Dua që të takosh gjithë familjen dhe miqtë e tu, sepse mund të mos i shikosh më për njëfarë kohe.

Dua të të dërgoj në një program katërjavësh intensiv anglishteje (njëzetekatër orë në javë) që ndodhet në Universitetin e Riversajdit në Kaliforni. Universiteti është pesë minuta më këmbë nga shtëpia jonë. Kursi fillon më tre gusht dhe mbaron më një shtator. Ky kurs drejtohet nga programi i arsimimit ndërkombëtar. Do të mund të bësh pyetje për ne, amerikanët, dhe gjërat e mbrapshta që bëjmë. Gjithashtu, mund të bësh muhabetë grash me motrën dhe kumatën time.

*Gjithë dashurinë time,
Majkëll*

Më njëzet qershor 1995, unë, disa nga shoqet e mia dhe im vëlla po prisnim jashtë portës së vetme të aeroportit “Nënë Tereza” për mbërritjen e Majkut, kur ndjeva një debulesë të njohur nga mesi e poshtë. *Hajde! Dashurokam prapë!* Çfarë kujtese e gëzueshme! Sa konfirmim i mirëpritur pas dy muajsh në ecje raskapitëse vetëm me besim! Kisha qenë shumë e zënë duke mundur sulmet e dyshimeve dhe të shqetësimeve për dashurinë e tij dhe ribashkimin tonë. As që më kishte rënë ndër mend të mendoja për ndjenjat e mia.

Siç kishte premtuar, Majkëll doli dhe qëndroi i gjatë e simpantik, me flokët e verdha edhe më të gjata e kaçurrela seç i mbaja mend. Hodhi sytë rreth e qark, mbi shoferët e taksive që po i ofronin ta çonin në kryeqytet, derisa dallooi dorën time që po valëvitja në erë. Vrapova drejt tij dhe i hodha krahët në qafë. Ai më ngriti peshë dhe më rrotulloi për qark. Pastaj më mbajti për

dore duke zbritur shkallët. Shoqet dhe vëllai im i çliruar e puthën me radhë në të dyja faqet – mirëseardhja shqiptare. Majkëll më mbajti për dore kudo që shkuam dy-tri ditë më pas. Më dukej vetja si vajzë e vogël gjithandej nga shkonim nëpër qytet për të plotësuar gjithë dokumentat e nevojshme për vizën time të përhershme dhe nisjen time pas një jave.

Dhëndri im e mbajti fjalën dhe u kthye për të marrë nusen në shtëpi. Perëndia e mbajti fjalën. Perëndia gjithmonë i qendron besnik premtimeve të tij ndaj meje.

EPILOG

Kanë kaluar dy javë qëkur i dërgova gazetës lokale tregimin tim dyqindfjalësh për Shën Valentinin. E kisha harruar fare derisa më befason një nga gazetarët me një lajm të shkurtër elektronik. Është një ftesë që ta telefonoj dhe të caktoj një datë për intervistën dhe fotografimin tonë si çift. Janë të interesuar për historinë tonë dhe duan ta përshkruajnë në një artikull të shkurtër. Nuk mund ta fsheh ngazëllimin kur i jap lajmin Majkut.

- Do të dalim në gazetë!

- Për çfarë? – pyet Majkëll.

- Harrove ti? Për tregimet e dashurisë që po botojnë për artikullin e Shën Valentinit. Kanë zgjedhur tonën! – përgjigjem ende e çuditur.

- Dukesh e befashuar. Nuk të thashë unë që do ta pëlqenin historinë tonë? – thotë Majk duke buzëqeshur.

- Më the dhe kishe të drejtë. Duhet të përgatitemi për intervistën! Çfarë të vesh? Po mendoj ndoshta kostumin rozë që më ke blerë ti. Vetëm se është nja pesëmbëdhjetë vjeç. Pastaj, rozë sikur është bërë bozë me Shën Valentinin. Po sikur të vesh kostumin ngjyrë qumështi? Apo e ka fundin shumë të shkurtër? T'i mbledh flokët lart apo t'i lëshoj? – vazhdoj ta bombardoj me pyetje duke kërcyer pupthi mbas tij, ndërsa ai ecën nga korridori te dhoma e gjumit e prapë në korridor për te kuzhina.

- Po, po, - përgjigjet Majku herë pas here.

- “Po” është i shkurtër apo “po” që ta vesh? – ngul këmbë unë, edhe pse e di që Majkëll as po më kushton vëmendje as i bëhet vonë për gjithë këtë muhabet.

- Vish çfarë të duash, - përgjigjet.

- E di që do të na nxjerrin fotografi? U, sa mirë! Herën e fundit që dolëm fotografi bashkë në studio, ishte para trembëdhjetë vjetësh, kur na erdhën prindërit e mi për vizitë. Jo se dukem më mirë tani që jam më e moshuar, po më pëlqejnë fotografitë, gjithsesi, - i përgjigjem. – Obobo!

- Ç'ke tani?

- Më duhet të shkruaj libër tani.

- Pse? Për çfarë? – përgjigjet Majkëlli dhe unë e di që tani po më dëgjon me vëmendje të plotë.

- Sapo u kujtova që i premtova Zotit.

- Çfarë lloj premtimi?

- I premtova Perëndisë që, në qoftë se gazeta e zgjedh historinë tonë të njohjes dhe martesës, unë do të shkruaja një libër për të.

- Ç'të gjeti ty që ta bëje atë? – pyet Majkëlli.

- Pashë një ëndërr para ca muajsh sikur po qëndroja para një salle plot me njerëz duke u thënë si dhe ku u takuam për herë të parë. E konsiderova përzgjedhjen e tregimit tonë nga gazeta si konfirmim të dytë.

- Ose përmbushje të ëndrrës. Lexuesit e gazetës janë një “sallë” goxha e madhe, - përgjigjet burri im mendjendritur dhe unë e kuptoj që mund të ketë të drejtë. Por është shumë vonë tani. E kam bërë premtimin dhe e di mirë që nuk mund ta thyej. (“Kur i ke bërë një zotim Perëndisë, mos vono ta plotësosh, sepse ai nuk kënaqet me budallenjtë; plotëso zotimin që ke marrë. Më mirë të mos marrësh zotime, se sa t'i bësh dhe të mos i plotësosh,” thotë Bibla tek Predikuesit 5:4-5).

Përmbajtja:

1.	Në Pogradec.....	7
2.	Në fillim.....	25
3.	Ndërmjet.....	34
4.	Loz e qesh derisa.....	45
5.	Në Berat.....	59
6.	Në Greqi.....	69
7.	Në Cakran.....	82
8.	Sërish në shkollë.....	99
9.	Fikur.....	108
10.	Ndezur.....	120
11.	Një ndërgjegjësim i ri.....	132
12.	Mirupafshim apo lamtumirë?.....	147
13.	Sërish në rrugë.....	161
14.	Rruga e gjatë e kthimit.....	179
15.	Një lindje e re.....	190
16.	Një dhomë e re.....	202
17.	Një punë e re.....	219
18.	Një vit i ri.....	234
19.	Një zyrë e re.....	248
20.	Një premtim i ri.....	264
21.	Njëzetepesë.....	278

22.	Një ëndërr e re.....	292
23.	Përpyjekja e parë.....	306
24.	Përpyjekja e dytë.....	321
25.	Nga Kalifornia me dashuri.....	337
26.	Ardhja e dytë.....	359

Cip. Katalogimi në botim - b.K.
TIRANË

Shpënguar prej Krishtit, Përktheu:
Mirela M Kuhn, -Tiranë : dy Lindje dhe dy
Perëndime, 2014
380 f ; 23 cm

ISBN: 978-99956-609-4-9